

KDU 811.18-26
008 (=18)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME
19
2012



PRISHTINË
2013

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Kosova Academy of Sciences and Arts

STUDIME

19

2012

Del një herë në vit.
Published annually.

Këshilli redaktues - Editorial Board

Rexhep Ismajli - Kryeredaktor, Editor-in-chief

Eqrem Basha - Sekretar, Secretary

Pajazit Nushi - Anëtar, Membre

Tahir Emra - Anëtar, Membre

Idriz Ajeti, kryeredaktor nderi - editor-in-chief of honour

Adresa e Redaksisë:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Redaksia e revistës Studime

Rr. Agim Ramadani, p.n.

10 000 Prishtinë

Tel. + 381 38 249 303

Fax. + 381 38 244 636

E-mail: ashak@ashak.org

Shënim:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka vendosur që revista “Studime” me këtë shtrirje fushash studimore të mos vazhdojë më tutje. Në vijim nga numri i ardhshëm do të dalin dy revista të specializuara: njëra për shkencat shoqërore, me redaksi të re, ndërsa kjo me po këtë titull dhe me redaksi të re do të vijojë si revistë e specializuar për fushat filologjike. Redaksia.

Udhëzime për autorët e punimeve të propozuara për botim

Për botim në revistën Studime do të merren në konsideratë ndihmesat që nuk janë botuar më parë (pos në raste të veçanta) dhe që paraqesin rezultate hulumtimesh origjinale shkencore, profesionale apo të zbatuara të autorit në fushat e shkencave filologjike dhe shoqërore, të cilat nuk i prekin të drejtat autoriale të të tjerëve. Për të gjitha punimet e paraqitura për rubrikën **Artikuj - studime** Redaksia merr parasysh procedurën e recensimit. Recensionimi mbetet në Redaksi, ndërsa emrat e recensuesve nuk bëhen të njohur për autorin e punimit. Për të tjerat vendos Redaksia. Për origjinalitetin dhe cilësinë e ndihmesave përgjigjen vetë autorët.

Punimi i paraqitur duhet të përmbajë:

Emrin dhe mbiemrin e autorit, vendin ku jeton e vepron ai aktualisht dhe titullin e punimit. Pastaj vjen Abstrakti me jo më shumë se 200 fjalë, ndërsa në vijim, para punimit, shënohen deri në 10 Fjalë çelësa. Në fund të punimit duhet të ketë një Rezyme: nëse punimi është në një gjuhë zyrtare të Kosovës, rezymeja duhet të jetë në një prej gjuhëve me qarkullim të gjerë (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe e kundërta në rreth 1 faqe. I tërë punimi mund të shtrihet më së shumti deri në 8 faqe A4 të radhitura me kompjuter Microsoft Word (210x297 mm), me margjina 20 mm., fonti Times New Roman 12 pt me radhor Normal. Abstrakti, Fjalët çelësa, Rezymeja dhe Bibliografia duhet të jenë në Times New Roman 10 pt. Literatura e punimit jepet në fund, ndërsa fusnotat në tekstin me të cilin ndërlidhen, në fund faqeje. Figurat dhe tabelat jepen në tekst. Në literaturë dhe fusnota duhet të shënohen: emri dhe mbiemri i autorit, titulli i punimit të cituar, titulli i publikimit, botuesi, vendi i botimit, viti i botimit, nr. i faqes (faqeve). Kur citohet shqip: f. për një f. dhe ff. për më shumë faqe (në gjuhë tjetër: p., përkatësisht pp.).

Referimet në fusnotë zakonisht shënohen si vijon:

ÇABEJ, Eqrem (1976): **Studime gjuhësore III**, Rilindja, Prishtinë, ff. 303-406.

Nëse citohet një punim në revistë:

DOMI, Mahir (1979): La linguistique albanaise en ce 35e anniversaire de la Libération, në **Studia albanica XVI, 2**, Tirana, pp. 15-28.

BELLUSCIO, Giovanni M. G. (2005): L'aspetto fonetico della parlata arbëreshe di Spezzano Albanese (CS), in Genesin, Monica und Matzinger Joachim (Herausgegeben von): **Albanologische und balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried Fiedler**, Verlag Dr. Kovač, Hamburg, pp. 1-12.

Ndihmesa e propozuar duhet të jetë korrektuar gjuhësisht sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes standarde/ të gjuhës në të cilën është shkruar. Redaksisë i dorëzohet versioni elektronik. Autorët që përdorin shenja të veçanta duhet t'i dorëzojnë dhe fontet përkatëse, ashtu si dhe një version në letër apo PDF, për identifikim të shenjave të veçanta.

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Redaksia rezervon të drejtën për të mos dhënë shpjegime në rast se nuk botohet ndihmesa e paraqitur.

LIGJËRATA
TË ANËTARËVE TË RINJ TË ASHAK-UT

Akademik Hivzi ISLAMI

FJALA E KRYETARIT TË ASHAK

Kolegë dhe miq të nderuar, Zonja dhe Zotërinj,

Na ka tubuar sot profesori dhe studiuesi i shquar, miku ynë i dashur, prof. dr. Kolec Topalli, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, tashmë anëtar i jashtëm edhe i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i zgjedhur në Kuvendin e saj, të mbajtur më 5 Dhjetor 2012, me propozim të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe të aprovuar nga Kryesia e ASHAK-ut. Do të kemi rastin t'i dorëzojmë sot *Fletëdëshminë e anëtarit të jashtëm* të Akademisë sonë dhe njëkohësisht të ndjekim ligjëratën e tij.

Akademik Topallin e njohim të gjithë, jo vetëm për kontributin e jashtëzakonshëm në fusha të ndryshme të studimeve albanistike, mbi të gjitha në ato të fonetikës historike dhe të gramatikës historike, për kontributet e shumta në studimet e shqipes së hershme dhe asaj të sotme, por edhe si pjesëmarrës të rregullt dhe të zellshëm në konferencat tona shkencore, në tryezat, në diskutimet, në përrurimet dhe në aktivitetet e tjera që organizon Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. E kemi konsideruar gjithnjë si pjesë të rrethit tonë, prandaj dhe zgjedhja e tij u prit e u vlerësua aq lart.

Janë të rrallë studiuesit që kanë gjerësinë dhe thellësinë e intereseve të akademik Kolec Topallit. Janë të rrallë shkencëtarët që kanë energjinë dhe frytshmërinë e rezultateve të kërkimeve të tilla. Mjafton t'u hedhet një sy botimeve voluminoze, kapitale në fushë të fonetikës dhe gramatikës historike, të realizuara në një periudhë relativisht të shkurtër kohore, për ndërmarrje kaq të gjera, për t'u bindur në seriozitetin e përkushtimit të tij shkencor.

Është mahnitës fakti se gjithë ai vëllim prodhimi kulmor është rezultat i punës së një njeriu, derisa ne do të thoshim se është i denjë për punën e një instituti të tërë, i një ekipi të gjerë kërkuesish e studiuesish. Kur t'i shtojmë gjithë kësaj faktin se akademik Topalli është persekutuar dhe

penguar pothuaj gjatë gjithë kohës sa ka zgjatur diktatura komuniste për të realizuar ëndrrën e tij, duke u internuar dhe transferuar në fshatra të largët, atëherë bëhet edhe më e qartë sakrificat e madhe dhe energjia e jashtëzakonshme që i është dashur të bëjë për të rrumbullakuar një opus kaq të gjerë. Pengesat për ta evituar si shkencëtar e gjuhëtar për Topallin nuk patën ndikim demoralizues e frustrues. Përkundrazi, ai gjeti forcën morale, durimin, besimin dhe vullnetin e pashoq se cilësitë e punës së tij shkencore-hulumtuese do të marrin vlerësim publik të merituar. Dhe e morën, dhe kjo na nderon dhe ne si miq e kolegë të tij dhe e nderon edhe shkencën albanologjike kudo në botë.

Kolegë dhe miq,

Më lejoni në fund t'i uroj akademik Kolec Topallit shëndet dhe jetë të gjatë, duke pritur vepra të reja, të frytshme shkencore kështu kuptimplotë dhe të rëndësishme për shkencën dhe kulturën tonë dhe ta ftoj të marrë *Fletëdëshminë e mirënjohjes* sonë për punën e tij, duke e zgjedhur anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe t'ju ftoj të ndjekim bashkë ligjëratën e tij me titull "*Disa rezultate në studimin e zhvillimit historik të gjuhës shqipe*".

Akademik Kolec TOPALLI

FJALA E MBAJTUR NË AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS¹

Më lejoni të them dy fjalë zemre për këtë rast unik në jetën time.

Jeta e çdo njeriu ka ditë të veçanta, mbi të cilat është e papushtetshme mbretëria e harresës. Një e tillë është për mua kjo e sotmja. Dhe kjo ditë është e mbushur me kujtime, me mirënjohje, me falënderime, me premtime.

Kujtimet e para për këtë pjesë të Atdheut kanë qenë shumë të trishtuara. Për arsye që dihen, kam mundur të shkel në këtë tokë të bekuar vetëm në shekullin XXI në vitin 2001, menjëherë mbas luftës së vetme që njohu e gjithë Europa që nga lufta e dytë botërore. Dhe dita e sotme më bën të kujtoj vizitën e parë në Kosovën martire, të shkatërruar e të shkrumbuar nga lufta, me shtëpitë e djegura të Gjakovës e me rrënoja përgjatë gjithë rrugës deri në Prishtinë. Por çdoherë që kam ardhur në vitet në vijim, kam parë ndryshimet e mëdha, ndërtime, njerëzit e lirë, që më ofruan kurdoherë miqësi e mikpritje, dashuri e respekt. Jua them me sinqeritetin tim më të plotë, se me përjashtim të Shkodrës, vendlindjes sime, nga të gjitha vendet e Shqipërisë dhe të trevave shqiptare, qyteti ku kam ardhur më shpesh dhjetëvjeçarim e fundit, ku kam gjetur më shumë bujari e ngrohtësi, është Prishtina, që tashmë është e pandarë nga puna ime. E sot, kur Akademia e Shkencave më bën pjesë të saj, e ndiej më shumë se kurrë afërsinë me këtë copë të Atdheut, me të cilën s'patëm kurrë kufij natyrorë, ndërsa kufijtë e vendosur nga njerëzit janë gjithnjë të përkohshëm, se Atdheu i shqiptarëve është i pandashëm. Prandaj e ndiej për detyrë të falënderoj nga zemra të gjithë akademikët që pranuan të jem pjesë e tyre, miq prej vitesh e dashamirë të punës sime, me të cilët kam ndarë çaste të bukura sa herë jam takuar me ta, në Kosovë e në Shqipëri.

Por anëtarësimi në këtë akademi, përveçse nder e mirënjohje, është edhe premtim për punë. Ndërmjet dy pjesëve të Atdheut tonë ka shumëçka

¹ Me rastin e pranimit anëtar i Akademisë, më 28. 02. 2013.

për të bërë. Le të jetë shkenca, kultura, arsimi, arti, fjala e lirë, gjuha e gjithçka që ka krijuar ky popull bashkërisht, simboli i bashkimit të Atdheut të copëzuar pa dëshirën e shqiptarëve. Kosova e Shqipëria le të jenë si dy krenët e shqiptonjës së flamurit tonë kombëtar, me një trup të vetëm, me një shpirt, me një zemër, që rreh në të gjithë trupin, me gjakun që qarkullon në të dyja anët. Le të jetë bashkimi, rruga jonë. Ndasitë e përçarjet le t'ua lëmë atyre që i krijuan.

U lutem kolegëve akademikë të mos ngurrojnë për të kërkuar angazhimin tim në punët e përbashkëta për të njësuar mendjet e zemrat tona, se angazhimi im do të jetë i plotë për çdo detyrë të ngarkuar, për çdo thirrje të tokës shqiptare në të dy anët e kufirit të saj, se titulli që jepet sot është jo vetëm nder e respekt, por në radhë të parë angazhim pune.

Falënderoj të gjithë të pranishmit që u ndodhët në këto çaste gëzimi të paharrueshëm, në këtë ditë në shenjtë të jetës sime.

Kolec TOPALLI, Tiranë

DISA REZULTATE NË STUDIMIN E ZHVILLIMIT HISTORIK TË GJUHËS SHQIPE¹

Me synimin e paraqitjes së disa prej rezultateve të punës sime në studimin e gjuhës shqipe, dëshiroj t'i bëj të njohur këtij auditori të nderuar disa aspekte të hulumtimeve në tri fusha të rëndësishme të gjuhës: fonetikës, gramatikës historike dhe etimologjisë.

E kam nisur punën kërkimore para më shumë se 40 vjetësh, në fillim të viteve '70. Që në hapat e parë, krahas problemeve të shqipes së sotme, më tërhoqën gjeneza dhe burimi i dukurive të ndryshme. Prandaj edhe artikujt e parë janë një përzierje e dy aspekteve të studimit të gjuhës: sinkronisë e diakronisë. Por pas artikujve të parë, të botuar në vitet '80-'90, iu kushtova tërësisht studimit historik të gjuhës, ku kanë dhënë kontribut të vyer shumë emra gjuhëtarësh të huaj e vendas, në radhën e të cilëve spikasin edhe dijetarët e akademikët nga Kosova: Selman Riza, Idriz Ajeti, Besim Bokshi e Rexhep Ismajli. E kam pasur dhe e kam për nder të eci në gjurmët e këtyre shkencëtarëve të nderuar, si edhe shumë të tjerëve nga Shqipëria e nga ngulimet arbëreshe, që punuan me përkushtim të veçantë, krahas gjuhëtarëve të huaj, që janë marrë me studimin e gjuhës shqipe.

Faza e parë e studimeve të mia është ajo e hulumtimeve në fushë të fonetikës historike, fryt i të cilave janë 8 monografi për kapitujt më të rëndësishëm, duke u përmbyllur kjo fushë me hartimin e veprës "Fonetika historike e gjuhës shqipe". Disa prej rezultateve të kësaj pune janë këto që vijojnë.

1) Në punë të theksimit të fjalëve, shqipja, në një kohë të hershme të zhvillimit të saj, që mund t'i përkasë periudhës parahistorike, ka kaluar nga theksi i lirë i indoeuropianishtes në theks të ngulitur në rrokjen nistore, ashtu si disa gjuhë të tjera të familjes indoeuropiane, siç janë gjuhët gjermanike, letonishtja, çekishtja, latinishtja në fazën parahistorike etj.

¹ Ligjëratë e mbajtur në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 28. 02. 2013, me rastin e pranimit anëtar i jashtëm i saj.

Dëshmi për këtë dukuri janë huazimet më të lashta që kanë hyrë në gjuhën shqipe nga greqishtja e vjetër e latinishtja dhe e kanë zhvendosur theksin e fjalës nga një pozicion më fundor në rrokjen nistore; si p.sh.:

Nga greqishtja e vjetër	Nga latinishtja	Në gjuhën shqipe	Nga latinishtja	Në gjuhët gjermanike
μᾶχανά		mokën / mokër		
	oleáster	voshtër	monēta	gjerm. Münze
	compáter	kumtër	fenēstra	gjerm. Fenster
	nováster	noshtër	cellārium	gjerm. Keller
	Geórgius (it. Giorgio)	Gjergj	tolonārius	gjerm. Zöllner
	Johánnes (it. Giovanni)	Gjon	Johánnes	ang. John

Në një fazë të dytë të zhvillimit të saj, shqipja ka kaluar në theksim parafundor, ashtu si latinishtja, polonishtja e kymrishtja e re, një gjuhë e grupit kelt. Me këtë dukuri, shqipja e vendos theksin e fjalës në rrokjen e fundit të temës para mbaresës, duke krijuar bashkë me mbaresat fjalë parafundore. Edhe kjo dukuri mund të ndiqet me huazimet më të vona që kanë hyrë në shqipe nga gjuhë me të cilat ka pasur marrëdhënie në periudhën e mesjetës.

Huazime sllave	Në gjuhën shqipe	Huazime italiane	Në gjuhën shqipe	Huazime greke	Në gjuhën shqipe
lëdina	lëndinë	mácchina	makínë	φάκελος	faqéll
lópata	lopátë	bálsamo	balsám	τριανδάφυλος	trëndafil
névolja	nevójë	fábrica	fabríkë	πάτος	Patós

Theksim nistor ka pasur ilirishtja, çka përbën një argument të fortë të lidhjeve gjenetike me këtë gjuhë të vjetër, të folur në Gadishullin Ballkanik. Kurse kalimi i shqipes në theksim parafundor është një dukuri e brendshme e saj, që është zhvilluar në kohën e vonë latine, gjithësesi në mijëvjeçarin e parë, dhe siç e dëshmojnë shembujt e dhënë, ka filluar të veprojë para fillimit ose në fazën më të hershme të marrëdhënieve me gjuhët sllave, me italishten dhe me greqishten e mesme e të re. Pas këtij procesi në sistemin prozodik të gjuhës shqipe nuk kanë ndodhur ndryshime të tjera.

2) Se ç'rol ka luajtur ndryshimi i theksit të gjuhës shqipe, mund ta ilustrojmë me evolucionin e fjalëve që nisin me grupin tingullor: vo- / va-. Ky grup tingullor historikisht ka origjinë diftongore, meqenëse është

formuar nga zbërthimi në diftong i zanores /o/ në një periudhë të hershme të shqipes, gjë që duket në rrethin e ngushtë të fjalëve që ka përfshirë.

	Fjala shqipe	Burimi	
Të tra-shë-guara	<i>vorr / varr</i>	ie. <i>ēr-</i> “dhe, tokë”, gr. <i>hñáð</i> , gjerm. l. vj. <i>erda</i> “dhe, tokë”	
	<i>vojta / vajta</i>	ie. <i>ēj-</i> “shkoj, eci”, lat. <i>eo</i> , gr. <i>ἀγιέ</i>	
	<i>votër / vatër</i>	ie. <i>āt-</i> , av. <i>ātarš</i> , pers. re <i>ādar</i> “zjarr”	
	<i>vok / vak</i>	ie. <i>āiq¹⁸</i> - “i rrafshët, i përshtatshëm”, lat. <i>aequus</i> “i barabartë”	
	<i>vesh</i>	ie. <i>āuðs-</i> “vesh, dëgjim”, lit. <i>ausis</i> , got. <i>ausō</i>	* <i>vosh ~ vesh</i> khs. <i>i vogël ~ të vegjël</i>
Hua-zime të moç-me	<i>vodhë / vadhë</i>	gr. vj. <i>ἴνϗ</i>	
	<i>voj / vaj</i>	lat. <i>olium</i>	
	<i>(i) vorfën / (i) varfër</i>	lat. <i>orphanus</i>	
	<i>voshtër</i>	lat. <i>oleaster</i>	
	<i>vepër</i> <i>(i) verbër</i>	lat. <i>opus ~ opera</i> lat. <i>orbis</i>	- <i>ën / -ër</i> formant shumësi

Ky grup tingullor është krijuar për një periudhë të gjatë kohe duke kaluar nëpër disa faza, nga të cilat e fundit është zhvilluar para periudhës së shqipes së shkruar.

Faza e parë është diftongimi i zanores /o/ në /uó/, ashtu siç ka ndodhur në disa raste edhe në italishte, p.sh.: *uovo* nga lat. *ovum*, *uomo* nga lat. *homo*. Pas këtij procesi, për shkak të theksimit nistor të shqipes së lashtë, theksi i fjalës u zhvendos mbi gjysmëzanoren /u8/, duke kaluar diftongu /u8ó/ në togun zanor /úo/ (faza e dytë). Në këtë fazë ky tog doli në një shteg me togun zanor të fjalëve që përmbanin një sonante hundore a lëngëzore (*ftuo*, *kruo*), prandaj të gjitha këto togje në dialektin e Jugut e shndërruan togun zanor /uo-/ në /ua-/. Pas këtij ndryshimi këto togje u ndanë, meqenëse ndodheshin në pozicione të ndryshme të fjalës; si rrjedhim, togjet /úo-/úá-/, që ndodheshin në ballë të fjalëve, e zhvendosën edhe një herë theksin, këtë radhë nga zanorja nistore në zanoren e dytë të togut (/úo-/úá-/ >/u8ó-/u8á-/). Kjo zhvendosje e dytë, që krijonte fjalë parafundore, ka pasur si shkak rregullimin mekanik të theksit të shqipes. Pas kësaj lëvizjeje

zanorja e ballit të fjalës, që mbeti e patheksuar, u kthye në gjysmëzanore dhe më vonë në fërkimoren /v/, duke krijuar ndryshimin /vo-/va-/ ndërmjet dy dialekteve. Nëse togjet zanore *úo/úa* të fjalëve *voj/vaj*, *votër/vatër* ndoqën një rrugë tjetër që ndryshonte nga ajo e togjeve *úo-/úa-* të fjalëve *ftuo/ftua*, *kruo/krua*, kjo ndodhi për arsye se togu zanor i grupit të parë ishte në kushte të tjera nga ai i grupit të dytë: i pari ndodhej në ballë të fjalës në tema daktilike, kurse i dyti ndodhej në fund të saj në tema trokaike.

VOTËR ~ VATËR : ie. ātar-

otër					
otër	uótër			votër /vatër	
				votër /vatër	


lat. *ovum* > it. *uovo*

lat. *homo* > it. *uomo*

Otër	uótër	Úotër			
				votër /vatër	
Otër	uótër	Úotër			
			úotër /úatër		

					vo- / va-
Otër					
	uótër				
		Úotër			
		úotër /úatër			
			Iótër /Iátër		
				votër /vatër	
O	uó	Úo			
		úo- / úa-	Ió- / Iá-		vo- / va-

on > ð > o					
	óu				
		Úo			
		úo- / úa-			
			Ió- / Iá-		
				vo- / va-	



3) Problemi tjetër që do të trajtojmë është: cila është mosha e tingujve të shqipes? Sigurisht, mosha e tyre nuk mund të përcaktohet ashtu si mosha e një njeriu, por disa rezultate pozitive mund të arrihen duke përdorur metodën krahasimtare, që merr si pikënisje, nga njëra anë, gjuhën indoeuropiane dhe nga ana tjetër, shqipen e sotme.

Shqipja, me 36 fonemat e saj, paraqet një sistem tingullor mjaft të zhvilluar me më tepër fonema se shumë gjuhë të kontinentit tonë. Ky sistem është formuar gjatë shekujve dhe ka ndryshuar me kalimin e kohës. Në të ka tinguj të trashëguar, me moshë sa vetë gjuha; por ka edhe tinguj më të ri, që kanë dalë nga tinguj të tjerë ose janë formuar në rrymë të zhvillimit të brendshëm në periudha të ndryshme të zhvillimit të saj.

Le të analizojmë moshën e zanoreve.

Fazat e zhvillimit	Zanoret	Shembuj
Faza I (e rashëguar)	A	<i>i athët</i> : ie. <i>as-</i> , gr. ἄκρος “majë”, lat. <i>acidus</i> “i thartë”, lit. <i>asztris</i> “i mprehtë”; <i>atë</i> : ie. <i>atta</i> , gr. ἄττα “plak”, got. <i>atta</i> “atë”, lat. <i>atta</i> “kujdestar”; <i>amë</i> : ie. <i>amma</i> , isl. vj. <i>amma</i> “gjyshe”, gr. ἄμμα “nënë”
	I	<i>hi</i> : lat. <i>cinis</i> <i>gji</i> : lat. <i>sinus</i> <i>lidh</i> : ie. <i>liĝ-</i> , lat. <i>ligāre</i> “lidh”
	U	<i>ujë</i> : ie. <i>ud-</i> , ind. vj. <i>udān(i)</i> “ujë”, gr. ὕδωρ “ujë”; <i>(e) tu</i> : ie. <i>tu</i> , ind. vj. <i>tū</i> , gr. (dor.) τύ; <i>tul</i> : ie. <i>tu-</i> “fryhem”, ind. vj. <i>tūlam</i> “tufë puplash, pambuk”, gr. τῦλος “kallo, fryrje”
	E	<i>mbledh</i> : ie. <i>leg-</i> “mbledh”, gr. λέγω, lat. <i>legō</i> “mbledh e lexoj”; <i>kredh</i> : ie. <i>kerd-</i> “hidhem, kërcëj”, irl. vj. <i>focerdaim</i> “hedh”, bret. vj. <i>credam</i> “shkoj” <i>gjerr</i> : ie. <i>sker-</i> “ndaj, pres”, nord. vj. <i>skera</i> “copëtoj”, gjerm. l. vj. <i>sceran</i> “ndaj, pres”
Faza II (para-historike)	O	O-ja (e trashëguar): <i>natë</i> : ie. <i>nokt-</i> , lat. <i>nox, noctis</i> , <i>ah</i> : ie. <i>osk-</i> , gr. ὄζυα O-ja (e sotme): <i>motër</i> : ie. <i>māter</i> , lat. <i>māter</i> , ind. vj. <i>mātār</i> <i>mot</i> : ie. <i>mēt-</i> , lit. <i>mĕtas</i> “vit, kohë”;
Faza III	Y	<i>hyll</i> : ie. <i>sūl-</i> “diell”, <i>shyta</i> : ie. <i>sū-t</i>

(historike)		<i>brymë</i> < lat. <i>brūma</i> , <i>myk</i> < lat. <i>mūcus</i> <i>shtyllë</i> < gr. στύλος, qypër < gr. κύπερη
	Ë	I. Ë-ja e patheksuar: <i>amë</i> : lat. <i>amma</i> , <i>atë</i> : lat. <i>atta</i> <i>pëllambë</i> < gr. vj. παλάμη, <i>frashër</i> < lat. <i>fraxinus</i> II. Ë-ja e theksuar (tosk.): <i>zë</i> : ie. <i>ǵlhon-</i> , <i>bënj</i> : ie. <i>bhanŎō</i> <i>mëngër</i> < gr. μάγγανον, <i>këmbë</i> < lat. <i>camba</i>

Nga sistemi i lashtë i gjuhës indoeuropiane gjuha shqipe ka trashëguar zanoret -a-, -i-, -u- dhe -e-. Këto 4 zanore janë të moçme sa vetë gjuha shqipe, domethënë mosha e tyre matet me mijërvjeçarë. Përkundrejt këtyre, zanoret e tjera, -o-, -y- dhe -ë-, kanë dalë nga evolucioni i zanoreve të tjera. Gjuha indoeuropiane e ka pasur zanoren -o-, por në gjuhën shqipe, ashtu si në disa gjuhë të tjera, është shndërruar në zanoren -a-; si rrjedhim, -o-ja e sotme ka dalë nga zanore të tjera, nga zanoret e gjata -ā- dhe -ē-. Por ky shndërrim është i periudhës parahistorike, me të cilin ajo afrohet me gjuhët gjermanike dhe balto-sllave.

Më vonë se zanorja -o- është formuar zanorja -y-, meqenëse me të dalin edhe disa huazime latine, që kanë pasur një -ū- të gjatë në atë gjuhë; si rrjedhim, ky tingull mund të jetë formuar në periudhën e kontakteve me atë gjuhë të lashtë, gjithsesi në mijëvjeçarin e parë.

Për formimin e zanores -ë-, më e reja në sistemin tonë zanor, duhen dalluar dy raste. Rasti i parë është -ë-ja e patheksuar me burim nga çdo zanore tjetër, një dukuri që përfshin mbarë shqipen dhe i përket mijëvjeçarit të parë. Kësaj dukurie i janë nënshtruar huazimet nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja; por ajo pushon së vepruari mbi huazimet më të reja mesjetare nga gjuhët sllave, italishtja e greqishtja e mesme dhe e re. Rasti i dytë është -ë-ja e theksuar, që është një dukuri me karakter dialektor dhe lidhet me hundorësinë e zanoreve; meqenëse vetëm disa prej zanoreve të hundorëzuara shndërrohen në këtë tingull; si rrjedhim, dukuria është më e re, por gjithsesi, edhe ajo është zhvilluar në mijëvjeçarin e parë, para fillimit të marrëdhënieve me gjuhët sllave, italishten dhe greqishten e re.

Fazat e zhvillimit	Bashkëtingëlloret	Shembuj
Faza I (e trashëguar)	Hundoret -m-, -n-	<i>mi</i> : ie. <i>mūs</i> , lat. <i>mūs</i> , gr. μῦς, sll. vj. <i>myš</i> <i>natë</i> : ie. <i>nokt</i> , lat. <i>nox</i> , lit. <i>naktis</i> , got. <i>nahts</i>
	Lëngëzoret -l-, -r-	<i>laj</i> : ie. <i>loI</i> , gr. λόω, lat. <i>lavo</i> -, <i>āre</i> , isl. vj. <i>lauðr</i> <i>rosë</i> : ie. <i>erōd</i> -, gr. ἐρωδιός, lat. <i>ardea</i> , nord. vj. <i>arta</i>
	Grykoret -k-, -g-	<i>kap</i> : ie. <i>kap</i> -, ind. vj. <i>kapati</i> , gr. καπέτις, lat. <i>capio</i> -, <i>ēre</i> <i>gur</i> : ie. <i>g^{er}</i> -, ind. vj. <i>gīrī-h</i> , sll. vj. kisht. <i>gora</i> “mal”
	Buzoret -p-, -b-	(i) <i>parë</i> : ie. <i>p^āIo</i> -, ind. vj. <i>purvaḥ</i> , gr. πρώτος, lat. <i>primus</i> <i>ballë</i> : ie. <i>b^leI</i> -, ind. vj. <i>bhālam</i> , prus. vj. <i>ballo</i>
	Dhëmboret -t-, -d-	<i>tjerr</i> : ie. <i>ter</i> -, gr. τείρω, lat. <i>tero</i> , lit. <i>trini</i> <i>dem</i> : ie. <i>demā</i> , irl. vj. <i>dam</i> , gr. δαμάλις, pers. re <i>dām</i>
Faza II (parahistorike)	Fërkimoret -sh-, -h-, -f-, -v-	<i>shoh</i> : ie. <i>sek</i> -, lat. <i>sequor</i> , gjerm. l. vj. <i>sēhan</i> , lit. <i>seku</i> <i>helm</i> : ie. <i>skel-mo</i> , trak. σκόλημη, isl. vj. <i>skalm</i> <i>fuqi</i> : ie. <i>spē(i)</i> -, let. <i>spēks</i> “forcë”, <i>spēju</i> “mundem” <i>valë</i> : ie. <i>IeI</i> -, gjerm. l. vj. <i>wēlla</i> , sll. vj. <i>vīlna</i> , lit. – <i>vīlnis</i>
Faza III (historike) mijëvjeçari I	Fërkimoret -th-, -dh-	<i>thadër</i> : ie. <i>sēs</i> -, gr. κεάζω “çaj”, lat. <i>castro</i> -, <i>āre</i> “pres” <i>dhëndër</i> : ie. <i>gēm(e)</i> , gr. γαμβρός, ind. vj. <i>jāmātar</i>
	Qiellzoret -q-, -gj-	<i>qershī</i> < gr. vj. κερασία, <i>qytet</i> < lat. <i>civitatē</i> <i>gjarpër</i> : ie. <i>serp</i> -, ind. vj. <i>sarpā</i> , lat. <i>serpens</i>
	Sonantet -nj-, -j-, Lëngëzoret -ll-, -rr-	<i>një</i> : ie. <i>anŌom</i> , lat. <i>ūnus</i> , got. <i>ains</i> , gr. οἶνη <i>jam</i> : ie. <i>esmi</i> , arm. <i>em</i> , lit. <i>esmi</i> <i>llërë</i> : ie. <i>eleŌ</i> -, “gr. ὀλένη, lat. <i>ulna</i> , got. <i>aleina</i> <i>rreth</i> : ie. <i>rot</i> -, lat. <i>rota</i> , gjerm. l. vj. <i>rad</i> , <i>rallë</i> < lat. <i>arus</i>
	Faza IV (historike) Mijëvjeçari II (gjysma I)	Fërkimoret -s-, -z- Fërkimorja - zh-Afrikatet -c-, -ç- -x-, -xh-

Përcaktimi i moshës së bashkëtingëlloreve është një proces më kompleks, në radhë të parë për numrin e tyre më të madh. Nga 29 bashkëtingëlloret e shqipes, vetëm 10 prej tyre vijnë drejtpërdrejt nga gjuha indoeuropiane. Këto janë: sonantet hundore -m-, -n-; lëngëzoret -l-, -r-; grykoret -k-, -g-, buzoret -p-, -b- dhe dhëmboret -t-, -d-. Këto janë bashkëtingëlloret më të lashta të gjuhës shqipe, mosha e të cilave është e njëjtë me atë të gjuhëve të tjera.

Një periudhe të lashtë i përket edhe fërkimorja -sh-, që e ka burimin të -s-ja e trashëguar. Lashtësinë e saj e dëshmon edhe fakti se këtë përfundim ka pasur -s-ja e trashëguar edhe në disa gjuhë të tjera të familjes indoeuropiane, si në gjuhët ariane, balto-sllave, në armenishte etj. Pra, -sh-ja nga -s-ja e trashëguar mund të jetë formuar kur shqipja ishte në fqinjësi me këto gjuhë, që përbëjnë grupin satem.

Edhe disa fërkimore të tjera janë formuar në periudhën parahistorike nga fonema të tjera, ose nga grupe bashkëtingëlloresh. Të tilla janë bashkëtingëlloret -h-, -f-, -v-. Periudhës historike, kohës së marrëdhënieve me latinishten, i përkasin bashkëtingëlloret ndërdhëmbore -th-, -dh-; qiellzoret -q-, -gj-, sonantet -nj-, -j-, lëngëzoret -ll-, -rr-, që mund të jenë formuar në mijëvjeçarin e parë. Më të vona, duke u lidhur me mijëvjeçarin e dytë janë fërkimoret -s-, -z- dhe afrikatet -c-, -x-, -ç-, -xh-. Këta të fundit janë tingujt më të rinj të gjuhës shqipe; megjithatë, këta mund të jenë formuar në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë, sepse tek autorët e vjetër ata dalin të formuar.

Me formimin e afrikateve në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë merr fund formimi i sistemit bashkëtingëllor dhe i tërë sistemit fonematik të gjuhës shqipe.

Nga mosha e bashkëtingëlloreve varet shkalla e prodhimit të tyre në fjalorin e shqipes. Përgjithësisht, sa më të lashtë të jenë tingujt në gjuhën shqipe, aq më prodhimtarë janë ato; përkundrazi, sa më të rinj të jenë, aq më pak prodhimtarë janë. Kjo është arsyeja që, ndërsa me tingujt -p-, -k-, -m-, -n-, -b-, -d-, -l- etj. është numri më i madh i fjalëve të shqipes; përkundrazi, me afrikatet -c-, -x-, -ç-, -xh- është numri më i vogël i tyre.

4) Faza tjetër e studimeve të mia në fushë të gjuhës shqipe është gramatika historike. Pas disa artikujve të botuar për çështje problematike, kam botuar 4 monografi për kapitujt më të rëndësishëm të kësaj fushe: për përemrat, nyjat, sistemin emëror dhe sistemin foljor. Pas këtyre kam hartuar “*Gramatikën historike të gjuhës shqipe*”, prej së cilës dëshiroj të

paraqes disa nga rezultatet e mia në studimin e njëjës prej formave foljore më problematike: së ashtuquajturës mënyrës dëshirore.

Pas përpjekjeve të gjuhëtarëve për ta nxjerrë këtë formë foljore disa prej latinishtes, të tjerë në zhvillim të brendshëm të gjuhës shqipe, prej vitesh kemi ardhur në përfundimin se forma foljore e mënyrës dëshirore është e trashëguar nga gjuha indoeuropiane dhe se përdorimet e saj dëshmojnë se shprehja e dëshirës së folësit është vetëm njëri prej përdorimeve të kësaj forme, krahas përdorimeve të tjera, që ruhen nëpër dialekte.

Nr.	Ku përdoret	Shembuj
1	në protasat e periudhave hipotetike pas lidhëzës kushtore <i>në</i>	Shembuj <i>Në pastë ra vathi, kam veshin</i> <i>Ndë rafsha, mos u vrafsha</i> Buzuku: <i>gruoja në fëjefitë, fëjen nde e shtatët kat mortār</i>
2	në fjali të varura, që nisin me përemra të pacaktuar ose me ndajfolje lidhore, që përmbajnë foljen <i>do</i>	- me foljen <i>jam</i> : <i>kushdo qoftë, cilido qoftë, kudo qoftë, kurdo qoftë, sido qoftë,</i> - me folje të tjera: <i>Kudo shkosh, mos u rrzofsha, Kudo rafsha, mos u vrafsha.</i>
3	në fjali të varura me një përemër të pacaktuar	<i>Kush dajtë, kjaftë e kurr mos këndoftë;</i> <i>Kush mos levdoftë vedin, i u djegët kasolla,</i> <i>Kush e ndjefitë e e kallxoftë, u baftë gur e u verboftë,</i> <i>Kush e digjofitë e diftoftë, u thaftë në bres e teposhtë.</i>
4	në fjali të varura para lidhëzave <i>ku</i> , <i>nga</i> , <i>kur</i> , <i>sa</i> , <i>që</i> , <i>qysh</i> etj.	<i>Qoftë ku vetoftë e bumbulloftë,</i> <i>Se kjosh gjallë, kurr mos t'u hjekët mëç çika e tejdetit;</i> <i>Kur lafsh dur e faqe, ti bijë, t'ngrihtë ujt e ar serm,</i> Buzuku: <i>qysh kloftë bām, ju të besoni;</i>
5	në fjali të përbëra me kuptim urdhëror-lejor	<i>Ljuftë qoftë, gjak mos qoftë;</i> <i>Vendin e huej e levdosh, por kurr mbrendë mos i vosh;</i> <i>Ma mirë thaçin dredhoi Leka se mbet Leka</i> <i>Vajza n'atë rasë thotë: Kjofitë ba kjo fejesë!</i>

Nga shembujt e mësipërm duket qartë se mënyra dëshirore e foljes ka modalitet lidhor për të shprehur një supozim dhe kuptimin kohor të së ardhmes. Prandaj edhe kur shprehim një dëshirë, folja ka kuptimin e mënyrës lidhore. Këtë e dëshmon fakti se edhe në gjuhët që nuk kanë një for-

më foljore për të shprehur një dëshirë, e shprehin atë me mënyrën lidhore, si p.sh.:

Latinisht	Gjermanisht	Ang.	Italisht	Frëngjisht
<i>prosit</i>	<i>es lebe</i>	<i>long live</i>	cosi sia	sois heureux

Forma foljore e mënyrës dëshirore në gjuhën shqipe ka si formant të veçantë një -s-, që del në të gjitha format vetore, me përjashtim të vetës III njëjës, ku ajo ka rënë, meqenëse u ndodh në një grup bashkëtingëlloresh, ku *haptë* ka dalë nga *hapshtë* e *shkoftë* nga *shkofshhtë*. Ky formant ka qenë formanti i së ardhmes sigmatike në gjuhën indoeuropiane, që ka kuptim kohor të ardhmë dhe modalitet lidhor. Një formë të tillë e kanë pasur edhe disa gjuhë të tjera indoeuropiane, prandaj e ashtuquajtura mënyrë dëshirore origjinarisht është e ardhmja sigmatike me formantin -s-, që krahasohet me të njëjtën formë të indishtes së vjetër, lituanishtes, greqishtes etj.

Shqip	Indishte e vjetër	Greqisht	Lituanisht
hap-sh-a	<i>dâ'-syâ'mi</i>	δῶ-σ-ω	<i>du'-s-iu</i>
hap-sh	<i>dâ-sya'si</i>	δῶ-σ-εις	<i>du'-s-i</i>
*hap-sh-të > haptë	<i>dâ-sya'ti</i>	δῶ-σ-εις	<i>du'-s</i>
hap-sh-im	<i>dâ-syâ'mas</i>	δῶ-σ-ομες	<i>du'-s-ime</i>
hap-sh-it	<i>dâ-sya't'a</i>	δῶ-σ-ετε	<i>du'-s-ite</i>
hap-sh-in	<i>dâ-sya'nti</i>	δῶ-σ-οντι	<i>du'-s</i>

Formanti tjetër, bashkëtingëllorja -f-, që e marrin foljet me temë në zanore, e ka burimin në zhvillim të brendshëm të gjuhës shqipe. Meqenëse mënyra dëshirore ndërtohet mbi bazën e formës së pjesores, foljet me temë në zanoren -o- kanë pasur pjesoren me diftong, *punuo*, *shkuo*, që në një fazë më të lashtë dilte me formën *punoI*, *shkoI*. Forma e dëshirores, e ndërtuar me formantin -sh- nga diftongu -oI-, pësoi të njëjtin ndryshim si huazimi latin *causa*, që ka dhënë shqipen *kafshë*, domethënë gjysmëzanorja e diftongut kaloi nëpër shkallët: -I- > -v- > -f-; si rrjedhim: *shkoI* + -sh- u bë *shkofsh*, *punoI* + -sh- u bë *punofsh*.

5) Faza e fundit e studimeve në fushë të historisë së gjuhës shqipe është etimologjia. Sipas një projekti të hartuar para dy vjetësh dhe të miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Gjuhësisë, kam nisur hartimin e një fjalori etimologjik, i cili do të botohet vitet e ardhshme në 4 vëllime.

Vëllimin e parë e të dytë tashmë i kam përfunduar dhe pritet botimi i tyre. Po vijoj punën për vëllimin e tretë.

Një punë e tillë e ka zanafillën në vitet që mbyllën shekullin e kaluar, atëherë kur nisa kërkimet dhe hulumtimet në fushë të historisë së gjuhës shqipe, dhe mungesa e një fjalori të tillë që një pengesë serioze për të arritur rezultatet e dëshiruara; si rrjedhim, u detyrova të hulumtoj shumë etimologji të pastuduara nga dijetarët më parë dhe të ndreqi mjaft të tjera, të cilave u ishte dhënë një shpjegim tjetër.

Për hartimin e këtij fjalori kam shfrytëzuar studimet e kryera në këtë fushë prej më shumë se një shekulli e gjysmë nga dijetarë të tjerë; prandaj ajo do të jetë një vepër për të tashmen dhe për të ardhmen. Për të tashmen është një pasqyrë e rezultateve më të fundit që ka arritur shkenca e etimologjisë që nga zanafilla e deri në ditët tona, me përpjekje për t'i çuar ato më tej; për të ardhmen do të jetë një pikënisje për studime të tjera të kësaj fushe. Jemi të bindur se një vepër e tillë, për vështirësitë e mëdha që ka kjo fushë dhe për mangësitë e tjera që paraqet studimi i shqipes, nuk mund të quhet asnjëherë e përfunduar, aq më pak e përkryer. Ajo përbën vetëm një piketë të re në udhën e gjatë të studimeve etimologjike për gjuhën shqipe, e cila do të pasohet nga shumë të tjera në të ardhmen. Jetoj me shpresë se do ta përfundoj edhe këtë vepër të dobishme dhe të domosdoshme për studimet tona albanologjike.

STUDIME, ARTIKUJ

Besim BOKSHI, Prishtinë

RIMARJA E KUNDRINAVE NË GJUHËT BALLKANIKE

KDU 81'36

Abstrakt

Në këtë artikull shqyrtohet procesi i rimarrjes së kundrinave në gjuhët ballkanike. Diskutimi nxjerr në shesh vjetërsinë e kësaj dukurie në gjuhën shqipe përmes trajtave të patheksuara të vetës së tretë njëjës i për kundrinën e zhdrejtë dhe e për kundrinën e drejtë, të cilat rrjedhin nga përemri dëftor-vetor, i cili qe zëvendësuar nga përemri i rrënjës më **to*. Ai nuk kaloi në një shquese prandaj rimarrja e kundrinës është më e lashtë se krijimi i njëjës shquese, para krijimit të theksit dinamik, pra para kontakteve të protoshqipes me latinishten. Këto vihen në kontrast me maqedonishten që këtë fenomen e ka pas sh. XIII, rumanishten – në sh. XIV, ndërsa në dialektet e greqishtes veriore më herët nën ndikimin e shqipes.

Fjalët çelësa: rimarrja e kundrinës, përemër dëftor, përemër vetor, njëjës shquese, protoshqipe, maqedonishtre, rumanishte, greqishte, gjuhë ballkanike.

Shaban Demiraj në veprën *Gjuhësi ballkanike* (1994) e ka shtruar çështjen e rimarrjes së kundrinave në gjuhët ballkanike në një vëllim prej 20 faqesh. Ai paraqet gjendjen e rimarrjes së kundrinave në gjuhën shqipe, rumune, bulgare, maqedone e në greqishte të re dhe jep mendimet e gjuhëtarëve të ndryshëm për burimin e kësaj dukurie, e cila “zhvillim më të madh ... ka marrë në shqipe e në maqedonishte”.¹

Rimarrjen e kundrinave në gjuhën shqipe ne e patëm trajtuar në veprën *Për vetorët e shqipes* (2004) nën temën: Relacionet sintagmatike të varianteve të dy serive të vetorëve (f. 87-94). Aty ishim shprehur se

“Variantet e lira dhe variantet e lidhura janë në relacion seleksioni sintagmatik, në të cilin segmentin konstant të këtij relacioni e përbëjnë variantet e lidhura, ndërsa segmentin variabil – variantet e lira,

¹ Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, 127. f. 127. Këtë temë ai e kishte trajtuar më parë në veprën *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986.

meqë këto nuk mund të përdoren pa qenë të pranishme variantet e lidhura”.

Kjo gjendje shihet se ishte e përgjithshme në fillim të fazës së dokumentuar të shqipes, sidomos për funksionin e kundrinës së zhdrejtë e për dy vetat e para të kundrinës së drejtë. Në një pjesë të konsiderueshme mos-përdorimi i variantit të lidhur te autorët e vjetër është bërë nën ndikimin e tekstit nga i cili u përkthye, siç shihet qartazi te Bogdani. Mungesa e trajtës së lidhur përdoret edhe si variant stilistik në raport me përdorimin e tij, p.sh: *...do të kuptojnë qi mua do; Asimi herë shikonte mua...* etj.²

Për variantet e dy vetave të para, të cilat shënojnë gjënë e re të kumtimit, Sh. Demiraj mendon se

“janë format e reduktuara ato që, në zanafill, kanë përforcuar format e theksuara të këtyre përemrave”.³

Ky parashikim është i pambrojtshëm, sepse e lë të pasqarueshëm përfitimën e trajtave atone a të patheksuara. Kjo rrjedh nga mendimi i pasaktë se format e reduktuara të vetorëve të vetës së parë e të dytë njëjës më, të janë përftuar nga format e plota që dalin në shqipen e fazës së dokumentuar muo, ty Duke u nisur nga fakti se format e lidhura të vetës së tretë njëjës për dhanore i dhe për kallëzore e janë forma të përftuar nga format atone të një përemri të lashtë dëftor-vetor: **is, (*ei), *iā, (*eiā), *id,*⁴ para se të krijohet theksi dinamik, mund të përfundohet se format më, të burojnë nga forma atone edhe më të lashta se këto të vetës së tretë.

Nga ky përemër i lashtë, që u zëvendësua nga përemri i rrënjës në **-to* (përemër që e ka edhe shqipja e sotme, por pa elementin deiktik) me përrjashtim të rasës emërore njëjës, që e mori në paradigme të tij bashkë me dy format e shënuara atone kundrinore, nuk u krijua nyja shquese. Ajo u përftua nga përemri në **-to* që e zëvendësoi, kështu që trajtat atone *i, e* janë krijuar para nyjës, e cila, sipas shumicës së gjuhëtarëve, është përftuar në kohën e kontakteve të para të shqipes me latinishten. Nga kjo nxirret përfundimi i shënuar më lart se këto forma janë krijuar edhe para theksit në gjuhën tonë.⁵ Është e padyshimtë pastaj që variantet atone kundrinore të dy vetave të para, si vetorë të mirëfilltë, të jenë krijuar mjaft më herët se vari-

² Shih shembuj te Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 588.

³ Demiraj, vep. e cit., f. 595.

⁴ Shih B. Bokshi, *Për vetorët s shqipes*, Prishtinë, 2004, f.103-4. Shih edhe mendimin e Sh. Demirajt në vep e cit., f. 457.

⁵ Shih vep. e cit., f. 100-103.

antet atone të vetorit të vetës së tretë, i cili paradigmën e serisë së lidhur deri në kohë të vona nuk e kishte të plotë, sepse nuk kishte forma për kundrinat në shumës.⁶ Disa gjuhë indoevropiane kanë krijuar trajta atone kundrinore me forma të ndryshme nga trajtat tonike, disa trajta pra që nuk kishin përdorim tonik. Forma të tilla gjithnjë atone të dhanores njëjës ishin për vetën e parë **mōi*, për vetën e dytë **tōi*, kurse për kallëzore të tilla ishin format **mē*, **tē*.⁷ Kështu imponohet të besohet se protoshqipja bashkë me gjuhë të tjera kishte krijuar këto forma atone kundrinore, të cilat, kur u krijua theksi, u bënë të patheksuara dhe e ndërruan gradualisht formën: **mōi* > **mi* > *më*, **tōi* > *ti* > *të*; **mē* > *më*, **tē* > *të*, që përfunduan kështu në forma sikretike për dhanore e kallëzore. Që atëherë si forma atone për gjinore-dhanore-rrjedhore të dy vetave të para të numrit shumës përdorshin rrënjët përemërore **nō-*, **vō-*.⁸ Këto kanë përfunduar: **nō-* > **në* e zëvendësuar më vonë nga *na*, **vō-* > **vë* > *u*, e zëvendësuar krejt vonë nga *ju*.

Nga sa u tha del se që në një periudhë të protoshqipes për të shënuar kundrinat përdorshin trajtat atone, në fillim të të dy vetave të para e më vonë edhe të vetës së tretë njëjës. Ishin format tonike e pastaj të theksuara ato që u përdoren për ta rimarrë kundrinën. Duket, besoj qartas, se krijimi i këtyre formave atone është bërë për të realizuar funksionet e kundrinave.

Varianteve të të dy serive të vetave të para, mbasi zëvendësojnë vetat e pranishme në bisedë, u mungon kuptimi anaforik, prandaj nuk mund të shënojnë subjektin e njohur më parë. Ato mund të përdoren vetëm për të shënuar personin e papërmendur. Përdorimi i trajtave tonike a të theksuara bëhej për ta vënë më në pah vetën, për ta spikatur dallimin me vetat e tjera, duke rënë edhe theksi i fjalisë mbi to. Kështu variantet e lira ishin të markuara, ndërsa të lidhurat - të pamarkuara, të cilat si të tilla e përjashtojnin bashkëvajtjen. Përjashtimin e përdorimit të varianteve tonike a të theksuara nga prania e varianteve të lidhura e vërtetojnë edhe gjuhët sllave e gjuhët romane, që kanë trajta të patheksuara edhe formalisht të ndryshme nga trajtat e theksuara. Përdorimi i dy varianteve ka filluar nga një ndërhyrje e vonuar e variantit të lirë në një fjali eliptike apozitive, mbasi ishte përdorur varianti i lidhur, ashtu siç del në gjuhën frënge p.sh.: *tu me con-*

⁶ Për përfitim e këtyre formave të shumës shih vep. e cit., f. 105-12.

⁷ A. Meje, *Uvod u uporedno proučavanje indoevropskih jezika*, Beograd, 1965, f. 184.

⁸ A. Meillet, po aty.

nais, moi? Tu veux me voir, moi? etj.⁹ Për frëngjishten përemri i theksuar në këtë përdorim çmohet si “nënvizues i kundrinës nëpërmjet një pleonazme”, apo se këtu “forma e palidhur shfaqet për të rimarrë një formë të lidhur ...”.¹⁰ Përdorimi i varianteve të lira të vetorëve dhe i emrave në funksion të kundrinës për të vënë në spikamë gjënë e re a gjënë e njohur në bashkëvajtje me variantet e lidhura të të tri vetave është mjet i gjuhës afektive, i cili përfundon në automatizëm dhe bëhet mjet i gjuhës logjike - mjet sintaksor.¹¹

Ndërkaq, përdorimi i variantave të vetës së tretë është me ndryshime nga ai i dy vetave të para:

Variantet e lidhura të vetës së tretë kanë kuptim anaforik, kështu që përdorimi i tyre zanafillës përlijet vetëm kur në funksion të kundrinës shënojnë personin e njohur e të përmendur më parë. Edhe këtu variantet e lira përdoren për të spikatur vetën. Por veta e tretë si vete jashtë diskursit, ishte e nevojshme të shfaqej edhe si subjekt i panjohur, i papërmendur më parë, si element i ri i kumtimit. Ndërsa variantet e lidhura nuk mund ta realizonin këtë kuptim, variantet e lira e kishin këtë mundësi. Ato mund ta tregonin gjënë e re të kumtimit duke qenë të shoqëruara me një gjymtyrë zgjeruese të tyre, me një fjali relative përcaktuese, p.sh.: Pashë atë që erdhi etj. Emri në trajtë të shquar, të cilin nyja shquese e bën të njohur, mund të dilte në funksion të kundrinës vetëm si nënvizues i gjësë a i personit të përmendur më parë, prandaj do të dilte në bashkëvajtje me trajtën e patheksuar të vetorit si rimarrës i kundrinës: e pashë djalin, e dërgoi letrën, i tha djalit etj. Vetëm emri me përcaktues të tjerë mund të shënonte gjënë e re të kumtimit: pashë një djalë të shtrirë. takuan disa nxënës etj. Kështu, mbasi variantet e lidhura të vetës së tretë mund të shënonin vetëm gjënë e njohur të kumtimit, variantet e lira, ashtu si dhe emrat kur shënonin gjënë e re si më sipër, nuk mund të dilnin në bashkëvajtje me to, por do të përdoren si shënues të vetme të kundrinës. Nga kjo kuptohet se këtu bashkëvajtja me variantet e lidhura është mjaft e re dhe e papërgjithësuar për kallëzoren: e pashë atë që erdhi, e mora atë e jo këtë etj. e gjithësesi dytësore edhe për dhanoren. Në këtë përdorim u neutralizua aftësia e trajtës së patheksuar të vetës së tretë për të shënuar vetëm gjënë e njohur a të përmendur më parë.

⁹ Shih vep. e cit., f.89.

¹⁰ *Grammaire du français contemporain* (grup autorësh), Paris, 1964, f. 233.

¹¹ J. Vendryes, *Le langage – introduction linguistique à l’histoire*, Paris, 1968, f. 157 e vijim.

Në disa gjuhë indoevropiane trajtat atone a të patheksuara të vetës së tretë janë krijuar më vonë në numrin shumës.¹² Edhe shqipja trajtat e lidhura të vetës së tretë njëjës, siç u pa, i ka shumë të lashta, ndërsa ato të numrit shumës i ka mjaft të vona.¹³ Kjo duket se ka të bëjë me faktin se vetëm në njëjës është i realizueshëm plotësisht kuptimi anaforik, kuptimi i gjësë së njohur të kumtimit. Duke qenë se variantet atone të dy vetave të para janë mjaft më të lashta se ato të vetës së tretë njëjës dhe se për shumës janë krijuar tepër vonë, mund të përfundohet se në fillim kuptimin anaforik e realizonin vetëm variantet e lira. Kjo do të thotë se të parat variante të lidhura ishin ato të dy vetave të para, d.m.th. ato që shënonin subjektin e ri të kumtimit.

Si mund të arsyetohet përgjithësimi i përdorimit të dy serive të vetorëve të vetës së tretë dhe të emrit bashkë me trajtën e patheksuar në rastin e kundrinës së zhdrejtë edhe atëherë kur shënohet gjëja e re e kumtimit? Njëra nga arsyet mund të jetë fakti se dhanorja në një fazë të zhvillimit të hershëm të sistemit rasor të shqipes erdhi e u bë rasa më ekstensive e atij sistemi dhe doli edhe në funksione jashtëkundrinore.¹⁴ Mbasi rasa dhanore ka një kuptim përkatësie (prandaj mund ta realizonte funksionin e gjinorës), trajtat atone e pastaj të patheksuara nga lidhja me foljet që kërkojnë kundrinën e zhdrejtë, dolën të lidhura edhe me folje që nuk e kërkojnë këtë kundrinë. Kështu vetëm forma e dhanores, për shkak të këtij kuptimi, mund të kalonte në funksione të plotësve dhe të kryefjalës logjike. Trajta e lidhur e kallëzores, për shkak se rasa kallëzore nuk e ka kuptimin e përkatësisë, nuk e zgjeroi distribucionin e saj në funksione jashtëkundrinore, me përjashtim të përdorimit në shprehjet idiomatike e në funksionin tepër të kufizuar të plotësit të kohës (natën, ditën, të hënën, një ditë etj.).

Siç kemi shënuar në veprën *Për vetorët e shqipes*, vendosja proklitike a enklitike ndaj foljes kallëzues e trajtave atone a të patheksuara të vetorëve është e lidhur me kërkesat e ritmit, që mund të ndryshojë gjatë zhvillimit të gjuhës e që ka të bëjë me renditjen regresive a progresive të elementeve të frazës dhe me vendin e theksit të fjalës. Pajtimi zotërues i këtyre rrafsheve përbën ritmin bariton apo oksiton.¹⁵

¹² Shih B. Bokshi, vep. e cit., f.92.

¹³ Vep. e cit.

¹⁴ Shih Besim Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980, f. 299-305.

¹⁵ Shih Ch. Bally, *Linguistique générale et linguistique française*, Berne, f. 202.

Format e trajtave atone edhe në protoshqipen do të kenë kaluar nga enkliza burimore ndaj fjalës së parë në fjali që nuk ishte folje, në renditje proklitike a enklitike ndaj foljes kallëzues gjatë procesit të fiksimit të rendit të fjalëve. Ne kemi shënuar se protoshqipja edhe para kontaktit me latinishten kishte renditja regresive të përbërësve të grupit nominal: Mbiemër - Emër (Emër në dhanore - Emër) e rrjedhimisht e kishte vendosjen e detyrueshme enklitike të formave kundrinore të patheksuara të vetorëve, renditje që ishte edhe në përputhje me ritmin kryesisht bariton. Pas përngjitjes së njëjës shquese shqipja krijoi renditjen progresive Emër - Mbiemër (Emër - Emër në gjinore) si renditje të zakonshme, që do të thotë se edhe trajtat e patheksuara të vetorëve tani kishin kaluar në renditje proklitike ndaj foljes kallëzues, në përputhje me ritmin kryesisht oksiton. Kështu kjo proklizë është e kohës para përfundimit të rotacizmit, aty kah shek. VII. Vetëm me urdhëroren pohore trajtat e patheksuara janë enklitike. Për italishten renditja enklitike me urdhëroren është çmuar si mbetje e renditjes latine. Edhe për shqipen kjo renditje duhet të vështrohet si ruajtje e renditjes regresive që është mjaft e lashtë në fillimet e saj. Në të dy renditjet e formave të patheksuara, format e theksuara kundrinore dhe kundrinat emërore e rimerin kundrinën: merr-më mua, mos më merr mua etj. Rastet kur e antipojnë formën e parheksuar: mua më tha, etj. duhet të jenë më të vonshme, përfutur mbasi ishte përgjithësuar përdorimi i trajtës së theksuar pranë variantit të parheksuar në renditjen më tha mua etj.

Kuptohet se kjo lashtësi e madhe e përdorimit të trajtave atone kundrinore që para kontaktit të protoshqipes me latinishten nuk do të thotë se që atëherë janë përdorur edhe format tonike në funksion të rimarrjes së kundrinave. Por duke marrë parasysh faktin se shkalla e përgjithësimi të rimarrjeve së kundrinave është shumë e madhe në gjuhën shqipe, më e madhe se në gjuhët e tjera ballkanike dhe del identike edhe në shkrimet e autorëve tanë të vjetër që në shek. XVI, është reale të mendohet se kjo gjendje është mjaft shekuj më e lashtë dhe gjithësesi më e lashtë se rimarrja në gjuhët e tjera ballkanike.

Meqë zhvillimi i përgjithësuar i rimarrjes së kundrinave në maqedonishten perëndimore e jugore, që është i ngjajshëm me zhvillimet në gjuhën shqipe, është i vonshëm (shek. XIII) dhe meqë kjo dukuri është mjaft e rrallë në Bullgarinë lindore, nuk ka sesi të përjashtohet mundësia e ndikimit të shqipes mbi këtë gjuhë sllave, me të cilën kontakti i shqipes ka qenë më intim.

Në rumanishten e sotme përveç rimarrjes së rregullt të kundrinave me anë të dy vetave të para të vetorëve, që është e njëjtë me rimarrjen në gjuhën shqipe, në raste të tjera rimarrja ndryshon nga gjendja në gjuhën shqipe, sepse rimarrja aty “mund të jetë e detyrueshme, fakultative apo e pamundshme” ashtu si dhe fakti se në gjuhën rumune nuk është përgjithësuar rimarrja e kundrinës së zhdrejtë.¹⁶ Dyfishimi i kundrinës në rumanishte e ka fillin në shek. XVI dhe nuk arrinë të dalë e konsoliduar mirë as në shek. XVIII.¹⁷ Kjo e përjashton mundësinë që dyfishimi në gjuhën rumune të jetë përfunduar në kontinuitet nga latinishtja, që do me thënë se e përjashton edhe ndikimin e saj mbi gjuhët e tjera të Ballkanit.¹⁸ Zhvillimi i kësaj dukurie shumë më vonë se në gjuhët e tjera ballkanike tregon se rumanishtja u ndikua nga gjuhët përreth: sllave, shqipe e greke.

Dukuria e dyfishimit të kundrinës del në raste të kufizuara vetëm në dialektet veriore të greqishtes së sotme “ku kontaktet me popullsinë romane, shqiptare dhe sllave kanë qenë më të ngushta.”¹⁹ Kontakti i lashtë i këtyre të folmeve të greqishtes me të folmet e shqipes dhe lashtësia e dukurisë në gjuhën shqipe flasin për mundësinë e ndikimit nga shqipja. Ndikimi nga dialekti vllah nuk është i mundur nga shkakut se fenomeni i dyfishimit të kundrinës në gjuhën rumune, siç pamë, përfshirë edhe vllhishten, është shumë më i vonë se në këtë pjesë të greqishtes.

Në bazë të kësaj mendojmë se ndikimi fillestar në përhapjen e dukurisë së dyfishimit të kundrinës në gjuhët ballkanike është ushtruar nga shqipja në greqishten e në maqedonishten. Pastaj këtë e ka përhapur maqedonishtja mbi bullgarishten e bashkë me të edhe mbi rumanishten, mbi të cilën ka ndikuar edhe shqipja e greqishtja.

¹⁶ Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f.133.

¹⁷ Po ai, po aty.

¹⁸ Siç ka pretenduar Ilievski. Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 138-9.

¹⁹ Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 137.

Besim BOKSHI, Prishtina

REDUPLICATION OF OBJECT IN THE BALKAN LANGUAGES

Summary

Analyzing the reduplication of objects in Balkan languages, the author comes to the conclusions that the process started and developed quite earlier in Albanian (proto-Albanian) than in other Balkan languages. He notices the ancientness of this phenomenon in the unstressed forms of the third person singular **i** of the indirect object and **e** of the direct object. These forms derive from the demonstrative-personal pronoun, which was replaced by the pronoun of the root to **-*to**, which the actual Albanian possesses without a deictic element. This old pronoun was not transformed into an indefinite article, hence the reduplication of objects in proto-Albanian is older than in the case of the formation of the definite article and before creation of dynamic stress, i.e. before the contact of proto-Albanian with Latin. Reduplication in Macedonian dates back to the 13th century, in Rumanian dates back to the 16th century, while in the northern dialects of the actual Greek language the reduplication emerges earlier than in Rumanian language influenced by the Albanian.

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë

GJENEZA E TEKSTIT DHE CAMAJ

KDU 82.09
801.82

Abstrakt

Në këtë kumtim, duke u nisur nga rrëfimi i Martin Camajt për Palimpsestin, diskutohen çështje të gjenezës së tekstit, po edhe më larg, të gjenezës së krijimit letrar, pra të hulumtimit në të dy binarët e krijimit tek ky autor. Merren në vështrim rezultatet e hulumtimeve filologjike-gjuhësore, po edhe zhytjet më tej.

Fjalët çelësa: gjeneza e tekstit, palimpsesti, Buzuku, poezia, kërkimi shkencor.

Gjatë gjithë shekullit të tij të punës poeti kontemplativ dhe gjuhëtari Martin Camaj, gati në mënyrë të vazhdueshme ka lëvizur paralelisht në dy binarë të ndryshëm krijimtarie: në binarët e krijimtarisë poetike dhe letrare, që për medium të saj ka gjuhën, në një anë, dhe në krijimtarinë hulumtuese shkencore po për gjuhën, në anën tjetër. Matteo Mandalà në fillim të viteve '90 duke referuar vlerësimin tonë të mëhershëm për kontrastet si një prej tipareve thelbësore në poezinë e Camajt, me të drejtë e kishte përmendur këtë fakt, duke shtruar një pyetje me interes parimor:

*“a mund të jetë një poet edhe linguist e kritik letrar?”*²²

Menjëherë pastaj ai vinte të shtonte se në traditën italiane ideja e Benedetto Croce-s, mbisundues për kohë të gjatë atje dhe më gjerë në këto fusha, shkonte deri tek ndalesa për linguistët dhe për ‘literatët jofilozofues’, madje edhe ta komentonin poezinë. Mandalà e ndjente të nevojshme të kujtonte gjithashtu traditën strukturale në vijën e R. Jakobson-it, për të cilin, për shkak se poezia ngërthehet intimisht me gjuhën, pra ushtrimi kritik në thelb është i lidhur me studimin e gjuhës poetike, një kërkesë e tillë bëhet kusht i patjetërsueshëm për vetë të kuptuarit e natyrës së poezisë. Për Mandalanë, që t’i afroresh në mënyrë produktive poezisë së Martin Camajt, çka domethënë t’i qëmtosh strukturat semantike të thella në të, është më shumë se e nevojshme t’i kesh të qarta këto

²² MANDALÀ (1991), f. 51.

relacione midis gjuhës dhe poezisë.²³ Sado që ka kohë që kam qenë pak larg nga tematizimet e këtilla, nuk e mohoj dot se i kam pasur për zemër dekada më para kur kisha shkruar diçka për to.

Në këtë kumtim, megjithatë, nuk e kam ndërmend të merrem më tej me ndërdymjet që shtronte kështu Mandalà, as me hulumtimin e karakterit që pretendojnë disa ‘hermetik’ të poezisë së Camajt, madje as me dyshimin tjetër që Mandalà e ka formuluar ligjshëm si vijon:

“deri në çfarë pike është gati poeti të heqë dorë nga armët e gjuhësisë? Dhe deri në çfarë shkalle linguisti dhe kritiku ndikojnë mbi poetin?”

Do të merrem porse me një aspekt të lidhur me të gjitha këto, me një aspekt që ka të bëjë me gjenezën si çështje që del te Martin Camaj, në studimet gjuhësore dhe, mbase, edhe në krijimet letrare.

Qysh me të gjallë të Camajt më kishte rënë të shprehja mendimin për studimet e tij gjuhësore, si për të folmet e arbëreshëve, ashtu edhe për tekstet e vjetra shqip. Në këtë kumtim nuk është e nevojshme të përsëris argumentimet e shprehura më parë për vlerësimet e detajuara të kësaj pjese të krijimtarisë së tij.²⁴ Dua të vë në pah më parë ku qëndrojnë ndihmesat e tij konkrete në fushën e studimeve të teksteve të vjetra shqipe dhe të ngre ndonjë ide e supozim për interpretime më të gjera lidhur me atë që ai e kishte quajtur gjenezë.

Në fazën e tij të studimeve Martin Camaj kishte marrë dijeni në fusha të veçanta të romanistikës dhe të sllavistikës në Universitetin e Beogradit, sikurse edhe Idriz Ajeti. Në të njëjtën kohë ai kishte ndjekur studimet në fushën e albanologjisë për aq sa ofronte atëherë orientimi qartësisht junggramatikan i përfaqësuar nga Henrik Barić, duke mos lënë pa parë ato që ofronin Ivan Popović e Radosav Bošković afërsisht në atë vijë, apo orientimi më tepër filologjik i Petar Skok-ut dhe vijat e zgjedhura prej tyre. Këto janë sidomos vitet e para ’50, kur Martini kishte mani-

²³ Në kulturën shqiptare një relacion i ngjashëm krijimi paralelisht në të dy këto fusha ka mundur të hetohet te dy personalitete me rëndësi: Ndre Mjeda, poeti i shquar, ishte njëherësh krijues në zë në fushën e gjuhësisë, paçka se shkëlqimi i poetit e ka eklipsuar capak aurën e gjuhëtarit jo pak të thelluar; në kohën tonë mund të duket me interes rasti i Besim Bokshit, që në fillimet e tij u afirmua si poet i refleksionit, edhe politik, i vrojtimit të thelluar, ndërsa më vonë u shqua si linguist në fushat e studimeve diakronike me zbatimin e metodave strukturale dhe me hulumtime që sa i përket aspektit pozitivist kontrastojnë dukshëm me atitudën e poetit. Përtej të dyjave sikur del kontemplacioni.

²⁴ Shih ISMAJLI (1981) f. 213-216 ; ISMAJLI (1995), 115-128 ; ISMAJLI (2007), 17-26.

festuar tashmë publikisht interesa dhe arritje në fushën e letrave - kishte botuar dy përmbledhje me poezi. Qysh në fillimet e punës të Institutit Albanologjik në Prishtinë, dy të absolvuarit për filologji, përveç albanistëve tashmë të njohur Selman Riza e Idriz Ajeti – pra dy të absolvuarit Martin Camaj dhe Hasan Kaleshi ishin caktuar bashkëpunëtorë të Institutit Albanologjik. Kjo do të thotë se ata tashmë gjatë studimeve kishin shfaqur shenja të mjaftueshme për interesat shkencorë dhe formimin përkatës. Martin Camaj, pos tjerash, parashikohej të përgatiste për botim Fjalorin e Kristoforidhit me zëvendësimin e shpjegimeve greqisht në gjuhën frënge. Fundi i vitit 1955 e përtregoi tërë radikalizmin e orientimit antishqiptar të Jugosllavisë së kohës me mbylljen e Institutit Albanologjik e të institucioneve kulturore, me deportimin e S. Rizës që tashmë kishte botuar në Prishtinë tre librat e tij të suksesshëm dhe paralajmëronte të tjerë. Mundësia e rritjes së shpejtë të Prishtinës në një qendër të mirëfilltë studimesh albanistike (pos Rizës, aty shiheshin tashmë emrat e Ajetit, Camajt, Kaleshit, mund të shtoheshin Anton Çetta, Kadri Halimi, etj. në fushat jogjuhësore) sikur u desh të ndërpritej në mënyrë abrupte, duke rritur ndjenjën e mungesës së perspektivës, duke i dhënë hov sa më të madh valës së shpërnguljeve për Turqi, kështu që edhe Camaj u desh disi në ato rrethana t'i gjente vetes çare duke u larguar në Itali.

Në fillimet e tij Camaj në studimet gjuhësore mori formim në traditën e studimeve junggramatikane. Këto interesime i vijoi në Romë, ku megjithatë, iu theksua aspekti kulturor i hulumtimeve të teksteve të vjetra shqipe, sidomos gjatë punës në Bibliotekën e Vatikanit, duke u bërë ndër të paktit studiues që veprën e Buzukut mund ta vështronin nga kopja e saj e vetme e ruajtur.

Kështu në disertacionin e tij për “Mesharin” specifíkimi në nëntitull “Ndhimesa gjuhësore për studimin e gjenezës” merr tërë peshën e nevojshme dhe sikur e thekson shtytjen për të dalë nga mbytyja në detajet e pafund të hulumtimeve konkrete. Hulumtimet që Martini tashmë kishte bërë lidhur me ortografinë dhe fonetikën e Buzukut, konkretisht dy pikat themelore të studimit të tij: *h*-ja buzukiane inorganike dhe çështja e shënimit të hundorësisë së zanoreve, u bënë pjesë e rëndësishme e monografisë së tij; kësaj iu shtuan shqyrtimet e natyrës gramatikore për paskajoren, për raportet futuri-lidhorja dhe për elemente të stilit, të cilat e shpunë të shqyrtimi serioz i varieteteve stilistike dhe të mundësia e ndikimit të teksteve të ngjashme sllave popullore të Basenit të Dubrovnikut

dhe të zonës kulturore veneciane në Adriatikun jugor dhe hulumtimet për vendin e botimit të “Mesharit”.

Prej këndej i dolën përfundime me rëndësi:

- së pari hulumtimi teknik për letrën e librit ia fuqizoi bindjen e krijuar dhe mbi baza të tjera të natyrës kulturore-historike për ‘basenin venecian’ si një ekumenë brenda së cilës ndodhnin dhe zhvillime të tilla në atë që do të njihet si *Albania Veneta*; hulumtimi për letrën, madje, i tregonte se botimi nuk do të jetë bërë në Venedik,²⁵

- hulumtimi për zanoret hundore ia theksoi supozimin që Buzuku të kishte qenë bartës i së folmes së Malësisë së Madhe, ndërsa për ne pikërisht në këtë aspekt ka baza për diskutim lidhur me një zhvendosje më parë në anën tjetër të Liqenit të Shkodrës, te Kraja e viset përtej, çka nuk përjashtonte as Camaj;

- hulumtimi i varieteteve të pjesëve të ndryshme të librit në raport me shqipen e përdorur, i pabarazive në përkthim e stil, i elementeve ‘toske’ brenda pjesëve të ndryshme, etj. e shpunë te përfundimi i ekzistencës së teksteve të mëhershme që do të jenë përdorur në shërbimet fetare të kopjuara përgjatë gjithë brigjeve të Adriatikut shqiptar dhe, madje edhe më në jug, të Jonit; ato tekste, sipas tij, mund të jenë përdorur drejtpërsëdrejti ose përshtatur në veprën e Buzukut; Çabej dhe Riza në këtë pikë anonin më shumë nga shpjegimet unitare – Çabej varietetet ishte i prirur t’i shpjegonte me intencën e Buzukut për varietete stilistike, apo edhe me rrethana të tjera, ndërsa Riza ishte i prirur më tepër që këtë ta shihte si rezultat të mediokritetit të Buzukut;

- hulumtimi i përkthimit dhe i stilit e shpuri te krahasimi me tekstet e vjetra sllave të Bernardino da Spalato 1495²⁶ dhe Nikša da Ranjina 1508, edhe

²⁵ Pajtohej me Çabejnë se gjuha e Buzukut në thelb paraqet të folmet e Mbishkodrës. Argumentet konkrete, si: lokucionet idiomatike *e sih paneh se is scuom en cheso iete, m-erç preih stexx; dicc, ën dhençit* (gabimisht *dhent+shit*, po *dhen+shit*, ku *n* forcon *sh* në *ç*) as *gneh grimesse; me sojt për shoj; vietate; paret; bagmi; miellteh en-gavigçit; atoh neh nah tucheğnene; me x schale*, në fakt nuk flasin në mënyrë të padyshimtë për Triepshin e Malësinë e Madhe si burim, sepse mund të tregohet se gjendeshin edhe gjetiu. Theksonte se dallimet midis të folmeve të Krajës e të Malësisë nuk kanë qenë të mëdha, sidomos me Hotin, Grudën e Triepshin të afërët me Kuçin (atje persiston sporadikisht diftongu *uo* në alternim me *ua*: *Kêka e rãd, e druo t’perdreth*). Dy termat: *endhezunë* dhe *ëndhes* dhe *thashunë*, pas tij, ekzistojnë sot vetëm në të folmen e Malësisë së Madhe, f. 50-51.

²⁶ Në sh. 15 kishte leksionarë në Dalmaci në gjuhën popullore kroate. Leksionari ‘dalmatin’ me tre versione, *i Korçullës* i gjysmës së sh. 15, *i Zarës* dhe *i Bernardinit*

ato kishin arritur në shkallën kur u njohën nga këta përmes kopjimeve e qarkullimit dorëshkrimor nëpër versione të mëhershme, çka paraqet një rezultat me interes, sepse buzukologët e tjerë këtë mundësi nuk e kanë pasur;²⁷

- Në këtë vazhdë të hulumtimit të gjenezës, ai e kishte parë të nevojshme të sillte në shtojcë këngë nga Triepshi për të vënë edhe më shumë në pah mendimin se baza dialektore e Buzukut mund të ishte e atyre anëve.

Në fund fare, do theksuar se, pasi kishte konstatuar përmes elementeve të identifikuar si toske se ekzistonin në atë kohë lidhje e komunikime religjioze midis Veriut dhe Jugut të Shqipërisë, Camaj merrej me lidhjet e tekstit të Buzukut me ato të autorëve të mëvonë të vjetër, të cilat janë evidente. Ato bien në sy te Budi, i cili do ta ketë konsultuar Buzukun. Kjo nuk ka mbetur pa hetuar as tek autorët si Çabej, Riza, e të tjerë. Janë, porse, sipas Camajt, dy dallime:

- gjuha e Budit paraqet të folme tjetër dhe është më unike në aspektin dialektor se ajo e Buzukut;

- Budi i shkruan fjalët bashkë, sipas zakonit tradicional.²⁸

Të dyja këto çështje janë theksuar, po edhe bërë objekt studimi të hollësishëm sidomos nga Selman Riza.

Nga kjo traditë, mendonte Camaj, veçohet Pjetër Bogdani me gjuhën e tij hasjane "të larë" në Shkodër. Nëse lëmë anash bazën dialektore, nuk del shumë e qartë se në ç'kuptim veçohet Bogdani nga kjo traditë, diversitetin e bazës idiomatike të së cilës Camaj e postulonte qysh në fillimet e shqipes së shkruar. Në qëndrim, në stil, në teknikë shkrimi e përkthimi?

Për studimet Buzukiane Martin Camaj do të mbetet i rëndësishëm me ndihmesat e tij konkrete filologjike, linguistike, sa me idetë me implikime kulturore e letrare për atë kohë, të cilat shpesh kanë mbetur pa elaboruar. Në kohën jo shumë të gjatë të studimit të këtij teksti ai kishte arritur të thellohej në interpretimet fonetike të grafisë, ashtu siç u pa në rastin

(*Evangelarium Bernardini Spalatensis*, botuar në Venedik më 1495, i pari libër i shtypur në gjuhën popullore me alfabet latin me karaktere të tipit gotik.

²⁷ Theksonte se mund të hetohen ndikime nga këto burime sidomos në leksik dhe në mënyrën e përkthimit të pjesëve latine. Për këto mund të krahasohet versioni i diskutimit të Riza, si për mënyrën e përkthimit, ashtu edhe për ndikimet sllave të Buzuku, por mbi baza të tjera. Elemente si *tjesk*, jo *tjesak* mund të shërbejnë po ashtu si indicie përshtatjeje.

²⁸ CAMAJ (1960), 74-5.

e *h*-së dhe të nazalizmit.²⁹ Largvajtëse mund të jenë idetë e tij të krahasimit të teksteve të Buzukut me tekstet popullore kroate, në një anë, dhe me tekstet e traditës shqipe jugore, në anën tjetër. Këtë të dytën nuk e la pa bërë as Çabej. Kështu dhe praktikisht arrijmë tek ideja e theksuar nga Riza në kritikën e pabotuar për studimin e Çabejtë, sipas së cilës analiza e përkthimit të tekstit të Buzukut ka rëndësi të dorës së parë. Analiza e Rizës është më shteruesja që është bërë deri sot, natyrisht në raport me versionin latin. Hipoteza për mbështetje edhe në përkthimet sllave popullore, e bazuar seriozisht nga studimi i Camajt, mbetet për t'u hetuar.

Edhe ky studim i specializuar, i veçantë, nxjerr në pah nevojën që vepra e Buzukut të shqyrtohet jo vetëm nga aspekti i saj i brendshëm; pikërisht për të studiuar këtë aspekt të brendshëm, del nevoja të shihen çështje si: historia kulturo-religjioze shqiptare; historia gjuhësore; lidhjet e shqiptarëve me fqinjët dhe me qendrat e rrezatimit kulturor të kohës, etj., për të cilat kishin folur edhe Çabej, Riza e të tjerë buzukologë, ndërsa studimi si ky i Camajt flet në mënyrë të thelluar e të qartë.

Sa i përket orientimit në studimet e tij gjuhësore, në tërë veprën e tij për Buzukun hetohet horizonti lingvistik junggramatikan që fillin e kishte te Bariqi e shtyhej më tej te Jokli e Meyeri, çka shihet edhe më qartë në studimin e tij më të rëndësishëm për historinë e gjuhës *Albanische Wortbildung* të mbrojtur si Habilitacion në Mynih dhe të botuar më 1966. Aty Camaj shqyrtonte një varg çështjesh të zhvillimit fonetik brenda shqipes me perspektivë dhe indoeuropiane, por që kanë qenë me rëndësi për sqarimin e çështjeve morfologjike dhe të proceseve të fjalëformimit. Gjithnjë në vorbullën e Mynihut me orientim të theksuar indoeuropianist, ballkanistik, në një anë dhe historik, por me interesa të shquar filologjikë e kulturorë si tek albanologu i rëndësishëm Georg Stadtmüller, etj. aty nxjerrin krye kërkesat për vështrim më të gjerë të çështjeve se ç'kërkonte hulumtuesi i detajit. Aty gëlon ajo që quhet gjermanisht *Aufhebung* (përsundimi) i problematikës dhe metodës junggramatikane dhe nis nevoja për vështrime funksionale e strukturore, siç do të shihet te përshkrimet e të folmeve arbëreshe a te *Gramatika* e Camajt.

Kontakte me qerthujt gjuhësorë të Beogradit në vitet '50 kanë pasur dhe Selman Riza e Idriz Ajeti. Ajeti, si Camaj, siç mund të shihet në studimet e tij të asaj kohe, kishte ndjekur rrugën e Bariqit, ndërsa Riza, edhe

²⁹ ISMAJLI (1995), ff. 115-128.

në mënyrë eksplicite, kishte parapëlqyer më tepër orientimet që synonin më shumë funksionimin e gjuhës, prandaj edhe gjendjet jo zhvillimin, pra më shumë orientimin e Aleksandar Belićit.

Vetëm pas vendosjes në Mynih dalin te Camaj horizonte të tjera në fushën e studimeve gjuhësore, e ato do ta shpien disa herë tek vështrimet funksionale-strukturale, sidomos në përshkrimet e gjendjeve të të folmeve arbëreshe në fushën e fonetikës. Në ato studime Camaj referonte edhe në mënyrë eksplicite jo vetëm koncepte si ai i fonemës dhe i kundërvënieve fonologjike, po edhe studiues si André Martinet. Në takimet e para me të në Lenggries më 1972 gati e tërë biseda na kishte shkuar në këto çështje.

Kjo hetohet dhe në Parathënien e tij për veprën e Bogdanit.

“Mendoj se shumë para Buzukut kanë ekzistuar përkthime të Ungjijve në gjuhën shqipe që përmes një elaborimi të hollë gjatë përdorimit dhe ritokimit të kopistëve në ato tekste është arritur në një stil të vërtetë e të veçantë shqiptar dhe, çka është më e besueshme, te një pasurim i kësaj gjuhe të përbashkët kishtare, e cila përfshinte forma disparate të folmesh të ndryshme rajonale, sa ishin rajonet e ndryshme prej të cilave vinin anëtarët e klerit shqiptar që përdornin atë gjuhë. Buzuku me siguri u shërbye nga këto tekste biblike dhe më shumë se një përkthyes i guximshëm duhet të konsiderohet shpesh kompilator i mirë, edhe pse si prift i mësuar dhe i kujdesshëm duhej ta kishte përpara gjithnjë shkrimin e shenjtë latinisht. Nga ky fakt do të shpjegohej pjesërisht varieteti i toneve stilistike që gjatë një leximi të kujdesshëm jep përshtypjen e një kompozimi me karakter kombinimi prej mozaiku”.³⁰

Çabej dhe Riza kanë shpjegime të tjera në këtë drejtim. Ata që të dy flasin për Buzukun si autor të vetëm të përkthimit, me ç’rast Çabej i theksonte meritat e përkthyesit të formuar, ndërsa Riza përkundrazi i vinte në pah mungesat dhe modestinë e Buzukut në formimin e tij në këtë drejtim. Pa hyrë në detajet në këtë pikë këtu dhe tani, dua ta them vetëm përfundimin se më duket që udha e hapur nga Camaj mund të jetë gjithnjë prodhuese.

Në rrugën e kërkimit të gjenezës së ‘Mesharit’ gjithnjë mbi bazë të argumenteve gjuhësorë, Martin Camaj kishte bërë një krahasim të shkurtë të gjuhës dhe të shkrimit të Buzukut me të Budit, të Bardhit dhe të Bog-

³⁰ CAMAJ, f. 35 (Përkthimi r.i.)

danit, duke shquar vijat e një tradite të vetme, sado që secili prej tyre kishte sjellë elemente të veçanta të shkrimit (sidomos Budi), elemente nga të folmet përkatëse, etj. Nga kjo traditë, pas tij, veçohet ndjeshëm Bogdani, të cilin ai e cilësonte madje “shkrimtarin dhe stilistin e parë të vërtetë të letërsisë shqipe”. Bogdani po ashtu desh t’i afrohej traditës duke shprehur nevojën që t’i përshtatej Shkodrës, por sipas tij, gjuha e Bogdanit është thellësisht “e zhytur në rrënjët e të folmes së Hasit e të Maleve të Prizrenit” (f. 75). Me Bogdanin dhe gjuhën e tij Camaj u mor dhe me rastin e botimit anastatik të *Çetës së Profetëve* të vitit 1977 në Mynih. Në një parathënie të shkurtë në formë çelësi për leximin e tekstit të Bogdanit, Camaj kishte vënë dhe vrojtime që tejkalojnë ndjeshëm interesimet e tij të mëhershme për autorët e vjetër: kishte provuar të rindëronte dhe sistemin fonematik, çka shprehte qartë ujërat linguistike në të cilët ndodhej ai tani. Në studimin për Bogdanin dhe gjuhën letrare, fare vonë, Camaj vinte të ritheksonte ndihmesat e tij në këtë drejtim dhe mundësinë që ai të trajtohej madje si nismë-tari i një gegnishteje letrare me bazë kosovarishten, çka do të theksonte sidomos Arshi Pipa.

Për autorët e vjetër, pos vrojtimeve të atyqëtushme në formë shënimesh për raste të tjera diskutimi, Camaj kishte shkruar dhe dy herë të tjera: me rastin e 400-vjetorit të Budit – një artikull përkujtimor të botuar te *Shëzjat* më 1966 dhe në një recension për veprën e Çabejtë ‘Meshari’ i Gjon Buzukut, të botuar gjermanisht dhe italisht.³¹

Në shkrimet e tij gjysmërrëfimore, Martin Camaj më vonë la shënime, për mua, me interes për të ndjekur idenë e tij të mëtejme për Palimpsestin dhe kërkimin e gjenezës, jo vetëm të ‘Mesharit’. Sikur ‘shkasi’ i kërkimit të fillimeve të shkrimit shqip, përtej gjurmëve materiale të dukshme e kishte shpënë tek hulumtimi nëpër palimpsestet gjysmë të dukshme

³¹ CAMAJ (1971c), recension për ÇABEJ (1968) 517-18, CAMAJ (1972), rec. për ÇABEJ (1968), 284-85, Martin Camaj ka paraqitur veprën e Eqrem Çabejtë ‘**Meshari**’ i **Gjon Buzukut (1555)**. Në këtë recension të shkurtë, që përfundon me vlerësimin e lartë: “vepra më e mirë filologjike e albanistikës deri sot dhe edhe kryevepra e Çabejtë”, Camaj rithekson disa informata themelore për Buzukun dhe veprën e tij, paraqet aspekte të veprës së Çabejtë e cila në secilën pjesë “sjell kontribute me vlerë për zgjidhjen përfundimtare të problemit të prejardhjes së Mesharit, edhe nëse jo gjithmonë mund të bashkëpajtohesh me mendimin e studiuesit tonë”, dhe shtron mospajtimin e tij kryesor: “Sipas meje, nuk është i pranueshëm pohimi i Çabejtë se përkthimi i këtij **Meshari** në gjuhën shqipe është vepër ekskluzive e Buzukut. Kjo bie në kundërshtim, pos tjerash, me stilet e ndryshme dhe me cilësitë e ndryshme të përkthimit” (përk. R. I.).

e më tej fare drejt zhytjes në mitizime e mite, kërkimit të palimpsestit të vet, për t'u kthyer sërish te poezia. Hulumentimet e gjenezës së "Mesharit" e vetëdijësojnë mbase për këtë të dytën, e shpien te krijimi. Martin Camaj qe një krijues dinamik. Bëri kalime nga njëra fushë e kërkimit njohës në tjetrën, nga një mënyrë e vështrimit dhe të shprehjes në tjetrën, qoftë në poezi, në prozë apo diskutime për letërsinë, qoftë dhe në dije ta quajmë krejt pozitiviste në raport me të parat, në gjuhësi. Brenda secilës prej këtyre fushave ai përjetoi lëvizje e transformime nga tradicionalja tek modernia: në poezi nga lirika krejt shqipe dhe me formë, varg e figuracion tradicional e viteve '50 drejt lirikës moderne dhe të kursyer, me varg të lirë e figuracion modern të viteve '70-'80; në prozë nga rrëfimi shqiptar i pjesës së parë të shekullit, te proza moderne Karpa; ndërsa në studimet gjuhësore nga përvoja junggramatikane e filologjike tradicionale te përshkrimet strukturale të të folmeve.

Bibliografi:

- AJETI (1968), Idriz: recension për CAMAJ (1966), **Gjurmime albanologjike**, 1/1968, Prishtinë, 241-243.
- ÇABEJ (1955), Eqrem: *Gjon Buzuku*, **Buletin për shkencat shoqërore** 1/1955, Tiranë, 23.
- ÇABEJ (1968), Eqrem: "**Meshari**" i **Gjon Buzukut (1555)**, botim kritik, II vëllime, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, Tiranë, 1968.
- ÇABEJ, E. (1968): "**Meshari**" i **Gjon Buzukut (1555)**, botim kritik, Pjesa e parë Hyrje dhe transliterim, Pjesa e dytë Faksimile dhe transkribim fonetik, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1968, I - 299 pp., II - 404 pp.
- ÇABEJ, Eqrem (1955): *Gjon Buzuku*, **Buletin për Shkencat Shoqërore** nr. 1, pp. 9-23; nr. 2, pp. 71-100; nr. 3, pp. 39-50 und nr. 4, pp. 113-124, Tiranë.
- CAMAJ (1957), Martin: *Prilog poznavanju grafije Gjon Buzukua*, **Godišnjak Balkanološkog instituta**, Sarajevo, I/1957, 203-211.
- CAMAJ (1959), Martin: *Për vokalin nazal ke Buzuku*, **Shêjzat**, 5-6/1959, Romë, 163-174.
- CAMAJ (1960), Martin: **Il "Messale" di Gjon Buzuku. Contributi linguistici allo studio della genesi**, Roma, Shêjzat, 90.
- CAMAJ (1966), Martin: **Albanische Wortbildung**, Albanische Forschungen 6, O. Harrassowitz, Wiesbaden, 1966, 175.
- CAMAJ (1969), Martin: **Lehrbuch der Albanischen Sprache**, O. Harrasowitz, Wiesbaden, 1969, 136;
- CAMAJ (1971), M.: **La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino**, Studi e testi v. IV, Firenze 1971, 120.
- CAMAJ (1971b), Martin: *Zur albanischen Mundart von Barile in der Provinz Potenza*, **Dissertationes albanicae** 13, München, 1971, 127-140;
- CAMAJ (1971c), Martin: recension për CABEJ (1968), **Südost-Forschungen, Band XX**, 517-18, München 1971
- CAMAJ (1972), Martin: recension për CABEJ (1968), **Shêjzat** 5-8, Romë, 1972, 284-85.
- CAMAJ (1977), Martin: **Die Albanische Mundart von Falconara Albanese in der Provinz Cosenza**, Albanische Forschungen 16, München, 1977;

- CAMAJ (1984), Martin: **Albanian Grammar**, O. Harrassowitz, Wiesbaden, 1984, 337.
- DEMIRAJ (2007), Bardhyl (Herasugb.): **Nach 450 Jahren. Buzukus "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit**, Albanische Forschungen 25, Harrassowitz, Wiesbaden.
- DEMIRAJ, Sh. (1995): A ka pasur një traditë shkrimi të gjuhës shqipe para Buzukut ?, **"Meshari" i Gjon Buzukut – monument i kulturës shqiptare (1555-1995)**, Ulqin 1995, 35-42.
- DEMIRAJ, Shaban (1990): **Eqrem Çabej**, 8 Nëntori, Tiranë, pp. 268.
- FIEDLER, Wilfried (2004): **Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)**, ASHAK, Prishtinë, pp. 814.
- GAZULLI, Nikollë: **Hylli i Dritës XVII**, 547, cituar sipas Çabej (1968), 56.
- ISMAJLI (1971), Rexhep: recension për Camaj (1971), **Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike**, I/1971, Prishtinë, 213-216);
- ISMAJLI (1977), Rexhep: *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes*, **Gjurmime albanologjike - seria filologjike, VII** 1977, Prishtinë, 1978, 229-256.
- ISMAJLI (1995), R.: *Kontributi i Martin Camajt për studimet buzukiane*, **"Meshari" i Gjon Buzukut - monument i kulturës shqiptare (1555-1995)**, Ulqin, 1995, ff. 115-128.
- ISMAJLI, R. (1994): *Rithemelimet e Selman Rizës*, **Etni e modernitet**, Pejë, pp.141-158.
- ISMAJLI, R. (2000): **Tekste të vjetra**, Dukagjini, Pejë, pp. 427.
- ISMAJLI (2007), Rexhep: *Studien über Buzuku in den 50er Jahren des 20. Jahrhundert*, në Demiraj (2007), 17-26.
- JOKL (1930), Norbert: **Letër redaksisë "Hylli i Dritës"**, VI, 1930, Shkodër.
- JOKL, Norbert (1930): *Nji studim përreth librit të Buzukut*, **Hylli i dritës VI**, nr. 3, Shkodër.
- MANDALÀ (1991), Matteo: *Alcune osservazioni sulle poesie di Martin Camaj*, **Albanica**, A Quarterly Journal of Albanological Research and Criticism special issue dedicated to Martin Camaj, spring 1991, nr. 2.
- RESSULLI, Namik (1958): **Il "Messale" di Giovanni Buzuku**, Riproduzione e trascrizione, Studi e testi 199, Città del Vaticano, Biblioteca apostolica Vaticana, 1958, pp. 406.
- RIZA (1960), Selman: **Pesë autorët më të vjetër të shqipes**, Tiranë, 1960, V.
- RIZA (1983), Selman: **Nyjet e shqipes në tekste e pesë autorëve tanë më të vjetër**, pjesë e **Nyjat e shqipes** nga viti 1962, botuar në **Studime filologjike** 1/1983, Tiranë, 21- 53
- RIZA, S. (1944): **Tri monografina albanologjike**, Tiranë; Riza (1996), pp. 1-222.
- RIZA, S. (1952), **Fillimet e gjuhësisë shqiptare**, Prishtinë; Riza (1996), pp. 223-352.
- RIZA, S. (1958): *Mbi vlerën fonetike të grafivet buzukiane dhe (u) latine*, **Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore**, nr. 1, pp. 81-85, Tiranë.
- RIZA, S. (1958a): **Relacion i zgjeruar mbi ribotimin kritik të Gjon Buzukut nga Eqrem Çabej**, nga dorëshkrimi riprodhuar në Riza (1996), pp. 491-542.
- RIZA, S. (1996): **Vepra 1**, ASHAK, Prishtinë, pp. 566.
- RIZA, S. (2002): **Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe**, Toena, Tiranë, pp. 399. Shkruar në vitet ,60, riprodhuar dhe në Riza (2004), pp. 233-654.
- RIZA, S. (2004): **Vepra 4**, ASHAK, Prishtinë, pp. 664.
- ROQUES (1932), Mario: **Recherches sur les anciens textes albanais**, Paris, 1932.
- ROQUES, Mario (1932): **Recherches sur kles anciens textes albanais**, Paris.
- RROTA, J. (1930a): **Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe. D. Gjon Buzuku (1555)**, Shkodër, botimi i dytë 1938.

Rexhep ISMAJLI, Prishtina

CAMAJ AND GENESIS OF THE TEXT

Summary

Contemplative poet and linguist Martin Camaj moved concurrently in two different tracks of creative work: poetic and literary, on the one hand, with language being the medium of interest; and the linguistic-scientific research, on the other. Matteo Mandalà asked the question: “Can a poet be a linguist and a literary critic at the same time?”

This paper treats one aspect related to this matter, by observing the genesis as an issue in linguistic studies and, perhaps, in literary work as well. In his beginnings of literary studies Camaj was influenced by the 'Yung-grammarians' studies. He continued with the same interests in Rome where the cultural aspect of researching old Albanian texts became his foremost interest, especially while working in the Vatican Library, thus becoming one of a few scholars who could make use of Buzuku's only preserved copy.

In his half-narrative writings, Martin Camaj left behind interesting notes of high interest for those tending to follow his idea on the Palimpsest and the quest of genesis, not only of '*Meshari*'. Martin Camaj was a dynamic author. He moved from one field of cognitive research to another, from one way of perception and expression to another, be that in prose, poetry or discussions on literature, or even in, let us say, fully positivist knowledge in relation to the former, the linguistics. In each of these fields he had shifts and transformations from the traditional to the modern: in poetry from fully Albanian lyrics with the form, verse and traditional figuration of the 1950s to the modern and thrifty lyrics with free verse and modern figuration of the 1970s and 1980s; in prose, from the Albanian narration of the first part of the century to the 'Karpa' modern prose; in linguistic studies, from the 'Yung-grammarians' experience and traditional philological experience to the structural description of speeches.

Kolec TOPALLI, Tiranë

SHTRESIMI I HUAZIMEVE NGA GJUHËT BALLKANIKE NË NJË FJALOR ETIMOLOGJIK

KDU 811.18-36
81'374.4

Sipas një projekti të miratuar në Këshillin Shkencor të Institutit të Gjuhësisë, kemi nisur punën për hartimin e një fjalori etimologjik të gjuhës shqipe. Fjalorë të tillë janë pasqyrë e historisë së gjuhës, dhe në një kuptim më të gjerë, janë pasqyrë e historisë së vetë popullit që e flet atë. Për gjuhën shqipe ata dëshmojnë trashëgiminë e hershme mijëravjeçare të ruajtur brez pas brezi që nga periudhat më të hershme të njerëzimit, si edhe rrugën e vështirë të historisë së shqiptarëve përgjatë shekujve, me kontakte të shumta e të vazhdueshme me popuj të ndryshëm, që kanë lënë gjurmët e tyre në histori dhe në gjuhë, në tradita e zakone, në doke e fe, në mendësi dhe në mënyrën e jetesës.

Duke ndjekur udhën e gjatë të historisë së kombit që e flet, shqipja ka marrë e ka dhënë me gjuhë të tjera. Në historinë e këtyre marrëdhënieve bëjnë pjesë edhe lidhjet me gjuhët e Gadishullit Ballkanik, të cilat rrjedhin nga fqinjësia gjeografike ose nga kontakti me gjuhët e popujve që erdhën si pushtues në trevat e banuara nga shqiptarë. Fjalorë të tillë bëjnë të mundur të dallohen shtresat e ndryshme të huazimeve historike, si edhe të ndiqen rrugët e hyrjes së tyre. Dukuritë fonetike e gramatikore që kanë vepruar në huazime të periudhave të ndryshme, bëjnë të mundur gjithashtu përcaktimin e kronologjisë së vetë dukurive, kur dihet se kontaktet me disa popuj të trevës ballkanike mund të datohen historikisht.

Me një vështrim të përgjithshëm të situatës gjuhësore në Gadishullin Ballkanik, shqipja në periudhën historike të 2000 vjetëve të shkuara ka pasur marrëdhënie gjuhësore me lindjen dhe perëndimin, me gjuhë më të lashta e me gjuhë më të reja në këtë Gadishull, me kontakte që rrjedhin nga fqinjësia gjeografike mijëravjeçare dhe me gjuhë të ardhacakëve, që erdhën si pushtues.

Problemet kryesore që dalin në një fjalor etimologjik lidhur me huazimet e periudhës historike janë: përcaktimi i burimit të tyre, shtrirja gjeografike e dialektore dhe shkalla e rrënjësimit të tyre në gjuhë.

Në mbështetje të analizave burimore të huazimeve, procesin e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët me të cilat ka pasur kontakte, mund ta ndajmë në tri faza: faza e parë përfshin marrëdhëniet me gjuhët e vjetra klasike, greqishten e latinishten. Kjo është periudha antike e shqipes, që lidhet me nënën a shqipen e vjetër. Periudha e dytë përfshin marrëdhëniet me gjuhë më të reja, që janë të gjalla edhe sot dhe përfshin marrëdhëniet me italishten, gjuhët sllave dhe greqishten e mesme e të re. Periudha e tretë, më e reja përfshin marrëdhëniet gjuhësore në mesjetën e vonë, duke filluar me shekullin XVI deri në shekullin XX, që është e lidhur kryesisht me ndikimin e turqishtes, duke vijuar ndikimi i gjuhëve sllave dhe i greqishtes së re në krahinat kufitare, të banuara nga shqiptarë, si edhe ndikimi i gjuhëve perëndimore kryesisht nëpërmjet librash.

Për periudhën e parë, greko-latine, analiza etimologjike e huazimeve dëshmon se fjalët e marra nga këto dy gjuhë, u janë nënshtruar dukurive të njëjta. Kjo do të thotë se huazimet e këtyre gjuhëve kanë hyrë në shqipe afërsisht në të njëjtën kohë. Në këtë rast, huazimet e greqishtes së vjetër, më të pakta në numër, krahasohen me shtresën më të lashtë të huazimeve latine. Ndër këto dukuri vëmë në dukje:

1) theksi në fjalët e huazuara nga këto dy gjuhë, ose është ruajtur në pozicionin e tij në fjalë me ritëm daktilik, ose është zhvendosur në rrokjen e ballit të fjalës, për arsye se shqipja në atë periudhë të lashtë të zhvillimit të saj ka pasur theks nistor. Kësisoj, *drapënë* nga gr. vj. *δρόπανον*, *kandërrë* nga gr. vj. *κάνθαρος* dhe *femën* nga lat. *fēmina*, *balsëm* nga lat. *balsamum*, e kanë ruajtur njëlloj pozicionin e theksit; kurse *mokënë* nga gr. vj. *μῶχανά* dhe *voshtër* nga lat. *oleaster* e *kumtër* nga lat. *compāter*, e kanë zhvendosur atë në rrokjen nistore.

2) Gjatësia e zanoreve, që shfaqet me të njëjtat ndryshime në huazimet e marra nga këto gjuhë, është i njëllajtë me evolucionin e gjatësive të trashëguara. I tillë është ndërrimi /ā/ > /o/, në fjalë të trashëguara: *motër* nga ie. *māter*; në huazimet greke: *mollë* nga gr. *μῶλον*, *shkop* nga gr. *σκ πος*; në huazimet latine: *rruaj* nga lat. *rādere*, *truaj* nga lat. *trādere*.

3) Zanorja /ē/ (e gjatë) në huazimet e këtyre dy gjuhëve ka dhënë /e/; në huazimet greke: *shpellë* nga gr. *σπηλαιον*, *pellëg* nga gr. vj. *πίλαγος* dhe *eshkë* nga lat. *ēscā*, *vëner* nga lat. *venēnum*. Meqenëse në elementin e trashëguar /e/-ja ka dhënë /o/, kjo do të thotë se huazimet e këtyre gjuhëve kanë hyrë pasi kishte mbaruar evolucionin i /ē/-së në /o/; por në një kohë kur shqipja i ruante ende gjatësitë e zanoreve të trashëguara; sepse me këtë

shpjegohet përse /ē/-ja nuk është diftonguar në /je/ në këto huazime, dukuri që ka prekur /e/-në e shkurtër të fjalëve të trashëguara dhe të huazimeve nga greqishtja e vjetër e latinishtja.

4) /o/-ja (e shkurtër) paraqitet me dy evolucione të ndryshme në të dyja këto gjuhë, nga njëra anë, me zanoren /u/, si në *mushk* nga gr. vj. *μύσχος* dhe *nun* nga lat. *nonnus* e *murg* nga lat. *monachus*; nga ana tjetër me grupin *vo-* / *va-*, si në *vodhë* / *vadhë* nga gr. vj. *οῦή*, *voj* / *vaj* nga lat. *oleum*, *i vorfën* / *i varfër* nga lat. *orphanus*. Të dy këto evolucione gjenden edhe në fjalë të trashëguara; për shndërrimin /o/ > /u/ vëmë në dukje: *punë*: ie. *pondā*, *hudhër* : ie. *sšor-* me të njëjtin kuptim; për evolucionin *vo-* / *va-* kemi: *vatër* / *vatër* : ie. *āt-* “zjarr”, *vorr* / *varr* : ie. *ēr-* “dhe, tokë”.

5) Zanoret paratheksore të huazimeve nga të dyja këto gjuhë, kanë ndjekur rrugë të njëjtë evolucionari. Ato janë rrëgjuar në fjalë me një zanore paratheksore, si në *pëllambë* nga gr. vj. *παλάμη* dhe në *fëmijë* nga lat. *familia*; por në fjalë me dy rrokje të patheksuara është rrëgjuar vetëm zanorja më afër theksit të fjalës, kurse zanorja e ballit që ndodhej më larg theksit, është ruajtur; p.sh. *qersh* nga gr. vj. *κεράσια*, *mallëkoj* nga lat. *maledicere*, *kallënduer* nga lat. *calendarium*.

6) Zanoret pastheksore të huazimeve nga të dyja këto gjuhë janë rrëgjuar gjithandëj në zanoren -ë-; p.sh. *shpargën* nga gr. *σπάργανον*, *mangën* nga gr. vj. *μάγγανον*, *frashën* nga lat. *fraxinus*, *qiqër* nga lat. *cicer*.

7) Në aspektin gramatikor, huazimet e të dyja gjuhëve që dalin me sonanten hundore -n ose me një lëngëzore, marrin mbaresën -ë në shqipe, që është mbaresa e kallëzores së trashëguar, e cila në emrat mashkullorë me këtë përbërje është shtrirë edhe në emërore me ristrukturimin e sistemit rasor. Vëmë në dukje, nga huazimet e greqishtes së vjetër: *pjepënë* nga gr. vj. *πέπων*, *kandërë* “enë vaji” nga gr. vj. *κάνθαρος* dhe *lepurë* nga lat. *leporem*, *shekullë* nga lat. *seculum*.

8) Një aspekt tjetër gramatikor është veprimi i metafonisë në huazimet e të dyja këtyre gjuhëve, si: *presh* nga gr. vj. *πράσον*, *bretëk* nga gr. vj. *βρόταχος* dhe *rreze* nga lat. *radia*, *rremb* nga lat. *rāmus*, *qerre* nga lat. *carrus*.

Të gjitha këto evolucione të përbashkëta që kanë ndjekur huazimet nga të dyja këto gjuhë, të çojnë në përfundimin se marrëdhëniet e shqipes me greqishten e vjetër dhe latinishten, megjithëse me intensitet dhe kohëzgjatje të ndryshme, janë zhvilluar afërsisht në të njëjtën kohë, dhe

duke u mbështetur edhe në tregues të tjerë, e kanë fillësën e tyre në kapërcyell të fillimit të mijëvjeçarit të parë të erës së re.

Për huazimet e periudhës së dytë, analiza e tyre etimologjike të çon në përfundime të tjera. Huazimet e mesjetës së hershme lidhen me ndikimin e gjuhëve sllave, të greqishtes së mesme e të re dhe të italishtes. Përcaktimi i kufijve kronologjikë të ndikimeve të këtyre gjuhëve mund të bëhet duke marrë parasysh faktorët historikë dhe gjuhësorë. Sipas faktorit historik mund të përcaktohet kufiri i fillimit të ndikimit të sllavishtes, meqenëse sllavët kanë ardhur në Ballkan në një periudhë të caktuar, që datohet nga historia. Kurse kufiri i fillimit të ndikimit të greqishtes së mesme e të re dhe i italishtes mund të bëhet sipas faktorit gjuhësor, meqenëse këto gjuhë janë vijuese të gjuhëve të vjetra, si rrjedhim, ndikimi mbi shqipen është në vazhdimësi gjuhësore.

Për të përcaktuar burimin dhe moshën e këtyre huazimeve, është e nevojshme të mbahen parasysh disa dukuri fonetike që janë zhvilluar në kohën e hyrjes së këtyre huazimeve ose në periudhën para hyrjes së tyre. Dukuri të tilla janë rregullimi mekanik i theksit, hundorësia e zanoreve e rotacizmi, rrëgjimi i zanoreve të patheksuara etj. Disa prej tyre, siç është rregullimi mekanik, është dukuri mbarëgjuhësore; por dukuri të tjera, siç është hundorësia, kanë nisur si të tilla në fazat e tyre të para, por më vonë janë zhvilluar si dukuri dialektore duke dhënë edhe përfundime të ndryshme. Më së fundi, ka pasur edhe dukuri, siç është rotacizmi, që ka pasur karakter dialektor që në fillimet e tij.

Rregullimi mekanik i theksit mund të ndiqet me huazime që janë marrë nga gjuhët e ndryshme. Kësaj dukurie nuk i janë nënshtruar huazimet e periudhës së parë, domethënë ato që janë marrë nga greqishtja e vjetër e latinishtja, por u janë nënshtruar huazimet e periudhës së dytë, huazimet nga sllavishtja, greqishtja e mesme a e re e italishtja; si p.sh., nga sllavishtja: *zakón* nga sll. *zákon*, *lëndinë* nga sll. *lędina*, *kastravec* nga sll. *krástavec*; nga italishtja: *makínë* nga it. *mácchina*, *rrezík* nga it. *risico*, *balsám* nga it. *bálsamo*; nga greqishtja e mesme dhe e re: *faqéll* nga gr. *φάκελος*, *trëndafil* nga gr. *τριαντάφυλος*, *Patós* nga gr. *πάτος*. Kjo dukuri është e lidhur me rrëgjimin e zanoreve pastheksore, të cilat kur janë ruajtur të parrëgjua, e kanë tërhequr theksin e fjalës mbi vete duke krijuar përgjithësisht fjalë parafundore me mbaresat e sistemit emëror.

Ndryshe është zhvilluar hundorësia e zanoreve, që ka nisur si dukuri mbarëgjuhësore, por më vonë ka marrë tipare dialektore duke marrë rrugë

të ndryshme zhvillimi në dy dialektet e shqipes. Ndërsa në gegërishte hundorësia është ndalur me krijimin e zanoreve hundore, që janë ruajtur të tilla deri në ditët tona, toskërishtja, përkundrazi, ka vijuar evolucionin e tyre, me rotacizimin e sonantes hundore, e cila nga ana e saj është bërë shkak për zhdukjen e karakterit hundor të zanoreve. Fakti që huazimet e periudhës së dytë, përgjithësisht, nuk u janë nënshtruar hundorësisë dhe rotacizimit, i vendos këto dy dukuri në periudhën para se të fillonin kontaktet me këto gjuhë, ose diçka më vonë, në periudhën e kontakteve të hershme, duke marrë parasysh se një shtresë më e moçme e këtyre huazimeve u është nënshtruar këtyre dukurive. Të tilla janë huazimet me rotacizëm: *tërsirë*, *shtëpreshtë* nga sllavishtja; *spërk*, *korë* nga greqishtja e re; *kudhër*, *këmborë* nga italishtja. Meqenëse huazimet nga këto gjuhë mund të datohen afërsisht rreth shekullit VII-VIII, përfshirja e një pjese të vogël të huazimeve nga këto gjuhë dëshmon se vetë dukuritë ishin në shuarje e sipër në kontaktet e para me këto gjuhë, duke bërë të mundur vendosjen e kufirit kronologjik të shuarjes së tyre në shekujt e fundit të mijëvjeçarit të parë.

Të gjitha këto dukuri duhen vlerësuar në një fjalor etimologjik kur është puna për kronologjinë e hyrjes së huazimeve, që nganjëherë përcaktohet nga format e fjalëve, siç ndodh me huazimet e dyfishta: *këmborë* e *kambanë*, *Mërtiri* e *Martini*, *gjirë* e *gjini*, *djemër* e *demon*, *korë* e *ikonë*, *Frar* e *fanar*, *spërk* e *spanua* etj. Ndërkaq, duhet marrë parasysh se disa dukuri, kur morfologjizohen, vijojnë të veprojnë me rrugë analogjike edhe kur janë shuar fonetikisht. E tillë është p.sh. hundorësia e zanoreve në gegërishte, që shfaqet në disa elemente formuese të marra nga turqishtja, siç është prapashtesa *-dan*, te emrat *flakadâ* e *lavërdâ*; shndërrimi i zanores /a/ në /ë/ në pozicion hundor në disa huazime turke, si *tamëm*, *bakëm*; si edhe qiellzorëzimi i grykoreve në huazime të reja që kanë hyrë me rrugë librore, siç janë disa forma shumësi, si: *çeqe* nga ang. *check*, *stoqe* nga ang. *stock* etj.

Periudha e tretë e depërtimit të huazimeve nga gjuhët ballkanike është më e vona dhe lidhet me kontaktet me turqishten në mesjetën e vonë, prej së cilës shqipja ka marrë fjalë që lidhen me mënyrën e jetesës orientale, me jetën luftarake etj. Shumica e huazimeve nga kjo gjuhë po zhyndoset gjithnjë e më shumë në periferi të shqipes me prirje për të dalë nga gjuha. Me ndryshimet e mëdha që pësoi organizimi i mënyrës së jetesës në shekullin e fundit është pakësuar ndjeshëm pesha e këtyre huazimeve, prandaj edhe paraqitja e tyre në një fjalor etimologjik do të ketë parasysh

shkallën e rrënjosjes së tyre në gjuhën e sotme. Për këtë arsye në fjalor do të trajtohen huazimet me përhapje të përgjithshme, si: *xhep, baba, mashë, xham, pambuk, sheqer* etj.; por do të lihen jashtë huazimet me përhapje krahinore a lokale, si: *alldysy, allçak, masllahat, hudud, zahmet* etj., që s'kanë gjasë të hyjnë në përdorim të përgjithshëm. Ndonjë prej këtyre huazimeve, megjithëse ka dalë nga shqipja, ka lënë gjurmë në toponimi, në emra familjesh a personash, siç është p.sh. emri *bazhdar* "nëpunës që peshonte mallrat", i cili si apelativ ka dalë jashtë përdorimi, por ruhet si emër familjesh.

I njëjti qëndrim do të mbahet ndaj huazimeve librore a fjalëve diturake, që kanë hyrë nëpërmjet librash dhe kohët e fundit po vërshojnë me fuqi të jashtëzakonshme duke errësuar shpesh forcën krijuese të shqipes. Edhe prej këtyre huazimeve do të trajtohen etimologjikisht vetëm ata që kanë fituar qytetarinë në fjalorin e shqipes, që janë të nevojshëm dhe kanë krijuar edhe rrjedhoja të tjera me mjetet fjalëformuese të shqipes. Sipas këtij kriteri do të përfshihen në fjalor emrat: *akt, dokument, normë, kolektiv*; mbiemrat: *absolut, abstrakt* etj., duke lënë jashtë termat shkencore e teknike të degëve të ndryshme të shkencave, si: *neurozë, agregat, termostat, anestezi* etj., që kanë përdorim të kufizuar dhe njihen vetëm nga specialistët e fushave të veçanta. Këto terma shkencore e teknike, që janë prej burimi të huaj, mund të trajtohen në fjalorët terminologjikë sipas degëve të shkencës.

Duke kaluar tashti në shqyrtimin e aspektit sasior, në fjalësin e tij, në një fjalor etimologjik të vëllimit të mesëm do të përfshihen huazimet që kanë hedhur rrënjë në gjuhë, që janë të domosdoshëm dhe kanë krijuar përgjithësisht rrjedhoja me ndajshtesa. Të tilla janë fjalët: *adhuroj, i lirë, bankë, bujk, kumbull, drejt* etj. Por do të lihen jashtë huazimet që kanë qenë lidhur me mënyra jetese të së kaluarës, si rrjedhim, edhe fjalët me të cilat janë shprehur kanë dalë jashtë përdorimit. Jashtë fjalorit do të mbeten edhe disa huazime që kanë autorët e vjetër, por nuk janë integruar në gjuhë, si: *dullye, baçil, furrëqí, axímatë* etj.

Së fundi, për të gjitha huazimet që shpjegohen, ashtu si edhe për fjalët e trashëguara, do të shënohet në mënyrë të përmbledhur bibliografia, duke shfrytëzuar literaturën e qëmtuar prej vitesh, për mbledhjen e së cilës kanë kontribuar shumë gjuhëtarë, nga radhët e të cilëve po lejohem të përmend, të pranishëm në sallë: akademikët Besim Bokshi, Rexhep Ismajli, Wilfried Fiedler, Francesco Altimari; profesorët Matteo Mandalà, Besim

Kabashi, Bardhyl Demiraj, Irena Sawicka, Monica Genesin; ndërsa të papranishmëm, gjuhëtarët: Eqrem Çabej, Kolë Ashta, Eric Hamp, Antonio Filippin, Michiel de Vaan, Elton Prifti, Marcu Gabinski, Andrei Avram, Paolo Di Giovine etj. Të gjithëve u jam mirënjohës për kontributin e dhënë.

Literatura

- BOKSHI, Besim: *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Prishtinë, 1980.
- ÇABEJ, Eqrem: *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Tiranë, I 1982, II 1976, III 1987, IV 1996, VI 2002, VII 2006.
- DIZDARI, Tahir: *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*. Tiranë, 2005.
- HULD, Martin E.: *Basic Albanian Etymologies*. California State University. Los Angeles, 1984.
- JANSON, Bernd: *Etymologische und chronologische Untersuchungen zu den Bedingungen des Rhotazismus im Albanischen unter Berücksichtigung der griech. und lat. Lehnwörter*. Frankfurt am Main - Bern - New-York, 1986.
- JOKL, Norbert: *Linguistisch - kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*. Berlin und Leipzig, 1923.
- MEYER, Gustav: *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Strassburg, 1891.
- THUMB, Albert: *Altgriechische Elemente des Albanischen*. IF 26, 1910.
- TOPALLI, Kolec: *Fonetika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 2007.

Kolec TOPALLI, Tirana

STRATIFICATION OF BORROWINGS FROM BALKAN LANGUAGES IN AN ETYMOLOGICAL DICTIONARY

Summary

In the process of compiling an etymological dictionary (the work that started this year), a special focus is attached to the borrowings from the Balkan languages with which Albanian had contacts (interacted with) in different periods of history. Such dictionaries help identifying various strata of historic borrowings as well as the ways of their entry into one language.

An overview of the general linguistic situation in the Balkan Peninsula shows that during the past 2,000 years the Albanian has had linguistic interaction with the East and the West, the old and new languages in this peninsula, as a result of centennial geographical vicinity, and also with the language of settlers who came as occupiers. The key problems that emerge in working on an etymological dictionary related to borrowings in a given historic period are: identification of the source, geographical and dialectal distribution, and the range of incorporation into the language.

A analyzing the borrowings and the process of the relations between Albanian and the languages it has had contacts with involves three phases: the first phase includes relations with old classical languages, Greek and Latin. This is the ancient period of Albanian, linked to the roots of the old Albanian. The second period includes the relations with new languages, that is, the living languages, including Italian, Slavic languages, and relations with new- and middle-new Greek language. The third period, the most recent one, includes linguistic relations during the late medieval age, starting from 16th century to 20th century, and it is mainly connected with the Turkish influence, followed by the influence from the Slavic languages and old Greek language in border zone provinces inhabited by Albanians, as well as the influence of Western languages, mainly through books.

Bardh RUGOVA, Prishtinë

GJUHA E KUMTESAVE PËR SHQIPEN STANDARDE

KDU 811.18'26

Abstrakt

Synim i këtij studimi është të vërejë shkallën e neutralitetit shkencor në kumtesat që trajtojnë standardin e shqipes e që janë paraqitur në revista, simpoziume, seminare dhe konferenca shkencore në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni gjatë dy dekadave të fundit.

Hulumtimi i mbështetur në gramatikën e tekstit tregon tendencën e autorëve për të shprehur qëndrimet personale gjatë hartimit të njësive dhe/ ose duke zëvendësuar gjuhën shkencore me veçori subjective, çka diskutimet e tilla për shqipen standard i bën të marrin një dimension ideologjik dhe të besimit.

Fjalët çelësa: Gjuhës standarde, gramatikë e tekstit, gjuhë e shkencës, përfytyrim tekstor, ideologji

Synim i këtij studimi është të vërejë shkallën e neutralitetit shkencor në kumtesat që trajtojnë standardin e shqipes e që janë paraqitur në revista, simpoziume, seminare dhe konferenca shkencore në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni gjatë dy dekadave të fundit. Punimi hulumton diskursin e këtyre kumtesave, në përpjekje për të dalluar ndërhyrjet e bindjeve dhe të ideologjisë në diskutimet e qarqeve akademike për çështjen e shqipes standarde.

Standardi i shqipes është një ndër temat më të diskutuara në konferencat e gjuhësisë në Kosovë, Shqipëri dhe në institucionet akademike shqiptare në Maqedoni. Vetëm brenda 16 muajve të fundit janë mbajtur disa konferenca shkencore, në të cilat shqipja standarde ose probleme eventuale të saj kanë qenë temë kryesore e diskutimeve, ndërsa debati rreth saj është pasqyruar edhe në medime.

Ky studim mbështetet në një hulumtim mbi një mostër rasti të 59 artikujve të botuar në revista studimore, të nxjerra nga konferencat, seminarët dhe simpoziumet e ndryshme. Ndonëse mostra është e rastit, nga ajo janë hequr artikujt, me të cilat një autor paraqitet më shumë se një herë. Prandaj, mostra është e përbërë nga 59 artikuj të 59 autorëve të ndryshëm,

në mesin e të cilëve janë edhe tre autorë joshqiptarë. Përzgjedhja është bërë me zgjedhje të rastit, por duke u kujdesur që të mos ketë përsëritje autorësh. Punimet pastaj janë bashkuar në një korpus të vetëm dhe janë trajtuar pa emrat e autorëve. Përzgjedhja e punimeve është bërë sipas kësaj skeme:

- Një nga punimet është artikull i botuar në Seminarin XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare më 1995;
- Një është marrë nga Seminari 19 për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (2001);
- Tetë janë marrë nga konferenca “Shqipja stanarde dhe shoqëria shqiptare sot” (2002);
- Tre janë nga Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (2002);
- Gjashtë janë marrë nga Konferenca “Zbatimi i kulturës së gjuhës në shqipen e shkruar” (2004);
- Një nga Seminari XXIII (2004);
- Dy nga Seminari XXIV (2005);
- Katër nga Seminari XXV (2006);
- Pesë nga Seminari XXVI (2007);
- Po pesë nga Seminari XXVIII (2009);
- Një nga “Studime filologjike 1-2 (2009);
- Një nga revista “Filologji 17” (2010);
- Dy nga Seminari XIX (2010);
- Një nga Seminari XXX (2011);
- Pesë janë marrë nga Seminari V i Albanologjisë në Shkup, më 2011;
- Tri nga Studime Filologjike XVI, (2011);
- Dhjetë nga Konferenca “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit” (2011).

Hulumtimi, duke gjurmuar ngjyrimet eventuale ideologjike, nuk synon të trajtojë drejtimin e këtyre ideologjive, kështu që qëndrimet ideologjike pro dhe kundër ndonjë problemi rreth shqipes standarde i vë në të njëjtën kategori, atë të shprehjes së qëndrimit brenda artikullit. Hulumtimi nuk bën krahasimin e artikujve që lidhen me shqipen standarde me artikuj të tjerë të fushave të tjera të gjuhësisë. Artikujt e hulumtuar i nënshtrohen analizës së diskursit. Analizën e diskursit e konsiderojmë analizë të gjuhës në përdorim, duke i kundruar format e shfrytëzuara gjuhësore varësisht nga funksionet që i kanë këto forma. Si e tillë, gjuha në përdorim nuk mund të kufizohet në përshkrimin e formave, pa i marrë parasysh qëllimet ose funk-

sionet, të cilave u shërbejnë ato forma (BROWN & YULE 1983, JOHNSTONE 2008, WEIJUN He X, Van DIJK 1988). Hulumtimin, po ashtu, e mbështesim mbi konceptet e studiuesit Michael HALLIDAY (2004:49), i cili e përkufizon gjuhën e shkencës si një tërësi formash të ndryshme të ligjërit, në të cilat përshtatohen dhe zbatohen aktualitetet shkencore parë si burim sistematik për krijim të kuptimit e jo si përmbledhje instancash të tekstit. Halliday, duke e konsideruar gjuhën shkencore si regjistër më vete (2004: 170) vlerëson se gjuha e shkencës përfshin format e ndryshme të diskursit, në të cilin kryhen aktivitetet e të bërit shkencë (2004: 49). Fjalori enciklopedik i anglishtes i Websterit, te zëri *shkencë* (1996: 1716) jep këtë sqarim si shpjegim të parë: “Fushë e dijes ose e studimit që merret me një tërësi faktesh ose të vërtetash të aranzhuara në mënyrë sistematike dhe që tregojnë veprimin e ligjeve të përgjithshme”.

Së këndejmi, gjuha e një artikulli shkencor është gjuhë që shërben për formulim të hipotezave, paraqitje të të dhënave dhe provë të hipotezave.

Duke nxjerrë këtë përkufizim po ecim pak më tutje nga konceptet e Platonit të shekullit IV para erës sonë. Ai duke konsideruar se mosdija është thelbi i çdo të keqeje, do të përpiqej ta përkufizonte dijen si “besim i mirëfilltë i arsyetuar”. Ai këtë e arsyetonte me tri kërkesa. Që të themi se dimë diçka, koncepti duhet të jetë i vërtetë, duhet ta besojmë dhe duhet të arsyetojmë, pra, duhet t’i tregojmë arsyet se përse e besojmë. Njëzet e katër shekuj më pas, konceptet i vërtetë dhe besim dhe arsyetim duan një sqarim më të thellë.

Një ndër themeluesit e teorisë së metodës shkencore, Karl Popperi do ta quajë historinë e njerëzimit si një histori të paragjykimëve dhe të dogmës, shpesh të kapluar edhe nga mungesa e tolerancës (POPPER 1997: 83). Mbështetur në këtë pikë, Popperi do të përcaktojë vijën e demarkacionit mes shkencës dhe joshkencës. Sipas tij, një teori nuk mjafton të quhet shkencore vetëm në bazë të verifikueshmërisë së saj, por doemos edhe në bazë të falsifiabilitetit. Pra, nuk mjafton metoda induktive, por që një teori të quhet e dëshmuar ose e arsyetuar ajo duhet të trajtohet dhe të dëshmohet me metodën deduktive (1997: 88, 2005: 18). Sipas Poperit, një shkencëtar, qoftë ai teorist apo empirist, vë deklarime në sisteme të deklarimeve dhe i teston ato hap pas hapi. Në fushë të studimeve empirike ndërton hipoteza ose sisteme teorike dhe i provon ato kundër përvojës përmes vëzhgimit ose eksperimentit (POPPER, 2005:3). Autorë bashkëkohorë si Masimo Pigliucci do

ta kontestojnë rigorozitetin e vijës demarkuese të Popperit, duke thënë se ekzistojnë disa mënyra të ndryshme se si bëhet shkenca dhe kjo përcaktohet nga dy kritere, kompleksiteti i objektit të studimit dhe shkalla, në të cilën luan rol historia e studimit të atij sistemi që trajtohet. Sa më jokompleks problemi, aq më i saktë dhe i qartë rezultati. Po ashtu, sa më historik problemi, aq më të lehta do të jenë parashikimet e bëra, të nxjerra si rezultat i studimit (PIGLIUCCI 2010:303). Këtu i kthehemi edhe njëherë lidhjes e vërtetë – besim te Platoni dhe te konceptet e Popperit se njeriu është qenie e arsyeshme, sa edhe ideologjike (1997:83).

Në hulumtimin e artikujve për shqipen standarde janë trajtuar: a). parashtrimi i temës dhe mbështetja e propozimeve; b). kategorizimi i tekstit dhe shkalla e objektivitetit.

Parashtrimi i temës dhe mbështetja e propozimeve janë gjurmuar duke kundruar të përkufizuarit e temës së artikullit dhe të tezave të propozuara; duke vërejtur nëse artikulli përfshin matje konkrete dhe/ ose lexim kritik.

Kategorizimi i tekstit dhe shkalla e objektivitetit janë gjurmuar duke vërejtur tipat e zgjedhur të tekstit për të realizuar propozimet, shkallën e mbiemrave të përdorur dhe llojet e tyre si dhe llojet e fjalive të përdorura për t'i paraqitur dhe argumentuar propozimet.

Argumentimi shkencor është përkufizuar si një lloj teksti, në të cilin dërguesi bart gjykimet duke lidhur konceptet e ngjarjevem të dukurive, të objekteve dhe të ideve me sistemet e të menduarit dhe të dijës, në mënyrë që propozimet e dala të jenë të verifikueshme, ndërsa si formë, ky lloj teksti karakterizohet nga stili neutral i modifikuar nga zgjedhjet e stilit formal dhe të atij teknik (WERLICH 1983:118)

Mostra e hulumtimit përfshin vetëm punime të periudhës pas vitit 1992.

Këtu mund të sqarojmë se trajtimi i standardit të shqipes përfshin dy faza të ndryshme, fazën e trajtimit të këtij problemi para vitit 1992 dhe faza tjetër pas kalimit nga sistemi totalitar në atë liberal të Shqipërisë, në rend të parë. Kjo fazë fillon me konferencën “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare” në nëntor të vitit 1992. Faza e parë dominohet nga tekste deskriptive-instruktive si tipa tekstesh dhe si tekste subjektive kundruar nga rrafshi i përfaqësimit të tekstit. Këtë fazë do ta trajtojmë me disa copëza teksti të Androkli Kostallarit (1987:31) që mjaftojnë për të argumentuar pohimin e bërë më lart: “(a) Është e vështirë të gjesh në Evropë një gjuhë tjetër letrare që të ketë bërë brenda një shekulli një hap cilësor kaq të gjerë e

të shpejtë si ai i shqipes... (b) Bie në sy gjithashtu përmirësimi i gjuhës së shtypit tonë nga një vit në tjetrin, afrimi i saj me gjuhën popullore... (c) Sot del nevoja që në të gjitha mjetet e informimit të përmirësohet më tej zbatimi i normës së drejtshkrimit, të thellohet puna për fjalën shqipe e për ndërtimet shqipe të menjanohen tërësisht frazat stereotipe, me shumë fjalë e me pak mendime dhe në përgjithësi të ketë një gjuhë më të thukët e më të përpiktë, e cila mishërohet më mirë me njësinë e formës ...”

Kundruar nga elementet e këndvështrimit folës, numri i mbiemrave që shprehin qëndrim (plot gjashtë raste në 117 fjalë – pra mbi 5 për qind), i vetës së parë (*gjuha jonë, shtypi ynë*), i njëjësive treguese kundruall atyre përshkruese (*është e vështirë, hap kaq cilësor, del nevoja, bie në sy*), i fjalive që shprehin cilësi a atribut (*Është e vështirë...; mishërohet më mirë...*), teksti del subjektiv. Po ashtu, sipas shembullit të tretë, jepen koncepte instruktive, udhëzime si të veprohet, jo rezultate hulumtimi. Ky koncept flet jo për diskutim shkencor, por për urdhër përdorimi. Mirëpo, kjo fazë nuk përbën objektin tonë të studimit. Përqendrimi i këtij studimi është mbi fazën e dytë, atë të hapjes së diskutimit për shqipen standarde.

Këto janë rezultatet e hulumtimit:

- Nëntë nga artikujt nuk e kanë të deklaruar tezën e tyre të punimit. Tema e propozuar në titullin e artikullit ose është krejt e përgjithshme, ose nuk përputhet me përmbajtjen. Ndër titujt e tillë mund të shënohen formulimet e tilla si: *“Rreth kulturës së gjuhës në...”*, *“Kontributi i disa studiuesve të huaj...”*, *“Disa prirje zhvillimi”*. Tre nga artikujt përfshijnë shembuj rasti dhe gabime të vërejtura që autori i shënon, pa i sistematizuar. Që të nëntë artikujt përfshijnë brenda përgjithësime.

- Njëzet e pesë artikuj nuk paraqesin kanë fare hulumtim. Në mesin e tyre janë nëntë artikujt që nuk e kanë tezën të deklaruar dhe artikujt të tjerë që argumentojnë në mënyrë subjektive ose bëjnë shqyrtim literature për të nxjerrë përfundimet e tyre. Pesë artikuj kanë edhe gabime faktike.

- Njëzet e nëntë artikuj përfshijnë argumentime subjektive të propozimeve të tyre, qoftë në nivelin global (si temë), qoftë në nivelin lokal, si mikropropozim. Kjo shifër përfshin vetëm argumentimin, jo edhe përdorime të tjera të përfaqësimit subjektiv të tekstit. Që të gjitha këto këtë përfaqësim e shprehin nëpërmjet përdorimit të vetës së parë.

- Njëzet e katër nga punimet përfshijnë argumentim të mbështetur mbi një lexim literature, por pa lexim kritik, duke i trajtuar si të vërteta a

priori të thënat e atyre autorëve: *siç thotë Kadare, me të drejtë e quan dr. Shykrane Gërmizaj, siç thotë gjuhëtari P. S. Ray...* Në këtë grup përfshihen edhe punime, të cilat argumentimin e shfaqin mbi mendime të autorëve të ndryshëm, por sërish pa lexim kritik dhe me përzgjedhje të një mendimi, sipas idesë që mbështetet. Po ashtu, përfshihen edhe mbështetje në nocione (të vërteta a të pavërteta) të ndryshme përgjithësuese për ta argumentuar propozimin (*Në disa shtete perëndimore gjuha e normuar letrare mbrohet me dispozita ligjore; Kështu kanë vepruar edhe popuj të tjerë; Sic është bërënë të gjitha shtetet evropiane*). Në këto fjali nuk jepet dokumentacioni mbështetës për të argumentuar propozimet.

- Dymbëdhjetë nga punimet kanë fjali përgjithësuese dhe hipotetike (*Rëndësia e studiuesve të huaj për ta studiuar gjuhën shqipe para dhe pas normëzimit të saj ishte dhe është mjaft e rëndësishme; Libri ka përbërje interesante; kombi shqiptar shfaq...* *Shqipja standard sot vazhdon të jetë një nga çështjet e shqetësimeve, të nxitur nga motive që mund të jenë tepër të ndryshme...*).

- Pesëmbëdhjetë nga punimet kanë udhëzime, nëpërmjet fjalive të kërkimit të veprimit (*Hartuesi duhet të ketë përgatitje bashkëkohore; Për menjanimin e ndërtimeve të tilla duhet punuar vendosmërisht; Një rishikim jo vetëm se ka nevojë, por na duhet të nxitojmë...*).

- Njëzet e nëntë nga artikujt argumentojnë duke përdorur fjali që shprehin cilësi dhe attribute, kundruall fjalive që shprehin gjendje a veprim (*Është një anonimus analfabet; Gjuha shqipe është e ngarkuar me fjalë të huaja; Gjuha është e inventarizuar*).

- Tridhjetë e katër nga artikujt kanë përdorim të mbiemrave që shprehin qëndrim. Për ta përcaktuar shkallën e përdorimit të mbiemrave cilësorë, është bërë krahasimi me numrin e mbiemrave që shprehin qëndrim në një numër gazete (RUGOVA 2009: 200). Sipas atyre të dhënave, një numër gazete në pjesën informative të saj përfshin mbiemra 3,8 për qind të numrit të përgjithshëm të fjalëve, ndërsa 21 për qind e atyre mbiemrave të përdorur janë mbiemra që shprehin qëndrim. Kjo nënkupton se afër 0,7 për qind e fjalëve të përgjithshme përbëjnë mbiemra që shprehin qëndrim. Këta 34 artikuj për shqipen standard kanë në shkallë të ndryshme përqindje më të lartë se kjo të përdorimit të mbiemrave që shprehin qëndrim: *shtëpia jonë e bukur, fjala e bukur shqipe, gamë tepër e gjerë, kjo arritje e madhe, roli frymëzues i gjuhës, gjendje e vështirë...*

Përfundimet:

- Të dhënat e nxjerra që tregojnë se 9 nga 59 artikujt e hulumtuar nuk kanë temë të deklaruar, 25 nuk përfshijnë hulumtim empirik dhe 24 të tjera mbështesin argumentimin e tyre në literaturë pa realizuar lexim kritik, se 12 përfshijnë përgjithësime dhe se 29 nga 59 artikujt përfshijnë argumentime subjektive tregojnë për prirjen që diskutimet për standardin e shqipes të realizohen me gjuhë joshkencore.

- Të dhënat që tregojnë se 29 nga 59 artikujt përfshijnë argumentime subjektive, se 15 nga artikujt përfshijnë propozime udhëzuese të përdorimit të gjuhës, se 34 nga artikujt përfshijnë mbiemra që shprehin qëndrim dhe 29 përfshijnë argumentime nëpërmjet përdorimit të fjalive të cilësimit dhe të atribuimit, tregojnë prirjen që diskutimet për standardin e shqipes të kenë ngjyrime subjektive.

- Prirja për përdorim të gjuhës joshkencore dhe për subjektivizëm bën që diskutimet për shqipen standarde të marrin ngjyrim të ideologjisë dhe të besimit.

Bibliografi:

- BROWN & YULE 1983, Gillian dhe George. *Discourse Analysis*, Cambridge University Press, Cambridge
- HALLIDAY 2004, Michael. *The Language of Science*, Continuum, New York
- JOHNSTONE 2008, Barbara. *Discourse Analysis*, Blackwell, Oxford
- PIGLIUCCI 2010, Massimo. *Nonsense on Stilts, How to tell Science from Bulk*, University of Chicago Press, Chicago
- PLATO, *Theaetetus* (përkth. B. Jowett), www.gutenberg.org/files/1726/1726-h.html#2H-4-0002
- POPPER 1997 Karl. "Science: Problems, Aims, Responsibilities", te *The Myth of the framework: in defence of science and rationality*, Routledge, New York
- POPPER 2005, Karl. *The Logic of Scientific Discovery*, Routledge, London & New York
- RUGOVA 2009, Bardh. *Gjuha e gazetave*, KOHA, Prishtinë
- VAN DIJK 1988, Teun. *News as Discourse*, Lawrence Erlbaum Associates, Hillsdale
- WEIYUN HE 2003, Agnes. "Discourse Analysis" te *The Handbook of Linguistics* red. Mark ARONOFF dhe Janie REES-MILLER, Blackwell, Oxford
- WERLICH 1983, Egon. *A Text Grammar of English*, Quelle & Meyer, Heidelberg

Bardh RUGOVA, Prishtinë

LANGUAGE OF PAPERS ON STANDARD ALBANIAN

Summary

The aim of this study is to observe the range of scientific neutrality in papers dealing with the Albanian standard language, presented in journals, symposia, seminars and conferences in Kosovo, Albania and Macedonia during the last two decades. The paper examines the discourse of these papers, in an effort to distinguish the insertions of the beliefs and ideology in academic circles' discussions on the issue of standard Albanian. The standard Albanian is one of the most discussed topics in linguistics conferences in Kosovo, Albania as well as among Albanian academic institutions in Macedonia. During the last 16 months alone, several scientific conferences have been organized, with the standard Albanian or its potential problems being the central main topic of discussion. The debate on the standard Albanian has also been reflected in the media.

This study uses sample cases from 59 articles published in research journals, papers issued from conferences, seminars and symposia. Although the choice of sample is random, it was designed in such a way to include only one paper from an author. Therefore, the sample is composed of 59 items of 59 different authors, among them three being non-Albanian authors.

Research notes in the sample papers that have no thesis statement, papers that don't support their conclusions with argumentation, papers that include generalizing conclusions and linguistic elements that represent the subjective representation of text in different levels. Research based on the text grammar, shows the tendency of authors to express personal views during the drafting of items and/or replacing scientific language with subjective features, which makes the standard Albanian discussions take dimension of ideology and faith.

Lindita TAHIRI, Universiteti i Prishtinës

KONSTRUKTIMI I IDENTITETIT TË KOSOVËS NË MEDIAT NDËRKOMBËTARE

KDU 323.1(496.51):659

Abstrakt

Ky punim synon krahasimin e prezantimit të Kosovës në tri media të mëdha ndërkombëtare: “The Washington post”, “The New York Times” dhe “The Guardian” gjatë periudhës 2008-2011, përmes katër llojeve të kornizave: asaj tematike, të burimeve, përjasjeve dhe raporteve të fjalëve me përdorim më të shpeshtë. Analiza krahasuese e këtyre mediave të rëndësishme jo vetëm në botën anglishtfolëse, ka për qëllim të nxjerrë në pah tiparet gjuhësore të rrëfimit gazetaresk ndërkombëtar për Kosovën në periudhën disavjeçare para dhe pas shpalljes të pavarësisë. Studimi synon të zbërthejë mënyrën se si konstruktohet identiteti i ri i Kosovës për audiencën ndërkombëtare dhe brenda çfarë kornizash vendosen informatat për Kosovën, duke e tërhequr kështu vëmendjen kah praktikat dhe perspektivat e caktuara politike në SHBA dhe Britaninë e Madhe.

Hyrje

Pas deklaratës të pavarësisë të Kosovës në 17 shkurt 2008 në Parlamentin e Kosovës, Serbia e kontestoi këtë deklaratë dhe në fund të po atij viti u kërkua mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e këtij veprimi. Pas 17 muajsh Gjykata e shpalli deklaratën të ligjshme, dhe ndërkaq SHBA dhe shumica e vendeve të BE-së tanimë e kishin njohur shtetin e ri të Kosovës. Këto lajme kanë arritur ta tërheqin vëmendjen e medieve më të mëdha ndërkombëtare të cilat analizohen në këtë studim.

Studimi e krahason prezantimin e Kosovës në periudhën 2008 -2011, në tri media të mëdha ndërkombëtare: “The Washington post” (WP), “The New York Times” (NYT) dhe “The Guardian” (G). Kriteret e përzgjedhjes të këtyre gazetave janë ndikimi, tirazhi, dhe reputacioni: WP e ka tirazhin rreth 700 000 kopje ndërsa NYT rreth 1 milion, dhe që të dyja këto të përditshme

konsiderohen me shumë ndikim sidomos nga pikepamja e prezantimit të lajmeve ndërkombëtare. G arrin pothuaj 37 milion lexues në muaj (BBC 2010) duke u radhitur kështu në gazetat më të lexuara në ueb në gjuhën angleze, krahas NYT.

Janë analizuar gazetat nga 1 janari 2008 deri në fund të marsit të vitit 2011, duke e përfshirë periudhën e shpalljes të pavarësisë të Kosovës dhe shpalljen e vendimit të GJND-së. Shkrimet janë identifikuar përmes LexisNexis me fjalën çelës 'Kosovo', që rezultoi në gjithsej 251 artikuj në G, 146 në NYT, dhe 107 në WP. Pas leximit më të kujdesshëm u pa se këta artikuj nuk ishin të gjithë të rëndësishëm për studim, dhe u përdor kërkesa e përzgjedhur e LexisNexis me të paktën 5 përsëritje të fjalës çelës. Nga ky kërkim dolën gjithsej 67 shkrime në G, 45 shkrime në NYT, dhe 35 shkrime në WP që u analizuan pasi u pastruan nga të dhënat shtesë.

Metodologjia

Këto tri të përditshme ndërkombëtare janë analizuar për mënyrën se si i kanë përzgjedhur temat, si i kanë shfrytëzuar burimet, si i kanë prezantuar pikëpamjet e burimeve, si janë përqendruar në tituj dhe mestituj, pra janë analizuar nga këndvështrimi i kornizave të përgjithshme përmes të cilave i është përshfaqur realiteti audiencës. Studiuesit e medieve u kanë kushtuar vëmendje të veçantë kornizave të rrëfimeve gazetareske, të cilat ndikojnë në konstruktimin e interpretimeve të ndryshme tek lexuesit (BIOCCA, 1991; ENTMAN, 1993; GAMSON, 1992; PRICE, TEWKSBURY & Powers, 1996; RHEE, 1997; VAN DIJK, 1988, 1993, 1998). Një nga autorët që është marrë me efektet e kornizimit mediatic, Shanto Iyengar pohon se pikëpamjet tona për çështjet si terrorizmi ose varfëria kryesisht varen nga mënyra se si i ndërlidhim ato me prezantimet e mediave (2010). Për më shumë, në intervistën e dhënë Institutit të kornizimit (2009), Iyengar thotë se efektet e kornizimit e bëjnë të njëjtin ndikim si tek lexuesit e informuar ashtu edhe tek ata të painformuarit për çështje politike.

Pyetjet që shtrohen në këtë studim janë si vijon:

Pyetja hulumtuese 1: Si dallojnë këto tri gazeta në përzgjedhjen e temave?

Pyetja hulumtuese 2: Si dallojnë këto tri gazeta në përzgjedhjen e burimeve?

Pyetja hulumtuese 3: Si dallojnë këto tri gazeta në përzgjedhjen e pikëpamjeve të burimeve?

Pyetja hulumtuese 4: Si dallojnë këto tri gazeta në raportet mes fjalëve me denduri më të madhe?

Për t'iu përgjigjur pyetjes së parë janë përdorur këto kategori kodimi, të nxjerra nga temat më të pranishme në të tri mediat: imazhi perëndimor i Kosovës, imazhi mysliman i Kosovës, imazhi perëndimor i Serbisë, imazhi agresor i Serbisë, pakica serbe, përpjekjet diplomatike, UÇK-ja e portretizuar si organizatë kriminale, fushata e NATO-s kundër Serbisë si veprim legjitim, fushata e NATO-s kundër Serbisë si gabim, situata ekonomike, procesi zgjedhor, kultura.

Pyetja e dytë përqendrohet në burimet dhe citimet kryesore, të përshkruara përmes këtyre kategorive koduese: gazetarët në teren agjencitë, zyrtarët amerikanë, zyrtarët europianë, zyrtarët kosovarë, zyrtarët serbë, zyrtarët rusë.

Pyetja e tretë i nxjerr në pah pikëpamjet e burimeve, përmes tri kategorish kodimi: neutrale, të favorshme, dhe të pafavorshme..

Pyetja e katërt i shqyrton raportet mes fjalëve me denduri më të madhe në tekstet e të tri gazetave, duke u përqendruar në konstruktet bashkërenditëse, në ato të rasës gjinore, dhe në modalitetin e foljeve që i shoqërojnë emrat me denduri më të madhe. Jemi përcaktuar për këto tre lloje raportesh gramatikore për shkak të efekteve semantike dhe pragmatike që i nxisin ato: strukturat e bashkërenditura sugjerojnë njëjtësi, paralelizëm, ngjashmëri, unitet, rasa gjinore sugjeron raporte të ndryshme mes pronarit dhe pronës, si për shembull pronësinë, autorësinë, raportin mes pjesës dhe tërësisë, apo dominimin. Ndërkaq, modaliteti është shprehje gramatike e përqasjes subjektive të folësit, që nënkupton mundësinë, domosdoshmërinë, obligimin, lejen, dëshirën.

Rezultatet e analizës

Nga korpusi prej gjithsej 147 shkrimeve apo 90 645 fjalëve 45 për qind prej tyre i takojnë G, 34 për qind NYT, dhe 21 për qind W. P. Llojet e këtyre shkrimeve gazetareske paraqiten në tabelën e mposhtme:

Tabela 1. Llojet e shkrimeve në tri gazetat

	Sasia e fjalëve	Mesatarja e fjalëve në shkrim	Editoriale	Artikuj	Lajme
NYT	31942 (34%)	726	7 (16%)	38 (84%)	0
WP	18014 (21%)	514	5 (14%)	23 (66%)	7 (20%)
G	40689 (45%)	607	19(28%)	46 (69%)	2 (3%)

Këto tri gazeta dallojnë në përzgjedhjen e temave. Në tabelën 2 shihet se tek NYT (40%) dhe G (38%) më shumë hapësirë zë tema e përpjekjeve diplomatike, ndërkaq WP i ofron hapësirën kryesore pakicës serbe në Kosovë (39%). Një nga dallimet kryesore të NYT nga dy gazetat e tjera është shquarja e temës të legjitimitetit të fushatës së NATO-s kundër Serbisë (35%) dhe imazhi i Serbisë si agresor (24%). WP dallon nga gazetat e tjera me përfaqshjen ndaj Kosovës si vend mysliman (15%). NYT dhe WP i japin më shumë hapësirë imazhit perëndimor të Kosovës (7%) dhe Serbisë (6%) krahasuar me G (1.5%).

Tabela 2. Krahasimi i mbulimit të temave

	NYT	WP	G
Imazhi perëndimor i Kosovës	3 (7%)	2 (6%)	1(1.5%)
Imazhi mysliman i Kosovës	1(2.5%)	5 (15%)	1(1.5%)
Imazhi perëndimor i Serbisë	3 (7%)	2 (6%)	1(1.5%)
Imazhi agresor i Serbisë	10 (24%)	7 (19%)	5(8%)
Pakica serbe	10 (24%)	14 (39%)	11(16%)
Përpjekjet diplomatike	17 (40%)	10 (30%)	25 (38%)
Krimet e UÇK	7(17%)	4(12%)	11(16%)
Fushata NATO-s kundër Serbisë si legjitime	15 (35%)	2 (6%)	4(6%)
Fushata NATO-s kundër Serbisë si e gabuar		3 (9%)	6(9%)
Situata ekonomik	1 (2.5%)	1 (3%)	1(1.5%)
	1 (2.5%)	1 (3%)	3(4.5%)
Kultura			3(4.5%)

Tabela 3 tregon dallimin e gazetave në shfrytëzimin e burimeve: NYT përdor më së tepërmi të dhëna nga gazetarët në terren (38%), ndërsa WP citon më së tepërmi zyrtarë serbë, dhe NYT citon më së tepërmi zyrtarë europianë (31%), pastaj zyrtarë serb (27%) dhe kosovarë (25%).

Tabela 3. Krahasimi i burimeve

	Gazetarët në terren	Agjencitë	Zyrtarët amerikanë	Zyrtarët europianë	Zyrtarët kosovarë	Zyrtarët rusë	Zyrtarët serbë
NYT	17(38%)	6 (13%)	9(20%)	14(31%)	11(25%)	3(6%)	12(27%)
WP	8(21%)	7(20%)	7(20%)	8(21%)	5(14%)	1(3%)	11(29%)
G	21(30%)	0	7(10%)	10(15%)	7(10%)	1(1.5%)	6(9%)

Tabela 4 e tregon skemën e qëndrimeve ndaj Kosovës, që dallon në të tre mediumet. NYT ka kryesisht qëndrim neutral me 76% ashtu si edhe WP me 69% . Ndërkaq qëndrimi i G është kryesisht i palavorshëm me 46 %, dhe pastaj neutral me 36 % . NYT është gazeta e fundit sipas qëndrimit të pafavorshëm dhe WP është e fundit sipas qëndrimit të favorshëm.

Tabela 4. Krahasimi i qëndrimeve të burimeve

	I favorshëm	neutral	I pafavorshëm
NYT	8(18%)	34(76%)	3(6%)
WP	4(12%)	25(69%)	6(19%)
G	12 (18%)	24 (36%)	31(46%)

Tabelat 5 i kanë shfrytëzuar vizualizimet nga Phrase Net dhe Word Tree (Programi IBM Many Eyes) për t'i identifikuar 50 fjalët më të shpeshta në tekst dhe raportet mes tyre. Disa nga emrat e shteteve relevante në këtë studim janë analizuar si pjesë e konstrukteve të bashkërenditura dhe e atyre gjinore. Po ashtu ato janë analizuar për nga modaliteti i foljeve që i shoqërojnë këto emra.

Tabela 5a tregon se emrat e shteteve të cilat më shpesh janë pjesë e konstrukteve bashkërenditëse me lidhëzën “dhe” në NYT janë Serbia (26) dhe Kosova (21), me kombinim reciprok të barabartë(6). Raporti tjetër më i shpeshtë është mes Ruisë (15) dhe Serbisë (11), dhe pasojnë konstruktet bashkërenditëse mes Washingtonit dhe Brukselit, Washingtonit dhe BE-së, si dhe BE-së dhe NATO-s. Një nga shtetet që përmenden më së pakti është Shqipëria (3), përkundër rolit që e ka duke e pasur popullatën e vet në Kosovë, dhe madje rasti i vetëm kur përmendet në këtë bashkërenditje është kur të dyja shtetet ndërlidhen me krimin e organizuar.

Emri i shtetit që më së tepërmi shfaqet në rasën gjinore është Kosova (177) sidomos i shoqëruar me “Pavarësinë” (49) Emri tjetër i përdorur më shpesh në këtë rasë është Serbia (72), në raport me President/ Ministër i jashtëm/kapital/ president pro-perëndimor (21).

Katër emra janë analizuar në raport me modalitetin e foljeve që i shoqërojnë, ndërkaq emri Kosova po ashtu është analizuar nga aspekti i shoqërimit me frazën e deklaramit të pavarësisë, duke e pasur parasysh se kjo ka qenë ndodhia kryesore në periudhën kur është analizuar korpusi. Në tabelën 5a del se Kosova është kryefjalë e “deklarimit të pavarësisë” 13 herë, dhe modaliteti më i shpeshtë që e shoqëron këtë emër është ai i qëllimit të planifikuar, i vendimit dhe premtimit, që i nënkuptojnë pjesëzat e

kohës së ardhshme “do të” dhe ai i lejimit, i preferencës, i ftesës, i rekomandimit, që e nënkupton folja “duhet”. I ngjashëm është edhe roli i emrit të Serbisë në këtë mostër.

Tabela 5a. Fjalët me denduri përdorimi në NYT dhe raportet mes tyre

Denduria e fjalëve	Konstruktet bashkërenditëse	Denduria e fjalëve	Rasa gjinore	Emrat me denduri të theksuar	Foljet shoqëruese të emrave
Serbia (26) Kosova (21) Shqipëria(3)	Kosova dhe Serbia (6) Serbia dhe Kosova (6) (krimi) në Kosovë dhe Shqipëri	Kosova (177) Pavarësia (49)	Pavarësia e Kosovës (46) deklarata/ autonomia/ popullata e Kosovës (46)	Kosova (504: 1.6%)	Deklaroi pavarësinë (13) Do të (8) Do të duhej të (8) Mund (3) Do të mundej (1)
Rusia (15) Serbia (11)	Serbia dhe Rusia (6) Rusia dhe Serbia (5)	Serbia (72)	Presidenti/Ministri i jashtëm/ Kapitali? E ardhmja?president i pro-perëndimor i Serbisë (21) Represioni i dhunshëm i Serbisë (1)	Serbia (272: 0.9%)	Do të duhej (10) Do të(8) Duhet (5) Mund (3)
BE (11) NATO (7) Washingtoni (6) Brukseli (4)	Washingtoni dhe Brukseli (3) BE dhe Washingtoni (2) BE dhe NATO (2)	Miloshiq (18)	Reagimi i dhunshëm i Millosheviqit (2)	Washingtoni (17: 0.05 %)	Përkrah Kosovën Një Kosovën Akuzon politikanët nacionalistë
				Brukseli (13: 0.04%)	Mundet/duket

Tabela 5b tregon se në WP emrat më të shpeshtë të shteteve janë Kosova (11) dhe Serbia (7), por me lidhëzën “dhe” Serbia gjithmonë është pjesa e parë e strukturës bashkërenditëse. Raportet më të shpeshta të bashkërenditjes janë mes Rusisë (7) dhe Serbisë (6), ndërsa Shqipëria dhe Kosova përmenden rrallë dhe ndërlidhen me mungesën e rendit dhe ligjit.

Emri i shtetit që më së tepërmi përdoret në rasën gjinore është (95) i bashkëlidhur me “pavarësinë” (27) dhe pas tij vjen Serbia (28), ndërlidhur

me Kryeministrin/ Ministrin e Kosovës/qeverinë/ liderët . Kosova është 7 herë kryefjalë e “deklarimit të pavarësisë”, dhe shoqërohet me modalitetin e qëllimeve të ardhshme dhe shprehive, ndërkaq Serbia shoqërohet me modalitetin e rekomandimit, këshillës, doemosdoshmërisë.

Tabela 5b. Fjalët me denduri përdorimi në WP dhe raportet mes tyre

Denduria e fjalëve	Konstruktet bashkërenditëse	Denduria e fjalëve	Rasa gjinore	Emrat me denduri të theksuar	Foljet shoqëruese të emrave
Kosova (11) Serbia (7) Shqipëria (4) Bosnja (3)	Serbia dhe Kosova (1) (shkelja e ligjit) Kosova dhe Shqipëria (2) Kosova dhe Bosnja (3)	Kosova (95) Independence (27)	Pavarësia e Kosovës (26) Shkëputja e /vendimi/shumica /autonomia/ legjitimiteti i Kosovës (18)	Kosova (292: 1.6%)	Deklaroi pavarësinë (7) Do të (2) Duhet (3) Mund (1)
Rusia (7) Serbia (6)	Serbia dhe Rusia (1) Rusia dhe Serbia (4)	Serbia (28)	Kryeministri/ Ministri për Kosovë/liderët e Serbisë (6)	Serbia (125: 0.7%)	Duhet (4) Mund (2) Do të (1)
NATO (7) EU (3)	EU dhe NATO (3)	Milloseviq (11)	Serbia/Qeveria/Fushata Brutale e Milloseviqit	Washingtoni (8: 0.04%)	Dinte për kidnapimet/Duhet të kërkojë nga Kosova/Duhet ta sigurojë Serbinë
				Brukseli (0)	

Tabela 5c tregon se G e tërheq vëmendjen kah bashkërenditja e shteteve si Abkhazia dhe Ossetia/ Transnistria, duke e sugjeruar për publikun paralelizmin e rastit të Kosovës me kërkesën për pavarësi nga republikat kaukaziane. Kosova është e bashkëvendësuar me Shqipërinë vetëm kur bëhet fjalë për trafikim të organeve, ndërkaq për dallim nga mediumet e tjera, G e prezanton Rusinë si partner me Përfundimin. Për dallim nga mediumet e tjera, në rasën gjinore emri i Kosovës nuk shoqërohet vetëm me përshkrime gjeografike apo emërtime institucionesh, por e paraqet me nënkuptime negative të ndërlidhura me shkëputjen e njëanshme nga Serbia.

G nuk e përfshin Milloseviqin në 50 fjalët më të shpeshta, dhe ai në rasën gjinore bashkëvendësohet me institucionet administrative, me trupat

ushtarake, me proceset motive, dhe vetëm një herë me “krimet”. Bie në sy dhe fakti se Kosova nuk është asnjëherë kryefjalë e “deklarimit të pavarësisë”, dhe se Brukseli është kryefjalë i foljeve të veprimit për dallim nga Washingtoni.

Tabela 5c. Fjalët me denduri përdorimi në G dhe raportet mes tyre

Denduria e fjalëve	Konstruktet bashkërenditëse	Denduria e fjalëve	Rasa gjinore	Emrat me denduri të theksuar	Foljet shoqëruese të emrave
Kosova (38) Serbia (21) Shqipëria (4)	Kosova dhe Serbia (5) Serbia dhe Kosova (2) (Trafikimi i organeve) Kosova e Shqipëria (2)	Kosova (146) Pavarësia (25) Deklarata (18)	Pavarësia e Kosovës (37) Shkëputja/njëanshmëria/veriu i Kosovës (21)	Kosova (554: 1.4 %)	Do të (9) Duhet (9) Mund (2)
Rusia (18) Serbia (21)	Serbia dhe Rusia (5)	Serbia (39)	Presidenti/Kryeministri i Serbisë (10)	Serbia (181: 0.5 %)	Do të (8) Duhet (1) Mund (1)
Rusia (18) Perëndimi (3) EU (6) NATO (4)	Perëndimi dhe Rusia (1) EU dhe NATO (2)	Milosheviqi nuk hyn në 50 fjalët me denduri më të madhe	Jugosllavia/forcat jugosllave/forcat serbe /ushtria/shtypja/nënshtrimi /krimet e Millosheviqit	Washingtoni (10: 0.02%)	Njohu Kosovën Duhet të pyesë Këshillin e sigurimit Ka pasur njohuri
Abkhazia (9)	Abkhazia dhe Ossetia/Transnistria (8)	Marti (9)	porti i Martit	Brukseli (25: 0.06%)	Duhet të udhëheqë Gjeti zgjidhje E mori rolin Do të urdhërojë Është i kënaqur

Përfundim

Ky studim sugjeron se këto tre medime nuk e ofrojnë imazhin e njëjtë të realitetit për lexuesin, dhe ndryshimet në tre të përditshmet mund të reflektojnë synimet më të përgjithshme strategjike të ndërlidhura me diskursin politik për Kosovën. Analiza komparative e këtyre gazetave demonstroi se

New York Times gjatë periudhës që e mbulon ky studim ka dëshmuar profesionalizëm dhe paanësi, përderisa Guardian shfaq tendencën për paraqitje të pabalancuar të lajmeve nga Kosova. Washington Post-i shfaqet me dy përjasje kundërthënëse: e legjitimon deklarin e pavarësisë duke e shpjeguar konfliktin e dhunshëm dhe duke ofruar njohuri paraprake për historinë e Kosovës, mirëpo në rastin e akuzës për trafikimin e organeve e paraqet një imazh të krimit të organizuar dhe madje të institucionalizuar.

Pyetja se a është ky portretizim i Kosovës një fenomen i gazetarisë së sotme që gjithnjë e më shumë po synon ta argëtojë me çdo kusht publikun, apo është tregues i diskursit politik për Kosovën nga qarqet e caktuara të interesit, i tejkalon synimet e këtij studimi.

Referencat

- BIOCCA, Frank. 1991. *Television and political advertising: Vol.2. Signs, codes and images*. Hillsdale, Nj: Lawrence Erlbaum.
- ENTMAN, Robert. M. 1993. Framing: Towards clarification of a fractured paradigm. *Journal of Communication*, 43(4), 51-58.
- FAIRCLOUGH, Norman. 2003. *Analyzing Discourse*. London: Routledge.
- FAIRCLOUGH, Norman. 1995. *Media discourse*. London: Edward Arnold.
- <http://www.frameworksinstitute.org/> viewed 5 May 2012
- GAMSON, William. A. 1992. *Talking politics*. UK: Cambridge University Press
- IYENGAR, Shanto. 2010. *News That Matters: Television and American Opinion*. University of Chicago Press.
- LAKOFF, George and Turner, Mark. 1989. *More than Cool Reason*. Chicago: University of Chicago Press.
- LAKOFF, George. 1987. *Women, Fire, and Dangerous Things: What Categories Reveal about the Mind*. Chicago: University of Chicago Press.
- PRICE, Tewksbury, & Powers. 1996. *Switching trains of thought: The impact of news frames on reader's cognitive responses*. Annual meeting of the International Communication Association Conference, Chicago.
- RHEE, June Woong. 1997. *Strategy and issue frames in election campaign coverage: A social cognitive account of framing effects*. *Journal of Communication*, 47(3), 26-48.
- RAID, David and Teixeira Tania, 2010. *Are people ready to pay for online news?* BBC news at http://news.bbc.co.uk/2/hi/programmes/click_online/8537519.stm viewed 7 May 2012
- VAN DIJK, Teun A.. 1998. Opinions and Ideologies in the Press, in *Approaches to Media Discourse*, ed. Ballan Bell and Peter Garrett. Oxford: Blackwell Publishers.
- VAN DIJK, Teun A.. 1988. *News as Discourse*. Hillsdale, NJ: Erlbaum.
- VAN DIJK, Teun A.. 1988. *News Analysis. Case studies of international and national news in the press*. Hillsdale, NJ: Erlbaum.
- VAN DIJK, Teun A.. 1993. *Elite discourse and racism*. Newbury Park, CA: Sage
- VAN DIJK, Teun A.. 2008. *Discourse and Context: A Sociocognitive Approach*. Cambridge University press.
- WODAK, Ruth. 2011. *The Discourse of Politics in Action*. Palgrave Macmillian.

Lindita TAHIRI, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë

BUILDING OF KOSOVA'S IDENTITY IN INTERNATIONAL MEDIA

Summary

This study suggests that the three media outlets observed do not provide the same image of reality to the reader while the differences between three dailies can reflect more general strategic aims connected to political discourse on Kosova. The comparative analysis of these newspapers demonstrates that *The New York Times*, during the period covered by this study has shown professionalism and impartiality, while *The Guardian* tends to offer unbalanced presentation of the news on Kosova. *The Washington Post* has two contradictory approaches: it legitimizes declaration of independence by explaining the violent conflict and provision of preliminary information on the history of Kosova, but on the case of allegation on trafficking in human organs it tends to create a picture of organized, even institutionalized, crime.

The question whether this way of depicting Kosova is a phenomenon of actual journalism seeks to entertain the public by all means or if this is an indicator of political discourse on Kosova of certain interest groups, goes beyond the objective of this study.

Shaban SINANI, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

TEKSTI BIBLIK NË VEPRËN E MIGJENIT

KDU 821.18.09

Abstrakt

Në studimet tradicionale letërsia e Migjenit është trajtuar si letërsi ateiste. Por në një vështrim tekstocentrist, provohet se kjo letërsi është e kushtëzuar thuajse në të gjitha nivelet prej tekstit biblik-ungjillor. Kushtëzimi është në shkallën strukturore, mitologjike dhe kultologjike, në prozodi e metrikë, në tipologjinë e figurës, në nivelin e shembëlltyrës, motivit, tematologjisë, në leksik e idiomatikë, në të gjitha shkallët e ndërtekstorësisë. Mund të vërtetohet se prania e tekstit biblik në veprën e Migjenit nuk është thjesht një çështje kulture dhe formimi. Ai që është quajtur “ateizëm i Migjenit” në të vërtetë është i njëjti qëndrim iluminist që shprehej në ideologjinë klasike gjermane (Nietzsche, Schopenhauer) për “vdekjen e Zotit klasik”. Kjo nuk do të thotë se Migjeni, si filozofët gjermanë, duke qenë kundër një Zoti të ngulitur në trurin e njerëzisë dymijë vjet më parë, ishte kundër besimit, kundër çdo besimi. Poezia dhe proza e Migjenit jo vetëm që nuk kanë refuzim të fjalës, termit, idiomës, figurës, shembëlltyrës, strukturës, frymës, tipologjisë së mendimit, që vijnë nga Shkrimet, por janë tërësisht të sunduara prej tyre. Dhe kjo parapëlqesë formale e poetit shprehet në figurshmërinë e letërsisë së tij.

Fjalë çelësa: Realizmi kritik, realizmi social, realizmi socialist, romantizmi revolucionar, simbolizmi, surrelizmi, brezi i humbur, ateizmi, interteksti biblik, struktura, miti i Mesisë, mitet e krishtera, Zoti klasik, Mbinjeriu, besimi i ri, shembëlltyra, sinoptikanizmi, tipologjia e figurës.

I.

Tre çerek shekulli prej kohës së botimit, poezia dhe prozat e Migjenit ia kanë dalë të dëshmojnë se provat e studiuesve për t’i kushtëzuar me një epokë, me një poetikë e problematikë, kanë qenë dështim i paralajmëruar. “*Poeti i modernitetit*”, “*zëdhënës i protestës dhe rebelimit*”, “*denoncuesi i varfërisë dhe i mjerimit*”, “*frymëzues i revolucionit, i kritikizimit dhe i antikonformizmit*”, “*demaskuesi i fesë, klerit dhe i monarkisë*”³²: të

³² “Kësisojt Migjeni shpallet herë realist, herë krijues militant; herë gjysmë realist - gjysmë romantik revolucionar; këtu simbolist, atje surealist; këtu kështu, atje ashtu”. Shih M. RAIFI, *Madhështia si antitraumë*, në MIGJENI: *Vepra*, 4, Rilindja, 1980, f. 221-222.

gjitha këto nuk janë gjë tjetër veçse paracaktime e përcaktime të përkohshme studiuesish, që synojnë apo pa dashur bëjnë kundërvënien ose aktualizimin e letërsisë³³.

Vepra e Migjenit risinë më të madhe ia solli letërsisë shqipe duke dalë jashtë disiplinës së dy rrjedhave më të kodifikuara të letërsisë së qytetit të veriut, “*rrymbës*” françeskane dhe asaj jezuite. E. Koliqi, që i pati përkufizuar qartë këto shkolla³⁴, megjithëse Migjenin e njihte herët dhe kishte shkruar për të qysh në vitin 1935, duke e cilësuar një poet premtues, pati gjetur një vend të ndërmjetëm për veten dhe një lidhje deri-diku “*të eksteriorizuar*” edhe për Mjedën, të cilin e shihte më të afërt me Skiroin se me autorët e *Lekës*³⁵.

Para se të ishte një “*shkrimtar outsider*” për letërsinë shqipe të kohës³⁶ dhe në pikëpamje të etnicitetit të diskutueshëm sidomos në dy dekadat e funtme, Migjeni ishte një “*outsider*” në lidhje me këto dy shkolla dhe ndaj letërsisë shqipe të kohës përgjithësisht³⁷. Ai ishte, jashtë dyshimit, një shkollë më vete. Dhe, sipas receptimit të parë kritik, ishte një “*shkrimtar i shuguruem*” qysh në moshën 25 vjeç³⁸. Orientimi i tij drejt

³³ Këtu bëjnë pjesë dhe përpjekjet për ta kushtëzuar me miq bolshevikë (Gjovalin Luka, parathënie e *Vargjet e lira*, Tiranë 1954: *Migjeni mbante lidhje me Grupin Komunist të Shkodrës nëpërmes shoqes Afërdita Shahini*). Pas Gj. Lukës, poezia *Një natë pa gjumë* nuk i kushtohet *Corvus-it*, “*trockistit*” Andrea Stefit, por veprimtares komuniste shkodrane me të cilën Migjeni kishte jo vetëm miqësi. Inicialet e dedikimit A. Sh. duhej të kuptoheshin si *Afërdita Shahini*.

³⁴ Ernest KOLIQI, *Dy shkollat letrare shkodrane: e etënve jezuitë dhe e etënve françeskanë*, në: *L’Albanie Libre*, Roma 1961. Ky studim i E. Koliqit u botua në dy numra të *Shëjzave*, nr. 9-10-11-12 e vijim, f. 373-390, me titullin *Dy shkollat letrare shkodrane*.

³⁵ “*Nji zorim qi mund të rrjedhi prej këtij rreshtimi kronologjik është ai i cilësimit të qendrave letrare në vise e rrethe të ndryshme, por kjo kapërcehet lehtëz tue marrë parasysh rrymbat letrare jashta rrjedhjes krahinore të auctorëvevet. Për shembull, Mjedja, për përgatitje e prirje e qëllime artistike është më afër Zef Skirojt se sa Fishtës dhe të tjeret shkrimtarë shkodranë; Koliqi është më afër Lasgush Poradecit se Prennushit e Bernadin Palajt; Shantoja në prozë është shumë më afër Konicës se Anton Harapit*”. Shih: E. KOLIQI, *Dy shkollat letrare shkodrane, Shëjzat*, nr. 9-10-11-12 e vijim, f. 379.

³⁶ “*Rrugës drejt bashkëkohësisë, pra edhe drejt Evropës, do t’i hynin dy poetë të një brezi të ri, dy “outsider”, që u shkëputën nga letërsia tradicionale dhe i dhanë kulturës shqiptare vendin e vet në Evropën bashkëkohëse: mesianiku Migjeni dhe panteisti Lasgush Poradeci*”. Shih Robert ELSIE, *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1997, f. 210.

³⁷ R. ELSIE, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1997, f. 211; Sh. SINANI, *Miti i idesë në vend të kultit të heroit*, në *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20*, Tiranë 2010, f. 88-98.

³⁸ Në ftesën që *Illyria* i bënte *Të ndërtit zotni Millosh Nikollës* më 4 nëntor 1935 për të pasur një bashkëpunim të përdyjavshëm botues mes tyre thuhet se kjo ftesë ruhet

revistës *Bota e re*, më shumë se një afeksion ideologjik për bolshevizmin, duket të ketë qenë një zgjidhje a parapëlqim i Migjenit për të dalë jashtë letërsisë së orientuar të dy shkollave shkodrane dhe tribunave të tyre³⁹. Mendimi se në këtë orientim mund të ketë luajtur rol dhe “*karakteri ishullor*” i pakicës ortodokse në Shkodër vazhdon të jetë dhe sot ngulmues⁴⁰. I pari që pati vërejtur se dy shkollat shkodrane kishin dhe largvajtësit e tyre qe E. Koliqi, i cili, megjithëse Migjenin e njihnte mirë, nuk e “*eksteriorizon*”⁴¹, pavarësisht se këtë e bën dhe për veten e do ta bën-te më vonë edhe për Martin Camajn.

II.

Revolucionar e bolshevik për një pjesë⁴²; përkundrazi, i keqpërdorur nga komunistët si pararendës i realizmit socialist për një pjesë tjetër⁴³; Migjeni erdhi në 100-vjetëshin e lindjes së tij krejt indiferent ndaj përcaktimesh të tilla, të cilat, me sa duket, as që i kishte në mendje kur krijonte.

Kjo indiferencë lidhet me faktin që *Vargjet e lira* të tij janë një tekst i hapur, që u siguron brezave receptimin që munden, pa përllogaritje e paracaktime. Ndoshta i vetmi kushtëzim që mund të shenjohet në këtë ve-

“*vetëm për njata autorë qi mirë o keq e kanë marrë një farë shugurimi nga publiku*”. Shih: E. KOLIQI, *Migjeni dhe unë*, *Shêjzat*, 1-10/1974, f. 83. Me nismën e Koliqit emri i Migjenit u përfshi në të parin botim antologjik të letërsisë shqipe, *Shkrimtarë shqiptarë*, pjesa I, Tiranë 1941, f. 471-475.

³⁹ Identifikimi i Migjenit me revistën *Bota e re* është një shtrembërim historik. Nuk mund të paragjykohe interesimet dhe propozimet e revistës *Illyria* për të pasur bashkëpunim me të, gjithaq sa nuk mund të paragjykohe ankimet e redaksisë së *Botës së re* për vijimin joperiodik të bashkëpunimit nga Migjeni. Këtë çështje besojmë se e ka shtjelluar qartë E. KOLIQI në artikullin *Migjeni dhe unë*, në *Shêjzat*, nr. 1-10/1974, f. 379.

⁴⁰ “*Midis këtyre dy deteve armiqësorë, në qytet jetonte një minoritet i vogël (jo më shumë se njëqind familje) të një feje të tretë: ortodokse. Familja e Migjenit, ndonëse jetonte në pjesën katolike të Shkodrës, i përkiste këtij ishulli*”. Shih: Ismail KADARE, *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, në KADARE - *Vepra*, vëllimi i 19-të, Tiranë 2009, f. 149.

⁴¹ E. KOLIQI në artikullin *Migjeni dhe unë*, në *Shêjzat*, nr. 1-10/1974, f. 379 e vijim.

⁴² Mendime të tilla si ai i Andrea VARFIT, se me poezitë *Të lindet njeriu dhe Trajatat e mbinjeriut* Migjeni “*në thelb i këndon udhëheqjes, partisë komuniste që do të lindte*”; ose se “*mbinjeriu i Migjenit asht jo individ, por një fuqi kolektive shoqënore - fuqia e proletariatit*” (R. QOSJA), janë tejkalime të qarta të kumtit që ofron vetë teksti letrar, janë projekte ideologjike të autorëve. Shih për më shumë: A. ALIU, *Rreth kritikës mbi veprën e Migjenit*, në *Migjeni - Vepra*, v. 4, *Rilindja*, Prishtinë 1980, f. 9-11.

⁴³ Duke perifrazuuar vargjet e *Internacionales*, R. QOSJA shprehet se Migjeni “*kërkon përmbysjen e botës së vjetër për të lindë në gërmadhat e saj Jeta e Re: fjalët Kohë e Re, Epokë e Re, Jetë e Re, Migjeni i shkruen me gërmë të madhe*”. R. QOSJA: *Millosh Gjergj Nikolla - Migjeni (1911-1938)*, në *MIGJENI - Vepra*, v. 4, *Rilindja*, 1980, f. 132.

për është ai me librin më të kodifikuar të kohërave dhe njëherësh me tekstin më gjinikues në histori, njohur me emrin “kodi i kodeve” (*The Great Code*), teksti biblik: *Bibla dhe Ungjijtë*⁴⁴.

I diplomuar për teologji me tezën *Dy natyrat e Krishtit*, qysh në vitet e seminarit Migjeni do të shkruante gjithashtu prozën *Dy Milloshët*⁴⁵. Gjerdhja e përfytyrimit në të dyja prozat është e njëjta: natyra hyjnore dhe tokësore e Hyjit; natyra tokësore dhe hyjnore e njeriut si krijesë/kreatyrë dhe shembëlltë e Krijuesit⁴⁶. Të dy tekstet, i provimit të teologjisë dhe ai laik, duket sikur bashkohen në titullin e meshës së shugurimit të dytë të F. Nolit peshkop *Mbaje kryqin!*. Dallimi midis Mesisë së Nolit dhe Mesisë së Migjenit është se i pari e kërkon Shpëtimtarin dhe misionarin tek vetja, kurse i dyti, përkundrazi, kërkon një Mesi të papërcaktuar, herë në formën e Mbinjeriut, herë në formën e njeriut që nuk i nënshtrohet fatit të shekullit, por pa e menduar kurrë veten të tillë: ai vetë ishte heroi i dobësisë dhe i dhimbjes, i anës tjetër të Mesisë⁴⁷. Tek Migjeni Mesia ka më shumë pamjen e *Shelbuesit*, është “hyji në salvime”⁴⁸, kurse tek Noli, si në ciklin biblik të *Albumit*, ashtu dhe në *Autobiografinë* e vet, Mesia (pas Gjergj Kastriotit dhe Napoleonit), është vetvetja⁴⁹. Mesia i Migjenit është në kryqëzim, ai shfaqet si Krishti në kryq në ankim ndaj Perëndisë-At: “*Elohim, Elohim, pse po më braktis?!?*”⁵⁰.

Dy opozicionet më të qortueshme që janë krijuar më së shpeshti për botëkuptimin e Migjenit janë ato me serbishten dhe me besimin. Për serbishten sigurisht ka ndikuar një vetidentifikim negativ, kurse për besimin

⁴⁴ N. FRAY, *The Great Code: The Bible and Literature*, First Harvest Edition USA 1983.

⁴⁵ “Në ndërgjegjen time ka dy Milloshë: Milloshi i gjallë i jetës së përditshme, që vepron e gabon; dhe Milloshi tjetër, që i vihet përballë atij, e vëren dhe dënon gabimet e Milloshit real. Te njeriu bahet vazhdimisht një luftë e mbrendshme për përsosjen shpirtnore”. Shih S. HAMITI, *Letërsia moderne shqipe*, UET Press 2009, f. 398.

⁴⁶ Shih: *Shkrimet e krishtere greke*, Shtojcë, s.a, s.l, f. 413-414.

⁴⁷ “Zoti ka vdekur. Ku është zhdukur Zoti? Faltoret janë muzeumi i Perëndisë”, shprehej F. Nietzsche në librin e tij *Legjenda e të çmendurit* (shih F. NIETZSCHE: *The Death of God*, në: *The Gay Science*, Cambridge University Press 2002, p. 109-110, 119-120, 199-201). Shih gjithashtu dhe krhs *Parathanien e parathanieve: Perëndi, ku je?*.

⁴⁸ Krhs shpjegimin në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, Tiranë 1984: “Shëlbim, shpëtimi i shpirtit (sipas fesë së krishterë). Shëlbimi i shpirtit. Kungata e shëlbimit. Uratë për shëlbim”.

⁴⁹ Këtë çështje e ka shtjelluar me një ekspertizë të mirëfilltë shkencore studiuesi Mensur RAIFI, në monografinë *Lasgushi, Noli dhe Migjeni*, Prishtinë 1986. Shih nga ai: *Madhështia si antitraumë*, në *MIGJENI – Vepra*, V. 4, Rilindja, Prishtinë 1980, f. 213-230.

⁵⁰ Krhs: Ungjilli sipas Mateut 27:46: *Eli, Eli, Lama sabaktani?*; Ungjilli sipas Markut 15:34: *Eloi, Eloi, Lama sabaktani? (Eloi, Eloi, Lama Sabachthani)*.

me siguri fryma kontestuese e vargjeve të tij. Theofan Popa, një prej njohtësve më të hershëm të Migjenit, në kujtimet e tij shkruan:

“Kur u takuam për herë të fundit në Shkodër, ai u shpreh shumë ashpër kundër pikëpamjes kishtarë, tue kritikue frymën edukative të shkollës sonë. Kur i kujtova unë një nga profesorat ma të drejtë të shkollës, ai më tha: “Nji Krisht mbi kryq dhe ai janë të krishterë të vërtetë”. Ky qe bisedimi im i fundit me Milloshin”⁵¹.

Popa kishte të drejtë kur pohonte se *“atë nuk i interesonte vetëm teologjia, ku dhe aty dallohej si një nga nxanësit ma të fortë”⁵²*, përkundër vërejtjeve të disa studiuesve të tjerë për të krijuar një hierarki vlerësimi dhe interesimi të tij ndaj lëndëve laike ndaj atyre teologjike e sidomos për të vërtetuar një prirje refuzimi ateist të krishterimit⁵³. Gjithashtu të pavertetueshme mbeten mendimet e shprehura se poezia e Migjenit mund të ketë kriptuar ide filozofike dhe ateiste të Engelsit⁵⁴. Sa i takon mendimit se Milloshi seminarist u formua më shumë si satanai se si i krishterë, kjo mbetet një pikëpyetje e madhe mbase e pavërtetueshme⁵⁵. Më e vërtetueshme është pikëpamja se Migjeni nuk kishte ndonjë konsideratë për sloganin e francezkanëve *Fe e Atme* (*“in hoc signum scripsi”*), po aq sa dhe në inversin e saj *Atdhe e Fe*⁵⁶. Në rastin më të mirë mund të mbetet vetëm si dëshmi e një vullneti përforcues të ateizmit të Migjenit, që më shumë sa kaq mund të kishte qenë një vullnet për shëndoshjen e fesë dhe të besimit, në mos me Mesinë biblik, me Mbinjeriun mesianik. Antiklerikalizmi dhe sidomos ateizmi i Migjenit janë ekzagjeruar duke konfunduar me ta kritikizmin e tij dhe përgjithësisht kontestimin e vlerave të jetës⁵⁷. Një prej studiuesve të

⁵¹ Kujtime të Theofan POPËS, mik i Migjenit në seminarin e Manastirit, *Skënder LUARASI, Jeta*, gusht 1956, në *MIGJENI, Vepra*, Cetis 2002, f. xii. Shih: ΒΑΣΙΛΙΟΥ ΚΑΣΚΑΒΤΑΜΗ: *Θεοφανής Ποπα - ένας συγχρονος ιεραποστολος*, Αθηνα, s. a., f. 262-295.

⁵² Idem, ibidem.

⁵³ Skënder LUARASI, *Jeta*, gusht 1956, në *MIGJENI, Vepra*, Cetis 2002, f. ix.

⁵⁴ *“Në “Parathanjen e parathanjeve” si ven në dukje se njeriu e ka krijuë Zotin si përfytyrim, me çka në të vërtetë e ilustron mendimin e Engelsit, i cili ka thanë se qenia të cilin e adhuronte njeriu si Zot ishte qenia e tij deri atëherë e panjoftun”*. Shih: R. QOSJA, *Millosh Gjergj Nikolla - Migjeni (1911-1938)*, në *MIGJENI - Veprat*, v. 4, Rilindja 1980, f. 121.

⁵⁵ *“Për mendësinë e një fetari, Milloshi i ri, në mos ishte djalli vetë i veshur me rrobë seminaristi, kishte bërë, së paku, një pakt me djallin për t’u joshur (tani për tani) nga gjithçka e ndaluar, makabre, shkatërrimtare ... Kështu Migjeni e mbaroi seminarin si një antiseminarist”*. Shih: Ismail KADARE, *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, në *KADARE - Vepra*, vëllimi 19, Tiranë 2009, f. 150.

⁵⁶ Shih: Mensur RAIFI, art. cit., f. 226.

⁵⁷ Për poezinë e Migjenit, Dh. SHUTERIQI shkruan se *“ajo lajmëron ardhjen e një epoke të re, ardhjen e epokës ku njerëzimi nuk do të gënjejhet më nga prrallat biblike, që i servirin sherbëtorët e “zotave”, prifërinjt, me qëllim që t’i kenë kurdoherë të nën-*

hershëm të letërsisë e jetës së Migjenit, A. Pipa nuk pati ngurruar të pohonte se poeti mund ta kishte ndaluar vetë qarkullimin e *Vargjeve të lira*. Ndërsa S. Luarasi, në parathënien e tij analitike për vëllimin e vetëm poetik të Migjenit, shenjonte se të atin, Gjergjin,

“për herë e zgjidhnin epitrop në kishën ortodokse” dhe “sepse e çmonin dhe e nderonin, komuniteti i tij e dërgoi ta përfaqësonte në kongresin kishtar të Beratit më 1922”⁵⁸.

III.

Identifikimi i tekstit biblik në veprën e Migjenit u zgjodh si argument duke qenë se në traditën e studimeve ka ekzistuar një pikëpamje e paracaktuar, sipas së cilës *Shkrimet* dhe *Vargjet e lira* janë ashtu si poeti dhe murgësja në një nga poezitë e Migjenit, dy anët e skajshme të një litari (“Unë dhe ti, murgëshë, dy skaje po të një litari / të cilin dy tabore ia ngrehin njeni-tjetrit”: në *Kanga skandaloze*)⁵⁹. Sido që ky opozicion paraqitet mjaft i diskutueshëm, këtu çështja shtrohet jo në vështrimin doktrinar-teologjik, por në vështrim dhe krahasim tekstologjik. Në të vërtetë, prerjet ndërtekstore me *Shkrimet* tek Migjeni janë më se evidente.

“Migjeni do ta ndërtojë me frymën e mitologjisë kristiane, biblike. Mitemat agim i pritun, ditë e parathanun, jetë e re, jetë e re me vdekjen e njeriut, ditë e re, qiell i ri etj. janë si të nxjerra nga *Letra e dytë e Shën Palit* apo nga libri *Apokalips i Shën Gjonit*. Këto nuk janë as retorikë, as trill mesianik, janë frymë e kulluar ungjillore, të cilën e kanë braktisur edhe vetë praktikat hierarkike të strukturave religjioze-kishtarë. Mesianizmi është ide metafizike e predikuar nga gjithë profetët hebraikë, ide e gjallë edhe sot tek ‘populli i Librit’”⁶⁰.

Pyetja se deri në ç’skallë *Vargjet e lira* dhe prozat e Migjenit kanë simetri me tekstin biblik-ungjillor tentohet të verifikohet në këto shkallë:

1. Në shkallën strukturore (njësitë përbërëse të *Vargjeve të lira* dhe analogjia me “katërlibërshin” - “tetravangjel”, katër Ungjijtë në *Besëlidhjen e Re*. Sikurse dihet, është në traditën e *Shkrimeve* numërtimi i librave dhe emërtimi i tyre sipas njësive nënstrukturore (*Pentateuche* - *Pesëlibërshi*, *Libri i Moisiut* në *Besëlidhjen e Vjetër*, për shembull).

2. Në shkallën konceptuale (në radhë të parë cilësia e vërtetueshme e karakterit sinoptik të *Vargjeve të lira* dhe e prozave, krejt analoge me karakterin

shtruar”. Shih: SHUTERIQI Migjeni, në MIGJENI - *Vepra*, v. 4, *Rilindja*, 1980, f. 79.

⁵⁸ S. LUARASI, *Jeta*, gusht 1956, në MIGJENI, *Vepra*, Cetis 2002, f. viii. Khs A. PIPA, *Për një kritikë letrare*, te *Kritika*, viti 1944, f. 3. Idem, *Miti i Perëndimit në poezinë e Migjenit*, në *Për Migjenin: tri esse*, Tiranë 2006, f. 60-61.

⁵⁹ Gjerësisht: Sh. SINANI, ‘*Vargjet e lira*’ dhe *Shkrimet*, *Art & Trashëgimi*, 3/2012, f. 94-97.

⁶⁰ S. BEJKO, *Migjeni midis niçeanizmit dhe mesianizmit*, *Temp.*, nr. 43, 9 tetor 2005, f. 3-6.

sinoptik të tre ungjijve sinoptikë (pas Matthew-t, pas Mark-ut e pas Luca-s);

3. *Në shkallën e mitit.* Në lidhje me këtë shkallë sa janë bërë përpjekjet e para, duke identifikuar sidomos mitin e Mesisë (Mesiah), gjithaq dhe të profetëve të *Testamentit të Vjetër*:

4. “Ndërsa zhvendosemi në universin e paqetë të Migjenit, ne si lexues vihemi në pozita dilematike me pyetje të tilla delikate si: Si reflektohet dhe identifikohet miti biblik i Mesisë në veprën e Migjenit; si është ndryshuar dhe risemantizuar duke iu nënshtruar metamorfozave në tekstin e tij?”⁶¹.

5. Në shqyrtimin tonë i përmbahemi mendimit se paralelet me figurat e krishterimit janë të karakterit kultologjik dhe mitologjik (Krishti, Maria Magdalena). Mitologjia është pagane, ndërgjegjja është e krishterë; mitet janë të periudhës sakrale, kultet janë të periudhës sanktuale. Të dyja këto kanë një prerje semantike të fortë: nga lat. “sacer” erdhi në terminologji “consacrare”, “konsakroj”; sikurse nga lat. “sanctus”, “sancire” rezultuan sinonimet e pjesshme me të: “sanzionare” (it.), “sanctioner” (fr.) - “sanksionoj”.

6. *Në shkallën e subjektivitetit të Autorit si “Auctor, Krijonjës” [Buzuku]:* Migjeni, ashtu si Prometheu, ashtu si Krishti, është njeridashës, filantrop, jo mizantrop, njeriurrejtës⁶².

7. *Në shkallën e prozodisë dhe të metrikës (vargu heterometrik);*

8. *Në shkallën e pragmatikës (shembëlltyrës: parabola, “prrallë biblike”);*

9. *Në shkallën e ndërtekstit (tekstit të brendashkruar në formë të referuar, tekstit të brendashkruar në formë sintagmatike, tekstit të brendashkruar në formë perifrastike - të parafrazuar);*

10. *Në shkallën e motiveve;*

11. *Në shkallën e gjedhes figurative;*

12. *Në shkallën e një lexicon-i gjuhësor* (që, në vështrimin e kësaj trajtëse, mban në vlerësim vetëm atë pjesë të leksikut që vjen prej kulturës librore, duke mos vështruar si objekt dhe leksikon liturgjik-kishtar të përftuar në formën e ligjërimit gojor në shqipen popullore).

⁶¹ Valbona AVDULLAJ, *Miti i Mesisë në një lexim të ri të poezisë Shkëndija të Migjenit*, në *Haemus plus*, 2012/2, f. 88.

⁶² Krhs: M. RAIFI, *Leopardi është mizantrop, Migjeni është filantrop*, në *Madhështia si antitraumë*, botuar në MIGJENI, *Vepra*, vëll. 4, botimet Rilindja, 1980, f. 215.

1. Në shkallën strukturore:

Teksti biblik luan rolin e një teksti referencial para së gjithash në shkallën e modelimit të mendimit dhe të shprehjes poetike të tij. Struktura e *Vargjeve të lira* është ndërtuar në katër pjesë, ashtu si *Besëlidhja e Re*, me katër ungjijtë dhe *Veprat e Apostujve*. Secili emërtim i pjesëve ndjek të njëjtën strukturë si në *Shkrimet*. Dihet mirë se numri katër si numër simpatik njihet për shenjimin e katër elementeve themelues të botës, për shenjimin e katër anëve të horizontit, pjesërisht dhe të katër stinëve, dhe, veç të gjithash, për shkakun se katër janë Ungjilltarët e mëdhenj dhe katër janë Ungjijtë⁶³. Strukturimi katërpjesësh i *Vargjeve të lira* nuk është rastësi. Për të ruajtur **strukturën katërpjesëshe** të veprës së vet, të njëjtë me atë Ungjijve të *Besëlidhjes së Re*, këngët *Parathania e parathanieve* dhe *Kangë më vete* nuk shenjohen fare si njësi në strukturë as në botimin e vitit 1936, që e kishte propozuar vetë autori; as në botimet e viteve 1944 e 1956. Vetë ky përjashtim nga struktura ka një analogji me tekstet biblike. *Canticum canticorum* është pjesë e *Shkrimeve*, por nuk është libër më vete, ashtu sikurse *Parathania e parathanieve* dhe *Kangë më vete* - pjesë jo të përbashkuara në katër ciklet e *Vargjeve të lira*⁶⁴.

Simetri të Vargjeve të lira dhe Besëlidhjes së Re si dy "katërlibërsha" ("τετραεναγγελιον"):

Parathania e parathanieve Zanafilla - Gjenezja

- | | |
|-------------------------|----------------------------|
| 1. Kangët e Ringjalljes | Ungjilli sipas Matthew-t |
| 2. Kangët e Mjerimit | Ungjilli sipas Mark-ut |
| <i>Kangë në vete</i> | <i>Canticum canticorum</i> |
| 3. Kangët e Përdimit | Ungjilli sipas Luke-s |
| 4. Kangët e Rinis | Ungjilli sipas Gjonit |

Në strukturimin kanonik të librave të Biblës njihet rasti i *librit më vete* apo i *librit të ndërmjetmë*. *Canticum canticorum*, që pason *Librin e Psalmeve*, qëndron më vete pa u numëruar si libër i pavarur i Biblës. *Kangë më vete*, dhe në formën e vet quajtëse, ruan simetrinë me *Këngën e këngëve*.

Në botimin e vitit 1958 *Kangët e fundit* renditen si një cikël i pestë. Duke mos qenë pjesë e konceptit të librit në botimin e pëlqyer nga autori, për rastësi, apo ndoshta për shkak të një ngjashmërie gjenetike, u përgji-

⁶³ M. LAMBERTZ, në veprën *Zwischen Drin und Vojusa: Märchen aus Albanien - Midis Drinit dhe Vjosës: përralla nga Shqipëria*, Leipzig 1922, ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për këtë, duke iu referuar traditës europiane të këngëve popullore tradicionale me karakter ushtrimor për fëmijët, për t'i gjetur çdo numri kuptimin e vet simpatik.

⁶⁴ Sh. SINANI, *Migjeni italisht nga Jolanda Kodra*, në *Shqip*, 20 maj 2010.

gjen pak a shumë *Veprave të Apostujve*⁶⁵. Kjo analogji përforcohet prej faktit që *Veprat e Apostujve*, të shkruara pasi ishin shpallur ungjijtë, në formën e letrave dhe të kujtimeve, rregullisht përmbajnë kreun e *Përshëndetjeve të fundme*, si modele të përmylljes së letërkëmbimit me bashkësitë besimtare. Veç kësaj, ashtu si *Veprat e Apostujve*, edhe cikli i vjershave të shkruara pas *Vargjeve të lira*, duke qenë më kronikale dhe më jetëshkrimore, ka një paralele tjetër me “*librin shtesë*” ndaj katër Ungjijve.

2. Në shkallën e prozodisë:

Shumë është diskutuar për mënyrën si erdhi vargu i lirë në poezinë e Migjenit; një varg që ishte pa ndonjë traditë në historinë e letërsisë shqipe. Përveçse te Jeronim De Rada dhe në ndonjë rast tjetër të rrallë, vargu heterometrik nuk ka paraprijës deri tek Migjeni. Madje nuk ka munguar dhe interpretimi që *Vargjet e lira* kanë më shumë kuptimin “*vargjet e lirisë*” se “*vargje heterometrike*”.

Në letërsinë botërore varg zanafillës i karakterit heterometrik është vargu i psalmeve apo i *Librit të psalmeve*, pasuar prej *Canticum canticorum* dhe *Libri i Proverbave*. Ndikimi i letërsisë shqipe prej psalmodisë nis prej librit të parë shqip, “*Mesharit*” të Gjon Buzukut, në të cilin, siç e ka vërejtur studiuesi I. Rugova, po dhe të tjerë para tij, gjenden katër lutje (“*oratio*”)⁶⁶, që Buzuku vetë i quan psalme, besohet rikrijime e parafrazime prej liturgjisë së Shën Gjon Gojarit, për veten dhe për prindërit e tij. Me këto katër lutje/psalme Buzuku mbaron: “*E këtu sosenë të shtatë Psalmat të Pendësëvet*”⁶⁷. Vlen të kujtohet se para Migjenit ishte Asdreni ai që

⁶⁵ *Kangët e fundit* janë shtojcë e botuesit, njësoj si *Veprat e apostujve* shtojcë e Ungjijve, vepër kanonike, por më shumë me rëndësi për historinë e krishterimit.

⁶⁶ I. RUGOVA, *Katër urata origjinale të Buzukut*, në *Buzuku*, nr. 14/2004.

⁶⁷ E. ÇABEJ i krahason psalmet e Buzukut, tekste origjinale brenda “*Mesharit*”, me tekstin liturgjik që gjendet në f. XXXVII të origjinalit, ku “*kemi të bëjmë me një pjesë të sjellë nga Dhjata e Re të Shën Gjon Gojartit apo Pagëzuesit, që po ashtu jepet në veten e parë, po pa u përmendur emri i këtij të shenjtë*”. Shih: I. RUGOVA, *Katër urata origjinale të Buzukut*, në *Buzuku*, nr. 14/2004.

⁶⁷ Katër lutjet në formë psalmesh të D. Gjon Buzukut në “*Meshari*” janë: **I.** “*O Jezu Krisht, shelbuosi i gjithë shekullit e shpërblesi i shpirtënavet, Zot, regji i pâmort, u tÿ të lus, Dom Gjoni, sherbëtori uit, të madhenë zotëni tande të pâfine për këta të kënduom të këtyne Psalme, qi u i pâdenji këndova, ti të më liberonjsh shpirtinë tem ò katit, e ti vëliz zemërenë teme përâpëtë ò duorshit s atyne qi për të keq ecnjënë. E ò së kujtuomeshit së pâdërejta e të pâlגיע ti libero korpnë tem, aj përôdenë sherbëtyrë ò kati me mos klenë. E ti dbo ò meje të deshëruomiitë e katit gruosë. E ò meje hiq gjithë të pâlגיע qish i pâ-*

vëllimin e vet me poezi, një prej vëllimeve më të diskutueshme, e kishte quajtur *Psalmë murgu*. Vargu heterometrik nuk kishte traditë, por letërsia me kod biblik dhe ungjillor kishte një traditë prej afro katër shekujsh⁶⁸. Në fillim të shekullit të 20-të F. Noli kishte botuar *Israelitë e filistinë* dhe në *Albumin* e vet kishte veçuar e pavarësuar “*ciklin biblik*”.

Ndikimi i prozodisë, i sintagmatikës dhe i pragmatikës së ligjëritimit të kodifikuar të *Librit të psalmeve* dhe *Librit të proverbave*, përgjithësisht i librave të versifikuar të Biblës, në veprën e Migjenit mund të shihet si dukuri jo e papritur dhe jo e çuditshme. Gjerdhja biblike dhe ungjillore shenjohehet në një mënyrë më të dukshme në vargëzimin e Migjenit, që përgjithësisht, me lirinë e vet, ndjek modelin e *Librit të Psalmeve* dhe të *Librit të Proverbave*, që njëherësh përbëjnë modele arketipalë të vargjeve të lira dhe kanë vërtetuar një fuqi gjinikuese në historinë e letërsisë botërore. Prozodia e Migjenit, tipologjia e llojeve, ndërthurja e tyre, prozat poetike dhe shthurja e strukturave tradicionale të poezisë, meritojnë një shqyrtim krahasues me strukturën e vargëzimit në këto dy libra, të cilët kanë modeluar e jo ndikuar format poetike të tij.

Katër pjesëve të librit u paraprin *Parathania e parathanieve*, historikisht e interpretuar gabim, *ad litteram*, si *Hyrja e hyrjeve*, apo *Kredoja e kredove*, në përkthime në gjuhë të huaja edhe *Preambola e preambolave*⁶⁹,

emëni mundë shtjerë òdë mend, ansish qish dukenë e ansish qi z dukenë, qi ata lypnjënë shpirtinë tem me mbajturë me mos ecunë pr udhë të Tinëzot. O Zot, bâsi i gjithë shekullit, tÿ të klofsha truom, qi më Atët e më Shpirtinë shenjtë gjellin e jet, për gjithë jetë të jetësë. Amen”. II. “Zot, ti qi bane qiellë e dhenë, afërë veti venë oratëtë e mi. E për të madhet mishërier tande e për të kënduomit qi u tÿ këndonj këta Psalma sod, u i pâdenji tue t-u lutunë u tÿ të lus, muo sherbëtorit tit mbë këtë jetë ti të të denjonesh muo me më dhanë shëndet ò mendët e ò korpit, e mot u me bam pendesënë e dërejët përpara mort-së sime. E më ban hir, Zot, me pasunë të liruomitë e katevet mive. Përse u mbë tjetëret jetë me gjithë Shenjt të tû u të mundinj me pasunë patrienë e jetesësë amëshuome. Amen”. III. “O Zot i gjallëvet e i vdekunet, Shelbuosi i gjithëve, qi ti z-do mortnë e t-përkateuomit, ma aj të konvrtonetë e të gjellinjë, òdijemë, u tÿ të lus, e m î afërë muo Dom Gjonit. E muo shkatëro të shkruomitë e gjithë katet mive. E tÿ tue t u pëlqyem, përze oratëtë e mî qi u m' tÿ përdâ, Zot, për muo e për gjithë njerëzit të mî ò gjakut sim, e për miq të mî e pr anëmiqt të mî, për të gjallët porsi për të vdekunitë”. IV. “O Zot, ti qi ordënove na me nderunë atënë e amënë, kî mishërier, tÿ tue t-u pëlqyem ò shpirtit së tatësë e të mamësë sime, e atyne u ndije katet e tyne; e muo e ata na ban neve na me pasunë gazëmendnë e dritësë jetësë glatë (gjatë). Për Krishnë Zotnë tanë. Amen”.

⁶⁸ Krhs: “Zot, kî mëshirier n meje / përse u jam sëmuni: / shëndoshmë, përse eshtënatë e mî lëngonjë / e shpirti im ansht tërbuom fort / ma ti, Zot, djerje kur të më apsh ndimë”.

Transkriptim i S. RIZËS, në vep. cit., Prishtinë 2004, f. 454.

⁶⁹ Jolanda KODRA, *Migjeni, Poesie e prose*, Tiranë 1962.

duke qenë në të vërtetë me kuptimin *Profecia e profecive* dhe duke iu përgjigjur me strukturën e vet *Canticum canticorum*, *Kangës së kangëve*, *Kangjeljes së kangjeljeve*, pjesë e *Biblës*, por jo libër më vete, ashtu si tek Migjeni: pjesë e *Vargjeve të lira*, por jashtë ndërtimit strukturor të tij⁷⁰.

Duke qenë në këtë pikë vlen të kujtojmë se Migjeni, pavarësisht se veprën e tij e quajti *Vargje të lira*, jo vetëm në ndarjen e pjesëve, por edhe në tituj e nëntituj të poezive, dhe në brendi të tyre, përdor rregullisht emërtimin “*kangë*”, që në thelbin e vet këtu i përgjigjet emërtimit “*psalm*”⁷¹. Organizimi i vëllimit të quajtur “*vargje të lira*” në ballinë me cikle “*kangësh*” e përaftron veprën e Migjenit me psalmodinë e lashtë hebraike dhe të mëvonshme, poezi të këndueshme, që kishin dhe instrumentin e tyre të posaçëm, “*psalterion*” (“*ψαλτήριον*”).

Ligjërimi parathënës, përdorimi i rregullt i së ardhmes së domosdoshme, i së ardhmes me karakter urdhërues (rasti i *Parathanies së parathanieve*; ligjërimi paracaktues, i shprehur në të ardhmen gramatikore me funksionet e urdhërues së pashmangshme, shprehet edhe me mjete gjuhësore, me formën konservative të gegërishtes “ka” plus pjesore. Sa i takon karakterit parathënës të poezisë *Parathania e parathanieve*, kjo mund të vërehet lehtësisht prej vargjeve përmbyllëse të saj:

“Ka ardhë një kohë,
në të cilën njerzit po kuptohen fare mirë
për me ndërtue Kullën e Babilonit -
dhe në maje të Kullës, në majë të majës së fronit
ka me hypë njeriu
dhe ka me thirrë:
Perëndi, ku je?!”⁷²

Në këto vargje “*Kulla e Babelit*”, e shkruar me të madhe, sjell ndër mend jo vetëm mitin biblik të mosmarrëveshjes njerëzore, që profetizohet të kthehet në marrëveshje, por edhe *Kullën e Rojës*, dhe historinë mesjetare të mbrojtjes së krishterimit prej dhjetëra urdhërash e rendesh jashtë disiplinës. Por në të njëjtën

⁷⁰ Kristaq JORGO, *Për historinë e tekstit të veprës “Vargje të lira” të Migjenit*, në *Studime filologjike*, nr. 1-4/1997, f. 19-32. Po ai, *Letërsia (ç)mitizuese: parabola e djalit plangprishës në poezinë “Shkëndija” të Migjenit*.

⁷¹ MIGJENI, *Vepra*, Cetis 2002: *Kanga e rinis*, f. 10; *Kangët e pakëndueme*, f. 12, *Kanga e të burgosunit*, f. 26; *Kanga e dhimbës krenare*, f. 28; *Kanga skandaloze*, f. 32; *Kanga që s’kuptohet*, f. 68; *Kanga e fundit*, f. 72; *Kanga e qytetit të huej*, f. 194; *Kanga e trumcakut*, f. 195. Këtu nuk përmenden vjersha të tjera ku fjala “*kangë*” është një “*key word*” për poezinë, ose kur ka sinonime të fjalës “*kangë*” a terma të marrë prej muzikës (“*baladë*”, “*recital*”, “*melodi*”, “*sonet*”).

⁷² Khs: “*Deri kur, o Zot, do të bërtas dhe Ti nuk do të më dëgjosh?*” - “*Habakuku*”, 1:2.

kohë të sjell ndërmend monofrazën e Nietzsche-s në *Die fröhliche Wissenschaft*: “*Der Mensch schuf Gott!*”, njeriu e ka krijuar Zotin dhe jo Zoti njeriun (f. 38);

“*Das freilich weiss Niemand, selbst der liebe Gott nicht*”,

askush s’ e di rrjedhën, as Zoti vetë (s. 9);

“*Es scheint mir, dass diessmal der Gott der Träume sich über meine Gewohnheiten lustig machen wollte*” - “*Mua më duket se Zoti luan me ëndrrat e mia*” (s. 22).

Mbi të gjitha, a nuk është pyetja e Migjenit “*Perëndi ku je?!?*” e njëjta me pyetjen e Nietzsche-s:

“*Unë kërkoi Zotin*”; “*Ku është zhdukur Zoti?*”, “*Zoti ka vdekur*”; “*Zoti ka vdekur përgjithnjë*”; “*Nëse Zoti nuk është në kisha dhe manastire, ku mund të jenë muzeumet e tij?*”; “*A nuk është djalli ana tjetër e Zotit?*” [sunt bona mixta malis]⁷³. “*Ich suche Gott! Ich suche Gott!: Wohin ist Gott? Gott bleibt tot!*”; “*Wir haben ihn getötet, - ihr und ich! Wir Alle sind seine Mörder*”; “*Was sind denn diese Kirchen noch, wenn sie nicht die Griffe und Grabmäler Gottes sind?*”⁷⁴.

Vdekja e “*Zotit klasik*” është një prej përfundimeve të aluminizmit gjerman. Një Zot i ri duhet të lindet. Gabimisht kontestimi i Zotit klasik është interpretuar si ateizëm dhe jo si formë kërkimi e një Zoti të ri.

3. Në shkallën konceptuale:


Ashtu sikurse tre ungjijtë kronologjikisht më të hershëm (ungjijtë sipas Matthew-t, Mark-ut dhe Luke-s), të cilët në tekstologjinë kritike ungjillore cilësohen terminologjikisht si *vepra sinoptike*, edhe ciklet e poezive të **Vargjeve të lira** kanë prerjen e tyre sinoptike në të gjitha rrafshet: të poetikës, të figurës, të frymës dhe të kumtit. *Karakteri sinoptik*, modeli strukturor, prozodia, si dhe idiomatika, janë analogjitë më të dukshme të tekstit poetik të Migjenit me tekstin biblik. Në veprën e Migjenit karakteri sinoptik shprehet në formën e së njëjtës cilësi rimarrjeje, prerjesh të përbashkëta, rikrijimesh, deri dhe inkorporimesh. Në *Vargjet e lira* jo vetëm një cikël poezish rishprehet në tjetrin, por edhe poezia transmodelohet në pikëpamje të tipologjisë së llojit në prozë e anasjelltas: Rasti i prozës *Një refren i qytetit tem*, së cilës i brendashkruhet gjithë poezia *Fragment (Prej mëshirës së të pamëshirëve)*, mund të jetë më shprehësi i sinoptizmit në këtë veper. Por karakteri sinoptik i *Vargjeve të lira* rishprehet edhe në mundësitë

⁷³ F. NIETZSCHE, *Die fröhliche Wissenschaft: Gott ist tot: aber so wie die Art der Menschen ist, wird es vielleicht noch Jahrtausende lang Höhlen geben, in denen man seinen Schatten zeigt.-Und wir-wir müssen auch noch seinen Schatten besiegen!*, Leipzig 1887, s. 108.

⁷⁴ F. NIETZSCHE, *Die fröhliche Wissenschaft: Wohin ist Gott?- rief er, ich will es euch sagen! Wir haben ihn getötet,-ihr und ich! Wir Alle sind seine Mörder;Was sind denn diese Kirchen noch, wenn sie nicht die Griffe und Grabmäler Gottes sind?* Leipzig 1887, s. 125.

e shumëfishta që ofron vepra për atë mënyrë leximi që quhet “*lexim biblik*” apo lexim në perikope (“*gospels lectionary*”). Rëndin ciklor dhe sidomos leximin sinoptik paralelisht me Migjenin e kishte preferuar po në ato vite dhe Lasgush Poradeci⁷⁵.

Afëritë në shkallën konceptuale shfaqen herët. Shumë pranë janë eseja teologjike për kryerjen e provimit përfundimtar në teologji me titull *Dy natyrat e Krishtit* me skicën letrare autobiografike *Dy Milloshët*⁷⁶. Pamjet e mesianizmit, të shprehura në formën e besimit tek Mbinjeriu dhe në forma të tjera, janë vënë re prej studiuesish më herët. Thirrja që ndërthur dëshpërimin me shpresën: *Vall! A ka shpëtim ndokund?! (në Vjeshta në parakalim)*, apo *Thirrje për shpëtimin e jetës. Apoteozë e shekullit të njëzetë (në Legjenda e misrit)*, mbitheksojnë pikërisht idenë e të të shëlbuesit.



Sinoptikanizmi në tekste ungjillore me prerjet sasiore e përmbajtëso

⁷⁵ Krhs për shembull strukturën e librit **Vallja e yjeve**: 1. Në vend të parafjalës: Zog’ i Qiejve 2. Vallja e Qiellit 3. Vallja e Dherit 4. Vallja e Yjeve 5. Vallja e Përjetësisë 6. Vallja e vdekjes 7. Kur nuk ndjehesh fare mirë. Ndërsa libri **Ylli i Zembrës** është organizuar në këto cikle: 1. Zemra e Qiellit 2. Zemra e Dherit 3. Zemra e jetës 4. Zemra e Përjetësisë 5. Zemra e Vdekjes 6. Kush ma njohu dhembshurinë. Ashtu si te Migjeni, edhe në vëllimet e Poradecit ciklet rishprehen tek njëri-tjetri.

⁷⁶ Krhs: “Në ndërgjegjen time ka dy Milloshë; Milloshi i gjallë i jetës së përditshme që vepron, gabon dhe Milloshi tjetër, që i vihet përballë atij, e vëren dhe dënon gabimet e Milloshit real. Te njeriu bahet vazhdimisht një luftë e mbrendshme për përsosjen shpirtmore”. Citohet sipas: Sabri HAMIT, *Letërsia moderne shqipe*, UET 2010.

Studiuesit kanë vërejtur në mënyrë të veçantë *frymën e mesianizmit* si dukuri shpirtërore në letërsinë e Migjenit⁷⁷. Mesianizmi nuk mund të cilësohet vetvetiu si refuzim i krishterimit. Nietzsche, prej të cilit Migjeni pati përftesa, kishte pohuar me kohë se “*i krishteri i fundmë u kryqëzua në kryq, dhe ky qe Krishti*”, ndërsa krishterimi i mëvonshëm ishte vetëm një besim kishtar, e kjo më së pari nënkuptonte “*kthimin tek burimi*”, njësoj si qe propozuar në periudhën e Rilindjes Europiane⁷⁸. Dhe nëse ky burim nuk rikthehej, atëherë duhej krijuar një Mesi i ri: prej zoroastrizmit (*Ashtu foli Zarathustra*), prej budizmit (*Vdekja e Zotit*) apo *ex novo*.

Duke përmendur këto fakte dhe të tjera në vijim, është e nevojshme të theksohet se kjo trajtesë nuk ka për qëllim të evangjelizojë botëkuptimin e Migjenit dhe as të polemizojë me ata që kanë pasur e kanë bindjen në refuzimin ateist të besimit prej tij. Çështja shtrohet në rrafshin e tekstit, si shenjë e *Shkrimeve* dhe e kulturës teologjike të Migjenit në veprën e tij në poezi e në prozë. Dihet mirë se *Bibla* studiohet jo vetëm si një libër-amzë i krishterimit, por edhe si mitologji dhe model mendimi e përfytyrimi. Duke e vështruar në këtë anë, prania e tekstit biblik në veprën e Migjenit është e pafshehur, shpesh e pohuar qysh në titujt e poezive dhe prozave të tij.

4. Në shkallën e pragmatikës (shembëlltyrës):

Në një shkallë më të padukshme letërsia e Migjenit implikohet prej tekstit biblik në nivelin e pragmatikës, kryesisht përmes modeleve të shembëlltyrave, ku mund të gjenden e të renditen vargorë të një zinxhiri të gjatë, prej shembëlltyrës së të parëlindurit, dhjetë urdhëresave dhe viçit të artë, të mëkateve (veçmas të mëkatit të origjinës) dhe natyrës së pashpëtimtë të individit, përdëllimit dhe vuajtjes për të tjerët, kopështit të Edenit, varkës së Noah-ut, malit të Moisiut, kultit të *mannah*-së dhe mallkimeve biblike me etje e uri shkretëtire (“*apoteozës së misrit*”), deri tek përfytyrimi për ferrin dhe mëkatin tokësor.

Ndodh shpesh që teksti biblik përthyeret përmes mendimtarëve dhe poetëve paraardhës botërorë, si Dantja në rastin e përfytyrimit për *Ferrin*, Dostojevski, Nietzsche, Schopenhauer, Goethe e Kierkegardit për filozofinë e kuptimit të jetës.

⁷⁷ Kristaq JORGO, *Identiteti i qëndresës së panjohur: rasti Shqipëria: letërsia shqiptare, mesianizmi*, botuar në *Tempulli*, nr. 2/2000, f. 75-84.

⁷⁸ F. NIETZSCHE, në librin e tij *Legjenda e të çmendurit*.

Në rrafshin e pragmatikës mund të veçohen së paku tre modele lehtësisht të identifikueshëm parabolash biblike të interpretuar si tekste të lira:

- *Shembëlltyra e djalit plangprishës*, vërejtur më herët prej studiuesve, në poezinë *Shkëndija*. Në të njëjtën poezi mund të gjendet dhe e përkundërta e shembëlltyrës së paralajmërimit të ardhjes së Krishtit prej priftërinjve mobedë, me anë të shenjës që bie mbi vatër. Shpesh Migjeni e përdor lëndën ungjillore për të kriptuar figurën e vet dhe për të kondensuar mendimin.

- *Shembëlltyra e kullës së Babelit* (e kullës së Babilonit), e paralajmëruar në poezinë e Migjenit jo si dështim i marrëveshjes njerëzore, por si triumf i saj në *Parathanien e parathanieve*;

- *Shembëlltyra e gruas mëkatore, Maria Magdalenës*, në emër të së cilës njehet dhe një ungjill apokrif, e paditur prej farisejve si grua e përdalë, më pas të shenjtëruar; një prej shembëlltyrave që pati shkaktuar debate të gjata kishtarë në koncilet e kryehershme⁷⁹. Është shembëlltyra më paradigmatisht në veprën e Migjenit, e shenjuar sidomos në poezitë *Baladë qytetëse*, *Melodi e këputun* dhe në prozën *Histori e njenës nga ato*. Çlirimi i gruas mëkatore (i gruas publike) prej dënimit moral i përngjan parabolës së Krishtit me Maria Magdalenën⁸⁰.

Në letërsinë frënge shenjtërimin e mëkatit e pati shprehur qartësisht Baudelaire-i, në poezinë e njohur *Mon coeur mis à nu*:

“Analyse des contre-religions, exemple: la prostitution sacrée.

Qu’est-ce que la prostitution sacrée?

Excitation nerveuse,

Mysticité du paganisme”⁸¹.

Në prozën *Historia e njenës nga ato* të njëjtën parabolë Migjeni e përmbyll kështu: “Rreth emrit të Lukes, veçanërisht rreth trupit të saj, ishte

⁷⁹ Shih: *Shkrimet e krishtere greke*, Shtojcë, s.l., s.a., f. 413-414.

⁸⁰ “Por Jezusi i tha asaj gruaje: “Besimi yt të shpëtoi; shko në paqe!”, 7:50.

⁸¹ Charles BAUDELAIRE: “*Mon coeur mis à nu: journal intime*”, Paris 1887, p. 7. Krhs dhe:

“*De l’Obsession, de la Possession, de la Prière et de la Foi.*

Dynamique morale de Jésus.

Renan trouve ridicule que Jésus croie à la toute-puissance,

même matérielle, de la Prière et de la Foi.

Les sacrements sont des moyens de cette dynamique.

De l’infamie de l’imprimerie, grand obstacle au développement du Beau.

Belle conspiration à organiser pour l’extermination de la race juive.

Les juifs Bibliothécaires et témoins de la Rédemption”.

*krijue njëfarë aureole (nimbusi) si rreth krenave të shenjtëve ... Me e quejtë Luken kurvë i dukej si me e quejtë priftin grue pse ka veshë ragjën (veladonin)*⁸². Dhe nuk është e rastit që “*njena nga ato*” mban emër shenjtori, madje emrin e Ungjilltarit Lukë të femërorizuar.

Vepra e Migjenit i përgjigjet konceptit të filozofit postmarksist danez, që shprehej se mendja e njeriut, ashtu si një parashutë në lartësitë e qiejve, mund të jetë e dobishme dhe shpëtimtare vetëm nëse është e hapur. Në letërsinë e Migjenit bashkohen mendja e hapur me fuqinë e figurës së tekstit më kanonik në botë, *Biblës*, që përbën rezervatin e subjekteve dhe të formave të shprehjes në historinë e letërsisë botërore.

5. Në shkallën e motiveve:

Në një shumicë rastesh brenda një poezie apo proze ndërthuren disa parabola, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën, duke iu mbivendosur modeli i figurës motivit biblik a ungjillor; teksti perifrastik tekstit të autorit, gjedhja zanafillëse trajtës letrare:

<i>Titulli i poezisë / skicës së Migjenit</i>	<i>Referencë në lëndën biblike dhe ungjillore në rrafshin e motivit (tematologjik)</i>
<i>Parathania e parathanieve</i>	<i>Gjeneza; Kulla e Babelit; Libri i Profecive; Canticum Canticorum</i>
<i>Kangët e pakëndueme</i>	<i>Ungjijtë dhe letrat jokanonike, ungjijtë apokrifë dhe gnostikë</i>
<i>Baladë qytetëse</i>	<i>Maria Magdalena</i>
<i>Melodi e këputun</i>	<i>Maria Magdalena</i>
<i>Kanga e të burgosunit</i>	<i>Krishti i kryqëzuar</i>
<i>Trajtat e Mbinjeriut</i>	<i>Mesia, Shelbuesi, “shpirt i kryqzuem”, “agim i pritun”, “dit’ e parathanun”, zoroastrizmi, Mesia para Mesisë, Ashtu foli Zarathustra</i>
<i>Vjeshta në parakalim</i>	<i>Mesia: “Vall! A ka shpëtim ndokund?!”</i> ⁸³
<i>Kanga skandaloze</i>	<i>“Unë dhe ti murgeshë, dy skaje të një litari”: devocioni vs mëkati.</i>

⁸² *Historia e njenës nga ato, në Migjeni - Vepra, Cetus 2002, f. 154.*

⁸³ Khs tekstin referencial ungjillor: “*Gjëja e parë që duhet të kuptohet është se ne nuk mund ta shpëtojmë vetveten*” (Marku 10:26-27); “*Vetëm Perëndia mund të na shpëtojë*” (Zbulesa 7:10); “*Shpëtimi është plotësisht një vepër e hirit të Perëndisë*” (Efesianët 2:5); “*Nuk duhet as të na shkojë në mendje se Perëndia e jep në mënyrë të hirshme shpëtimin në përgjigje të ndonjë cilësie të mirë që shikon në ne*” (Titu 3:5; 2 Timoteu 1:9); “*Shpëtimi nuk mund të fitohet apo meritohef*” (Galatasit 2:16).

<i>Shpirt' i ri</i>	<i>"Fli e një lterit të ri", "lajm i idealit të ri", "o vall' u fik një hy!": lajmi i mirë, evangelion.</i>
<i>Shpirtënt shtegtarë</i>	<i>"Vendet e shuguruem" - Krishterimi sakral</i>
<i>Dy buzë</i>	<i>Maria Magdalena</i>
<i>Hidhet e përhidhet</i>	<i>"Për një ringjallje mbi të vjetra kalbësina"</i>
<i>Një natë pa gjumë</i>	<i>"Pak dritë" - "Mehr Licht"</i>
<i>Frymzim i pafat</i>	<i>"O njerëz të bimë nga far' e ambël": Zanafilla, njeriu si shembëlltë e Hyjit.</i>
<i>Sokrat i vëjtun a derr i kënaqun</i>	<i>"Jepini Cesarit çfarë i takon Cesarit"</i>
<i>Tragjedi apo komedi</i>	<i>Te Deum laudamus, Te Deum Majestoso</i>
<i>Mollë e ndalueme</i>	<i>"Fruti i ndaluar"</i>
<i>A do qymyr, zotni</i>	<i>"Sa at qymyr, fisnike" - Maria Magdalena</i>
<i>Në kishë</i>	<i>"Eni këtu ju të dëbuenit dhe të përbuzunit e këtij shekulli" (Kisha e zotit Krisht)</i>
<i>Legjenda e misrit</i>	<i>Mannah, ushqimi i shenjtë (hebr.: "manhu")</i>
<i>Të korrurat</i>	<i>"Na kët farë s'e kemi mbjellë" - Shembëlltë e Krishtit</i>
<i>Historia e njenës nga ato</i>	<i>"Besimi yt të shpëtoi"⁸⁴ "Ishte krijue njëfarë aureole" "Me e quejtë Luken kurvë i dukej njësoj si me e quejtë priftin grue" - Mari Magdalena</i>
<i>Bukën tonë të përditshme falna sot</i>	<i>"Ati ynë" - Pater Noster</i>
<i>Idhuj pa krena</i>	<i>Idhujt e rremë⁸⁵</i>
<i>Të fala nga fshati</i>	<i>"Tue mendue kështu në vesh më tingëllojnë fjalët e dikuajt: "Besimi yt të shpëtoi" - Krishti dhe Maria Magdalena</i>

Në kohën kur At Gjergj Fishta, meshtar franceskan, hyjnizonte mitet dhe zotat paganë, megjithëse ndërgegjija e tij fetare nuk ia lejonte këtë; në kohën kur E. Koliqi, i lëkundur prej formimit perëndimor, përjetonte

⁸⁴ Ungjilli sipas Lukës, 7:48, 50: "Mëkatet të janë falur Besimi yt të shpëtoi; shko në paqë".

⁸⁵ Interpretimi në përkthimin italisht në formën "idoli decapitati" - "idhuj me krye të prerë", nuk përmban kuptimin burimor të idiomës në ligjërimin e Migjenit. Në të folmet veriore, sidomos verilindore, mbiemri "kryepremë" është i ngulitur dhe përdoret edhe për të identifikuar Shën Gjoni Kryepremë. Po të ishte fjala për idhuj "me krye të prerë", Migjenit, që e njëjste më së miri ligjërimin teologjik, do t'i kishte ardhur më për mbarë forma "idhuj kryepremë". Por këtu është në tjetër kuptim: idhuj pa kuptim, pa krena, paganë, të rremë. Për përdorimin në kuptimin "idoli decapitati" shih Jolanda Kodra, *Migjeni, Poesie e prose*, Tiranë 1962.

dilemën e madhe “*midis malit dhe detit*”⁸⁶, Migjeni përthirri në letërsi një kulturë që nuk kishte të bënte as me malin mitik të identifikimit etnik të shqiptarëve, as me “*detin e pabesë*”, nga përfytyrohej se shqiptarëve u kishte ardhur gjithnjë e keqja: një prej kulturave më universale të njerëzimit, matricën e tre besimeve abrahamike, më të fuqishmet e globit, *Biblën*, duke e kthyer letërsinë në qytet, atje ku oraliteti merr fund dhe legjenda përqeshet. Ai që është quajtur “*mit i Perëndimit*” tek Migjeni është më shumë për shkak të rolit kushtëzues që ka pasur historikisht Bibla në të gjitha kulturat europiane. *Gjeneza, Libri i Jobit*⁸⁷, *Libri i Profecive, Libri i Urtësisë, Libri i Jeremisë, Libri i Psalmeve, Libri i Proverbave, Ungjijtë*, janë të pranishme në veprën e Migjenit ashtu si poezia popullore në poemat e Fishtës dhe në prozën e Koliqit.

6. Në shkallën e ndërtekstorësisë:

Teksti biblik në veprën e Migjenit formën më të drejtpërdrejtë e ka si tekst i brendashkruar. Në një shumicë rastesh *Shkrimet* janë pjesë e tekstit të autorit në ligjëratë të drejtë. Rregullisht Migjeni në këto raste tekstin e *Shkrimeve* e veçon ndër thonjëza, duke shtuar në mënyrë të papërcaktuar: “*ka thanë dikush*”, “*asht thanë dikund*”, “*diku thohet*”:

- *Vjeshta në parakalim*: “se nesër do vdesin ... Vall! A ka shpëtim ndokund?!”⁸⁸.

- *Në kishë*: “Eni tek unë ju të dëbue mët e të përbuzunit e këtij shekulli, ka thanë dikur zot’ i kësaj kishë, se tek unë do të gjeni prehje”⁸⁹.

- *Zoti të dhashtë*: “Zoti që kujdeset për zoqtë e qiellës, s’ka me i lanë njerëzit të vdesin nga uja”⁹⁰.

- *Të fala nga fshati*: “... pesimist nuk jam, se besoj në një fuqi të njeriut, besoj në mbinjeriun! (tue mendue kështu në vesh më tingëllojnë fjalët e dikujt: “*Besimi yt të shpëtoi*”)”⁹¹.

- *Bukën tonë të përditshme falnae sot*: Ati ynë, uratë: “Ati ynë që rri në

⁸⁶ Dhurata SHEHRI, *Midis malit dhe detit*, Tiranë 2006.

⁸⁷ Krhs: “E i tha Zotynë: a nukë kërkove sherbëtuorrrë tem Jobinë, qi s’anshtë tjetërë njeri mbë shembëllesë të tÿ përmbi dhët, i mirë e i dërejhtë, e qi të droe Tinëzot, e qi i ikën së keqi?”. Transkriptim i S. Rizës, vep. cit. Prishtinë 2004, f. 454.

⁸⁸ *Vjeshta në parakalim*, në *Migjeni - Vepra*, Cetis 2002, f. 31.

⁸⁹ *Në kishë*, po aty, f. 92.

⁹⁰ *Zoti të dhashtë*, po aty, f. 100.

⁹¹ *Të fala nga fshati*, po aty, f. 220.

qiell, shejtnue qoftë emni yt, të mbrijë mbretnimi yt, të bahet vullneti yt sikur në qiell dhe në tokë”⁹².

- *Në kishë*: “Vërtet, me të vërtetë po ju tham ...”⁹³ - sintagmë paraprijëse tipike e predikimeve të Jesus Krishtit.

- *Vrasja e trumcakut*: “Hipoteza dhe andrrash. Miliona vjetësh dhe një fjalë goje, si për shembull: “... të bahet dritë! Dhe drita u ba!”⁹⁴.

Në një formë të dytë teksti biblik-ungjillor vjen i pranishëm në veprën e Migjenit në *shkallë sintagmatike*:

- *Tragjedi apo komedi*: *Te Deum majestoso, Te Deum laudamus*;

- *Moll’ e ndalueme*: “I undshëm e zhelemel ec ngadalë përbri dyqaneve plot “molla të ndalueme” (prallë biblike”);

- *Kanga e të burgosunit*: “Nëpër hekra **b** të dritores seme / shof qiellën të coptueme në katërdhetë copë”⁹⁵.

- *Trajtat e Mbinjeriut*: “Shpirt i kryqzuem, marrzi e vulosun / ... / Një agim i pritun, dit’ e parathanun”⁹⁶.

- *Frymëzim i pafat*: “O njerëz të bimë nga far’ e ambël!”⁹⁷.

- *Sokrat i vuejtun - apo derr i kënaqun?*: “Vetë perëndia, tue i ra kokës me dorë, tha se nxanësi e kaloi mësuesin, dhe shumë-shumë u pendue se ç’shkathtësi i dha njeriut. Njeriut iu shtue vullneti për t’u praktikue në shkathtësi. -E dikush dikur tha: “Nuk mundet me kenë sherbëtori ma i madh se zotnia, as nxanësi ma i madh se mësuesi i tij”. O, vall, ç’ironi!”⁹⁸.

- *Tragjedi apo komedi?*: “Shejti dhe Katili arrijtën shprehjen e ... tragjedisë apo komedisë së vet”⁹⁹.

- *Tragjedi apo komedi?*: “E Mira, e Keqja, Perëndia, prej territ, nëpër

⁹² ... *Bukën tonë të përditshme falna sot*, po aty, f. 175. Kjo përshtatje e lutjes *Ati ynë* në një tekst letrar prej Migjenit mund të numërohet si një prej mbi 100 varianteve të shprehura shqip të *Pater Noster* në gjuhën shqipe, duke filluar prej “*Mesharit*” të Gjon Buzukut. Të njëjtën gjë pati bërë dhe Mitrush KUTELI me *Canticum canticorum* në *E madhe është gjëmë e mëkatit*.

⁹³ *Në kishë*, po aty, f. 93.

⁹⁴ *Vetvrasja e trumcakut*, po aty, f. 96. Khs: “Ai tha: “*Le të bëhet dritë*” dhe u bë dritë” (*Të Bërëtë* 1:3).

⁹⁵ *Kanga e të burgosunit*, po aty, f. 26.

⁹⁶ *Trajtat e Mbinjeriut*, po aty, f. 29.

⁹⁷ *Frymëzim i pafat*, po aty, f. 67.

⁹⁸ *Sokrat i vuejtun - apo derr i kënaqun*, po aty, f. 75.

⁹⁹ *Tragjedi apo komedi?*, po aty, f. 79.

njeriun, erdhën në dritë, edhe nëpër njeriun kanë me u zhdukë në terr”¹⁰⁰.

- *Në kishë*: “Kur u zhduk kryet, lypsi vazhdoi t’i lëmojë gjashtë lekët dhe t’androjë ma tepër dhe të *knaqet ma tepër se tradhtari Iskariot me tridhetë q’i fitoi, kur e shiti Mësuesin e vet dhe t’atij padres*”¹⁰¹.

Në një formë të tretë prania e tekstit biblik-ungjillor, në formën e paratekstit, gjenotekstit dhe në formë më të rregullt *si tekst perifrastik*, paraqitet si cilësi përbashkuese e veprës së tij:

- *Vetmia*: “*Së paku të më mallkojnë / - I mallkuem! / Së paku të më urojnë / - I uruem!*”¹⁰².

- *Ngjarje pa lëvizje*: “*Ai njeri, që aq e mundon at kafshë, a meriton t’i hudhen në shpinë të gjithë ata gurë që janë barra e kalit të mjerë? ... Unë shikojshe njeriun, kalin, karrocën, të gjithë të kryqzuem në një gjendje mundimi e dhimbjeje të jashtëzakonshme*”¹⁰³.

- *Idhujt pa krena*: “*U tret pluhuni i idhujve q’u shembën krejt, dhe s’u mbet fara, e idhujt që mbetën pa krena qendrojnë si dëshmorët e shëmtuem e një jetës së përndueme*”¹⁰⁴.

- *Urime për 1937*: “*... gjëmojnë njerëzit nën barrën e kryqave të vet tue shkue në Golgotha*”¹⁰⁵.

- *Urime për 1937*: “*Në rasë se tryeza e shkrimit të çalon, ti qeshu. Në rasë se e vetmja karrigë që ke në shtëpi asht e shpueme dhe s’ke ku të rrish, ti qeshu. Në rast se s’ke zjarrm e ke të ftoftë, po, ti, qeshu. Në rasë se ndonjë ditë, ashtu kot, të mungon edhe buka, ti merre për lojë, për shaka, dhe qeshu, qeshu*”¹⁰⁶.

- *Të korrumat*: “*Kështu dy ditë. Të tretën ditë prap një diell mrekullisht i bukur!*”¹⁰⁷.

- *Të korrumat*: “*Ç’asht kjo? Na këtë farë s’e kemi mbjellë ... E pra, e*

¹⁰⁰ *Tragjedi apo komedi?*, po aty, f. 80.

¹⁰¹ *Në kishë*, po aty, f. 93.

¹⁰² *Vetmia*, po aty, f. 69.

¹⁰³ *Ngjarje pa lëvizje*, po aty, f. 95.

¹⁰⁴ *Idhujt pa krena*, po aty, f. 107. Krhs tekstin referencial biblik: “*Do të shkatërroj idhujt dhe do t’i zhduk perënditë e rreme nga Nofi; nuk do të ketë më princ nga vendi i Egjiptit dhe do të kall frikën në vendin e Egjiptit*”, Libri i Ezekielit, 30:13.

¹⁰⁵ *Urime për 1937*, po aty, f. 113.

¹⁰⁶ *Urime për 1937*, po aty, f. 114.

¹⁰⁷ *Të korrumat*, po aty, f. 117.

thanun asht: “Çfarë do të mbjellish, të tillë (lashtë) do të korrish”¹⁰⁸.

- Studenti në shtëpi: “Qe një rasë ku duhet me tregue fuqin e ndërgjegjes, të mendimit dhe të dashnis për me shpëtue diçka nga zakonet fatale”¹⁰⁹.

- Husarët n’Adriatik: “O det i bekuem, sa i madhnueshëm je, sa e madhe asht mîrsija jote, ti lidh të gjitha qytetet e botës, bashkon të dashunit, miqtë dhe armiqtë”¹¹⁰.

Veç këtyre formave, dëshmohet prania e tekstit biblik-ungjillor në formën e informacionit historik, të figurshmërisë letrare e gjuhësore, deri në shkallën e gjedhes së figurës letrare.

7. Në shkallën e lexicon-it gjuhësor:

Në nivelin e izoglosave dhe të fjalëve-çelësa teksti biblik është dhe më i pranishëm dhe ka rolin e indit në gjithë veprën e Migjenit: pamjet e mesianizmit, trajtat e mbinjeriut, idealizimi i shpëtuesit të botës dhe përgjithësisht i misionit të njeridashës (“Shkodra, Ballkani, Europa, bota mbarë asht e sëmurë prej këtij akrobacioni dallëndyshuer”)¹¹¹, kulla e Babelit, dy natyrat e Krishtit (njerëzore dhe hyjnore, siç debatohej në koncilet e para të krishterimit legjitim), dy pamjet e Milloshit, ferri ngushëllues (“pash më pash due me i ra ferrit”), “historia e njenës nga ato” dhe debati i gjatë në krishterimin e hershëm se nga ç’mëkat e kishte çliruar Jesui Maria Magdalenën (nga prostitucioni apo nga gjykimi i padrejtë)¹¹². Mund të provohet se kufizat biblike dhe ungjillore gjenden në veprën e Migjenit deri në shkallën e citimit protokollar, njësoj si në shkrimin akademik.

Pothuajse nuk ka poezi a prozë të Migjenit ku të mos jetë i pranishëm leksiku përveçues i ligjërimit ungjillor dhe liturgjik. Në këtë rast merret në vlerësim vetëm leksiku libror i këtyre ligjërimeve, kurse leksiku popullor, i përftuar në rrugë gojore, nuk është veçuar. Dhe prapë se prapë kjo mund të jetë prerja më ndërthurëse e veprës së Migjenit me tekstin biblik-ungjillor:

¹⁰⁸ *Të korrurat*, po aty, f. 118.

¹⁰⁹ *Studenti në shtëpi*, po aty, f. 134-135.

¹¹⁰ *Husarët n’Adriatik*, po aty, f. 191.

¹¹¹ MIGJENI - *Vepra*, skica *Të fala nga fshati*, Cetis 2002, f. 220.

¹¹² Shih: *Shkrimet e krishtere greke*, Shtojcë, f. 415-416.

Teksti biblik-ungjillor si citim (në shkallën e protokollit), si terminologji, si leksik, në nivelin e sintagmës.	Poezia / skica ku gjendet tek Migjeni
<i>Kulla e Babilonit</i> - (“për me ndërtue Kullën e Babilonit ”)	<i>Parathana e parathanieve</i>
<i>Shejtni/shenjtim</i> (“që plakun e lamë në “shenjtinë” e tij”)	<i>Na t’birt e shekullit të ri</i>
<i>Satan/satanik</i> (“e gota e turbullt, gota satanike ”)	<i>Poema e mjerimit</i>
<i>Farisejt</i> (“të cilt në mënyrë pompoze porsi farisejt ”)	<i>Poema e mjerimit</i>
<i>Blasfemi, shejtni, lutje, zhgun</i> (shkëlqen shejtnia mbi zhguna)	<i>Blasfemi</i>
<i>Kryqzuem</i> (“Hekrat e kryqzuem dhe ndërgjegj’ e eme”)	<i>Kanga e të burgosunit</i>
<i>Kryqzuem</i> (“ Shpirt i kryqzuem , marrzi e vulosun”)	<i>Trajtat e Mbinjeriut</i>
<i>Parathanun</i> (“një agim i pritun, dit’ e parathanun ”)	<i>Trajtat e Mbinjeriut</i>
<i>Shpëtim</i> (se nesër do vdesin ... Vall! A ka shpëtim ndokund?!)	<i>Vjeshta në parakalim</i>
<i>Kalesë</i> (pashka, kalimi) (“ma la der’ vonë kujtimin, kujtimin e ftoftë të kalesës ”) ¹¹³	<i>Kanga skandaloze</i>
<i>Ferri</i> (... pash më pash t’i bij ferrit)	<i>Kanga skandaloze</i>
<i>Rruzullimi</i> (“veton rreth rruzullimit ”)	<i>Rezignata</i>
<i>Lter</i> (“Vall, shpirt i therun ... fli e një lterit të ri”)	<i>Shpirt i ri</i>
<i>Pëllumb</i> (“O shpirt! Pëllumb i gjorë ...”)	<i>Shpirt i ri</i>
<i>Apoteozë; Tymnore (temjan)</i> (“n’apoteozën e hekurit; shpirtënt përshkohen në tymnore ”)	<i>Kangët e Përndimit</i>
<i>Shuguruem</i> (“bajnë të fala dhe me thanë vendeve të shuguruem”)	<i>Shpirtënt shtegtarë</i>
<i>Credo</i> (“besojma” e krishterimit): (“e me një credo gëzojnë qiellën me çagjë e të tymuem”)	<i>Shpirtënt shtegtarë</i>
<i>Purpure, purpuer; Apoteozë</i> (“rrezash purpure dhe jetëdhurimi”)	<i>Sonet pranveruer</i>
<i>Purpuer</i> (“me kuqlim e tiza purpuer ”)	<i>Z. B.</i>
<i>Parathanse</i> (“një heshtje parathanse zemrën don të më përpijë”)	<i>Një natë</i>
<i>Lutje, lutem, perëndi</i> (“ Të lutem, o perëndi ”)	<i>Lutje</i>
<i>Ringjallje</i> (“... po, nji ringjallje mbi të vjetra kalbsinat”)	<i>Hidhet e përhidhet</i>
<i>I mallkuem</i> (“Së paku të më shajnë: i mallkuem ”)	<i>Vetmia</i>
<i>Te Deum majestoso</i> <i>Te Deum laudamus</i>	<i>Tragjedi apo komedi</i>

¹¹³ Pashka, kalimi i zemërimit të Hyjit për popullin e vet të lënduar, një prej dhjetë provave se *Unë jam Zoti yt*. Shih ndër të tjera: Sh. SINANI, *Kodikët e Shqipërisë në Kujtesën e Botës*, Tiranë 2010, f. 601.

Moll' e ndalueme (“I undshëm e zheleml ec ngadalë përbri dyqaneve plot “molla të ndalueme” (prallë biblike”).	Moll' e ndalueme
Të dëbuemit: (“Eni tek unë ju të dëbuemët e të përbuzunit e këtij shekulli, ka thanë dikur zot’ i kësaj kishe , se tek unë do të gjeni prehje”).	Në kishë
Testament (“ Testamenti i dhimave të tij”).	Vetvrasja e trumcakut
Zoti (“ Zoti që kujdeset për zoqtë e qiellës , s’ka me i lanë njerëzit të vdesin nga uja”).	Zoti të dhashtë
Gjysmë njeriu, gjysmë zotniu (“Mezi u gjet një gjysmë njeriu, gjysmë zotniu ”).	Programi i një reviste
Idhujt (“Duen t’adhurojnë, po çka të ardhurojnë? Idhujt pa krena? ”).	Idhujt pa krena
Apoteozë (“Në shekullin e njëzetë s’ka apoteoza perëndish ”).	Legjenda e misrit
Krishtlindje, kryqat, Golgotha (“... gjëmojnë njerëzit nën barrën e krygave të vet tue shkue në Goglotha ”).	Urime për 1937
Anatema (“ Anatema, mallkime, alarme ”).	Gogoli
Fara, farëhedhësi (“ Çfarë fare do të mbjellish, të tillë (lashtë) do të korrish”).	Të korrurat
Apokaliptik (“si me dashtë me marrë me të mirë një përbindësh apokaliptik ”).	Të korrurat
Prostitutë, aureolë	Historia e njenës nga ato
Shpëtim (salvim): (“... mbytej e shpirti i tij bërtiste: aman, shpëtim!”).	Pak poezi
Ati ynë, uratë (“ Ati ynë, bukën e bardhë na fal ... Uuu, kjo prallë asht shumë e gjatë... Sa mirë e di Zefi uratën? ”).	Bukën tonë të përditshme falnae sot
Besimi, mbinjeriu, Mesia: (“... pesimist nuk jam, se besoj në një fuqi të njeriut, besoj në mbinjeriun! (tue mendue kështu në vesh më tingëllojnë fjalët e dikujt: “ Besimi yt të shpëtoi ”).	Të fala nga fshati
Amshimi: “Ç’janë një milion vjet para eternitas...”	Vetvrasja e trumcakut ¹¹⁴

Në Vargjet e lira dhe prozat e Migjenit leksikoni biblik e ungjillor përmban veç tjerash: anatema, apoteoza, *Ati ynë*, bekimet, biblike (prallë), blasfemia, breznitë (“brez mbas brezi/ sternipa donë me mbetë”), credo (besojma), drita (*Të bëhet dritë, Unë jam drita e Botës* -

¹¹⁴ Prozë e shkurtër në dorëshkrim, ruhet në Muzeun Historik të Shkodrës (botuar dhe në: MIGJENI, *Veptra*, f. 195).

Ἐγὼ εἶναι φωτίας τοῦ Κοσμοῦ)¹¹⁵ buka e shenjtë, burgu i shpirtit (“*unë, djepi juej, e ndoshta vorri juej*”), dreqnit (satanai, katili), e përlyeme, eternitas, farisejt, fli, flijimi (“*me u ba fli*”), grigjë, hyjnore, idhujt e remë (“*idhujt pa krena*”), kryqat, kryqzim, kryqzuem, Këshndella, kensi, kushtimi (dedikimi), kanga e re (krhs *Besëlidhja e Re*), lajmi i mirë (“*lajmi se do të shpërndahej misër ...*” - krhs.: “εὐαγγέλιον”), lajmi i keq, lteri, lumnitë, mallkimet, misri dhe “*mannah*”, mni, molla e ndalueme, oratoria (lutjet), parathana, parathania, priftënt, parajsa, prrallë (rasë) – shembëlltÿrë, përdëllimi, përunjësia, purpuer, qiellore, perëndore, ringjallja (“*kangët e ringjalljes*”), ragjë (raso, zhgun), shkëndija, shpëtimi/salvimi, shugurim, shuguruem, stërzane (virgjine), tymnore (themjan), testament, tempujt, virgjineshë, uratë, urdhëresat, yjet, urtësitë.

Këto janë vetëm disa prej këtyre **rrathëve gjuhësorë** që vijnë prej tekstit biblik dhe kodifikojnë poezinë dhe prozën e Migjenit.

Nuk janë të pakta rastet kur veprën e Migjenit e ndërmjetëson filozofia bashkëkohore europiane, sidomos ajo gjermane: F. Nietzsche¹¹⁶, A. Schopenhauer dhe të tjerë. Ndodh në poezinë e Migjenit që autori i tekstit të parë të mos përmendet, si:

“*Pak dritë, pak dritë, o mik, o shok, o vlla*”,

varg që në gjermanisht do të përkthehej me fjalët e njohura të *Goethe*-s:

“*Mehr Licht! Mehr Licht! Mein Freund, mein Bruder!*”¹¹⁷

Shpesh ngjan se Migjeni, përmes ligjërimit liturgjik, më shumë synon ta fshehë apo ta shmangë vetveten, se ta zbulojë.

Migjeni u pohua si poet “*jashtë rendit*”: përtej kufijve të shkollave, përtej preferencave të kohëve, përtej receptimeve të shmangura. Botimi i parë i *Vargjeve të lira* nuk qarkulloi (ende nuk është sqaruar nëse e ndaloi censura apo ishte vetë autori që e ndaloi); një botim i vitit 1956 gjithashtu u ndalua; thuajse në të gjitha botimet janë bërë redaktime dhe po ashtu përpjekje për “*disiplimin ideologjik*” e të kuptimit të kumteve. Por Migjeni është ai që gjendet përtej prizmit: të gjitha mospërputhjet e mospajtimet vijnë prej universalitetit të veprës së tij, por më shumë prej prizmit që studiuesit vendosin shpesh midis saj dhe vetes.

¹¹⁵ Krhs *Ungjilli sipas Mateut*, 5:14: *Unë jam drita e botës*.

¹¹⁶ Për një krahasim më të hollësishëm ndërtekstor me veprën e F. NIETZSCHE-s shih: *The Death of God*, në: *The Gay Science*, Cambridge University Press 2002, p. 109-110, 119-120, 199-201.

¹¹⁷ Me të njëjtën thirrje do të mbyllej jeta e argjipeshkvit Vinçenc Prennushi më 1947.

Në gjithë letërsinë e Migjenit ka dhimbje njerëzore dhe pafuqi për ndryshimin e fatit të botës. Por jo në formën e një hetimi filozofik, më shumë në frymën e atij grupimi shkrimtarësh që u quajtën *Lost Generation*¹¹⁸, për shkak se pikëllimi botëror ishte shprehur në humbjen e trishtueshme të përmasës së të ardhmes. Përmbysja e estetikës klasike të shkrimtarëve realistë, romantikë, sentimentalistë, simbolistë, shqiptarë e europianë, sipas shumë gjasash erdhi prej një frymëzimi që humbjen e shihte tek vetja dhe shpëtimin diku jashtë, në mënyrë të papërcaktuar, ashtu si “*brezi i humbur*”. F. Nietzsche dhe Schopenhauer janë referenca të drejtpërdrejta në tekstin e Migjenit; Dostojevski, A. Rimbaud¹¹⁹, Th. Carlyle dhe G. Leopardi janë përmendur shumë herët si autorë me bashkëprejje poetike me të¹²⁰. Ndërkaq shkrimtari serb Borisav Stanković me *Nečista krv* dhe kroati Miroslav Krleža janë përafuar në dy dekadat e fundme, ndonëse për një problematikë të “*komunikim-korrespondimit të veprës së Migjenit me ngjarjet letrare të kohës në Ballkan e në Europë*” ishte folur shumë më parë¹²¹.

Në vend të përfundimeve

Vargjet e lira dhe prozat e Migjenit kanë simetri të dukshme me tekstin biblik-ungjillor, i njohur si *Great Code* apo *Code of Codes* për gjithë historinë e letërsisë botërore¹²². Kushtëzimi i veprës së Migjenit me tekstin biblik, përveçse në pamjet e mesianizmit, mund të verifikohet në disa shkallë: *1. Në shkallën strukturore*: njësitë përbërëse të *Vargjeve të lira* dhe analogjia me “*katërlibërshin*” - “*tetravangjel*”, katër Ungjijtë në *Besëlidhjen e Re*. Sikurse dihet, është në traditën e *Shkrimeve* numërtimi i librave dhe emërtimi i tyre sipas njërive nënstrukturore (*Pentateuqe – Pesëlibërshi, Libri i Moisiut në Besëlidhjen e Vjetër*). Poezia e vetme jashtë cikleve që kishte botimi i parë (1936) kanë analogjitë e tyre me pjesë gjegjëse të

¹¹⁸ “*You are all Lost Generation*”. Kjo fjali, thënë E. Hemingway-t prej Gertrude Stein në vitin 1924, më pas u bë kryeshenja e brezit që e kishte humbur besimin tek bota dhe u përpoq të mbronte njerëzoren (pikëllimin, dëshpërimin, dhimbjen, humbjen), në kohën kur njeriu nisi të bëhej i padashur në letërsi.

¹¹⁹ Mensur RAIFI, art. cit., f. 221-222.

¹²⁰ Q. Draçini, *Vepra poetike e Migjenit*, në *Fryma*, 1944/3-4.

¹²¹ Shih Ali ALIU, art. cit., f. 29.

¹²² Northrop FRYE, *The Great Code: The Bible and Literature*, New York, Harcourt 1982; Idem, *The Secular Scripture: A Study of the Structure of Romance*, Harvard University Press 1976.

Shkrimeve: *Parathënia e parathënieve*, gabimisht e interpretuar si *Preambole dei preamboli*, në fakt ka ndërtimin e vet paralel me *Canticum canticorum* dhe në tërësi është krijuar si model ligjërimi profetik, duke ruajtur kuptimin *Profecia e profecive*. 2. *Në shkallën konceptuale*: në radhë të parë cilësia e vërtetueshme e karakterit *sinoptik* të *Vargjeve të lira* dhe e prozave, krejt analoge me karakterin *sinoptik* të tre ungjijve *sinoptikë* (sipas Matthew-t, sipas Mark-ut dhe sipas Luce-s. 3. *Në shkallën e mitit* (mesianizmi, *Shkëndija*). 4. *Në shkallën e prozodisë dhe të metrikës*: vargu *heterometrik*, apo vargu i lirë, për të cilin është diskutuar aq shumë, vjen në letërsinë shqipe jo si një befas, por prej një modeli zanafillës, si ai i *Librit të Psalmeve* dhe i *Librit të Proverbave*. 5. *Në shkallën e pragmatikës dhe sintagmatikës*: kjo mund të provohet prej vendit që ka ligjërimimi me shembëllyra, parabola, “*pralla biblike*”. Shembëllyra e frutit të ndaluar, e djalit plangprishës, e Shën Maria Magdalenës (“*la prostitution sacre*”, Bodeaulaire), janë vetëm disa prej parabolave të tij. 6. *Në shkallën e ndërtektit* (tekstit të brendashkruar në formë të referuar, tekstit të brendashkruar në formë sintagmatike, tekstit të brendashkruar në formë perifrastike - të parafrazuar). 7. *Në shkallën e motiveve*. 8. *Në shkallën e gjedhes figurative*. 9. *Në shkallën e një lexicon-i gjuhësor*: mbahet në vlerësim vetëm ajo pjesë e leksikut që vjen prej kulturës librore, duke mos vështruar si objekt dhe leksikon liturgjik-kishtar të përfutur në formën e ligjërimimit gojor në shqipen popullore. *Vargjet e lira* të Migjenit kanë “*të ardhmen udhëruese*” të ligjëtimeve biblike-ungjillore me karakter parathënës. Pyetja e tij “*Perëndi, ku je*”, nuk është një pyetje Krisht-mohuese, si pyetja e Nietzsche-s “*Ku është zhdukur Zoti*”. Mesia i Migjenit, ndryshe prej atij të Nolit, që e kërkon Shpëtimtarin dhe misionarin brenda vetes, të sjell ndër mend anën tjetër të Krishtit, Shelbuesin, të flijuarin për hir të amnistimit të njerëzimit nga e keqja. Heroi i Migjenit, edhe në pamjet e mesianizmit, është kryesisht hero i dobësisë. Kjo të kujton dy sprovat më të hershme të tij: *Dy natyrat e Krishtit*, si hartim shkollor në seminarin teologjik në Manastir dhe *Dy natyrat e Milloshit*, skicë letrare intime e së njëjtës kohë.

Bibliografi

- ALIU, A.: *Rreth kritikës mbi veprën e Migjenit*, në *Migjeni - Vepra*, vëllimi 4, botimet *Rilindja*, Prishtinë 1980.
- AVDULLAJ, V.: *Miti i Mesisë në një lexim të ri të poezisë Shkëndija të Migjenit*, në *Haemus plus*, 2012/2.

- BAUDELAIRE, Ch.: *Mon coeur mis à nu: journal intime*, Paris 1887.
- BEJKO, S.: *Migjeni midis niçeanizmit dhe mesianizmit*, në *Temp.*, nr. 43, 9 tetor 2005.
- DRAÇINI, Q. *Vepra poetike e Migjenit*, në *Fryma*, 1944/3-4.
- ELSIE, R.: *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1997.
- FRYE, N.: *The Great Code: The Bible and Literature*, New York, Harcourt 1982.
- FRYE, N.: *The Secular Scripture: A Study of the Structure of Romance*, Harvard University Press 1976.
- HAMITI, S.: *Letërsia moderne shqipe*, botim i UET, 2010.
- JORGO, K.: *Identiteti i qëndresës së panjohur: rasti Shqipëria: letërsia shqiptare, mesianizmi*, në *Tempulli*, nr. 2/2000.
- JORGO, K.: *Letërsia (ç)mitizuese: parabola e djalit plangprishës në poezinë Shkëndija të Migjenit*.
- JORGO, K.: *Për historinë e tekstit të veprës Vargje të lira të Migjenit*, në *Studime filologjike*, nr. 1-4/1997.
- KADARE, I.: *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, KADARE: *Vepra*, 9, Tiranë 2009.
- Κασκανταμη, Βασιλίου: Θεοφανής Ποπα-ενας συγχρονος ιεραποστολος, Αθηνα, s. a.
- KODRA, J.: *Migjeni, Poesie e prose*, Tiranë 1962.
- KOLIQI, E.: *Dy shkollat letrare shkodrane, Shêjzat*, nr. 9-10-11-12.
- KOLIQI, E.: *Migjeni dhe unë*, në *Shêjzat*, nr. 1-10/1974.
- LAMBERTZ, M. në veprën *Zwischen Drin und Vojusa: Märchen aus Albanien - Midis Drinit dhe Vjosës: përralla nga Shqipëria*, Leipzig 1922.
- LUARASI, S.: *Jeta, gusht 1956*, në *Migjeni, Vepra*, Cetis 2002.
- MIGJENI: *Vepra*, Cetis 2002.
- MIGJENI: *Vepra, vëllimi 1-4, Rilindja*, Prishtinë 1980.
- NIETZSCHE, F.: *Die fröhliche Wissenschaft*, Leipzig 1887.
- NIETZSCHE, F.: *The Gay Science, Cambridge University Press 2002.***
- PIPA, A.: *Miti i Perëndimit në poezinë e Migjenit*, në *Për Migjenin: tri esse*, Tiranë 2006.
- PIPA, A.: *Për një kritikë letrare*, botuar në revistën *Kritika*, viti 1944.
- QOSJA, R.: *Milosh Gjergj Nikolla - Migjeni (1911-1938)*, në *Migjeni - Veprat*, vëllimi 4, botimet Rilindja 1980.
- RAIFI, M.: *Lasgushi, Noli dhe Migjeni*, Prishtinë 1986.
- RAIFI, M.: *Madhështia si anti-traumë*, në *Migjeni - Vepra*, v. 4, botimet Rilindja, Prishtinë 1980.
- RUGOVA, I.: *Katër urata origjinale të Buzukut*, në *Buzuku*, nr. 14/2004.
- SINANI, Sh.: *'Vargjet e lira' dhe Shkrimet*, në *Art & Trashëgimi*, nr. 3/2012.
- SINANI, Sh.: *Kodikët e Shqipërisë në Kujtesën e Botës*, Tiranë 2010.
- SINANI, Sh.: *Migjeni italisht nga Jolanda Kodra*, në *Shqip*, 20 maj 2010.
- SINANI, Sh.: *Miti i idesë në vend të kultit të heroit*, në *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Tiranë 2010.
- SHEHRI, Dh.: *Midis malit dhe detit*, Tiranë 2006.
- Shkrimet e krishtere greke*, s.a., s.l.
- Shkrimtarë shqiptarë*, pjesa I, Tiranë 1941.
- SHUTERIQI, Dh. S.: *Migjeni*, në *Migjeni - Vepra*, vëllimi 4, botimet Rilindja, 1980.

Shaban SINANI, Center for Albanian Studies, Tirana,

THE BIBLIC TEXT IN THE WORKS OF MIGJENI

Summary

The *Free Verses* and Migjeni's prose have a visible symmetry with biblical-evangelical text known as *Great Code* or *Code of Codes* throughout the history of the world literature. The correlation of Migjeni's work with the biblical text, except for the messianic views, can be proved in several levels:

1. Structural level: the contents of *Free Verses* and the analogy with four books of the Bible, *Four Gospels* in *The New Testament*. Namely, it is a tradition in *Writings* to enumerate books and denominate them according to sub-structural units (*Pentateuch, the book of Moses in the Old Testament*). The only poetry that does not fill in the pattern of this cycle of the first edition (1936) has analogies with respective parts of *Writings: Preamble to Preamble*, interpreted wrongly as *Preambole dei preamboli*, in fact has a parallel construction with *Canticum canticorum* and it has been created entirely as a prophetic lecturing model, keeping the meaning *The Prophecy of Prophecies*. 2. Conceptual level: first of all, the verifiable quality of synoptic character of *The Free Verses* and prose, fully analogous with the synoptic character of *Three Gospels* (according to Matthew, Marc and Luke).

3. Mythical level (Messianism, *Spark*). 4. Prosody and metrical level: heterometric verse or free verse, so considerably discussed, comes into Albanian literature not as a surprise but from an original model such as the one of *the Book of Psalms* and *the Book of Proverbs*. 5. The pragmatism and syntagmatic level: this can be proved by focusing on lecturing with images, parables, and biblical fairy tales. The images of the forbidden fruit, the dissolute boy, St. Mary Magdalene (*la prostitution sacre, Bodeaulaire*) are only some of parables. 6. The subtext level (intra written text in a referred form, intra written text in a syntagmatic form, intra written text in the paraphrased-paraphrased form). 7. Motive level. 8. The figurative modeling level. 9. The linguistic-lexical level: only that part of the lexicon which comes from books is kept, without considering as an object the liturgical-church lexicon that became part of the common Albania vernacular.

Migjeni's *Free Verses* has imposing future tense of biblical-evangelical lecturing with predictive character. His question, God, where are you?, is not a

question denying the existence of Christ in the way of Nietzsche's question Where did the God disappear? Migjeni's messiah, unlike that of Noli's who calls for a savior and missionary within himself, reminds us of the other part of the Christ, that of the one who sacrifices himself to save the mankind from the evil. Migjeni's hero, even in the views of messianism, is mainly a hero of feebleness. This reminds us of two of his early challenging works: Two natures of the Christ, an essay from the school times at the theological school in Manastir, and Two natures of Millosh, an intimate literary essay from the same time.

Dhurata SHEHRI, Tiranë

KRITIKA LETRARE DHE TERMINOLOGJIA

KDU 821.18.09

Terminologjia e studimit të letërsisë është një nga ato domene të terminologjisë që ka vuajtur më shumë nga ideologjizimi. Kjo nuk është as e re e as e paargumentuar, mjafton të kujtojmë se letërsia ka qenë për një periudhë të gjatë pjesë e propagandës ideologjike, e për rrjedhojë edhe metagjuha që e përshkruan, karakterizon apo vlerëson do t'i mbante gjurmët e saj.

Përtej Shqipërisë, kritika letrare, këtë shekull, është modeluar pak a shumë rreth disa poleve që kanë përcaktuar edhe terminologjinë themelore të kritikës, analizës dhe studimit të letërsisë: e kemi fjalën për

- * autorin,
- * kanonin,
- * komparativizmin,
- * gjininë letrare,
- * interpretimin,
- * intertekstualitetin,
- * lexuesin,
- * historinë e letërsisë,
- * temën dhe
- * tekstin.

Nga këto bërthama konceptesh, gjegjëse termash, në fjalorët shqiptarë të termave letrarë koncepti dhe termi i autorit, me të gjitha konotacionet që nga “lindja” deri tek “vdekja” mungojnë, për t'u zëvendësuar nga shkrimtari (më shumë si shkrimtaruc); koncepti i kanonit mungon, por ai është i pranishëm thjeshtë në mënyrë performative; komparativizmi paraqitet si

“metodë historike-krahasonjese e shkencës së letërsisë borgjeze ...që përpiket të bindë lexonjësin për diçka shumë të gabuar, d. m.th. se krijimtaria letrare artistike gjoja nuk e pasqyron jetën por nuk është gjë tjetër veçse një përsëritje e vazhduar e disa mjeteve letrare të cilat vetëm kombinohen në mënyra të ndryshme”;

teksti është vetëm “Fjalët autentike të autorit, vepra e tij në dorëshkrim ose e botuar”; tema është

“sfera e fenomeneve të jetës që shkrimtari zgjedh, paraqet në veprën e vet dhe që ndriçon nga pozita të caktuara ideo-politike”; për të mbërritur tek konceptet art, figurë dhe kritikë, të cilin po e citoj: “kritikë= Vepra letrare, artikuj dhe shënime që i kushtohen të çmuarit, analizës dhe shpjegimit të veprave letrare nga pikëpamja e interesave të jetës dhe të kohës”.

Përveç mungesë së koncepteve të themelore të kritikës letrare të një shekulli, në fjalorët terminologjikë të letërsisë vërehet sidomos përmasa ideologjike e pjesës më të madhe të termave vlerësues (gjukses) të letërsisë. Përmasa ideologjike është dominante në terminologjinë e letërsisë qa sa mund të flasim për terminologji ideologjike.

Në këtë artikull, përmbledhtazi, terminologjinë ideologjike do ta gruponim në këtë mënyrë:

- * terma letrarë me kuptim të deformuar ideologjikisht
- * leksik jo letrar shndërruar në terma letrarë ideologjikë
- * terma letrarë të formuar me para apo prapashtesim ideologjik

Në grupin e parë do të përfshinim ato ndërkombëtarizma që janë deformuar ideologjikisht të tilla si:

- Dadaizëm**
- Dekadentizëm**
- Ekspresionizëm**
- Estetizëm**
- Formalizëm**
- Impresionizëm**
- Kozmopolitizëm**
- Kubizëm**
- Modernizëm**
- Neoklasicizëm** etj

Po japim si shembull përkufizimin në fjalorin e Gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980 për termin

DEKADENTIZËM *m.*

Tërësi drejtimesh letrare e artistike borgjeze e revizioniste, që janë kundër realizmit e i vënë vetes si qëllim kryesor të pasqyrojnë bo-

tën e ngushtë të individit, që mohojnë tërësisht trashëgimin kulturor e artistik, mbrojnë formalizmin dhe predikojnë individualizmin borgjez, pesimizmin e shturjen morale, për t'i larguar masat punonjëse nga lufta klasore e çlirimtare. Dekadentizmi i shekullit XIX (XX).

Dallimi në kohë mes citimit të mësipërm (1965) dhe të mëposhtmit (1990) është shumë i vogël edhe në përdorimin e termit simbolizëm, të ngjashëm kuptimisht, por edhe ideologjikisht me dekadentizmin:

“Simbolizmi ndikoi mbi dadaizmin dhe surrelizmin... E përbashkëta e këtyre drejtimeve artistike është subjektivizmi, RRE-ZIKU i të cilit lind edhe nga krijimi i simboleve të reja që ndërtohen mbi bazën e shoqërimit të përfytyrimeve të largëta që nuk perceptohen dot.”

Shpjegimin shkencor të kësaj dukurie, pra të deformimit ideologjik të termave ndërkombëtarë e gjejmë të shprehur qartë nga studiuesi Samara:

“Ashtu sikurse krijimi i fjalëve të reja dhe zëvendësimi i një termi me një term të ri, edhe rikuptimësimet e modifikimet e karakterit konotativ në këtë leksik lidhen me faktorë gjuhësorë dhe ideologjikë, **sepse termat ose fjalët e leksikut politiko-shoqëror nuk janë thjeshtë shenjues të inventarit ontologjik, por emërtues të koncepteve me karakter ideologjik**”. (boldi i yni)

Të njëjtën procedurë e shpjegon edhe studiuesi F. Leka kur shprehet se:

“Termet e shkencave shoqërore kanë një karakter më të theksuar botëkuptimor e ideologjik, prandaj këtu dalin disa probleme lidhur me gjetjen e barazvlerësve në gjuhët e huaja, ku mund të ketë përputhje në rrafshin gjuhësor, por mospërputhje në rrafshin e përmbajtjes. Kjo zgjidhet me shpjegime të shkurtra sqaruese të termave që lënë shteg për ndonjë paqartësi.”

E papritur nuk është përsëritja e të njëjtit përkufizim edhe në fjalorin e vitit 1984, por në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 2006.

Në grupin e dytë do të përfshijmë leksik jo letrar shndërruar në terma letrarë ideologjikë. Rruga e shndërrimit të leksikut të terminologji, është e njohur prej leksikografëve, por terminologjia politiko-shoqërore ka disa specifika që lidhen me motivimin e togfjalëshave të tillë si:

Frymë demokratike**Frymë tendencioze 16**

Gjuhë e errët

Letërsi oborrtare

Figurë negative

Hero pozitiv

Partishmëri në art

Partishmëri në letërsi

Letërsi borgjeze

Romantizmi përparimtar

Letërsi reaksionare

Letërsi demokratike etj (ku në rastin e fundit edhe termi demokratike është I deformuar ideologjikisht)

Analiza e dukurisë së pezhorativizimit ideologjik të tremave letërore mund të shihet edhe nga ana e formave, ose e mjeteve gjuhësore të përdorura për krijimin e terminologjisë. Në këtë kënd, ndjehet i fortë përdorimi i parashtesave mohuese *anti*, *kundër*, *para*, *pseudo*, apo i prapashtesave përkeqësuese *ist*, *izëm*, *izo* etj. Termat e këtij lloji do t'i përfshijmë në një **grup të tretë** dhe po japim vetëm disa terma si shembull:

Antiartistik**Pseudoklasicizëm**

Shkrimtaruc

Modernist**Dekadentist****Sentimentalist**

Antidemokratik

Antiklerikal

Pseudoshkrimtar etj

“...edhe disa ndajshtesa, si p.sh parashtesat anti-; kundër-; pseudo-; dhe prapashtesat -izëm; -ist, -izo të cilat mund të thuhet se janë specializuar tashmë për formimin e fjalëve terma që përdoren kryesisht në këtë fushë (politiko shoqërore – shën. ynë). Formimet me këto ndajshtesa përbëjnë edhe tipat më karakteristikë të fjalëve a termave të këtij leksiku; mbi 90% e fjalëve me këto ndajshtesa në FGJSSH (1980) shënojnë nocione politiko-shoqërore.”

– shprehet studiuesi Samara – por edhe leksikologu Ferdinand Leka në studimin “Aspekte të zhvillimit të fjalorit politiko-shoqëror në shtypin e luftës”.

Më konkretisht, konotacioni politik (lexo ideologjik) i mjeteve gjuhësore të përdorura për krijimin e terminologjisë përkeqësuese duket tek shembulli i mëposhtëm:

MODERNIZËM *m. art., let.*

Tërësi rrymash, drejtimesh e shkollash subjektiviste e formaliste në artin borgjez të fundit të shekullit XIX e të shekullit XX (si kubizmi, futurizmi, abstraksionizmi etj.), që i kundërvihen artit përparimtar realist, heqin dorë nga pasqyrimi i realitetit objektiv dhe nën ndikimin e ideologjisë reaksionare borgjeze, ushqejnë përbuzjen për njeriun e u shërbejnë klasave shfrytëzuese. Modernizmi në art (në pikturë, në artet e zbatuara, në letërsi, në muzikë). Shfaqje të modernizmit.

2. edhe ~MA, ~MAT. Shfaqje moderniste. (Në Fjalorin e vitit 1984 përkufizimi është i njëjtë)

MODERNIST *mb. libr.*

Që ka të bëjë me modernizmin; që mbështetet në modernizmin; që mendon e vepron sipas modernizmit; që e paraqit realitetin nga pozitativat e modernizmit. Pikëpamje (prirje) moderniste. Art modernist. Letërsi (poezi) moderniste. Pikturë (skulpturë, muzikë) moderniste. Shkrimtar (pikturor) modernist.

2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Ithtar, pasues i modernizmit. Modernistët borgjezë. (Në Fjalorin e vitit 1984 dhe në atë të vitit 2006 përkufizimi është i njëjtë, hiqet vetën sintagma: MODERNISTËT BORGJEZË në botimin e vitit 2006.)

Gjithsesi, duke qenë në fushë të termave të letërsisë, tek figurat, nëse do të rrekeshim të gjenim figurën dominante të gjithë terminologjisë letrare të përdorur për gati gjysmë shekulli në kritikën letrare në Shqipëri ajo është ANTITEZA. (figurë shumë e qartë, nëse nuk kupton njërin nga krahët e antitezës këtë ta shpjegon tjetri; siç ndodh për shembull në një term që çuditshëm ndodhet në Fjalorin e termave letrarë: **konservatorizëm**)

“si qëndrim i një njeriu që pranon gjendjen politike dhe shoqërore të prapambetur, pa u përpjekur për ta ndryshuar e përmi-

rësuar. Një njeri i tillë quhet konservator. Antonimi: revolucionar.”

Thelbi i kritikës së realizmit socialist ishte funksioni i letërsisë dhe jo letërsia. Ky është shkak që figura dominante e terminologjisë që gjykon letërsinë si funksion të marrë trajta të antonimisë: letërsi reaksionae/ përparimtare, progresiste/ regresiste, realiste/ antirealiste. Parimi i funksionalitetit dhe antonimisë është baza edhe për pranimin dhe më pas vlerësimin e letërsisë botërore

Por fjalët kanë kujtesë dhe kjo kujtesë ideologjike e tyre ruhet edhe sot, kur kanë kaluar gati 20 vjet nga rënia e ideologjisë.

Kritika sot në Shqipëri ende zotërohet pavetëdjshëm prej antinomisë dominante ideologjike, ndonëse ka rënë të paktën njëri prej krahëve që e mban në këmbë. Nëse një letërsi është e mirë apo e keqe kjo është së pari thellësisht subjektive (dhe subjektiviteti si kategori bie ndesh me antitezën dhe antoniminë).

Kritika e sotme flet gjuhën e pasardhësve të gjuhës ideologjike. Ajo i ka ende me shumicë në sasi e në peshë pezhorativët ideologjikë. Ata hasen në media e në tekste shkollorë si “të pafajshëm”, “neutralë”, si terma më shumë vlerësues se gjykues. Duke i njohur si joneutralë të paktën ne ia njohim gjuhës së kritikës pushtetin e ideologjisë.

Dhurata SHEHRI, Tirana

LITERARY CRITIQUE AND TERMINOLOGY

Summary

Actual literary critique in Albania continues to be unconsciously influenced by the dominant ideological antinomy. It speaks the language of successors of the ideological language. It has still, in both quantity and weight, abundant ideological pejoratives. One comes across such a language in the media and school texts as “innocents”, “neutral”, or the terms that are more evaluative than judgmental. Recognizing them as biased, the language of critique at least can recognize the power of ideology.

The ideological terminology treated in this paper is sorted out according to the following clustering:

- Literary terms with ideologically deformed meaning
- Nonliterary terminology transformed into ideological literary terms
- Literary terms formed by ideological prefixes or suffixes

The first group includes ideologically deformed international terms such as: Dadaism, decadency, expressionism, estheticism, formalism, impressionism, cosmopolitanism, cubism, modernism, neoclassicism etc.

The second group includes nonliterary lexicon transformed into ideological literary terms. Lexicographers know the way of the transformation of lexicon (terminology); however, the social-political terminology has some specifics related to the motivation of such phrases: democratic spirit, tendentious spirit, dark language, court literature, negative figure, positive hero, partisanship in art, partisanship in literature, bourgeois literature, progressive romanticism, reactionary literature, democratic literature etc.

An analysis of the phenomenon of ideological pejoratives literary terms can be also viewed through linguistic forms and means used for terminology creation. One can come across a considerable use of negative prefixes of the sort anti-, against- (kundër), para-, pseudo-, or deteriorating suffixes -ist, -ism, -tious (-izo) etc. Such terms fall onto the third group. Examples of such terms are: *Anti*-artistic, pseudo-classicism, hedge writer, modernist, decadent, sentimentalist, antidemocrat, anticlerical, pseudo-writer etc.

Hivzi ISLAMI, Prishtinë

LUFTA KUNDËR FAKTORIT DEMOGRAFIK SHQIPTAR SI STRATEGJI AFATGJATE E POLITIKËS SERBO-JUGOSLLAVE¹

KDU 323.28(=18:497.1)"19"
314.15:045(=18:497.1)119"

Shekulli XX ishte shekull i kthesave dhe i proceseve të mëdha progresive të njerëzimit si rezultat i zhvillimit material e mendor, i të arriturave shkencore, i industrializimit, i modernizimit të teknologjisë, i ekspansionit mjekësor e sanitar. Por ishte ky njëkohësisht edhe shekull i brutaliteteve e barbarive deri te ndërmarrjet gjenocidale në përmasa botërore (dy luftëra botërore), rajonale (konflikte e luftëra midis vendeve e popujve), nacionale (diktaturat vendore komuniste). Në përmasa rajonale sikur goditje më të mëdha pati kombi shqiptar në gjithë hapësirën e tij etnike, ku shquhet lufta institucionale serbo-jugosllave kundër faktorit demografik shqiptar në trojet etnike shqiptare jashtë Shqipërisë politike.

Ideja për grabitjen e territoreve të huaja, për shfrytëzimin e pasurive të tyre e të fuqisë punëtore dhe për ndjekjen sistematike të popujve të vegjël e të nënshtruar nga popujt e mëdhenj dhe regjimet e tyre dhe pastaj realizimi i këtyre ideve në praktikë, janë të kamotshme, por duket se në terren gjetën shprehje në mënyrën më brutale në kohën moderne dhe veçanërisht në kohën tonë. Ndërmarrjet e hapëta gjenocidale në rrafshin demografiko-territorial ndaj tyre nxitën edhe një tip krejtësisht të ri të migrimeve, me përmbajtje specifike, të ashtuquajtur “spastrim etnik”, “migrim human” apo “këmbim popullatash”. Në kuadër të krimeve kundër njerëzimit, shpërngulja e qëllimshme, e planifikuar, sistematike dhe e dhunshme e popullsisë së një etnikumi ose shfarosja e plotë apo e pjesërishtme e një grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar në sistemet juridike të shumë vendeve, duke përfshirë edhe legjislacionet e vetë vendeve që ushtrojnë ndërmarrje me karakter gjenocidi, konsiderohet si krim gjenocidal. Këtë cilë-

* Kumtesë e mbajtur më 26. 11. 2012 në Akademinë Solemne të organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

sim e gjejmë edhe në dokumentet e OKB-së.

Ndonëse këtë lloj krimi nuk e gjejmë në periudha të hershme historike, megjithatë, disa elemente si të idesë, ashtu edhe të realizimit praktik të tij i hasim herët, p. sh. që nga dyndjet e mëdha të popujve, te migrimet e karakterit invadues në kohën e sundimit të mbretërive të mëdha, çfarë ishte rasti me pushtimet e romakëve, mongolëve, avarëve, turqve, duke shkaktuar dëbime masive të popullatave autoktone dhe imigrime po ashtu masive të popullsive të pushtuesve. Ndërkaq, në kohën e re dhe më të re, me rritjen e aspiratave shtetmëdha paraqiten migrimet e pakicave të tëra etnike, madje edhe të popujve për arsye kryesisht gjeopolitike dhe politiko-fetare.

I

Që nga projekti "Naçertanije" i Ilija Garashaninit (1844), që ishte formulimi i parë i Serbisë së Madhe si ide dhe konceptcion hegjemonist, dhe veçanërisht pas Kongresit të Berlinit (1878) nuk prajtën angazhimet e regjimeve serbe për shkatërrimin e homogjenitetit etnik të tokave shqiptare dhe spastrimin etnik të tyre për kolonizimin e Kosovës me elementin sllav, për dobësimin e forcës vitale të popullatës shqiptare dhe pengimin e përtëritjes normale biologjike përmes masave të ndryshme të presionit e të dhunës deri te ndërmarrjet e hapëta gjenocidale dhe rrjedhimisht për ndërrimin e kompozicionit etnodemografik të saj.

Pas këtij Kongresi, pushteti serb, në përpjekje për ta realizuar synimin e tij të homogjemonizimit kombëtar e shtetëror serbomad, që e konsideronte si më të shenjtin, kishte formuluar qëndrimin gjenocidal e racor që sa më pak shqiptarë të mbesin në territoret e çliruara nga Turqia, aq më i madh do të jetë kontributi për shtetin dhe kush shpërngul sa më shumë shqiptarë do të ketë merita më të mëdha për atdhe. Për këtë qëllim, me dhunë dhe represalie, Serbia bëri spastrimin etnik të shqiptarëve të më se 600 fshatrave nga rrethet e Prokuples, të Vranjës, të Leskovcit e të Nishit, si dhe nga vetë qendrat e këtyre rretheve. Të dëbuarit shqiptarë, të njohur si muhaxhirë, u vendosën në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare. Këtu edhe i gjejmë fillet e spastrimeve etnike të kohës bashkëkohore në praktikë, sikundër që bëri Serbia e Millosheviqit në vitet të 90-ta të shekullit XX, kur etnikisht spastroi miliona joserbë në hapësirat e ish-Jugosllavisë.

Kështu bëri Greqia në gjysmën e parë të shekullit XX kur ndoqi qindra e mijëra turq dhe shqiptarë, qoftë dhe në kuadër të marrëveshjes së

Llozanës për këmbimin e popullatave midis saj dhe Turqisë më 1923, kur u këmbyen rreth 1,5 milion banorë; me deportimin dhe vrasjen e miliona çifutëve nga Gjermania e Hitlerit (holokausti), si dhe me shpërnguljen me dhunë apo me vullnet të më se 9 milion gjermanëve nga vendet e Evropës Lindore pas kapitullimit të nazizmit; pastaj aspiratat për konsolidimin territorial-shtetëror e politik, çfarë ndodhi me Izraelin në vitin 1948 e këndej, i cili vetëm në vitin e formimit të tij instaloi afër 1 milion çifutë dhe shpërnguli rreth 700.000 arabë, apo dëbimet për shkaqe të mostolerimit fetar, sikurse ngjau me Indinë dhe Pakistanin më 1947, ku në dy drejtime u këmbyen rreth 17 milionë njerëz. Kemi shembullin e Bullgarisë në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar, kur dëboi qindra e mijëra turq në Turqi.

Të veçanta janë spastrimet etnike që bëri Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit në vitet '30 '40 të shekullit XX, me deportimin e koreanëve, të kinezëve, të polakëve, të gjermanëve etj. dhe të sjelljes së rusëve e të bjellorusëve në territoret e këtyre popujve dhe veçanërisht në vendet baltike (Estonia, Letonia dhe Lituania) për ta thyer homogjenitetin etnik të tyre.

Politika e dëbimit të shqiptarëve vazhdoi gjatë gjithë gjysmës së parë të shekullit XX, me intensitet të shtuar në vitet e 20-ta e të 30-ta. Në vitin 1912, si vit i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, të cilin po e kremtojnë shqiptarët kudo që janë, Kosova mori dy goditje të rënda: ndarja e dhunshme nga trangu shtetëror-politik dhe okupimi klasik nga Serbia, kur ushtria serbe bëri mizori të papara mbi popullatën shqiptare dhe dëbimin e saj, proces ky që u zhvillua gati pandërprerë me intensifikimin e spirales së dhunës dhe të krimeve të llahtarshme mbi popullatën shqiptare deri në fund të shek. XX.

Për këto arsye, si dhe për ta njohur situatën popullore të shqiptarëve, gjendjen numerike e reprodutive dhe qenien e perspektivën e tyre demografike e kombëtare, shqiptarët janë ndër popujt e rrallë në botë që kanë më shumë arsye ta studiojnë problematikën e tyre demografike, aq më tepër kur, vështruar nga perspektiva historike, *vëllimi, rritja demografike dhe shtrirja e pakëputur etnike ishin ndër faktorët më të fuqishëm të rezistencës ndaj asimilimit, ruajtjes së identitetit dhe substancës së tyre kombëtare*. Edhe për të ardhmen, si duket, në zgjidhjen definitive të problemit kosovaro-shqiptar dhe të çështjes shqiptare në përgjithësi, faktori demografik do të vazhdojë të mbetet i pakapërcyeshëm.

II

Në të gjitha synimet dhe projektet serbe të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjatë gjithë shekullit XX ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, si pjesë të programit nacional serb, *në mposhtjen e faktorit demografik shqiptar* dhe në sendërtimin e aspiratave shtetomëdha serbe, *plleshmëria e femrës shqiptare konsiderohej si një nga pengesat më të mëdha*. Jovan Cvijiq (1865-1927) si udhëheqës i delegacionit serb në Konferencën e Paqes në Versajë në vitet 1918-1919 dhe shef i Seksionit etnografiko-historik, ku bëheshin hartat etnike dhe caktoheshin kufijtë -, i kishte vënë bazat gjeografike dhe gjeopolitike të ekspansionizmit serb në Ballkan, duke mos e fshehur fare shqetësimin për shtimin demografik të shqiptarëve. Në mënyrë më transparente angazhimet e Çubrilloviqit qysh në elaboratin e parë racist e fashistoid kundër shqiptarëve “Iseljavanje Arnauta (“Shpërngulja e shqiptarëve”, 1937) e veçonin këtë komponent të progresit të shqiptarëve. Në këtë elaborat V. Çubrilloviqi theksonte: “Në rastin tonë kemi të bëjmë me një racë të gjallë, të fuqishme dhe të plleshme për të cilën i ndjeri Cvijiq ka thënë se është raca më ekspansive në Ballkan. Gjermania prej vitit 1870 deri në vitin 1914 ka shpenzuar miliarda marka që, gradualisht, duke e blerë tokën nga polakët, t’i kolonizojë trevat e veta lindore. Por, pllshmëria e nënave polake ka ngadhënjyer mbi organizimin gjerman dhe paratë gjermane. Në vitin 1918 Polonia e mori prapë Poznanjin e vet. Statistikat tona të viteve 1921 dhe 1931 tregojnë se edhe plleshmëria e grave shqiptare ka ngadhënjyer mbi politikën tonë të kolonizimit”.

Çubrilloviqi i pakënaqur me politikën serbe të kolonizimit me element sllav dhe të dëbimit të shqiptarëve nga të ashtuquajturat “viset jugore”, në vigjile të përfundimit të Luftës II Botërore, pra më 3 nëntor 1944 (pas çlirimit të Beogradit) doli me elaboratin tjetër, drejtuar Mareshalit të Jugosllavisë dhe Ushtrisë Jugosllave me titull “Problem manjina u novoju Jugoslaviji” (“Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re”). Qëllimi kryesor i tij ishte që Jugosllavia të bëhej një shtet etnikisht i pastër, i populluar vetëm me popullatë sllave apo jugosllave. Sipas tij “ishte me rëndësi që etnikisht të pastrohen gjermanët dhe hungarezët nga Vojvodina dhe shqiptarët ngë Serbia e Vjetër dhe Maqedonia”. Ndonëse rrethanat ndërkombëtare të kohës nuk shkonin në favor të realizimit të këtyre qëllimeve fashistoide, Çubrilloviqi, megjithatë, kishte shpresë të madhe në “ushtrinë vëllazërore sovjetike”, por edhe në “Shqipërinë e vërtetë”, siç e quante, sepse “simpatitë që i kemi ne ndaj popullit në Shqipëri”, thoshte ai, “nuk guxojnë të na

pengojnë që t'i qërojmë hesapet me banditët kuislingë të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit". Në rastin e shqiptarëve, ky elaborat nuk gjeti aplikim menjëherë, sepse rrethanat ishin të tilla, para së gjithash ndikuan marrëdhëniet e mira që ekzistonin midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Por, pas prishjes së raporteve me Shqipërinë (1948), në bazë të marrëveshjeve tjera të fshehta, të përtëritura jugosllavo-turke, menjëherë nisi vala e shpërnguljes masive të shqiptarëve me dhunë për në Turqi, që zgjati gjatë gjithë viteve të 50-ta dhe gjysmës së parë të viteve të 60-ta të shekullit XX. Emigrimi me presion ndodhi në rrethanat e bllokadës së plotë informatave për pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë dhe të botës.

Edhe pas Luftës II Botërore *preokupim kryesor i Serbisë dhe i ish-Jugosllavisë ishte që problemi i shqiptarëve përsëri të zgjidhej me shpërngulje në Turqi, kryesisht në shkretirat e Anadollisë*. Serbia dhe ish-Jugosllavia e dëshironin edhe Kosovën e pazhvilluar dhe me normë të lindshmërisë të tipit evropian, edhe Kosovën e kolonizuar dhe joshëse për serbët (!), qëllime këto që nuk shkonin së bashku. Pas rënies së A. Rankoviçit në korrik të vitit 1966 në Kosovë nisi procesi i trajtimit të barabartë të shqiptarëve me serbët dhe malazeztë dhe afirmimi i tyre nacional e kulturor. Por serbët dhe malazeztë, duke mos u pajtuar me trajtimin e barabartë të shqiptarëve, nisën ta braktisin Kosovën, ndërsa në Kosovë të vijnë shqiptarët nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia e Jugut, por edhe myslimanët nga rajoni i Sanxhakut. Ardhja e shqiptarëve në Kosovë u bë për shkak të reduktimit të të drejtave kombëtare e qytetare dhe politikës shtypëse maqedono-serbo-malazeze.

III

Pas vitit 1981 ish-Federata, me të gjitha mekanizmat e saj, duke financuar segregacionizmin, aparatën represiv dhe terrorin shtetëror, vazhdoi të angazhohej haptazi për mposhtjen e epërsisë numerike dhe reproduktive të shqiptarëve dhe të vënies së baraspeshës etnike përmes kolonizimit të serbëve dhe dëbimit të shqiptarëve. Shqiptarofobia madje ishte aq transparente sa që nuk fshihej fare prapavija neomaltusianiste dhe raciste, deri te veprimet konkrete të gjenocidit faktiv masiv ndaj shqiptarëve të Kosovës në vitet 1998-1999, kur ndodhi depërtimi i rreth një milion shqiptarëve, i paparë pas Luftës II Botërore. Problemet demografike të shqiptarëve nuk shtroheshin me qëllim të përmirësimit të cilësisë së riprodhimit biologjik dhe të jetës sociale të shqiptarëve e të humanizimit të raporteve midis gji-

nive apo të zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës, siç justifikohet atëherë. Të gjitha institucionet serbe e jugosllave shpifnin teza të ndryshme, ndër të cilat edhe tezën se shqiptarët po lindin shumë fëmijë për shkaqe nacionaliste me qëllim që t'i ndjekin serbët nga Kosova dhe të krijojnë "Kosovën etnikisht të pastër" dhe "Shqipërinë e Madhe".

Në mitingjet populliste nacionaliste të viteve të '80, ku bëhej homogenizimi dhe mobilizimi etnik i masave serbe dhe ku shfrytëzohej e tërë energjia e popullit "hyjnor" serb kundër shqiptarëve dhe përgatitjes për konfrontim me të gjithë popujt joserbë, u nxorën parulla dhe kërkesa me *përmbajtje thjesht raciste e gjenocidale*, si p.sh. "Shqiptarët shumohen shumë, por farën e kanë të prishur", "Shqiptarët duhet dëbuar nga Kosova", "Shqiptarët duhet vrarë" etj. Në anën tjetër, indoktrinimi antinatalist dhe në esencë antishqiptar kishte marrë tashmë përmasa të gjera te të gjitha shtresat e shoqërisë serbo-jugosllave, duke e fyer rëndë femrën shqiptare, të cilën në çdo forum politik, në medime, në rrugë e cilësonin si "makinë për prodhimin e fëmijëve".

Kërkesat për zvogëlimin e natalitetit me masa administrative, antisociale dhe anticivilizuese të tipit indiano-kinez, shqiptarët i kuptuan shumë drejt: si kërkesa që hynin në modelin gjenocidal të të menduarit dhe të sjelljes së ish-shtetit ndaj tyre, por fatmirësisht pa asnjë mundësi që të gjenin aplikim, sepse Serbia ua kishte suprimuar shqiptarëve të gjitha të drejtat (punësimin, arsimin, mbrojtjen shëndetësore, pensionimin etj.). Dhe përkundër një thyerjeje të fuqishme demografike pas vitit 1991, me shpërnguljen masive të të rinjve shqiptarë, proces ky që vazhdoi deri në çlirimin e Kosovës, përtëritja biologjike dhe zëvendësimi i brezave të shqiptarët nuk u rrezikuan dhe në këtë mënyrë dështuan të gjitha tendencat neomaltusianiste e raciste, si dhe "rruga demografike" e zgjidhjes së problemeve ekonomiko-sociale dhe politike në Kosovë dhe të shqiptarët.

Të frikësuar nga numri i madh i shqiptarëve, shtrirja e gjerë dhe territorialisht kompakte dhe perspektiva e tyre demografike dhe kinse për shkak të rrezikimit të hapësirës serbo-jugosllave dhe prosperitetit gjendemografik, kombëtar, politik dhe ekonomik të sllavëve të jugut, të gjitha qarqet ish-jugosllave nisën t'i numëronin shqiptarët dhe ta shtrinin shqiptarofobinë në të gjitha rajonet dhe bashkësitë etnike, veçanërisht të serbët, maqedonët dhe malazezët. Çdo zgjerim demografik të shqiptarëve drejt Serbisë së Jugut, Maqedonisë Qendrore dhe Podgoricës këto qarqe e shpjegonin si "zgjerim të hartës nacionaliste të Shqipërisë së Madhe".

Serbia përmes ish-Federatës Jugosllave donte ta përdorte Maqedoninë si territor provues jo vetëm për ta kufizuar lindshmërinë dhe rritjen demografike të shqiptarëve, por edhe për ta reduktuar shkollimin shqip dhe perspektivën e përgjithshme të tyre në Kosovë. Menjëherë pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë në vijën antishqiptare ishte krijuar blloku serbo-malazezo-maqedon, kurse pas gjysmës së këtyre viteve në këtë front ishin inkuadruar edhe boshnjakët, kroatët dhe sllovenët. Maqedonia sikur shihte frikë edhe më të madhe nga numri i shqiptarëve dhe dinamika e tyre natyrore demografike. Numri zyrtar i shqiptarëve në vitin 1981 në Maqedoni ishte 377.726 ose 19,8% në popullsinë e përgjithshme (në punësim merrnin pjesë vetëm me 6,7%). Çdo kërkesë elementare njerëzore dhe kushtetuese e shqiptarëve nga politika zyrtare maqedonase dhe jugosllave kualifikohet si kërkesë “kundërrevolucionare”. Ky pushtet nxori edhe ligjin mbi kufizimin e ardhjeve të shqiptarëve në vendbanimet e Maqedonisë, ku përsëri, sikurse edhe te nataliteti, filloi nga Tetova.

Krimi e gjenocidi ishin të paramenduar dhe të planifikuar nga strukturat politike, shtetërore dhe ushtarake të Serbisë, ndërsa arsyetimin dhe legjitimimin e tyre e bënë intelektualët, shkencëtarët, shkrimtarët, mediat dhe Kisha Ortodokse Serbe me patriarkun Pavle në krye, i cili gjithnjë e ka mbështetur të keqen. Në fillim të luftës në Kroaci Patriarku i kishte shkruar lordit Karington, udhëheqësit të Konferencës për ish-Jugosllavinë, se serbët dhe kroatët nuk mund të jetojnë së bashku. Ndërkaq krimineli dhe vrasësi Zhelko Razhnjatović – Arkan, kishte thënë: Komandanti im suprem është patriarku Pavle, për të cilën gjë ai kurrë nuk është distancuar. “Arkani me njerëzit e tij të armatosur hynte pa u penguar në manastiret ortodokse, ndërsa patriarku Pavle kurrë nuk i ka dënuar krimet, të cilat formacionet e armatosura serbe i kishin kryer në Kroaci, në Bosnjë dhe në Kosovë”.

Në vazhden e ideve dhe projekteve të shumta të qarqeve e institucioneve shkencore, kulturore dhe kishtarë serbe për pastrime etnike, krime e veprime gjenocidale me qëllime ekspansioniste këto 170 vjetët e fundit duhet veçuar projektin e Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve të vitit 1986, i cili për ta ndërsyer shtetin kundër shqiptarëve, ata i paraqiste si armik shekullor, të cilët, kinse njëherë biologjikisht e pastaj edhe politikisht i rrezikonte serbët, hapësirën e tyre jetësore dhe prosperitetin gjeodemografik dhe shtetëror serb! Projekti në opinion doli me emrin “Memorandum SANU”. Qëllimi kryesor i tij ishte krijimi i Serbisë së Madhe ose dominimi serb në gjithë Jugosllavinë komuniste, që duhej të arrihej me

përdorimin e forcës ushtarake (APJ-së) përmes ndërrimit të dhunshëm të Kushtetutës së vitit 1974, zbatimit të represionit, luftës dhe krimeve masive e gjenocidit ndaj shqiptarëve, kroatëve dhe boshnjakëve, gjë që edhe ndodhi midis viteve 1990 dhe 1999, derisa nuk u mposht definitivisht makineria ushtarako-policore serbe me intervenimin e forcave të NATO-s. Për regjimin e Millosheviqit ky projekt ishte platforma kryesore e veprimit për 15 vjet rresht. Ky projekt ishte një lloj *in memoriam* për Jugosllavinë e dytë dhe hyrje në luftërat e përgjakshme. Millosheviqi nuk ishte as komunist e as fetar; ai e donte pushtetin personal dhe Serbinë e Madhe. Për këtë projekt dhe gjithë politikën serbomadhe, historiania serbe dhe udhëheqësja e dikurshme e Serbisë, Llatinka Perović, ishte ndër zërat e rrallë që theksonte se objektivat militariste të Serbisë ishin “revidimi i kufijve të brendshëm, këmbimi i popullatave dhe ristrukturimi i hapësirës politike ballkanike”.

Akademikët dhe intelektualët serbë i kishin vënë bazat ideologjike dhe shkencore për dëbimin dhe shfarosjen biologjike të shqiptarëve edhe midis dy luftërave botërore dhe menjëherë pas Luftës II, siç bënë akademikun Vasa Çubrilloviqi (1937, 1944), nobelisti Ivo Andriq (1939) etj. Nga gjysma e nëntorit 2012 Kryetari aktual i Serbisë T. Nikoliq kërkoi ndihmë nga SANU për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, pra një “Memorandum” të ri, dhe me sa dihet përgjigja është pozitive!

Politika zyrtare serbe nuk do të heqë dorë në asnjë mënyrë nga objektivi për rikolonizimin e Kosovës dhe ndjekjen e shqiptarëve me qëllim të ndërrimit të përbërjes kombëtare dhe serbizimit të plotë të Kosovës dhe lufta kundër faktorit demografik shqiptar do të bëhet pjesë përbërëse e strategjisë serbomadhe. Fushata fantastike e zvogëlimit të numrit të shqiptarëve dhe e rritjes së numrit të të tjerëve, veçanërisht e serbëve bëhet më transparente në prag dhe gjatë Konferencës së Rambujesë në fillim të vitit 1999 nga ana e përfaqësuesve të Serbisë. Deportimi i një milion shqiptarëve pas fillimit të bombardimeve të forcave të NATO-s më 24 mars 1999 ishte dëshmia më e qartë për këtë.

IV

Në vazhdim po i zëmë në gojë valët e kolonizimit serb të Kosovës dhe valët e dëbimit të shqiptarëve nga Kosova në gjysmën e dytë të shekullit XX, ku çdo pikë meriton shqyrtim të veçantë:

1. Pas disa valëve të kolonizimit nga okupimi serb i Kosovës më 1912 e deri në vitin 1941, me intensitet të shtuar në vitet e 20-ta e të 30-ta,

në vitet e 50-ta e më vonë në Kosovë vazhdon shpërngulja e shqiptarëve në Turqi dhe sjellja e serbëve në Kosovë dhe kjo është *vala e parë e fuqishme e kolonizimit*: shumë serbë dhe malazezë nga Serbia dhe Mali i Zi vijnë si kuadro me kualifikime të ulëta, të mesme ose që dinin vetëm shkrim-lëxim, por një numër i konsiderueshëm instalohet me familje. I zënë vendet e punës në organet administrative e shtetërore, në drejtorate, në institucione sociale dhe shërbime komunale, në ente shëndetësore dhe kulturore etj. Të ardhurit ishin kryesisht nga viset e Serbisë së Jugut dhe nga rajoni i Plavës, Gucisë, Podgoricës etj., të cilët më vonë, pas përfundimit të karrierës së punës dhe pasurimit, kthehen në vendlindjet e tyre, ku edhe i kishin pronat e patundshme dhe farefisin.

2. *Vala e dytë e kolonizimit* ndodhi përmes “Programit jugosllav për Kosovën”, i cili u miratua në vitin 1989 nga Qeveria RSFJ-së, natyrisht me kërkesën e Serbisë. Kjo politikë e re kolonizuese ishte pjesë e programit ekstrem nacional serb, që gjithashtu kishte për qëllim instalimin e serbëve për ta ndërruar kompozicionin etnodemografik të Kosovës. Privilegjet e serbëve ishin shumë të mëdha: sigurimi i punësimit, i banesave, i trojeve falas, i kredive afatgjata pa kamatë, për të njëjtin vend pune të ardhurat shumë më të mëdha se të shqiptarëve dhe beneficione të tjera.

Po këtë vit, ekstremisti i njohur serb Vojislav Sheshel, i cili sot po gjykohet në Hagë për krime të luftës, në qarqet neoçetnike në perëndim kërkoi vendosjen e 100.000 kolonëve në Kosovë; më vonë disa herë e përsëriti këtë kërkesë në tribuna publike dhe në vetë Parlamentin e Serbisë. Për t'u realizuar kjo aspiratë, Shesheli, në kushtimin famëkeq “Spremtë se, spremtë çetnici”, kërkonte që Prishtina të bëhej kryeqytet i Serbisë dhe i Jugosllavisë, ku do të përqendroheshin të gjitha institucionet shtetërore, shkollat policore e ushtarake, shumë policë, oficerë e nëpunës me familje. Ndërkaq, gjithashtu në këtë vit, Vukashin Jokanoviqi, në cilësi të kryetarit të Kuvendit të Kosovës shkoi edhe shumë më larg dhe kërkoi atëherë që Kosova të kolonizohej me 300.000 serbomalazezë. Qarqet shoviniste serbe flitnin atëherë edhe për sjelljen e 400.000 serbëve nga Rumania në Kosovë, ndonëse në Rumani, sipas vetë burimeve serbo-jugosllave, nuk jetonin më shumë se 24.000 serbë!

“Programi jugosllav” u siguronte kolonëve serbë 3.284 banesa dhe 1.422 troje falas për ndërtim, ndërsa vetëm në periudhën 1989-1993 para-sihihej ndërtimi i 2.000 banesave dhe i 710 shtëpive individuale me kushte tepër të volitshme. Ish-Federata Jugosllave dhe republikat e saj ndanin mje-

te të mëdha për stimulimin e ardhjes sa më masive të serbëve në Kosovë, që përkrahej edhe nga ish-udhëheqja komuniste shqiptare e Kosovës.

Pas rrënimit të plotë të autonomisë dhe subjektivitetit politik të Kosovës në ish-Federatën Jugosllave në mars të vitit 1989 dhe okupimit klasik të saj, shpërngulja e serbëve vazhdon me intensitet të dukshëm, por pushteti serb tash këtë proces nuk e problematizonte, sepse shqiptarët nuk mund t'i fajësonte më para botës dhe opinionit serb. Po ta pranonte faktin e shpërnguljes së serbëve pas aneksimit dhe okupimit të plotë të Kosovës, ky pushtet publikisht do ta pranonte politikën e tij të dështuar në Kosovë.

3. Me valën e dytë të kolonizimit lidhet drejtpërdrejt *vala e tretë e kolonizimit të Kosovës* kur në vitin 1989 në Kuvendin e Serbisë dhe në Komitetin Qendror të LKS-së miratohet programi me një titull tepër perfid dhe cinik "Programi për paqe, liri, barazi, demokraci dhe prosperitet të Kosovës", që kishte fuqinë e një programi nacional, politik dhe shtetëror serb. Ndërkaq në vitin 1991 Kuvendi i Serbisë nxori ligjin për kushtet e ndarjes së tokave bujqësore në Kosovë me qëllim të realizimit të synimeve kolonizuese. Pas këtij viti, me qëllim të serbizimit të Kosovës, regjimi serb, krahas ndjekjes së shqiptarëve nisi të instalojë edhe refugjatë-kolonistë nga Kroacia e BeH, si dhe serbomalazezë nga Shqipëria. Këto programe të Serbisë tërthorazi në fillim u ndihmuan edhe nga Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatë me seli në Prishtinë. Këta refugjatë serbë pushteti okupues i vendosi në pjesë të ndryshme të Kosovës, më tepër në objektet arsimore, edukative e rekreative të nxënësve dhe studentëve, në çerdhet e fëmijëve, në shtëpitë e jetimëve dhe në objektet hoteliere, turistike dhe industriale. Numri i këtyre refugjatëve nuk ishte i madh, por qëllimet e sjelljes së tyre ishin tepër djallëzore. Sipas vetë burimeve serbe ky numër sillej rreth 10.000 veta, por ata nga sjelljet duket se ishin pjesa më militante dhe kryesisht kriminelë të luftës të cilët pushteti serb i ndërsente çdo ditë kundër shqiptarëve.

4. Me ofensivën kroate "Stuhia" në Krajinë të Kroacisë (Knin) më 5 gusht të vitit 1995 pason eksodi masiv i serbëve nga territoret deriatëherë të okupuara të Kroacisë nga Serbia, ku një numër të konsiderueshëm të tyre regjimi serb nisi ta instalojë në Kosovë, i cilësuar si *valë e katërt e kolonizimit të Kosovës*. Me këtë ndërmarrje pushteti serb nuk kishte për qëllim t'i zgjidhte tragjeditë individuale e familjare të të ikurve, të instrumentalizuar sikurse serbët e Kosovës nga politika e Beogradit, por për të realizuar aspiratat tashmë të njohura hegjemoniste ndaj Kosovës gjatë realizimit të katër

valëve të mëparshme të kolonizimit të saj. Për këtë qëllim pushteti okupues serb formoi trupin koordinues në nivel të Kosovës, si dhe disa shtabe komunale.

Vendosja e këtyre serbëve në Kosovë nuk mund të cilësohej si "vendosje e përkohshme" e as të ardhurit si "refugjatë", siç përpiqej t'i shpjegonte regjimi serb dhe organizatat humanitare joshqiptare, por si tendencë e instalimit të përhershëm dhe në funksion të ndërrimit të përbërjes kombëtare të popullsisë së Kosovës, ndërsa të ardhurit si kolonë. Kolonizimi bëhet me dhunë, ngase vetë kolonët refuzonin kategorikisht që të vendoseshin në Kosovë, si territor i okupimit klasik dhe i konflikteve potenciale në Ballkan. Serbia zyrtare dhe forcat opozitare këtë tragjedi njerëzore e shihnin si rast të volitshëm për realizimin e projektit të Millosheviqit, të miratuar para "Stuhisë" kroate, për kolonizimin e 100.000 serbëve në Kosovë, i cili paraqiste valën më të fuqishme të paralajmëruar në vargun e valëve të kolonizimit të Kosovës midis dy luftërave botërore dhe pas Luftës II Botërore. Projekti pjesërisht gjeti zbatim, veçanërisht pas ofensivës kroate më 5 gusht 1995, kur, përkundër vullnetit të tyre, u instaluan në Kosovë disa mija serbë nga Kroacia.

5. *Vala e deportimit masiv të shqiptarëve ndodhi në vitin 1998 dhe veçanërisht në vitin 1999.* Ky depërtim ndodhi në sytë e gjithë botës, ku idetë dhe synimet e kahmotshme të regjimeve dhe qarqeve të ndryshme serbe brenda tyre u shndërruan në gjenocid faktik masiv ndaj shqiptarëve. Sipas të dhënave ende jo të plota, mbi 15 mijë shqiptarë civilë, ku kishte fëmijë, gra dhe pleq, u vranë, u masakruan ose u dogjën të gjallë dhe u futën në qindra varreza masive; mbi 120.000 shtëpi të shtrira në rreth 1100 vendbanime u dogjën, u rrënuan e u dëmtuan; fshatra të tëra e shumë qendra urbane, me sistemet e tyre infrastrukturore, u shkatërruan; rreth një milion shqiptarë u deportuan jashtë Kosovës me mjete të ndryshme, me trena, kamionë, autobusë, vetura, këmbë nëpër male, gjithnjë rrugës duke u poshtëruar, torturuar dhe femrat duke u dhunuar; disa qindra mijëra të tjerë nën dhunë e kërcënime u ndoqën nga shtëpitë e tyre, duke bredhur brenda territorit të Kosovës, më tepër nëpër terrenet malore. Ka ende varreza masive të shqiptarëve që nuk janë hapur as në Kosovë e as në Serbi.

Regjimi fashistoid serb, me të gjitha mjetet u vërsul mbi identitetin etnik, historik dhe kulturor të shqiptarëve dhe mbi themelet e jetës së tyre. Rrënimi i monumenteve kulturo-historike, p. sh. i 218 xhamive, i kompleksit memorial të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, zhdukja e busteve të figurave

të shquara të rilindësve tanë dhe ndërrimi i gjithë onomastikës së Kosovës kishte për qëllim ringjalljen e miteve kishtare mesjetare serbe dhe serbizimin e plotë të Kosovës. Përmes deportimit masiv që i ngjante plotësisht deportimit të çifutëve gjatë Luftës II Botërore dhe zhdukjes së dokumentacionit (letërnjoftimet, pasaportat, regjistrat kadastrale, librat amë të të lindurve, të të kurorëzuarve dhe të të vdekurve, numrat personalë, librat e nënshtetësisë etj.) në pranverën e vitit 1999, ky regjim donte ta dehumanizonte njeriun e përkatësisë etnike shqiptare dhe gjithë bashkësinë shqiptare dhe ta këpuste çdo lidhje juridike të shqiptarëve me truallin gjeoetnik të tyre, ta rrëronte një etni, një kulturë, një shoqëri me të gjitha inatitucionet e saj.

Kjo gjendje e nderë dhe shumë e dhimbshme për shqiptarët e Kosovës mori fund me hyrjen e trupave të NATO-s më 12 qershor 1999. Në mbështetje të planit të M. Ahtisarit Kosova u pavarësua më 17 shkurt 2008, por nën mbikëqyrje të bashkësisë ndërkombëtare, ku serbët e Kosovës, me 4-5% në popullsinë e përgjithshme të saj, do të kenë privilegje të papara në Evropë dhe në botë, siç e thoshte edhe vetë zëvendësiv i M. Ahtisarit, z. A. Rohan. Ndërkaq, më 10 shtator 2012 përfundoi procesi i kësaj mbikëqyrjeje, kur punët dhe përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës rriten edhe më shumë dhe problemet dhe sfidat e institucioneve të Kosovës mbesin në radhë të parë në përpjekjet për mbrojtjen nga invalidizimi i mundshëm territorial i shtetit, në mbrojtjen nga grabitja e pasurisë kombëtare, në sundimin e ligjit, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në angazhimin për jetë dinjitoze të qytetarëve të Kosovës etj.

Hivzi ISLAMI, Prishtina

FIGHT AGAINST ALBANIAN DEMOGRAPHIC FACTOR AS LONG-TERM STRATEGY OF SERBIAN-YUGOSLAV POLITICS

Summary

Since the time of Ilija Garašanin's project "Načertanije" (1844), which was the first the formulation of 'Greater Serbia' as hegemonic idea and conception, and especially after the Berlin's Congress (1878), there has been no end to Serbian efforts to ruin ethnic homogeneity of Albanian lands, ethnic cleansing drives, and efforts to colonize Kosova with Slav elements, aiming at weakening the vital force of the population, including through open genocidal acts. The reproductive capability of Albanian women was seen as one of the biggest obstacles.

After 1878, aiming at national and state homogenization through the use of force and repression, Serbia committed ethnic cleansing of Albanians in more than 600 villages in the region of Prokuplje, Vranje, Leskovac, and Nish and on those towns. The expelled Albanians known as '*muhaxhir*' settled in Kosova and other Albanian lands. This is where the implementation into practice of modern ethnic cleansing starts.

The institutional fight against Albanian demographic factor intensified after 1981. Albanophobia was that transparent, with evident neo-Malthusian and racist background, which can be illustrated with stances like, "Albanians' birth rate is high but their reproductive material is rotten", "Albanians should be expelled from Kosova", "Albanians should be killed," and so on. During 1990s, Milošević's Serbia committed carried out ethnic cleansing of millions of non-Serbs in the areas of former Yugoslavia, whereas 1998-1999 alone, it expelled around one million Albanians from Kosova.

Serbian academicians and intellectuals laid the ideological and "scientific" foundations to expulsion and biologic extermination of Albanians in the period between two World Wars and immediately after the World War II (Čubrilović's projects in 1937 and 1944; those of Nobel prize winner Ivo Andrić in 1939 and so on). One should recall in particular the project of Serbian Academy of Sciences and Arts of 1986, known as the 'SANU Memorandum'. That project served as a fundamental action platform to Milošević for 15 years. The project was a kind of an *obituary* to former (second) Yugoslavia and a prelude to the bloody wars. Milošević was neither a communist nor a religious man; he yearned for power and for the 'Greater Serbia.'

The paper further treats the cycles of Serbian colonization of Kosova, respectively the expulsion of Albanians from Kosova during the second half of 20th century. After several waves of colonization of Kosova by Serbs from 1912 to 1941, which intensified during in the 1920s and 1930s, the 1950s also saw another cycle of the expulsion of Albanians from Kosova to Turkey and bringing of Serbs instead, which marked *the first vigorous phase of colonization*.

The second wave of colonization was implemented through “The Yugoslav Program on Kosova”, adopted in 1989 by the Government of SFRY, definitely at Serbia’s request. The second wave of colonization is linked directly to *the third wave of colonization*, which started in 1989 when the Assembly of Serbia and the Central Committee of Serbian Communist Party adopted the program with a cynical title, “The program for peace, freedom, equality, democracy and prosperity in Kosova”. The Croatian offensive called “Storm” in the region of Krajina (Knin) launched on 5th of August 1995, was followed by mass exodus of the Serbs from the Croatian territories. A considerable number of these Serbs were brought to Kosova by Serbian regime, as part of *the fourth wave of colonization of Kosova*. The fifth wave took place in 1998 and especially in 1999 after mass deportation of Albanians.

This difficult and very painful position of Kosova Albanians ended after the entry of NATO troops on 12 June 1999. By referring to the Ahtisaari’s plan, Kosova became independent on 17 February 1998, though under international supervision. In this new Kosovo, the Serbs who make up only 4-5% of total population of Kosova enjoy unprecedented privileges in Europe and the world, as Ahtisaari’s deputy Albert Rohan put it. The process of international supervision of independence ended on 10 September 2012, when the Kosova institutions were vested with additional authorities and responsibilities.

Arsim EJUPI, Prishtinë

ZHVILLIMI DEMOGJEOGRAFIK I LUGINËS SË PRESHEVËS – VËSHTRIM RETROSPEKTIV

KDU 911.3:312 (496.51-11)091)

314.15.045 (496.51-11)091)

Abstrakt

Lugina e Preshevës ka përjetuar një zhvillim të vullshëm demogjeografik. Nëpër territorin e saj kanë kaluar perandori e pushtues. Të gjitha këto procese kanë pasur një refleksion të fuqishëm edhe në rrafshin demogjeografik. Popullsia e Luginës së Preshevës u është nënshtruar proceseve të ndryshme transformuese, si për asimilime etnike dhe gjuhësore, për konvertime fetare, pastaj shpërnguljeve të dhunshme të popullsisë dhe proceseve kolonizuese etj. Lugina e Preshevës që nga kohërat e lashta e deri në ditët e sotme kalon nëpër disa periudha të zhvillimit demogjeografik. Në periudhat e hershme ajo banohej nga fisi ilir i dardanëve. Edhe në periudhat e mëvonshme Lugina e Preshevës banohet nga popullsia shqiptare si pasardhëse e pakontestuar e popullsisë iliro-dardane. Popullsia shqiptare për shkak të presioneve të pushtuesve të ndryshëm bizantin, sllav e turk në periudha të caktuara rezikohet nga asimilimi dhe shpërngulja, mirëpo vëllimi, vazhdimësia etnike me popullsinë shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni, komponentet pozitive të shtimit natyror i mundësojnë asaj të mbijetojë dhe të shënojë rritje nëpër shumicën e periudhave të zhvillimit demogjeografik. Kjo dëshmohet nga të dhënat e shumta arkeologjike, toponomastike, nga të dhënat e regjistrimeve të popullsisë etj.

Fjalët çelës: *Lugina e Preshevës, popullsia, zhvillimi demogjeografik, regjistrimet, struktura etnike*

Hyrje

Për të kuptuar më mirë proceset aktuale demografike në Luginën e Preshevës dhe tendencat zhvillimore duhet të bëhet një vështrim për të kaluarën demogjeografike të këtij rajoni, për problemet sociale, ekonomike dhe kulturore me të cilat është ballafaquar popullsia e Luginës së Preshevës, si dhe për rrethanat historike dhe gjeopolitike që kanë shkaktuar transformime në rrafshet e lartpërmendura. Situata demografike në Luginën e Preshevës vazhdimisht është ndryshuar nga një periudhë historike në tjetrën, duke bartur me vete veçoritë politike, sociale, ekonomike, antropogjeografike të periudhës konkrete. Për shkak

të pozitës shumë të volitshme gjeokomunikative dhe gjeostrategjike, kjo Luginë është pushtuar nga perandori të ndryshme të cilat, më pak ose më shumë, kanë shkaktuar transformime në rrafshin demogjeografik përmes migrimeve të të gjitha llojeve dhe drejtimeve, kolonizimit, asimilimit gjuhësor, konvertimit fetar, spastrimeve etnike etj. Kjo ka bërë që numri i popullsisë shqiptare të ndryshojë nga një periudhë në tjetrën. Megjithatë në të gjitha regjistrimet e bëra që nga periudha osmane e deri në ditët e sotme popullsia shqiptare shënon një pjesëmarrje të lartë brenda rajonit.

Periudhat e zhvillimit demogjeografik

Në zhvillimin demogjeografik të Luginës së Preshevës mund të dallohen disa periudha. Periudha e parë është nga shekulli III – I para erës sonë kur territori i Luginës së Preshevës banohej nga fisi ilir-dardanë. Edhe në kuadër të vetë Mbretërisë Dardane, Lugina e Preshevës ishte pjesë e pandarë. Popullsia dardane ishte e koncentruar kryesisht në viset kodrinore-malore të Karadakut dhe Rujanit, prandaj ajo ishte popullsi më tepër blegtorale sesa bujqësore. Fortifikimet dardane në Rahovicë, Preshevë, Bushtran, të vendosura në shpatet e maleve, tregojnë për një funksion strategjik-mbrojtës për popullsinë e cila jetonte prapa këtyre kështjellave, por edhe të rrugëve të cilat kalonin nëpër Karadak dhe Rujan, çka na bën të kuptojmë se këto rrugë ishin shfrytëzuar edhe në periudhat parafeudale.¹

Periudha e dytë është ajo prej shekullit I të erës sonë kur Mbretëria Dardane bie nën sundimin e Perandorisë Romake dhe Bizantine. Edhe në këtë periudhë popullsia dardane në viset kodrinore-malore vazhdon t'i rezistojë asimilimit, ndërsa në pjesën fushore të Luginës së Preshevës zhvillohet një jetë mjaft e bujshme shoqërore-politike dhe në rrethanat e kohës Lugina e Preshevës dallohej për një dendësi mjaft të madhe të banimit. Në periudhën romake ishin ngritur shumë vendbanime romake në territoret e fshatrave Çukarkë, Bukurocë, Zhunicë, Corroticë e Rincë. Nga të gjitha këto lokalitete dallohej vendbanimi afër Zhunicës i cili i kishte karakteristikat e qendrës urbane. Ky vendbanim i madh dhe i rëndësishëm i antikës së vonshme, me siguri se në periudhën romake ishte një nga vatrat kulturore-politike të fushës së Preshevës.² Materialet arkeologjike të gjetura në territoret e fshatrave të lartpërmendura si pitos, enë të qeramikës, monedha, tregojnë për një popullsi e cila kishte të zhvilluar bujqësinë gjithashtu edhe tregtinë, të bazuar në shitje-blerjen e produkteve bujqësore. Gjetja e pitosëve

¹ KOSTIĆ, M.: *Preševska Kotlina-društveno-geografska studija*, Vranjski Glasnik V, 1969, 95.

² JOVANOVIĆ, M.: *Arheološka istraživanja u 1968 godini*, Vranjski Glasnik, Knjiga IV, Vranje, 1968 f.496. ff. 498-499.

të shumtë të cilët kishin shërbyer për konservimin e produkteve bujqësore tregon për zhvillimin e bujqësisë e vreshtarisë qysh nga periudha romake. Një moment i rëndësishëm në zhvillimin antropogjeografik e kulturor të popullsisë në Luginën e Preshevës është përqafimi i besimit të krishterë i cili bëhet në periudhat e para të lulëzimit dhe përhapjes së fesë krishtere. Gjatë periudhës bizantine në Luginën e Preshevës vazhdon një jetë e pasur, sidomos në periudhën e sundimit të perandorit Justinian, kur kemi një banim kontinuel të Luginës së Preshevës me elementet e jetës kulturore bizantine.¹ Për këtë dëshmojnë materialet arkeologjike të gjetura, si stolitë e qaforet, gjilpërat, sëpatat, monedhat bizantine me figurën e Justinianit etj.

Në fund të shekullit XII Lugina e Preshevës bie nën sundimin e shtetit mesjetar serb, me çka fillon një periudhë e re në zhvillimin demogjeografik të Luginës së Preshevës. Kjo është periudha e zgjerimit territorial të shtetit të ri serb, të formuar nga Dinastia e Nemanjidëve. Të udhëhequr nga Stefan Nemanja serbët fusin nën sundimin e vet Dioklecian (Malin e Zi) dhe Shqipërinë e Veriut, në verilindje duke përfshirë Nishin dhe disa pjesë të Kosovës deri në veri të Maqedonisë.² Sundimtari i parë serb që e futi nën sundimin e vet Luginën e Preshevës ishte Vukani, kurse pas tij vijnë me radhë disa prijës të Dinastisë së Nemanjidëve. Në fund të shekullit XIV, Lugina e Preshevës bie nën sundimin e Sevastokratorit³ Dejan dhe djemve të tij Dragashit dhe Konstandinit. Nga kjo periudhë (viti 1381), Presheva përmendet për herët të parë në një dokument kishtar si qendër e Zhupës së Preshevës dhe kur kisha e Arhilevicës (Rahovicës) dhe e Norçës i dhurohet Manastirit të Hilandarit, edhe pse ekzistojnë hipoteza se shkrimi i parë për Preshevën daton edhe më herët. Në pjesën e parë të shekullit XV Qesari Uglesha (1402-1423) kishte nën sundimin e vet Zhupën e Igonoshtit, Vranjës dhe Preshevës.

Mungesa e të dhënave mbi popullsinë shqiptare gjatë periudhës së sundimit të shtetit mesjetar serb në Luginën e Preshevës nuk është për shkak të mosekzistimit të elementit etnik shqiptar në këtë rajon, por për shkak të tërheqjes së popullsisë shqiptare në viset malore. Duke qenë larg prej kontaktit me popullsinë sllave, shqiptarët kanë arritur t'i shmangen në radhë të parë asimilimit gjuhësor e pastaj atij fetar. Në gjysmën e dytë të shekullit XV, Lugina e Preshevës bie nën sundimin e Perandorisë Osmane. Pozita e volitshme gjeokomunikative në

¹ VUKANOVIĆ, T.: *Preševo*, Vranjski Glasnik broj II, Vranje, 1966, f. 5.

² MALCOLM, N.: *Kosova – një histori e shkurtër*, Prishtinë-Tiranë, 2001, f. 44.

³ Sevastokrator ishte titull i lartë bizantin i cili ishte futur në fund të shekullit XI dhe i dedikohet anëtarëve të ngushtë të familjes mbretërore. Përveç Bizantit, është shfrytëzuar edhe në Bullgari (shekulli XIII dhe XIV) dhe në Serbi.

kryqëzimin e rrugëve që shkonin prej veriut kah jugu dhe prej perëndimit kah lindja, si dhe kushtet e volitshme natyrore bëjnë që Presheva shumë herët të fitojë karakteristikat dhe funksionet e një qendre urbane në të cilin gravitonin vendbanimet e rajonit. Kështu nga një defter i shekullit XV (1489), paraqitet si seli e vilajetit të Preshevës me emrin Preshova. Sipas historianit S. Rizaj, Presheva “gjatë tërë kohës moderne e mban funksionin e qytezës.”¹

Prej vitit 1912 e deri në fillim të LDB Lugina e Preshevës pa vullnetin e popullsisë së vet mbetet pjesë e Mbretërisë Jugosllave në kuadër të Banovinës së Vardarit. Deri në regjistrimin e vitit 1921 Lugina e Preshevës vazhdon të banohet me shumicë nga shqiptarët edhe pse kemi një zvogëlim të numrit të popullsisë myslimane krahasuar me statistikat e mëhershme të Perandorisë Osmane. Edhe në këtë regjistrim nuk ekziston kategoria e përkatësisë kombëtare, por popullsia evidencohet sipas përkatësisë fetare dhe gjuhësore. Më poshtë po japim të dhënat mbi përkatësinë fetare të popullsisë në rrethin e Preshevës të Banovinës së Vardarit.

Popullsia e pranishme (qytetare dhe ushtarake, e përhershme dhe përkohësisht e pranishme)									
Rrethi i Preshevës									
	Vendbanimi	Totali	%	Mysli- manë	%	Orto- doksë	%	Kato- likë	%
1	Presheva	5952	100	5322	89.4	629	10.57	1	0.02
2	Bujanoci	8245	100	4807	58.3	3438	41.7		
3	(V.)	4762	100	3453	72.5	1309	27.49		
4	Bilaçi	3473	100	2464	76.2	826	23.78	1	0.03
5	Zhunica	3899	100	14	0.36	3834	99.61	1	0.03
6	Kleniki	3895	100	8	0.21	3887	99.79		
7	Klinoci	2541	100	1436		1105	43.49		
8	Levosova	1825	100			1825	100		
9	Novosella	2925	100			2925	100		
	Shaince		100						
		3746	100	17686	46.2	19788	52.79		0.01

Tabela 1. Popullsia e Rrethit të Preshevës sipas përkatësisë fetare në vitin 1921

Burimi: Popis stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca, Sarajevë, 1921 godine, f. 102.

Nga tabela shihet që në Preshevë dominon popullsia e besimit mysliman. Në vendbanimet e tjera, si Bilaç dhe Bujanoc, kemi përqindje të lartë

¹ RIZAJ, S.: Kaza Prešova 1896/7 godine. Upravno-politička organizacija i kulturno-prosvetne institucije, Vranjski Glasnik, II, Vranje, 1966.

të popullsisë myslimane. Të besimit mysliman ishin shqiptarët dhe turqit. Duke pasur parasysh që popullsia turke ishte shumë e vogël dhe përbëhej nga familjet e agallarëve, bejlerëve e nëpunësve të pushtetit, mund të konstatojmë se pjesa dërmuese e popullsisë myslimane ishin shqiptarë. Megjithatë raporti i numrit të përgjithshëm të popullsisë myslimane prej 17686 banorëve ndaj 19788 banorëve të besimit ortodoks që për nga kombësia ishin serbë, nuk shpreh gjendjen reale të strukturës kombëtare të popullsisë në Luginën e Preshevës. Arsyet kryesore për një raport të tillë joreal janë të natyrës metodologjike dhe administrative-politike.

Gjatë regjistrimit të vitit 1921 në kuadër të rregullimit politiko-territorial të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, Rrethi i Preshevës (Preševski Srez) nuk përfshinte disa fshatra të Karadakut të cilët në pikëpamje administrative territoriale ishin të lidhura me Rrethin e Gjilanit ose Kumanovës. Pastaj metodologjia e deklaramit të popullsisë sipas përkatësisë fetare dhe gjuhësore e jo sipas përkatësisë kombëtare, shkalla shumë e lartë e analfabetizmit në mesin e popullsisë kanë lënë mundësi manipulimi gjatë realizimit, përpunimit dhe publikimit të rezultateve. Një arsye tjetër duhet kërkuar në moszbatimin e regjistrimit në tërë territorin e Luginës së Preshevës, sidomos në fshatrat kodrinore-malore të Karadakut.

Tabela 2. Popullsia e Rrethit të Preshevës sipas gjuhës amtare në Mbretërinë SKS në vitin 1921

Rrethi i Preshevës											
Nr.	Vendbanimi	Totali	%	Armatute	%	Serbo/Kroate	%	Turke	%	E tjera	%
1	Presheva	5952	100	4633	77.84	661	11.11	323	5.43	335	5.63
2	Bujanoci	8245	100	4033	48.91	3436	41.76	110	1.33	666	8.08
3	Bilaçi	4762	100	2620	55.02	1298	27.26	343	7.2	501	10.5
4	Zhunica	3473	100	2454	70.66	802	23.09	18	0.52	199	5.73
5	Kleniki	3899	100		0	3883	99.59		0	16	0.41
6	Klinoci	3895	100		0	3887	99.79		0	8	0.21
7	Levosova	2541	100	1413	55.61	1102	43.37	6	0.24	20	0.79
8	Novosella	1825	100		0	1825	100		0		0
9	Shaince	222925	100		0	2925	100		0		0
		3746	100	15153	40.44	19788	52.9	800	2.14	1745	4.6

Burimi: Popis stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca, Sarajevo, 1921 godine, f.102.

Periodha prej vitit 1921 e deri në Luftën e II Botërore përcillet me pasoja të rënda demogjeografike, ku vjen deri të shpërngulja e një numri të

madh të shqiptarëve, kryesisht në Turqi. Nën petkun e zbatimit të reformës agrare dhe presioneve në baza fetare që në esencë kishin për qëllim spastrimin etnik, shumë shqiptarë detyrohen t'i lëshojnë vatrat e veta në të cilat pastaj vendosen kolonistë serbë. Në këtë mënyrë, pushteti jugosllav arrin pjesërisht të ndryshojë kompozicionin etniko-demografik në Luginën e Preshevës. Ajo, sikurse trojet e tjera etnike shqiptare në ish-Jugosllavi ka qenë e përfshirë në planet, elaboratet dhe aksionet me karakter gjenocidal të qeverisë së atëhershme jugosllave të koordinuara me qarqet shkencore dhe akademike serbe për dëbimin e shqiptarëve.

Reforma agrare ishte një aksion i cili edhe pse pretendohet se bëhej me qëllim të përmirësimit marrëdhënies pronësore-juridike dhe sociale-ekonomike si dhe pozitës së popullsisë fshatare, në thelb kishte për qëllim keqësimin e gjendjes edhe ashtu të rëndë të popullsisë shqiptare përmes marrjes së tokave duke i detyruar ata të shpërngulen, ndërsa në tokat e braktisura të shqiptarëve të silleshin kolonistë serbë me familjet e tyre. Autori J. Trifunoski duke relativizuar pasojat e reformës agrare thotë se Lufta I Ballkanike dhe Lufta I Botërore kanë ndikuar në masë të konsiderueshme në aktivizimin e rrymave të muhaxhirëve dhe ndërrimin etnik të popullsisë.¹ Ai thotë se disa shpërngulje të myslimanëve kanë filluar qysh prej vitit 1912. Kjo popullsi myslimane ka qenë kryesisht shqiptare, e cila nën masat e presionit ekonomik, politik e psikologjik, ka filluar të shpërngulet. Në tokat e braktisura të shqiptarëve janë sjellë kolonë serbë si në shpatet e Karadakut në perëndim, ashtu edhe të Rujanit në lindje. Kolonistëve të ardhur i është dhënë një sipërfaqe e konsiderueshme e tokës bujqësore, e cila me herët i është marrë shqiptarëve, edhe pse serbët thonë se kolonistët e ardhur janë vendosur në tokat djerrinë, bile disa prej tyre me gjendje më të mirë ekonomike e kanë blerë tokën.² Në shpatet e Rujanit dhe të Karadakut kolonëve të vendosur u jepej nga 5 ha tokë bujqësore ndërsa brenda territorit të fshatit shtëpitë e kolonëve serbë të ardhur ishin të grupuara dhe të vendosura kryesisht në hyrje të fshatit. Ato ishin në hyrje të fshatrave të mëdha, si për shembull në Rahovicë e Corroticë.³ Në këtë mënyrë regjimi jugosllav gjatë kësaj periudhe ka arritur deri diku me sukses të ndryshojë pasqyrën etnike dhe konfesionale në Luginën e Preshevës në dëm të popullsisë shqiptare dhe asaj myslimane. Këto ndryshime

¹ TRIFUNOSKI, J.: *Kumanovsko-Preševska Crna Gora*, SANU, Beograd, 1951, f. 104.

² KOSTIĆ, M.: *Preševska Koltlina*, Vranjski Glasnik, Knjiga V, Vranje, 1969, f. 113.

³ TRIFUNOSKI, J.: Po aty, f. 66.

vërehen sidomos në të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 1931 kur kemi rënie të numrit të popullsisë myslimane në Preshevë nga 89.42% në 76.08%, pastaj në Bilaç nga 76.19% në 64.06%, na Bujanoc nga 58.30% në 57.14% dhe në një vendbanim tjetër emri i të cilin nuk figuron në statistikat e regjistrimit nga 72.51% në vitin 1921, në 37.91% në vitin 1931.

Nëse analizojmë pjesëmarrjen e popullsisë ortodokse (serbe) në periudhën brenda viteve 1921-1931, shohim që kemi një rritje në shumicën e vendbanimeve të Rrethit të Preshevës. Kështu në Preshevë nga 10.57% sa ka qenë pjesëmarrja e popullsisë ortodokse, më 1931 ajo arrin në 23.67%, pastaj në Bilaç nga 23.78% në 35.85%, në vendbanimin emri i të cilit nuk figuron në burimin e cekur nga 27.49% në 37.91%, në Bujanoc nga 41.70% në 42.71%.

Tabela 3. *Popullsia e Rrethit të Preshevës për nga përkatësia fetare në vitin 1931*

Rrethi i Preshevës											
Nr	Vendbanimi	Totali	%	Muslimanë	%	Ortodoksë	%	Katolikë	%	Të tjerë	%
1	Presheva	7525	100	5725	76.1	1781	23.8	15	0.2	4	0.05
2	Bujanoci	10462	100	6081	57.1	4545	42.7	16	0.15		
3	C	6280	100	3898	62.1	2381	37.9	1	0.02		
4	Bilaçi	4789	100	3068	64.1	1717	35.9	4	0.08		
5	Zhunica	4183	100	19	0.45	4160	99.5	4	0.11		
6	Kleniki	2281	100			2281	100				
7	Klinoci	3399	100	1853	54.5	1545	45.5	1	0.03		
8	Levosova	1964	100			1964	100				
9	Novosella	1510	100	1	0.07	1508	99.9	1	0.07		
10	Shaince	1832	100	1	0.05	1824	99.6	7	0.38		
	Zhbevc										
	Totali	44405	100	20646	46.5	23706	53.4	49	0.11	4	0.01

Burimi: Popis stanovništva u Kraljevini Jugoslavije, Vardarska Banovina, Kumanovski Okrug, Preševski Srez 1931 godine, Knjiga II, Beograd, 1938, f. 104.

Shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Luginën e Preshevës

Një moment shumë i rëndësishëm në kuadër të zhvillimit demografik të popullsisë në Luginën e Preshevës është shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Sanxhaku i Nishit. Përmasat e këtyre shpërnguljeve,

që për nga forma dhe përmbajtja mundë të karakterizohen si spastrime etnike të territoreve, do të kenë pasoja të shumta në rrafshin demogjeografik, social-ekonomik e gjeopolitik për hapësirat emigruese, dhe për imigrueset.

Sanxhaku i Nishit ishte i katërti në Vilajetin e Kosovës. Përfshinte kazatë e Nishit, Pirotit, Leskocit, Vranjës dhe Znepolës. Në ndryshimet e mëvonshme administrative-territoriale brenda Sanxhakut, Kazaja e Vranjës i bashkohet Sanxhakut të Prishtinës. Struktura etnike e popullsisë në Sanxhakun e Nishit ishte e përzier. Popullsia shqiptare jetonte me shumicë në disa kaza të saj. Shqiptarët në numër të konsiderueshëm jetonin në Toplicë, Kurshumli, Kosanicë, Jabllanicë e Pusta Rekë. Përpos këtyre trevave popullsia shqiptare jetonte dhe në trevat e Veternicës, Gërdelicës e Masuricës.

Shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Sanxhaku i Nishit ndodh në kohën kur Serbia pas luftërave serbo-osmane e futë nën kontroll këtë territor, si dhe pas vendimeve të Kongresit të Berlinit me ç'rast fuqitë e mëdha të asaj kohe, si Rusia, Austro-Hungaria, Anglia e Franca i njohin Principatës Serbe sovranitetin mbi territorin e Sanxhakut të Nishit. Fuqitë e mëdha të kohës duke tentuar të fitojnë sa më tepër territore në Gadishullin Ballkanik nga Perandoria Osmane, aprovojnë në heshtje projektet serbe për shpërnguljen e shqiptarëve nga këto territore. Nuk dihet numri i saktë i popullsisë shqiptare të shpërngulur dhe për këtë ka variante të cilat thonë se janë shpërngulur 30000 banorë shqiptarë e deri mbi 200000 banorë shqiptarë. Përcaktimi i numrit sa më real të banorëve të shpërngulur mund të bëhet duke marrë parasysh numrin e vendbanimeve me popullsi shqiptare në Sanxhakun e Nishit. Në këtë territor kanë qenë rreth 600 vendbanime shqiptare, pra kryesisht me popullsi shqiptare, rreth 370 sosh dhe të tjerë me banorë të përzier.¹ Sipas historianit S. Uka numri i popullsisë shqiptare të shpërngulur nga Sanxhaku i Nishit sillet në rreth 200000 banorë.

Popullsia shqiptare e shpërngulur u vendos në qytetet e Kosovës, në Bujanoc, në Preshevë, në Maqedoni, një pjesë në Turqi. Në Preshevë dhe Bujanoc është vendosur kryesisht popullsia shqiptare e rrethit të Vranjës dhe Masuricës dhe atë kryesisht në fshatrat kodrinore të shpateve malore të Karadakut dhe Rujanit si në Corroticë, Raincë, Shoshajë e Poshtme, Rahovicë, Bushtran, Tërrnoc i Madh, Breznicë, Konçul etj.

¹ UKA, S.: *Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë*, Prishtinë, 1994, f. 29.

Brenda fshatrave popullsia muhaxhire¹ përbën lagje të veçanta si në Breznicë, Konçul, Corroticë e Rahovicë, ndërsa fshati Shoshajë e Poshtme, Rainca e Vogël, Reka e Thatë janë tërësisht të populluara me muhaxhirë të ardhur nga trevat e Masuricës. Duhet të përmendim faktin se pjesa dërmuese e muhaxhirëve të vendosur në Preshevë dhe Bujanoc janë të shpërngulur disa vite më vonë pas Kongresit të Berlinit. Këto ishin 14 fshatrat e trevës së Masuricës të Qarkut të Vranjës, banorët e të cilëve nuk u shpërngulën gjatë muajit të fundit të vitit 1877 dhe as gjatë vitit 1878. Këto ishin Suvojinca, Benovci, Prekodelci, Dllugojnica, Llukavica, Zhitoragja, Masurica Plakë etj.² Mirëpo presionet e vazhdueshme ndaj popullsisë shqiptare të Qarkut të Vranjës bënë që deri në vitin 1882 edhe ata të shpërngulen nga këto treva dhe të kalonin në anën e Perandorisë Osmane, në anën e Preshevës.³ Nga shpërngulja përjashtim bëjnë banorët e fshatrave të komunës së sotme të Medvegjës, të cilëve në fakt u ishte lejuar kthimi në shtëpitë dhe pronat e veta si në: Tupallë, Gërbavc, Llapashticë, Sfirçë e Brendshme, Sijarinë, Kapit dhe Dediq,⁴ si dhe Banjën e Sijarinës, Starabajë e Ramabajë. Nga një popullsi shqiptare prej rreth 200000 banorësh të shpërndarë në mbi 600 fshatra të Sanxhakut të Nishit, sot jetojnë vetëm disa qindra të shpërndarë në 9 fshatra. Pasojat e këtyre shpërnguljeve janë të nduarnduarshme duke filluar nga ato demogjeografike, sociale-ekonomike, gjeopolitike etj. Popullsia e shpërngulur dhe e vendosur nëpër fshatrat e Luginës së Preshevës shkaktoi varfërimin e mëtejshëm social dhe ekonomik të popullsisë së këtyre fshatrave edhe pse nuk mungoi mikpritja vëllazërore dhe atyre shumë shpejt iu gjet strehimi dhe ushqimi. U rrit numri i popullsisë bujqësore dhe asaj të mbajtur, u rrit dendësia agrare, e cila shkaktoi imtësimin e mëtejshëm të pronave etj. Shpërngulja e popullsisë shqiptare kishte për qëllim spastrimin etnik të territorit të pushtuar dhe kolonizimin e tij me popullsi serbe. Në këtë mënyrë shpërngulja e popullsisë shqiptare i ndihmoi Serbisë për të krijuar një realitet të ri etniko-demografik të cilin do të tentojë në periudhat e mëvonshme ta zbatojë edhe në Kosovë dhe në trojet tjera etnike shqiptare.

¹ *Fjalor i shqipes së sotme*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1984, f. 742.
Banorët e shpërngulur njihen si "Muhaxhirë", njerëz të shpërngulur ose refugjatë.

² Po aty, f. 46.

³ Po aty, f. 46.

⁴ VASOVIĆ, M.: *O jednoj šiptarskoj oazi u Gornjoj Jablanici*, "Zbornik Radova GIJC", Sveska V, Beograd, 1958, f. 87.

Popullsia shqiptare në Komunën e Medvegjës

Sikurse Presheva e Bujanoci edhe Medvegja përbën një pjesë të pandashme të trungut gjeoetnik shqiptar. Popullsia shqiptare e saj përbënte një masë territorialisht dhe etnikisht kompakte e cila në periudhat e kaluara ka pasur fatin edhe më tragjik se shqiptarët e Preshevës dhe të Bujanocit. Deri në vitin 1878 ajo ka jetuar me shumicë në shumë fshatra jo vetëm të Jabllanicës së Epërme, por edhe në rrethet e Toplicës, Kosanicës, Pusta Rekës, Masuricës, Gërdelicës e Vranjës. Pas vitit 1878 dhe vendimeve të Kongresit të Berlinit, viset e lartpërmendura bëjnë pjesë në kuadër të Mbretërisë Serbe. Nga kjo kohë fillon një periudhë ndoshta nga më tragjiket që ka përjetuar popullsia shqiptare, e përcjellë me vrasje, masakrime, dhunime, shpërngulje dhe formave tjera të ngjashme përmes të cilave është realizuar një spastrim etnik i përmasave të mëdha nga viset e lartpërmendura. Për dallim prej viseve tjera, në Jabllanicën e Epërme (Medvegja), për shkak të kontaktit me territoret kompakte shqiptare në Kosovë dhe pozitës së re kufitare me Vilajetin e Kosovës, kushteve natyrore, kompaktësisë etnike të fshatrave shqiptare, edhe pse mjaft e cunguar vazhdon të mbijetojë.

Mbretëria Serbe, me qëllim të ndryshimit të strukturës etnike në territoret që sapo i kishte futur nën kontrollin e vet, fillon të bëjë kolonizimin me popullsi serbe e malazeze. Kështu, në vitin 1880 ajo sjell Ligjin për Imigrim, i cili sipas përmbajtjes së vet i jepte lehtësime të shumta popullsisë së ardhur.¹ Ky ligj parashihte që çdo familjeje të ardhur t'i dhurohej deri 4 ha tokë punuese dhe 2 ari truall për ndërtimin e shtëpisë, ndërsa familjeve më të mëdha të tipit të kooperativave bujqësore (zadruga) mund t'u jepej edhe nga 2 ha tokë të punueshme për çdo mashkull të familjes me moshë mbi 16 vjet. Në aspektin e marrëdhënieve pronësore-juridike në dekadën e parë të ardhurit ishin në pozitën e shfrytëzuesit të tokës, e cila pastaj bëhej pronë e tyre. Këto dhe shumë hollësi të tjera, që përmbante në vete ligji na bënë të përfundojmë se ai ishte një ligj tipik i cili kishte për qëllim kolonizimin e vendbanimeve të boshatisura nga shqiptarët.

Intenca e Mbretërisë Serbe ishte që kolonizimin e këtyre territoreve ta bënte me popullsi malazeze, e cila për shkak të mentalitetit të saj malësor ishte e vrazhdë dhe e prirur për konflikte. Kështu, me disa marrëveshje ndërmjet saj dhe Mbretërisë Malazeze bëhet ardhja e disa mijëra malazezëve të cilët në mënyrë të planifikuar vendosen në zonën kufitare mes Perandorisë Osmane

¹ VASOVIĆ, M.: *Gornja Jablanica-Geografska svojstva*, Beograd, 1998, f. 86.

dhe Mbretërisë Serbe. Në fakt qëllimi nuk ishte mbrojtja fizike e Mbretërisë Serbe nga sulmet e mundshme prej territorit të Perandorisë, por ndërprerja e kontinuitetit etniko-demografik, gjuhësor e kulturor të popullsisë shqiptare të rrethit të Jabllanicës me atë të Kosovës si dhe krijimin e situatës së pasigurt përmes inskenimit të konflikteve ndërmjet popullsisë malazeze dhe shqiptare, presioneve dhe masave të tjera represive për të detyruar edhe atë popullsi të mbetur në Jabllanicën e Epërme (Medvegjë) t'i lëshojë vatrat e veta. Kolonizimi i suksesshëm i malazezëve në komunën e Medvegjës do të shërbejë si një model i mirë për t'u zbatuar më vonë edhe në Kosovë, më konkretisht në Rrafshin e Dukagjinit.

Mungesa e shënimeve për popullsinë e komunës së Medvegjës para vitit 1878 nuk na jep mundësi për ta vlerësuar numrin e popullsisë shqiptare në këtë anë. Por pas këtij viti bëhen regjistrime të cilat, edhe pse jo të plota, japin një mundësi për analiza të ndryshme demografike, me çka mund të përcillet zhvillimi demogjeografik i popullsisë në këtë komunë. Më poshtë po japim të dhënat e regjistrimit i cili njihej si “regjistrim i njerëzve dhe bagëtisë në territoret e reja të zbuluara në vitin 1878”. Ky regjistrim jep të dhëna vetëm për tetë vendbanimet e Jabllanicës së Epërme.¹

Prej 8 vendbanimeve të regjistruara, katër prej tyre: Tupalla, Svirca, Llapashtica dhe Kapiti janë me popullsi shqiptare, ku, sipas këtij burimi në 53 shtëpi kanë jetuar 383 banorë. Duke pasur parasysh që regjistrimi është bërë pas vendosjes së vijës së re kufitare në mes Serbisë dhe Perandorisë Osmane e cila është përcjellë me një valë të madhe të shpërnguljeve të shqiptarëve në drejtim të Kosovës, mangësive të vetë regjistrimit, mospërfshirjes së shumë fshatrave me strukturë etnike të përzier ku kanë jetuar edhe shqiptarët, mendojmë se këto të dhëna as për së afërmi nuk pasqyrojnë realitetin etniko-demografik në Jabllanicën e Epërme (komuna e Medvegjës). Mungesa e të dhënave të mjaftueshme nuk na lejon të analizojmë komponentet e ndryshme demografike të popullsisë përpos strukturës së popullsisë sipas moshës, e cila është në favor të popullsisë mashkullore, ndërsa kanë dominuar familjet e mëdha shumanëtarëshe me nga 9, 10 e më shumë anëtarë. Prej kësaj periudhe e deri në vitin 1910, në Mbretërinë e Serbisë janë realizuar edhe 3 regjistrime të popullsisë dhe shtëpive nëpër vendbanime të viteve 1893, 1900 dhe 1910. Edhe në këto regjistrime popullsia nuk deklarohet sipas përkatësisë kombëtare.

¹ Po aty, f. 114.

Në vendbanimet kompakte shqiptare gjatë këtyre tri periudhave të regjistrimit, që u përmendën, në regjistrimin e vitit 1878 kemi pasur rritje të vogël të popullsisë. Kështu, për shembull popullsia e Tupallës është rritur nga 292 banorë, sa ka pasur në vitin 1890, në 359 banorë në vitin 1900 dhe 488 banorë në vitin 1910; numri i banorëve të Sfirçës është rritur nga 389 në vitin 1890 në 501 në vitin 1900 dhe 673 në vitin 1910; numri i banorëve të Llapashticës është rritur nga 248 banorë në vitin 1890, në 322 banorë në vitin 1900 dhe 519 banorë në vitin 1910, ndërsa në Kapit nga 127 banorë në vitin 1890, në 169 banorë në vitin 1900 dhe 207 banorë në vitin 1910. Duhet cekur se përpos këtyre vendbanimeve, ku dominon popullsia shqiptare, kemi edhe shumë të tjera, në të cilat ajo është e pranishme në masë të konsiderueshme si: Sijarina, Starabaja, Gërbavci, Ramabaja, Banja e Sijarinës etj. Kjo rritje e pakonsiderueshme e popullsisë në vendbanimet kompakte shqiptare, por edhe ato të përziera nuk është rezultat i shtimit natyror të ulët të popullsisë, por i shpërnguljes së popullsisë në drejtim të Kosovës. Kështu edhe gjatë kësaj periudhe, edhe pse në përmasa më të vogla, vazhdon boshatisja e trojeve etnike shqiptare të Jabllanicës.

Veçori dalluese për komunën e Medvegjës është se ajo që nga vitet e 80-ta është shndërruar në një hapësirë emigruese prej të cilës shpërngulen si shqiptarët ashtu edhe bashkësitë e tjera etnike. Numri i popullsisë shqiptare shënon rënie të vazhdueshme dhe ai sot është reduktuar në vetëm disa qindra banorë. Pozita kufitare e vendbajmeve shqiptare të komunës së Medvegjës, izolimi komunikativ, mungesa e infrastrukturës dhe objekteve të tjera të standardit shoqërorë, por edhe presioni nga prania e shtuar e forcave policore dhe ushtarake serbe sidomos pas luftës në Kosovë, janë ndër faktorët kryesor shtytës të shpërnguljeve. Shumica e të shpërngulurve janë vendosur në qytetet e Kosovës si në Prishtinë, në Fushë Kosovë, në Kamenicë etj. Analizat e regjistrimit të fundit dhe daljet në terren na bëjnë të konkludojmë lirisht se boshatisja e fshatrave nga popullsia shqiptare në komunën e Medvegjës është në përfundim e sipër.

Regjistrimi i popullsisë dhe tendencat për ndryshimin e kompozicionit etniko-demografik në Luginën e Preshevës

Vitet të cilat përfundojnë me njësh janë vitet kur shtetet ndërmarrin aksionet për regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare. Këto regjistrime kryhen periodikisht në çdo dhjetë vjet në përputhje me porositë dhe rekomandimet e OKB-së. Edhe pse ekzistojnë forma të

ndryshme për grumbullimin e të dhënave mbi popullsinë dhe veçoritë e saj, regjistrimi i popullsisë paraqet aksionin më kompleks dhe më gjithëpërfshirës për grumbullimin e të dhënave mbi komponente të ndryshme të popullsisë siç janë ngjarjet vitale (lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkuroëzimet), pastaj të dhënat mbi strukturat e popullsisë sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor, përkatësisë etnike, konfesionale, gjuhësore, numrit të ekonomive familjare etj. Në këtë mënyrë shteti krijon një bazë të vlefshme të të dhënave, duke konstatuar situatën në rrafshin demografik, social-ekonomik e politik, për të drejtuar pastaj aktivitetet e veta me qëllim të riorganizimit, revitalizimit dhe përmirësimit të gjendjes së përgjithshme demografike, sociale-ekonomike, politike etj. Të gjitha planet, strategjitë dhe aksionet që ndërmerren shtetet kanë si pikënisje të fuqishme informacionet që i ofron regjistrimi i popullsisë, i cili përbën një nga projektet më të mëdha dhe më të shtrenjta të mbledhjes së të dhënave. Realizimi i suksesshëm i tij është në interesin e çdo shteti dhe shoqërie moderne.

Mbledhja e të dhënave mbi popullsinë e Luginës së Preshevës daton qysh nga Periudha Osmane. Këto informacione ishin mjaft të mangëta për faktin se ofronin të dhëna vetëm për numrin e shtëpive, banorëve dhe strukturën e tyre gjinore. Këto ishin kryesisht sallnamet dhe defterët të cilët pushteti osman i përpilonte për të pasur një pasqyrë të qartë mbi numrin e popullsisë taksapaguese. Në shekullin XVI pushteti osman realizon tri regjistrime dhe atë në vitin 1519, 1528 dhe 1570. Popullsia ishte regjistruar sipas përkatësisë fetare dhe të dhënat janë vetëm për numrin e familjeve. Periudha në të cilin ishin realizuar regjistrimet përkon me fillimin e konvertimit të popullsisë krishtere si katolike ashtu edhe ortodokse në konfesionin islam, proces që kishte përfshirë popullsinë shqiptare, serbe, vllehe etj. Këto regjistrime veçohen me të meta të shumta. Të dhënat janë marrë vetëm për numrin e familjeve dhe shtëpive nëpër vendbanime. Për këtë arsye të dhënat e dala nga këto regjistrime nuk japin një pasqyrë të qartë mbi strukturën etnike në Luginën e Preshevës. Kazaja e Preshevës, sipas statistikave zyrtare të Vilajetit në vitin 1883, kishte 15 846 banorë, prej të cilëve 8525 myslimanë dhe 7321 jomyslimanë¹, kurse Kazaja e Preshevës në vitin 1896/7 përfshinte 122 fshatra me 6958 ekonomi familjare dhe 42 248 banorë prej të tyre 22 224 meshkuj dhe 20 024 femra.²

¹ RIZAJ, S.: *Struktura stanovništva Kosovskog Vilajeta u drugoj polovini XIX stoleća*, Vranjski Glasnik, VIII, Vranje, 1972, f. 107.

² RIZAJ, S.: *Kaza Prešova 1896/7 godina*, Vranjski Glasnik, II, Vranje, 1966, f. 440.

Regjistrimet e popullsisë në Luginën e Preshevës vazhdojnë edhe gjatë periudhës së ekzistimit të Mbretërisë Jugosllave në vitin 1921 dhe 1931. Për dallim prej defterëve turk në këto regjistrime ishte përfshirë përkatësia fetare dhe gjuhësore, ndërsa nuk figuronte si kategori përkatësia etnike. Regjimi mbretëror jugosllav në koordinim me qarqet shkencore dhe akademike, në trojet shqiptare në Kosovë, në Maqedoni dhe në Luginën e Preshevës zbaton projektin e reformës agrare, i cili, me pretekstin e eliminimit të marrëdhënieve feudale, kishte për synim ndryshimin e pasqyrës etniko-demografike në dëm të popullsisë shqiptare dhe joserbe. Edhe pse jo në përmasat e shpërnguljeve në Kosovë, Luginën e Preshevës, një numër i popullsisë nën masat e presionit ekonomik, politik e psikologjik shpërngulet për në Turqi e Shqipëri. Në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve vërehet një zvogëlim i numrit të popullsisë myslimane (shqiptare).

Pas Luftës II Botërore në Jugosllavi bëhen edhe shtatë regjistrime. Popullsia shqiptare e Luginës së Preshevës sikurse shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë e bojkoton regjistrimin e vitit 1991 për shkak të suprimimit të gjendjes kushtetuese në Kosovë, largimit të punëtorëve shqiptarë nga institucionet shtetërore, situatën e brishtë të sigurisë, masave të represionit policor e ushtarak etj. Regjistrimi i fundit që është realizuar në Luginën e Preshevës është ai i vitit 2002, në të cilin edhe përkundër të metave të shumta të natyrës metodologjike dhe organizative të cilat nuk garantojnë një regjistrim normal, situatës postkonfliktuale, numrit të madh të shpërnguljeve, prezencës së madhe ushtarake dhe policore, popullsia shqiptare vendos të marrë pjesë në regjistrim.

Koncepcioni i popullsisë së pranishme: të metat dhe pasojat e aplikimit të tij

Në historikun e gjatë disa qindrvjeçar (regjistrimet e para të popullsisë u bënë në Evropë në pjesën e dytë të shekullit XVIII), të regjistrimit të popullsisë kemi një progres dhe avancim të dukshëm metodologjik, statistikor dhe teknik në procesin e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave. Në metodologjinë e regjistrimeve vazhdojnë të aplikohen dy koncepte: koncepti i popullsisë së pranishme dhe koncepti i popullsisë së përhershme. Koncepti i popullsisë së pranishme përfshinë në regjistrim të gjithë ata banorë të cilët në momentin kritik ndodhen në vendin e regjistrimit. Koncepcioni i parë

paraqet dobësi serioze për arsye se çdo person në momentin kritik regjistrohet dhe deklarohet si banor i atij vendi në të cilin gjendet në atë moment, ndonëse ai aty mund të ndodhet vetëm përkohësisht apo rastësisht.¹ Koncepti i dytë nënkupton regjistrimin dhe deklarimin e çdo personi si banor të përhershëm të atij vendi të banimit pa marrë parasysh se në momentin kritik të regjistrimit mund të mos ndodhet në vendin e përhershëm të banimit për shkak të punësimit, shkollimit, udhëtimit, vuajtjes së dënimit etj.

Edhe pse kohët e fundit në vendet e Evropës i jepet përparësi konceptit të popullsisë së pranishme, në rrethanat aktuale gjeopolitike të Gadishullit Ballkanik ku dominon një shkallë e lartë e heterogjenitetit në strukturën etnike të shteteve, ku ende nuk janë sanuar pasojat e konflikteve etnike dhe luftërave qytetare, ku kemi pasur një zhvendosje të madhe të popullsisë dhe zbatimin e formave të ndryshme të spastrimeve etnike të cilat për nga forma dhe përmbajtja kishin elemente të gjenocidit, mendojmë se aplikimi i konceptit të popullsisë së pranishme nuk është i përshtatshëm duke lënë vend për manipulime me qëllim të ndryshimit artificial të situatës demografike në terren. Kjo vlen sidomos për Serbinë në të cilën ekzistojnë disa bashkësi etnike si shqiptarët në Luginën e Preshevës, boshnjakët në Sanxhak, bullgarët në Serbinë Juglindore etj. Kontinuiteti gjeoetnik i këtyre bashkësive me hapësirat etnike “amë” në Kosovë, Bosnje, Bullgari etj, ka qenë një ndër shkaqet kryesore që i ka shtyrë serbët të ndër marrin aksione për të ndryshuar strukturën etniko-demografike në këto hapësira.

Koncepti i popullsisë së pranishme është aplikuar në regjistrimet e popullsisë ndërmjet dy luftërave botërore, për të vazhduar më pastaj me konceptin e popullsisë së përhershme deri në regjistrimin e vitit 1991. Në regjistrimin e fundit në Serbi (2002) përsëri zbatohet koncepti i popullsisë së pranishme me çka ajo rritë numrin e popullsisë serbe në nivel të Serbisë përmes regjistrimit të disa qindramijëra refugjatëve serbë nga Kroacia, Bosnja dhe Kosova, kurse në anën tjetër synon të zvogëlojë përqindjen e shqiptarëve në Luginën e Preshevës duke mos e përfshirë popullsinë e cila përkohësisht është në botën e jashtme. Sipas të dhënave nga komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë për vitin 2002, rreth 21% e popullsisë ishte në punë të

¹ ISLAMI, H.: *Rrjedha demografike shqiptare*, “Dukagjini”, Pejë, 1994, f. 109.

përkohshme në botën e jashtme ku pjesën dërmuese të tyre e përbëjnë shqiptarët. Nga kjo kuptojmë që të dhënat zyrtare të regjistrimit të vitit 2002 janë të mangëta përreth 24000 shqiptarë, e kjo rezulton me një kompozicion të ri dhe artificial etniko-demografik dhe një rrudhje të etnikumit shqiptar në rajon. Situata më delikate është në komunën e Preshevës, ku sipas të dhënave të ekspertëve vendorë (komunalë), përqindja e popullsisë në botën e jashtme arrin deri në 27%.¹ E gjithë kjo ka pasur reperkusionet e veta në rrafshin politik, ekonomik e social, sepse përmes këtij transformimi “kozmetik” të strukturës etnike është tentuar deri-diku me sukses të relativizohen dhe marginalizohen kërkesat e shqiptarëve për realizimin e të drejtave të tyre qytetare e kombëtare në kuadër të një rajoni të posaçëm.

Pjesëmarrja në regjistrimin i cili ishte mbajtur në Serbi gjatë pjesës së parë të muajit tetor të vitit 2011 të këtij viti për shkak të konceptit të aplikuar si dhe rrethanave aktuale politike e shoqërore do të rezultonte me një ndryshim edhe më të theksuar të pasqyrës etnike në Luginën e Preshevës në dëm të elementit etnik shqiptar.

Konflikti i armatosur ndërmjet UÇPMB-ës dhe forcave ushtarako-policore serbe i vitit 2001 ka pasur për pasojë shpërnguljen e popullsisë nga Karadaku i Preshevës dhe Malësia e Bujanocit, proces ky që vazhdon në ditët e sotme. Kohët e fundit po zhvillohet një “spastrim i qetë etnik” i Luginës së Preshevës. Familje të tëra shpërngulen në drejtim të vendeve të Evropës Perëndimore, kryesisht në shtetet e Beneluksit, Skandinavisë, Francës, Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë etj. Gjithashtu kemi zhvendosje të popullsisë, kryesisht të asaj të moshës së re, në drejtim të qendrave të mëdha të Kosovës: në Prishtinë, në Gjilan e gjetiu, për shkak të perspektivës më të mirë të punësimit, avancimit në karrierë etj.

Të gjitha faktet e lartpërmendura na lënë të kuptojmë se pjesëmarrja e popullsisë shqiptare në regjistrimin e vitit 2011 sipas metodologjisë së popullsisë së pranishme do të rezultonte me një përqindje shumë më të vogël të shqiptarëve në kuadër të Luginës së Preshevës. Pasojat do të ishin të natyrës politike, ekonomike e sociale në të gjitha komunat e Luginës së Preshevës, por situata më delikate do të jetë në komunën e Bujanocit me një dominim të butë të

¹ HYSENI, N.: *Popullsia si faktor i zhvillimit ekonomik të komunës së Preshevës*, Preshevë, 2004.

popullsisë shqiptare krahas asaj serbe, situatë kjo e cila rrezikon të ndryshohet në dëm të popullsisë shqiptare.

Për shkak të arsyeve të natyrës metodologjike, organizative, rrethanave aktuale politike dhe shoqërore mendojmë se duhet anuluar rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Luginën e Preshevës dhe i njëjti duhet të shtyhet derisa të përmirësohen mangësitë e lartpërmendura. Duke u ndodhur ndërmjet të rrezikut nga ndryshimi i pasqyrës etnike në Luginën e Preshevës në njërën anë dhe nevojës për regjistrimin e popullsisë në anën tjetër, mendojmë se në Luginën e Preshevës duhet bërë një regjistrim i posaçëm i monitoruar nga organizmat ndërkombëtar në mënyrë që rezultatet e dala nga regjistrimi të shprehin në mënyrë të drejtë dhe reale pasqyrën etniko-demografike në Luginën e Preshevës.

Përfundim

Për shkak të pozitës mjaft të volitshme gjeokomunikative dhe strategjike Lugina e Preshevës ka qenë hapësirë ku janë ndeshur ndikimet kulturore-civilizuese të perandorive dhe pushtuesve të ndryshëm, të cilat janë përcjellë me procese të shumta transformuese të natyrës gjeopolitike, demogjeografike, sociale e kulturore që kanë lënë gjurmë në popullsinë e këtij rajoni në aspektin vëllimor, etnik, fetar etj. Duke analizuar evoluacionin demogjeografik të Luginës së Preshevës nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme mund të konkludojmë për një banueshmëri të hershme të këtij rajoni. Popullsia shqiptare shënon një banim të vazhdueshëm nëpër të gjitha periudhat, ndërsa ajo shpeshherë i nënshtrohet proceseve emigruese duke u shpërngulur në drejtime të ndryshme, ndërsa në tokat dhe vendbanimet e boshatisura në mënyrë të planifikuar bëhet kolonizimi me popullsi serbe dhe malazeze.

Edhe përkundër të gjithë këtyre ndikimeve dhe transformimeve të cilat shpeshherë kanë rrezikuar asimilimin gjuhësor, kulturor dhe etnik, kemi pasur dominim të popullsisë shqiptare në strukturën etnike të popullsisë. Sikurse edhe në Kosovë dhe trojet e tjera etnike në ish-Jugosllavi, edhe në Luginën e Preshevës vëllimi, vazhdimësia etniko-demografike me popullsinë shqiptare në Kosovë, komponentet pozitive të shtimit natyror ishin dhe mbetën një ndër faktorët më të rëndësishëm të rezistencës ndaj asimilimit dhe spastrimit etnik të

Luginës së Preshevës. Regjistrimet e popullsisë në Luginën e Preshevës që nga periudha osmane e deri në ditët e sotme kanë pasur për qëllim pasqyrimin jo të drejtë etniko-demografik, duke zvogëluar numrin e shqiptarëve. Derisa në periudhat e hershme osmane dhe më vonë të Mbretërisë Jugosllave kjo është bërë përmes mospërfshirjes së kategorisë të përkatësisë etnike, në regjistrimet e mëvonshme kjo tendencë kamuflohet përmes përdorimit të metodologjisë së veçantë, e cila bazohet në konceptin e popullsisë së pranishme. Në këtë mënyrë në regjistrim nuk përfshihen një numër i konsierueshëm i popullsisë që jeton dhe punon në botën e jashtme.

Arsim EJUPI, Prishtina

DEMOGRAPHIC-GEOGRAPHIC DEVELOPMENT OF PRESHEVA VALLEY - RETROSPECTIVE OVERVIEW

Summary

Due to a very favorable geographical and geostrategic position, the Presheva Valley has been the region of cultural influences by various empires and conquerors, coupled with multiple transforming processes that belonged to geopolitical, demo-geographical, social and cultural nature that made impact on population of this region in terms of number, ethnicity, religion etc. An analysis of the demographic-geographical evolution of the Presheva Valley since ancient times shows that Albanians were indigenous population of this region. Albanians resided in that region during all periods, and they have been forced to migrate to different directions.

Despite all these influences and transformations, which often led to linguistic, cultural and ethnic assimilation, the Albanian always made the majority in the Presheva Valley. Just like with the case with Kosova and other ethnic territories in the former Yugoslavia, the Presheva Valley present and are present most important factors of resistance to assimilation and ethnic cleansing, i. e. number of population, demographic continuity with ethnic Albanian population in Kosova which are positive components of demographical regime. The censuses carried out in Presheva Valley from the time of the Ottoman rule until now aimed at presenting unrealistic view that is, reducing the number of Albanians. While in the early Ottoman period and later on during the Yugoslav Kingdom this was done through exclusion of the category of ethnicity, the follow-up censuses hid these trends using specific methodology based on the concept of the present population. In this way, the census does not include a considerable number of people who live and work abroad.

Fehari RAMADANI, Tiranë

QËNDRIMI I AUSTRO-HUNGARISË NDAJ LËVIZJES KULTURORE SHQIPTARE GJATË VITIT 1910

KDU 94(496.5).084'

*“...Ne nuk mund ta kuptojmë çlirimin e popujve ballkanikë
pa ndihmën që morën ata nga Fuqitë e Mëdha...”*

Stavro Skendi

Interesimi i qeverisë austro-hungareze për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare, në veçanti dhe për çështjen shqiptare në përgjithësi, daton nga mesi i shek. XIX. Ky interesim i Vjenës zyrtare në fakt reflektonte interesat e saj gjeostrategjike në Gadishullin Ballkanik. Perandoria Austro-Hungareze ishte në rivalitet me Perandorinë Cariste Ruse dhe më vonë edhe me Italinë për dominim në Ballkan. Nisur nga ky rivalitet, Austro-Hungaria duke përkrahur zhvillimin arsimor dhe kulturor të popullit shqiptar, përpiqej ta tërhiqte atë në anën e saj. Popujt tjerë të Ballkanit ishin përgjithësisht aleatë të Ruisë. Prandaj i vetmi popull që mund të ishte aleat i natyrshëm i Vjenës ishte ai shqiptar. Kjo ishte arsyeja që qeveria perandorake dhe mbretërore përkrahu përpjekjet e shqiptarëve për zhvillimin e tyre arsimor dhe kulturor.

Që nga marrëveshja e Rajhstagut (1876), Austro-Hungaria rriti aktivitetin e saj shumëdimensional, duke vënë në përdorim të gjitha mjetet politike, ekonomike, kulturore etj., për të përhapur e për të forcuar ndikimin e saj në Shqipëri. Nëpërmjet zhvillimit të tregtisë, hapjes dhe financimit të shkollave, ndihmesës së madhe për çështjet kishtare, kontributit të çmuar për shtypin shqiptar, madje duke u interesuar edhe për alfabetin dhe historinë e Shqipërisë, Perandoria Austro-Hungareze arriti t'i forcojë gjithnjë e më shumë pozitat e saj në Shqipëri. Ajo shfrytëzoi me shkathtësi në këtë drejtim dhe sundimin shtypës osman e synimet shoviniste të fqinjve.

Interesat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, shkruan studiuesi Zef Prella, përputheshin në “një pikë delikate” me interesat e qeverisë austro-hun-

gareze. Ishte rrezik që Shqipëria edhe pas shpalljes së pavarësisë të bëhej një “*Poloni ballkanike*” për shkak të synimeve pushtuese të fqinjëve të saj¹. Ishte në interesin e të dyja palëve që të pengohej vendosja e sundimit sllav në brigjet lindore të Adriatiku. Me këtë, shqiptarët do të ruanin territoret e tyre nga pushtimi i huaj, kurse Austro-Hungaria do të pengonte zgjerimin e mëtejshëm rus në Ballkan.

Pas aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës nga Austro-Hungaria (më 1908), Vjena i kushtoi një kujdes të veçantë zgjerimit të bazës së *Kultusprotektoratit* të saj në Shqipëri. Masat e ndryshme që duhej të shërbenin për këtë qëllim ishin: përgatitja e klerit katolik, financimi i shtuar i urdhrave katolike dhe institucioneve fetaro-kulturore si dhe i shkollave të ndihmuara financiarisht prej tyre, organizimi i peshkopatave, përfshirë edhe fuqizimin e ndihmesës financiare për organet e shtypit në gjuhën shqipe si dhe për personalitete të shquara shqiptare.

Një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin kulturor të popullit shqiptar, qeveria austro-hungareze vazhdoi ta jepte edhe gjatë vitit 1910, duke mbajtur e financuar shkollat e saj në Shqipëri.

Në një njoftim që i dërgohej Vjenës nga Shkodra më 15 maj të vitit 1910 jepej një përshkrim i hollësishëm i shkollave shqiptare për vitin shkollor 1909-1910, të financuara nga Perandoria Austro-Hungareze. Në të jepen të dhëna për mësuesit e këtyre shkollave, për arsimimin e tyre, si dhe numrin e klasave të secilës shkollë. Sipas këtij njoftimi qeveria e Vjenës gjatë vitit shkollor 1909-1910 financonte këto shkolla në trojet shqiptare²:

Shkodër: Kolegji i “*Françesk Saverit*”, që drejtohej nga jezuitët. Në kuadër të tij vepronin tre drejtime (shkolla): *Shkolla fillore e fretërve për djem*, e cila kishte 5 klasë, *Shkolla reale*, me tri klasë dhe *Shkolla tregtare*, me tri klasë. Në këto shkolla punën e mësuesit e ushtronin: P. Luigi Cattaneo, rektor i etërve jezuitë, 8 etër jezuitë që kishin mbaruar filozofinë, si dhe tre mësues shekullarë Kolë Thaçi, Pashko Gurakuqi dhe Lazër Gera.

Shkolla fillore e fretërve për djem përbëhej nga pesë klasë, me dy ndarje. Drejtor i saj ishte Atë Gjergj Fishta, kurse mësues, ishin: Atë

¹ PRELA, Zef. 1962. Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912), Në *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, (Përmbledhje studimesh kushtuar 50-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë)*. Tiranë, f. 131.

² Haus Hof und Archives, Politisches Archives, Wien, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Fondi: Dokumente të sjella nga Arkivi Shtetëror në Vjenë dhe të përthyerë në gjuhën shqipe, Vj. 20-14-1431. Njoftim nga Shkodra i 15 majit 1910. (Më tej: AIH, Vj...).

Ambroz Marlaskaj, Mati Logoreci, Gaspër Mikeli, Gaspër Beltoja, Kolë Kodheli, Alois Mushani dhe Palok Hoti. Mati Logoreci kishte të mbaruar Kolegjin Saverian, kurse Mikeli, Beltoja, Kodheli dhe Mushani kishin të mbaruar Shkollën Pedagogjike në Klagenfurt. Mësuesi Palok Hoti kishte mbaruar shkollën fillore italiane në Shkodër.

Shkolla fillore Stigmatine për vajza në Shkodër kishte gjashtë klasë. Drejtore e shkollës ishte motra e urdhrit S. Sanktacroce Cianciulli, kurse punën e mësueses e ushtronin tetë motra urdhri për “*literaturë e mësim punëdore*”. Për nga përkatësia kombëtare ato ishin të përziera. Kishte mësuese vendase, italiane dhe austriake.

Shkolla Stigmatine për vajza në Shirokë kishte një klasë me tri ndarje. Në të punonin katër motra urdhri për “*literaturë e mësim punëdore*”. Të katërtat kishin të kryer shkollën e vajzave në Shkodër.

Shkollat e djemve në Shirokë dhe Dajç-Bunë kishin nga një klasë me nga tri ndarje. Mësuesi i shkollës së parë kishte mbaruar Kolegjin Saverian, ndërsa mësuesi i shkollës së dytë, Shtjefën Maçi, ishte pa përgatitje shkollore.

Shkolla e djemve në Bushat, një klasë me dy ndarje. Mësuesi Mikel Agostini, kishte kryer shkollën fillore të fretërve.

Shkolla e djemve në Juban, një klasë me tre ndarje. Gjon Qerraxhia, mësuesi i saj, kishte kryer Kolegjin Saverian.

Shkolla e djemve në Selcë kishte një klasë. Ati françeskan, famullitari Jak Serreqi ushtronte punën e mësuesit.

Shkup: Shkolla shqipe katolike e famullisë. Kjo shkollë kishte tri klasë për djem, dy klasë për vajza dhe një kopsht fëmijësh. Mësues të saj ishin: Nikollë Rrota, i cili kishte mbaruar Shkollën Pedagogjike në Klagenfurt; Gjon Kajtazi kishte studiuar te *lazaristët* në Stamboll; Mehmet Teufiku, mësues i turqishtes, kishte të kryer shkollën *idadije* në Selanik. Mësuesja Protogena Be..., motër zemërdhimbshme, kishte studiuar në Zagreb dhe Charlotte Jusarit, motër zemërdhimbshme, e përgatitur gjithashtu në Zagreb.

Shkolla e Hekurudhës në Shkup ishte e organizuar në katër klasë dhe një kopsht fëmijësh. Mësues të saj ishin famullitari Jozef Ramaj, Nikollë Rrota (punonte edhe në shkollën tjetër të Shkupit), Nusret Efendiu, i përgatitur në shkollat osmane dhe Aloisa Bogdanoviq, i cili kishte kryer një kurs për kopsht fëmijësh në Tropan.

Shkolla katolike e famullisë në Ferizaj, me tri klasë. Punën e mësuesit në të e ushtronte famullitari Dom Pashk Krasniqi, i cili ishte arsimuar në shkollën françeskane në Shkodër.

Shkolla shqipe katolike e famullisë në Stubëll përbëhej nga tri klasë. Mësuesi i saj Dom Mikel Tarabulluzi, kishte mbaruar kolegjin e jezuitëve në Shkodër.

Shkolla katolike e famullisë në Janjevë kishte katër klasë për djem dhe tri për vajza. Mësues të saj ishin: Mata Ivanoviq, që kishte kryer shkollën fillore në Janjevë; Ivan Berisha, kishte kryer të njëjtën shkollë si i pari dhe Xhemail Arifi, mësues i turqishtes, kishte studiuar në shkollat osmane.

Shkolla katolike e famullisë në Letnicë kishte tri klasë. Mësues ishte Luka Filiç, i cili kishte kryer Kolegjin e Jezuitëve në Shkodër¹.

Në dokument thuhet se në dy shkollat e fundit mësimi zhvillohej në gjuhën sllave. Por sipas prof. Rexhepagiqit në vitin 1908 drejtori i shkollës së Janjevës ishte Pal Gjergja, shqiptar i Zarës, kurse mësues i klasës së parë ishte Ivan Berisha nga Janjeva. Angazhimi i mësuesve shqiptarë në shkollën e mësipërme është tregues se në të mësimi, krahas sllavishtes, zhvillohej edhe në gjuhën shqipe. Gjithashtu sipas katalogut të shkollës del se në ato vite nxënësit kanë mësuar edhe gjuhën shqipe². Këto argumente dëshmojnë se në shollën e Janjevës, krahas gjuhës sllave, mësimi është zhvilluar edhe në gjuhën shqipe. Një proces i njëjtë mësimor është zhbilluar edhe në shkollën e Letnicës³.

Prizren: Shkolla katolike e djemve kishte tri klasë me pesë ndarje. Mësuesi Anton Lezhja kishte kryer Shkollën Pedagogjike në Klagenfurt, kurse Lazër Lumezi e kishte kryer shkollën katolike në Prizren. Në atë shkollë punonin edhe dy mësues të tjerë Serafin Mitrovqi dhe Tahir bin Uzus, për të cilët nuk jepen të dhëna se ku i kishin kryer studimet. Por nga të dhëna të tjera burimore del se Mitrovqi e kishte kryer Shkollën Pedagogjike në Klagenfurt⁴. Ndërsa për mësuesin Tahir bin Uzus, ndonëse nuk kemi të dhëna

¹ AIH, Vj. 20-14-1431. Njoftim nga Shkodra i 15 majit 1910.

² REXHEPAGIQ, J., 1970. *Zhvillimi i arësimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në teritorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*. Prishtinë, f. 228; REXHEPAGIQ, J. 1972. Shkollat dhe arësimi në Kosovë nga fundi i shek. XVIII gjer më 1918. Në *Kosova-Kosovo*, nr. 1. Prishtinë-Priština, f. 210.

³ Për më tepër shih: RAMADANI, F. 2010. *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare 1900-1912*. Tetovë: Ars-zz, f. 68-69.

⁴ AIH, Vj. 17-8-802. Raport nr. 22, i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Kral, për Ministrinë e Punëve të Jashtme (Më tej: MPJ). Shkodër, 9 janar 1907.

të dokumentuara, por duke marrë për bazë faktin se në shkollën në fjalë ai jepte lëndën e gjuhës turke, mund të thuhet se ka pasur të kryer ndonjë shkollë osmane.

Shkolla katolike për vajza në Prizren kishte një klasë me tri ndarje dhe një kopsht fëmijësh. Në atë shkollë punonin dy motra zemërdhimbshme nga Zagrebi dhe dy motra zemërdhimbshme vendase¹.

Shkolla katolike në Gjakovë kishte vetëm një klasë me tri ndarje. Mësuesi i saj Ejëll (Engjëll) Ndoca, pesë vite kishte ndjekur mësimet në Kolegjin Papnor në Shkodër dhe dy vite kishte studiuar filozofi².

Shkolla e Pejës ishte vendosur në një lokal pranë shkollës katolike. Në të fëmijët meshkuj dhe femra i ndiqnin mësimet ndaras³.

Durrës: Shkolla fillore katolike për vajza e motrave zemërdhimbshme funksiononte vetëm me një klasë. Mësuesja motër Çeçilia Brisku, me përkatësi etnike austriake ose hungareze, ishte diplomuar si mësuese në kopshtin e fëmijëve. Një shkollë tjetër fillore ishte ajo katolike për djem në Rrëshen, e cila përbëhej nga dy klasë. Famullitari Dom Mark Vasa kishte kryer Kolegjin Papnor shqiptar nuk kishte asnjë kualifikim mësuesie⁴, por në mungesë të kuadrit punonte në cilësinë e mësuesit.

Kolegjin e mësipërm e kishte kryer famullitari Anton Lleshi, i cili punonte në shkollën katolike në Milot. Po ashtu edhe ky famullitar nuk kishte asnjë kualifikim për mësues.

Dioqeza e Sapës: Shkolla e djemve në Hajmel, me një klasë dhe tri ndarje. Mësuesi që punonte në këtë shkollë, Karl Shiroka, kishte mbaruar Kolegjin Saverian. Shkolla e djemve në Dajç Zadrimë, kishte të njëjtën strukturë sikurse shkolla e mësipërme. Në të punën e mësuesit e ushtronte françeskani Kol Zezaj.

Dioqeza e Lezhës: Shkolla e djemve dhe e vajzave e motrave zemërdhimbshme në Kallmet. Në këtë shkollë si mësuese punonin dy motra vendase, të cilat kishin kryer shkollën e vajzave në Shkodër.

Abacia e Mirditës: Shkolla e djemve në Orosh funksiononte me një klasë me tri ndarje. Mësuesi i saj Kolë Dema kishte mbaruar shkollën tregtare të jezuitëve.

¹ *Po aty*, Vj. 20-14-1431. Njoftim nga Shkodra i 15 majit 1910.

² *Po aty*.

³ REXHEPAGIQ, J., *vep. e përm. f.* 153, 234.

⁴ *AIH*, Vj. 20-14-1431. Njoftim nga Shkodra i 15 majit 1910.

Shkolla e djemve në Kashnjet kishte të njëjtën strukturë sikurse shkolla e Oroshit. Mësues i saj ishte Kolë Laca. Me një organizim të njëjtë, sikurse dy shkollat e sipërpërmendura, ishte edhe shkolla e djemve në Spaç. Në këtë shkollë në cilësinë e mësuesit punonte Zef Ndoci, i cili nuk kishte ndjekur asnjë shkollë¹.

Austro-Hungaria financonte edhe Kopshtin e fëmijëve servite dhe Shtëpinë e djemve jetimë në Shkodër. Në të parin punonin motra e urdhrit, Suora Maria Petroviq, e cila ishte eprore, pesë motra të tjera urdhri dhe tri ndihmëse, kurse në Shtëpinë e djemve jetimë drejtor ishte Br. Bernardin Dillingen, i cili kishte diplomuar në Shkollën Pedagogjike në Bregens. Një personalitet tjetër i dalluar i kësaj shtëpie jetimore ishte Br. Altman Fellingner, prefekt, që kishte të kryer seminarin për mësues në Shtrebersdorf. Djemtë jetimë frekuentonin shkollën e fretërve².

Përpos shkollave, kopshteve e jetimoreve të sipërpërmendura, Austro-Hungaria ka financuar edhe shkolla të tjera. Shkolla private katolike kanë vepruar edhe në trevën e Lumës³, në Tiranë⁴, në Durrës, në Vlorë⁵, në Zym, në Zllokuqan⁶. Këtij vargu shkollash mund t'i shtohet edhe një shkollë në trevën e Hotit (në Traboin)⁷, si dhe Ushtrimorja (Foshnjorja) *Fridrik Frabel* në Prizren, e themeluar në vitin 1907, por që filloi me punë më 1 shtator 1908. Si mësuese e saj u dallua Mikelangjela Çoba. Këtë ushtrimore e ndiqnin fëmijët (djem e vajza) të moshës tre deri në gjashtëvjeç. Çdo vit numri i nxënësve ishte 30-50⁸.

Qeveria austro-hungareze, përpos institucioneve edukativo-arsimore që kishte hapur dhe i financonte në territoret shqiptare, në të cilat mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, ndihmoi edhe në zhvillimin e gjuhës shqipe në kolonitë shqiptare jashtë vendit. Me ndihmën financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë nga viti 1901 në koloninë shqiptare në Borgo Erizzo (Arbënesh) të Zarës u hapën kurset e gjuhës shqipe.

¹ *Po aty*.

² *Po aty*.

³ *Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi i dytë, Rilindja Kombëtare, Vitet 30 të shek. XIX-1912*. 2002. Tiranë; "Toena", f. 301.

⁴ *Po aty*, f. 301, 351.

⁵ Stavro SKËNDI, 2000. *Zgjidhjet Kombëtar Shqiptar, 1878-1912*. Tiranë: PHOENIX & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, f. 238.

⁶ REXHEPAGIQ, J., *Shkollat dhe arësimi në Kosovë...*, f. 215.

⁷ REXHEPAGIQ, J., *vep. e për.*, f. 153.

⁸ *Po aty*, f. 237-238.

Më 30 mars 1910 guvernatori austro-hungarez në Zarë i paraqiste Ministrisë së Jashtme dëftesat e mësuesit të gjuhës shqipe në shkollat e Borgo Erizzos, Anton Palucës, me të cilat vërtetohej se ai kishte marrë 1.000 korona të dërguara nga Ministria e Jashtme¹. Në nëntor të vitit 1910 Ministria e Jashtme e njoftonte guvernatorin e saj në Zarë se i kishte dërguar 1.000 korona të tjera, “që të përdoren për përballimin e rrogës mujore prej 200 koronash të mësuesit të gjuhës shqipe... Anton Paluca... për kohën 1 tetor... 29 shkurt të vitit të ardhshëm”².

Shkollat e sferës së *Kultusprotektoratit*, duke ndihmuar shkollat laike shqipe, si p.sh. shkollën e djemve dhe të Shkollat austro-hungareze të cilat funksiononin në trojet shqiptare ishin shkolla fetare. Qeveria osmane kishte lejuar hapjen dhe funksionimin e tyre, e shtrënguar nga marrëveshjet e Kultusprotektoratit, në bazë të të cilave Austro-Hungaria kishte fituar të drejtën e mbrojtjes së katolikëve në Perandorinë Osmane. Megjithatë, qeveria austro-hungareze në disa raste dilte edhe jashtë vajtave në Korçë³ etj. Por këto ndihma jepeshin në mënyrë të fshehtë. Në disa raste, për të mos rënë në sy të autoriteteve osmane, Vjena refuzonte të jepte ndihma financiare për shkollat shqipe.

Hapja e Normales së Elbasanit (1 dhjetor 1909) përbën ngjarjen më të rëndësishme të Lëvizjes sonë Arsimore të periudhës së Rilindjes Kombëtare, pasi mori përsipër të përgatiste mësues për të gjitha shkollat shqiptare dhe ia doli aq për sa i premtuan rrethanat. Mirëpo Normalja përballej me vështirësi të mëdha financiare. Kontributet që jepnin atdhetarët shqiptarë për funksionimin me sukses të saj ishin të pamjatueshme, kurse qeveria osmane, e cila duhej të kujdesej për shkollimin e nënshtetasve të saj, jo vetëm që nuk e ndihmonte arsimin shqip, por i nxirrte atij një varg pengesash. Prandaj drejtuesit e Normales u detyruan të kërkonin ndihma nga jashtë. Kështu, Dervish bej Biçaku, i cili ishte kryetar i Këshillit administrativ të Normales, vendosi të kërkonte ndihma nga Austro-Hungaria. Në një vizitë, që i bëri konsullatës austro-hungareze në Durrës, Dervish beu do të kërkojë ndihmë nga ministri i jashtëm vjenez, konti Aehrenthal⁴.

¹ AIH, Vj. 20-2-250. Raport nr. 442/7, i guvernatorit e mb. në Zarë, për MPJ. Mars 1910.

² *Po aty*, Vj. 20-I-161. Njoftim nr. 3085, i MPJ për guvernatorin p. dhe mb. në Zarë. Vjenë, 21 nëntor 1910.

³ Për ndihmat financiare të qeverisë së Vjenës për Shkollën e vajzave në Korçë, shih: RAMADANI, F., *vep. e përm.*, f. 45-46, 59-60.

⁴ AIH, Vj. 19-2-208. Relacioni nr. 1627-29 nga Durrësi për ministrin e jashtëm von Aehrenthal, më 27 maj 1910.

Drejtuesit e Shkollës Normale planifikonin për vitin vijues shkollor 1910-1911 të ngritnin një godinë të re, sepse ekzistuesja nuk i plotësonte kërkesat gjithnjë në rritje për ndjekjen e mësimit atje. Në vitin e parë të funksionimit të saj shkolla kishte 160 nxënës, prej të cilëve 70 ishin bursistë, kurse për vitin vijues planifikohej që numri i nxënësve të arrinte në 1.000, prej të cilëve 600 do të ishin bursistë, kurse 200-250 do të ishin konviktorë. Për realizimin e gjithë këtij projekti kombëtar Dervish beu kërkonte ndihmë nga qeveria e Vjenës¹, pasi drejtuesit e shkollës nuk ishin në gjendje pa një ndihmë të jashtme ta realizonin me sukses planin e tyre.

Marrëdhëniet midis Perandorisë Austro-Hungareze dhe Perandorisë Osmane ishin përmirësuar pas ftohjes që patën në vjeshtën e vitit 1908 me aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës nga Perandoria Danubiane. Rrjedhimisht Ballhausplatzi nuk dëshironte që përsëri të kishte mosmarrëveshje me Portën e Lartë. Qeveritarët e Vjenës kishin frikë se dhënia e ndihmës për Shkollën Normale të Elbasanit do të merrej vesh nga Stambolli dhe kjo do t'i zemëronte qeveritarët osmanë². Për këtë arsye baroni Bornemisza nga ambasada austro-hungareze në Jeniqoj* propozonte që ndihma eventuale të maskohej “*në formë gjoja të një fushate, që paska organizuar Dervish Beu, me anën e shqiptarëve të atjeshëm me rastin e një qëndrimi në Vjenë*”³.

Planet e atdhetarëve shqiptarë për zgjerimin e objekteve të Normales dhe rritjen e numrit të nxënësve u prishën nga vendimi i Portës së Lartë për ta mbyllur shkollën. Mbyllja e Normales së Elbasanit në gusht të vitit 1910⁴ ishte një goditje e rëndë që i bëhej Lëvizjes Arsimore. Qeveria osmane nuk kishte ndërmend të lejonte rihapjen e Normales qoftë në Elbasan, qoftë në ndonjë qytet tjetër shqiptar. Prandaj udhëheqësit e Lëvizjes Arsimore Shqiptare, si Dervish bej Biçaku e Luigj Gurakuqi do të kërkojnë ndihmë materiale nga Austro-Hungaria “*...për të mundur që të riçelin institutin pedagogjik të Elbasanit, të mbyllur prej qeverisë turke*”,

¹ *Po aty.*

² *Po aty*, Vj. 19-2-211. Relacioni nr. 58H dërguar Vjenës nga Jeniqoi, më 15 korrik 1910.

*Jeniqoi ishte lagje e Stambollit ku ishin të vendosura përfaqësitë e huaja diplomatike.

³ *Po aty.*

⁴ Krah.: BARTL, P. 2006. *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare 1878-1912*. Tiranë: Dituria, f. 207, shënimi 8; *AIH*, Vj. 19-2-213. Relacioni nr. 449, që L. AMBROZY nga Roma i dërgonte Aehrenthalit në Vjenë, më 5 tetor 1910; REXHEPAGIQ, J., *vep. e përm.*, f. 216; *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar, vëllimi I*. 2003. Tiranë: Nënë Tereza, f. 215.

qoftë në Bosnjë, qoftë në Egjipt¹, në Itali, në Zvicër apo në ndonjë vend tjetër².

Në vitet e fundit të sundimit osman një pjesë e atdhetarëve shqiptarë i kishte kthyer sytë drejt Perandorisë Austro-Hungareze. Ata ishin të bindur se kjo Perandori ishte e vetmja Fuqi që mbështeste Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, pa pasur pretendime pushtuese. Në grupin e atdhetarëve shqiptarë që shpresonin në ndihmën e Vjenës ishte edhe Dervish Hima.

Në një letër që Dervish Hima i dërgonte konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër theksonte se “*lufta kundër edukimit (arsimit-F. R.) shqiptar është e rreptë nga ana e qeverisë*”. Prandaj ai kërkonte ndihmën e qeverisë austro-hungareze për hapjen e disa shkollave “*të vogla midis myslimanëve... shqiptarë*” në disa krahina të vendit. Gjatë një vizite, që ai kishte zhvilluar në Vjenë para pak kohësh, një zyrtar i Ministrisë së Jashtme, i kishte premtuar atij se “*në mënyrë formale departamenti do ta jipte pëlqimin e tij*” (nënvizimi në origjinal), për hapjen e shkollave. Nëpërmjet letrës Dervish Hima e pyeste konsullin e përgjithshëm se çfarë mendimi kishte ai “*për themelimin e disa shkollave*”, që ai planifikonte t’i hapte pas tre muajsh, kur të kthehej në Shqipëri. Nëse një gjë e tillë do të realizohej, ai premntonte se nëpërmjet gazetës së tij “Shqiptari” dhe nëpërmjet “*shtypit mik*” sigurisht se do të “*arrijmë të bëjmë një përshtypje të mirë*”³ për mbështetjen e qeverisë së Vjenës për arsimin në gjuhën shqipe. Brenda pesë ditësh Dervish Himës i kthehej përgjigje nga Vjena. Në letër thuhej se në Ministrinë e Jashtme vazhdonte të ekzistonte “*gatishmëria më e madhe*” në lidhje me çështjen e hapjes së atyre shkollave. Por kërkohet nga Dervish Hima që t’i njoftonte autoritetet përkatëse në Vjenë se në cilat vende ai planifikonte t’i hapte ato shkolla. Duhej të raportonte dhe për personelin mësimor dhe buxhetin që ai mendonte se mund ta siguronte nga miqtë e tij⁴ për realizimin e këtij projekti fisnik.

Dervish Hima fillimisht kishte planifikuar të hapte shkolla shqipe në krahinën e Dibrës dhe kërkesën e mësipërme e kishte bërë për

¹ *AIH*, Vj. 19-2-213. Relacioni nr. 449, që L. AMBROZY nga Roma i dërgonte Aehrenthalit në Vjenë, më 5 tetor 1910; *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik...*, f. 217.

² *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik...*, f. 217.

³ *AIH*, Vj. 20-6-662. Letër e drejtorit të gazetës “Shqiptari”, Dervish Hima, për konsullin e përgjithshëm. Pera, 18 prill 1910.

⁴ *Po aty*, Vj. 20-6-660. Letër nga Vjena për redaktotin e gazetës “Shqiptari”, D. Hima. Vjenë, 23 prill 1910.

këtë qëllim. Mirëpo, pas një muaji, siç duket ai kishte ndryshuar mendje në lidhje me vendin e hapjes së shkollave. Në qershor të vitit 1910 ky atdhetar iu drejtua Vjenës me një kërkesë të re për hapjen e shkollave në krahinat në jug të Dibrës. Në një raport të diplomatit austro-hungarez Rappaport thuhet: “*Ndërsa ai hapjen e shkollave në Dibër etj., e rezervon për më vonë, hëpërhë dëshiron që të ngrihet një shkollë vetëm në Strugë (Ohër) dhe në Bërzeshtë (midis Starovës dhe Elbasanit)*”¹. Rappaport e shihte të arsyeshme që kërkesa në fjalë të realizohej, prandaj ai i jepte vetes të drejtë që t’u propozonte zyrtarëve të tij në Vjenë: “*...që Dervish Himës t’i akordohet për mbajtjen e dy shkollave të projektuara një shumë të nevojshme prej 3.000 frangash për një vit*”, kurse shpenzimet tjera do të jepeshin në varësi të suksesit që do të kishin këto shkolla². Siç duket qeveria austro-hungareze e miratoi këtë kërkesë pasi i depozitoi pranë Wiener Bankverein-it 3.000 franga, të cilat do t’i paguheshin Dervish Himës nga filiali i Stambollit³.

Në një raport, që zëvendëskonsulli Halla i dërgonte nga Durrësi ministrit të tij të Punëve të Jashtme, kontit von Aehrenthal më 26 maj të vitit 1910, parashtronte dëftesën e Fuad bej Toptanit për marrjen e 15.650 frangave, të cilat qeveria e Vjenës ia kishte dhënë si ndihmë për hapjen e shkollave dhe realizimin e projekteve tjera të planifikuara nga ai dhe vëllai i tij, Fazil Pasha⁴.

Në kuadër të funksionimit të suksesshëm të shkollave të saj në Shqipëri, qeveria e Vjenës dha një kontribut të çmueshëm për botimin e teksteve shkollore dhe të veprave të tjera shkencore dhe letrare në gjuhën shqipe.

Në maj të vitit 1910 konsullata e Shkodrës e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, se kjo konsullatë kishte marrë në dorëzim 500 ekzemplarë të Katekizmit të Ri shqip, pjesa e parë. Nga këto, 170 ekzemplarë ishin vënë në dispozicion të shkollës jezuite dhe 20 të tjerë iu dhanë “*misionit të jezuitëve ambulantë*”⁵. Kurse shkollat tjera të Shkodrës dhe

¹ *Po aty*, Vj. 20-9-944. Raport pa numër i kons. Rappaport dërguar Vjenës më 15. 6. 1910.

² *Po aty*.

³ *Po aty*.

⁴ *Po aty*, Vj. 20-1-144. Raport i nënkonsullit Halla për ministrin e jashtëm, kontin von Aehrenthal, më 26 maj të vitit 1910.

⁵ *Po aty*, Vj. 20-11-1148. Raport nr. 164/2, që Zambaur i dërgonte nga Shkodra MPJ në Vjenë më 12 maj 1910.

të fshatrave përreth do vazhdonin të punonin me katekizmat e vjetër, të përgatitur me alfabetin e Mjedës, “*derisa ato të harxhoheshin krejt*”¹.

Tekstet për shkollat e financuara nga Austro-Hungaria botoheshin nga Shtëpia Botuese e Librit Shkollor perandorak e mbretëror në Vjenë². Më 19 tetor 1910, Drejtoria Qendrore e Shtëpive Botuese të Librit Shkollor e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme, se kishte shpenzuar 444 korona e 74 hellerë për botimin e Katekizmit të vogël shqip me një tirazh prej 2.000 ekzemplarësh. Shuma e sipërpërmendur duhej të shlyhej nga kjo Ministri pranë arkës së Shtëpisë Botuese³. Kurse më 14 dhjetor 1910 po kjo Drejtoria e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme se kishte shpenzuar 929 korona e 70 hellerë për botimin e Librit të Leximit shqip, pjesa e dytë, me një tirazh prej 1.600 ekzemplarësh dhe i lutej Ministrisë në fjalë, që të depozitonte shumën e sipërpërmendur pranë arkës së Shtëpisë Botuese⁴.

Përveç librave shkollorë, qeveria austro-hungareze ndihmonte edhe në botimin e librave tjerë në gjuhën shqipe. Në një dëftesë, që dr. Gjergj Pekmezi i dërgonte Vjenës në janar të vitit 1910, dëshmonte se ai kishte marrë në dorëzim nga qeveria vjeneze 600 korona, si ndihmë për botimin e *Bibliografisë Shqiptare*⁵. Në janar të po atij viti nënkonsulli austro-hungarez në Shkodër, Lejhanec, i dërgonte Ministrisë së Jashtme një dëftesë të françeskanit Atë Gjeçovi, me të cilën vërtetonte se ky atdhetar kishte marrë rregullisht një shumë prej 200 koronash. I ishte akorduar atij si shumë e jashtëzakonshme për botimin e një vepre në gjuhën shqipe⁶.

Në vitin 1910, shoqëria *Dija* kishte botuar në Manastir një kalendar të atij viti. Mirëpo kjo shoqëri përballej me vështirësi të mëdha financiare. Prandaj dr. Gjergj Pekmezi, në emër të shoqërisë *Dija* kërkonte nga Vjena, që t’i akordonte asaj një shumë prej 300 ose të paktën 200 koronash për mbulimin e shpenzimeve, pasi botimi i mësipërm “*konsiderohej si një ndërmarrje kombëtare*”⁷.

¹ *Po aty*.

² *Po aty*, Vj. 20-11-1175. Njoftim i Drejtorisë Qendrore të shtëpive botuese të Librit shkollor p. e mb., nr. 6290, drejtuar MPJ, më 19 tetor 1910.

³ *Po aty*.

⁴ *Po aty*, Vj. 20-11-1183. Njoftim i Drejtorisë Qendrore të shtëpive botuese të Librit shkollor p. e mb., nr. 7224, drejtuar MPJ, më 14 tetor 1910.

⁵ *Po aty*, Vj. 20-4-493. Dëftesë e Dr. Gj. Pekmezit drejtuar Vjenës, më 13 janar 1910.

⁶ *Po aty*, Vj. 20-2-256. Dëftesë nr. 819/2 ex 09 e françeskanit Patër Gjeçov drejtuar Ministrisë së Jashtme në Vjenë, 27 janar 1910.

⁷ *Po aty*, Vj. 20-4-494. Lutje e Dr. Gj. Pekmezit drejtuar Vjenës, më 19 prill 1910.

Gjergj Pekmezi bënte korigjimin e librave shqip të botuar në Vjenë, për të cilin aktivitet ai shpërblehej nga Ministria e Punëve të Jashtme e Austro-Hungarisë. Në një urdhëresë të datës 16 dhjetor 1910, që kjo Ministri ia drejtonte shefit të seksionit të botimit të librave shkollor, von Wolf, e urdhëronte këtë të fundit që t'i paguante dr. Gj. Pekmezit shumën prej 100 koronash si kompensim për korigjimin që ai i kishte bërë Librit të Leximit shqip, pjesa e dytë. PAGESA e shumës do të bëhej përkundrajt një dëftese¹, të cilën Pekmezi do ta nënshkruante dhe kjo do të shërbente si dëshmi se ai e kishte marrë shumën e mësipërme.

Në dhjetor të vitit 1910 konsullata e përgjithshme austro-hungareze në Shkodër i paraqiste Ministrisë së Jashtme veprën në dorëshkrim të autorit Dom Ndre Mjeda, të titulluar *Historia e shenjtë*. Konsulli propozonte që teksti në fjalë të shtypej në 1.500 ekzemplarë, aq sa nevojiteshin për shkollat të cilat ishin nën juridiksionin e asaj konsullate².

Krahas ndihmave të vazhdueshme financiare për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe, qeveria austro-hungareze ndihmonte edhe personalitete të shquara shqiptare, të cilët ishin veprimtarë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në fund të dhjetorit të vitit 1909, Ballhausplatzi njoftonte nënkonsullin Lejhanec, se i kishte dërguar 6.000 franga, me të cilat duhej të mbulohej kësti i parë i tremujorit janar-mars të vitin 1910 për Preng Pashën³.

Në raste të caktuara, Ministria e Jashtme e qeverisë austro-hungareze ndihmonte financiarisht personalitetet shqiptare për veprimtarinë e tyre politike. Në fillim të janarit të vitit 1910, konsullata austro-hungareze e Prizrenit e njoftonte Ballhausplatzin se shuma prej 400 frangave, akorduar imzot Lazër Mjedës, ipeshkvi të Ipeshkvnisë Shkup-Prizren i ishte dorëzuar atij. Në të njëjtën kohë ipeshkvi i përmendur i paraqiste Ministrisë një dëftesë me të cilën vërtetonte se shuma e mësipërme i ishte dorëzuar atij. Kjo ndihmë i ishte akorduar Mjedës për të mbuluar "*shpenzimet e bëra gjatë zgjedhjeve të deputetëve*" të Shkodrës⁴.

¹ *Po aty*, Vj. 20-11-1184. Urdhëresë nr. 171, e Ministrisë së Punëve të Jashtme për shefin e seksionit të botimit të librave shkollor, von Wolf, më 16 dhjetor 1910.

² *Po aty*, Vj. 20-11-1185. Raport nr. 630/2, i konsullatës së përgjithshme në Shkodër për MPJ. Shkodër, 15 dhjetor 1910.

³ *Po aty*, Vj. 19-1-109. Njoftim nr. 3780 i MPJ për konsullin Lejhanec në Shkodër. Vjenë, 24 dhjetor 1909.

⁴ *Po aty*, Vj. 20-9-954. Raport nr. 2 i kons. në Prizren për MPJ. Prizren, 4 janar 1910.

Në janar të vitit 1910, Ballhausplatzi e njoftonte nënkonsullin e saj në Shkodër Lejhanec se për këtë vit do t'i akordonte Gjergj Fishtës, një ndihmë financiare personale prej 500 koronash. Njëkohësisht i kërkohej Lejhanecit që ta njoftonte poetin shqiptar se ndihma në fjalë nuk i jepej atij në cilësinë e kryetarit të kuvendit të Gjuhadorit, por “*vetëm duke çmuar meritat e tij personale që ka për çyshtjen nacionale shqiptare dhe për letërsinë shqipe*”¹. Brenda javës Atë Fishta i paraqiti Ministrisë së Jashtme dëftesën me të cilën vërtetonte se konsullata e përgjithshme në Shkodër i kishte dorëzuar atij shumën e mësipërme². Nga këto relacione del qartë se qeveria austro-hungareze përpiqej që nëpërmjet ndihmave financiare t'i stimulonte personalitet shqiptare të kohës të kontribuonin sa më tepër në zhvillimin e çështjes kombëtare shqiptare. Qëllimi kryesor i saj ishte zhvillimi kulturor dhe ngritja e vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar.

Preng Bib Doda edhe gjatë vitit 1910 vazhdonte të merrte ndihma të rregullta financiare nga Ballhausplatzi. Në fillim të prillit të atij viti ai i paraqiste një dëftesë Ministrisë së Jashtme për marrjen e kështit të dytë të atij viti. Kësti tremujor arrinte shumën prej 6.000 frangave³. Ndhimja të rregullta financiare nga Ministria e Jashtme merrte dhe kapedani i Mirditës, Marka Gjoni. Për çdo tremujor ai merrte nga 2.000 franga. Nëpërmjet një dëftese ai vërtetonte se kishte marrë nga konsullata e përgjithshme në Shkodër ndihmën e mësipërme për korrik-gusht-shtator⁴. Aty nga fundi i shtatorit, Ballhausplatzi e njoftonte konsullin von Zambauer se shuma prej 2.000 frangash kishte arritur në zyrën postare perandorake dhe mbretërore në Shkodër. Rrjedhimisht autorizojë konsulli që ta tërhiqte dhe t'ia dorëzonte Marka Gjoni, për të mbuluar tremujorin e fundit të vitit 1910⁵.

Qeveria e Vjenës ishte e interesuar të mbante marrëdhënie të mira me qeverinë xhonturke dhe këmbëngulte në ruajtjen e *status quo*-së në Ballkan dhe përgjithësisht në Perandorinë Osmane. Për këtë arsye ajo në të shumtën e rasteve ndihmën financiare për personalitetet shqiptare e kushtëzonte me “*moszhvillimin e agjitacionit*” kundër xhonturqve. Kështu, në vitin 1909 Fazil pashë Toptanit i ishte akorduar një ndihmë prej 15.000

¹ *Po aty*, Vj. 20-1-120. Njoftim nr. 27 i MPJ për nënkons. Lejhanec në Shkodër. Vjenë, 7 janar 1910.

² *Po aty*, Vj. 20-11-1196. Dëftesë e Gjergj Fishtës për MPJ. Shkodër, 12 janar 1910.

³ *Po aty*, Vj. 21-11-1199. Dëftesë e Bib Dodës për MPJ. Shkodër, 13 prill 1910.

⁴ *Po aty*, Vj. 20-6-669. Raport nr. 82 i kons. në Shkodër për MPJ. Shkodër, 31 gusht 1910.

⁵ *Po aty*, Vj. 20-6-670. Njoftim nr. 2621 i MPJ për konsullin në Shkodër, von Zambaur. Vjenë, 26 shtator 1910.

koronash, por ai ishte kushtëzuar që ato “*të mos i përdorte për agjitacion kundër xhonturqve, por vetëm për qëllime thjesht kulturore dhe letrare të shqiptarëve*”. Nëse Fazil pashë Toptani do t’u përmbahej kushteve të mësipërme, atëherë i premttohej atij se një shumë e tillë do t’i akordohej edhe vëllait të tij Fuat beut. Sipas një raporti të nënkonsullit Halla për Ministrinë e Jashtme në fillim të prillit të vitit 1910 Fazil pasha u ishte përmbajtur kushteve të vëna nga qeveria austro-hungareze, prandaj nënkonsulli propozonte që shuma prej 15.000 koronash, e premtuar për Fuat beun, t’i dorëzohej atij. Ballhauplatzi pranoi propozimin e Halles dhe e autorizoi atë që shumën e mësipërme t’ia dorëzonte Fuat beut, duke e njoftuar njëherësh se ajo do të ishte ndihma e fundit për ata “*për qëllime kulturore dhe letrare*”. Por në qoftë se vëllezërit Toptani do të themelonin shkolla shqipe, ashtu siç kishin premtuar në shtatorin e vitit 1909, atëherë Ministria e Jashtme do ta shqyronte mundësinë e akordimit të ndonjë ndihme tjetër “*në masën e zakonshme si instituteve analoge në pjesët tjera të Shqipërisë*”¹.

Gjatë vitit 1910 Dervish Hima mori 12.500 franga ndihma nga qeveria austro-hungareze, prej të cilave 6.000 franga ndihmë të rregullt dhe 6.500 franga ndihmë të jashtëzakonshme².

Në fillim të janarit 1910 Ministria e Jashtme austro-hungareze aprovoi një ndihmë financiare prej 600 koronash për Gjergj Pekmezin. Sipas dëftesës së tij, kjo shumë i ishte dorëzuar menjëherë³. Në mars Ministria e Jashtme i kishte akorduar Preng Tahirit një ndihmë prej 160 frangash. Pas një muaji, në prill ai i paraqiste Ministrisë dëftesën për marrjen e shumës në fjalë⁴. Nga ana tjetër, qeveria vjeneze vazhdoi të derdhte mjete financiare për veprimtarë shqiptarë. Kështu, në fund të shtatorit, Pekmezit iu dhanë edhe 90 korona, për të mbuluar shpenzimet që kishte bërë ai për t’u ndihmuar disa bashkatdhetarëve të tij, të cilët kishin shkuar në Vjenë “për t’u pranuar në punë” ose për t’u regjistruar në “institucionet” e atjeshme⁵. Gj. Pekmezi, krahas ndihmave të jashtëzakonshme mjaft të shpeshta, vazhdonte të merrte ndihma të rregullta nga qeveria e Vjenës. Në nën-

¹ *Po aty*, Vj. 20-I-140. Njoftim sekret nr. 1224 i MPJ për nënkons. Halla në Durrës. Vjenë, 14 maj 1910.

² *Po aty*, Vj. 21-13-1314. Dokument mbi Dervish Himën. Vjenë, 21 gusht 1911. *AIH*, Vj. 21-5-542. Dokument mbi Dervish Himën. Vjenë, 21 gusht 1911.

³ *Po aty*, Vj. 20-4-492. Dëftesë e Dr. Pekmezit për MPJ. Vjenë, 13 janar 1910.

⁴ *Po aty*, Vj. 20-I-164. njoftim sekret nr. 49 i Prohaskës për MPJ. Prizren, 6 prill 1910.

⁵ *Po aty*, Vj. 20-I-172. Dëftesë e Gjergj Pekmezit për marrjen e shumës prej 90 koronave. Vjenë, 28 shtator 1910.

tor dhe dhjetor 1910 dhe janar 1911 ai i paraqiste Ministrisë së Jashtme tri dëftesa me të cilat vërtetonte se kishte marrë tri herë nga 120 korona, si ndihmë të rregullt, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 1910¹.

Një fushë tjetër që ndihmohej nga Austro-Hungaria ishte ajo e fesë katolike. Marrëveshjet e Kultusprotektoratit parashikonin pikërisht ndihmat për fenë dhe institucionet katolike në Perandorinë Osmane dhe mbrojtjen e tyre nga Austro-Hungaria. Në këtë drejtim, që nga mesi i shkurtit të vitit 1910 Ministria e Jashtme e njoftonte konsullatën e përgjithshme në Shkodër, se provincialit të françeskannëve, Palucit do t'i paguhej vetëm ndihma e zakonshme semestrale (gjysmë-vjetore) prej 1.440 koronash, kurse kuvendit të Gjuhadorit, do t'i caktohej një ndihmë vjetore prej 1.300 koronash².

Për çdo ndihmë që Ministria e Jashtme u akordonte institucioneve a personaliteteve të ndryshme, konsullatat austro-hungareze ishin të detyruara t'i dërgonin Vjenës dëftesat, me të cilat vërtetohej dorëzimi i ndihmave. Kështu në mars të vitit 1910 konsullata e Shkodrës i paraqiste Ministrisë dëftesat e ipeshkvit të Sapës, imzot Serreqit për marrjen e 500 koronave, që i ishin akorduar si “*dhuratë për përfundimin e meremetimeve në famullinë e Iballës*”. Famullitari Atë Çiril Zani, kishte nënshkruar një dëftesë për marrjen e 900 koronave, të cilat i ishin akorduar si kontribut për “*adoptimet në strehën*” në Shalë. Ndihma të tjera financiare u ishin dhënë famullitarëve në Nikaj e Rrapshe të Malsisë së Mbishkodrës. Famullitari Atë Pjetër Vrusha kishte paraqitur dëftesë për marrjen e 700 koronave për restaurimin e kishës në Nikaj, kurse famullitari Atë Sebastian Hila paraqiste dëftesë për marrjen e 1.600 koronave, akorduar atij si kontribut për restaurimin e famullisë në Rrapshe³.

Në ndonjë rast qeveria austro-hungareze u tregua tepër e kujdeshme në raport me ndihmat financiare që i derdhte në Shqipëri. Me sa duket këtë e bënte për të mos provokuar reagimin e Perandorisë Osmane. Sidoqoftë, nëpërmjet një njoftimi sekret ajo autorizonte konsullin von Zambaur në Shkodër që të tërhiqte shumën prej 5.000 franga-

¹ *Po aty*, Vj. 20-4-455. Tri dëftesa të Gjergj Pekmezit. E para 1 nëntor 1910, e dyta 1 dhjetor 1910 dhe e treta 1 janar 1911.

² *Po aty*, Vj. 20-9-947. Njoftim nr. 9699/6, i MPJ për konsullatën e përgjithshme në Shkodër. Vjenë, 16 shkurt 1910.

³ *Po aty*, Vj. 20-12-1269. Raport nr. 66/2 i konsullatës në Shkodër për MPJ. Shkodër, 23 mars 1910.

ve nga zyra postare perandorake dhe mbretërore. Nga kjo shumë, 4.500 korona do t'i dorëzoheshin imzot Preng Doçit, me të cilat do të shlyhej kësti i katërt për vitin 1909/10¹. Krahas ndihmës së zakonshme, abatit të Mirditës qeveria austro-hungareze edhe gjatë vitit 1910 i akordoi një ndihmë të jashtëzakonshme prej 20.000 frangash².

Një kontribut të rëndësishëm qeveria austro-hungareze dha edhe për zhvillimin e shtypit shqiptar. Shumë nga gazetat shqiptare që botoheshin gjatë vitit 1910 e kishin të pamundur ekzistencën e tyre pa një ndihmë financiare nga qeveria vjeneze.

Në vitin 1909 Dervish Hima hartoi një projekt, që parashikonte themelimin e një gazete* në gjuhën shqipe. Meqenëse ai përballej me vështirësi financiare dhe e kishte të pamundur ta realizonte projektin, iu drejtua për ndihmë qeverisë austro-hungareze. Ministria e Jashtme miratoi kërkesën e Dervish Himës për t'i akorduar atij një ndihmë vjetore prej 6.000 frangash, të cilat ai do t'i merrte në çdo tremujor. Sipas një shënimi të konsullit Kuriatkowski, këstin e parë prej 1.500 frangash ai do ta merrte në Vjenë, kurse këstin e dytë do ta merrte duke filluar nga shkurti i vitit 1910. Sipas një dëftese të paraqitur nga Dervish Hima, këstin e parë ai e kishte marrë nga Kuriatkowski³. Kësti i dytë nuk i ishte dorëzuar në kohë këtij intelektualit dhe atdhetari, prandaj në një letër që i dërgohej Dervish Himës nga Vjena, në prill të vitit 1910, Artur Rabler, përfaqësues i Postës Qendrore në Vjenë i propozonte atij që të caktonte një bankë në Pera ose Gallatë, pranë së cilës do të mund t'i dërgoheshin këstet tjera të ndihmës⁴. Në maj të atij viti, ndihma prej 1.500 frangash, iu dërgua Dervish Himës nëpërmjet Wiener Bankverein Degës së Stambollit⁵.

Drejtimesit e gazetës "Bashkimi", e cila dilte në Shkodër, i dërguan

¹ *Po aty*, Vj. 20-I-124. Njoftim sekret nr. 747 i MPJ për konsullin von Zambaur në Shkodër. Vjenë, 29 mars 1910.

² *Po aty*, Vj. 20-I-126. Njoftim sekret nr. 1771 i MPJ për konsullin e përgjithshëm në Shkodër, von Zambaur. Vjenë, 24 qershor 1910.

* Gazeta quhej *Shqipëtar* (Arnavud), numri i parë doli më 31. 12. 1909 në Pera-Stamboll. Drejtor Dervish Hima. (DAKA, P. 1971. Bibliografi retrospektive e shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë e v. 1848-1944. Në *Studime historike*, nr. 4. Tiranë, f. 195)

³ *AIH*, Vj. 19-9-978. Shënim sekret i kons. von Kviatkowski (datë 17 nëntor 1909).

⁴ *Po aty*, Vj. 20-6-660. Letër e A. Rabler, përfaqësues i Postës Qendrore në Vjenë, për D. Himën. Vjenë, 17 prill 1910.

⁵ *Po aty*, Vj. 20-6-654. Dokument pa firmë. Vjenë, 9 maj 1910.

disa numra ish-konsullit Rappaport, i cili në atë kohë ishte në shërbim në Ministrinë e Jashtme në Vjenë. Këta ekzemplarë iu dërguan atij, pa kërkesën e tij paraprake për një gjë të tillë. Në numrin e fundit, që ia dërguan atij ata patën përpiluar edhe një shënim në gjuhën shqipe: “Ju lutemi të na njoftoni a dëshironi të abonoheni në gazetë...”. Ky shënim ishte kuptuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme si kërkesë për një “ndihmë materiale”. Prandaj në qershor 1910 Ministria kërkonte nga konsulli i saj në Shkodër, von Zambaur, të shprehte mendimin e tij në lidhje me dhënien ose jo të ndihmës. Gjithashtu Ministria e njoftonte konsullin se akordimi i një ndihme të tillë nuk mund të kalonte shifrën e 2.000 frangave në vit¹. Në fillim të korrikut Zambaur u deklarua pro akordimit të një ndihme për gazetën në fjalë² dhe brenda muajit Ministria e Jashtme i akordonte “Bashkimit” një ndihmë prej 1.000 frangash për gjashtëmujorin e parë të vitit 1910. Ministria e autorizonte konsullin që shumën e mësipërme ta tërhiqte nga zyra e postës perandorake e mbretërore në Shkodër dhe t’ia dorëzonte drejtuesit të gazetës, Dom Ndoc Nikajt³. Në fillim të gushtit të atij viti Zambaur i paraqiste Aehrenthalit dëftesën e Dom Ndoc Nikajt, me të cilën vërtetonte se ai e kishte pranuar shumën prej 1.000 frangash⁴.

Në nëntor të vitit 1910 Ministria e Punëve të Jashtme e Austro-Hungarisë i kishte dërguar këstin e radhës Dervish Himës për gazetën e tij “Bashkimi”, e cila ndryshoi emërtimin, pasi më parë mbante emrin “Shqipë-tari”, emër të cilin D. Hima premonte se do t’ia rikthente sërish. Gazeta kishte filluar të shtrihej në një hapësirë të gjerë, përfshirë edhe Shqipërinë e Veriut, prandaj ajo, sipas Ministrisë, e meritonte plotësisht ndihmën financiare. Marrjen e 1.500 frangave e vërtetonte edhe vetë D. Hima⁵.

Gazetave shqiptare u jepeshin edhe kredi nga institucione të ndryshme austro-hungareze. Kështu, gazeta “*Bashkimi i Kombit*”^{*}, e

¹ *Po aty*, Vj. 20-6-647. Njoftim nr. 1720, i MPJ për konsullin në Shkodër, Zambaur. Vjenë, 21 qershor 1910.

² *Po aty*, Vj. 20-6-648. Raport i konsullit Zambaur për ministrin e Jashtëm, Alois von Aehrenthal. Shkodër, 7 korrik 1910.

³ *Po aty*, Vj. 20-6-649. Njoftim nr. 2062 i MPJ për konsullin e përgjithshëm në Shkodër, von Zambaur. Vjenë, 21 korrik 1910.

⁴ *Po aty*, Vj. 20-6-650. Raport nr. 69 i kons. Zambaur për Aehrenthalin. Vjenë, 4.8.1910.

⁵ *Po aty*, Vj. 20-6-655. Kësti i Nëntorit i subvencionit të rregullt për Drevish Himën. Vjenë, 10 nëntor 1910; Dëftesë e Dervish Himës. Vjenë, 10 nëntor 1910.

* “Bashkim’i Kombit”, gazetë javore, dilte në Manastir. Kryeredaktor i saj Fehim ZAVALANI. (DAKA, P., Bibliografi retrospektive..., *Studime historike...*, f. 193).

cila dilte në Manastir, gjatë vitit 1910 mori një kredi prej 10.000 koronave nga Oda e Tregtisë dhe Zejtarisë në Vjenë¹.

Fazil pashë Toptani, nga shtatori i vitit 1910 filloi të botonte në Kaj-ro të Egjiptit gazetën “Shkreptima”². Mirëpo edhe kjo gazetë, ashtu si pjesa dërrmuese e gazetave shqiptare që dilnin në atë kohë përballë me vështirësi financiare. I ndodhur në një situatë të tillë, Fazil Toptani, i cili kishte vizituar Vjenën, kërkoi nga Ministria e Punëve të Jashtme e Austro-Hungarisë që t’i akordonte një ndihmë financiare për gazetën e tij. Megjithëse në atë kohë përhapja e shtypit shqiptar në Perandorinë Osmane kishte shënuar një rritje të madhe dhe në Vjenë mendonin se në radhë të parë duhej të ndihmoheshin gazetatat shqipe, që dilnin brenda trojeve shqiptare për dallim nga ato që dilnin jashtë, por prapëseprapë duke marrë parasysh qëndrimin e “Shkreptimës” si dhe “qëndrimin personal të Fazil Toptanit dhe lidhjet e tij të afërta me Ismail Qemalin” e nxitën Ministrinë e Jashtme që t’i aprovonte një ndihmë të menjëhershme prej 3.000 koronash. Kjo ndihmë u realizua në fillim të janarit të vitit 1911, ndërsa Fazil Toptani paraqiti një dëftesë përkatëse për marrjen e saj³.

Qeveria austro-hungareze ndihmoi financiarisht edhe klubet shqiptare. Shpeshherë me ndërmjetësimin e konsujve të saj në trojet shqiptare, Ballhausplatzi u dërgonte klubeve harta dhe libra që lidheshin me Shqipërinë dhe shqiptarët, si dhe mjete financiare të cilat në disa raste, përdorreshin nga klubet, për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe.

Klubi shqiptar i Filatit nëpërmjet Musa Hamitit, në vitin 1910 kërkoi ndihmë nga Ministria e Jashtme e Austro-Hungarisë. Ndihma e akorduar në vitin 1909 ishte përdorur nga klubi për të blerë libra në gjuhën shqipe. Konsulli Bilinski i propozonte Ballhausplatzit që edhe këtë radhë t’i akordohej një ndihmë prej 200 frangash⁴. Propozimi i Bilinskit gjeti mbështetje në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Në një njoftim sekret që i dërgohej atij në prill të vitit 1910 vihej në dijeni se klubit të Filatit i ishte akorduar ndihma financiare prej 200 frangash⁵.

Austro-Hungaria përpos hapjes dhe financimit me mjetet e saj të shkollave në gjuhën shqipe brenda Shqipërisë, si dhe mbajtjen e kurseve të

¹ *AIH*, Vj. 20-83. Dokument pa firmë. Vjenë, 30 dhjetor 1910.

² DAKA, P., Bibliografi retrospektive..., Në *Studime historike...*, f. 196.

³ *AIH*, Vj. 21-8-879. Dokumenti me titull: Fazil Toptani. Vjenë, janar 1911.

⁴ *Po aty*, Vj. 20-I-148. Raport i kons. në Janinë Bilinski për MPJ. Janinë, 25 mars 1910.

⁵ *Po aty*, Vj. 20-I-149. Njoftim sekret nr. 965 i MPJ për kons. Bilinski. Vjenë, 19 prill 1910.

gjuhës shqipe në Borgo Erizzo, ngritjen arsimore të të rinjve shqiptarë e ndihmoi edhe me akordimin e bursave për ta. Shumë të rinj shqiptarë nëpërmjet bursave austro-hungareze studuan në shkollat perandorake, si në Vjenë, Innsbruk, Mydling, Klagenfurt etj.

Në janar të vitit 1910 drejtori i konviktit shqiptar në Vjenë, Leb, i dërgonte shefit të seksionit Wolf, një listë të shpenzimeve të bursistëve shqiptarë, për tremujorin e fundit të vitit 1909. Sipas raportit, për studentët shqiptarë ishin bërë disa shpenzime të jashtëzakonshme, të cilat arrinin shumën e 553,71 koronave*. Nga i njëjti raport kuptojmë se shuma e kërkuar i ishte dorëzuar drejtorit Leb më 12 janar 1910¹.

Nga një njoftim që Ballhausplatzi i dërgonte shefit të Seksionit von Wolf dhe Ministrisë së Tregtisë, sipas të cilit bëhej e ditur se Ministria e Jashtme kishte dërguar shumën prej 4.588 koronave me të cilat do të mbuloheshin bursat për nëntë bursistë shqiptarë të vendosur në konviktin shqiptar në Vjenë. Nga shuma e mësipërme, prej 4.588 koronash, 2.970 korona do të përdreshin për të shlyer bursat tremujore (15 prill - 15 korrik 1910) të nëntë konviktorëve. Secili prej tyre merrte nga 110 korona në muaj. Kuota prej 1.500 koronave llogaritej si pagesë e veçantë për tremujorin e dytë. Kurse shuma e mbetur prej 118 koronave dërgohej për të mbuluar shpenzimet, që ishin kryer nga koha e mbërritjes në konvikt të nëntë bursistëve, më 12 mars deri më 15 prill të atij viti².

Nga fundi i korrikut të vitit 1910, Ministria e Jashtme e ngarkonte shefin e Seksionit Wolf, që të paguante për llogari të Ministrisë së Tregtisë shumën prej 4.572 koronave. Kjo Ministri shumën e mësipërme do ta përdorte për të mbuluar bursat për periudhën 15 korrik-15 tetor 1910 të nëntë konviktorëve shqiptarë, të vendosur në konviktin shqiptar në Vjenë. Nga shuma e mësipërme, 2.970 korona do të përdreshin për të mbuluar bursat mujore për tre muajt në vazhdim; 1.500 korona të tjera “si paradhënie për shpenzime”, për tremujorin e tretë dhe shuma prej 102 koro-

* Lista e shpenzimeve dukej si më poshtë: Emin Aga 4,09 korona, Luigj Kromiqi 53,70 korona, Kol Margjini 42,82 korona, Engjëll Suma 63,62 korona, Lukë Lukaj 173,90 korona, Ramadan Duka 4,37 korona, dhe Kol Çurçia 80,52 korona. Gjithashtu për bursistët në fjalë ishin shpenzuar edhe 130,69 korona, për “*trajtım mjekësor*”. Nëpërmjet raportit Leb i lutej shefit të Seksionit që ta shlyente shumën e mësipërme.

¹ *AIH*, Vj. 20-12-1273. Raport nr. 101224/6 i drejtorit të konviktit Leb për shefin e seksionit Wolf. Vjenë, 8 janar 1910.

² *Po aty*, Vj. 20-13-1390. Njoftim nr. 19377/6, i MPJ për shefin e seksionit von Wolf dhe Ministrinë e Tregtisë. Vjenë, 4 prill 1910.

nave do të ishte “një tepricë e kuotës së ushqimit”¹. Në tetor të atij viti Ministria e Jashtme dërgonte një shumë tjetër prej 4.470 koronave për shlyerjen e bursave të nëntë konviktorëve shqiptarë². Më 31 tetor Ministria e Tregtisë e njoftonte Ballhausplatzin se shuma e mësipërme ishte pranuar nga ajo dhe se shpejt do të bëhej pagesa³.

Gjatë vitit 1910 Nikollë Dragusha dhe Angjelin Kromçi, që të dy nga Shkodra u dërguan për të ndjekur studimet në shkollat austro-hungareze. I pari me bursë të qeverisë vjeneze i filloi studimet për teologji dhe filozofi në Seminarin Teologjik në Innsbruck, kurse i dyti, me shpenzimet e familjes u dërgua në Vjenë, ku më 1910 dha provimin në “programin mësimor të qytetëses” në gjuhë gjermane⁴.

¹ *Po aty*, Vj. 20-14-1406. Njoftim nr. 46206/6 i MPJ për shefin e seksionit Wolf dhe Ministrinë e Tregtisë. Vjenë, 27 korrik 1910.

² *Po aty*, Vj. 20-14-1411. Njoftim nr. 61403/6 i MPJ për shefin e seksionit Wolf dhe Ministrinë e Tregtisë. Vjenë, 6 tetor 1910.

³ *Po aty*, Vj. 20-14-1416. Njoftim nr. 25 i Minis. së Tregtisë për MPJ. Vjenë, 31.10. 1910.

⁴ Asllani, U. 2000. *Studentët shqiptarë në Austri dhe kontributi i tyre për shtetin shqiptar*. Tiranë: Ilar, f. 254, 221.

Fehari RAMADANI, Tirana

AUSTRO-HUNGARIAN STAND ON ALBANIAN CULTURAL MOVEMENT IN 1910

Summary

After the suppression of the uprising in 1910, the Ottoman Empire launched a ruthless campaign against cultural development of Albanians. Schools, clubs and newspapers in Albanian were closed; the persecution of teachers, supporters of Albanian alphabet and Albanian patriots ensued. Anyone who possessed even a single book in Albanian could be persecuted; The *Union of the Nation* newspaper was shut down, while its editors Fehim Bey Zavalani and Gjergj Qiriazi were arrested.

In the period when Albanian schools were closed, Albanian teachers and the leaders of National Movement were persecuted, the Government of 'Young Turks' made efforts to spread further schools in Turkish language and even allowed Serbs to reopen 300 schools in the Balkan territories of Ottoman Empire. The Greeks also were allowed to open schools. Only the right of Albanians to be educated in their own mother tongue was denied.

Fortunately, in the abovementioned circumstances, in the in Albanian areas were functioning also the schools funded by Vienna's Government with classed in Albanian. Albanian patriots, driven by the need to promote education in Albanian and in absence of national schools, began more and more to attach importance to the schools funded by Austro-Hungarian Government.

Austro-Hungary also made an important contribution to the development of school texts and books in Albanian. It helped edition of a series of press organs in Albanian which played an important role in the dissemination of national ideas of that time.

Many prominent personalities of Albanian National Movement received considerable assistance from Austro-Hungarian Government. This financial assistance enabled them to continue their activity in the interest of national issue. The imperial and royal government also provided assistance to Albanian clubs, Albanian Catholic religious institutions, Catholic priests, and so on.

In addition, it was of special importance the assistance provided by Vienna's Government for the education of young Albanians in the schools of the Empire. The young attended classes in different Austro-Hungarian schools especially in those fields which were not available in Albanian lands of that time. The winners of scholarships awarded by

the Government and other Austro-Hungarian institutions were not only Albanian Catholic Young Men but also Albanian Muslim Young Men. This is an indicator that Vienna had as its goal further general cultural development of Albanian nation, regardless of religion.

Austro-Hungary expressed its interest, firstly, to develop Albanian nation in the cultural aspect and then after the creation of proper conditions to enable this nation to create its national state. The Austro-Hungarian diplomats kept insisting on having frequent meetings with the leaders of Albanian National Movement and arguing that it would be difficult for Albanians to develop their independent state without a cultural development.

Pajazit NUSHI, Prishtinë

HASAN TAHSINI DHE PIKËPAMJA E TIJ PËR KAUZALITETIN SHPIRTËROR

KDU 159.9

Abstrakt

Hasan Tahsini është ndër veprimtarët e Rilindjes Kombëtare që u mor me studime shkencore dhe i pari studiues shqiptar i psikologjisë. Botoi qysh më 1894 traktatin Psikologji ose Ilmi Ruh – Shkenca mbi shpirtin. Traktati ka formë libërthi të pakompletuar; u përkthye nga osmanishtja në shqipe më 1979 dhe u botua më 2007.

Fetari dhe besimtari Hasan Tahsini, i njohur edhe me emërtimin Hoxha Tahsini, në studimin çështjeve shpirtërore përgjithësisht ka kaluar caqet e zhvillimit të mendimit religjioz e metafizik dhe ka hyrë në fushën e mendimit shkencor për jetën psikike. Këto procese i lidhi ngusht me proceset neurofiziologjike të trurit dhe të pjesëve të tij, që ishin argumentuar eksperimentalisht. Proceset neurofiziologjike të trurit i ka konsideruar bartëse të proceseve psikike dhe shkaqe të tyre. Mendimi psikologjik i Hasan Tahsinit shtresohet në themelin e zhvillimit të psikologjisë ndër shqiptarët.

Termet e koncepteve kryesore: doktrina e fakulteteve mentale, eksperimenti, logjika e psikologjia, mendimi pozitivist, procese njohëse, shkak i lindjes dhe shkak i zhvillimit të proceseve psikike.

Tekstura kauzale dhe kauzaliteti

Mendimi i shqiptarëve në kohën e Rilindjes Kombëtare ka pasur për objekt shqyrtimi çështjet atdhetare, politike, iluministe, kulturo- arsimore, të ngritura mbi themelin e raportit mendor përgjithësues të relacionit shkak – rrjedhim për të vërtetën shqiptare. Sipas këtij relacioni çdo dukuri, ngjarje, ndryshim, proces i një mjedisi është i lidhur me dukuritë, ngjarjet, ndryshimet e tij. Ky relacion mendor përbën domethënien e termit të vjetër filozofik teksturë kauzale, që psikologu amerikan Egon Brunswik e ripromovoi edhe në gjysmën e parë të shekullit njëzet. Sipas tij njerëzit e perceptojnë mjedisin e tyre dhe ndryshimet e tij në bazë të probabilitetit empirik të dukurive të caktuara. Njohja e kësaj ndërlidhjeje sillet prej të panjohurës deri te varësia absolute e ndryshimeve nga shkakut ose shkaqet

e caktuara. Gjykime vlerësuese të këtij relacioni shfaqi Sami Frashëri në veprën e tij “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është dhe çdo të bëhëtë”. Qasje në relacionin mendor të këtij tipi të teksturës kauzale i kanë bërë çështjes shqiptare e zgjidhjes së saj në rend të parë Sami Frashëri, por edhe rilindësit e tjerë, si Naim Frashëri, Jani Vreto, Vaso Pasha, Hasan Tahsini, etj. që në vitet 1830–1840. Nga ky këndvështrim H. Tahsini dallon nga të tjerët si hulumtues, i cili ka bërë kërkime duke u mbështetur në lidhje të koncepteve a nocioneve abstrakte sipas së cilës lidhje efekti i një dukurie, gjendjeje e procesi paraprak përcakton dukurinë, gjendjen e procesin që pason menjëherë pas tij. Megjithëse ky relacion nuk është gjithmonë i domosdoshëm H. Tahsini i është përmbajtur. Këtu ndryshon domethënia e termit teksturë kauzale dhe kauzalitet. H. Tahsini në studimet e tij ka përdorur më tepër domethënien e termit kauzalitet. Përdorimi i kauzalitetit me domethënie të lartpërmendur dallon në kërkimin e fakteve shkaktuese dhe raporteve konstante ndërmjet tyre jo vetëm në hulumtimin e dukurive fizike, biologjike, e sociale, por edhe në gjurmimin e dukurive dhe të proceseve shpirtërore. Kjo është qasja themelore që dallon sidomos në zbatimin e metodave gjurmuese objektive dhe mbi rezultatin e zbatimit të të cilave ka interpretuar sistemin e njohurive për natyrën dhe fenomenet e saj, për njeriun e dukuritë shpirtërore të tij, si edhe për shoqërinë, për mendimin e njeriut dhe zhvillimin e tij. Këtu shtrohet pyetja: çfarë rezultatesh i ka dhënë H. Tahsinit qasja shkakore ose kauzale e gjurmimit të dukurive, proceseve dhe jetës psikike përgjithësisht?

Pyetje të ngjashme kanë shtruar edhe mendimtarët e tjerë shqiptarë e të jashtëm, por këtë e kanë bërë më tepër për veprimtarinë shkencore të gjithëmbarshme të H. Tahsinit. Këta, mendimin e H. Tahsinit për natyrën, shoqërinë dhe jetën psikike të njeriut, si edhe raportet ndërmjet tyre i kanë renditur në shkallën e lartë hijerarkike të mendimit shkencor. Kështu, mendimtari i dalluar i Rilindjes Kombëtare të shqiptarëve Sami Frashëri duke shkruar për H. Tahsinin ka thenë: “Është një nga dijetarët e kohëve të fundit që njihje mirë shkencat pozitive dhe tradicionale si edhe shkencat e reja në gjuhët e lindjes dhe të perëndimit... Jetën e tij e kaloi midis librave të shumtë dhe instrumenteve shkencorë, duke studiuar dhe duke dhënë mësim. Nuk u martua dhe nuk u mor me asgjë tjetër në botë përveç shkencës”. Megjithëse objekt i hulumtimit tonë është mendimi shkencor i H. Tahsinit për shkakësinë e dukurive shpirtërore në pikëpamjet e tij psikologjike e filozofike, mendoj se duhet thënë që mendimi shkencor i tij ka qënë

i lidhur ngushtë me iluminizmin e asaj kohe, ku zhvillimit të kulturës dhe arsimit të shqiptarëve në gjuhën e tyre i ka dhënë rëndësi të madhe. Në këtë pikëpamje mendimet e tij për zhvillimin e dukurive psikike të njeriut dhe për rolin e arsimit dhe të shkollimit në gjuhën amtare konsiderojmë se psikologjisë i japin shtrirje më të gjerë nga ajo që kishte në fillimin e shekullit njëzet, meqë kanë të bëjnë me zbatimin e dijenive psikologjike në edukim, në zhvillim e formim të strukturave psikike e sjelljeve të qëndrueshme dhe me ndryshimin pozitiv të tyre. Për ne shqiptarët psikologjia e H. Tahsinit” e botuar më 1894 ka rëndësi të posaçme, sepse me të është i lidhur mendimi për zhvillimin e sentimentit të atdhedashurisë mbi bazat e mendimit psikologjik. Vlera e veçantë e kësaj date ka të bëjë me raportin e këtij mendimi ndaj zhvillimit të psikologjisë empirike dhe fillesave të zhvillimit të psikologjisë pedagogjike. Psikologjia pedagogjike, përkatësisht psikologjia e zbatuar në edukatë, filloi zhvillimin e saj pothuajse në të njëjtën kohë. Për këto shkaqe mund të thuhet se mendimi psikologjik i H. Tahsinit ka rëndësi historike për shqiptarët dhe duhet vlerësuar si kontribut ngasës i pashkruar për fillim të zhvillimit të psikologjisë pedagogjike. Këto vlera dallohen në vepërën e tij *Psikologji ose Ilmi Ruh – Dituria mbi shpirtin*.

Vështrim përmbledhës i traktatit *Psikologjia ose Ilmi Ruh – Dituri mbi shpirtin*

Pikëpamjen, qëndrimet dhe mendimet përgjithësisht për shpirtin, strukturën, funksionin e shpirtit dhe zhvillimin e tij Tahsini i ka shprehur në një libërth të titulluar “Ilmi Ruh” – “Dituria mbi shpirtin” të botuar më 1894 në Stamboll dhe të përkthyer nga osmanishtja e të botuar në gjuhën shqipe pas 113 vjetësh, përkatësisht më 2007. Më



Origjinali u gjet në Bibliotekën e Teqesë së Rifaive të Gjakovës, qershor 1950.

poshtë paraqesim ballinën origjinale të këtij traktati:

Duke respektuar autorin e këtij libri dhe mendimet e Nuri Abdiut do t'i referohemi përkthimit origjinal të këtij libërthi me titull: *Nga seria e veprave të Hoxha Tahsinit, Psikologji ose "Ilmi ruh" – "Dituri mbi shpirtin"*.¹ Autori i librit "Psikologjia" në mbështetje të analizës së këtij libërthi shkruan: "Psikologjia" e Tahsinit përfaqëson kontribute të shquara në historinë e psikologjisë shqiptare që do të zhvillohej më vonë. Ndërkaq, për autorin e këtij libërthi ka thenë: "I pari studiues shqiptar që është marrë me seriozisht me kërkime dhe me lëminë e shkencës së psikologjisë ka qenë Hasan Tahsini". Libërthi ka gjithsej 42 faqe në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e libërthit ka gjasë se është shkruar ose botuar copa-copa dhe botuesi i saj Nadiri Fevzi ka mbledhë e sistemuar atë që ka pasë mundësi ta mbledhë. Libërthi ka parathënien e shkruar nga botuesi, dhe vetëm dy kapituj: "Shkenca e psikologjisë me temën "psikologjia" e shtrirë në 29 faqe në gjuhën osmane dhe kapitullin "konceptet e përgjithshme dhe konceptet e formuara nëpërmjet të abstraktimit" të shtrirë në 13 faqe të osmanishtes. Nga trajtimi i strukturës shpirtërore, të metodave hulumtuese, të bazës fiziologjike të psikikës, të organeve shqisore, të vetëdijës, të proceseve psikike dhe të gjuhës le të kuptohet se H. Tahsini në pak faqe është përpjekur t'i përshkruajë dhe t'i shpjegojë në rend të parë proceset psikike, sidomos ato të njohjes së realitetit ose, siç i quajmë sot, proceset kognitive, bazën fiziologjike të tyre, etj. Ndjenjat i ka prekur pak dhe për motivacionin nuk ka bërë fjalë drejtëpërdrejtë. Kalimi nga përmbajtja e njerës faqe në tjetrën herë herë kuptohet me vështirësi dhe kjo lë të kuptojmë se autori ka shkruar më gjerë, por shkrimi i tërësishëm nuk ka arritur në duart e botuesit. Megjithë mënyrën e sistemimit dhe të përpunimit të temave të veçanta në kuadrin e kapitujve të caktuar, përmbajtja e shpjegimet e dhëna për jetën psikike, për dukuritë e proceset e saj paraqesin një tablo të mendimeve të sintetizuara dhe sadopak të mjaftueshme për të kuptuar pikëpamjen, qëndrimet dhe mendimet e autorit në interpretimin e të arriturave psikologjike në gjysmën e dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe në dekadat e para të shekullit njëzet. Nga mënyra e përshkrimit dhe e shpjegimit të dukurive e proceseve të jetës psikike u përpoqëm të nxjerrim përcaktimin e pozicionit të përgjithshëm të mendimit të tij për natyrën, për shpirtin dhe për raportin dukuri natyrore – dukuri shpirtërore.

¹ Vepër e të ndjerit Hoxha Tahsin, Shtypur me lejen e Ministrisë së Arsimit, Botuesi Nadiri Fevzi, Përkthyer nga Vexhi Buharaja, Botohet për herë të parë në Stamboll, Viti 1310 (1894 e . r.), Biblioteka e Arsimit, Stamboll, Shtëpia botuese e shoqërisë së shtypshkronjave "Artin Asadurjan"

Shkencat natyrore dhe psikologjia në kohën e H. Tahsinit

Me studim të shpirtit dhe të dukurive shpirtërore, siç është e njohur, është marrë filozofia që nga periudha më e vjetër e zhvillimit të mendimit shkencor. Persiatjet filozofike i kanë kontribuar zhvillimit të mendimit psikologjik dhe disiplinës së shkencës së psikologjisë empirike. Këtë e ka pohuar edhe Hasan Tahsini në mënyrën specifike të paraqitjes së mendimeve të tij, që e dallojmë në cilësimin e mendimeve të filozofëve në vepërën e tij, siç janë Aristoteli, Lajbnici, Spinoza, etj.

Në historinë e zhvillimit të mendimit shkencor përgjithësisht dhe posaçërisht në historinë e zhvillimit të mendimit psikologjik është e njohur koha e pavarësimit të psikologjisë. Psikologjia u nda nga filozofia më 1879. H. Tahsini vdiq dy vjet pas pavarësimit të disiplinës së psikologjisë.

Vepra e H. Tahsinit Psikologji ose “Ilmi Ruh” – “Dituria mbi shpirtin” u botua më 1894, d.m.th. reth 15 vjet të zhvillimit të psikologjisë në rrugën zhvillimore të pavarësisë së saj. Koha e H. Tahsinit ka qenë kohë kur psikologjia ende ka qenë në kuadrin e filozofisë. Pozicioni i mendimit psikologjik të H. Tahsinit dallohet edhe kur psikologjia ka qenë në kuadrin e disiplinave të filozofisë. Mendimet e H. Tahsinit pothuajse vazhdimisht kanë qenë të lidhura me mendimet filozofike si edhe me rezultatet e zhvillimit të shkencave të natyrës, në rend të parë të fizikës, të astronomisë, por edhe të fiziologjisë. Njëkohësisht kjo është koha e zhvillimit të psikologjisë duke mos u ndarë krejtësisht nga filozofia në kapërcyell të fundviteve të shekullit nëntëmbëdhjetë. Kjo ishte koha e renditjes së psikologjisë në grupin e disiplinave të shkencave të natyrës.. Kjo tendencë e zhvillimit të psikologjisë dallohet edhe nga historia e psikologjisë. Wilhelm Wundt, 1831–1920, Theodor Gustav Fechner, 1801-1887, Ernst Heinrich Weber, 1795–1878, etj. Sigmund Freud, 1856–1939 në botimin e veprës së tij “Entwurf einer Psychologie” – “Skica e një psikologjie” më 1895 ka shkruar: “Edhe psikologjia është shkencë natyrore. Çfarë tjetër mund të jetë ajo!”. Duke pasur për bazë gjykimin për kohën e ndarjes së psikologjisë nga filozofia, kohën e hulumtimeve të para eksperimentale të strukturalistëve në krye me V. Vundtin, si dhe faktin se vëllimi i veprës prej rreth 3/4 të psikologjisë të H. Tahsinit u kushtohet ngacmimeve, shqisave dhe përbërjes e funksionimit të trurit e të qendrave trunore, si dhe të raporteve ndërmjet tyre, mund të thuhet se pikëpamja e H. Tahsinit për vendin e psikologjisë në sistemin e disiplinave shkencore anon kah pozicionimi i përgjithshëm i psikologjisë në grupin e shkencave natyrore.

Por koha e veprimtarisë hulumtuese e H. Tahsinit përputhet me zhvillimin e strukturalizmit në disiplina të shkencave natyrore. Kjo qasje ushtroi ndikim edhe në zhvillimin e psikologjisë së asaj kohe. Ndikimi i qasjes studimore të dukurive e proceseve psikike nga pikëpamja strukturaliste dallohet në konceptimin e lëndës së psikologjisë nga këndvështrimi strukturalist. Kjo pikëpamje e psikologjisë strukturaliste e fundviteve të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe e viteve të dekadave të para të shekullit përputhet me qasjen studimore të H. Tahsinit për jetën psikike, për dukuritë dhe proceset e saj. Këtë pohim e mbështesim në gjykimet e H. Tahsinit, sipas të cilave nga tërësia biopsikike e organizmit duhet të kuptohen strukturat psikike dhe funksionimi i tyre, si edhe format e manifestimit të jashtëm të tyre. Në formimin e një pikëpamjeje të këtillë të H. Tahsinit ndihet ndikimi i pikëpamjeve filozofike të Thomas Hobessit (1588–1679), të Immanuel Kantit (1724 -1804), të Christian Wolfit, 1679-1754, të Baruch Spinozës (1632–1677), të Wilhelm Gotfried Leibnizit (1646–1716), të Bonnet et Etien Condillacut (1715–1780), të René Descartesit (1596–1650), etj.

Pra, në frymën e mendimit evropian dhe të kulturës perëndimore të gjysmës së dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe në vitetet e para të shekullit njëzet dallohet tendenca e trajtimit të psikologjisë nga ana e Hasan Tahsinit në kuadrin e shkencave natyrore, ku ka doktoruar mendimtari shqiptar – H. Tahsini. Animi zhvillimor i psikologjisë kah shkencat natyrore u bë falë zhvillimeve të fiziologjisë e të fizikës në rend të parë dhe rolit të metodës eksperimentale në hulumtimin e dukurive dhe të proceseve fiziologjike e psikologjike dhe në zhvillimin e tyre. Mbi këtë bazë mori hov zhvillimi i psikofizikës dhe pjesërisht edhe i psikologjisë fiziologjike. Por krahas tyre u dallua edhe zhvillimi i psikologjisë diferenciale nga ana e Wilhelm Stern (1871-1938). Duke gjurmuar rolin e ngacmuesve fizikë, të shqisave dhe të qendrave të dukurive shpirtërore H. Tahsini njëkohësisht ka bërë fjalë për faktorët socialë në zhvillimin e të folurit, të ndërgjegjës dhe të vetëdijës, si edhe për sjelljet morale të njeriut. Të ngjashme kanë qenë përgjithësisht rrjedhat e mendimit psikologjik në Gjermani, në Francë, në Itali, etj. nga mbarimi i shekullit nëntëmbëdhjetë. E kuptueshme është pra se jashtë rrjedhave zhvillimore të këtylla nuk kanë mundur të vendosen dituritë mbi shpirtin të H. Tahsinit. Por për shkallën e zhvillimit të mendimit shkencor për dukuritë shpirtërore të asaj kohe niveli i lartë i paraqitjes shkrimore të përmbajtjeve të psikologjisë nga ana e mendimtarit H. Tahsini tregon bashkëkohësinë e mendimit të tij. Në kuadrin e vlerësimit të këtillë

të mendimeve të përgjithshme të H. Tahsinit dallohen disa karakteristika të posaçme të pikëpamjeve shkakore të dukurive psikike.

Doktrina e psikologjisë së fakulteteve dhe aktivitetet mentale të njeriut në *Psikologjinë* e H. Tahsinit

Doktrina e psikologjisë së fakulteteve është doktrine e popullarizuar në histori të psikologjisë pas gjysmës së dytë të shekullit tetëmbëdhjetë. Kjo doktrinë e ka shtrirë ndikimin e saj deri në vitet e para të shekullit njëzet. Sipas kësaj doktrine psikika e njeriut përbëhet nga një numër faktorësh ose fuqish, të cilët janë në gjendje të prodhojnë procese dhe veprime mentale të ngjashme; veprimet e ngjashme mentale kanë për bazë një faktor të përbashkët. Ky faktor i përbashkët është shkak, i cili prodhon akte psikike me kualitet, kohëzgjatje, intensitet dhe me rrjedhë të caktuar. Disa nga këto akte janë procese dhe veprime të ngjashme ndërmjet tyre dhe këto procese e veprime të ngjashme pak a shumë janë të shkaktuara nga këto fuqi, kapacitete, aftësi ose, siç janë quajtur atëherë, “fakultete mentale”. Themelues i kësaj doktrine është Christian Wolfi (1679 – 1754), filozof dhe matematikan gjerman. Ky filozof idealist termin “fuqi” e ka përdorur për të emërtuar “perëndinë”, fuqi mbizotëruese të shpirtit të njeriut.

Sipas doktrinës së fuqive mentale fuqitë, aftësitë, kapacitetet a fakultetet mentale janë të lidhura kryesisht me mendjen e njeriut. Ndërveprimi i këtyre fuqive është shkak kryesor, i cili prodhon proceset mendore dhe dukuritë mentale përgjithësisht. Si të këtilla, këto fuqi a fakultete mentale janë “agregate shpirtërore”, që shkaktojnë veprimet mentale të njeriut. Këto fuqi psikike ishin nxjerrë nga mendimi induktiv i vëzhgimeve të thjeshta të proceseve, të sjelljeve dhe të veprimeve të individëve. Numri i këtyre fuqive ishte i kufizuar. Në zhvillimin e kësaj doktrine përmenden këto fuqi a fakultete mentale: intelekti, kujtesa, vëmendja, vullneti.

Hasan Tahsini kur flet për fuqitë, kapacitetet ose aftësitë ai në esencë bën fjalë për aftësinë e të menduarit, përkatësisht për intelektin e njeriut. Përmbajtja e konceptit aftësi e mendimit në psikologjinë e Hasan Tahsinit lidhet ngusht me konceptin e arsytimit, i cili, sipas tij, mbështetet në ndijme dhe në përpunimin mendor të tyre. Arsyetimi ka shtrirje më të ngushtë se koncepti i “të kuptuarit” që e ka zbërthyer në nëntë veprime të brendshme të njeriut duke iu referuar, siç thotë ai, disa dijetarëve.¹

¹ Biblioteka e Arsimit Stamboll, Bulevardi “Babi Ali”, Shtëpia botuese e shoqërisë së

Siç shihet, arsyetimi e kuptimi janë procese të brendshme, të cilat Hasan Tahsini i lidh me aftësi të mendimit, përkatësisht me atë fuqi të intelektit që e ka identifikuar doktrina e fuqive mentale. Mbi këtë bazë mendore pohojmë se Hasan Tahsini e ka mbështetur pikëpamjen e tij për lëndën e psikologjisë në strukturën e fuqive të brendshme shpirtërore duke i vënë detyrë psikologjisë, përveç tjerash, studimin e këtyre fuqive.

Sipas doktrinës së fuqive mentale, kush posedon fuqi a fakultet të kujtesës së mirë ai do të mbajë në mend dhe do të riprodhojë saktësisht njësoj si data historike, numra të telefonit, tekste prozaitike, vargje poetike, etj. Kjo doktrinë ka buruar nga persiatjet filozofike dhe psikologjike për mendjen e njeriut dhe strukturën e saj.

Doktrina e fuqive psikike a e fakulteteve mentale ishte përhapur në kohën e shkollimit të Hasan Tahsinit si edhe atëherë kur e përpiloi tekstin “Imi Ruh”. Mirëpo kjo doktrinë nuk ka arritur të gjejë përkrahje dhe të gëzojë statusin e një teorie psikologjike pas njohjes dhe zbatimit të metodave ekzakte psikometrike.

Kur e përcakton objektin e studimit të psikologjisë, H. Tahsini pohon se “psikologjia është një shkencë e rëndësishme që bën fjalë mbi shpirtin dhe fuqitë (kapacitetet – aftësitë) e këtij si edhe mbi natyrën e rezultateve të këtyre fuqive. Në këtë përkufizim tri koncepte kryesore kanë rëndësi të theksohen: studimi i shpirtit, i fuqive e i natyrës së tyre dhe studimi i rezultateve të fuqive shpirtërore. Pa marrë parasysh dallimet e skajshme të përkufizimit të lëndës së psikologjisë posa të ndarë nga filozofia, mund të thuhet se përgjithësisht kështu është definuar lënda e psikologjisë në kohën e veprimtarisë së Hasan Tahsinit. Mbi këto tri koncepte të rëndësishme mbështetet gjykimi përfundues i ynë, sipas të cilit autori i librit “Imi Ruh” – “Dituria mbi shpirtin” për kohën e tij ka pasur koncept bashkëkohor të psikologjisë.

Persiatjet filozofike e psikologjike të asaj kohe mbi mendjen e njeriut dhe përbërësit e tij e kanë shtyrë autorin e tekstit “Imi Ruh” të merret edhe me raportin e logjikës me psikologji. Këtë e dallojmë në pohimin e tij, sipas të cilit “Psikologjia...bëhet bazë e logjikës”. Në trajtimin e raportit ndërmjet këtyre shkencave dallohet ndërlidhja e ngushtë ndërmjet mendimit të drejtë e orientimit të tij për zbulimin e së vërtetës dhe mendimit të drejtë e natyrës psikologjike të tij për zbulimin po ashtu e së të vërtetës.

Kjo ndërlidhje e ngushtë e logjikës me psikologji e ka shpënë H. Tahsinin në përfundim se psikologjia e të menduarit është bazë e logjikës. Pikëpamje të njëjtë për këtë raport ka pasur edhe mendimtari Xhon S. Mill, sipas të cilit logjika është degë e psikologjisë. Sot pikëpamja se psikologjia është bazë e logjikës dhe se kjo e fundit është degë e psikologjisë i takon së kaluarës.

Mendimi i Hasan Tahsinit në pasqyrën studimore të deritashme

Identiteti i mendjes së personalitetit H. Tahsini karakterizohet me produktivitet në mendimin shkencor dhe, mbi themelet e këtij mendimi, ka qenë i angazhuar në aktivitetet atdhetare të shqiptarëve duke ravijëzuar dhe potencuar vazhdimisht drejtimin e zhvillimit kulturor dhe arsimor të shqiptarëve në gjuhën e tyre amtare.

Për profilin e mendjes së H. Tahsinit gjykuar sipas angazhimeve të tij në disa fusha të jetës intelektuale është shkruar nga disa studiues shqiptarë dhe të jashtëm, ndër të cilët përmendim: A. Uçin, A. Naqellarin, D. Himën, D. Spahiu, G. Shpuzën, I. Hoxhën, I. Rexhën, J. Rexhepagiqin, M. Kemal Inalin, M. Stavilecin, Musa Krajën, N. Çabejnë, N. Allpanin, N. Sami Benarlin, N. Abdiun, R. Zekën, R. Teufikun, S. Frashërin, S. Kondin, V. M. Bajon, Xh. Lloshin, etj. Ndër njëzetentjë studiesit e përmendur të jetës dhe veprës së H. Tahsinit studimi i Nuri Abdiut ka karakter të monografisë për Psikologjinë e H. Tahsinit, kurse studiuesit e tjerë i kanë parqitur pikëpamjet e përgjithshme dhe të veçanta të tyre në trajtesa shkencore dhe artikuj, që u botuan në libra dhe në revista, si edhe në gazeta kryesisht profesionale të karakterit historik, pedagogjik e kulturor. Natyrisht, përpos vlerësimeve të dhëna për aktivitetin e Hasan Tahsinit, në shkrimet e të përmendurve ka përshkrime mbi faktet psikike, por ka edhe gjykime shpjeguese të pikëpamjeve dhe të veprimtarisë së tij. Por nuk mungojnë edhe përfundime të induktuara nga gjykimet e posaçme, sipas të cilave Tahsinin e kanë radhitur më tepër ndër filozofët, rrallë ndër psikologët, duke kundruar mednimet e tij me pikëpamjet filozofike të teorisë së deizmit, pozitivismit, panteizmit, etj.

Gjermuesit e deritashëm të mendimit shkencor të Hasan Tahsinit kanë përcaktuar qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre, kryesisht për tërësinë e mendimit të tij për natyrën e religjionin edhe për veçantitë e këtij mendimi në astronomi, në fizikë, në pedagogji, në histori, në gjuhësi, etj. Për çështjet e posaçme studimore të H. Tahsinit përmasash të gjera ka më pak hulum-

time. N. Abdiu i ka kushtuar studim monografik të veçantë veprës së psikologjisë së H. Tahsinit. Veprimtarisë pedagogjike të H. Tahsinit ia ka kushtuar një pjesë të veçantë të studimit për Sami Frashërin J. Rexhepagiqi dhe për aktivitetin pedagogjik të tij kanë shkruar H. Koliqi, A. Naqellari, H. Myzyri, etj.

Tash, kur traktati i Psikologjisë së H. Tahsinit është botuar tërësisht falë N. Abdiut dhe përkthyesit V. Buharaja – njohësitë të mirë të gjuhëve orientale dhe gjuhës shqipe, studiuesve u është mundur qasja e aspekteve të posaçme të mendimit shkencor të H. Tahsinit për dukuritë, gjendjet dhe proceset psikike.

Kauzalitetit shpirtëror dhe trajtimi i tij në *Psikologjinë* e H. Tahsinit

Hasan Tahsini në gjurmimin e dukurive dhe të proceseve shoqërore dhe shpirtërore u nis nga parimi, sipas të cilit asnjë dukuri, e bëmë dhe asnjë proces nuk mund të ngjet pa shkakun ose shkaqet e caktuara. Dukuritë shpirtërore kanë shkaqet e veta, rrjedhimisht Hasan Tahsini kërkonte të gjejë shkakun ose t'i zbërthejë shkaqet e një dukurie a procesi shpirtëror për të kuptuar natyrën dhe gjenezën e asaj dukurie ose të atij procesi. Së këndejmi nxorrëm edhe synimin e këtij gjurmimi. Synimi i gjurmimit është studimi i kauzalitetit në mendimin e H. Tahsinit të shprehur në veprën e tij “Psikologjia ose “Ilmi ruh” – “Dituria mbi shpirtin”. Shkas i marrjes në shqyrtim të këtij koncepti në veprën e përmendur është edhe fakti se H. Tahsini në këtë vepër ka reflektuar drejtpërdrejt dhe indirekt në zbulimin e shkakut ose të shkaqeve të dukurive shpirtërore. Shqyrtimin e drejtpërdrejtë e hasim në disa vende, ndër të cilat përmendim: “...çdo pasojë ka pa-tjetër një shkak...”, “Ngacmimi është nxitja që shkaktohet nga mjedisi (ambient – përkth.) i jashtëm në organet shqisore”, “Për këtë shkak...”, “... substanca e përhimtë, që ndodhet në tru, shkakton lëvizjet e trupit. . .”, etj. Ai ka folur edhe indirekt për zbulimin e shkakut, identifikimin e tij dhe rëndësinë e këtij identifikimi për njohjen sa më të plotë dhe, kuptohet, të saktë të dukurive e proceseve shpirtërore, që u paraprinë shkaku fizik – fiziologjik - social apo ai psikologjik. Një pikëpamje e këtillë përputhet edhe me pikëpamjen e sotme për raportin e përgjithshëm shkak – rrjedhim ose pasojë, ku shkak (lat. causa) rregullisht paraqitet para një dukurie të caktuar, që pason domosdoshmërisht pas veprimit të atij shkakut ose atyre shkaqeve, që e mundëson rrjedhimin e caktuar. Këtë përcaktim të Hasan Tahsinit për njohjen e raportit shkak – rrjedhim në studimin e dukurive

shpirtërore e dallojmë posaçërisht në faktin se ai e ka parapëlqyar metodën eksperimentale në studimin e dukurive psikike, sepse sipas saj mund të përcaktohet me nivel të lartë saktësie shkaku i lindjes, i zhvillimit dhe i ndryshimeve të një procesi fizik, fiziologjik dhe psikologjik të njeriut. Kështu, kur flet për çrregullimet psikike dhe shkakun e tyre ai përmend: "...bllokimi dhe paralizimi i brazdave zigzake të trurit, dmth. i rudhave, sjellin shrrëgullime psikike". Në këtë kuptim H. Tahsini ka folë për eksperimentin në disa raste, nga të cilat dallojmë: "...çdo eksperiment që mund të bëhet për të studiuar trurin është një gjë e vështirë sa s'ka ku të vej", "Madje, me anë të eksperimenteve të mësipërme, ata kanë zbuluar se truri i vogël, ...", etj. Ai nuk ka pranuar argumentin për gjurmët e perceptimeve në trurin e njeriut, sepse ato nuk mund të provohen, nuk mund të shihen dhe të dallohen. Pra, rekomandimi i metodës së eksperimentit në hulumtimet e dukurive shpirtërore tregon mënyrën produktive dhe objektive të të menduarit dhe të konceptuarit zhvillimor a gjenetik të gjendjeve, të dukurive dhe të proceseve psikike nga ana e H. Tahsinit. Ky përcaktim mund të vërtetohet vetëm me argumentimin e lindjes, të ndryshimit të një gjendjeje, dukurie, procesi, etj. nën ndikimin që ushtrojnë një shkak ose disa shkaqe. Për H. Tahsinin vetëm të provuarit objektiv të një gjendjeje, dukurie e procesi dhe lidhja direkte ose indirekte me shkaqet e saj i përket mendimit shkencor psikologjik. Prandaj mund të thuhet në konceptimin e pikëpamjes për shpirtin e njeriut dhe për proceset shpirtërore H. Tahsini është udhëhequr nga parimi i shpjegimit shkakësor ose kauzal të dukurive shpirtërore, duke i dhënë përparësi zbatimit të metodës eksperimentale, të cilën e ka konsideruar metodë të fiziologjisë, por që mund të zbatohet edhe për hulumtime psikologjike. Kjo metodë ka edhe sot zbatim të gjerë në hulumtimet psikologjike, por zbatimin e saj të mirëfillët e ka në formën e ndërlikuar të saj, që sot ka marrë përmasa të gjëra duke marrë parasysh edhe metodën e analizës multivariante të eksperimentit.

Por çfarë është koncepti i shkakut të dukurive shpirtërore në psikologjinë e Hasan Tahsinit? Për çfarë lloje shkaqesh fiziologjike dhe psikologjike ka bërë fjalë? Si i ka mbështetur gjendjet dhe proceset psikologjike në shkaqe të identifikuar dhe çfarë ka synuar me shpjegim shkakor të shpirtit dhe të proceseve shpirtërore? Pyetje të këtilla dalin nga analiza e përmbajtjes së kësaj vepre, ku krahas pyetjeve të shtruarra më lart dallohen edhe pyetje të tjera, siç janë: pse psikologjia ndahet nga filozofia, përkatësisht nga logjika në kohën e tij? Pse psikologjia ka për objekt dhe subjekt

shpirtin e njeriut? Pse mendimi objektiv ka vlerë diturore të lartë kur mbështetet në vërtetim objektiv dhe në eksperiment, etj. Nga përgjigjet e dhëna në pyetjet e shumta shkakësore mund të kuptohet synimi i trajtimit objektiv të jetës shpirtërore, të dukurive dhe të shkaqeve të zhvillimit të tyre si edhe botëkuptimi i tij i përgjithshëm për jetën shpirtërore të njeriut dhe për zhvillimin e saj.

Hulumtimi i përgjigjeve në pyetjet shkakëse është detyra parësore e këtij studimi dhe, besojë, se në mbështetje të njohjes së qasjes shkakore të lindjes, të zhvillimit dhe të ndryshimeve të strukturave, të dukurive dhe të proceseve natyrore, duke përfshirë edhe dukuritë e proceset shpirtërore mund të njihet e vërteta për shpirtin dhe për proceset shpirtërore.

Karakteristikat e mendimit shkakor në *Psikologjinë* e Hasan Tahsinit

Bashkëkohësia e rrjedhës së mendimeve të mendimtarit H. Tahsini me rrjedhat evropiane të mendimit për shkencën e psikologjisë të mbarimit të qindvjetëshit nëntëmbëdhjetë e fillimit të qindvjetëshit njëzet është njëra ndër karakteristikat e përmbajtjes së libërthit të psikologjisë së Hasan Tahsinit. Përbrenda kësaj karakteristike kryesore dhe lidhur ngushtë me të dallohet karakteristika e lidhjes së ngushtë të mendimit psikologjik me atë filozofik dhe lëkundja ende e saj nëpërmjet metafizikës dhe mendimit shkencor. Veçoria e identifikimit të “shpirtit” për objekt studiues të psikologjisë dhe lëkundja e kuptimit të tij ndërjet metafizikës dhe mendimit shkencor mbi bazën fiziologjike të formave të jetës psikike në kohën kur koncepti shpirt me konotacion religjioz ishte ende i pranishëm në psikologji është karakteristika e posaçme e mendimit psikologjik të H. Tahsinit. Në atë kohë koncepti dhe termi i tij “shpirt” ka pasur disa domethënie, ndër të cilat domethënia abstrakte e përçar me kuptimin religjioz të shpirtit ka qenë më e pranishme. Që atëherë nga psikologjia ka pasë filluar të shpurret koncepti dhe termi shpirt dhe tërësia e dukurive shpirtërore të emërtohen me termin psikikë. Qasja strukturaliste e studimeve psikologjike është veçori e ngjashme me zhvillimet strukturaliste të disa disiplinave të tjera, sidomos me ato të disiplinave të shkencave natyrore. Qasja strukturaliste e mbështetur kryesisht në metodën eksperimentale të studimit të dukurive e proceseve psikike është e pranishme edhe në mendimet e H. Tahsinit. Në këtë qasje dallohet më drejt karakteristika e gjurmimit të shkakut dhe shkaqeve të lindjes, zhvillimit dhe manifestimit të dukurive e proceseve të jetës psikike të njeriut. H. Tahsini ka vënë vënë në spikamë se psikologjia bën

fjalë për ato struktura shpirtërore që quhen fuqi, kapacitete shpirtërore dhe për natyrën e këtyre fuqive. Këto struktura hipotetike të kësaj doktrine i vlerësoi shkaqe të zhvillimit të jetës psikike dhe të formave të saj. Me këtë ai i është bashkëngjitur pikëpamjes idealiste të mendimtarit Kristian Volf – themelues i doktrinës psikologjike, e cila në kohën e tij është quajtur psikologjia e fuqive, e kapaciteteve, përkatësisht psikologjia e fakulteteve (lat. facultas = aftësi, fuqi).

Literatura

- Abdiu Nuri, *“Psikologjia” e Hasan Tahsinit*, Tiranë, 2007.
- Abdiu Prof. Dr. Nuri, *Mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar* (deri më 1939), botimi i dytë, Tiranë, qershor 2010.
- Çabej Nelson, *Nga historia e zhvillimit të shkencës shqiptare*, Tiranë, 1980.
- Dedja Bedri, *Shënime mbi historinë e zhvillimit të mendimit pedagogjik shqiptar*, Tiranë, 1972.
- Hoxha D. Ibrahim, *Hoxhë Hasan Tahsin Efendia. Të tjerët për të*. Tiranë, 1998.
- James, William, *Psychology*, Briefer Course, Collier Book, 1962.
- Koliqi, Prof. Dr. Hajrullah, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë, 2002.
- Pecjak, Vid, *Stvaranje psihologije*, Sarajevo – Beograd, 1984.
- Prenushi Mikel, *Kontributi shqiptar në Rilindjen Evropiane*, Tiranë, 1981.
- Schultz P. Duane – Schultz E. Sydney, *A history of Modern Psychology*, Sixth edition, Harcourt Brace College Publishers, 1981.
- Tahsini, Hasan, *Psikologjia*, Stamboll, 1894. (Përkthyer nga V. Buharaja, më 1979).
- Woodworth, S. Robert and Sheehan, R. Mary, *Contemporary Schols of Psychology*, London, 1971.
- Wolff, Christian, *Vernunftige Gedanken von Gott, der Welt und der Seele der Menschen, aych von allen Dingen Uberhaupt*, 1719.

Pajazit NUSHI, Prishtina

HASAN TAHSINI AND HIS VIEWS ON SPIRITUAL CAUSES

Summary

In his unfinished work, "Ilmi Ruh -The science of the soul", Hasan Tahsini presented different views on the spiritual life in the last years of the 19th century and the first decades of the 20th century. This is the first book on psychology written by an Albanian. It was written in the form of a treatise in Ottoman Turkish in 1894. It was translated into Albanian and published in 2007.

The book focuses on the experimental method for the study of the forms of psychical life. These were explained using the rational analysis of casual modality. Using this approach he explained (primarily) the process of cognition, which is based on what we feel and perceive, on the role of the brain and the functions of its parts.

Hasan Tahsini was a supporter of the psychological doctrine of mental faculties, respectively of spiritual skills, powers and capacity. Our desires, our reason and our instincts are God-given. Together they generate mental functions. This doctrine was conceived in support of the structure of hypothetical concepts. Hasan Tahsini presented the development of psychical processes and their objective manifestation in support of the results of the experimental method. This concept focused on the things that led to the emergence, development and manifestation of different phenomena and processes of the spiritual life and in supporting these general views, which determined the place of psychology in the group of natural sciences.

Based on such views Hasan Tahsini searched for the casual basis of cognitive processes and linked it with the so-called doctrine of mental faculties. This was a positive approach in the study of the processes of the psychical life of humans. He linked psychological studies to philosophical thought; the former were still at a theological and metaphysical level and had still not reached the level of scientific thought with regard to psychic life and their forms of development and manifestation.

The views of H. Tahsini about psychical life, research methods, the causes and factors for the development of psychical structures, processes, and their functioning are of special importance to the history of the development of Albanian psychological thought. He started putting an end to the use of philosophical narrative in psychology and molded the empirical basis of psychology, which he placed in the group of disciplines belonging to natural sciences.

Albert DOJA, Tiranë

NDERI, BESA DHE BESIMI: QASJE GJUHËSORE ANTROPOLOGJIKE NDAJ VLERAVE MORALE DHE FETARE

KDU 316.2(=18)

Abstrakt

Ky artikull eksploron mundësinë dhe interesin për të analizuar historinë semantike të termave të fjalorit të institucioneve që shërbejnë për të shprehur nocionet e nderit dhe besimit. Kjo analizë mundëson një qasje krahasuese në perspektivën e ndërthurur të antropologjisë historike dhe gjuhësore që mund të jetë themelore për të kuptuar raportet ndërmjet vlerave sociale të moralit dhe të fesë. Për të emërtuar fenë dhe besimin, shqiptarët përdorin terma që kanë të njëjtin trung të përbashkët indoeuropian me termat e latinishtes dhe të greqishtes së vjetër. Por edhe fjalë të tjera, që tregojnë vlerat morale të nderit, si betimi dhe fjala e dhënë, si edhe strategjitë për aleanca martesore mbeten të lidhura me të njëjtat burime në shqip. Në këtë mënyrë, termat e kësaj fushe leksikore tregojnë nocione që janë të rëndësishme për të kuptuar funksionimin e grupit social, familjar e farefisnor, si edhe atë të gjithë shoqërisë. Kështu bëhet e mundur të kuptohet më mirë shprehja e këtij nocioni themelor që mbështetet jo vetëm mbi një kod nderi tepër të rreptë, por edhe mbi struktura farefisnore shumë të forta, mbi përparësinë e fisit e të lidhjeve të gjakut dhe që përfshijnë përgjegjësinë kolektive në mekanizmat komplekse të sistemeve të aleancave dhe hakmarrjeve. Paralelisht, për të kuptuar vlerat morale si edhe natyrën e fesë tek shqiptarët, nuk duhet të nisemi nga subjektiviteti i një besimi apo objektiviteti i një dijeje, por nga marrëdhënia që parimet për nderin dhe praktikatat sociale vendosin midis njerëzve. Besimi dhe feja janë thjesht virtyte të nderit, pesha e besimit në fjalën e dhënë.

Hyrje

Gjuhësia indoeuropiane, me anë të relativizimit diskriminues të kuptimit të disa termave dhe fjalëve, duke përfituar edhe nga ndriçimet që kuptimet e ndryshme i japin njëri-tjetrit, mund të vendosë fenomenet sociale, fetare dhe juridike, në kontekstin e tyre evolutiv dhe historik. Punimet e Emile Benveniste (1969) u kanë dhënë koncepteve një kuptim të thellë

historik, të aftë të tregojë disa funksione tashme të padukshme, por pjesë përbërëse mirëfilli e institucioneve të emërtuara. Megjithatë, këto punime pak janë ndjekur nga antropologët. Kjo indiferencë e dukshme vjen nga fakti se *terrenet* fisnike të etnografisë nuk kanë asgjë indoeuropiane dhe nga që antropologët mendojnë se nuk kanë çfarë të presin nga këto etimologji. Por bëhet fjalë për histori semantike meqë në metodën e Benveniste çdo term ekzaminohet në kontekstet e tij domethënese të dokumentuara nga ligjërimet ku merr pjesë. Në fakt, kuptimi që kërkohet mund të arrihet vetëm nëpërmjet një analize të thellë të secilës prej vlerave të konstatuara historikisht. Çështja është të dalin në pah të gjitha pjesët përbërëse të një kuptimi tërësor, me qëllim që të rivendoset uniteti themelor i domethënies. Ky kërkim semantik dhe konceptual, i bazuar mbi një ndërtim të arsyetuar, tregon pikërisht ekzistencën e fenomeneve të vëzhguara edhe në shoqëritë e studiuara nga antropologët.

Shqyrtimi i disa nocioneve më të njohura fetare tregon se për të kuptuar fenomenet fetare duhet të largojmë idetë e gatshme, tipike për konceptimet e krishtera. Sot tendenca është që ideologjia e krishterë të projektohet mbi fetë e tjera duke e konsideruar çdo lloj *besimi* si një *besim fetar* apo si *fe*, në kuptimin që këto nocione kanë marrë për të krishterët. Ky është një gabim që pengon të kuptuarit e *feve*, domethënien dhe historinë e tyre. Antropologjia e *feve* ka ditur të pajiset me premisa të tilla metodologjike për t'u mbrojtur kundër këtyre lloj gabimesh gjykimi. Konkretisht, duhet pranuar rëndësia e përgjithshme antropologjike e vëzhgimeve etnografike të Evans-Pritchard (1956), sipas të cilave disa gjuhë natyrore, sado të pasura të jenë me terma që tregojnë qëndrime mendore, nuk kanë termin ekuivalent të konceptit perëndimor të “fesë” apo “besimit fetar”, i cili mendohet se është i zbatueshëm ndaj një përvoje apo qëndrimi universal.

Nëse një gjuhë ka apo jo terma të qartë për të shprehur realitetet institucionale, ky është një test konceptualizimi. Megjithatë, është e qartë që në këtë fushë, njësitë leksikore nuk janë gjithmonë të mjaftueshme, madje as të nevojshme. Origjinaliteti i marrjes sistematike në konsideratë të të shprehurit enonciativ, popullariteti i të cilit buron po ashtu nga punimet e Emile Benveniste (1966), ka të bëjë me faktin që gjuha përmban në mënyrë konstitutive tregues të lidhur me aktin e të folurit dhe praktikave gjuhësore. Sipas kësaj qasje, në kontrast me doktrinën e Saussure (1916 [1972]), gjuha përmban në sistemin e saj një përshkrim të përgjithshëm dhe klasifikim të situatave të ndryshme të ligjërimëve të mundshme, si

edhe udhëzime për sjelljen gjuhësore, d.m.th. specifikim të disa llojeve të ndikimit që mund të ushtrohen duke folur, si dhe disa roleve që mund t'i japim vetes ose t'ua imponojmë të tjerëve.

Në rastin e *fesë*, nga vetë natyra e këtij nocioni, nuk mund të gjendet një emërtim i vetëm dhe konstant, sepse ky realitet i kudondodhur nuk konceptohet gjithmonë si institucion i ndarë qartë, as i vendosur jashtë elementeve të tjerë të ansamblit institucional. Qytetërimet e vjetra, ashtu si shoqëritë e studiuara nga antropologët, nuk kanë *një* fe. Thelbësisht, është vetë ndërtimi i sociale që tek ata është fetare së brendshmi. Tërësia kulturore ka pak a shumë të njëjtën shtrije me tërësinë fetare, gjithçka është fetare, gjithçka është e mbrytur nga feja, gjithçka është shenjë e forcave hyjnore. E mbinatyrshmja është kaq e pranishme në shoqëri sa që nuk është e mundur të izohet karakteri i shenjtë nga karakteri social. Në fakt, shtrirja e përbashkët e fesë dhe organizimit shoqëror është një e vërtetë e vjetër në antropologjinë sociale. Më konkretisht, M. Mauss (1924 [2007]) ka treguar se fenomenet kryesore sociale kanë një dimension fetar si edhe një dimension ekonomik, politik, estetik, etj. Pas tij, shumë antropologë kanë punuar mbi këtë temë në shumicën e shoqërive, aq sa nocioni “fakt social total” është kthyer në një paradigmë themelore të antropologjisë.

Do të ishte e dobishme të kujtonim se as shoqëritë indoeuropiane nuk kishin terma për të emërtuar fenë. Shumë gjuhë europiane, historikisht, nuk e kanë pasur këtë term. Nevoja për të konceptuar qartë, pra për të përdorur një term të veçantë për të emërtuar fenë u shfaq kur feja u qarkua në një fushë të dallueshme, nisur nga momenti kur u kuptua se çfarë i përkiste asaj dhe çfarë mbetej jashtë saj. Fillimisht, ky emërtim u bë në greqishten e vjetër dhe në latinishten, me anë të termave që mund të merren si të barasvlershëm me fjalën “fe”. Kështu, ndryshe nga idioma të tjera, madje edhe indo-europiane, vetëm gjuhët perëndimore filluan, shumë vonë, të specializojnë fjalorin e tyre për të dalluar aparatit institucional të praktikave fetare nga institucionet e tjera sociale. Por kjo ishte një përpjekje për shkëputje, që përpiquej të mendonte ndarazi atë që nuk kishte qenë kurrë e ndarë.

Duke ndjekur Benveniste, kam pasur rastin të trajtoj në punime të tjera (Doja 2000) se si *religio* tregonte fillimisht nënshtrimin ndaj detyrimeve të kultit, një dispozicion të brendshëm e subjektiv, dhe jo një cilësi objektive të gjërave apo një tërësi besimesh dhe praktikash. Ajo ishte më tepër një hezitim apo vetëpërmbajtje, një “skrupull” që ndalon, dhe jo një ndjenjë që udhëheq drejt një veprimi apo që nxit praktikimin e kultit

(Benveniste 1969: 2.265-272). Vetëm duke filluar me shkrimtarët e krisherë feja trajtohet si një “lidhje” përrulësie, shprehje e varësisë dhe e detyrimit të besimtarit ndaj zotit që bëhet një lidhje objektive dhe që shpreh në të njëjtën kohë një ideologji të parandërtuar dhe të imponuar nga jashtë. Po ashtu, nëpërmjet nocionit të “supersticionit” zbulohet raporti midis dy vlerave të njëpasnjëshme, që reflektojnë fillimisht gjendjen e besimeve popullore dhe pastaj qëndrimin e kulturës elitare dhe ekleziastike ndaj vetë këtyre besimeve në raport me fenë zyrtare. Studimet antropologjike kanë treguar që herët karakterin detyrues të praktikave magjike (Mauss 1903 [1950]) që duket i njëjtë si në besimet ashtu edhe në praktikat supersticioze. Karakteri i tyre detyrues, i kuptuar si një forcë e brendshme, shpjegohet nga mekanizmi e “projektimit”, i formuluar nga psikanaliza freudiane, që lidhet me zhvendosjen e dijeve të pavetëdijshme në botën e jashtme. Në rastin e supersticioneve, forca detyruese nuk vjen nga e pavetëdijshmja, por nga tradita që imponon një normë (Belmont, 1979), meqë bëhet fjalë për një tërësi të strukturuar besimesh dhe praktikash.

Besimi vazhdon të mbetet një nga mekanizmat më të rëndësishme në çdo dukuri fetare. Ndryshe nga termat që përcaktojnë *fenë*, në fjalorin indoeuropian ekzistonte një term i përbashkët që përcaktonte *besimin*, gjë që tregon për një kuptim shumë të vjetër dhe pa dyshim themelor. Gjuhësia indoevropiane e ka nxjerrë kuptimin etimologjik nga rrënja **kred*, që ka dhënë foljen *credo* në latinisht dhe formën emërore të prejardhur *šraddhâ* që figuron në tekstet vedike të Indisë së lashtë (Benveniste 1969: 1.176-179). Megjithatë, korrespondenti latin i emrit vedik *šraddhâ* nuk është ai që pritej të dalë nga rakordimi morfologjik i foljeve. Antoine Meillet (1921) ka treguar se në latinisht është fjala *fides* që shërben si emër foljor i fjalës *credo*, domethënë që kjo fjalë duhet të ketë zëvendësuar fjalën e vjetër **kred*, prej të cilës edhe është ndikuar. Në fakt, në gjuhët latine moderne shihet qartë një konkurrencë kuptimore midis termash të prejardhura nga të dy rrënjët, p.sh. Fr. *foi, confiance* dhe *croyance*; It. *fede, confidenza* dhe *credenza*; Eng. *faith, confidence, credence, creed*.

Është pikërisht ky term që paraqet më shumë interes për këtë studim. Së pari, ai thekson me më shumë forcë karakterin e besimit (*confidence*) që është një ndjesi se mund t'i *besojmë* diçkaje nëpërmjet *konfidencës* dhe dorëzanisë për të *akredituar* apo dhënë *kredi* vërtetësie, si dhe detyrimit *kreditor* që ngjallim tek dikush si rezultat i shprehjes së pranimit dhe aprovimit tonë të asaj çka nuk është veçse thjesht një shtytje për të besuar

(*croire*). Pikërisht ky term është edhe vendi ku përdorimi i krishterë dhe shqendërzimi teologjik kanë qenë më shumë spektakolare. Më pas, ai do të ketë rëndësi të madhe për analizën time për të treguar vlerën sociale të domethënies së fesë tek shqiptarët.

Në pjesën e parë të këtij artikulli, me anë të një perspektive të ndërthurur të antropologjisë historike dhe gjuhësore, do të eksploroj mundësinë për të ndërmarrë analiza të historisë semantike të termave të fjalorit të institucioneve që shërbejnë për të shprehur nocionet e fesë dhe të besimit tek shqiptarët. Nga pikëpamja metodologjike nuk jam domosdoshmërisht i interesuar për etimologjinë dhe nuk do të synoj kërkimin pozitiv të provave filologjike për një prejardhje të supozuar indo-europiane. Do të përdor një qasje krahasuese, duke u përpjekur të përfitoj nga mungesa e vazhdimësisë midis shprehjeve të ndryshme semantike, me qëllim zbulimin e homologjive tipologjike që mund të dëshmonin për modele të ngjashme idesh dhe domethëniesh social-kulturore. Kështu, në pjesën e dytë, në vend të konkordancave literale, do të përqendrohem tek interesi analitik që mund të ketë marrja parasysh e faktit se vlerat morale të nderit tek shqiptarët, betimit dhe fjala e dhënë, si dhe strategjitë e aleancave martesore, shprehen me terma të së njëjtës fushë leksikore.

Mendoj se kjo ndodh ngaqë kemi të bëjmë me nocione që janë themelore për të kuptuar funksionimin e grupit social, familjar apo farefisnor, si edhe të gjithë shoqërisë. Kjo do të na çojë në pjesën e tretë të artikullit ku kategoritë e filozofisë analitike dhe të gjuhësisë së akteve të të folurit do të përfshihen për të kuptuar se besimi duhet vendosur në hullinë e akteve të ligjërit dhe të praktikave të shkëmbimit. Tek e fundit, nëse feja dhe besimi nuk janë gjë tjetër veçse institucione marrëdhëniesh që ligjërimet mbi nderin dhe praktikat sociale vendosin kurdoherë në mes të njerëzve, atëherë karakteri specifik i vlerave të tyre lokale mund të ndriçohet ndryshe nga vlerat e feve universaliste.

Feja dhe besimi

Nëse duam të kuptojmë raportet ndërmjet vlerave fetare lokale, në këtë rast tek shqiptarët, dhe feve të quajtura universale, qoftë kur është fjala për krishterimin apo islamin, historia semantike e termave të fjalorit është përsëri mjaft e rëndësishme. Zakonisht flitet në mënyrë të përgjithshme për “fenë” ose “ndjenjën fetare” të shqiptarëve, duke supozuar se fjala *fe* për-

mbledh të gjithë raportin e tyre me zotin. Së pari, nuk ka ndonjë fjalë shqip që të përkojë me këtë kuptim. Më pas, për të treguar “fenë” e krishterë apo islame, me të cilën janë lidhur, shqiptarët nuk kanë ndonjë fjalë me bazën *religio*, si shumica e gjuhëve fqinje, qofshin latine apo sllave, si dhe gjuhët e tjera indoeuropiane perëndimore. Normalisht, duhet të kishte një fjalë të ngjashme po të kemi parasysh afërsinë gjuhësore dhe nivelin e lartë të huazimeve. Kjo është edhe më befasese kur njohim prirjen e përgjithshme të gjuhës shqipe për të huazuar drejtpërdrejt nga latinishtja terminologjinë e saj ekleziastike (Haarmann, 1972; Bonnet 1999). Për më tepër, ka një histori shumë të vjetër krishterizimi (Doja 2000c), si duket të përhapur drejtpërdrejt nga predikimet e Shën Palit, i cili duhet të ketë “përhapur fjalën e Ungjillit, që nga Jeruzalemi, duke rrezatuar deri në Iliri” (*Rom. XV.19*).

Në shqip, fjala *fe* përdoret si ekuivalente e fjalës “religion”, por ndryshe nga sa mund të mendohet me etimologji popullore, fjala *fe* nuk ka ardhur nga fjala italiane *fede*, sepse nuk përputhet me prirjen e përgjithshme të gjuhës shqipe, si dhe as për arsye thjesht morfologjike. Sipas Eqrem Çabejtë (1996: 153-154), kjo fjalë ka rrjedhur pa asnjë dyshim prej fjalës latine *fides*. Kështu që mund të themi se kuptimi i termit shqip që tregon “fenë”, nuk i përket së njëjtës fushë semantike si *religio* dhe, si pasojë, nuk ka kuptimin e krishterë të fjalës “religjion”, por afrohet më tepër me kuptimin e *fides*, që për më tepër shpreh vlera të vjetra morale dhe juridike pa u kufizuar domosdoshmërisht vetëm tek vlerat fetare të krishterizuara.

Në bazë të *fides* (besim, besë) dhe *foedus* (pakt, marrëveshje, aleancë) në latinisht, si edhe *pistis* në greqishten e vjetër, gjendet rrënja indoeuropiane **beidh-* që shpreh në mënyrë të përgjithshme idenë e të besuarit (*confidence*) tek dikush ose diçka (Benveniste 1969). Në këtë kuptim *besimi* është një akt vullneti që varet nga ne, një pranim, që vetë ne mund edhe ta refuzojmë ose pezullojmë. Historikisht, kuptimi i parë i besimit ka qenë mirëbesimi, në kuptimin moral, si virtyt besnikërie. Besimi është gjithashtu një angazhim i vazhdueshëm mirëbesimi dhe “konfidence”, që shprehet në forma të ndryshme si fjala e dhënë, premtimi, dhënia e besës, betimi, kontrata, traktati, aleanca, konventa të ndryshme, etj.

Në Romë *fides* u kthye në virtyt moral, në bazë të një norme sociale, të një rregulli zakonor, sipas të cilit besimi (*confidence*) që na ofrohet, krediti moral për të cilin jemi të denjë, varen nga vetë besnikëria jonë. Kjo besnikëri është po ashtu një vlerë komplekse që përfshin sinqeritetin ose mirëbesimin, respektin e ligjeve të përbashkëta (*fides legum*), si dhe ka

gjithashtu kuptimin e dinjitetit dhe të prestigjit, që me fjalë të tjera e njohim si një kod nderi. Në rrethana të veçanta *foedus* tregon gjithashtu angazhimin reciprok të mirëbesimit dhe konfidencës: *accipe daque fidem foedusque feri bene firmum* “merr dhe jep besim, që një pakt i arritur të jetë i qëndrueshëm”. Format sociale që kanë të bëjnë me besimin në Romë mund të ishin si të thjeshta edhe solemne: fjala e dhënë, premtimi, besnikëria në martesë, miqësia, mikpritja, dhe së fundi betimi ushtarak (*sacramentum*), betimi gjyqësor i gjykatësit dhe dëshmitarëve (Freyburger 1986).

Për sa i përket nocionit të “besimit fetar” (*croyance*), në shqip ai shprehet me termin *besë* dhe derivatet e tij: *të mbesuomitë, me besuem, të besuem*, ose më të vona si *besoj, besim, besimtar*. Kuptimi i fjalës *besë*, së pari është “besim” dhe “bindje” në besnikërinë dhe sinqeritetin e ndershëm dhe të nderuar të dikujt ose në besnikërinë dhe saktësinë e diçkaje. Edhe folja *besoj* do të thotë *bindje e fortë* ose *besim i plotë* se dikush është besnik, i sinqertë dhe i nderuar, se diçka është besnike me realitetin ose që do të ndodhë patjetër.

Brenda gjuhës shqipe fjala *besë* është e pandashme nga *be*, njëra është zhvillim i tjetrës. Kuptimi i fjalës *be* është së pari pohimi ose mohimi i vërtetësisë të diçkaje para dikujt, “betimi” ose “beja” për dikë ose diçka të konsideruar si të shenjtë ose të çmuar, ashtu si “besimi”, “bindja e plotë” dhe “respektimi” i nderit. Ky kuptim duket në shprehjet *bëj be*, ose *jap be*, *be për nderin*, *vë në be*, *be e reshim*, *bëj be e rrufe*, të cilat prekin së pari gjithçka që është e shenjtë dhe e çmuar. I njëjti kuptim shfaqet edhe në kuptimet e prejardhura si tek fjalët *betoj, betohem, betim, betar*, ose fjalët e përbëra *përbej, përbehem, përbetoj, përbetohem*: *i përbetohej për çka kishte më të shtrenjtë*.

Kuptimi i fjalëve të prejardhura nga *be* shpesh është i pandarë nga konotacionet fetare si *përbetoj*, që i referohet gjithashtu përhapjes së formulave magjike ose lutjeve fetare me qëllim dëbimin e shpirtave të këqija, p.sh. *përbetoj të paudhin me lutje dhe namatisje*. Megjithatë, tek shqiptarët nocioni i shprehur nga fjala *be* tregon së pari betimin e të parëve që i jepnin vendimet solemne: *pleqtë e besë* ose *betarët* janë “të vjetrit” që sigurojnë dëshminë e garancisë në formën e betimit. Përfaqësues të çdo shtëpie në bashkësinë lokale (*be për derë*), janë ata që shprehin një *be pastruese*, betimin e “larjes”, duke u betuar për *gurin e besë*, “gurin e shenjtë” të besimit, me qëllim *larjen me be*, “pastrimin” nëpërmjet betimit të të akuzuarit që mbetet *zot i besë*, të cilit i “takon” detyra të respektojë betimin e bërë.

Për sa i përket origjinës etimologjike është pranuar gjerësisht se burimi parashqiptar (indoeuropian) i *be* dhe *besë* është e njëjta formë **beidh*-që ka dhënë *fides* dhe *foedus* në latinisht dhe *pistis* në greqishten e vjetër (Çabej 1976: 186-187, 1996: 154-156). Edhe pse në bazë të fjalës shqipe *besë* nuk kemi refleksin participial me *-t* të formës indoeuropiane të përafërt **bheidha-ti-a* (Çabej 1976: 206), ajo mund të ketë si bazë një formim nominal me *-së*, i vonë dhe i brendshëm për gjuhën shqipe, ku prapashitesa formon edhe grupe emërore jo vetëm grupe foljore.

Kuptimi i fjalës *besë* në krahasim me fjalët *pistis* dhe *fides* shfaqet për shembull në togfjalëshat *ka besë, fjala e besës, i zë besë, i jap besën, i rri në besë, jam në besën tënde, e preu në besë, "per fidem decipere", i doli nga besa, shkeli (hëngri, theu, ktheu) besën, mos kini besë mbë zotënit, gruo ki besë mou, a beson këtyre fjalëve? unë ashtu ende mbesonj e mirë e za besë*. I njëjti kuptim shfaqet edhe në përdorimet ndajfoljore (për *besë*) ose proverbiale (*besa e shqiptarit si purteka e arit, besa e burrit si pesha e gurit, si besa e gjarprit*) si edhe në fjalë të prejardhura më të vona si *besoj* ("croire; confier"), *besim* ("croyance; confiance"), *i besuar, i besueshëm, besueshmëri, i besëm, besatarë, bestar, besnik, besnikëri, i pabesë, pabesi*, etj. Në të njëjtën kohë, kuptimi i *besë* si "pakt" në krahasim me *foedus* duket jo vetëm në shembujt e shqipes së vjetër : *e u të vë një besë me ty, me besë qi populli i atij qi të ngadhënjë t'ish dobitës* (Çabej, 1976, 186-187), por edhe në togfjalëshat *lidhën besën apo bashkuan besën* dhe fjalët e prejardhura a të përbëra si *besatim, besatohem, besëtar* ose *besëlidhje, besëlidhës, besëthyerje, besëthyes, besëthyer, besëkeq, besëshkalë, besëprerë*.

Është domethënë fakti që *be* dhe *besë*, megjithë karakterin e tyre teknik në fushën institucionale, afrohen edhe brenda gjuhës shqipe me foljet *bind, bindem*, dhe derivatat e tyre, që shprehin nocione zbatimi dhe adrimi, respekti dhe frike, adhurimi dhe përkushtimi, si dhe habie e mrekullimi, në kontekste fetare apo të laicizuara. Për shembull, *gjithë njerëzia e shtëpisë zunë fill me ju bindunë ati Idhulli, e nukë ju bindnë asaj statuë* (Çabej 1976: 235-236). E njëjta fjalë del edhe si emër foljor *bind* "gjithçka që habit për nga madhështia dhe aspekti i saj i jashtëzakonshëm ose frikësues, mrekullues", p.sh. *bindi i botës, bindi i dheut* "gjëja më e mrekullueshme në botë, mbi tokë" apo *bindje*, si ndajfolje *bindisht, për bind*, si folje *përbind* "habit, friksoj", si mbiemër të *përbindshme* "gjëra të çuditshme, të jashtëzakonshme, të frikshme", si emër *përbindsh* "monstër i besimeve mitologjike", etj.

Edhe pse ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tri formave *be*, *besë* dhe *bind*, mund të shpjegohen brenda strukturës morfologjike të shqipes, Çabej (1976: 204-206) mendon se në bazë të *be* gjendet rrënja e përbashkët indo-europiane **bheidh-*, kurse baza fonetike e *bind* mund të ishte **bheidhno* prej nga vjen *bin* dhe më pas *bind*. Kalimi i kuptimit *be* në *bind* dhe *besë* në *bindje* ka të bëjë me idenë se betimi është para së gjithash një shtrëngesë detyruese. Ideja është e njohur në gjuhë të tjera indo-europiane, sepse fjala *be* afrohet me fjalën sllave ekleziastike *beda* “detyrim, rrezik”, me lituanishten *beda* “detyrim”, me letonishten *beda* “merak”, me got. *baidjan* “shtrëngo, detyroj”. Po ashtu qëndron afrimi i fjalës *besë* me *bind*, *bindem*, sidomos edhe sepse dy fjalët afrohen me fjalët greke që paraqesin në të njëjtën mënyrë të dy kuptimet : *peido* “bind”, *peidonai* “bindem”, dhe *pistis*, si edhe me fjalët latine *fides* dhe *foedus*.

Strukturat dhe vlerat sociale

Roli i besës dhe vlerave morale dhe kontraktuale që lidhen me të duhet të analizohet jo vetëm në historinë e ideve dhe praktikave fetare, por edhe në sistemet e marrëdhënieve familjare e farefisnore e në traditat gojore që zhvillohen si zëvendësime të formave të tjera të institucioneve dhe përfytyrimeve sociale. Nëse termat *be* dhe *besë* kanë të bëjnë me nocionet e “betimit” e “bërjes *be*” për dikë ose për diçka të konsideruar të shenjtë a të shtrenjtë, kjo më shpesh u referohet marrëdhënieve farefisnore që kanë të bëjnë me rrethin më të ngushtë familjar, p.sh. *bëj be më djalim, e përbetoj me nënë e baba*. Termat *besë* dhe *fe*, edhe kur shënojnë nocione fetare, janë lidhur gjithmonë me paktet, betimet solemne, si edhe me premtimet e miqësisë dhe aleancave martesore. Në traditën gojore, miti i Roza-fës që tregon sidomos rëndësinë e paktit të shenjtë të fjalës së dhënë hapet me nocionet e *besës* dhe *fesë*: *Lidhën besë e lidhën fe / Besë e fe të trimave*.

Fjala *fe*, term standard i shprehjes së “religjionit” në shqipe, tregon gjithashtu betimin për martesën, të dhënë gjatë ceremonisë së “fejesës”, sidomos “shenjën”, që konfirmon paktin e aleancës martesore në shoqërinë tradicionale. Më saktësisht, fjala *fe* tregon “pengun që sanksionon angazhimin e aleancës martesore” ose “kërkimin (e vajzës) për martesë” në shprehje të tilla si *daj dit, pres fenë*. Termi shprehet qartë në nenet e së drejtës zakonore : *me pre fen don me thanë me da ditën e vaden e kputme se kur me nisë krushqit për me marrë nusen; fe quhen sendet qi detyrohet ai qi merr nusen me ia çue prindve të nuses; ditën qe nepet feja njëfjet vajza*

se asht e xanun; djali sa të ket prind s'ka tager as në shej, as në petka, as në këpucë, e as në t'prem fejet (Gjeçov 1989: 64, 92). Në këtë kuptim, fjala u zhvillua brenda gjuhës shqipe duke dhënë foljen *fe-j-oj*, prej nga vjen edhe emri *fe-je-së* që tregon “fejesën” në shqipen standarde (Çabej 1996: 155-156). Ky zhvillim i brendshëm i gjuhës shqipe duket në përputhje me atë të gjuhëve të tjera latine si frëngjishtja ose italishtja në të cilat termat ekuivalente i përkasin së njëjtës fushe leksikore.

Në të njëjtën mënyrë si *foedus* dhe *fides* në latinisht, termat *besë* dhe *fe* tregojnë në shqip nocione që janë shumë të rëndësishme për të kuptuar rëndësinë e të gjithë sistemit të vlerave sociale si edhe funksionimin e grupit social, familjar dhe farefisnor, dhe të gjithë shoqërisë. Zhvillimi i *be* në *besë* shpreh tek shqiptarët këtë nocion themelor që mbështetet jo vetëm tek një “kod i nderit” shumë i rreptë, por edhe tek struktura farefisnore shumë të pranishme, tek lidhjet fisnore dhe ato të gjakut, të cilat mendohen se përfshijnë përgjegjësinë kolektive në mekanizmat komplekse të sistemeve të aleancave dhe hakmarrjeve.

Nderi është një përbërës thelbësor i nocionit të individit dhe parimet e nocionit të *besës* tek shqiptarët janë pjesë e ligjërimeve dhe praktikave kulturore të procesit të ndërtimit të karakterit personal të çdo individi. Në shumicën e ligjërimeve simbolike dhe praktikave kulturore përmenden pikërisht vlerat morale që në shoqërinë tradicionale shqiptare mbështeten posaçërisht mbi këtë nocion (Doja 2000b). Nga ana tjetër, vlerat e nderit janë të lidhura ngushtë me vlerat thelbësore të shoqërisë shqiptare, ato të të parëve në shumicën e rasteve dhe shpesh edhe fetare, ndoshta në mënyrë të ngjashme me shembullin e nderit në jug të Mesdheut, lidhur me vlerat fetare dhe *baraka*, “bekimi hyjnor” (Jamous 1981) i grupit familjar e farefisnor. Së fundi, ligjërimet për nderin nuk përfaqësojnë vetëm një vlerë morale përbërëse të karakterit personal të individit, një fjalë të dhënë, fjalën e nderit për të përmbushur një premtim ose një detyrim, por përfaqësojnë gjithashtu një institucion juridik dhe historik të së drejtës zakonore.

Shqiptarët kanë pasur ligjërime formale të nderit që vazhdimisht kanë ndërmjetësuar fusha të ndryshme veprimi. Në këtë kuptim, *besa* ishte një premtim solemn për të mbështetur diçka të rëndësishme ose për t'u bashkuar me dikë për një veprim të përbashkët ose në një marrëveshje kolektive me garancinë e fjalës së dhënë që premtimet e bëra do të respektoheshin dhe nderoheshin në mënyrë absolute. Këto ligjërime dukej se kishin detyrën e sigurimit të solidaritetit dhe kohezionit të grupit social, sank-

siononin respektin e rregullave në marrëdhëniet ndër-personale dhe ndër-familjare, rajonale dhe ndër-rajonale, të jetës sociale në bashkësinë lokale, në përputhje me traditat dhe zakonet e zonës dhe vendit. Analiza e konventave të ndryshme historike për veprimet e përbashkëta, të shprehura edhe nga termi i përbërë *besëlidhje*, në kuptimin e “aleancave në bazë të nderit”, tregon se në ç’masë praktikat kulturore informoheshin nga ligjërimet historike specifike që kishin në qendër nocionin e *besës*. Në historinë shqiptare njihen shumë raste besëlidhjesh rajonale ose ndër-rajonale që kanë prodhuar dhe riprodhuar ligjërimet e besës për të siguruar kohezionin e lëvizjeve të përbashkëta të individëve apo bashkësive të ndryshme. I quajtur edhe me termin “besa shqiptare”, ky ligjërim për nderin duket sikur ka marrë një vlerë kulturore të rëndësishme, meqë vetë termi si i tillë duket se ka depërtuar me të njëjtin kuptim edhe në gjuhët e tjera të Europës Juglindore.

Ishte e njëjta gjë në epokën klasike në lidhje me *fides* në latinisht e cila kishte një vlerë vendimtare që ekuivalenti grek *pistis* nuk e kishte. Është ideja e mbrojtjes që çdo qytetar në një moment rreziku apo krize të rëndë, kishte të drejtë t’u kërkonte bashkëqytetarëve të tij në emër të lidhjeve të shenjta që i lidhnin. Ky funksion nuk ka vetëm vlerë morale, por edhe domethënie institucionale. Grekët ndonjëherë e kuptonin me vësh-tirësi mentalitetin romak në lidhje me këtë. Historiani grek Polybe (*Historitë* VI 56.13-14) ishte i mendimit se epërsia e romakëve mbi popujt e tjerë qëndronte në faktin se ata ngritën një moral racional mbi institucionin e *fides*. Ky konceptim është thellësisht i lidhur me zakonet dhe institucionet e Romës republikane, aq sa mendohet se latinishtja është “e vetmja gjuhë indoeuropiane që e përmban këtë kuptim” (Freyburger 1986: 67–74)

Por edhe tek shqiptarët, institucionit të *besës* i njihen disa funksione të veçanta sidomos në kontrollin e forcave të errëta të hakmarjes. Në këtë kontekst, *besë* ishte fjala e dhënë nga shtëpia e viktimës ndaj vrasësit dhe familjes së tij, me betimin se nuk do të përpiqej të hakmerrej deri në një datë të caktuar, me qëllim që t’u jepte mundësinë të rregullonin çështjet sociale dhe ekonomike më urgjente. Pikërisht një moment i tillë ilustron në romanin *Prilli i thyer* të Ismail Kadarese. Për shqiptarët, në kohë të vështira, besa ishte gjithashtu një pakt për të pushuar armiqësitë dhe hakmarjet ndërmjet fiseve ose fshatrave, të garantuar nga fjala e dhënë e të gjitha palëve. Mund të përmendim edhe tekste të tjera si Iliada, Mahabharata ose Testamenti i Vjetër, ose të gjithë traditat gojore të Europës Juglindore, për të treguar se si shprehja e vlerave të nderit gjendet vazhdimisht

e pranishme në forma narrative të mbizotëruara nga konteksti i hakmarrjes.

Një ide e ngjashme gjendet si në Romën e lashtë edhe tek shqiptarët në lidhje me marrëdhëniet e mikpritjes. Miku ishte i mbrojtur nga *besa* gjatë qëndrimit të tij ose gjatë udhëtimit deri në vendmbërritjen tjetër. Ky ishte një betim mbrojtjeje që mbronte mikun gjatë qëndrimit: *jam në besë, marr në besë, i shkoj në besë*. Për ta kuptuar më mirë këtë marrëdhënie themelore, duhet përfytyruar situata e mikut që viziton një vend, dhe si i huaj, është i privuar nga çdo e drejtë, nga çdo mbrojtje, nga të gjitha mjetet e jetesës. Ai mund të pritet dhe të gjejë strehë dhe siguri vetëm tek ai me të cilin ka një raport mikpritjeje (Doja 1999: 222–227).

Megjithatë, i takonte dinjitetit romak të ruante vlerën e *fides*. Ai që tradhtonte, merrte mbi vete gjithë tërbimin e Jupiterit, kurse paqësorja *Fides* kishte vetëm një dënim: braktisjen. I braktisur në këtë mënyrë, tradhtari diskreditohej, përçmohej nga të gjithë bashkëqytetarët, mbetej pa kredi dhe i pambrojtur. Shembuj të shumtë kujtojnë se duhej respektuar pakti dhe të mbahej *besa* edhe ndaj armikut. Reflektimet filozofike të Ciceronit në lidhje me këtë nuk lënë asnjë dyshim për vlerën morale të *fides*, që këmbëngul mbi idenë se lidhja më e fortë është betimi për të dhënë besën dhe gjykimi më i rëndësishëm ka të bëjë me respektimin e betimit (*De officiis* 3.111). Kështu për shembull, historia e Regulus, që u burgos nga kartagjenasit dhe u dërgua me mision në Romë, me betimin se do të kthehej, dhe në fakt u kthye dhe vdiq në Kartagjenë, të kujton edhe historinë e baladës shqiptare për burrin që donte të shkonte në martesën e gruas. Heroi ishte i burgosur në Spanjë, por u lejua të shkonte pasi dha besën se do të kthehej.

Në Romë, *fides* ishte një virtut aristokratik, i pandashëm nga kuptimi i shtetit. Gjithë rrethi i një personazhi të fuqishëm ishte në patronazhin e tij, mbrohej nga *fides* e tij. I munduri që ishte në *besën* e fitimtarit nuk kishte asnjë të drejtë, nëse lidhja e duarve, që presin dënimin nuk ndiqet nga *foedus*, një traktat në formën e kërkuar. Është interesante të vihet re se në universin e *besës* shqiptare u zhvillua një tjetër term teknik, *ndore* (të jesh në duart e ...) që përkon saktësisht me nocionin romak të mbrojtjes. Në rastin e *besës* bëhet fjalë për fjalën e *dhënë*, që duhet mbajtur detyrimisht dhe duhet përmbushur domosdoshmërisht, kurse në rastin e nocionit *ndore*, ai ndryshon nga *besë* për faktin se është një pakt i njëanshëm, është fjala e *kërkuar*, por jo më pak e detyrueshme për t'u respektuar (Doja 1999b: 225–226). Nocioni *ndore* shfaqet si një institucion tjetër juridik i të drejtës zakonore shqiptare. Themeli institucional i këtyre konceptimeve është i

tillë që ndikimet sociale që rëndojnë mbi këto raporte personale mund të realizohen në rrethana të jashtëzakonshme, si për shembull një konventë solemne, që lidh dhe përmban angazhime reciproke, me betim (*besë*), sakrifica (*ndore*) dhe përkushtim (*bindem*).

Aktet e të besuarit

Shohim se nocionet e *fides* në latinisht si dhe *besë* dhe *fe* në shqip nuk janë fetare për nga objekti i tyre, por për nga konteksti. Në Romë, në çdo *foedus* të arritur ndërmjet dy partnerëve, edhe në fshehtësi, ndërhynte garancia e një të treti, që nuk ishte gjë tjetër veçse ajo e hyjnisë, praninë e vazhdueshme të së cilës romakët e njihnin nëpërmjet dëshmisë së *sacra* dhe të *auguria* (Dumézil 1987). Mbi këtë bazë mund të kuptojmë gjithashtu se fjalët *besë* dhe *fe* përdoren në shqip në dy mënyra të ndryshme, ashtu si *fides* në latinisht, herë për të theksuar raportin me tjetrin, herë raportin me vetveten. Karakteri i *besës* së pari është çka na bën të besueshëm për të tjerët. Ashtu si *fides* i qëndron besnik rrënjës së vet, veçanërisht në lidhje me mbiemrin *fidus* “besnik”, në shqip *njeri* apo *burrë i besës*, thuhet për një njeri “besnik” që i mban premtimet e tij, u qëndron angazhimeve të tij, si në shprehjet *me besë e fe*, ose *ka besë*. Kjo duket edhe tek mbiemri *i feshim*, si në shprehjet *i mirë e i feshim* “i mirë dhe besnik” ose me *mendje të feshme* “me mendje të shëndoshë”.

Këto fjalë shprehin besimin që ngjallim, besnikërinë, me zhvillime të tilla që përfshijnë kuptimet e premtimit, mbrojtjes, përkushtimit, etj. Është i besës, ai që *ka besë e fe*, ai që nuk ka ndërmend të tradhtojë, edhe nëse gabon padashje. Termat teknikë *kam besë e fe*, *mbaj besë*, *me besë e fe*, tregojnë një fakt të njohur tek shqiptarët si ekuivalenti i besnikërisë, i guximit dhe i nderit. Nocioni i nderit lidhet atëherë me një hierarki prestigji që vihet vazhdimisht në provë në një proces të përhershëm konkurrence drejt qëllimesh që mund të arrihen vetëm relativisht. Në mënyrë të anasjelltë, ashtu si në latinishte ku *fides* lidhet si me *virtus* edhe me *religio* (Dumézil 1980: 47–59), të konsideruara si një angazhim personal, *besë* dhe *fe* na bëjnë besimtarë.

Për të kuptuar natyrën e fesë tek shqiptarët, nuk duhet të nisemi nga fakti që fjala *besë* (“foi”) apo *besim* (“croyance”) është termi i përgjithshëm për të shënuar “besimin fetar”, ashtu sikurse *feja* tregon “religjionin”. Jo çdo besim mund të quhet *fe* (“religjion”), por vetëm besimi me anë të cilit shqiptarët kuptojnë nderin e *besës* dhe besnikërinë ose një besim që e

kanë përqaftuar nisur nga *besa* e nderit. Pra duhet të nisemi nga marrëdhënia që ligjërimet dhe praktikat e nderit vendosin ndërmjet njerëzve. Nuk bëhet fjalë këtu për subjektivitetin e një besimi ose për objektivitetin e një dijeje. Meqë *besimi* apo *besa* mund të *bindë* e mrekullojë dhe ashtu si *betimi* dhe *beja* kthehen në detyrim që duhet respektuar, edhe *feja* ka të bëjë me atë që adhurojmë dhe nderojmë, që i *bindemi*, i nënshtrohemi dhe i për-kushtohemi.

Kam pasur rastin të tregoj në botime të tjera (Doja 2000a), në perspektivën e filozofisë analitike dhe të gjuhësisë së akteve të të folurit (Searle 1969; Vanderveken 1988), se nocionet e përçuara nga këta terma, ashtu si ato shfaqen nëpërmjet analizës krahasuese të kuptimeve semantike, bëjnë të mundur ngritjen e hipotezës se besimi përfshihet në ligjërim dhe mund të interpretohet si çdo akt tjetër ligjërimi. Kështu, besimi do të ishte një bashkësi e përbërë nga akte të ndryshme që mund të analizohen në shumë nivele. Në themel gjendet akti propozicional, akti i “të besuarit”, i ngjashëm me një akt të foluri (*lokucionar*), d.m.th. që përdor shprehje (enonciative), praktika dhe sjellje, që kanë kuptim dhe i referohen diçkaje. Më pas, mund të dallojmë një akt *ilokucionar*, që është ajo çka bëjmë duke besuar, me fjalë të tjera, në aktin e të besuarit ne realizojmë një akt tjetër konstataues, pohues ose deklarues, në formën e besimit (*croyance*) të ngarkuar me një forcë *ilokucionare*. Së fundi, kam folur edhe për një akt *perlokucionar*, që është ajo çka prodhojmë nëpërmjet aktit të të besuarit.

Në këtë mënyrë, nëse akti ilokucionar është një akt i të shprehurit performativ, ajo çka bëjmë kur flasim, ose “kur bëjmë gjëra me fjalë” (*How to do Things with Words*) sipas formulës së thukët të John Austin (1962), edhe një enoncim konstataues vishet me një forcë ilokucionare për vetë faktin se në të përfshihet angazhimi i folësit veçanërisht në formën e besimit apo miratimit, siç e kanë nënvizuar Searle dhe Vanderveken (1985). Nëse pranojmë se besimi (*croyance*) ngarkohet me këtë forcë ilokucionare të akteve të ligjërimet, duhet të jemi në gjendje të përftojme një kuptim të ri të besimit dhe përfundimisht të pranojmë se me anë të të besuarit (*croire*) “bëjmë” gjithashtu që “gjërat e besuara” të ekzistojnë realisht. Akti i besës (*foi*) është pikërisht një akt ilokucionar që ka të për-bashkët me aktin e ligjërimet atë karakteristikë themelore sipas së cilës enoncatori nuk mund t’i kryejë pa u përpjekur t’i bëjë të ditur destinatorit se po i kryen. Në bashkëbisedim, marrësi i mesazhit e njej qëllimin e dërguesit të mesazhit për të prodhuar këtë apo atë akt të të shprehurit iloku-

cionar. Një numër i madh enoncimesh mund të kuptohen vetëm nëse njohim tek dërguesi i mesazhit qëllimin e hapur për ta çuar marrësin në një farë tipi përfundimesh.

Në këtë mënyrë, siç realizohet çdo akt ilokucionar në bashkëbisedim, edhe kryerja e një akti të të besuarit (*croyance*) përmban domosdoshmërisht këtë cilësi të shprehjes enonciative, ashtu si e gjejmë në praktikat fetare dhe sjelljet e ritualizuara. E njëjta gjë ndodh me nocionin e besimit (*confiance*) jashtë fushës fetare. Nuk mund “t’i besojmë dikujt” as “të kemi besim te dikush” pa u përpjekur të ndërtojmë me tjetrin një marrëdhënie të ndërsjellë besnikërie. Besimi (*croyance*) kërkon patjetër njohjen e qëllimit të besimtarit, si dhe bashkëbiseduesit apo kredituesit, për të prodhuar këtë apo atë akt besimi (*confiance*). Për sa i përket pohimit të besimit (*croyance*), ky është i brendshëm për vetë kuptimin e besimit (*confiance*). Ai përbën një akt ilokucionar si të tjerët, d.m.th. një cilësim i shprehjes enonciative, i paraqitur sikur të krijonte për marrësin një detyrim për të vepruar.

Për më tepër, nisur nga fakti që besimi apo konfidenca jepet dhe merret, akti i besës (*foi*) përfaqëson gjithashtu një vlerë perlokucionare, për faktin se mund të veprojë mbi tjetrin, por që lëkundet ndërmjet kuptimit aktiv të shprehjeve *jap besë* apo *kam besim* dhe kuptimit pasiv në shprehje të tilla si *meritoj besim* “jam i denjë dhe i besueshëm”. Si dhe në gjuhët e tjera, termat *besë* apo *besim* (“foi” a “croyance”) dhe *bindje* luhaten ndërmjet kuptimit aktiv dhe pasiv të besimit (*confiance*). Kështu, *kam besim*, *besoj*, dhe *kam bindje* kanë të gjitha kuptimin *jap besë* apo *i besoj* dikujt ose *jam i bindur* se dikush i mban premtimet dhe u përgjigjet shpresave.

Kjo vlerë vendos marrëdhënie të ndërsjellë pranimi ndërmjet njerëzve që orienton besimin (*confiance*) ose në drejtimin aktiv (“besimi që ngjall apo që jap”), ose në drejtimin pasiv (“besimi që marr apo që meritoj”). Kështu, *kam besim* i referohet “besimit” që meritojmë ose ngjallim, që fitojmë ose humbim. Nën këto drejtime të kundërta, ideja kryesore është se besa (*foi*) prodhon terma plotësues dhe asimetrikë të marrëdhënies ndërmjet njerëzve, ndërmjet atij që jep besën a ngjall besimin dhe atij që e merr besën ose ka besimin e dikujt. Duhet vërejtur në këtë rast se kuptimi aktiv i besimit (*confiance*) qëndron nga ana e atij që merr. Fjala e dhënë shpreh marrëdhënie ndërmjet besnikërisë së njërit dhe besimit apo konfidencës së të tjetrit. Duke dhënë besën (*foi*), vetvetja përfshihet në pranimin e tjetrit.

Hipoteza sipas të cilës kuptimi i shprehjes së besimit (*croyance*) duhet të jetë një akt besë (*foi*), do të thotë që si pjesë përbërëse të këtij kup-

timi duhet mbajtur edhe cilësimi i ngjarjes së përbërë nga shfaqja dhe mënyra e shprehjes së vetë këtij besimi. Kjo ngjarje shfaqet si një akt perlokucionar, me fjalë të tjera si një krijues detyrimesh, që prodhon një transformim juridik të situatës së partnerëve të besimit, në këtë rast midis njerëzve dhe zotave. Në Romë, ashtu si në Biblën hebraike, ishin normat e besueshmërisë dhe besnikërisë, që dalin në plan të parë. Në të gjitha rastet, janë format sociale të njohjes që bëjnë të mundur analizimin e llojit të marrëdhënieve të besueshmërisë perlokucionare të shprehur me nocionin e “besës” (*foi*). Në epokën klasike, *fides* vendoste bazën personale të lidhjes sociale dhe shërbente për të shprehur të gjitha format e besnikërisë së qëndrueshme: besën ndaj njerëzve si dhe besën tek hyjnitë. Ajo ishte si një pakt që bëhet me veten, me tjetrin apo me zotin dhe përfshinte qëndrueshmëri në marrëveshje dhe besnikëri në respektimin e angazhimeve të marra.

Nëse sipas Evans-Prichard (1965) besimet (*croyances*) nuk mund të vëzhgohen drejtpërsëdrejti, të besosh (*croire*) do të thotë të përfshish besimin (*confiance*) në një akt bese (*foi*) të shfaqur ndaj një perëndie, por me pikësynimin për të përfutur në mënyrë specifike mbështetjen e tij. Po kështu, nëse termi vedik *śraddhâ* i referohet “besimit (*croyance*)”, në Indinë e lashtë kjo nuk ishte asnjëherë besim në diçka, por ishte ekuivalente e “përkushtimit” të njerëzve ndaj një zoti, për shembull gjatë një lufte ose rivaliteti. Situata është ajo e një konflikti midis zotave ku njerëzit ndërhyjnë duke mbështetur njërin ose tjetrën kauzë. Në këtë angazhim njerëzit japin një pjesë të vetes së tyre që përforcon zotat që kanë zgjedhur të mbështesin. Ky “përkushtim” bën të mundur fitoren e zotit kampion dhe në këmbim i jep besnikut avantazhe thelbësore: fitore në luftërat njerëzore, shërim i të sëmurëve, bollëk në të vjela, pjellori të grave (Benveniste 1969: 1.176)

Në këtë kuptim bëhet fjalë për një bindje personale, që është qëndrimi i njeriut ndaj zotit, një marrëdhënie e njeriut me zotin, ashtu si e njeriut ndaj njeriut. Nuk është besim (*croyance*) në një *kredo* teologjike, por një besim (*confiance*) që besimtari u shfaq zotave, forcës së tyre, veçanërisht Indrës, zotit të ndihmës, zotit kombëtar në krye të gjithë të tjerëve, heroizmat e të cilit kanë mbushin poemat Rig-Veda. Në një fe të sakrificës siç ishte feja vedike, ky koncept fetar shprehet nga një seri termash që shkojnë nga “besa” tek “flijimet” (Benveniste 1969: 1.178-179). Në tekstet vedike gjendet koncepti i hyjnizuar në emrin e perëndeshës *Sraddhâ* që është ajo e flijimeve të dhuruara. Më pas, në një perspektivë ekleziastike, termi tregonte besimin (*confiance*) e laikut tek brahmani dhe pushteti i tij, që rridhte nga bujaria e dhurimeve.

Kështu kalohej nga besimi (*confiance*) tek zotat dhe tek fuqia e dhuratave.

Kur i besojmë dikujt, kur i japim kredi apo besimin tonë, kjo bëhet duke besuar ose pranuar se do të realizohen disa kushte. Besa (*foi*) orienton besimin (*confiance*) por ajo e orienton mbi bazën e besimeve (*croyances*) të forta, d.m.th. të mbështetura nga forca ilokucionare. Në tërësinë e raporteve kulturore të njerëzve dhe zotave ka një kontratë fillestare ku mund të operohet gjithmonë dallimi ndërmjet dhurimit që njerëzit i bëjnë një zoti dhe orakujt që zotat u dërgojnë njerëzve. Këto dy lëvizje janë me kah të kundërt, nga njerëzit tek zotat dhe nga zotat tek njerëzit, që janë të pranishëm së bashku dhe që përcaktojnë dy fusha plotësuese shkëmbimesh. Ashtu si e ka treguar Dumézil (1980: 47–59) në traditën romake, *fides* ka një fushë të dyfishtë, njëra pothuaj mistike, tjetra plotësisht juridike. Kjo sepse aktet e kultit, sidomos flijimet, në Romë ishin akte tregtie, zbatim kontratash shkëmbimi midis njerëzve dhe hyjnive. *Sacra* vazhdon domosdoshmërisht me *auguria* dhe *signa* (Dumézil 1987: 131–141). Automatizmi i tyre nuk është aq magjik sa është juridik. Ato janë detyruese si një pakt, të paktën si ai tip pakti i nënkuptuar që Marcel Mauss ka studiuar në *Ese mbi dhuratat, si forma arkaike të shkëmbimit* ([2007] 1924).

Përfshirja e besimit (*croyance*) në fushën e ligjërimit dhe shkëmbimit bën që akti i besimit të përmbajë gjithmonë sigurinë e shpërblimit. Bëhet fjalë për një lloj “garancie”, pengu, diçka materiale, por që përfshin edhe ndjenjën personale. Ky nocion përmban edhe një qëndrim mendor, *interior state* sipas shprehjes së Evans-Pritchard (1965), një forcë të brendshme, besimin (*confiance*) që i përket vetes dhe që e zhvendosim tek tjetri, drejt botës së jashtme, që shpesh është dikush ose diçka superiore dhe e fuqishme. Kështu, besa (*foi*) dhe besimet (*croyances*) vendosen në mënyrë paradoksale më tepër nga ana e supersticionit dhe fesë popullore se sa fesë zyrtare, ashtu si kam treguar në punime të mëparshme (Doja 2000a). Ato përbëjnë një lëvizje zhvendosjeje drejtuar jashtë, drejt tjetrit ose drejt një hyjnie, qofshin perënditë e Antikitetit, ose zoti i krishterë, njëri nga shenjtorët apo Virgjëresha, të cilës i japim diçka, një dhuratë në para, një qiri apo thjesht vetëm fjalë, d.m.th. lutje, me sigurinë se si shpërblim gjërat do kthehen në favorin tonë. Në këtë mënyrë shohim se “supersticioni” nuk është vetëm një projektim i thjeshtë i tendencave të pavetëdijshme në botën e jashtme. Kjo marrëdhënie është një lidhje besnikërie që shoqërohet domosdo me një akt besimi (*confiance*) dhe me sigurinë e kthimit të shpërblimit, që shpesh mund jetë apo të bëhet një shpresë hyjnore.

Vlerat lokale dhe universaliste

Nuk duhen ngatërruar shprehjet *kam besë e fe* ose *kam besim* në shqip, ashtu si *habere fidem* në latinisht, që do të thotë po ashtu “kam besë, kam besim (*confidence*)” tek dikush apo tek zoti, me ato shprehje që traditat aktuale të të menduarit të nxisin të formulosh duke përfituar nga lehtësitë që të japin format foljore (*besoj*) apo nyja shqese, si në shqip (*kam besim-in*) edhe në gjuhët e tjera latine (fr. *avoir la foi*). Kjo formulë ka një kuptim më shumë atributiv sesa relational : i atribuojmë dikujt një bindje fetare. Sot mund të shtyhem të mendojmë se besa, besimi te zoti, ose bindja fetare dhe më veçanërisht besimi fetar i krishterë, janë gjëra konkrete që ose e kemi ose nuk e kemi. Por vlerat relacionale janë më themelore, edhe kur privilegojmë kahun aktiv në drejtim të tjetrit apo të hyjnisë. Në origjinë, besa, mirëbesimi, ishte drejtimi që kushtëzonte ekzistencën dhe vlefshmërinë morale të një dëshmie, ciladoqoftë ajo.

Nga ana tjetër, krishterimi, që me autorët e tij të parë, u përpoq të shndërronte idenë thelbësore të besës (*foi*) me qëllim imponimin e idesë se ekziston një besim (*croyance*) praninë e të cilit duhet ta ndiejmë brenda vetes sonë. Për shembull Shën Agustini nuk ka pushuar së pohuari në mënyrë energjike se altari i besimit ndodhet në zemrën e secilit dhe kushdo është aq syhapur sa ta zotërojë atë, meqë puna e tij më e mirë dhe më e rëndësishme është të na bëjë të besojmë tek zoti i vërtetë (*Qyteti i Zotit* 4.19). Në lidhje me këtë “është interesante të shohim, ashtu si Dumézil (1980: 58), shenjtin polemist nga Hippone, që përjetonte me aq intensitet *fides*-besimin e tij, tek e kërkonte, pa e gjetur, në *fides*-besnikërinë e panteonit pagan, të cilën e trajtonte me të njëjtën liri sa çdo hyjni tjetër romake”.

Ideja “fetare” e besës dhe e besimit u fut më pas nga krishterimi, ashtu si edhe ideja e “fesë”, siç e kam treguar më hollësisht edhe në vende të tjera (Doja 2000a). Në të dy rastet, termat janë vendosur me shpejtësi, pothuaj në mënyrë ekskluzive, mbi eksperiencën ose manipulimin e së shenjtes, edhe pse më parë nuk e kishin atë kuptim. Duke shprehur qëndrimin që kjo nënkupton, termat u destinuan të kalonin nga dispozicioni subjektiv që theksojnë, tek realitetet objektive të cilave ky dispozicion u referohet.

Në fund të kësaj analize dëshiroj të pohoj se fjalët *besë* dhe *fe* në gjuhën shqipe përmbajnë kuptimin e dyfishtë të besnikërisë morale dhe besnikërisë fetare, të ruajtur deri në ditët tona, edhe pse shprehjet e besnikërisë kanë ndryshuar. Sot flasim për fenë duke përdorur termat e besimit (*croyance*), ndërkohë që tradicionalisht, kemi bërë të anasjelltën, duke i

konceptuar besimet si besnikëri. Në të dy rastet përdoret folja *besoj* (“croire”), por ajo nuk bashkohet me të njëjtat preokupime. Sot dallojmë besimtarët nga jobesimtarët, ndërsa në shoqërinë tradicionale besnikët *me besë e fe* u kundërvihen jobesnikëve *të pafe e të pabesë*. Feja popullore nuk i koncepton besimet si *fe* në kuptimin që kjo fjalë ka marrë tek të krishterët. Mësimi popullor nuk përmban asnjë nxitje për besimin, asnjë urdhëresë nga ajo që krishterimi dhe islami e quajnë *fe*. Në të vërtetë mund të gjenden shtysa për të besuar, por bëhet fjalë për t’i qëndruar *besnik* tërësisë së vlerave morale të bashkësisë lokale, farefisnore apo sociale. Kjo është shprehje e një besnikërie fetare kulturore, që ka të bëjë me respektimin e ligjeve të të parëve.

Te shqiptarët, krishterizimi ashtu si dhe më vonë islamizimi u kryen nëpërmjet një dialogu të detyrueshëm me kulturën lokale. Përsëri fjala është të kërkohet i njëjti ekuilibër, i vështirë për t’u kuptuar nga misionet e krishtera, ndërmjet vlerave të *lidhura* me Ungjillin dhe vlerave *morale* të një kulture lokale dhe një feje popullore. Mjafton të citojmë për këtë rastin e mikpritjes, e lavdëruar si shprehje e bujarisë së natyrshme të krishterë, por që në Shqipërinë e Veriut, si tek të krishterët edhe tek myslimanët shkaktonte rrufetë e hakmarrjes. Ishte një tipar kulturor që nuk varej nga morali i krishterë, por nga ndjenja e nderit, që paraqitej si *besnikëri* ndaj një ideologjie tjetër që bënte pjesë në një tjetër sistem vlerash.

Pa u interesuar nëse një tipar kulturor i përket apo jo kësaj apo asaj feje, tërësia e përfaqësimeve dhe besimeve kolektive, ritet, zakonet dhe ceremonitë i vishen gjithmonë fesë zyrtare që ka mbizotëruar tradicionalisht në krahinë, fshat apo familje. Të gjitha shfaqjet e saj pranohen përgjithësisht si “tradita dhe zakone të trashëguara nga të parët”.

Edhe pse individit mund të ndajë paragjykimet e një grupi fetar ndaj tjetrit, vlerat thelbësore të grupit përcaktohen nga një sistem afërsie farefisnore dhe aleancash martesore, solidariteti dhe armiqësie, prestigji dhe pozicioni social, që duhet të ketë qenë i përbashkët për të gjithë shqiptarët (Doja 1999a). Konvertimet fetare të shqiptarëve si edhe ato të popujve të tjerë të Evropës Juglindore janë para së gjithash fenomene historike kolektive që përfshijnë bashkësitë sociale dhe kulturore, më konkretisht anëtarët e një fisi, të një farefisi, të një bashkësie fshatare apo të një konfederate territoriale më të gjerë. Konvertimi në krishterim apo në islam ka ndodhur për shkak të përkatësisë në një rrjet social. Konvertimi dhe aderimi në një besim fetar bëhen atëherë pjesë e një procesi socializues

nëpërmjet kërkimit të një identiteti kolektiv.

Aderimi në një besim fetar do të thotë aderim në një grup social. Përcaktohem si mysliman ose i krishterë sepse i përkasim një familjeje, një grupi farefisnor apo social, që tradicionalisht ka aderuar në këtë besim fetar. Nuk është çështje ndjenje apo bindjeje fetare, është një fakt i kulturës sociale. Feja është një përkatësi që trashëgohet. Kjo nuk do të thotë se shqiptarët janë veçanërisht fetarë, *të lidhur* me një fe apo me një tjetër, por kultura fetare, e praktikuar me *besnikëri*, bëhet pjesëmarrëse në një identitet kolektiv që nuk mund të shprehej më mirë në formë tjetër.

Përfundim

Karakteri specifik i fesë tek shqiptarët është jo i zakonshëm dhe i vështirë për t'u kuptuar nëse përdorim në mënyrë skematike kategoritë tradicionale për të kuptuar fenë. Por artikulli i shqyrtimit të kujdesshëm të termave të fjalorit të institucioneve që shërbejnë për të shprehur nocionet e nderit dhe të besimit, bashkë me një qasje krahasuese sipas perspektivës të ndërthurur të antropologjisë historike dhe gjuhësore duket se është vendimtar për të arritur një kuptim të ri më të sofistikuar të raportit midis vlerave sociale të moralit dhe fesë.

Nëpërmjet analizës së historisë semantike dhe kulturore të disa vlerave dhe institucioneve sociale, qëllimi i këtij artikulli ishte të tregonte se si nocioni i nderit dhe nocionet fetare ndikojnë njëri-tjetrin. Kështu, tek shqiptarët besimi dhe feja shfaqen si virtyte të nderit, ndërsa pesha e besimit-*croyance* dhe e besimit-*confiance* qëndron në bindjen se besnikëria ndaj fjalës së dhënë është themeli i besës-*foi*.

Për sa i përket metodologjisë, u përpoqa të zbatoja analizën krahasuese të ideve më tepër se kërkimin pozitiv të provës filologjike. Sigurisht, kjo qasje nuk mund të jetë e plotë dhe mjaft pyetje mbeten të hapura. Megjithatë, nëse ky punim ka arritur të ravijëzojë sadopak një qasje të paparagjykuar të domethënies së vlerave morale dhe fetare tek shqiptarët, shpresoj se mund të shërbejë si pikënisje e rëndësishme për studime më të thelluara.

Referenca bibliografike:

AUSTIN, John 1962. *How to do things with words*. Oxford: Clarendon (William James lectures, 1955).

- BELMONT, Nicole 1979. "Superstition et religion populaire dans les sociétés occidentales", In: Michel Izard & Pierre Smith (eds), *La Fonction symbolique: essais d'anthropologie*. Paris: Gallimard, pp. 53–70..
- BENVENISTE, Emile 1966. *Problèmes de linguistique générale*. Paris: Gallimard.
- BENVENISTE, Emile 1969. *Le vocabulaire des institutions indo-européennes*. Paris: Minuit.
- BONNET, Guillaume 1999. *Les mots latins de l'albanais*. Paris: L'Harmattan.
- ÇABEJ, Eqrem 1976. *Studime etimologjike në fushë të shqipes - Études d'étymologie albanaise*, vol. 2 (A-B). Tirana: Akademia e Shkencave.
- ÇABEJ, Eqrem 1996. *Studime etimologjike në fushë të shqipes - Études d'étymologie albanaise*, vol. 4 (DH-J). Tirana: Akademia e Shkencave.
- DOJA, Albert. 1999a. "Morphologie traditionnelle de la société albanaise", *Social Anthropology: Journal of the European Association of Social Anthropologists*, 7 (1): 37–55, doi:10.1017/S0964028299000038 (<http://eprints.ucl.ac.uk/16544/>, <http://archives-ouvertes.fr/halshs-00406287>).
- DOJA, Albert 1999b. "Amitié, alliance, parenté: idéologie et pratique dans la société traditionnelle", In: Georges Ravis-Giordani (ed.), *Amitiés: Histoire et Anthropologie*. Aix-en-Provence: Presses de l'Université de Provence, pp. 217–255 (<http://archives-ouvertes.fr/halshs-00406315>, <http://eprints.ucl.ac.uk/16574/>).
- DOJA, Albert. 2000a. "Histoire et dialectique des idéologies et significations religieuses", *European Legacy: Journal of the International Society for the Study of European Ideas*, 5 (5): 663–686, doi:10.1080/713665519 (<http://archives-ouvertes.fr/halshs-00406263>).
- DOJA, Albert 2000b. *Naître et grandir chez les Albanais: la construction culturelle de la personne*. Paris/Montreal: L'Harmattan (<http://archives-ouvertes.fr/halshs-00406333>).
- DOJA, Albert. 2000c. "The politics of religion in the reconstruction of identities: the Albanian situation", *Critique of Anthropology*, 20 (4): 421–438, doi: 10.1177/0308275X0002000404 (<http://archives-ouvertes.fr/halshs-00406257>).
- CICERO. 1913. *De Officiis*. Cambridge: Harvard University Press.
- DUMÉZIL, Georges 1980. *Idées romaines*. 2e édition. Paris: Gallimard.
- DUMÉZIL, Georges 1987. *La Religion romaine archaïque*. 2e édition. Paris: Payot.
- EVANS-PRITCHARD, Edward 1956. *Nuer religion*. Oxford: Clarendon.
- EVANS-PRITCHARD, Edward 1965. *Theories of primitive religion*. Oxford: Clarendon.
- FREYBURGER, Gerard 1986. *Fides: étude sémantique et religieuse depuis les origines jusqu'à l'époque augustéenne*. Paris: Les Belles-Lettres.
- GJEÇOV, Shtjefen 1989. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, (ed.) Koco Nova. Tirana: Akademia e Shkencave (Trashëgimia Kulturore Shqiptare, e Drejta Zakonore, 1).
- HAARMANN, Harald 1972. *Der lateinische Lehnwortschatz im Albanischen*. Hamburg: H. Buske (Hamburger philologische Studien, 19).
- JAMOUS, Raymond 1981. *Honneur et baraka: les structures sociales traditionnelles dans le Rif*. Cambridge/Paris: Cambridge University Press/Éditions de la Maison des sciences de l'homme (Atelier d'anthropologie sociale).
- MAUSS, Marcel (with Henri Hubert) 1903 [1950]. "Esquisse d'une théorie générale de la magie", *Sociologie et anthropologie*. Paris: Presses Universitaires de France, pp. 3–141.
- MAUSS, Marcel. [2007] 1924. *Essai sur le don: forme et raison de l'échange dans les sociétés archaïques*. Paris: Presses Universitaires de France, doi: 10.1522/cla.mam.ess3.

- MEILLET, Antoine. 1921. "Lat. credo et fides", *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*, **22**: 215–218.
- POLYBIUS. 1922–27. *The Histories*. Cambridge: Harvard University Press.
- SAINT AUGUSTIN of Hippo. 1950. *The City of God*. New York: Modern Library.
- SAUSSURE, Ferdinand de 1916. *Cours de linguistique générale*. Nouvelle edition. Paris: Payot 1972.
- SEARLE, John R. 1969. *Speech acts: an essay in the philosophy of language*. Cambridge: Cambridge University Press.
- SEARLE, John R. & Daniel Vanderveken 1985. *Foundations of illocutionary logic*. Cambridge: Cambridge University Press.
- VANDERVEKEN, Daniel 1988. *Les actes de discours: essai de philosophie du langage et de l'esprit sur la signification des énonciations*. Bruxelles: Mardaga.

Albert DOJA, Albanian Academy of Sciences, Tirana

HONOR, PLEDGE AND BELIEF: ANTHROPOLOGICAL APPROACHES TO MORAL AND RELIGIOUS VALUES

Summary

The specific character of religion among Albanians is uncommon and difficult to understand by employing only the traditional schematic categories of understanding a religion. However, a careful analysis of the terms of the vocabulary of institutions that serve to express the notion of honor and belief, along with a comparative approach based on combined perspective of historic and linguistic anthropology, seem to be crucial for a new and more sophisticated understanding of the relation between social values of moral and religion.

By means of an analysis of semantic and cultural history of some values and social institutions, this article aims at proving that the notion of honor and religious notions influence each other. Thus, the belief and religion among Albanians are expressed as virtues of honor, while the weight of belief *-croyance-* and the belief-*confiance* are based on the conviction that staying true to a given word is the foundation of pledge-*foi*.

As regards methodology, I tried to use more comparative analysis of ideas compared with positive research on philological evidence. This approach, certainly, cannot be complete and many questions still remain open. However, I hope that if this paper has succeeded in outlining to some extent an unbiased approach to the meaning of moral and religious values among Albanians, it can serve as an important starting point for more advanced studies.

Edi SHUKRIU, Prishtinë

ARTI PARAHISTORIK SHKËMBOR I VLASHNJËS - SPIRALET DHE DRERI

KDU 904(49651)

Abstrakt

Arti parahistorik shkëmbor është zbuluar në vitin 2005 te Mrizi i Kobajës, pranë fshatit Vlashnjë (Komuna e Prizrenit). Është kjo një gjetje e veçantë, pasi që ky lloj i artit që nuk ka qenë i njohur në Kosovë dhe as në Ballkanin Perëndimor, pos atij në Tren të Shqipërisë dhe Lipci të Malit të Zi.

Lokaliteti me pikturim parahistorik gjendet në anën e djathtë të Lumbardhit dhe derdhjes së tij në Drinin e Bardhë dhe përbëhet nga grupimi i përsëritur skematik i shtatëmbëdhjetë (17) spiraleve të dukshme dhe të një dreri. Kompozicionet janë vendosur në tavanin kompakt dhe murin e hapësirës së shenjtë, hijerore. Pikturimi në tavan përbëhet vetëm nga spiralet, që kanë drejtime të ndryshme, ndërsa në pikturimin në mur gjendet edhe imazhi i drierit.

Spiralet janë paraqitur si ideograme konceptuale, ndërsa dreri, i cili u paraqin spiraleve në *Horizontin mural I*, si piktogram. Spiralet janë krijuar nga një vijë e pandërprerë dhe në një rast nga pika të renditura në varg. Këto paraqiten vetëm ose si spirale dyshe, gjithnjë si pjesë e kompozicionit. Pikturimi është bërë me ngjyrë të kuqe, mbi një sfond të bardhë, jo aq të ruajtur dhe kryesisht të mbuluar me kalcit.


Pikturimet dhe shenjat që i la njeriu parahistorik, siç janë pikturat e *Mrizit të Kobajës*, janë një gjuhë dhe “shkrim” i parë që ende duhet të mësohet dhe të deshifrohet, për ta kuptuar atë, veten tonë dhe njeriun në tërësi.

Fjalët çelës: arti shkëmbor, njeriu parahistorik, piktogram, ideogram, Vlashnja, spiralet, dreri


Në pranverë të vitit 2005 u zbulua pikturimi parahistorik shkëmbor pranë Vlashnjës së Prizrenit, i pari i këtij lloji në Kosovë dhe në rajon. Pikturimi gjendet në hijeroren shkëmbore të hapësirës që mban mikrotoponimin *Mrizi i Kobajës* dhe përbëhet kompozicioni i shtatëmbëdhjetë (17) spiraleve dhe të një dreri, të realizuar me ngjyrë të kuqe mbi një sfond të bardhë. Kompozicionet e veçanta janë vendosur në tavanin jokompakt dhe në murin e hijerore (Skica 1).

Mrizi i Kobajës shtrihet mbi bregun e djathtë të Lumbardhit dhe derdhjes së tij në Drinin e Bardhë, rreth 1 km në perëndim të fshatit Vlashnjë, në jugperëndim të Fushës së Prizrenit (Fot. 2). Kjo hapësirë, e izoluar gjeografikisht, është tejet pitoreske dhe e qetë, ofron përshtypjen e një mikrokozmosi të veçantë, tek i cili nuk është dhe aq lehtë të depërtohet.

Pjesa e epërme e *Mrizit të Kobajës* përshkohet me sedimente të gurit gëlqeror, ndërsa në pjesët e poshtme ka prezencë të granitit (300-400 m). Kjo hapësirë është shfrytëzuar gjatë mijëvjeçarëve për nevoja shoqërore dhe shpirtërore të banorëve parahistorike dhe të pasardhësve të tyre.



Skica 1. Arti parahistorik shkëmbor i Vlashnjës



Fot. 1 Pjesë e Mrizit të Kobajës dhe hijerorja Fot. 2 Hijerorja e derdhja e Lumbardhit në Dri

Në zonë janë konstatuar tri lokalitete arkeologjike të periudhave të ndryshme, të cilat gjenden në largësi prej rreth 50 m nga njëra-jetra: (1) hijerorja me kompozicion të artit shkëmbor parahistorik (Fot. 1, skica 2), (2) shpella, e cilat duket të jetë banuar në parahistorinë e hershme (Fot. 3) dhe (3) themelet e kishës së vogël mesjetare (Fot. 4).

Në veri të zonës është konstatuar dhe një vendbanim i periudhës mesjetare, siç dëshmojnë themelet e godinave të shumta, struktura e mureve dhe llaçi që lidh gurët e themeleve. Vendbanimi gjenden në hapësirë të gjerë në të djathtë të derdhjes së Lumbardhit në Dri, përkatësisht mbi pjesën e majtë të kanjonit të Drinit dhe për të është e nevojshme një përnjohje e veçantë arkeologjike dhe incezim gjeofizik.

Lokalitetet e identifikuara përbëjnë zonë periferike të kompleksit më të gjerë kulturor, ku bëjnë pjesë vendbanimet kodrinore *Gradi-shta* e *Vlashnjës* (epoka e neolitit të hershëm - mesjetë), *Gorica e Madhe*, *Gorica e Vogël*, si dhe lokalitetet në hapësirën e anës së majtë të Lumbardhit dhe derdhjes së tij në Dri, siç është ai i epokës së neolitit dhe themelet e Kishës së Shën Kollit (Skica 2).




Fot. 3. Shpella



Fot. 4. Kisha mesjetare



Fot. 5. Gradishta e Vlashnjës



Skica 2. Lokalitetet arkeologjike në rrethin e Vlashnjës

Përshkrimi i artit shkëmbor

Pikturimi parahistorik shkëmbor i Vlashnjës përbëhet nga grupimi i përsëritur skematik i shtatëmbëdhjetë (17) spiraleve të dukshme dhe të një

dreri. Kompozicionet janë vendosur në tavan (*Tavani 1* dhe *Tavani 2*) dhe mbi mur të strehimores, në dy horizonte (*Horizonti I* dhe *Horizonti II*). Pikturimi në tavan përbëhet vetëm nga spiralet, me drejtime të ndryshme, ndërsa në atë mbi mur gjendet edhe piktura e drrerit (*Horizonti I*). Pikturimet janë kryesisht të mbuluara me kalcit.

Në artin parahistorik të Vlashnjës spiralet janë paraqitur si ideogramme konceptuale, ndërsa dreri, i cili u paraprin spiraleve në *Horizontin mural I*, si piktogram. Spiralet janë krijuar nga një vijë e pandërprerë apo, në një rast, nga pika të renditura në varg dhe paraqiten vetëm ose si spirale dyshe, gjithnjë si pjesë të kompozicionit.

Pikturimi është bërë me ngjyrë të kuqe mbi një sfond të bardhë jo aq të ruajtur dhe të mbuluar me klacit. Ngjyra e kuqe është bërë nga përzierja e gjakut të shtazëve dhe të dyllit apo okërit.

Pikturimi në tavan

Pikturimi në tavan, i cili nuk është kompakt, është bërë në dy nivele: *Tavani 1* (4.70 x 0.85m) dhe *Tavani 2* (0.97 x 0.70m).

Tavani 1 përmban tetë spirale të ndara në dy zona: *Zona A* (në perëndim) dhe *Zona B* (në lindje). Zonat gjenden në një largësi prej 73 cm prej njëra-tjetrës. Në *Zonën A* janë pikturuar katër spirale, në distancë prej 20-40 cm nga njëra-tjetra. Tri prej tyre kanë drejtimin e lëvizjes së orës, ndërsa tjetra drejtim të kundërt (fot. 8). Në *Zonën B* gjenden dy spirale dyshe, njëra e ruajtur mirë, ndërsa tjetrës i duken vetëm gjurmët (Fot, 9).

Tavani 2 (0.97 x 0.70 m) përmban dy spirale dyshe të vendosura nën *Zonën A* të *Tavanit 1*. Spiralet dyshe kanë drejtime të kundërta, njëra në drejtim të lëvizjes së orës dhe tjetra në drejtim të kundërt.





Fot. 8 Tavani: *Zona A* - katër spirale Fot. 9. Tavani: *Zona B* - spirale dyshe


Pikturimi në mur

Pikturimi në mur i realizuar pak më djathtas nga pikturimet e tavanit është krijuar në dy nivele: *Horizonti I* dhe *Horizonti II*.

Horizonti I përmban pikturimin e një dreri dhe pesë spiraleve të dukshme (12.5 x 0.58 m). Pikturimet janë ruajtur relativisht mirë në një sipërfaqe prej 6.70 x 0.33 m. Dreri, i cili i paraprinë spiraleve, është pikturuar në pjesën perëndimore (29 x 29 cm). Mbi bririn e majtë të drerit gjendet një spirale e vogël. Pas drerit gjendet një spirale e ruajtur mirë, e përcjellë nga katër spirale të tjera njëra pas tjetrës në drejtim të lëvizjes së orës dhe në drejtim të kundërt. Spirala e katërt është më së shumti e dëmtuar.

Horizonti II është i përbërë nga tri spirale të dukshme dhe gjurmë motivesh që nuk mund të identifikohen (12.70 x 0.74 m, skica 1). Spirala e dytë, më e madhja dhe më e ruajtura në gjithë kompleksin ka drejtim të lëvizjes së orës (75 x 65 cm), ndërsa spirala e dytë ka drejtim të kundërt. Në pjesën e epërme të këtij horizonti në të djathtë gjendet dhe një rip i pikturuar i gjatë dhe i ndërprerë, nën të cilin kompozicioni i mëtejshëm është i paqartë.

Ndonëse dëmtimet e kohëve në të dy horizontet e pikturimit në mur nuk lejojnë përfundim të sigurt, ka gjasa që në to të jenë paraqitur spiralet dyshe, gjë që mund të ofrojë interpretim paksa tjetër semantikës së kompozicionit.



Skica 3. Pikturimi mural: Horizonti I dhe Horizonti II

Motivet

Motivet që paraqiten në artin shkëmbor parahistorik të Vlash-njës janë një shumësi e spiraleve dhe një drer, të vendosur në tavanin dhe murin e hijerores dhe të pikturuar me ngjyrë të kuqe. Numri i përgjithshëm i spiraleve të evidentuara është shtatëmbëdhjetë (17), dy mbëdhjetë (12) në tavan dhe pesë (5) në mur. Kësaj të fundit duhet shtuar dhe spiralen e vockël në bririn e majtë të drrerit.

Dymbëdhjetë (12) spiralet e tavanit janë të ndara në zonën perëndimore (Zona A) me katër (4) spirale dhe atë lindore me dy (2) spirale dyshe (Skica 1). Tri spirale të zonës perëndimore kanë drejtimin e lëvizjes së orës, ndërsa vetëm njëra në drejtim të kundërt (Foto 6, 9).

Zbërthimi dhe përcaktimi kohor

Zbërthimi i kompozicionit piktural të *Mrizit të Kobajës*, me piktogramet e spiraleve dhe ideogramin e drrerit, të vendosura në pozicione të ndryshme, nuk duket i thjeshtë. Artisti parahistorik (udhëheqësi shpirtëror) ka bërë përzgjedhje të veçantë me përzgjedhjen e spiraleve, si piktograme dhe imazhit të drrerit, si ideogram, duke sjellë kompleksitetin e gjuhës së tij.

Spiralja si simbol i kulturave dhe të kohëve të ndryshme është prezente edhe në parahistorinë e Kosovës, në qeramikën neolitike dhe, më pas, në stolitë e epokës së hekurit. Duke qenë simbole shpirtërore të rritës dhe të evolucionit, spiralet lidhen me idenë e mëvonshme të vdekjes dhe të ringjalljes.

Vazhdimësia e idesë së krijuar mbi vdekjen dhe ringjalljen dhe më pas të imazhit të universit (gjeometria e shenjtë) dëshmohe nga

labirinti unik me qark të mbyllur, i cili u zbulua në Kosovë në vitin 1988. Labirinti është trajtuar në monumentin e përkushtuar Perëndeshës Dardane (viti 211. Smirë. Fot. 10).



Fot. 10. Labirinti rrethor Fot. 11 Imazhi i drerit, pikturimi në mur

Artin shkëmbor parahistorik të Vlashnjës e veçon paraqitja e drerit, simbol i hyjve primarë, më pas kasnec i botës së nëndheshme (Fot. 11). I vendosur para vargut të spiraleve në murin e hijerores dreri i Vlashnjës del si kasnec i botës së nëndheshme, rrjedhimisht i ciklit të përjetësisë. Imazhi i tij duket më i zhvilluar se ai i drerit nga Valcamonica, që i takon epokës së hershme të bronzit dhe në të cilin janë të dukshme lidhjet e simboleve diellore të drerit dhe të ciklit diellor. Dreri paraqitet dhe në artin shkëmbor të Europës Juglindore, në atë të Trenit (Korçë, Shqipëri) dhe të Lipcicit (Boka e Kotorit, Mal i Zi), por në to janë pjesë të kompozicionit të gjuetisë së tyre dhe në të cilat gjahtarët kalurojnë duke mbajtur heshta. Dreri është prezent edhe në artin ilir dhe ishte njëri ndër shtazët më të adhuruara të shqiptarëve. Kur kihet parasysh se dreri përfytyrohet dhe si kasnec i botës së nëndheshme,

udhëheqja e tij të një vargu të spiraleve në pikturimin mural në *Horizontin I* të Vlashnjës i jep drerit edhe funksionin e simbolit të rilindjes.

Në artin parahistorik të Vlashnjës artisti ka mëtuar ta bartë mesazhin në kohën e tij, por edhe tej saj, me ndarjen e pikturimeve në tavan dhe në mur, me pikturim të drerit dhe pozitën specifike të tij, me madhësitë e ndryshme të spiraleve, me vendosjen e spiraleve në pozita dhe kahe të ndryshme, në drejtim të lëvizjes së orës dhe në drejtim të kundërt, përkatësisht nga pika qendrore e krijimit apo deri tek ajo.

Vendosja vetëm e spiraleve në tavan sjell lidhmërinë me sferat qiellore, ndërsa pozitat e ndryshme të tyre, si dhe drejtimet e ndryshme duket se sjellin edhe një kalendar parahistorik. Në anën tjetër, pikturimi i drerit në mur, me vargun e spiraleve (mbase dhe dyshe) sjellin lidhmërinë me tokën, përkatësisht me botën e nëndheshme, që sjell rumbullakimin e ciklit të përfytyruar të jetës: lindjes - vdekjes - rilindjes. Kështu, pikturimet në tavan dhe në mur lidhen ngusht me ciklin e jetës dhe ciklin e ndërrimit të moteve. I parë në këtë kontekst, arti parahistorik i Vlashnjës është i vlefshëm, sepse sjelli 1. konceptin e banorëve parahistorik mbi ciklin e jetës dhe 2. kalendarin parahistorikë. Që të dyja paralajmërojnë ekzistimin e vrojtuesve parahistorik të qiellit, të lëvizjes së yjeve dhe të fenomeneve të përgjithshme të natyrës.

Vetë kompozicioni ka si rezultat fillestar zhvillimin e kultit solar dhe të helioatrisë së krijuesve të saj, por mesazhi shkon edhe më tej. Këtë hapësirë duhet parë edhe si vend kulti ku janë zhvilluar ritet e iniciacionit të djemve, që kanë zgjatur disa ditë. Plasaritjet e shumta të shkëmbinjve kanë mundur të shërbenë për fshehjen nga burrat të gjërave organike, ndërsa të rinjve ka mundur t'u shërbejë për fjetje shpella në afërsi. Mbështetur në analogji, hijerorja duhet ta ketë dhe binjaken për femra jo tepër larg nga *Mrrizi i Kobajës*. Vendi i shenjtë për femra me gjasë duhet të jetë në hapësirat e anës së majtë të Lumbardhit mbi derdhjen e tij në Drinin e Bardhë, diku rreth fshatit Kobajë. Mundësia që të jetë në anën e djathtë të kanjonit të Drinit është më e vogël për shkak të pozitës gjeografike tejet të vështirë për t'u përballuar.

Përcaktimi kohor i artit shkëmbor parahistorik të Vlashnjës nuk është aq i lehtë, aq më tepër që për të nuk gjenden analogji të drejtpërdrejta. Po aq të vështirë datimin e bën përhapja e simbolizmit diellor në shoqëritë e epokës së bronzit edhe në Ballkan (Qerrja e Duplajës), si dhe fakti se ky

simbolizëm shprehet që nga epoka e neolitit. Në këtë drejtim nuk ndihmojnë as dy lokalitetet e vetme me pikturim shkëmbor parahistorik të kësaj pjese të Europës Juglindore, të zbuluara më herët në Tren dhe Lipci. Që të dy artet shkëmbore parahistorike, i Trenit dhe i Lipcit, paraqesin gjuetinë e drerëve, me paraqitjen edhe të njerëzve. Arti shkëmbor i Trenit, i ngjashëm me atë të Valcamonica-s, por pa prezencë të spiraleve, është datuar në kapërcyell të mijëvjeçarit të dytë në të parin p.K., si dhe arti shkëmbor i Lipcit me pesë drerë, një drenushë, dy svastika dhe një gjuetar. Këto si koncepte dallojnë mjaft nga ai i paraqitur te Vlashnja, me shumë spirale dhe vetëm një drer.

Shumësia e lokaliteteve arkeologjike të periudhave të ndryshme jo shumë larg hijerores nuk ndihmon po aq në datimin e këtij vendi të shenjtë. Nëse kihet parasysh kompozicioni gjithëpërfshirës, pozita e grupimeve skematike të simboleve, spiralet me drejtime të kundërta dhe pozita e tyre, si dhe mungesa e figurave të njerëzve, mendoj se pikturimi shkëmbor parahistorik i Vlashnjës është krijuar para vitit 2000 p.K., rrjedhimisht në fazat e hershme të epokës së bronzit të hershëm.

Hijerorja ka qenë në shfrytëzim për një kohë të gjatë si një vend i adhruar i shenjtë, ku popullata me ekonomi më komplekse i është lutur diellit dhe ku më pas janë zhvilluar edhe ritualet e iniciacionit. Shfrytëzimi i saj edhe gjatë epokës së hekurit e dëshmon majësheshta prej hekuri e ngulitur në murin e shkëmbit të hijerorja.



Fot. 12. Pëfshirja me kalcit i pikturimit



Fot. 13. Ekipi që për herë të parë vizitoi hijeroren

Studimi i mëtejshëm i artit parahistorik të Vlashnjës, si një arkiv i së kaluarës që përcjell mesazhe dhe tema primordiale, është një domosdoshmëri, sepse sjell një gjuhë dhe “shkrime” të para. Këto duhet të mësohen dhe të deshifrohen, për ta kuptuar njeriun parahistorik, veten tonë dhe njeriun në tërësi. Është kjo një botë tjetër, të cilin ende nuk e njohim dhe të cilin edhe njeriu parahistorik donte ta kuptonte. Studimet e tilla do të thonë dhe futje në intelektin njerëzor, njohjen e funksionimit të mekanizmave të këtij intelekt, si dhe depërtim në shpirtin e species sonë dhe gjetjen e logjikës së saj.

Pa marr parasysh gatishmërinë për promovimin dhe shfrytëzimin bashkëkohor të lokaliteteve në afërsi të *Mrizit të Kobajës*, arti parahistorik shkëmbor i saj paraqet një zbulim me interes të veçantë, si shprehje e mendjes dhe shpirtit të banorëve parahistorik të rajonit. Zbulimi i tij, i cili dëshmon zhvillimin e artit shkëmbor edhe në Kosovën parahistorike, është paralajmërues për prezencën e gjetjeve të tjera të ngjashme në këtë pjesë të Europës Juglindore. Ky art shkëmbor mund të ofrojë edhe shumë njohuri me interes pas realizimit të analizave përkatëse bashkëkohore dhe të studimit shumëdisiplinar, përfshirë fotogramerinë, ekzaminimin sistematik të pigmenteve, si dhe hulumtimin arkeologjik të shpellës.

Mrizi i Kobajës me artin shkëmbor parahistorik, si i veçantë apo bashkë me lokalitetet e tjera përreth, mund të trajtohet si peisazh i veçantë kulturor në mbrojtje të shtetit dhe po ashtu të shërbejë edhe si atraksion turistik me përfitime ekonomike.

Literatura

- ANATI, Emmanuel (2004): Introducing the World Archives of Rock Art (WARA): 50.000 years of visual arts Centro Camuno di Studi Preistorici, *New discoveries, new interpretations, new research methods*, XXI Valcamonica Symposium, Capo di Ponte, Edizioni del Centro.
- GREEN Miranda. (1991): The Sun - Gods of Ancient Europe, *B.T. Batsford Ltd.*, London.
- KORKUTI, Muzafer (1969): Piktura e Trenit, *Studime historike* 23/ 6, nr. 2, Tiranë.
- LEROI-GOURHAN, André (1964) : Les religions de la préhistoire, Press Universitaires de France, Paris.
- PUSIC, Ivan (1971) : Lipci, Morinja, Risan dessines préhistorique, *Epoque préhistorique et protohistorique en Yougoslavie, Société archéologique de Yougoslavie*, Beograd.
- STIPCEVIC, Aleksandar (1981) : Kultni simboli kod ilira, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne i Hercegovine, Sarajevo.
- TIRTJA, Mark (2004) : Mitologjia ndër shqiptarë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Dega e Etnologjisë, Tiranë.
- SHUKRIU, Edi (1995) : Dardania paraurbane, “*Dukagjini*”, Pejë/ (2004)
- SHUKRIU, Edi (2004) : Kosova antike, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “*Lumi*”, Prishtinë.

Edi SHUKRIU, Prishtinë

THE PREHISTORIC ROCKY ART OF VLASHNJA-SPIRALS AND THE DEER

Summary

The prehistoric rocky art was discovered in 2005 at the Shade of Kobaja, adjacent to the village of Vlashnja (municipality of Prizren). It is a unique discovery because this kind of art neither was known in Kosova nor in the Western Balkans, except the one in Tren of Albania and Lipc of Montenegro.

The site, with prehistoric painting, lays on the right side of Lumbardhi River and its flow into Drini i Bardhë, and it is made of a repeated schematic grouping of 17 visible spirals and a deer. The compositions have been placed on a compact ceiling and the sacred area, sanctuary. The painting on the ceiling contains spirals that have different directions while the wall painting contains also image of a deer.

The spirals were presented as conceptual ideograms, while the deer precedes spirals in the mural Horizon 1, as pictogram. The spirals were created on a straight line and in one case arranged in a row. They are presented only as double spirals, always as a part of composition. The painting is red on a white background, not well preserved and mainly covered by calcite.

Exhlale DOBRUNA-SALIHU, Instituti Albanologjik, Prishtinë

SKULPTURA E IMTË E BRONZIT NË PJSËN QENDRORE TË DARDANISË (KOSOVËN E SOTME) GJATË KOHËS ROMAKE

KDU 904:72(496.51)

Abstrakt

Në këtë punim, në bazë të ekzemplarëve të deritashëm të skulpturës së imtë punuar në bronz gjatë kohës romake në Kosovën e sotme, e cila në pjesën më të madhe është gjetur në arealin e Ulpianës dhe rrallë në arealet e qendrave tjera antike (Pejë dhe Therandë), do të japim një pasqyrë të pranisë së këtij lloji të skulpturës në këtë pjesë të Dardanisë.

Kjo skulpturë është e pranishme me dy grupe. Njërin grup e përbëjnë realizimet me përmbajtje religjioze-zbukuroese, ku gadi të gjithë ekzemplarët u takojnë statuetave të perëndive, të cilat edhe janë më të shumta nga e gjithë krijimtaria skulpturore e këtij lloji, ndërsa vetëm një ekzemplar është i natyrës animale. Grupit tjetër i takojnë punimet me përmbajtje dekorative-simbolike, deri tash të dëshmuara me dy aplika.

Numri më i madh i tyre ka të bëjë me modelet greko-helenistike dhe me një pjesë të mirë posedon kualitete të larta artistike punuar në qendrat e njohura të zanatit, kurse pjesa tjetër janë prodhime lokale, ku, pos krijimeve të zakonshme provinciale gjenden edhe ekzemplarë të kualitetit të lartë.

Këto realizime skulpturore tregojnë se kërkesa për skulpturën e imtë punuar në bronz, e cila në fakt ka të bëjë me punime artistike qoftë të importuara, qoftë të prodhimit lokal, në pjesën qendrore të Dardanisë (Kosovë) ka zënë një vend me rëndësi, që është rezultat i nivelit të lartë kulturor të qendrave antike të kësaj treve.

Fjalët çelësa: Dardania, Kosova, skulptura e imtë e bronzit, statuetat e perëndive dhe animale, aplikat, importi, prodhimi lokal.

Hyrje

Në pjesën qendrore të Dardanisë kërkesa për skulpturën e imtë në bronz është e hershme. Të një rëndësie të veçantë janë dy statueta të importit helen nga shekulli VI të gjetura në Prizren: figurina e njohur e Vrapueses që ruhet në Muzeun Britanik dhe figurina e bukur e cjamin të shtrirë,

e cila gjendet në Muzeun e Vranjës.¹ Në kohën romake numri i kësaj krijimtarie artistike është dukshëm më i madh, e cila në intervalin kohor nga fundi i shekullit I deri në fund të shekullit III në pjesën më të madhe është zbuluar në arealin e Ulpianës, ndërsa shumë pak në arealin e qendrave tjera – një municipi me emër të panjohur në rrjedhën e epërme të Drinit të Bardhë dhe një civitas (Pejë dhe Therandë). Prandaj këtu do të japim një pasqyrë të punimeve skulpturore të këtij lloji në këtë pjesë të Dradanisë gjatë kësaj kohe.

Këto punime janë të pranishme me dy grupe: religjioze-zbukuruese dhe zbukuruese-simbolike.

I. Realizimet e funksionit religjioz-zbukurues – Gati të gjithë ekzemplarët i përbëjnë statuetat e perëndive, të cilat njëherit janë edhe më të shumta nga e gjithë krijimtaria artistike e skulpturës së imtë të bronzit, kurse shumë rrallë janë të natyrës animale.

Katër statueta janë gjetur në qytetin e Ulpianës.

Njëra statuetë i takon **Minervës** (*Minerva*). E një gjatësie 10 cm., pos disa dëmtimeve të vogla dhe thyerjes së pëllëmbës së dorës së majtë, është e ruajtur mirë (fig. 1a, b).² Është e paraqitur në pozicionin e zakonshëm në këmbë, *en face*, me peshën e trupit që rëndon mbi këmbën e djathtë, ndërsa të majtën, të përkulur lehtë në gju, e ka të shtyrë anash. Kjo vërehet qartë përfundi kitonit (hiton) të dyfishtë (*tolaris*), i cili bie përgjatë trupit deri të shputat me pala të thella dhe të rralla pëpara, ndërsa prapa me pala të shpeshta dhe të cekta. Të gjitha elementet tjera i përgjigjen natyrës së saj. Në gjoks gjendet parzmorja (*aegis*), e cila, në vend të figurës së Meduzës, është e zbukuruar me ornamente dhe e punuar në të dy anët, kurse në kokë mban përkrenaren korintase; në dorën e majtë të lëshuar poshtë mban mburojën eliptike (*clipeus*) që prek tokën, ndërsa me dorën e djathtë, të lakuar në bërryl e të ngritur, me siguri mbante heshtën (*hasta*) në të cilën mbështetej. Detajet fizionomike të modeluara thjeshtë dhe ornamentet e egidës e të mburojes janë trajtuar me gravurim. Sipas mënyrës së punimit, sidomos trajtimit të drapesisë, e cila së bashku me trupin

¹ RICHTER, G. M. A. (1950): f. 373, fig. 86 (figurina e Vrapueses); VUKADINOVIĆ, T. P. (1973): ff. 1 e tutje, fig. 6, TT. 1-3 (figurina e cjamin).

² E gjetur gjatë gërmimeve arkeologjike në vitin 1958. Gjendet në Muzeun Popullor të Beogradit me nr. inv. 2789/III, khr. POPOVIĆ, Lj. (1969): n. 84; VELIČKOVIĆ, M. (1972) f. 21, n. 13. Interpretimin DOBRUNA-SALIHU, E. (2010): f. 154, fig. 1.

është trajtuar dukshëm më me kujdes se sa koka e një madhësie më të vogël, mund të thuhet se kjo figurinë gjithsesi ka të bëjë me një punë provinciale mesatare të shek. II apo III më me siguri të një punëtorie lokale.

Është e njohur se statuetat e Minervës kopjojnë tipat e Athenës greke të krijuar në shek. V dhe IV p. Kr. Në rastin tonë, pozicioni dhe të dy atributet e statuetës kanë të bëjnë me paraqitjen standarde të perëndeshës së armatosur që paraqet replikën e skemave të njohura të perëndeshës, para së gjithash të tipit të Athenës luftarake (*Athene Promahos*),¹ të cilën e hasim në të gjithë Perandorinë, ku mund të gjejmë edhe analogji. Nga trevat diç më të afërta, kjo do të ishte figurina nga treva e Histrisë, me dalline në pozicionin e pjerrtë të mburojës dhe të pozicionit të këmbëve (fig. 2),² kurse nga qendrat e largëta më së shumti ngjashmëri hasim në dy statueta nga Madridi dhe Roma.³

Kjo statuetë në Dardani paraqet të vetmin ekzemplar të kësaj perëndeshe në skulpturë të plotë, ndërsa të dytin në gjininë e skulpturës, ku ekzemplari tjetër është realizim relievor në një pllakë kulti punuar në mermer nga pjesa jugore dardane, treva e Kumanovës.⁴

Në dy realizimet tjera statuale është paraqitur Merkuri (*Mercurius*). I skalitur në këmbë, me peshën që rëndon mbi këmbën e majtë, përkatësisht të djathtë, te të dy statuetat perëndia është paraqitur sipas modeleve të skulpturës së plotë të formuar në kohën klasike – me pamjen karakteristike të të riut, kapelën e udhëtarit me flatra (*petasos*) dhe vetëm me klamidën (*hlamida*) e hedhur mbi njërin sup. Kjo ikonografi në kohën romake bëhet mënyra e zakonshme e paraqitjes së tij⁵. Që të dy figurinat po ashtu janë të ruajtura shumë mirë.

Te njëri ekzemplar, me gjatësi 6 cm., kemi të bëjmë me statuetën e vendosur mbi një bazament konusoid të profiluar (fig. 3).⁶ Me klamidën e lëshuar nga supi i majtë në llërë, kokën e përkulur lehtë në të djathtë dhe këmbën e majtë të përkulur në gju e të tërhekur prapa, Merkuri, është

¹ Khr. DINNSMOR, W. B. (1921): ff. 118 e tutje.

² JURKIĆ-GIRADI, V. (2005): f. 155, n. 2.4.7. nga Bërtonigla.

³ REINACH, Salomon (1897a): f. 289, n. 3 (nga Madridi); i njëjti (1904): f. 84, n. 1 (nga Roma).

⁴ DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005): ff. 806-807, n. kat. 307, T. 144, fig. 265.

⁵ Khr. SIEBERT, G. (1990): f. 364, nn. 923-925, f. 368, n. 953 a-c. Në këtë kohë ai është paraqitur edhe me flatra në kokë; i njëjti, f. 367, n. 948 a, b, f. 368, n. 953 b.

⁶ Rrethanat e gjetjes nuk janë të njohura. Gjendej në Muzeun e Kosovës me n. inv. 968, kurse në vitin 1998 është bartur në Beograd, ku gjendet edhe sot, khr. ARHEOLOŠKO BLAGO (1998): f. 600, n. 242. Interpretimin DOBRUNA-SALIHU, E. (2010): f. 154, fig. 2.

paraqitur me atributet kryesore: shkopin lajmëtar (*caduceus*) në dorën e majtë, qesen e të hollave (*marsupium*) në dorën e djathtë të lëshuar poshtë, si dhe petasin në kokë nga i cili dalin paksa blejtë e shpeshtë të flokëve në ballë. Edhe pse statueta është trajtuar mjaft e shtanguar, me një dozë skematizimi dhe pa plastikë, sidomos te gjymtyrët, si dhe pa modelim të qafës, proporcionet e trupit janë të mira. Të gjitha detajet fizionomike, të cilat janë modeluar thjeshtë, si dhe detajet e trupit – muskulatura e toraksit dhe e abdomenit – sikundër edhe gjunjë, si i vetmi detaj i këmbëve me shputa të shkurtëra dhe pa detaje karakteristike, janë potencuar me vija të gravuruara harkore dhe të drejta. Ndërkaq, gjinjë, kthiza dhe organi gjeneral janë theksuar me nga një vrimë të thelluar, që haset edhe në qesen mjaft glomaze. Me këto detaje tregon ngjashmëri me statuetën nga Kladova e sotme në provincën e Mezisë së Epërme.¹

Kjo statuetë, që karakterizohet nga mënyra rustike e punimit, është prodhim i punëtorisë lokale – pa dyshim nga një mjeshtër, i cili, megjithëse autodidakt, sado pak e njihte zanatin e skalitjës, që shihet në orvajtjet e modelimit të drejtë anatomik të trupit – që, bazuar në statuetat e punimit të ngjashëm nga provincat e tjera,² mund të thuhet se i takon shek. II ose III.

Tek ekzemplari tjetër kemi të bëjmë me grupin statuar të gjatësisë 12,5 cm. në bazamantin në trajtë pllake (fig. 4).³ Këtu Mërkuri është paraqitur me të gjitha atributet dhe shoqëruesit: dashin dhe gjelin anash, breshkën në mes të këmbëve, si edhe perëndinë e mirë, personifikimin e pasurisë Plutin (*Plutos*) në krahun e majtë mbi një postament të lartë. Duke qëndruar në mes të këtij grupi skulptur me të dy atributet – shkopin lajmëtar dhe qesen – është trajtuar në trajtë fëmije të plotë ngjashëm me Erosin. Ky trajtim të përkujton figurën e fëmisë nudo me atributet dhe shoqëruesit e kësaj perëndie të paraqitur në relievin e stelës mbivarrore në Muzeun Kombëtar i Romës.⁴ Mirëpo kjo nuk ndikon në kualitetet artistike, meqë këtë e hasim edhe te statueta e veshur e Mërkurit me pamje djaloshare nga

¹ BRUNSMID, J. (1914): ff. 220-221, n. 29.

² Khr. ZOTOVIĆ-ŽUNKOVIĆ, Lj. (1959): f. 213, fig. 2; VUČKOVIĆ, M. (1972): ff. 30-31, n. 30; TADIN, Lj. (1979): 16-17, nn. 23, 26, T. 15, figg. 22, 25.

³ E gjetur në një ndërtesë dhe e bartur në Muzeun e Kosovës me nr. inv. 127, ndërsa në vitin 1998 është bartur në Beograd, ku ende gjendet, khr. ČERŠKOV, E. (1969): ff. 72-73, fig. 32; ARHEOLOŠKO BLAGO (1998): f. 600, n. 242. Interpretimin DOBRUNA-SALIHU, E. (2010): ff. 154-155 fig. 3.

⁴ SIMON, E. – BAUCHENSS, G. (1992): f. 519, n. 229.

Sremi i sotëm në provincën e Panonisë,¹ si edhe te figurat e tjera mitologjike, siç është dadofori nga *Mediana* (Bërzi Brodi) në Dardani.² Trupi i perëndisë, i këthyer natyrshëm në anën e majtë, është modeluar me proporcione të sakta, muskulaturë të paraqitur mirë, gjinjtë e plotë, barkun e gufuar, kërthizën e thelluar dhe gjenitalet. Po ashtu edhe në kokën e këthyer në atë drejtim, të gjitha detajet, pos flatrave glomaze të petasit me pupla të theksuara, janë trajtuar në mënyrë plastike dhe me mjeshtri. Kjo vërehet si te tufat e flokëve, nga të cilat duket një rend krrrelash të rregullta në formë rrrathësh në ballë, ashtu edhe në modelimin e drejtë të veshëve. Në të njëjtën mënyrë janë trajtuar edhe tiparet në fytyrë, ku sytë janë detajuar me kapakë dhe bebe të thelluar, hunda e rregullt, ndërsa goja paksa e hapur. Ngjashëm është trajtuar edhe koka e Plutit në figurë fëmije. Ndërkaq, si palat e klamidës, e cila nga supi i majtë bie mbi postament (hermë), ashtu edhe figurat e shtazëve janë trajtuar me vija të skalitura thellë në mënyrë lineare. Shikuar në tërësi, figura e perëndisë, megjithë pjesët e plota të trupit, si dhe trajtimin e këmbëve pa muskulaturë në trajtë shtyllash me shputa glomaze, së bashku me paraqitjen sipërfaqësore të pëllëmbës së dorës së djathtë me qese, përmban kualitete të larta artistike, që tregon se duhet të jetë skalitur në njërën nga qendrat e njohura të zanatit. Sipas modelimit të njëjtë të pëllëmbës së dorës së djathtë (në të cilën mbante qesen) me statuetën e mëhershme të Mërkurit, por me dallime të qarta në stilin e punimit, mund të thuhet se ndoshta kemi të bëjmë gjithashtu me prodhim të punëtorisë së Ulpianës rreth shek. II ose III.

Grupet statuale të Mërkurit – Hermesit i hasim në të gjithë Perandorinë. Ato më me shumë shoqërues janë të pranishme si te krijimet e traditës lisipiane të "Hermesit në pushim"³ ashtu edhe te paraqitjet e zakonshme të Mërkurit në këmbë të realizuara në skulpturë të plotë dhe relief, kryesisht altarë.⁴ Mirëpo analogji të përfafërt me ekzemplarën tonë nuk kemi hasur, pos deri diku një grupi statuar i cili ruhet në muze të Luvrit, ku

¹ BRUNŠMID, J. (1914): f. 221, n. 31; TADIN, Lj. (1979): ff. 16-17, n. 25, T. 15, fig. 24.

² JOVANOVIĆ, A. (1975): f. 58, n. 6, T. 6, fig. 7. Interpretimin: SREJOVIĆ, D. – CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1987a): f. 150, n. 60; DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005): ff. 574, 575, 857, 858, kat. n. 404, T. 187, fig. 349.

³ SIEBERT, G. (1990): 5/1, f. 369, nn. 964, 965; 5/2, f. 281, figg. 964, 965.

⁴ REINACH, S. (1987a): f. 174, nn. 3, 4, 6-8; SIMON E. – BAUCHENSS, G. (1992): 6/1, ff. 549-551, nn. 503-508, 515; 6/2, f. 105, fig. 503-508, 515 (numri më madh i altarëve vjen nga Galia).

kjo perëndi është paraqitur me të njëjtin shoqërues, por pa Plutin (fig 5)¹.

Deri më tash në tërë Dardaninë disponojmë edhe me tri statueta të kësaj perëndie në bronz – dy nga areali i *Scupi-t* dhe një nga Mediana.² Në skulpturë, po ashtu janë të pranishme edhe dy realizime në mermer nga Mediana dhe *Timacum minusi* (Ravna te Knjazhevci), të cilat i takojnë importit.³

Statueta e fundit deri më tash nga kjo qendër i takon Apolonit (*Apollo*). Figurina e gjatësisë 11,5 cm. nuk është e ruajtur në tërësi. Asaj i mungon e gjithë dora e djathtë së bashku me atributet, si dhe sipërfaqja i është e dëmtuar mjaft nga korozioni, sidomos në fytyrë dhe flokë (fig. 6).⁴ Perëndia, me pamjen e një të riu, është paraqitur nudo, në këmbë, me peshën e trupit që rëndon mbi këmbën e djathtë, mbi të cilën e ka hedhur të majtën, e cila prek tokën vetëm me gishta. Dora e majtë është e lakuar në bërryl. Koka, në harmoni me pozicionin e trupit, të modeluar me vija të buta është kthyer në të djathtë me një përkulje të lehtë. Ngjashëm edhe fytyra është modeluar me vija të njëjta dhe me detaje precize dhe plastike, sikundër edhe flokët e ndarë në mes, ku krrelat në maje lidhen në nyjen karakteristike të Apolonit (*krobylos*), kurse pjesa tjetër e flokëve e rrethon fytyrën në formë kurore, duke përfunduar me dy përdredha mbi supe. Po ashtu edhe ana e pasme e statuetës është e punuar me kujdes.

Kjo figurinë, me tiparet themelore të skulpturës së Praksitelit, duket se e kopjon origjinalin grek në mermer të formuar në kohën helenistike me mbështetje të trupit në dorën e majtë nga një skulptor i panjohur nën ndikimin e stilit të po këtij skulptori. Shikuar nga ky aspekt, më e afërt është me katër realizime statuale të tipit të afërt: “Satiri në pushim” dhe *Apollon Ly-*

¹ REINACH, S., po aty, n. 4.

² Ekzemplarët nga areali i Skupit, njëri i gjetur në vetë Skupin dhe tjetri në Çellopek të Tetovës, janë rustik, khr. KORAČEVIĆ, D. (2002): f. 54, T. 3, fig. 7. Kurse figurina e gjetur në Madianë, e cila i takon importit, paraqet punë mjaft cilësore, khr. DRČA, S. (1991): ff. 22-23, n. 10.

³ Për ekzemplarin nga Mediana khr. JOVANOVIĆ, A. (1975): f. 59, n. 10, T. 8, fig. 11. Interpretimin: SREJOVIĆ, D. – CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1987a): f. 148, n. 65; DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005): ff. 549, 550, 848, kat. n. 348, T.178, fig. 329 Për ekzemplarin nga Timak minusi khr. VULIĆ, N. (1941-48): f. 94, n. 205. Interpretimin DOBRUNA-SALIHU, E., po aty, ff. 551-552, 849, n. 585, T. 178, 330.

⁴ E gjetur në vitin 1956 gjatë punimeve bujqësore në lokalitetin Gradinë dhe e ruajtur në Muzeun e Kosovës me nr. inv. 82, ndërsa nga viti 1998 e bartur në Beograd, khr. NIKOLIĆ, D. (1957): ff. 265 e tutje; ČERŠKOV, E. (1969): f. 72, fig. 30; SREJOVIĆ D. – CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1987a): f. 76, n. 29; ARHEOLOŠKO BLAGO (1998): f. 597, n. 236; DOBRUNA-SALIHU E. (2010): ff. 155-156, fig. 4.

keios të Praksitelit,¹ *Pothos*-in e Skopasit² dhe sidomos është e afërt me realizimin e skulptorit Timarhides nga shek. II p. Kr., *Apollon Kitharoidos*, ku perëndia është paraqitur i mbështetur me dorën e majtë në lirë (kitarrë), kopja më e mirë e të cilit gjendet në Kirenë (*Cyrene*, Shahati) në Libi.³

Nga stuatat e Apolonit në bronz, në trevat e largëta më së shumti analogji ikonografike hasim në dy statueta nga qendrat e sotme Montreal dhe Reims në Francë (Galia ant.), ku perëndia dorën e djathtë e ka të ngritur mbi kokë, ndërsa të majtën të mbështetur në lirë.⁴ Apolonin të mbështetur në lirë dhe këmbë të kryqëzuara, por me dorën e djathtë të lëshuar përgjatë trupit, poshtë, e hasim edhe te dy ekzemplarë në qendrat e provincave tjera.⁵ Ndërkaq, te dy ekzemplarë nga dy provinca më të afërta, Apoloni, megjithëse është skalitur në pozicion të ngjashëm, posedon një detaj të njëjtë me ekzemplarin tonë – mungesën e mbështesës në dorën e majtë – duke paraqitur rast interesant. Njëra statuetë është nga *Ulpia Traiana Sarmizegetusa* (Varhelya) në Daki, në të cilën Apoloni, me llërën e dorës së majtë të thyer, dorën e djathtë e ka të ngritur mbi kokë, ku duke marrë parasysh se në të mbante pendën (*plectrum*), mund të bëhet se flet për prani të lirës (fig. 7).⁶ Në statuetën tjetër nga Martinci i sotëm në Panoni, Apoloni, të cilit i është thyer pëllëmba e dorës së majtë, është paraqitur me dorën e djathtë të lëshuar poshtë, ku, ngjashëm, mbante pendën, që njëjtë duket se aludon në lirë. Kjo figurinë, sipas pozicionit të trupi, këmbëve dhe sidomos kokës, së anuar në të djathtë, me frizurë të krehur në trajtë kurore dhe dy përdredhat mbi supe, tregon ngjashmëri më të madhe me statuetën tonë, por me dallime të theksuara në punim (fig. 8).⁷ Në krahasim me të gjitha këto figurina, përkundër numrit të vogël pa kurrfarë mbështetëse në gjendjen e tashme, kurse shumicës së rasteve i mbështetur në lirë, vështirë është të thuhet saktë se figurina e jonë – e cila dorën e djathtë duhet ta kishtë të lëshuar përgjatë trupit – a paraqet Apolonin e mbështetur në lirë, apo skalitësi si në këtë rast, ashtu edhe te dy ekzemplarët e cekur më lart nuk e ka skalitur këtë instrument, me ç'rast do të

¹ PICARD, Ch. (1948): f. 510; BIEBER, M. (1955): fig. 17; KRAUSKOPF, I. (1984): ff. 193-194, n. 39 f-z.

² LIPOLD, G. (1950): T. 91/3.

³ BIEBER, po aty, figg. 678-679; KRAUSKOPF, I., po aty, f. 257, n. 586.

⁴ LEBEL, P. (1962): ff. 15-16, n. 4, T. 3; RIDER, A. de (1913): f. 18, n. 1057, T. 62.

⁵ REINACH, S. (1987): f. 241, n. 4, f. 254, n. 5.

⁶ ALICU, D. – POP, C. – WOLLMANN, V. (1979): f.143, n. 371.

⁷ TADIN, Lj. (1979): ff. 11-12, n. 8, T. 4, fig. 8 a, b.

paraqiste një elaborim të origjinalit helenistik. Sido që të jetë, një gjë është e sigurt, duke paraqitur një replikë shumë të bukur, të kualitetit të lartë artistik, të punuar në kohën e hershme perandorake, gjatë kohës së Hadrianit, i takon importit nga një qendër e njohur artistike, e cila në Ulpianë u shfytëzua në funksion të altarit shtëpiak (*lararium*) ose të zbukurimit.

Kjo statuetë paraqet të vetmin realizim skulpturorë të Apolonit në Kosovë, ndërsa të dytin në tërë Dardaninë, të cilin e përben një statuetë në mermer kualitativ të gjetur në Skup, që po ashtu paraqet import.¹

Një statuetë vjen nga territori i Ulpianës, e gjetur në vendbanimin dhe stacionin *Vendenis* (Gllamnik). Ajo paraqet **Venerën** (*Venus*), së cilës i mungon shputa e këmbës së djathtë me një pjesë deri nyelli dhe shputa e këmbës së majtë, ndërsa e gjithë pjesa tjetër e figurinës është e ruajtur mirë me një gjatësi 7,6 cm. Sipërfaqja e saj është e mbuluar me patinë të gjelbërt të mbylltë, ku vende-vende ka mbetur ngjyra e përhimtë natyrale e metalit (fig. 9a, b).² Me një kthyerje të lehtë të trupit lakuriq nga e majta, perëndesha qëndron me peshë mbi këmbën e majtë, ndërsa të djathtën, të përkulur lehtë në gju, e ka tërhequr pak prapa. Të dy duart i ka të lakuara në bërryl. Me të majtën, të ngritur deri në lartësi të supeve, mban një tufë flokësh të përdredhur dhe të larguar nga trupi. Me të djathtën, diçka më dimensionale, lart mbi kokë, në drejtim të fytyrës, mban një pasqyrë predimensionale (*speculum*) me një dorëz të gjatë të mbështetur në pjesën e brendshme të llërës. Pa dyshim se perëndesha është paraqitur në çastin e tolatit – rregullimit të flokëve – dhe si e tillë paraqet njërën nga variantet e shumta të Venerës lakuriqe, të cilat janë punuar sipas Praksitelit dhe shkollës së tij.³ Kokën e ka të këthyer me tri të katërtat në profil djathtas, me shikim në pasqyrë. Flokët e ndarë në mes dhe të krehur me kujdes në krela të shpeshata rreth fytyrës, prapa, në zverk, mbledhen në një, prej nga dy tufa përdredhash bien në supe. E të gjithën e zbukuron diadema e theksuar mjaft në trajtë të kurorës. Përkundër frizurës, detajet në fytyrë janë trajtuar thjeshtë me gravurim, kurse trupi është punuar me mjaft kujdes, detajet anatomike të të cilit janë trajtuar natyrshëm jo vetëm në anën e përparme, por edhe të pasme. Shikuar në tërësi, kjo statuetë paraqet një punë mjaft

¹ KORAČEVIĆ, D. (2002): f. 55, fig. 15.

² Është gjetje rasti në pronën private të H. Islamit afër ndërtesës luksoze (vilës) me mozaik, khr. DOBRUNA-SALIHU, E. (1995): ff. 78-80, fig. 1 a, b; e njëjta (2010): ff. 156-157, fig. 5.

³ Khr. BIEBER, M. (1955): figg. 36-39 shtatoret portretore në ikonografi të Venerës; e njëjta (1977): figg. 225, 226, 228 Afroditë – Venera.

cilësore me proporcione të harmonishme, e cila me siguri u punua sipas një modeli të mirë helenistik në njërën nga qendrat e njohura të zanatit.¹ Prandaj, pa dyshim, kemi të bëjmë me import, në të mirë të së cilës flet edhe vendi i gjetjes, ku, sipas të gjitha gjasëve ka qëndruar në altarin (*lalarium*) e ndërtesës luksoze me mozaikun e Orfeut. Megjithëse është vështirë të përcaktohet saktë koha e punimit,² prap, duke u bazuar në figurinat e një punë të mirë provinciale dhe të importuara në qendrat e provincave tjera gjatë shek. II ose gjysmës së parë të shek. III³, mendojmë se është e mundshme që edhe kjo statuetë t'i ketë takuar kësaj kohe.

Paraqitja e Venerës në çastin e toaletit me pasqyrë në dorë, e cila në trevën e Dardanisë deri më tani paraqet të vetmin rast, nuk janë të rralla në trevat provincat tjera të Perandorisë. Perëndesha, e cila pasqyrën shpesh e mban në dorën e majtë, ndërsa rrallë në të djathtë, është paraqitur me varianta të ndryshme: duke rregulluar flokët⁴ – si në rastin tonë – ose me krehër, ndërsa rrallë me mollë, ose pa të.⁵ Në mes tyre më së shumti analogji me figurinën tonë mund të hasim te tre ekzemplarë, ku perëndesha me njërën dorë po ashtu mban një tufë të flokëve. Te njëri, ku është paraqitur gjysmë e veshur, ngjashmëria është e pranishme te pozicioni i tërësishëm i trupit, kokës dhe dorës me të cilën mban tufën, me ndryshim të dimenzioneve shumë të vogla të pasqyrës (fig. 10).⁶ Tek ekzemplari tjetër, i një pune shumë të mirë, sipas pozicionit të trupit dhe dorës së majtë me të cilën mban tufën, ndërsa te ekzemplari i tretë, i një pune rustike, sipas dimenzioneve të mëdha të pasqyrës dhe dorës me tufën e flokëve.⁷

¹ Është e njohur se skulptura e Praksitelit në artin romak, e cila më së shumti haset, është punuar sipas kopjeve helenistiko-romake, khr. BIEBER, M. (1955): f. 98.

² NEUGEBAUER, K. A. (1921): f. 111 thekson se datimi i figurinave të bronzit është shumë i komplikuar, meqë vetitë stilistike nuk janë aq të shprehura për të qenë element kyç për përcaktimin kohor të monumentit.

³ Khr. VELIČKOVIĆ, M. (1972): ff. 38-39, nn. 51-53 a, b; TADIN, Lj. (1979): ff. 13-15, nn. 14, 17-19, TT. 8-11, figg. 14, 16-18 për Mezinë e Epërme dhe pjesën jugore të provincës së Panonisë.

⁴ Khr. REINACH, S. (1897a): f. 361, nn. 6, 7; i njëjti (1904): f. 105, n. 8, f. 106, n. 6; i njëjti (1910): f. 202, n. 1; PICARD, G. Ch. (1997): ff. 208-209, nn. 165-167.

⁵ Khr. Reinach, S. (1987a): f. 361, nn. 2-5, 9, 10; Picard, G. Ch., po aty, ff. 208-209, nn. 163, 164, 173-175, 177. Nga qendrat e afërta khr. Veličković, M. (1972): ff. 42-43, n. 59 (nga areali i Viminacit në Mezi të Epërme); Tadin, Lj. (1979): f. 15, n. 20, T. 12, fig. 19 a, b (nga Mursa në Panoni).

⁶ REINACH, S. (1910): f. 202, n. 1.

⁷ PICARD, G. Ch., po aty, f. 208, nn. 165, 166.

Deri tash ky ekzemplar në tërë trevën dardane paraqet rastin e katërt të kësaj perëndeshe punuar në bronz. Tri statuetat e tjera janë nga areali i *Naissus*-it, ku, megjithëse është paraqitur nudo, nga të cilat njëra i takon tipit *Pudica*, në të tria mban attribute të tjera dhe edhe kemi të bëjmë me prodhime vendore¹. Kurse në mbarë Kosovën ky ekzemplar paraqet rastin e dytë të saj punuar në skulpturë. Ekzemplari tjetër, vendgjetja e të cilit, sipas të gjitha gjasëve, duhet të jetë në Ulpianë, është punuar në mermer, ku kemi të bëjmë me një grup statuar të Venerës, po ashtu të tipit *Pudica*, me dy erosë me dimensione shumë vogla.² Në Dardani janë të pranishme edhe katër shtatore të kësaj perëndeshe të punuara në mermer, nga të cilat tri janë të këtij tipi – dy nga Timak minusi,³ një nga Skupi⁴.

Statueta e fundit në bronz deri tash e zbuluar në Kosovë, që u takon perëndive, është gjetur në afërsi të Pjës së sotme (*Siparuntum* ?). Paraqet **Marsin** (*Mars*) në këmbë me gjatësi 7,2 cm. të vendosur në një bazament të ulët rrethor (fig. 11).⁵ Pos dëmtimeve të detajeve në kokë dhe të sipërfaqes së koroduar, që më vonë është pastruar, e tërë figurina është ruajtur mirë. Kokës në profil në anën e djathë i përgjigjet pesha e trupit që rëndon mbi këmbën e kësaj ane, ndërsa e majta është e tërhequr lehtas prapa. Me pamje të të riut, kjo perëndi është paraqitur në pajisje ushtarake: mantelin e zakonshëm (*paludamentum*), përkrenaren me tufë puplash (*crista*), parzmoren (*lorica*), mburojën e vogël ovale (*cetra*) dhe heshtën (*hasta*), e cila mungon, është rast i shpeshtë edhe te statuetat e tjera të saj. Punimi i gjithmbarshëm paraqet një punë provinciale të prodhimit serik nga shek. III.

Kjo statuetë mund të lidhet me tipin e Marsit hakmarrës (*Ultror*),⁶ por me qëndrim invers të trupit me kokën në profil dhe në figurë të perëndisë në moshë të re, pa mjekërr. Ndërsa në statuetën nga qendra tjetër e Dardanisë, areali i Naisit, po ashtu të paraqitur në pajisje ushtarake, i

¹ DRĆA, S. (1992): ff. 21-22. nn. 7-9, figg. 7-9.

² DOBRUNA-SALIHU, E. (2012): ff. 86-87, fig. 8.

³ Vulić, N. (1931), f. 232, n. 620; i njëjti (1941-48): f. 92, n. 197. Interpretimin Dobruna-Salih, E. (2003-2005): ff. 546-547, 847-848, kat. nn. 382-383, T. 177, figg. 327-328.

⁴ Ky ekzemplar është gjetur në kohë të fundit dhe ende nuk është publikuar. Rëndësia e tij qëndron në faktin se me të u dëshmuua nderimi i kësaj hyjneshe edhe në pjesën jugore dardane.

⁵ Rrethanat e gjetjes nuk janë të njohura, por mendohet se u zbulua rastësisht në gjysmën e parë të shekullit XX. Gjetet në Muzeun Popullor në Beograd me nr. inv. 2783/III, khr. POPOVIĆ, Lj. (1969): n. 86; VELIČKOVIĆ, M. (1972): ff. 18-19, n. 9. Interpretimin DOBRUNA-SALIHU E. (2010): f. 157, fig. 6.

⁶ DURBRACH, F. (1905), ff. 1607 e tutje.

përgjigjet tipit burimor edhe me qëndrim edhe me paraqitje në figurë të perëndisë me mjekërr,¹ i cili është kreacioni origjinal i artit romak dhe haset në vendet ku kanë depërtuar legjionet romake.² Në krahasim me statuetat e trevave të tjera, megjithëse në një paraqitje të ngjashme ikonografike me statuetën tonë, Marsi është paraqitur edhe në statuetën nga Siscia (*Siscia*, Sisaku) në provincën e Panonisë,³ prapë, ngjashmërinë më të madhe e hasim në statuetat e Marsit nga Ber Isseli i sotëm në Austri.⁴ Prandaj ndoshta vendin e punimit më parë duhet kërkuar jashta Kosovës, ku ka ardhur përmes importit për nevoja të legjionarëve.

Në tërë Dardaninë paraqitja ikonografike e kësaj perëndie haset vetëm në këto dy lokalitete.

Për dallim të statuetave të perëndive, nga statuetat animale në bronz, deri më tash, disponojmë vetëm figurinën e **elefantit** (*elephantus*) të gjetur në Rahovec. Me një lartësi 18 cm., së bashku me bazamentin drejtë këndor në trajtë pllake dhe pjesën për fiksion të gjatësisë 14,3 cm., është e ruajtur mirë (fig. 12).⁵ E gjithë sipërfaqja e trupit të elefantit është e dekoruar me vija të gravuara të pjerrta drejtimesh të kundërta, duke formuar katrorë të vegjël të mbushur me rathë të vegjël në trajtë parzmoreje, që ka efekt mjaft dekorativ. Ai është paraqitur me të gjitha detajet në një ecje të ngadalshme me këmbën e djathtë të shtyrë përpara dhe surlën e ngritur lart, në rrënjën e së cilës duket goja me të dy dhëmbët. Sytë me kapakun e tretë të theksuar, veshët e mëdhenj në harmoni me ecjen dhe bishti i shkurtër e kompletojnë figurinën, e cila duket mjaft natyrale. Në tërësi paraqet një realizim mjaft të bukur me proporcione precize, prandaj me siguri ka të bëjë me import, kohësisht aty nga fundi i shek. I dhe fillimi i shek. II, për t'u përdorur si objekt zbukurues.

Statuetat e elefantit hasen rrallë edhe në provincat e tjera të Perandorisë, ku deri tash nuk kemi mundur të gjejmë asnjë analogji me këtë ekzemplar.⁶ Ndërkaq, figura e elefantit është e pranishme që herët, si

¹ DRČA, S. (1992): ff. 20-21, n. 4.

² Khr. RIDER, A. (1913): nn. 484, 667, 1043.

³ TADIN, Lj. (1979): f. 15, n. 21, T. 13, fig. 20.

⁴ FLEISCHER, R. (1967), ff. 53-54, nn. 42-44.

⁵ Rrethanat e gjetjes nuk janë të njohura. Gjendej në Muzeun e Kosovs me nr. inv. 972, ndërsa nga viti 1998 gjendet në Beograd, khr. ČERŠKOV, E. (1969): f. 72, fig. 27; ARHEOLOŠKO BLAGO (1998): f. 647, fig. 304. Interpretimin DOBRUNA-SALIHU, E. (2010): f. 158, fig. 7.

⁶ Khr. REINACH S. (1897a.): f. 766, n. 1, 22I; i njëjti (1904): f. 223, n. 1; i njëjti (1910): f. 527, nn. 4, 5, ku statueta e fundit me surlë të thyer po ashtu është e zbukuruar me

në mozaikë, siç është rasti me mozaikët e Ostisë (*Ostia*, afër Ostisë së sotme) në Itali nga shekulli I, ashtu edhe në relief, siç e hasim në frizin e pallatit të Hadrianit nga dekadat e para të shekulli II në Efes (*Ephesus*, te Selçuku), ku gjendet i shoqëruar nga Dionisi.¹

II. Realizimet e funksionit dekorativ-simbolik - përbëjnë dy aplika.

Njëra aplikë është në trajtë busti të perëndisë **Merkur** (*Mercurius*). Ajo u gjet në fshatin Studençan të Therandës. Busti i gjatësisë 15 cm., vende-vende me patinë të gjelbërt, pos thyerjes së krahut dhe flatrës së anës së majtë, si dhe një të çareje të po kësaj ane rreth qafës, është i ruajtur mirë (fig. 13a, b).² Figura e perëndisë nudo me vija fëmijërore të fytyrës është modeluar me të gjitha detajet e paraqitura mirë, të cilat shumë qartë e theksojnë moshën e saj. Në kokën me flatra të vogla, të këthyer lehtë në të djathë, të gjitha tiparet në fytyrën ovale me faqe të plota dhe ballë të lartë janë trajtuar në mënyrë korrekte. Sytë e mëdhenj, me kapakë dhe bebëze të thelluar, janë mjaft të theksuar dhe mbi të kurorëzuar me vetulla. Hunda e gjerë, buzët e trasha e të hapura lehtë dhe mjekrra me një gropëz rinore-djaloshare në mes. Flokët kaçurrel, të ndarë në mes, bijnë në të dy anët mbi veshë deri në zverk. Të krehur në krela të rregullta, të cilat përpara, rreth fytyrës, përbëhen nga tre gjysmërrathë, ndërsa anash dhe prapa prej rrrathëve të plotë duket mjaft e stilizuar dhe e gjeometrizuar. Edhe sipërfaqja e flatrave të vogla, që dalin në tepe të kresë, po ashtu është e dekoruar me gjysmërrathë të gravuruar, të cilët, të renditur në trajtë të luspave të boçës së pishës, pa dyshim paraqesin puplat. Ky dekor gjendet edhe në hallkën gjysmërrathore në fund të bustit me gjoks të fryrë diskret, e cila sipas të gjitha gjasave ka qenë e natyrës dekorative. Kurse hallka tjetër, e zakonshme, në zverk ka pasur funksion praktik, meqë në të kapej grremçi, i cili nuk është ruajtur.

Në pjesët tjera të Dardanisë deri më tash nuk është gjetur asnjë aplikë e kësaj perëndie, prandaj ky ekzemplar paraqet një unikat në këtë trevë. Kurse nga trevat provincat tjera janë të njohur rreth 30 bust-aplika në cilësi të peshës po ashtu në figurë fëmije apo djaloshi.³ Në mesin e tyre

motivin e parzmores.

¹ Observim.

² Është gjetur në vitin 2001 në pronën private të B. Kabashit me rastin e hapjes së një kanali, prej nga u bart në Muzeun Arkeologjik të Prizrenit. Tash e humbur. (2008): f 9 e tutje, fig. 2 a, b; e njëjta (2010): ff. 158-159, fig. 8.

³ PICARD, G. Ch. (1992): f., 517.

kemi hasur edhe në ngjashmëri me dallime të vogla, siç është rasti me ekzemplarën nga Siscia, me dallim të hallkës, e cila gjendet në tepe të kresë dhe mungesës së hallkës së poshtme.¹ Në rastet e tjera në më të shumtën e herave mban petasin me hallkën në mes të flatrave. Një bust-aplikë e tillë në figurë fëmije gjendet në Muzeun Kombëtar të Naplit dhe një tjetër në Pallatin Konservator të Romës, ku është ruajtur së bashku me kantar.² Kurse te një ekzemplar, i cili gjendet në Muzeun Wolhaus në Enns të Austrisë, janë të pranishme dy elemente të ngjashme me ekzemplarën tonë: krehja e flokëve në tufa të rregullta krelash spiraloide me hallkë në tepe, por që i takojnë një stili tjetër punues, dhe hallkën tjetër në mes të skajit të poshtëm të bustit, e cila ka shërbyer për përforcim (fig. 13),³ me çka largohet nga funksioni i peshës.

Në bazë të krahasimit me ekzemplarët e tjerë, sidomos të hallkës në fund të bustit, kjo aplikë gjithsesi më parë duhet të ketë pasur funksion dekorativ-simbolik në ndonjë qerreje transportuese ose në shtëpi të ndonjë tregtari sesa funksion praktik në cilësi të peshës në kandar. Mirëpo në të dy funksionet është në pajtim me natyrën e Mërkurit – Hermesit si perëndi i tregtisë që ishte, i cili merret edhe si zbulues i masave për gjatësi dhe peshë.⁴ Pa marrë parasysh funksionin, si dhe përkundër stilizimit të disa detajeve, kjo bust-aplikë paraqet punë të mirë, më parë të një punëtorie lokale (të Ulpianës). Por vështirë është të thuhet përkatësia kohore e saktë e saj, meqë gjeometrizimi i krelave (tufave) nuk thotë shumë, por sipas gjatësisë së flokëve mund t'i ketë takuar fillimit të shek. III.⁵

Aplika tjetër është në trajtë të një **koke gruaje** të gjetur në Ulpianë (fig. 14).⁶ Është e ruajtur mirë, pos dëmtimeve në tepe, ku gjenden mbetjet e diçkaje deri tash të panjohura, të cilën e mbante në majë të kokës (diadem?), që e vështirëson identifikimin e saj. Punimi është solid, i realizuar me gravurim të të gjitha detajeve në fytyrën rumbullake. Sytë, përkundër stilizimit, gadi me trajtë rumbullake, janë modeluar me kapakët e sipërm,

¹ BRUNŠMID, J. (1914): f. 222, n. 33.

² PICARD, G. Ch., po aty, nn. 210, 212.

³ Po aty, f. 542, n. 430.

⁴ SREJOVIĆ, D. – CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1987): f. 475.

⁵ Gjatësi të ngjashme të flokëve me përdredha të renditura në formë të rregullt gjejmë edhe në aplikën e bustit të të riut nga Tërmeta afër Zagrebit, khr. TADIN, Lj. (1979): f. 40, n. 113, fig. 108.

⁶ Rrethanat e gjetjes nuk janë të njohura, khr. ČERŠKOV, E. (1969): fig. 23. Interpretimin DOBRUNA-SALIHU E. (2010): f. 159, fig. 9.

bebëz dhe iris të thelluar, si dhe mbi ta janë theksuar harqet e vetullave, të cilat bashkohen me hundën diçka më të gjatë, ndërsa vetëm goja gjysmë e hapur është e dëmtuar. Flokët, e ndarë në mes në krela të rregullta dhe mjaft të shpeshta, po ashtu të punuara me gravurim, duke mbuluar veshët, bien në të dy anët e fytyrës, për t'u lidhur një në zverk. Kjo krehje i përgjigjet njëres prej variantave të frizurës të cilën e kanë mbajtur perandorëshat e gjysmës së dytë të shekullit II¹ në bazë të së cilës aplika duhet t'i ketë takuar fundit të shek. II apo fillimit të shek. III dhe me siguri, po ashtu, paraqet prodhim të punëtorisë lokale.

Përfundim

Në fund mund të themi se këta ekzemplarë të skulpturës së imtë në bronz, të cilët i kanë analogjitë edhe në pjesët tjera të Perandorisë, në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me modelet greke dhe helenistike dhe gati gjysma e tyre posedojnë kualitete të larta artistike (statuetat e Apolonit, Venerës, grupit statuar të Mërkurit dhe elefantit) të punuara në qendrat e njohura të zanatit, pos grupit statuar të Mërkurit, i cili ka gjasë t'i ketë takuar prodhimin zejtar të punëtorisë së Ulpianës. Kurse pjesa tjetër (statuetat e Minervës Mërkurit, Marsit dhe dy aplikat) paraqesin punë të zakonshme provinciale, të cilat, pos figurinës së Marsit, i takojnë prodhimin lokal.

Këto realizime skulpturore tregojnë se kërkesa për këtë lloj skulpture, e cila në fakt ka të bëjë me punime artistike – të importuara ose të prodhimin lokal – në pjesën qendrore të Dardanisë (Kosovën e sotme) ka zënë vend me rëndësi, që është rezultat i nivelit të lartë kulturor të qendrave antike të kësaj treve. Me siguri hulumtimet e mëtejme arkeologjike të Ulpianës dhe të krejt kësaj pjese të Dardanisë do të kontribuojnë në gjetjen e numrit më të madh të ekzemplarëve të kësaj krijimtarie artistike të skulpturës së imtë në bronz.

SHKURTESAT

- AJA American Journal of Archaeology, Princeton, N.J.
 DarSag Ch. DAREMBERG – E. SAGLIO, Dictionnaire des Antiquités Grecques et Romaines, Paris
 GMKM Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, Prishtina 1 (1956)-9 (1969); Glasnik Muzeja Kosova, Prishtina 10 (1970-)

¹ Khr. FITTSCHEN, K. (1982): (Faustina e Re me të bijën, Lucilën, dhe nusen, Krispinën).

Kosova	Kosova, Prishtinë
LIMC	Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae
Spomenik SKA, SANU Spomenik Srpske (kraljevske) akademije nauka i umetnosti,	Beograd
Starinar	Starinar, Bograd
VHAD	Vjesnik Hrvatskog arheološkog društva, n.s. Zagreb
VrGl	Vranjski glasnik, Vranje
ZborNMN	Zbornik Narodnog muzeja u Nišu, Niš

Literatura

- ALICU, Dorin – POP, Constantin – WOLLMANN, Volker (1979): **Figured Monuments from Ulpia Traiana Sarmizegetusa**, BAR International Series 55, Oxford.
- ARHEOLOŠKO BLAGO (1998): **Arheološko blago Kosova i Metohije od neolita do sredneg veka**. Katalog izložbe, Srpska akademija nauka i umetnosti i Muzej u Prištini, Beograd.
- BIEBER, Margarete (1955): **The Sculpture of the Hellenistic Age**, Columbia University Press, New York.
- BIEBER, Margarete (1977): **Ancient Copies. Contributions of the History of Greek and Roman Art**, University Press, New York.
- BRUNŠMID, Josip (1914): *Antikni figuralni bronsani predmeti u hrvatskom Narodnom muzeju u Zagrebu*, **VHAD 13**, 1913-14, 207-268.
- ČERŠKOV, Emil (1969): **Rimljani na Kosovu i Metohiji**, Arheološko društvo Jugoslavije, Beograd.
- DINSMOOR, William Bell (1921): *Attic building accounts. IV. The statue of Athena Promachos*, **AJA 25/2**, 118-129.
- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (1995): *Disa monumente plastike të kohës romake në rajonin e Llapit*, **Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit**, Sesion Shkencor (Prishtinë 16.-17. nëntor 1993.), Prishtinë, 77-85.
- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (2003-2005): **Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake 1-2**, Instituti Albanologjik, Prishtinë
- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (2008): *Dy monumente të perëndive të vreshtarisë dhe tregtisë të zbuluara rishtas në Kosovë*, **Kosova 29-30, 2007-2008**, 9-19.
- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (2010): *Predmeti umjetničkog obrta tijekom rimskog doba u središnjem dijelu Dardanije (današnjeg Kosova)*, **Umjetnički obrt od prapovijesti do ranog srednjeg vijeka** (Medjunarodno arheološko savjetovanje, Pula, 25-28 Novembre 2009), **Histria Antiqua 18**, Pula, 153-166.

- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (2012): *Sculpture of foreign marble in the central part of Dardania (present day Kosova) during Antiquity*, **Interdisciplinary Studies on Ancient Stone, IX ASMOSIA International Conference** (Tarragona, 8-13 June 2009), Tarragona, 82-88.
- DRČA, Slobodan (1991): *Sitna rimska bronzana plastika u Narodnom muzeju u Nišu*, **ZborNMN 6-7**, 19-42.
- DURRBACH, Félix (1905): **DarSag IV**, s.v. *Mars*, 1607-1623.
- FITTSCHEN, Klaus (1982): **Die Bildnistypen der Faustina Minor und die Fecunditas Augustae**, Abhandlungen der Akademie der Wissenschaften in Göttingen, Philologisch-historische Klasse, Göttingen.
- FLEISCHER, Robert (1967): **Die römischen Bronzen aus Österreich**, Römische Germanische Zentralmuseum zu Mainz am Rhein, Verlag P. von Zabern, Mainz am Rhein.
- GIRARDI-JURKIĆ, Vesna (2005): **Duhovna kultura antičke Istre. I. Kultovi u procesu romanizacije antičke Istre**, Školska knjiga, Zagreb.
- JOVANOVIĆ, Aleksandar (1975): *Neki aspekti problema skupnog nalaza skulpture sa Medijane kod Niša*, **Starinar 24-25, 1973-74**, 57-65.
- KORAČEVIĆ, Dušanka (2002): **Skupi. Gradska teritorija**, Muzej na grad Skopje, **Skopje**.
- KRAUSKOPF, Ingrid (1984): **LIMC 2**, s.v. *Apollon*, Zürich-München, 183-363.
- LEBEL, Paul (1962): **Catalogue des collections archéologiques de Montbéliar 3. Les bronzes figurés**, Les Belles lettres, Paris 1962.
- LIPOLD, Georg (1950): **Die Griechische Plastik**, Handbuch der Archäologie, München.
- NEUGEBAUER, Karl Anton (1921): **Antike Bronzestatuetten**, Schoetz & Parrhysius, Berlin.
- NIKOLIĆ, Danica (1957): *Bronzana statueta sa Ulpijane*, **GMKM 2**, 265-272.
- PICARD, Charles (1948): **Manuel d'archéologie grecque, sculpture 3/2**, Paris.
- PICARD, Gilbert Charles (1997): **LIMC 8**, s.v. *Venus*, Zurich-Dusseldorf, 192-233.
- POPOVIĆ, Ljubiša (1969): **Antička bronza u Jugoslaviji**. Katalog izložbe, Narodni Muzej, Beograd.
- REINACH, Salomon (1897, 1897a, 1904, 1910): **Repertoire de la statuaire grecque et romaine, 1-5**, Paris, 1/1897, 2/1897a, 3/1904, 4/1910, 5/1924.
- RICHTER, Gisela Marie Augusta (1950): **The Sculpture and Sculptors of the Greeks**, Yale University Press, New Haven.
- RIDDER, André de (1913-1915): **Les bronzes antiques du Louvre 1-2**, Musée du Louvre, Paris.
- SIEBERT, Gérard (1990): **LIMC 5**, s.v. *Hermes*, Zürich-München, 285-387.

- SIMON, Erika – BAUCHENSS, Gerhard (1992): **LIMC 6**, s.v. *Mercurius*, Zürich-München, 500-554.
- SREJOVIĆ, Dragoslav – CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, Aleksandrina (1987): Rečnik grčke i rimske mitologije, Beograd.
- SREJOVIĆ, Dragoslav – CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, Aleksandrina (1987a): **Rimska skulptura u Srbiji**. Katalog izložbe, Beograd.
- TADIN, Ljiljana (1979): **Sitna rimska bronzana plastika u Jugoistočnom delu provincije Panonije**, Fontes archaeologiae Iugoslaviae, Beograd.
- VUKANOVIĆ, Tatomir, P. (1973): Bronze figurine representing the he-goat from Teranda (Prizren) og Hellenistic-Illyrian epoch, **VrGI 9**, 1-43.
- VELIČKOVIĆ, Milivoje (1972): **Rimska sitna bronzana plastika u Narodnom muzeju**, Narodni muzej, Beograd.
- VULIĆ, Nikola (1931): *Antički spomenici naše zemlje*, **Spomenik SKA 77 /55**.
- VULIĆ, Nikola (1941-48): *Antički spomenici naše zemlje*, **Spomenik SANU 98 /77**.
- ZOTOVIĆ-ŽUNKOVIĆ, Ljubica (1959): *Tri bronzane statuete iz Negotinskog muzeja*, **Starinar 9-10, 1958-59**, 211-214.

Exhlale DOBRUNA-SALIHU, Prishtinë

SMALL BRONZE SCULPTURE IN CENTRAL PART OF DARDANIA (ACTUAL KOSOVA) DURING THE ROMAN TIME

Summary

There was an early interest in small bronze sculpture in the central part of Dardania. Two statuettes of Hellenic import from the 6th century, found in Prizren, are of special importance: the renowned figurine of the runner which is kept in British Museum and beautiful figurine of a he-goat which is kept in the Vranja Museum. There were many such artistic creations in the Roman time respectively from the end of 1st century until the end of 3rd century and these creations were discovered mainly in the area of Ulpiana - a municipium (municipality) with an unknown name on the upper flow of Drini i Bardhë River and a civitas (Peja and Theranda) - and less in the area of other areas. This work includes a presentation of sculptural works of this kind in this part of Dardania during this period of time. These works, based on their function, are divided into two groups: religious-ornamental and ornamental-symbolical.

I. Figures of ornamental-religious function - almost all objects belong to Gods' statuettes - Roman pantheon - and they outnumber all other artistic creations of small bronze sculpture. But they are rarely of animal nature such as the figurine of the elephant.

II. Figures with ornamental-symbolical function-include two appliqués, one of them in the shape of Mercury torso and the other one in the shape of woman's head.

These pieces, analogous with other parts of the Empire, mainly have to do with Greek and Hellenic models and almost half of them have high artistic qualities (the statuettes of the statues' group of Mercury, Apollo, Venus, and elephant), made in the prominent centers, except the group of statues of Mercury which it is likely to belong to the production craft of Ulpiana. Others (statuettes of Minerva, Mercury, Mars and two appliqués) present a common provincial work, which, except for the figurine of Mars, belong to local production.

These sculptural creations show that this kind of sculpture - which in fact has to do with artistic works, imported or local products- in the central part of Dardania - were considered to be of high importance, as a result of high cultural level of the ancient localities of the area. Further archeological researches in Ulpiana and all this part of Dardania, most certainly result in a bigger number of objects of the same sculptural oeuvre.



fig. 1 a,b



fig. 2



fig.3



fig. 4



fig. 5



fig. 6



fig. 7



fig. 8



g. 9a, b




fig. 10



fig. 11



fig. 12



fig. 13a, b



fig. 14

Shpresë SIQECA, Prizren

VESHJET KOMBËTARE TË KOSOVËS NË FUND TË SHEKULLIT XIX DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX

KDU 391 (496.51)"19"

Abstrakt

Në punimin “Veshjet kombëtare të Kosovës në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX” janë marrë në shqyrtim disa nga veshjet më karakteristike të burrave dhe grave të Kosovës, të grupmohave të ndryshme. Në të kaluarën në Kosovë kanë dominuar veshjet e burrave të tipit me tirq dhe të grave të tipit me këmishë dhe një ose dy përparëse.

Veshjet kombëtare të burrave i takojnë tipit të veshjes me tirq dhe tipit të veshjes me shallvarë. Veshjet e burrave të tipit me shallvare janë përdorë kryesisht në qytete. Ato janë zhdukë nga përdorimi në fillim të shekullit XX.

Veshjet kombëtare të grave i takojnë tipit të veshjes me këmishë dhe një ose dy përparëse dhe tipit të veshjes me dimi. Veshjet e grave të tipit me këmishë dhe një përparëse përdoren në rajonin e Llapit dhe të Moravës etj. Veshjet e grave të tipit me këmishë dhe dy përparëse përdoren në rajonin e Hasit të Prizrenit, Rrafshit të Dukgjinit, Rugovës, Drenicës etj. Veshjet e grave të tipit me dimi përdoren kryesisht në qytete si dhe në rajonin e Opojës, Gorës, Anadrinit, Podgurit të Prizrenit, Zhupës, Therandës, Jabllanicës, Llapit e Gollakut etj.

Fjalët çelësa: veshjet kombëtare, aksesorët, stolitë, tirqit, këmisha, përparëset, qytetet, rajonet, etj.

I. VESHJET E BURRAVE

Veshjet e burrave të tipit me tirq kanë disa varianta sipas rajoneve ku përdoren: 1. Veshjet e burrave të rajonit të Hasit të Prizrenit, Opojës, Rrafshit të Dukagjinit, Rugovës, Shalës së Bajgorës, Drenicës, Karadakut të Gjilanit etj.

1. VESHJET E BURRAVE TË RAJONIT TË HASIT TË PRIZRENIT

Burrat e rajonit të Hasit të Prizrenit veshin tirq të qepur prej zhguni të bardhë /Fig. 1 dhe 2/. Brekët janë prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek. Zbukurohen me gajtanë të zinj rreth qepjeve, shkekave e këmbëzave. Këmisha është prej pëlhure të bardhë pambuku e endur në vek. Është e gjatë gjer nën brez. Ka mëngë të gjata që mblidhen në kapakë. Rreth hapjes së kraharorit dhe mëngëve është e punuar me gjilpërë dantella “rretë”. Shalli dhe shoka janë të endura prej leshi. Shoka është e endur me vija shumëngjyreshe. Mbi këmishë vishet xhamadani i cohës me kapakë të dhëmbëzuar. Mbathin çorapë dhe meste të thurura prej leshi me ngjyrë të zezë, me zbukurime të imëta me motive gjeometrike. Mbathin opinga lëkure. Në kokë vënë plisin në formë të rumbullakët rreth të cilit e mbështjellin shaminë.¹

Në të kaluarën, burrat e rajonit të Hasit të Prizrenit përdornin qostekë me orë, unaza të mëdha dhe çibukë.²



Fig. 1 dhe 2, Veshjet e burrave të rajoni të Hasit të Prizrenit

¹ Shih më gjerësisht, SIQECA Shpresa /2004/: Trashëgimia etnologjike e Hasit të Prizrenit, Monumentet e Kosovës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Prishtinë, ff. 157-178.

² SIQECA Shpresë /2002/: Argjendaria prizrenase ndërmjet artit dhe kultit, perlat e etnisë shqiptare në Prizren, Shtëpia botuese “Gjeçovi”, “Dukagjini”, Pejë, f. 061.

2. VESHJET E BURRAVE TË RAJONIT TË OPOJËS

Burrat e rajonit të Opojës /komuna e Sharrit/ veshin tirqit të qepur prej zhguni me ngjyrë të bardhë ose ngjyrë kafeje /Fig. 3 dhe 4/. Ato janë të gjerë, sidomos te këmbëzat. Gajtanët janë të punuar në formë të drejtë ose të valëzuar. Brekët dhe këmisha janë të qepura prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek. Këmisha ka mëngë të gjata, që mblidhen në kapakë. Rrethi i jakës, grykës dhe i mëngëve ka dantella të gjera, të punuara me gjilpërë “zyrefe“. Shoka është e endur prej leshti ngjyrë krem, me katrorë ngjyrë kafeje. Mbi këmishë vishet xhamadani i bardhë i qepur prej zhguni ose pëlhure. Mbi xhamadan vishet lurka “koporani” prej zhguni të bardhë ose të zi. Është e gjatë gjer nën brez. Ka mëngë të shkurtra gjer në bërryla dhe kapolen të quajtur “cuc”. Në dimër vishet gëzofi e mbi të fere-xheja e cila qepet prej zhguni. Ajo është e gjatë deri në fund të këmbëve. Ka mëngë të gjata deri mbi llërë dhe kapole¹. Mbathin çorapë leshti, me ornamente florale e gjeometrike. Ata mbathin opinga prej lëkure me toja “norta” prej leshti. Burrat në kokë vënë zakonisht plisin e rrumbullakët.² Qostekët me orë të punuara në Prizren përdorëshin rrallë dhe vetëm te shtresat e pasura fshatare të rajonit të Opojës, të Hasit të Prizrenit, të Therandës me rrethe etj.³



Fig. 3 dhe 4, Veshjet e burrave të rajonit të Opojës

¹ Kumtim gojor i Rrefik Llutviut, 84 vj. Bresanë.

² Shih: SIQECA S. /2008/: Veshjet kombëtare dhe tekstilet e rajonit të Opojës në Komplexin Monumental të Lidhjesë Shqiptare të Prizrenit, “Studime” 15, ff. 282-283.

³ SIQECA S., Argjendaria prizrenase ndërmjet artit dhe kultit, perlat e etnisë shqiptare në Prizren, f. 061.

3. VESHJET E BURRAVE TË RAJONIT TË RRAFSHIT TË DUKAGJINIT

Burrat e rajonit të Rrafshit të Dukagjinit veshin tirq dhe kallçinj të qepur prej zhguni të bardhë, të zbukuruar më gajtanë të zinj /Fig. 5/. Brekët janë të qepura prej pambuku, endur në vek dhe kanë këmbëza të “kokrrueme“. Këmisha është e qepur prej pëlhure të bardhë pambuku, me vija me ngjyrë kafeje të çelët. Ajo ka mëngë të gjata, të mbledhura në kapakë. Rreth grykës ka një rrip të bardhë të qëndisur. Shalli i brezit është i endur prej pambuku të bardhë, me vija me gjerësi të ndryshme dhe ka thekë të bardha në të dy anët /Fig. 6/. Shoka është e endur prej lesi me vija shumëngjyrëshe Mbi këmishë vishet mitani dhe hërka. Mitani është i qepur prej pëlhure të zezë. Ai është i gjatë gjer në brez dhe ka mëngë të gjata e të ngushta, të prera në fund. Rreth jakës, në dy kapakë dhe në fund të mëngëve është i zbukuruar me gajtanë ngjyrë vishneje të mbyllët. Hërka është e qepur prej lesi me ngjyrë të bardhë dhe e zbukuruar me gajtanë të zinj. Dimrit vishet edhe çyrku, gëzofi dhe japonxha.

Burrat mbathin çorapë dhe meste lesi, të zbukuruara me motive florale dhe opinga lëkure. Ata në kokë vënë plisin e rrumbullakët.



Fig. 5 dhe 6, Veshjet e burrave të rajonit të Rrafshit të Dukagjinit

4. VESHJET E BURRAVE TË RAJONIT TË RUGOVËS

Burrat e rajonit të Rugovës /rrethi i Pejës/ veshin tirq të qepur prej zhguni të bardhë, të zbukuruar zakonisht me tetë fije gajtani të zi. Brekët

janë të qepura prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek. Këmbëzat janë të qëndisura dhe të punuara me dantellë. Këmisha është e qepur prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek. Rreth hapjes së kraharorit është e qëndisur me gjilpërë, me motive florale. Shalli i brezit dhe shoka janë të endura në vek prej leshi. Shalli ka zbukurime gjeometrike, ndërkaq shoka është me vija shumëngjyrëshe. Mbi këmishë vishet xhamadani e mitani prej zhguni të bardhë /Fig. 7/. Ka dy kapakë që mbërthehen njëri mbi tjetrin dhe kanë skaje të dhëmbëzuar. Zbukurohet me fije gajtani të zi. Dimrit burrat veshin japonxhën të qepur prej zhguni të bardhë me formë të gjysmërrethit, është pa mëngë, ka kapole dhe pak dekorime me gajtanë të zi. Mbathin çorapë leshi, meste dhe opinga. Në kokë vënë plisin e rrumbullakët rreth të cilit e mbështjellin shallin e gjatë prej pambuku të bardhë.¹

Prej stolive vënë qostekë për orë të punuar me teknikën e granulimit dhe të zbukuruar me gurë ngjyrash e madhësish të ndryshme.² /Fig. 8/



Fig. 7 dhe 8, Mitani dhe qosteku për orë i burrave të rajonit të Rugovës

5. VESHJET E BURRAVE TË RAJONIT TË SHALËS SË BAJGORËS

Burrat e rajonit të Shalës së Bajgorës veshin tirq të bardhë, të zi ose ngjyrë kafeje. Tirqit zbukurohen me gajtanë të zinj. Këmisha është e qepur prej pëlhure të bardhë, endur në vek. Brezi është prej leshi me vija shumëngjyrëshe. Mbi këmishë vishet xhamadani dhe mitani. Burrat mbathin çorapë leshi dhe opinga me përkryesa. Ata në kokë vënë plisin e rrumbu-

¹ SIQECA, S.: Veshjet kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, f. 20.

² SIQECA S.: Koleksioni i armëve dhe i stolive në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, "Studime", nr. 12, Prishtinë, f. 199.

llakët, ndërsa përreth tij e lidhin marhamën.¹ Veshjet e burrave të rajonit të Shalës së Bajgorës ruhen në Muzeun e Mitrovicës, koleksione private etj.

6. VESHJET E BURRAVE TË RAJONIT TË DRENICËS

Burrat e rajonit të Drenicës veshin tirq të qepur prej zhguni të bardhë ose të zinj, të “galmë”. Tirqit e përditshëm zakonisht zbukurohen me tri deri pesë fije gajtani të zi, ndërsa tirqit e bajraktarëve me 10-12 fije.² Dimrit veshin kallçinj të zbukuruar me dy fije gajtani të zi. Këmisha është e qepur prej pëlhure të bardhë pambuku e endur në vek. Është e gjatë gjer nën brez. Ka mëngë të gjata e të mbledhura në kapakë. Në brez vënë shallin prej pambuku. Mbi shall vënë shokën prej leshi, endur në vek në dy liq. Shoka është me shumë ngjyra, me vija për së gjati. Mbi këmishë vishet xhamadani prej pëlhure “allaxhe” ose “fermene” prej cohe me ngjyrë të kuqe të mbyllët. Mitani është prej pëlhure “allaxhe”. Hërka qepet prej zhguni. Mëngët i ka të gjata gjer në bërryla. Ka kapole. Është e zbukuruar me pak gajtanë. Dimrit veshin japanxhën dhe çyrkun. Mbathin çorapë leshi dhe opinga “gogishte” me dredhë leshi. Në kokë vënë plisin e rumbullakët, rreth të cilit lidhin marhamë të bardhë. Armët dhe stolitë ishin pjesë të pandashme të veshjes së burrit drenicak. Në krah mbante pushkën e gjatë, ndërsa në brez koburen. Prej stolive përdorte qystack me orë, unaza etj.³

7. VESHJET E BURRAVE TË KARADAKUT TË GJILANIT

Burrat e rajonit të Karadakut të Gjilanit veshin tirq të qepur prej zhguni të zi ose ngjyrë kafë, të zbukuruar me gajtanë të zinj. Këmisha është prej pëlhure të bardhë pambuku e endur në vek. Ka mëngë të gjata e të gjera, që mblidhen në kapakë. Shoka “lahurike” është e endur prej leshi, me vija shumëngjyrëshe. Mbi këmishë vishet xhamadani prej zhguni të zi ose ngjyrë kafë. Mbathin çorapë leshi të zbukuruara me ngjyra. Opingat janë prej lëkure, të mbledhura pak në majë. Rrudhat e opingave i quajnë “vangje”. Në kokë burrat vënë plis të rumbullakët. Prej stolive mbajnë qostekë me orë etj.⁴

¹ SIQECA, S.: Veshjet kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, f. 21-22.

² Shih SIQECA S., Variacione të veshjes së meshkujve të Drenicës, “Bujku”, Prishtinë.

³ Aty.

⁴ SIQECA, S., Veshjet kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, f. 21.

8. VESHJET E BURRAVE TË PRIZREN

Burrat e Prizrenit veshin shallvare të qepur prej cohe të kuqe ose të kuqe të mbyllët /Fig. 9 dhe 10/. Këmisha është e qepur prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek. Shoka punohet prej mëndafshi apo pambuku.



Fig. 9 dhe 10, Veshjet dhe stolitë e burrave të Prizren

Mbi këmishë vishet mitani prej pambuku. Rreth jakës, mëngëve dhe bërrylave mitani zbukurohet me gajtanë të zinj. Mbi mitan vishet xhamadani prej kadifeje ose prej cohe. Xhamadani zbukurohet me fije ari ose gajtani me motive florale, me vija paralele e rrathe spiraloidë që kanë të bëjnë me kultin e diellit. Mbi xhamadan vishet dollama e kadifeenjtë ose e cohës. Mbathin çorapë të bardha dhe këpucë. Prej stolive përdorin qostekë argjendi për orë, zinxhirë kraharori, unaza, çibukë, kuti duhani të punuara me teknikën e filigranit etj.

II. VESHJET E GRAVE

1. VESHJET E GRAVE TË RAJONIT TË HASIT TË PRIZRENIT

Gratë e besimit mysliman të Hasit të Prizrenit veshin këmishë prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek /Fig. 11/, të gjatë gjer në brez. Veshin “fustan” prej pëlhure të bardhë pambuku. Fustani është me rrudha. Përparësja “kanac-i i parë” është e bardhë në mes, ndërsa në dy skaje ka ornamente të njëjta gjeometrike e florale. Ka formën e katërkëndëshit këndrejtë. Pështjellaku i pasmë “i mramë” është me vija të trasha vertikale ngjyrash të ndryshme. Ka formën e katërkëndëshit këndrejt. Në kërdhokla vënë “kollanin” prej një cope dërrase, e cila mbushet me lecka dhe mbështillet

me pëlhurë. Mbi kollan vënë brezin prej leshti të kuq. Mbi këmishë vishet xhamadani prej pëlhure. Mbathin çorapë leshti, shputa e opinga. Në kokë vënë shami dhe marhama, të endur në vek me dy skaje “sylykë” të qëndisura me motive florale e gjeometrike. Prej stolive përdorin gjerdanin “gjyksoren” me një, dy ose tri rende monedhash të argjendta, vathë etj.¹

Gratë e besimit fetar katolik të rajonit të Hasit të Prizrenit veshin këmishë të qepur prej pëlhure pambukut, endur në vek /fig. 12/, të qëndisur me motive florale e zoomorfe të zogjve, që i quajnë “me zog”, “me dallëndyshe” etj. Përparësja “kanac-i i parë” endet prej leshti në sfond me ngjyrë të kuqe. Në mes ka vija paralele, ndërsa në dy skaje zbukurime në formë të iksave dhe të rombeve të dhëmbëzuar. Pështjellaku i pasmë “kanac-i i dytë” endet prej pambuku me ngjyrë të kuqe dhe me vija paralele të kaltra. Në brez vënë “kollanin” prej leckave të vjetra, të mbështjella me një pëlhurë leshti të kuq. Mbi kollan vënë brezin prej leshti të kuq. Mbi këmishë veshin xhamadan prej zhguni “guja”, me zbukurime në formë të rrumbullakët “rrotulla”, të gjysmërrethit “bajrak me rrotulla”, në formë të rombeve “me topa” ose “me rrahtë”, të trekëndëshit, të kryqit të stilizuar e të gjysmëspirales. Mbathin çorapë dhe shputa leshti si dhe opinga prej lëkure.

Gratë mbajnë vathë në formë të gjysmëhënës, përfundi të cilëve kapet nga një monedhë. Vathët punohen me filigran e granulim dhe zbukurohen me gurë. Përdorin gjerdanin “rende gjyks” të përbërë nga rende monedhash, me një monedhë të madhe në mes etj.



Fig. 11 e 12, Veshjet e grave të besimit mysliman dhe katolik, të rajonit të Hasit të Prizrenit

¹ SIQECA Shpresë /2006/: Koleksioni i armëve dhe i stolive në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit /Katalog i ekspozitës/, Prizren, f. 9.

2. VESHJET E GRAVE TË RAJONIT TË OPOJËS

Gratë e rajonit të Opojës /komuna e Sharrit/ veshin këmishë të bardhë prej pambuku të tiores, të endur në vek /Fig. 13/. Rreth jakës, grykës dhe në fund të mëngëve, zbukurohet me dantellën "zyrefe" të punuar me gjilpërë dhe të zbukuruar me rruaza me ngjyrë të njejtë si zyrefet. Gratë veshin kryesisht dimi prej pambuku me ngjyrë të bardhë ose me lule. Përparëset "bofçet" enden prej pambuku, leshi të përzier me pambuk dhe leshi të dhive /Fig.14/. Ato enden me dy fletë pëlhure. Janë të shkurtë dhe të gjerë. Në përparëse paraqiten ornamentet florale /lulet/ në forma natyrore, ornamentet gjeometrike, ornamentet "lul sexhadi", "bofçe me bajrak", ornamentet në formë të misrit me fleta "lul kollomoqi".¹ etj. Çorapët thurren prej leshi të dhëve me pesë kërrabëza gjypnerë. Ato janë të bardha, ndërsa në maje zbukurohen me motive florale, gjeometrike e zoomorfe. Gratë veshin opinga lëkure. Në kokë vënë mafes të bardhë, i cili është i qëndisur skajeve dhe ka dantellën "zyrefe".²

Gratë e reja mbajnë vathë që formohen me përshtatjen e monedhave. Monedha kapet me një pafitë filigranike në formë të gjysmëhënës, e cila zbukurohet me tre gurë me ngjyrë të kaltër.³ Këto stoli blehen në Prizren nga argjendarët prizrenas.



Fig. 13 dhe 14, Veshjet e grave të rajonit të Opojës

¹ Kuntim gojor i Vezire Sopajt, katundi Zhur, 2003.

² Shih më gjerësisht: SIQECA Shpresa, Veshjet kombëtare dhe tekstilet e rajonit të Opojës në Kompleksin Monumental të Lidhjesë Shqiptare të Prizrenit, f. 286-288.

³ SIQECA Shpresa, Argjendaria prizrenase ndërmjet artit dhe kultit, perlat e etnisë shqiptare në Prizren, f. 065.

3. VESHJET E GRAVE TË RAJONIT TË RRAFSHIT TË DUKAGJINIT

Gratë e rajonit të Rrafshit të Dukagjinit /rrethi i Pejës, Gjakovës, Deçanit dhe Junikut/ veshin këmishë prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek /Fig. 15 dhe 16/. Këmisha është e gjatë dhe ngritet në brez. Mëngët i ka të gjera e të shkurtra gjer në bërryla. Përparësja “kanac-i” është në formë të katërkëndshit kënddrejt. Endet prej leshi ngjyrë kafeje. Në pjesën e sipërme dhe në të tri anët ka një dantellë të gjerë e të zezë, punuar me grep “rrjetim”. Pështjellaku i pasmë është gjithashtu në formë të katërkëndëshit kënddrejt, por i vogël. Zbukurohet me fije spiku të zi e penj leshi të bardhë, me motive florale, gjeometrike, në formë të spirales etj. Mbi këmishë vishet xhamadani e mitani me ngjyrë të zezë. Gratë mbathin çorapë dhe meste leshi të zi dhe opinga lëkure. Ato në kokë vënë lidhcë e marhamë prej pëlhure të bardhë, endur në vek.¹



Fig. 15 dhe 16, Veshjet e grave të rajonit të Rrafshit të Dukagjinit

4. VESHJET E GRAVE TË RAJONIT TË RUGOVËS

Gratë e rajonit të Rugovës /rrethi i Pejës/ veshin këmishë të qepur prej pëlhure të bardhë pambuku, me vija të holla ngjyrë kafeje, të radhitura në linjën vertikale /Fig. 17 dhe 18/. Është e gjatë gjer nën gjunj. Mëngët i ka të shkurtra gjer në bërryla, të mbledhura në kapakë. Brekët janë të qepura prej pëlhure të bardhë pambuku endur në vek. Kanë këmbëza leshi me ngjyrë të zezë, me zbukurime të imëta florale e gjeometrike. Përparësja

¹SIQECA S., Veshjet kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, f. 39.

është prej leshi, e zbukuruar në të tri anët me fije spiku të zi, të punuara me grep. Ka zbukurime asimetrike të qëndisura me penj e rruaza shumëngjyrëshe. Pështjellaku i pasmë “shpellak-u” është i vogël dhe në formë të trapezit. Punohet nga coha e spiku. Ka ornamente florale e spiraloide. Shoka është e zezë, e zbukuruar me rruaza shumëngjyrëshe, me motive florale e gjeometrike. Mbi këmishë vishet xhamadani i cohës, i zbukuruar me gajtanë shumëngjyrësh, me ornamente florale, në formë zigzage, të rrumbullakët, spirale e spiraloide.¹ Mbathin çorapë leshi dhe opinga lëkure. Në kokë vënë shami të bardhë, me thekë. Përdorin vathë, stoli kraharori “gjyksore”, gjerdanë prej argjendi “fill-i”, zinxhirë me hajmali etj.



Fig. 17 dhe 18, Xhamadani dhe pështjellaku i pasmë i grave të rajonit të Rugovës

5. VESHJET E GRAVE TË RAJONIT TË DRENICËS

Hulumtimet për veshjet e grave të rajonit të Drenicës janë bërë në fshatrat Runik dhe Vitak të Drenicës së Rrafshit.²

Gratë e rajonit të Drenicës veshin këmishë të qepur prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek. Ajo është e gjatë gjer në fund të këmbëve. Përparësja është prej leshi, e endur në vek me dy fletë pëlhure. Ajo është e gjatë dhe në formë të katërkëndshit këndrejt. Zbukurohet me ornamente florale e gjeometrike.³ Pështjellaku i pasmë është gjithashtu i endur në vek. Ai është i vogël. Zbukurohet në të tria anët me grep. Shoka është prej leshi, e endur në vek. Mbi këmishë vishet xhamadani. Mbathin çorapë leshi,

¹ Aty, f. 38.

² Informacionet janë marrë nga Ajet Topalli, Vitak, 1980.

³ Një përparëse është e ekspozuar në Muzeun e shkollës së fshatit Tërpezë. Përparësja është e endur prej leshi, me truallin me ngjyrë të kuqe. Në truall dhe bordure ka ornamente gjeometrike /në formë të rombeve dhe të gjysmërombeve/.

meste dhe opinga. Ato në kokë vënë shami të qëndisur me oja. Stolitë e grave të Drenicës janë punuar kryesisht prej ruazave. Ato i punojnë vetë gratë e këtyre trevave.

Veshja e vjetër e grave e rajonit të Drenicës ndodhet në Muzeun Etnologjik të Mitrovicës. Veshja e grave të Drenicës ndodhet në Muzeun Etnologjik të Prishtinës, në koleksione private etj.

6. VESHJET E GRAVE TË PRIZRENIT

Gratë e besimit mysliman të Prizrenit veshin këmishë të qepur prej mëndafshi, endur në vek /Fig. 19/. Ka mëngë të gjata dhe të gjera. Rreth jakës, grykës e mëngëve punohet dantella “oja” me penj mëndafshi. Veshin dimi prej mëndafshi, sateni dhe të materialeve të tjera. Përparëset enden prej mëndafshi dhe qëndisen në dy skaje me fije ari, me teknikën e mbushjes. Veshin jelekë e xhamadanë të punuar me fije mëndafshi të trashë ngjyrë portokalli.¹ Veshin xhybe e dollama prej cohe me ngjyrë të gjelbër, të kuqe, të kuqe të mbyllët, të zezë, ngjyrë vishnje, ngjyrë vjollce etj. Ato qëndisen me fije ari ose argjendi, me motive të mëdha florale. Në kokë vënë shaminë “përlenta” të endur prej mëndafshi me ngjyrë natyrore. Në bordura punohet dantella me gjilpërë “oja”, e cila ka zakonisht motive florale të luleve e të gjetheve me lule. Prej stolive gratë përdornin unaza, vathë, byzylykë, broshe, zinxhirë kraharori, paftë brezi etj.²

Gratë e besimit fetar katolik të Prizrenit veshin këmishë të qepur prej pëlhure të bardhë pambuku, endur në vek /Fig. 20/. Ato veshin dimi me këmbëza të zbukuruara me gajtanë të verdhë. Përparësja “boshqa” endet prej pambuku me ngjyrë të kuqe e të bardhë dhe zbukurohet me motive florale, gjeometrike dhe zoomorfe. Nuset dhe gratë e reja veshin xhamadanë, xhybe e dollama me ngjyrë të kuqe të mbyllët apo ngjyrë vishnjeje të thellë. Në dollama paraqitet motivi i dragoit.

Gratë mbathin çorapë të bardha dhe këpucë të zeza. Ato në kokë vënë kapelën “fesin”, e cila mbështillet me shami të hollë mëndafshi “vallye”, rreth së cilës punohet me gjilpërë dantella “oja”. Prej stolive përdorin unaza, vathë, byzylykë, broshe, zinxhirë kraharori, paftë brezi etj.³

¹ DURHAM, Edith /1998/, Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët, “Naum Veqilharxhi”, Tiranë, ff. 188-189.

² Shih SIQECA Shpresa, Argjendaria prizrenase ndërmjet artit dhe kultit, ff. 059-074.

³ Shih më gjerësisht: SIQECA Shpresë, Veshjet dhe tekstilet e femrave katolike priz-



Fig. 19 dhe 20, Veshjet e grave të besimit fetar mysliman dhe katolik të Prizrenit

PËRFUNDIM

Punimi “Veshjet kombëtare të Kosovës në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX” bën fjalë për veshjet kombëtare dhe aksesorët /armët e stolitë/ e burrave dhe të grave të Kosovës në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Veshjet kombëtare të Kosovës janë punuar prej leshi, pambuku, mëndafshi, kadifeje, lëkure, druri, argjendi, ari të praruar, hekuri, çeliku etj. Shumica e veshjeve janë punuar me teknikën e qepjes dhe të endjes dhe në mënyrë industriale. Janë të zbukuruara me dantella dhe qëndisje. Armët dhe stolitë janë punuar me teknikën e rrahjes, të derdhjes, të savatit, të filigranit dhe të granulimit. Në veshje, armë dhe stoli, paraqiten motivet florale, gjeometrike, zoomorfe, antropomorfe dhe motivet në formë të dragoit. Janë punuar në kuadër të artizanatit shtëpiak dhe nga terzinjtë, kazazët, këpucarët, qeleshepunuesit etj. Ndërkaq, armët dhe stolitë janë punuar nga mjeshtrit armëtarë, argjendarë dhe makasçi. Di-sa prej eksponateve janë punuar në mënyrë industriale dhe janë importuar nga jashtë. Veshjet kombëtare të meshkujve janë unike dhe me më pak dallime. Në dallim prej tyre, veshjet e grave kanë kolorit të pasur dhe dallojnë nga një rajon në tjetrin.

Bibliografi

- DURHAM E. *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, “Naum Veqilharxhi”, Tiranë, 1998.
- Monumentet e Kosovës*, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Prishtinë, 2004.
- SIQECA Mr. Sh. *Veshjet kombëtare shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, “Libri shkollor”, Prishtinë, 1998.
- SIQECA Sh. *Përlat e etnisë shqiptare në Prizren*, Gjeçovi, “Dukagjini”. Pejë, 2002.
- SIQECA Sh. *Koleksioni i armëve dhe i stolive në “Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” /Katalog i ekspozitës/*, Prizren, 2006.
- “*Studime*”, nr. 12, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2006.
- “*Studime*” nr. 15, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2008.
- Bujku*, Prishtinë.

Shpresë SIQECA, Prizren

KOSOVA'S NATIONAL COSTUME IN THE END OF 19th AND BEGINNING OF 20th CENTURY

Summary

The paper deals with Kosova's male and female national costume and accessories - weapons and jewelry - in the end of the 19th and the beginning of the 20th century. Kosova's national costumes and accessories were made of wool, cotton, silk, velvet, leather, wood silver, plated gold, iron, steel etc. Most of the costumes were sewed and produced through weaving technique and industrial. They are adorned by lacework and embroidery. Weapons and jewelry were usually made of forging, melting, chiseling "savat", filigree and granulate techniques. Different motives were presented in the national costumes, weapons and jewelry: floral, geometrical, zoo-morphic, anthropomorphic, as well as motives of the dragon.

The national costumes are homemade work or are made by tailors, silk processors, shoemakers, woolen cap (plis) makers etc. Weapons and jewelry were made by armament manufactures and silversmiths. Some of them were made in the industrial way or were brought from abroad.

Men's costumes were unique, with small differences between the regions, while women's costumes were colorful and differ from one region to another.

Abaz HADO, Tiranë

ARTI PAMOR I RILINDJES KOMBËTARE

KDU 39:75(=18)(091)

Abstrakt

Duke parë artin e rilindjes në fokusin e këtij studimi, vërehet se ky art realist ka sjellë vepra të rëndësishme që përbëjnë bazën e marrëdhënies mes artit pamor, folklorit etnografisë. Duke qenë një art thellësisht realist u mbështet kryesisht në subjekte folklorike etnografike, duke zbuluar dhe konfirmuar ndër të tjera bukurinë e kësaj etnografie, ndërkohë që shfaq dhe ndjenjat dhe qëndrimin patriotik.

Bashkëpunimi dhe përdorimi i elementëve etnografikë në artin shqiptar ka nisur shumë herët. Sipas të dhënave rezulton që shenjat e para të prezencës së elementeve etnografike shfaqen në artin bizantin dhe post-bizantin, sigurisht pa analizuar periudhat historike më të herëshme neolitike, deri në periudhat e artit ilir. Ka dëshmi arkeologjike sidomos për zbulimoret e grave, ilire dhe atyre arbënore, që tregojnë për vlera të rralla përpunuese të bronzit, hekurit, e deri tek argjendi. Sipas këtyre të dhënave, këto elemente përdorshin për zbulimin e veshjeve të kohës veçanërisht në veshjet e grave dhe vajzave të reja. Ndërsa piktorët mesjetarë ikonografë, përveç zbatimit të kanoneve të rrepta, në veprat e tyre mistike kish-tare herë pas here fusnin edhe ndonjë element të etnografisë lokale. Dy artistët më të njohur të kësaj kohe, Onufri dhe i biri Nikolla, ofruan disa elemente apo pjesë të shkëputura nga jeta e përditshme tokësore. Dhe për këtë studiuesja Dhorka Dharmo ka shkruar:

“Në veprën e tyre të cilësisë të lartë pasqyruan në një masë të gjerë elementin etnografik dhe e shfrytëzuan në mënyrë të ndërgjegjshme disa tipare të stilit të artit popullor. Ata krijuan në këtë drejtim një traditë tonën shumë të çmuar që u ndoq dhe u pasurua më tej në shekuj të mëvonshëm e që ka luajtur një rol shumë pozitiv në formimin e një arti me tipare shqiptare”.¹

¹ GJERGJI, A.: Vështirime historike mbi veshjet në Shqipëri, **Etnografia shqiptare** 7, Tiranë 1977,f, 493 .

Në pamje të parë duket si paradoks që këta piktorë ikonografë arritën të kapërcejnë kanonet e rrepta të artit bizantin për të pikturuar disa elementë të etnografisë lokale. Këta piktorë mesjetarë janë formuar dhe edukuar në malin Athos, përgjithësisht vend ku mësohej zanati i piktorit dhe kanonet strikte të artit kishtar.

Ikonografët me origjinë shqiptare, sipas të dhënave biografike, jetuan e krijuan në mjediset e vendit të tyre. Ata pikturuan barinj të bazuar mbi një legjendë popullore si “Barinj apokrifikë”. Pikërisht në pikturimin e tyre kemi përshkrim e veshjes lokale, por dhe një ndjesi e lehtë jetësore. Prof. Adromaqi Gjergji na jep të dhëna për këto veshje.

“E njëjtë është veshja e bariut të ri, me atë këmishë të hollë me mëngë të gjera ose të ngushta, e mbledhur për mesi me rrip dhe e plotësuar ndonjëherë me mbathje të puthitura pas këmbëve në formë getash, të lidhura me gjalm nën gju, si dhe kapelja me majë të lartë e me strehe të gjerë anash për hije”.¹

Piktura mesjetare me gjithë frymën mistike dhe kanonizimin e rreptë, nuk mundi të pengojë Onufrin që bariut t’i vendosë në kokë një kapele tradicionale dhe të varë në brez një kungull.

Gjithashtu ka edhe dokumente piktorike të tjera si, afresku i vitit 1757. Studuesja Andromaqi Gjergji e ka përcaktuar figurën e ktitorit të ulur në gjunjë, me veshje popullore. Ai paraqitet i veshur me një këmishë të gjatë me mëngë, ndërsa sipër ka një kaporane me mëngë të shkurtëra dhe në kokë mban një takije të bardhë. Pra janë pikërisht këto elemente të pakta të veshjes që shfaqen në afresk. Ato përbëjnë shenjat e para të lidhjes me realitetin tokësor dhe etnografinë tradicionale. Kjo për piktorët ikonografë shqiptarë ka qenë një ndjesi, frymëzim që arrinte shprehje artistike me profesionalizëm të lartë. Këto vepra na afrojnë më shumë delikatesë dhe art, një mjedis real folklorik dhe etnografik, me shenja të qarta lokale. Më vonë mbështetja e artistëve në jetën reale dhe veshjet popullore apo elemente të saj bëhen më direkte.

Piktori David Selenicasi, (shek XVIII) shfrytëzon elemente të veshjeve popullore për të treguar preferencën individuale, duke modeluar personazhe të vërtetë të kohës. Një portret i tillë është i një njeriu real, ktitorit Haxhi Jorgji, që paraqitet me veshje tradicionale. Ai mbështillet nga një pelerinë me push përpara. Kjo veshje përdorej nga pasanikët e qytetit të

¹ DHAMO, Dh.: Elementi etnografik në pikturën mesjetare të Onufrin dhe Nikollës, **Konferenca kombetare e studimeve etnografike** (28 30 qershor 1976), Tiranë, f. 109.

Voskopojës në atë kohë. Ndërsa figura “Hedhësi i farës” na paraqitet krejt ndryshe. Veshja e tij, duke filluar me kapelën që mban në kokë, këmishën e bardhë me një tip qillotash dhe me çantën dekorative hedhur krahëve, ndërsa në këmbë ka mbathur opinga me retra. Kjo lloj veshje padyshim është jashtë përfytyrimit kanonik kishtar, duke ngjarë më shumë me një figurë reale se sa të një të shenjtji. Kjo është një tjetër lidhje dhe bashkëpunim i etnografisë tradicionale me artin. Kjo traditë vazhdon dhe më vonë, me ikonografinë tonë, vëllezërit Zografi, Cetri, por dhe të tjerë si Zengo, të cilët bënë një art ikonografik, duke shfrytëzuar elemente të jetës reale pavarësisht kanoneve përcaktuese dhe mjaft të rrepta në periudha të ndryshme.

Në rethoren e viteve 1880 jeta shqiptare paraqitet shumë delikate nga pikëpamja sociale, politike, ekonomike dhe kulturore. Shoqëria më e përparuar e kohës, me gjithë problemet e mëdha që ekzistonin, bëri përpjekje për një zhvillim dhe emancipim në marrëdhëniet social-politike. Në historinë e artit shqiptar, kjo periudhë përcaktohet në këtë mënyrë:

“Nga mesi i shekullit XVIII, deri në fund të shekullit XIX, arti dekorativ e ornamental popullor pati një periudhë shkëlqimi ... Pasuria dhe larmia e madhe kishin karakter të theksuar patriakal, jeta ishte shumë e mbyllur dhe me kushtëzime kanonesh të rrepta.

Meqenëse mungonte një klasë borgjeze, apo kapitaliste, nuk mund të kishte një zhvillim shoqëror të tillë që të mundësonte emancipimin tërësor të jetës shqiptare. Familjet tradicionale ruanin marrëdhëniet e vjetra me doket dhe zakonet e veta; jeta publike ruante ato mentalitete shekullore”.¹

Kjo natyrisht ishte shumë e dukshme, nostalgjike, interesante dhe poetike në qytetet si Shkodra, Korça, Elbasani, Gjirokastra, Berati etj. Këto janë qytete që dallojnë për arkitekturën e pasur me karakteristika të veçanta, unike që kanë harmoni elementesh dekorative, raporte të gjetura dhe të studiuara mirë të masës arkitektonike me njeriun. Një tipar i dukshëm i vlerës është kontrasti i ekuilibruar grafik dhe trasparenca hapësinore. Arkitektura e këtyre qyteteve ka ornamentikë të pasur, ngjyra të përmbajtura, por me kontraste, dhe lidhet bukur me relievin dhe banorë që jetojnë në këto banesa. Interesante paraqiten këta banorë, me veshjet tradicionale plot

¹ KUQUALI, A.: *Elementet e artit popullor, përbërës të rëndësishëm të karakterit kombëtar të arteve figurative të realizmit socialist*, Konferenca kombëtare e studimeve etnografike, (28/30 qershor 1976), Tiranë.

ngjyra, duke u kthyer dhe në dekor të bukur lëvizës, në raporte me rrugët dhe mjediset e këtyre qyteteve.

Të dyja i japin mjedisit të qyteteve, një ansambël ngjyrash plot dritë poetike e romantizëm. Veshja tradicionale popullore si koncept artistik përmbledh ndërtimin e strukturës kompozicionale, raportin piktorik, kontrastin grafik, dekorativitetin dhe zbukurimet. Nga një lexim abstragues i shumë të dhënave rezulton se shumë elementë të saj nga pikëpamja e zgjidhjes dhe konceptin estetik lidhen, harmonizohen dhe ndërthuren në mënyrë organike grafikisht me mjedisin dhe arkitekturën popullore.

Në këtë rast nënvizoj një konstatim interesant të studiuesit dr. Andon Kuqali me të cilin ndaj të njëjtin mendim:

“Në kontrastin grafik të veshjes popullore vëren raporte me atë të banesës qytetare të Beratit, Korçës, Gjirokastrës, Prizrenit, malësisë së Gjakovës” etj.¹

Pra kjo është atmosfera e kësaj periudhe, duke përfshirë tërë elementet përbërëse. Nga një anë kemi atmosferën krijuese, sociale, politike, ekonomike dhe nga ana tjetër vlerën e arkitekturës, folklorit dhe etnografisë tradicionale.

Këto vlera do çonin shumë shpejt drejt një arti të ri, që largohet përfundimisht nga ikonografia dhe arti kishtar. Arti i ri është realist në trajtimin piktorik dhe laik të lëvrimin të tematikës dhe subjekteve. Ky art fillon të trajtojë subjekte dhe motive nga jeta dhe realiteti tokësor. Arti i kësaj periudhe do cilësohej nga historiografia e artit si “Art i Rilindjes Kombëtare”. Përveç vlerës si një lëvizje e përparuar artistike ndikoi dhe atmosfera patriotike në vitet 1880. Arti i ri që filloi, dalloj për realizmin e thellë dhe frymën romantike që e përshkruan. Arti i rilindjes kombëtare fillon të trajtojë si subjekt primar mjedisin folklorik shqiptar, ku përfshihen momente interesante nga jeta dhe tradita popullore, ku etnografia është pjesë e pandarë e vlerës. Në këtë kohë artistët gjetën një burim frymëzimi te përmbajtja folklorike, duke shfrytëzuar bukurinë e veshjeve tradicionale. Arti i Rilindjes është padyshim art i folklorit, etnografisë dhe patriotizmit. Përfaqësuesi më i spikatur i saj padyshim është piktori Kol Idromeno.

¹ Po aty.

RËNDËSIA E PIKTORIT KOL IDROMENO

Ky artist kuptoi rëndësinë që kishte folklori dhe etnografia për artin e ri, të cilin filloi ta aplikonte në aspektin e pasurisë së harmonisë koloristike, simbolikës së elementeve dekorative, kontrastit grafik dhe dritë-hijeve, si dhe elementin etnik.

Duke parë vlerat e veprës së Kol Idromenos kemi vlerësuar trajtimin piktorik realist me shumë karakteristika të veçanta. Vepra e tij është përgjithësisht folklorike, me elemente thellësisht etnografike. Historia e artit shqiptar ka vlerësuar mjeshtërinë, profesionalizmin dhe vlerat e një realizmi unikal. Ai arriti përmes artit të sjellë një ndryshim të madh konceptual në pikturën e kohës. Aplikoi për herë të parë në Shqipëri një art të ri laik.

“Në kohën kur u realizua portreti, as motra Tone, as vetë Idromeno nuk e dinin se po krijohej piktura e parë realiste në Shqipëri, se në atë vepër do të shënohej fillimi i një faze të rene të gjithë artin shqiptar”,

ka konstatuar me të drejtë historiani i njohur Ferid Hudhri.

Lëvizja artistike e këtij artisti shënon një moment me rëndësi historike, që u shoqërua me ndryshime të thella në perceptimin artistik. Pas tij arti mori një drejtim thellësisht të ri. Kol Idromeno që në veprën e parë tregoi qartë tendencën dhe drejtimin që do marrë krijimtaria e tij. Është momenti që një art aplikohet larg kanoneve ikonografike bizantine dhe pasbizantine. Filluan të trajtohen me realizëm të thellë e frymë romantike subjekte dhe motive nga jeta reale. Këto subjekte bazohen në perceptime folklorike dhe etnografike. Vepra e tij u mbështet fort në trashëgiminë popullore, duke përthyer bazamentin mitologjik në konceptet filozofike estetike të jetës dhe realitetit tokësor. Arti cilësohet si pjesë e pandarë e laikizmit. Ndërsa përmbajtja ideofilozofike shprehur menjëherë nga trajtesa mistike, shprehja artistike e gjen mbështetjen te realizmi romantik. Për herë të parë një veper arti lidhet dhe pasqyron veprimtarinë politike, sociale dhe shoqërore të kohës. Personazhet e pikturave nuk janë figura biblike, shenjtorë apo apostuj, por njerëz kryesisht familjarë dhe të njohur që gëzojnë autoritet politik, ushtarak, shoqëror. Përveç kësaj, të gjithë këta personazhe mbajnë veshur më së shumti kostumet dhe veshjet tradicionale, që pikturohen me vërtetësi maksimale. Kjo u bë e dallueshme që me portretin familjar “Motra Tone” (1883), që njeriun e dashur të familjes e pikturon me një veshje të bukur tradicionale, e cila përdorej nga gratë katolike të qytetit të Shkodrës. Kjo nuk është rastësi, por një ndjesi dhe

emocionalitet personal, që do shoqërojë krijmtarinë e tij. Në qoftë se në artin e ri portreti “Motra Tone” njihet si vepra e parë laike, gjithashtu është edhe portreti i parë, që prezantohet me veshje tradicionale në historinë e pikturës shqiptare. Ky portret menjëhere mori vlerë me rëndësi të veçantë pavarësisht se u ekspozua për publikun shumë vonë, pasi ka qëndruar në shtëpinë e Idromenos si portret familjar. Në vitin 1954 ekspozohet në Galerinë e Arteve të Tiranës (sot Galeria Kombëtare e Arteve). Kjo vepër parashtrroi në publik realizimin e koncepteve të artistit të ri, që po guxonte të ndryshonte parimet e artit të kohës. Mënyra e re e pikturimit sollti një etapë të re në artin shqiptar. Por ajo çka është me rëndësi në këtë vepër, është se shohim dukshëm referencën, preferencën individuale për të bashkëpunuar dhe mbështetur në vlerat e etnografisë popullore. K. Idromeno pikturon me dashuri dhe ndjesi emocionale portrete njerëzish të njohur si tregëtarë apo të profesioneve të ndryshme, që vishen me kostume tradicionale. Duket që kjo mënyrë e pikturimit u ka dhënë shumë peshë dhe autoritet real ketyre njerëzve. Nëpërmjet paraqitjes së tyre në këtë mënyrë afirmojë personaliteti gjendja ekonomike, pozicioni klasor dhe social.

“Gjurmët e dallimeve midis shtresave të ndryshme shoqërore, të pasqyruara në cilësinë e materialit të përdorur, në cilësinë artistike të disa prej pjesëve më të zbukuruara të veshjeve, siç ishin jelekët e mëngoret me qëndisma me fije ari apo në stolitë metalike, që edhe mbas çlirimit i mbante njëlloj, si fshatari i varfër dhe ai i pasur... Ruheshin gjithashtu disa shenja fetare, sidomos në veshjet dhe stolitë e grave. Ato të krishtera dalloheshin nga ato të myslimaneve. Këto ndryshime kishin të bënin kryesisht me funksionin praktik dhe shoqëror të veshjeve dhe në një masë më të madhe, më të kufizuar, me anën estetike të tyre”.¹

Është kjo mënyrë që i siguroi një sukses të menjëhershëm pikturës “Motra Tone”. Padyshim një rol të rëndësishëm për suksesin ka luajtur veshja e bukur dhe e pasur, me vlera të larta e mjaft evidente. E theksojmë këtë pasi kemi parasysh se kur realizoi një portret të dytë me veshje qytetare, nuk arriti të njëjtin sukses të vlerës. Ky artist i ri në atë kohë aplikonte një art thellësisht realist, ku parësore përveç karakterit të figurës vendosi shijet artistike dhe ndjenën estetike në lidhje të ngushte me artin popullor. Si një artist i talentuar arriti me intuitë profesionale të kuptojë rëndësinë që kishte për artin e tij mbështetja dhe shfytëzimi i asaj pasurie

¹ KUQUALI, A. : Historia e artit shqiptar 2, botim i vitit 1988, Tiranë, f. 4.

koloristike dhe ornamentale që gjendej në veshjet popullore. Prandaj ai e vlerësoi maksimalisht dhe u mbështet fuqishëm në artin popullor, veçanërisht në elementet e kulturës materiale. Në tërësinë e kostumeve tradicionale gjenden mundësi dhe forma të ndryshme, që artisti mund t'i kalojë në kanale të ndërlikuara krijimi. Një piktor kërkon pasurimin e shprehjeve artistike, të cilat i fiton nga eksperiencia profesionale, nga fuqia e perceptimit dhe talentit, nga aftësia e vëzhgimit dhe analizës, por edhe duke u mbështetur shpesh në zgjidhjet stilistike, dhe estetike që gjenden në ndonjë art tjetër, siç është arti popullor, veçanërisht kostumografia tradicionale. Pikërisht Kol Idromeno gjeti mundësinë në këto mënyra, që krijimet e tij të fitojnë pasuri koloristike, dritë kontrast, sugjestion dhe emocion të veçantë. Pikërisht, veshja të "Motra Tone" është një nga vlerat e padiskutueshme, duke i dhënë një prezencë dhe sugjestion këtij portreti. Kjo padyshim është vepra më e rëndësishme, e cila ka fituar një status të veçantë në sistemin e vlerave të artit të tone. Sepse është vepra më e njohur, më e ekspozuar, më e riprodhuar dhe më popullore. Në sajë të një kujdesi të veçantë ajo është restauruar në Laboratorin e Konservimit dhe Restaurimit, pranë Muzeut të Luvërit. Për vlerat që kjo vepër mbart, mes të tjerave interes të madh ka ngjallur ngjyra e bardhë e degermisë (shamisë), që mbulon një pjesë të portretit. Për këtë arsye u ekspozua për pak kohë në muzeun e njohur "Dorsey" France.

Ky portret nuk është thjesht një vepër që pasqyron portretin e një gruaje të bukur, me një shikim zhbirues, me tip e karakter të përcaktuar. Me këtë vepër Idromeno ka shkuar më tej në synimet për arritje artistike dhe për lartësimin e simbolikes. Përmes këtij portreti, një grua e hijëshme e kohës paraqet një thellësi psikologjike e sugjestion artistik. Vështrimi i saj anash, i jep një forcë enigmës që përmban, duke dhënë idenë sikur kërkon të hetojë diçka.

Ajo që i ka dhënë veçanësi, është pozicioni i duarve plot elegancë dhe bukuri, apo kapje e degermisë së bardhë, për të na dhënë në këtë mënyrë, mundësinë të zbulojmë fytyrën e ëmbël të një vajze të bukur 24 vjeçare. Ky gjest elegant i ka dhënë simbolikë, duke plotësuar përmbajtjen artistike dhe misionin shoqëror. Mendoj se një portret si "Motra Tone", me ato përmasa vlerash që përmban, nuk është vetëm një vepër intime dhe familjare. Ajo ka arritur të kapërcejë analizën e një modeli të thjeshtë. Gjatë procesit krijues ajo mori ngarkesa të thella emocionale. Kjo vajzë e bukur në jetën private ka qenë këngëtare dhe bashke me vëllanë, Kolën, që ishte

dhe një muzikant i talentuar, merrin pjesë nëpër dasma. Ajo bënte një jetë shumë familjare, me kërkesa qytetare. Bashkëshorti i saj ishte një njeri i emancipuar, mësues, që në atë kohë kërkonte nga gruaja të vishej në mënyrë moderne. Ndërkohë, Kol Idromeno vendos ta pikturojë me veshje tradicionale, si portretet familjar. Ai është i ndërgjegjshëm se gjatë realizimit të kësaj vepre po shpaloste idetë, synimet stilistike për një art realist, progresiv për kohën dhe kushtet që ndodhej Shqipëria. Çdo element është pikturuar me realizëm dhe hollësi, degermia (shalli i madh) që ia mbulon flokët dhe bie deri në gjoks me palat e hollësishme. Jeleku, veshja e trupit me ornamente, me qëndisma të zeza mbi materiale të thella dhe ngjyra të njëjta. Shumë interesante dhe sugjestoniuese janë trajtesat dekorative në të dy krahët që zbulojnë figuracione lakonike me të zeza mbi të kafta.

Duhet thënë se nga pikëpamja etnografike portreti përmban një kompleks vlerash që trasetohen artistikisht. Dallojmë “veprime” elegante, si për të liruar paksa pamjen e fytyrës nga shamia e bardhë, e cila zë sipërfaqen më të madhe të tablosë.

Në një vepër tjetër “Portret burri me çibuk” kemi një trajtim piktorik thellësisht realist që na zbulon një burrë galant me kostum qytetar shkodran. Ai pozon me një qëndrim prej fisniku, duke treguar jo vetëm bukurinë fizike, por dhe hijeshinë dhe dekorativitetin e kostumit që ka veshur. Fesi i kuq me një xhufkë në kokë, këmisha e bardhë me një kravatë të bukur elegante me perlë dhe dy lule, jeleku shumë i detajuar dhe me ornamentikë punuar me një gajtan të zi, ndërsa brezi është me vija të kuqe, okër e të bardhë. Nga çibuku prej smeraldi, qosteku, veshja shumë ornamentale, kravata me perlë dhe lule, kuptohet se kemi të bëjmë me një person të shtresës së lartë shoqërore.

Konstatohet se Kol Idromeno ka patur një intuitë artistike të thellë në dallimin apo prioritetin e realizimit të një misioni, për një art të ri, ku përveç subjekteve dhe pasqyrimin të njeriut të kohës, primare kishte trajtimin e subjekteve folklorike dhe etnografike. Këto vepra do të pasqyronin në këtë mënyrë motive të jetës sociale dhe familjare në Shkodër. Ai përcakton drejtimin dhe tendencën për një art realist, i cili mbështetet tërësisht në trajtimin e subjekteve aktuale të kohës. Në veprën e tij dominon folklorizmi dhe etnografia, nga ku mund të evidencohen motive, doke dhe zakone tradicionale në gjykimin dhe shikimin e jetës së përditëshme si një aktualitet në lëvizje dhe zhvillim. Artisti bazohet më fuqishëm në etnografinë e pasur zonale. Mbi këto bazamente ndërton një vepër me një subjekt shu-

më domethënës dhe të pasur në ngjarje dhe personazhe. Kjo është vepra “Rrugët e jetës” (1896) që ka në përmbajtje të saj marrëdhënien e njerëzve me moralin shoqëror dhe besimin fetar. Në këtë kompozim figural nuk shohim ndonjë frymë mistike, sepse përceptimi artistik është bazuar mbi veprimtarinë komplekse të njeriut në aktivitetin e zakonshëm ditor. Nga mënyra e konceptimit dhe përmbajtjes së saj, vepra të krijon ndjesinë si një zgjatim logjik i artit popullor, pavarësisht tematikës thellësisht fetare: Njerëz që kryejnë veprimtari të ndryshme, ndajnë rrugët e jetës, ferrin dhe parajsën. Në këto grupime shprehen aspekte gjykimi për mëkatet dhe mirësinë që kanë kryer personazhet gjatë veprimtarisë së tyre familjare e shoqërore.

Janë interesante skema të tilla, si: argëtim me aheng, me gjah, duke kalëruar, duke kryer grabitje apo duke bërë lojëra të ndryshme etj. Janë plot 210 figurat që trajtohen dhe përshkruhen me vërtetësi kaligrafike, pasi shumica mbajnë veshje tradicionale popullore të Shkodrës dhe zonës përreth.

“Rrugët e jetës” është një vepër me tematikë mitologjike, me përmasa të mëdha ku përshkruhen me vërtetësi etnografike skema të ndryshme nga veprimtaria ditore e njerëzve të shtresave shoqërore të ndryshme. Sipas shkrimeve dhe mësimëve të biblës, veprimtaria njerëzore është e gjyqeshme, prandaj ajo duhet të udhëhiqet nga dashuria dhe mirësia. Njeriu merr rrugën e përcaktuar nga fati në bazë të veprimëve që ka kryer në jetë. Pikërisht këto ide pasqyrohen në këtë vepër me rëndësi fetare dhe folklorike. Përmes tregimit dhe alegorisë piktori analizon veprimtarinë e përditshme të grupeve shoqërore, ku rëndësi merr prezantimi i veshjeve të tyre tradicionale. Kjo përcakton nivelet klasore të shoqërisë dhe veset e tyre. Për mënyrën e jetës që bëjnë njerëzit për mëkatet dhe të mirat janë caktuar dy rrugë, parajsa dhe ferri; këtë përpiqet të tregojë kjo vepër. Ndërkohë që është përcaktuar masa e njerëzve që kanë marrë destinacionet e tyre, në sajë të veprimtarisë njerëzore dhe shoqërore, duke kaluar në rrugët që kanë merituar, Parajsa, për të gjithë ata, me sjellje dhe moral të lartë njerëzor, familjar dhe shoqëror; ndërsa ferri, i gatshëm të presë të gjithë ata që kanë vese të këqija, të dëmshme dhe me mungesë morali njerëzor. Në ferr pasqyrohen ngjarje të jetës toksore, të mbushura plot me vese të këqija. Ndërsa në parajsë ka vend vetëm për njerëzit me virtyte morale, që kryejnë veprimtari normale njerëzore. Kjo veper është interesante se ka arritur të përshkruajë me hollësi dhe të diferencojë grupime të përcaktuara me

veprime dhe gjeste që dënohen nga morali shoqëror, besimi dhe feja. Në vepër gjejmë përshkrime ngjarjesh, momente të veçanta nga veprimtaria shoqërore. Por me rëndësi është përshkrimi real dhe i hollësishëm i veshjeve tradicionale të qytetarëve katolikë të Shkodrës. Nisur nga një tematikë dhe subjekt fetar, artisti i referohet artit popullor si nje perceptim real i vlerave. Në këtë vepër, ndër të tjera, dallon dhe një skemë gazmore shumë interesante “Aheng Shkodran”. Vepra është e mbushur me skema folklorike dhe grupime të kompozuar me një fantazi të madhe. Vepra të tilla marrin përfytyrime të veçanta folklorike poetike. Në mënyrë të veçantë mund të dallojmë përshkrimet e tipave shumë të pasur dhe me karaktere të ndryshme. Vepra ka marrë vlera të mëdha etnografike sepse personazhet janë veshur me kostume tradicionale. Përveç figurave të muzikantëve ku gjejmë edhe vetë portretin e artistit, të tjerët janë duke kënduar e duke u gëzuar, në mënyrë origjinale. Mes kësaj atmosfere gëzimi, spikasin dhe figurat e shëmtuara të dy djajve, që janë pikturuar me një fantazi të veçantë e të çuditshme. Nga mënyra se si veprojnë djajtë duket sikur kanë ndikuar për t’i tërhequr në rrugë të “keqe”. Kjo skemë ka përshkrime figurash me lëvizje intresante, të pikturuara me hollësi dhe korrektesë etnografike, veshjet e qytetarisë së Shkodrës. Njerëzit në kokë mbajnë fes të kuq me xhufkë që varet mbrapa (element me influencë turke), këmisha të bardha, jelekë të kuq me ornamentikë të pasur, qëndisur me gajtan me ngjyrë të zezë, brez ku dominon ngjyra e kuqe. Të gjithë kanë benevrekë të errët. Kjo është përgjithësisht atmosfera që buron nga kostumografia që është padyshim veshje e shtresës së thjeshtë qytetare. Një moment tjetër në këtë tablo janë dy kalorësit e pasur, të veshur me kostum tradicional. Ata udhëtojnë të qetë mbi kuaj. Mbrapa u shkon një fshatar, që me sa duket është një nga shërbëtorët e tyre. Ai dallon se ka një veshje tjetër, që përdoren në fshatra të zonës, apo nga njerëz të shtresës të ulët shoqërore. Ndërsa kalorësit kanë veshje qytetare me fes të kuq, me jelek, brezorja me ornamente, ku duken pisqollat. Benevrekë të errët, me këmbore të bardhë dhe kepuçë të zeza. Kjo ka plotësuar në këtë mënyrë kostumin tradicional që përdoret nga qytetarë të pasur dhe fisnike të Shkodrës. Ndërsa fshatari në kokë ka qeleshe të bardhë, këmishë të bardhë, jelek të errët me mëngë të shkurtëra, me tirqit e bardha prej shajaku, me ornamente në formë azhuri të zi, që ndjek formën anash deri poshtë, afër opingave. Në krahë ka hedhur një pushkë. Është e dukshme që K.Idromeno, ka një opsion pozitiv dhe lidhje të pandarë vlerësimi dhe

bashkëpunimi me folklorin dhe etnografinë. Madje ky artist ka influencuar edhe te piktorë të tjerë, që të ndërtonin një lidhje emocionale dhe të veçantë ndaj motiveve folklorike dhe elementeve etnografike.

Një nga tablotë më sugjestionuese të artit të kësaj kohe, por dhe të artit realist, në përgjithësi është “Dasma shkodrane “ (1924). Që në fillim konstatojmë se kemi të bëjmë me një vepër tipike folklorike, me karakter të theksuar etnografik. Përmes drejtpeshimit kompozicional, harmonisë së ngjyrave, dritës së gëzueshme dhe hijeve transparente trajtohet një moment dasme në qytetin e Shkodrës. Kjo festë e rëndësishme familjare është përshkruar me një hollësi të admirushme ku me sa duket funksionon një skemë, një rit që shoqëron çdo moment në këtë festë. Figurat me veshje tradicionale që ndrisin nga ngjyrat duket që përdoren në raste festash të tilla nga qytetarë katolikë. Ndërsa ambienti dominohet nga një mjedis shumë popullor, një portë e madhe me hark, nga ku duket një banesë karakteristike e arkitekturës popullore, e mbushur me dasmorë që zbresin nga shkallët, ndërsa mbrapa në sfond duket xhamia dhe minarja e lartë e pak më tej një këmbanare e kishës. Ky është një realitet ekzistues dhe aktual i besimit në këtë qytet. Larmia e bukuria e veshjeve të grave krijojnë atmosferë të vërtetë festive dhe gëzimi. Sepse të gjithë shfaqin një gëzim që marrin pjesë në këtë ceremoni dasme. Nga pikëpamja folklorike ka vlerë pasi kompozimi është ndërtuar mbi skema të vërteta të mënyrës e zhvillimit të një rituali dasme. Ndërsa nga pikëpamja etnografike na vjen një informacion interesant pasi na shpaloset një pasuri e madhe e veshjes tradicionale, e mbushur me ornamentikë dhe zbukurime të rralla që përdoren në raste të tilla. Vlerat e kësaj vepre janë të dukshme në shumë dimensione. Interesante paraqitet skema kompozicionale që ndërtohet në disa plane, të cilët krijojnë atmosferë dhe lëvizje lakonike të figurave. Një element që paraqet interes në këtë vepër me vlera etnografike është se kemi një imponim dhe trajtim tejet korrekt të kostumeve popullore. Çdo pjesëmarrës ka veshje me simbolikat përkatëse që përcaktojnë nivelin dhe statusin shoqëror dhe fisnor në këtë ceremoni.

Grupimet e ndryshme në këtë vepër besoj se janë bërë sipas përkatësisë dhe rëndësisë fisnore. Në të djathtë, në plan të parë dallojnë dy gratë, ndërsa njëra vështron nga nusia, tjetra ka ngritur dorën dhe sheh përpara, këto duken që i paraprijnë grupit të krushqëve, kurse pas tyre një djallë i vogël mban një boshçe. Veshja e tij me jakë të bardhë, brez dhe kësule të kuqe, si dhe vendi ku ai qëndron, tregojnë se ka një rol të rëndësishëm

në këtë ceremonial. Ndërsa në qëndër të veprës është nusja, e shoqëruar nga dy gra që e kanë vënë në mes.

Njëra komunikon me të ftuarit, ndërsa tjetra është tërësisht e përqendruar te vajza nuse. Nusja duket qartë jo vetëm se është në qendrën e këtij kompozimi interesant, por vendosja e grupit të grave është bërë në formë të tillë që të gjitha linjat e çojnë vështrimin në këtë figure kryesore. Kjo është një zgjidhje kompozicionale që bazohet mbi skemat e artit klasik ku horizontalet, vertikalet dhe lakonizmi i linjës çojnë në zbulimin e subjektit dhe personazhit kryesor. Në veshjen e nuses përveç kostumit të saj dallon dhe shamia e bardhë që mbulon pothuaj gjithë fytyrën e shkon deri poshte trupit. Ajo që tërheq vëmendjen është japanxha e kuqe zbukuruar me fije, me ngjyra të ndryshme, e cila zakonisht hidhej krahëve. Sipas etnologëve, kjo është një pjesë tipike e veshjes për nuse. Ndërsa grupi që nënkupton dukshëm shoqërueset apo krushkat përshkohet nga një dritë transparente, duke u dhënë kostumeve ndriçim dhe bukuri impresionuese për të evidencuar pasurinë koloristike. Shumë përshtypje të bëjnë figurat e grave që janë nën rrezet e burimit të dritës, që kanë veshur kostume që dallojnë mes dasmoreve tjera. Në rastin e benevrekëve të errëta, përdorur nga gratë dhe burrat katolikë, kemi të bëjmë me një influencë nga veshjet venedikase.

Në krahun e majtë ndodhen dasmorë të tjerë, midis të cilëve njëra nga gratë i kushton vëmendje fëmijës së vogël, dy gra tjera me kostume të përmbajtura në ngjyrë plotësojnë harmonishëm ambientin festiv.

Pas planit të parë kemi një grupim të kompozuar natyrshëm, që krijon një drejtpeshim elementesh figurative, siç janë figurat e burrave dhe fëmijëve të vegjël. Kompozimi zhvillohet brenda një oborri me mur të lartë, porta e madhe me hark e mbuluar me çati lart, mbrapa saj shtëpia dykatëshe nga duken shkallët, prej së cilës po zbresin dasmorë të shumtë. Në këtë tablo horizontale figurat kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e atmosferës festive. Ndërsa peizazhi, në plan të dytë plot dritë, me shtëpitë karakteristike shkodrane, i plotëson elementet përbërëse të një pikturë me përmbajtje etnografike. Kjo atmosferë është pasuruar nga larmia arkitektonike, me ornamentike mjaft plastike dhe kontrast grafik. Drita e plotë direkte e diellit i ka dhënë ngrohtësi përshkrimit të ambientit dhe një pjesë të figurave.

Por folklor të pastër dhe etnografi të pasur nuk shohim vetëm në kompozime figurale, por dhe në portrete, peizazhe e vizatime. Një vepër me vlera serioze është “Portret burri me fes” që prezanton një person

autoritar të kohës. Portreti përcakton individualitetin e një personaliteti, që pozon për të evidencuar në një farë mënyre pozitive e vet shoqërore dhe klasore. Kjo vepër është pikturuar me hijeshi dhe të befason me veshjen tradicionale. Në kokë ai mban një fes të kuq, me xhufkë në kokë. Ka veshur një këmishë të bardhë dhe mbi të një xhamadan me ngjyrë të kuqe, qëndisur me gajtan të zi që na tregon një pamje sugjestive. Kemi gërshetim të formës me lakime vertikale në mes, ndërsa në mbyllje në pjesën e përparme duken elemete zbukurimore në formë gjetheje. Në xhamadan dallohet dekori ornamental me një vijë të zezë të trashë që plotësohet nga rathë të vegjël që vijnë njëri pas tjetrit. Në pjesën e poshtme të tij, deri afër dorës kemi një mbyllje me elemente që valëzojnë me ritëm linear grafik. Portreti mbyllet me një brez mesi të trashë, me dekoracione horizontale dhe vertikale. Duke parë këtë portret besojmë që kostum të tillë me pasuri ornamentale, me qëndrimin galant si tip, me mustaqe spic, me pamje burrërore, na krijohet mundësia të shohim një karakter të skalitur fort, që mbart psikologjinë e një njeriu të kënaqur nga jeta dhe pozicioni shoqëror. Ndërkohë na afrohet dhe mundësia të shijojmë një pamje autoritare që buron nga ajo veshje e pasur dhe pozante. Duke pasur një marrëdhënie të afërt me folklorin dhe etnografinë piktori arriti të krijojë kompozime, portrete si dhe disa peisazhe që u bënë të njohura. Portret interesant është “Fshatari nga Zadrime”, ku shohim një njeri të thjeshtë, i cili duket nga veshja e që mban. Një vepër që ofron pamje të bukura të një mjedisi karakteristik është peizazhi “Oborr shkodran”(1933), ku përshkruan pamjen e brendshme të një oborri shkodran. Mes këtij oborri të bukur me pemë, lule të larmishme e objekte tjera qëndron një vajzë të vogël me kostum popullor. Në këtë vepër është krijuar një atmosferë e ngrohtë intime dhe familjare. Ky peizazh tregon në një farë mënyre organizimin e mjedisëve në qytete karakteristike, ku jeta e familjes përditësohet në këto banesa të bukura plot lule, poezi, gurë dhe dru të gdhendur me hapësira të bollshme plot ajër dhe dritë, por dhe etnografi. Peizazhi mbështillet nga një dritë e ngrohtë e ëmbël transparente. Oborri, me pemët, lulet dhe vajza e vogël me kostum tradicional, janë pikturuar me kujdes dhe hollësi kaligrafike. Të krijuar përshtypja sikur kemi të bëjmë me një qilim të endur shumëngjyrësh. Me interes në krijimtarinë e këtij artisti janë veprat me karakter intim që përbajnë elemente etnografike të pastra. Në vitin 1931 pikturon një portret gruaje me ndjeshmëri dhe emocionalitet të dukshëm. Është një grua në moshë që ka tipare, ku shprehet një bukuri natyrale. Ky artist

portretet i nxjerr nga sfondi i errët për të përqendruar dritën në momentet kryesore përcaktuese të tipareve dhe karakteristikave të modeleve. Kjo është e dukshme në portretin e gruas së tij. Ai e ka pikturuar duke u përqendruar në trajtimin piktorik, ku penelata delikate krijon formë plastike të fytyrës së saj, ngjyra plot dritë, që shpërndalet ëmbëlsisht në pjesën ballore. Në këtë portret të përmasave jo shumë të mëdha është pikturuar bukur veshja e saj që përdorej gjerësisht nga gratë qytetare të besimit katolik në qytetin e Shkodrës. Mbi flokët e saj është vendosur një salmon, element të cilën nuk e kemi hasur në asnjë pikturë tjetër. Këmisha e poshme dhe sipër saj janë të bardha, ndërsa jeleku dhe shamia e vendosur përpara formulojnë veshjen e gruas së moshuar shkodrane.

Gjithashtu një portret tjetër interesant i këtij artisti është ai i quajtur “Fshatari nga Zadrima” Përveç tipit me karakter të detajuar, tërheq vëmendjen edhe veshja e burrave të zonës së Zadrimës. Këto janë portrete thellësisht familjare dhe shumë intime. Ato përbajnë shprehje artistike dhe informacion të pasur me vlera etnografike.

Në tërësi vepra e K. Idromenos tregon ndër të tjera forcën e një pikturë realiste që mbështetet fuqishëm në etnografinë dhe folklorin duke u bashkuar dhe me frymën e një patriotizmi real. Arti i këtij artisti pati rëndësi për kohën se ndryshoi dhe transformoi pikturën shqiptare, e modernizoi atë në ato kushte të vështira ekonomike dhe shoqërore.

Abaz HADO, Tiranë

THE VISUAL ART OF NATIONAL RENAISSANCE

Summary

The art of Renaissance is the focus of this study, and it shows that that period saw the creation of important works of art which constitute the basis of a relation between visual art, folklore, and ethnography. Being genuinely realist art, it relied mainly on folklore and ethnographic themes and confirmed, among other things, the beauty of this ethnography by expressing patriotic feelings.

Special focus is attached to Kolë Idromeno's work. In general, Idromeno's work shows, among others, the force of a realist painting that strongly relying on ethnography and folklore coupled with the spirit of real patriotism. The art of this artist was important at that time because it changed and transformed the Albanian painting and also modernized it in difficult economic and social conditions.

Ilirjana DEMA, Universiteti i Arteve, Tiranë

PËR NJË QËNDRIM RACIONAL NË INTERPRETIMIN E FIGURAVE RITMIKE TË PARREGULLTA IRRACIONALE

KDU 784.94

Abstrakt

Përvoja më ka diktuar zgjidhje teoriko-praktike origjinale, të cilat do t'i grupoja në kë të mënyrë:

1. Klasifikimi i figurave irracionale në dy kategori: a) figura irracionale të formuara sipas modelit të figurave racionale të metrikave të ndryshme, b) figura irracionale për të dyja metrikat

2. Përpjesëtimi brenda llojit të vlerave irracionale me progresion gjeometrik

3. Tërheqja sistematike e vëmendjes në ndërgjegjësimin e pulsimit të vlerës tetëshe në rrahjen e metrave të thjeshtë dhe të përbërë, si formuese e shprehive poliritmike dhe asimetrike

Këto zgjidhje teoriko-praktike e kanë kaluar provën e suksesit jo vetëm në kapërcimin e dobësive të studentëve, por madje, në një kontekst më të gjerë, efikasiteti i tyre ndihmon konkretisht në deshifrimin e literaturës bashkëkohore si dhe motivon një qëndrim të ndërgjegjësuar në ekzekutim.

Fjalë çelës: solfezh, vlera irracionale, progresion gjeometrik.

Hyrje

Ritmi si element bazik i gjuhës muzikore, në kuptimin si bashkësi formuese dhe karakterizuese, është shprehje e energjisë dhe dinamikës së vazhdueshme përgjatë rrjedhës kohore të një vepre, por në kuptimin si nocion stilistik koncepti ritëm rrok tiparet themelore të një kulture (ritmi sasior [kuantitativ] i periudhës antike greko-latine, ritmi theksor i periudhës së mesjetës, barokut dhe klasicizmit). Në procesin formues të studentëve muzikantë edukimi ritmik si objekti kryesor i disiplinës së solfezhit, në bashkëveprim me elementet e tjera, merr përparësi të njëjtë me edukimin melodik dhe harmonik. Veçanërisht ai u shërben interpretuesve për ruajtjen e korrektësisë në deshifrimin me objektivitet të partiturës muzikore. Ku-

mtesa nuk pretendon të rivierësojë përkufizimet teorike. Nga periudha he-lenistike deri në shekullin XIX teoricienë të shumtë kanë kontribuar në pasurimin gjithëpërfshirës të kuptimit të tij në rrafshin teorik, psikologjik e estetik. Duke e konsideruar të ezauruar këtë çështje, e njëkohësisht duke e vlerësuar rëndësinë e edukimit ritmik në parametrat e duhur, dëshiroja prej kohësh të ofroja përvojën personale në rrafshin metodologjik me zgjidhje teoriko-praktike origjinale, përftuar në 34 vjet përvojë pedagogjike në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve Tiranë.


Metodologjia e edukimit të saktësimit ritmik, që tashmë e ka kaluar sprovën e suksesit, mbështetet kryesisht në ndërgjegjësimin teoriko-praktik bazuar në metodën e krahasimit, përgjithësimit, analizës dhe sintezës, krejt në të kundërt me metodën intuitive spontane, që rëndom ndeshet në shkolat tona.

Para parashtrimit të temës e shoh të domosdoshme, për interesin që paraqet, të ndalem në metodologjinë e edukimit ritmik të figurave të rregullta (racionale), që jo vetëm i paraprin çështjeve në vijim, por e vlerësoj si çelësin e zgjidhjeve teoriko-praktike në interpretimin e figurave të parregullta (irracionale).

1-Reduktimi i shumësisë së figurave ritmike të rregullta, faktor i rëndësishëm orientimi

Për një orientim teorik dhe saktësim praktik, pasurinë e figurave ritmike në 20 shekuj muzikë i kam reduktuar në formatimin e tetë figurave racionale, të cilat i përkasin vlerës katërshe, si vlerë e përbashkët për metrat $\frac{2}{4}$; $\frac{3}{4}$; $\frac{4}{4}$. (Shembulli 1)

Shembulli nr.1



Si gjetje origjinale ky formatim në përshtatje me vlerat e tjera bëhet faktor i rëndësishëm orientimi e ndërgjegjësimi në procesin e realizimit praktik të figurave më të ndërlikuara. Në këtë kuptim, ai merr vlerën e një kontributi teorik.

Ndërsa me orientimin e solfezhimit parlato bazuar jo në lëvizjen e dorës sipas skemave tradicionale klasike dirizhoriale, por në goditjen e vlerës katërshe, duke këmbëngulur rigorozisht pulsimin me kohëzgjatje të barabartë të nënndarjes së saj në dy vlera tetëshe, mbi bazën e së cilës realizohet leximi i tetë figurave, kontribuohet praktikisht në saktësinë e edukimit ritmik. Pas përvetësimit të rrahjes së tyre në mënyrë të ndërgjegjësuar, shumë shpejt studenti krijon shprehinë dhe shkathtësinë e duhur.

Duke marrë parasysh progresionin gjeometrik të nënndarjes së vlerave, formatimi përcillet te vlera e plotë, gjysëm, tetëshe e gjashtëmbëdhjetëshe, me të njëjtin princip formati. Në këtë mënyrë përftohen 32 figura në dukje të reja, të zmadhuara apo të zvogëluara në vlerë një ose dy herë, të cilat përvetësohen me lehtësi, pasi ruajnë të njëjtin princip, të njëjtën renditje dhe të njëjtën mënyrë rrahjeje. Nëse do të shtonim në këto figura edhe përdorimin e pushimeve dhe lidhjeve përkatëse, apo dhe kuadrin e plotë të metrikes së thjeshte binare (dy pjesëtuese) si: $\frac{2}{2}$; $\frac{3}{2}$; $\frac{4}{2}$; $\frac{2}{8}$; $\frac{3}{8}$; $\frac{4}{8}$, numri i figurave ritmike shumëfishohet, për pasojë studenti ndihet nën presionin numerik, duke u shoqëruar me vështirësi të shumta mosnjohjeje në realizimin e tyre praktik. Bazuar në metodologjinë e parashtruar më sipër, gjithçka bëhet e thjeshtë, pasi orientimi teoriko-praktik ndjek principin e tetë figurave të para.

Po kështu veprohet edhe në formatimin e figurave ritmike të metrave të përbërë trinarë (tripjesëtues) $\frac{6}{8}$; $\frac{9}{8}$; $\frac{12}{8}$; $\frac{15}{8}$ apo në shumëfishin e vlerës së tyre $\frac{6}{4}$; $\frac{9}{4}$; $\frac{12}{4}$, me të vetmin ndryshim që në pulsimin e goditjes apo rrahjes metrike vlerës katërshe i shtohet tetëshja e tretë. (Shembulli 2)

Shembulli nr.2

Shumësia e figurave në:

	Metrikën e thjeshtë				Metrikën e përbërë			
I								
II								
III								
IV								
V								
VI								
VII								
VIII								

Tetë figurat e vlerës katërshe vumë re që gjeneruan një pafundësi figurash ritmike, të cilat përvetësohen krejtësisht natyrshëm, pa vështirësi, pasi procesi i nxënies nuk është më intuitiv dhe empirik, por produkt i vetëdijshëm bazuar në të njëjtën logjikë racionale dhe sens orientimi si për tetë figurat e para.

Reduktimi i shumësisë së figurave ritmike racionale vetëm në tetë, nëpërmjet kësaj metodologjie ofron:

Së pari - E panjohura vjen me ndërmjetësinë e së njohurës dhe e ndërlikuara shfaqet si dukuri e thjeshtë në teori dhe në zbatimin praktik.

Së dyti - Metoda e rrahjes dhe solfezhimi parlato i figurave veç kësaj edukon: a) pulsimin e vlerave të vogla, duke rritur ndjeshëm disiplinën ritmike, b) ndihmon forcimin e kujtesës muzikore, c) realizon theksimin e rrahjes së parë dhe diferencën e mbështetjeve midis batereve të tjera dhe levareve brenda masës, duke frenuar anarkinë emocionale ritmike e duke i lënë rrugë të hapur lirisë së shprehjes dhe qetësisë së frymëmarrjeve.

2- Klasifikimi i figurave të parregullta (irracionale) në dy kategori

Literatura muzikore e fundshekullit XIX dhe ajo e shekullit XX në kërkim të performancave të reja stilistike dhe estetike ofron një pasuri figurash ritmike irracionale, të drejtpërdrejta e të kontraktuara, poliritmike e asimetrike, të cilat rrisin dukshëm shkallën e vështirësisë në interpretim. Realizimi praktik i tyre kushtëzon përgatitjen gjithëpërfshirëse të studentëve me problematikat dhe zhvillimet bashkëkohore të gjuhës muzikore, ku ndërmjet të tjerave një vend të rëndësishëm zë edukimi ritmik.

Duke ndjekur të njëjtën metodologji rrahjeje si në figurat e rregullta racionale, kam ofruar zgjidhje teoriko-praktike origjinale lehtësisht të adaptueshme, pa cenuar rolin dhe karakterin e tyre asimetrik.

Në rrafshin teorik klasifikimi i tyre në dy kategori dhe nëndarja e vlerave irracionale me progresion gjeometrik si ajo e vlerave racionale, është një qëndrim i patrajtuar më parë në traktatet teorike.


Në zbatimin praktik zgjidhja shoqërohet me rezultate të konsiderueshme edhe në nivele të diferencuara studentësh.


Në kategorinë e parë klasifikohen figurat e parregullta formatuar sipas modelit të figurave të rregullta racionale, si: duola, kuartola, triola dhe sekstola. Dy të parat janë racionale për metrikën e thjeshtë dhe bëhen të parregullta për metrikën e përbërë. Dy të tjerat janë racionale për metrikën e përbërë dhe kthehen të parregullta për metrikën e thjeshtë.

Në kategorinë e dytë klasifikohen figurat të parregullta që janë të tilla si për metrikën e thjeshtë po ashtu edhe për atë të përbërë, si: kuintola, septola, nonola etj. (Shembulli 3)


Shembulli nr. 3

Racionale Irracionale

gr. a) $\frac{2}{4}$  $\frac{6}{8}$

gr. b) $\frac{6}{8}$  $\frac{2}{4}$

Irracionale

gr. b) $\frac{2}{4}$  $\frac{6}{8}$

Një prej teorive dhe metodologjive italiane, ajo e Ettore Pozzoli-t, ekzekutimin e figurave të grupit të parë e realizon me ndryshimin e karakterit metrik të lëvizjes nga binar në trinar dhe anasjelltas, e lehtë si mënyrë, pasi figurat irracionale nuk janë më të tilla, por lë vend për spekulim dhe humbet domethënien e figurave irracionale. Metodistët francezë triolat e zmadhuara në vlerë si ato me vlerë tetëshe apo katër-she i realizojnë nëpërmjet kontraktimit të figurave të triolave me vlera të vogla. (Shembulli 4)


Shembulli nr. 4



E drejtë si mënyrë, por kërkon një ndjeshmëri shumë të lartë ritmike për të siguruar korrektësinë në interpretim, ndonëse ajo ka përsëri karakter subjektiv dhe intuitiv.

Në metodologjinë që kam praktikuar kërkoj të edukoj ndjesinë e poliritmikës. Studenti realizon njëherësh edhe ndarjen e lëvizjes metrike në dy segmente të barabarta vlerash dhe solfezhon tri vlera të barabarta të triolës. I tërë procesi bazohet në një nënndarje shumë të saktë racionale, duke kufizuar maksimalisht qëndrimin empirik intuitiv. Vështirësia tejkalohet nga përpjesëtimi brenda llojit të figurave irracionale të të dy klasifikimeve, duke ndjekur progresion gjeometrik, element ky që e bën të vetëdijshëm qëndrimin e mbajtur në ekzekutim dhe lehtëson kuptimin veçanërisht në rastet e ndërlikuara të kontraktimit e të zmadhimit. (Shembulli 5)

Shembulli nr. 5



Së pari - Kjo tabelë qartëson momentet e interpretimit të triolave me vlerë të ndryshme sipas lëvizjes së dorës ↓↑ (batere / levare) me të cilën studenti rreh metrin.

Së dyti - Nëpërmjet saj vëmë re rregullsinë e barazisë të përpjesëtimit të vlerave irracionale me progresionin gjeometrik. (Shemb. 6).

Shembulli nr.6



Ky formulim teorik gjen zbatim adekuat në të gjitha figurat e parregullta të të dy grupimeve e njëkohësisht ndihmon e hedh dritë edhe në kuptimin e realizimit praktik të kontraktimit të tyre. Shembulli 7 është tregues i qartë i poliritmikës dhe veçanërisht i realizimit praktik.

Shembulli nr.7



Të gjitha këto figura e gjejnë veten e tyre si figura të rregullta në lëvizjen metrike $\frac{6}{8}$ por nuk janë aspak të ngjashme në solfezhim në metrekën e thjeshtë $\frac{2}{4}$. Krahasimi figurativ është i ngjashëm, por, në bazë të arsyetimit të mësipërm, interpretimi ka diferencë.

Parashtruar paraqitjen e plotë të triolave në të gjitha vlerat, format e shumta që ato marrin veçanërisht në krijimtarinë e shekullit XX, mënyrën sesi duhen interpretuar ato, përmes së cilës sigurohet si fakt racional saktësimi ritmik e njëkohësisht përplasja asimetrikeritmike e raportit 2 me 3. U konkretizua sesi ndërgjegjësimiti teoriko-praktik shërben për edukimin e poliritmikës, aq prezente në veprat kontemporane. Dinamizmi që buron nga kontrasti i kombinimeve poliritmike, veç të tjerave, është një tipar stilistik që dallon krijimtarinë muzikore të Stravinsky-it, Ligeti-it, Boulez-it etj.

3 – Figurat e parregullta (irracionale) me formim irracional

Grupimet ritmike me 5, 7, 9 dhe 11 nota konsiderohen të parregullta për nga formatimi, sepse nuk janë përpjesëtime as të vlerave të metrave të thjeshtë dhe as të vlerave të metrave të përbërë. (Shembulli 8)


Shembulli 8




Deri tani u morëm me interpretimin teoriko-praktik të triolës, por një rregull që të legjitimojë pretendimin e formulimit teorik duhet të gjejë zbatim edhe në figurat irracionale të klasifikuara në këtë kumtim në kategorinë e dytë “praktika, kriteri i së vërtetës”. Tabela në vijim vërteton si nëndarjen e vlerave irracionale me progresion gjeometrik, po ashtu dhe koherencën e njëjtë të realizimit të tyre praktik si në figurat irracionale të grupit të parë. (Shembulli 9)

Shembulli nr. 9


a) Nënndarja rracionale e vlerave të kuintolës



b) Mënyra e interpretimit të septolës



c) Format e ndryshme të kuintolës dhe septolës të kontraktuara



Kështu vepohet edhe me figurat e tjera ritmike irracionale të grupimit të dytë, si nonola, undecimola etj.

Përfundime

1. Përkufizimet teorike të lartpërmendura dhe metodologjia praktike ishin të barazvlefshme për të dy klasifikimet e figurave të parregullta në të gjitha pamjet e tyre; të zmadhuara apo të zvogëluara një ose dy herë në vlerë, të kontraktuara, e të zbatuara në rastet e metrikës së thjeshtë dhe të përbërë.

2. Ky proces teoriko-praktik edukon në mënyrë masive, e jo vetëm te studentët shumë të talentuar, korrektësinë ritmike, forcon disiplinën artistike, ndihmon kapërcimin e dobësive dhe ndërjegjësimi shpejton kohën e përvetësimit.

Bibliografia

- Chailley, J. Challan, H. (1957), *Théorie complète de la musique*, Première cycle, Deuxième Cycle. Paris; Éditions Musicales, Alphonse Leduc.
- Gervais, Françoise (1967), *60 Leçons de solfège rythmique*, Paris; Éditions Henry Lemoine.
- Hindemith, Paul (1983), *Teoria musicale e solfeggio*, Milano; Edizioni Suivini Zerboni.
- Lejet, Edith (1985), *La précision rythmique dans la musique*, Paris; Éditions Musicales Hortensia.
- Lejet, Edith (1987), *Le rythme appliqué*, Paris; Éditions Musicales Hortensia.
- Pozzoli, Ettore (1987), *Solfeggi parlati e cantati*, Appendice al III Corso. Milano; Casa Ricordi.
- Pozzoli, Ettore (1969), *Solfeggi parlati e cantati*, I, II, III Corso. Roma; BMG Ricordi.
- Rhythm.(2001).*The New Grove Dictionary of Music and Musicians* (Vol.21, f. 277-301).New York: Oxford University Press.
- Rossi, Luigi (1977), *Teoria musicale*, Bergamo; Casa Musicale Edizioni Carrara.
- Coppin, Suzanne, (1986), *Lectyres Rythmiques – Degré supérieur*, Paris; Édition Musicales, Alphonse Leduc.

Ilijana DEMA, Universiteti i Arteve, Tiranë

FOR A RATIONAL APPROACH IN THE INTERPRETATION OF IRRATIONAL RHYTHMIC FIGURES

Summary

Musical literature of the 20th century requires, among other things, comprehensive preparation of students with the rhythmic problems, especially within the context of contemporary development.

My own experience has led me to original solutions, both theoretical and practical, which I would group as follows:

1. The classification of irrational figures under two categories: a) irrational figures, formatted according to the model of rational figures of different metrics, b) irrational figures for both metrics

2. The proportion within the types of irrational rhythmic groups with geometric progression

3. Systematic attract of attention in the awareness of the pulsation of the eighth note on the beat of simple and compound metrics, as a shaping factor of polyrhythmic and asymmetric habits

These theoretical and practical solutions, have passed the test of success over the years, not only to overcome the weaknesses of students, but also in a broader context, their effectiveness feels like concrete assistance in deciphering contemporary musical literature and also motivate a conscious approach to musical performance.

PËRVJETORË

Hivzi ISLAMI, Kryetar i ASHAK-ut

ME RASTIN E 5-VJETORIT TË PAVARËSISË SË KOSOVËS¹

Jemi tubuar sot këtu, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për ta shënuar 5-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, shtetit më të ri në botë, me një koncert solemn. Më lejoni që me këtë rast t'i them disa fjalë.

Kombi shqiptar brenda harkut kohor njëshekullor, përveç anëve të dhimbshme, pati dhe dy shpërthime produktive, që u hapën rrugë shqiptarëve për jetë autonome e të pavarur, për shtetësi e sovranitet, për zhvillim e prosperitet të gjithmbarshëm. Më 28 Nëntor 1912 Shqipëria “bâhet në vehte, e lirë e e mosvarme”, ndërsa pas 96 vjetësh, erdhi edhe një ditë tjetër historike për Kosovën dhe shqiptarët, 17 Shkurti i Madh, 2008 - dita e pavarësisë dhe e sovranitetit të Kosovës. Brezat luftuan për më shumë se pavarësia e Kosovës, por rrethanat ndërkombëtare dhe kapacitetet tona ishin ato që ishin. Edhe kjo ditë për Kosovën e ndrydhur e të dërmuar me shekuj nga perandori e regjime të egra, nuk do të vinte pa mbështetjen e fuqishme ndërkombëtare, para së gjithash të SHBA-ve dhe NATO-s.

Viti i Madh jubilar – 100-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë – u kremtua nga të gjithë shqiptarët kudo që gjendeshin, në truallin gjeoetnik dhe në diasporë. Akademia jonë këtë përvjetor e shënoi me 5 aktivitete të dendura e dinjitoze: Akademia jonë këtë përvjetor e shënoi me 5 aktivitete të dendura e dinjitoze: 3 aktivitete bashkë me Institutin e Historisë - 100-vjetorin e themelimit dhe të ekzistimit të Shoqatës Panshqiptare “Vatra”, Akademisë – kujtesën historike, kushtuar 100-vjetorit të mbajtjes së Kuvendit të Junikut, Konferencën Shkencore dyditore, duke e përmbyllur me dy aktivitete artistike: Ekspozitën e veprave pamore të autorëve shqiptarë dhe Koncertin solemn me vepra të kompozitorëve dhe interpretëve muzikorë mbarëkombëtarë.

Në vitin 1912 Kosova me viset përreth mori dy goditje të rënda: e para, u nda dhunshëm nga trugu shtetëror-politik, nga Shqipëria politike, dhe e dyta, ndodhi okupimi klasik nga Serbia. Këtë gjendje, të arritur me dhunë dhe terror, fatkeqësisht, e verifikuan të gjitha konferencat ndërkombëtare paqësore, nga ajo e Versajës (1919), e Parisit (1946), e Brukselit (1990), e Hagës (1991), e Londrës (1992) deri te Konferenca e Dejtonit (1995), duke e favorizuar jashtë çdo mase Serbinë. Spiralja e dhunës, e krimeve

¹ 15.02.2013

të lahtarshme mbi popullatën shqiptare dhe dëbimi i saj me mjete gjenocidale, me fluktuime kohore, nuk patën të ndalur deri në gjysmën e vitit 1999 kur intervenoi forca më e madhe ushtarake në botë.

Gjatë gjithë shekullit XX tragjeditë e mëdha që i përcollën shqiptarët jashtë Shqipërisë londineze në rrafshin kombëtar, politik, ekonomik, social, familjar etj. janë ndarjet e imponuara e të dhunshme. Territori shqiptar jashtë kësaj Shqipërie midis dy luftërave botërore u copëtua në tri banovina. Gjatë LNÇ-së u nda në tri zona okupuese, ndërkaq pas saj Kosova, kundër vullnetit të popullit shumicë, në korrik të vitit 1945 u fut me forcë ushtarake nën Serbi/Jugosllavi si “krahinë autonome” (autonomna oblast), me status politik-konstitucional më të ulët se të Vojvodinës. Me këtë pozitë mbeti deri në Kushtetutën e tretë të Jugosllavisë (1963), kur u barazua me Vojvodinën dhe shqiptarët nga statusi i pakicës u avancuan në kombësi, që do të thotë se prapë mbetën qytetarë të dorës së dytë. Territorët e tjera, të banuara me shqiptarë, mbetën në tri republika të tjera, me status të kombësisë.

Me ndryshimet e mëdha politike në kreun e ish-shtetit në vitin 1966, pasuan ndryshimet të tjera. U hapën mundësi për ndryshime kushtetuese dhe u nxorr Kushtetuta e vitit 1974, me të cilën u forcua subjektiviteti konstitucional-juridik e politik i Kosovës deri në një lloj pavarësie nga Serbia, me të drejtën e vetos në ish-Federatë. Por pas vitit 1981 pasoi ndërhyrja politike e policore e Serbisë dhe e organeve të ish-Federatës Jugosllave, e përcjellë nga një represion policor e ushtarak, me qëllim të suprimimit të kësaj Kushtetute dhe vënies së Kosovës përsëri nën juridiksionin e Serbisë, gjë që ndodhi në vitin 1989, me dhunë policore dhe ushtarake.

Si reagim ndaj terrorit shtetëror, suprimimit me dhunë të gjendjes kushtetuese dhe vendosjes së gjendjes okupuese e koloniale, si dhe ngjarjeve në krah të ish-Jugosllavisë (referendumet për pavarësi), Parlamenti i Kosovës më 2 korrik 1990 shpalli Deklaratën Kushtetuese për Pavarësi, që u hartua nga Akademia jonë, ndërsa më 7 shtator 1990 shpalli në Kaçanik Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prej 26-30 shtator 1991 u mbajt Referendumi për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, ndërsa më 24 maj 1992 u mbajtën zgjedhjet parlamentare e presidenciale. Duke u udhëhequr nga parimet e proklamuar të bashkësisë ndërkombëtare, përfshirë edhe miqtë e sinqertë, me fuqi vendimarrëse, projekti i lëvizjes politike shqiptare ishte që problemi i Kosovës të zgjidhej me mjete paqësore. Por këto sakrificat nuk u shpërblyen nga bashkësia ndërkombëtare.

Me indiferencën ndaj dhunës dhe me pranimin e gjendjes faktike, të krijuar pas suprimimit të autonomisë federale, Evropa dhe bashkësia ndërkombëtare e pranin politikën e aktit të kryer, që e kurajonte Serbinë për sjellje edhe më agresive ndaj shqiptarëve, të cilët u detyruan të kalonin nga kursi paqësor në luftë të armatosur. U jemi

shumë mirënjohës të gjithë atyre që luftuan me pendë dhe armë dhe dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, sikundër që e falënderojmë shumë diasporën tonë që luajti një rol shumë të madh për këtë objektiv përmes ndihmave materiale, morale dhe ushtarake dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës.

Gjendja e nderë dhe shumë e dhimbshme për shqiptarët e Kosovës mori fund me hyrjen e trupave të NATO-s më 12 qershor 1999, në mbështetje të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, kur Kosova u vu nënën protektorat ushtarak dhe civil ndërkombëtar: KFOR-i, që mbeti autoritet i respektuar nga qytetarët, dhe UNMIK-u, pa ndonjë autoritet. Sipas kësaj Rezolute, Veriu i Kosovës mbeti territor kontestues dhe konfrontues midis Kosovës dhe Serbisë!

UNMIK-u nga fillimi ishte strukturë konfuze dhe jofunksionale. Përgjegjësitë që i mori, nuk i përmbushi, çfarë ishin reformat demokratike, ndërtimi i institucioneve, zhvillimi ekonomik, procesi i privatizimit, sundimi i ligjit, pengimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar etj. Me një mandat të pakufizuar, mjetet e Kosovës, të grumbulluara në fonde të caktuara, i dërgoi në banka të huaja, ku gjenden edhe sot dhe po gëlltiten nga kriza globale.

I paaftë për t'i zgjidhur problemet në terren, bëri planin për ndarjen e Kosovës në vija etnike – enklavizimin, ndonëse deklaronte se është kundër fragmentimit territorial të Kosovës; i toleroi strukturat e Serbisë në veri dhe bojkotimin e institucioneve të Kosovës në të gjitha nivelet nga serbët, të cilëve u dha privilegje të papara përmes diskriminimit pozitiv, edhe pse nuk paguanin as taksa në buxhetin e Kosovës, as rrymë, as ujë, as telefon.

Në mars të vitit 2004 ndodhën ngjarjet tragjike dhe me pasoja të rënda, të cilat kurrë nuk u ndriçuan! Pas tyre nisën bisedimet e Vjenës, nga të cilat rezultoi Plani i M. Ahtisarit. Në mbështetje të këtij plani, Kosova u pavarësua më 17 shkurt 2008, por nën mbikëqyrje të bashkësisë ndërkombëtare. Plani shoqërohej me propozimin për krijimin e komunave të reja serbe dhe decentralizimin e pushtetit, ku serbët e Kosovës, me 4-5% në popullsinë e përgjithshme të saj, do të kenë privilegje të papara në Evropë dhe në botë, siç e thoshte edhe vetë zv. i M. Ahtisarit, z. Albert Rohan.

Ky Plan, u bë pjesë e dokumenteve ndërkombëtare, duke marrë verifikimin e OKB-së dhe në vitin 2008 me shumë lehtësi u fut dhe në Kushtetutën e Kosovës. Në takimet e Vjenës 2005-2007, ku u vunë suazat bazë për zhvillimet e mëvonshme, kërkesat e popullatës shumicë të hapësirave përkatëse në Kosovë as që u shtruan nga ana e liderëve shqiptarë të Kosovës, e aq më pak ato të shqiptarëve të Luginës së Preshevës! Në asnjë rast nuk u përmend as emri i Luginës, as i shqiptarëve të atjeshëm! Edhe sot Lugina vazhdon të mos trajtohet si çështje ndërkombëtare, madje as e barabartë me Veriun e Kosovës.

Në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë më 22 korrik të vitit 2010 Kosova arriti një sukses të madh, kur ajo gati unanimisht, vendosi që me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës nuk është shkelur e drejta ndërkombëtare. Por kjo fitore nuk u shfrytëzua sa duhet në procesin e njohjeve ndërkombëtare, për çka tërhoqi vërejtjen edhe vetë z. Ahtisari në një takim me përfaqësues të Akademisë sonë vitin e kaluar.

Ndërkaq, më 10 shtator 2012 ndodhi edhe një kërcim pozitiv: përfundoi procesi i mbikqyrjes ndërkombëtare. Punët dhe përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës u rritën edhe më shumë. Problemet dhe sfidat e tyre mbetën në radhë të parë në mbrojtjen e tërësisë territoriale të shtetit, në zhvillimin ekonomik, në sundimin e ligjit, në mposhtjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si kushte kryesore për t'u integruar në BE etj. BE-ja vuri kushte Kosovës, vështirë të përballueshme edhe për vendet e zhvilluara të Evropës. Kosova dhe brenda saj shqiptarët si shumicë, në lëvizjen e lirë brenda Evropës së diversifikuar dhe kontrastive në shumë drejtimeu, mbetën më të izoluarit! BE-ja vepron me standarde të dyfishta! Prandaj lufta jonë për të vërtetën, për drejtësi dhe miq duhet të vazhdojë më energjikisht.

Pas mosuksesit të UNMIK-ut, një rol në sundimin e ligjit dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar pritej ta luante EULEX-i, por edhe kjo instancë, e ftuar nga institucionet e Kosovës, mjerisht nuk u tregua shumë efikase në këtë mision. Fitoret në paqe, në kuptimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, të demokratizimit të jetës në tërë kompleksitetin e tij, të ekonomisë së tregut, të respektimit të të drejtave të njeriut, sot nuk janë fare të lehta. Presidenti Klinton menjëherë pas luftës (1999), në Ferizaj, na la porosinë: "Ne e fituam luftën, ju fitoni paqen"! Ky mesazh i tij, i thellë përmbajtësisht, duhet të jetë udhërrëfyes i përhershëm për ne.

Rikomponimi i brendshëm territorial i Kosovës edhe sot vazhdon të mbetet një kaptinë e hapur deri te kërkesa e Serbisë zyrtare për pavarësinë e Veriut të Kosovës në formë të një entiteti autonom serb dhe për pavarësinë territoriale-administrative të enklavave të brendshme serbe, së bashku me monumentet e tyre fetare, hinterlandi territorial i të cilave po zgjerohet kundërligjshëm! Kjo kërkesë e Serbisë, që po udhëhiqet nga njerëzit e Millosheviqit e të Sheshelit, mjerisht po mbështetet edhe nga disa qarqe ndërkombëtare, veçanërisht nga disa kancelari evropiane, qëndrimi i të cilave nuk po evoluon pozitivisht ndaj çështjes së Kosovës dhe shqiptarëve.

5-vjetori i Pavarësisë së Kosovës për nga dimensionin kohor duket një jubile i vogël, por nuk ka asnjë dyshim se është tejet i madh për jetën tonë kombëtare, politike dhe shoqërore. Shteti më i ri në botë u krijua me shumë përpjekje, sakrificë dhe viktima. Dhe, me gjithë defektet e funksionimit të tij, Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran tashmë e pranuan më se gjysma e vendeve, anëtare të OKB-së, ndër të cilat edhe shtetet më të mëdha dhe më të fuqishme në planin politik, ekonomik, diplomatik dhe ushtarak

në botë. Shpresojmë që trendi i njohjeve të intensifikohet këtë vit. Urojmë gjithashtu që edhe jeta jonë të begatohet në dobi të mirëqenies dhe lumturisë. Prandaj jemi mbledhur sonte këtu, në mjediset e Akademisë, për ta shënuar këtë jubile me një Koncert solemn, të organizuar nga Seksioni i Arteve të Akademisë sonë, nën udhëheqjen artistike të akad. Zeqirja Ballatës. Urime dhe faleminderit.

Akademik Hivzi ISLAMI

KONFERENCA SHKENCORE “PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE KOSOVA
100 VJET PAS”¹

Kolegë dhe miq të nderuar,

Zonja dhe zotërinj,

Jemi në një vit të madh jubilar – në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe këtë sot e di çdo shqiptar kudo që gjendet, në truallin gjeoetnik dhe në diasporë.

Me Konferencën e sotme shkencore **“PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE KOSOVA 100 VJET PAS”**, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Instituti i Historisë i Prishtinës i vazhdojnë aktivitetet për shënimin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, sikundër që aktivitete të dendura për këtë qëllim janë duke zhvilluar Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë i Tiranës, Qendra e Studimeve Albanologjike etj. Më 25 prill Akademia jonë dhe Instituti i Historisë i Prishtinës shënuan 100-vjetorin e themelimit dhe të ekzistimit të Shoqatës Panshqiptare “Vatra”, ndërsa më 21 maj 2012 organizuan Akademinë – kujtesën historike, kushtuar 100-vjetorit të mbajtjes së Kuvendit të Junikut. Në muajin tetor, ndërkaq, në nderim të këtij jubileu të madh, Akademia jonë do të organizojë veprimtari artistike.

Shekulli XX ishte shekull i kthesave dhe i proceseve të mëdha progresive të njerëzimit si rezultat i zhvillimit material e mendor të paparë deri atëherë, i të ariturave shkencore, i industrializimit të shoqërisë, i modernizimit të teknologjisë, i ekspansionit mjekësor e sanitar. Por ishte ky njëkohësisht edhe shekull i brutaliteteve e barbarive deri te ndërmarrjet gjenocidale në përmasa botërore (dy luftërat botërore), në rrafshin rajonal (konflikte e luftëra midis vendeve e popujve) dhe në nivel nacional (diktaturat vendore komuniste). Vendet dhe popujt në këtë shekull i cilësuan fluktuime në shkallë të ndryshme të evolucionit shoqëror: ngritje dhe rënie, suksese dhe dështime, ecje të organizuara dhe anarki, qeverisje demokratike dhe diktatoriale, ndarje të dhunshme të gjeografive etnike nga historitë etnike e kombëtare përmes forcës ushtarake dhe politikës së “spastrimeve etnike” etj.

Në përmasa rajonale sikur goditje më të mëdha jo vetëm këto 100 vjetët e fundit, por shumë më tepër, pati kombi shqiptar në gjithë hapësirën e tij etnike, ku shquhet lufta kundër faktorit demografik shqiptar përmes spastrimit etnik të shqiptarëve dhe kolonizimit të trojeve

¹ Fjala e hapjes në Konferencën shkencore “Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas”, 13-14 shtator 2012 në mjediset e ASHAK-ut.

të tyre me element sllav. Megjithatë, brenda këtij harku kohor, kombi shqiptar pati edhe shpërthime produktive. Pikërisht para 100 vjetëve Shqipëria "bâhet në vehte, e lirë e e mosvarme" – thuhet në Deklaratën e Pavarësisë të 28 Nëntorit 1912, të mbështetur dhe firmosur nga delegatët e të gjitha krahinave shqiptare dhe të të gjitha shtresave të tyre shoqërore dhe konfesionale. Mjerisht, kaloi një shekull dhe shumë çështje dhe zhvillime të kësaj periudhe mbetën pa u ndriçuar shkencërisht në shkallën e nevojshme. Të tilla janë proceset që i paraprinë aktit madhor, Pavarësisë së Shqipërisë, përfshirë kryengritjet e shqiptarëve të Kosovës dhe të trojeve të tjera etnike në tërë kompleksitetin e tyre si ngjarje të cilat i hapën rrugë dhe e përshpejtuan pavarësinë e Shqipërisë. Nuk u ndriçuan sa duhet as proceset, dhuna dhe plojat në trojet e mbetura jashtë Shqipërisë që pasuan pas vitit 1912, sikundër që nuk u studiua sa duhet as qëndrimi i fuqive të mëdha ndaj çështjes shqiptare para dhe pas pavarësisë së Shqipërisë.

Ajo që na është e njohur relativisht mirë këto 100 vjetët e fundit dhe shumë më herët, nga fillimet e Rilindjes Kombëtare, veçanërisht nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, është fakti se shqiptarët e të gjitha trojeve, me luftëra të armatosura e të përgjakshme, me penë, me luftëra politike e paqësore, sollën një ditë të madhe historike për Shqipërinë dhe shqiptarët, pavarësinë e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, sikundër që 100 vjet pas, shqiptarët e Kosovës sollën 17 Shkurtin e Madh të vitit 2008, ditën e pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës. Këto data të mëdha historike, pra, nuk pikën nga qielli.

Brezat luftuan për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet të përbashkët kombëtar, por rrethanat ndërkombëtare nuk ishin në favor të shqiptarëve. Dhe sot është momenti që në të dy rastet t'i falënderojmë dhe t'u jemi shumë mirënjohës brezave që luftuan dhe dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë që po e gëzojmë ne sot, për krijimin e dy shteteve shqiptare nga një komb, por t'i falënderojmë edhe qarqet dhe miqtë ndërkombëtarë, veçanërisht SHBA dhe kryetarët e tyre: Vudrou Vilsonin (1920), Bill Klintonin (1999) dhe Bushin e Ri (2008), që qenë faktorë me rëndësi në të dy pavarësitë.

Kur shqiptarët u gjetën para reziqeve si komb, pas vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit më 3 mars 1878, që shkonin në favor të Rusisë dhe shteteve sllave të Ballkanit, dhe vendimeve antishqiptare të Kongresit të Berlinit (1878), krerët e Lëvizjes kombëtare u vunë në krye të rezistencës për gjetjen e rrugëve për status të veçantë të trojeve shqiptare dhe për administrim autonom brenda Perandorisë Osmane. Për këtë qëllim shqiptarët formuan besëlidhjet, kuvendet, siç ishte Kuvendi i njohur i Junikut, i mbajtur nga 21-25 maj 1912, pastaj komitetet, klubet kombëtare dhe shoqëritë atdhetare me organet e tyre. Kulmi u arrit me themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në qershor të vitit 1878 dhe të Lidhjes së Pejës në fund të janarit 1899, me programe përparimtare politike, shoqërore dhe kulturore. Nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX aktivitet të madh kombëtar, kulturor dhe politik dhe rrjedhimisht për pavarësinë e Shqipërisë zhvilluan diaspora dhe kolonitë shqiptare. Federata

Panshqiptare "Vatra" e Amerikës ishte pa dyshim një zë i fuqishëm për identitetin, konsolidimin dhe pajtimin e kombit shqiptar. Edhe për pavarësimin e Kosovës diaspora jonë luajti një rol shumë të madh me ndihma materiale, morale dhe ushtarake.

Në funksion të autonomitetit, pavarësisë dhe emancipimit të përgjithshëm shoqëror e kulturor të shqiptarëve para 28 Nëntorit 1912 ishte dhe Kongresi i Manastirit në vitin 1908 për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe, të cilin e organizoi dhe financiarisht e ndihmoi klubi i njohur "Bashkimi" nga Manastiri. Mirëpo, rol vendimtar për pavarësinë e Shqipërisë luajtën kryengritjet e njëpasnjëshme të shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malësisë së Mbishkodrës në vitet 1910-1912, të cilat pastaj u shtrinë në gjithë territorin etnik shqiptar. Për kryengritjet e vitit 1912 politikanët objektivë evropianë të kohës theksuan se shqiptarët ishin ata që "i shembën pirgjet e Perandorisë Osmane mbi kokën e tyre. Janë shqiptarët ata të cilët i shpartalluan turqit, e jo serbët, as bullgarët dhe as grekët".

Viti i Madh 1912 ishte dhe vit që prodhoi pasoja të tjera të rënda për shqiptarët: në pikëpamje politike-shtetërore trangu gjeoetnik u nda, me ç'rast Kosova dhe viset përreth mbetën jashtë Shqipërisë politike. Pazarllëqet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitin 1913 e lanë Kosovën dhe viset e tjera etnike shqiptare jashtë Shqipërisë londineze, të okupuara nga Serbia me forcë ushtarake. Ushtria serbe bëri mizori të papara mbi shqiptarët. Për fat të keq, këtë gjendje të arritur me dhunë, e verifikoi Konferenca e Versajës në vitin 1919, duke e favorizuar jashtë çdo mase Serbinë. Hilet e disa vendeve evropiane dhe të Rusisë karshi çështjes shqiptare ishin shumë të hapëta dhe po të mos ishte presidenti i atëhershëm amerikan Vudrou Vilson, i cili kundërshtoi planet sekrete të Marrëveshjes së Francës dhe Anglisë të janarit 1920 për copëtimin e mëtejme të Shqipërisë, nuk do të ishte as kjo Shqipëri e sotme, e rrudhur në 28.748 km². Mirëpo, pa këtë Shqipëri, kështu të rrudhur, sigurisht se nuk do të ishte as kjo Kosovë, njëherë si një autonomi dhe sot si shtet i pavarur dhe sovran, por edhe pa Kosovën, nuk ka dyshim se nuk do të ishte as kjo Shqipëri.

Midis dy luftërave botërore gjendja e shqiptarëve jashtë Shqipërisë politike u përkeqësua edhe më shumë në çdo pikëpamje. Territori shqiptar u copëtua në tri banovina (e Moravës, e Zetës dhe e Vardarit), ndërsa popullsia iu nënshtrua përndjekjeve, shpronësimeve, shpërnguljeve të detyrueshme deri te shfarosja fizike. Gjatë Luftës II Botërore ky territor u nda në tri zona okupuese (italiane, bullgare dhe gjermane). Pas kësaj lufte nuk u bë bashkimi i hapësirës etnike shqiptare në një shtet të vetëm në frymën e Rezolutës së Bujanit (1943-1944), por Kosova, kundër vullnetit të popullit shumicë, në korrik të vitit 1945 u fut me forcë ushtarake nën Serbi/Jugosllavi si "krahinë autonome" (autonomna oblast), me status konstitucional-politik më të ulët se të Vojvodinës. Me këtë pozitë mbeti deri në Kushtetutën e tretë të Jugosllavisë (1963), kur u barazua me Vojvodinën, ndërkaq territoret e tjera shqiptare nuk iu bashkuan Kosovës, por mbetën në tri republika të tjera (të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi). Nga ndarjet e imponuara e të dhunshme pasuan tragjedi të mëdha në rrafshin

kombëtar, politik, ekonomik, social, familjar etj.

Fatkeqësisht, rikomponimi territorial i Kosovës mbi bazë të planeve të ndryshme vazhdon të mbetet një kaptinë e hapur deri të kërkesa e fundit e Serbisë zyrtare për pavarësinë e Veriut të Kosovës si entitet autonom serb dhe për pavarësinë territoriale-administrative të enklavave të brendshme serbe, së bashku me monumentet e tyre fetare. Kjo kërkesë mjerisht po gjenë mbështetje edhe te disa qarqe të caktuara ndërkombëtare.

Pavarësia e Shqipërisë dhe Dita e Flamurit erdhën në kontekstin shoqëror shqiptar me kundërtënie të mëdha dhe pa vizione të qarta për ardhmërinë e kombit. Pavarësia e Shqipërisë ndodhi në mjedisin e pazhvilluar e të paarsimuar, të diversifikuar në pikëpamje ideologjike, politike e fetare. Kjo gjendje lente mundësinë për ndërhyrje më të mëdha nga jashtë, çfarë ndodhi gjatë tërë shekullit XX (varshmëritë dhe nënshtrimet e njëpasnjëshme nga Austro-Hungaria, Italia, dy Jugosllavitë, BRSS-ja, Kina).

Katër Jugosllavitë, në dimensionet e ndryshme, hapësinore e politike, e Versajës më 1919, e Titos më 1945, e Millosheviqit e vitit 1992 dhe e Koshtunicës (Unioni Serbi-Mal i Zi) e vitit 2003, ashtu siç u krijuan mbi bazë të forcës ushtarake dhe të politikës hegjemoniste serbe, ashtu edhe u shkatërruan nga veprimi i konceptit unitarist e militarist. Meritë e shqiptarëve të Kosovës ishte se ditën ta gjenin veten në projektet dhe proceset e perëndimit me të cilat ra sistemi komunist dhe u shpërbë ish-Jugosllavia, sikundër që edhe forcat demokratike dhe antiënveriste në Shqipëri u ngritën kundër diktaturës së egër që e la vendin të izoluar dhe më të pazhvilluar në Evropë.

Jubileu i madh, 100 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë, dhe jubileu i 5- vjetorit të pavarësisë së Kosovës, janë edhe një moment për ryshqirtimin e shumë çështjeve të historisë, me ç'rast ngjarjet dhe personalitetet historike do të interpretohen dhe vlerësohen nga këndvështrimi objektiv shkencor, sepse diktatura komuniste në Shqipëri doli më e pamëshirshme ndaj rrjedhave të historisë, duke e mjegulluar, errësuar deformuar çdo gjë që lidhej me të kaluarën me qëllim dhe të ideologjizimit ta saj. Është kjo ekskluzivisht detyrë dhe kompetencë e historianëve. Këto dy jubile janë gjithashtu një rast që gjakftohtë, pa emocione e patetikë, të nxjerrin mësim nga pikat e pësimeve e dështimeve të qeverisjeve në të dy anët e kufirit dhe të reflektojnë për një qeverisje racionale e produktive dhe perspektivë të sigurt evropatlantike.

Pavarësia e shtetit duket sikur ndërtimi i shtëpisë, më lehtë bëhet e më vështirë mbahet. Punët dhe përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës filluan pikërisht më 17 shkurt 2008 dhe do të jenë edhe më të mëdha pas përfundimit të procesit të mbikqyrjes ndërkombëtare që ndodhi para tri ditëve. Problemet dhe sfidat e Kosovës mbesin në radhë të parë të përpjekjet për mbrojtjen nga invalidizimi i mundshëm territorial i shtetit, të mbrojtja nga grabitja e pasurisë kombëtare, të sundimi i ligjit, të lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, të angazhimi për jetë dinjitoze të qytetarit të Kosovës.

Shpresoj se kjo Konferencë shkencore, me çështjet që do t'i trajtojë në kuadër të temës bosht, me komplementaritetin në mes tyre, mbi bazë të argumenteve të reja shkencore, do të jetë shumë produktive në zbardhjen e një mori problemeve dhe zhvillimeve njëshekullore.

Engjëll BERISHA, Prishtinë¹

NJËQINDVJETORI I SHPALLJËS SË SHQIPËRISË NË ARTIN MUZIKOR

Njëqindvjetori i shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar dhe ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë, me 28 nëntor 1912, është festë e madhe e gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë edhe pse themelimi i shtetit të pavarur u shpall vetëm për gjysmën e territoreve shqiptare, ndërsa gjysma tjetër e popullit ngeli jashtë kufijve politik, të shtetit shqiptar.

Kjo festë e madhe e njëqindvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë është me nder dhe obligim për historianët, shkrimtarët dhe intelektualët e fushave të ndryshme, që të japin kontributin e tyre. Në këtë drejtim po organizohen tribuna e seanca shkencore si dhe shfaqje të ndryshme artistike në teatër dhe koncerte muzikore.

Lufta që ka bërë populli shqiptar gjatë historisë për çlirim, pavarësi dhe bashkim kombëtar është përcjellë edhe me këngë e forma të ndryshme në fushën e artit muzikor. Kujtesa e popullit tonë është ruajtur nëpërmjet këngëve popullore dhe këngëve të kompozuar me motive atdhedashëse. Mund të themi se nuk ka ngjarje të rëndësishme apo personalitete, të cilëve populli nuk u ka thurur vargje dhe melodi. Të gjitha të vërtetat historike të dëshmuara janë të kënduara dhe shumë nga to të ruajtura me vite dhe gati me shekuj.

Ndër këngët më të vjetra janë ato epiko-legjendare e historike. Temat e këngëve të tilla janë të mbështetura në luftën e pandërprerë që ka bërë populli deri në shpalljen e pavarësisë, e që vazhdon ta bejë madje edhe sot, për bashkimin e të gjithë shqiptarëve.

Ndër këngët më të vjetra historike që duhet përmendur janë këngët e shekullit XV për heroin tonë të madh Gjergj Kastriotin Skenderbeun që këndoheshin e që për fat të keq nuk janë ruajtur. Frang Bardhi në një shënim të tij nga shekulli XVII dëshmon se ka pasur këngë për këtë hero të madh. Edhe dijetari francez Ami Boué (shekulli XIX) ka shënuar se në Shqipëri ka pasur këngë për Skenderbeun, por për fat të keq ato janë zhdukur. Këngë patriotike që këndohen dhe që janë të popullarizuara si këngë korale janë: “Nën Skenderbeun”, dhe “Vdekja e

¹ Fjalë e mbajtur në Koncertin solemn me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Skenderbeut". Arbreshët e këndonin deri vonë këngën "Skenderbeu një Amanet".

Këngë të vjetra patriotike

Ka mjaft këngë të vjetra patriotike që janë ruajtur e që këndohen edhe sot. Ato u takojnë viseve dhe krahinave të ndryshme shqiptare. Ato këngë këndohen si nga veriu ashtu dhe në jug të trojeve shqiptare. Mes tyre ka këngë popullore anonime, por edhe me autorë, poetë patriotë.

Këngë të kësaj natyre, të ruajtura e shpesh të kënduara nga rapsodët popullorë janë këto: "Krisi pushka gjëmoj deti" (Shkodër), "Kërcet pushka e Bec Petanit" (Lezhë), "Shkullen malet jo pa gjak" (Dibër), "Hollë po qet povata ltime" (Gjakovë), "Ju nizamt e Shipërisë" (Kosovë), "Mua më thonë Mahmut Dac Klisi" (Kukës). Këto këngë që u shënuan u takojnë viseve shqiptare gege. Ato janë këngë njëzanore homofonike dhe këndohen me përcjellje të instrumenteve popullore si me lahutë, çifteli e sharki. Këngët më të njohura patriotike të toskëve të viseve të Shipërisë jugore e që këndohen në disa zanore, si këngë polifonike në dy, tre e madje rrallë edhe në katër zëra, janë: "Kurvelesh e Gegëri" (Gjirokastrë), "Gjarpëri që na ka zënë" (Gjirokastrë), "Mbeçë more shokë" (Skarpar) etj.

Këngë origjinale e të adaptuara nga kompozitorë shqiptarë

Përveç këngëve popullore anonime, disa prej tyre u përmendën më sipër, na paraqiten edhe këngë patriotike të poetëve, shkrimtarëve dhe kompozitorëve shqiptarë. Krijimtaria origjinale në fushën e artit muzikor u paraqit pak më vonë në krahasim me letërsinë, me poezinë e prozën shqiptare. Kompozitorët u paraqitën nga fundi i shekullit XIX. Ata kompozitorë të parë krijuan këngë e forma tjera modeste muzikore me tema patriotike. Mes këngëve origjinale dhe ato me tema patriotike po përmendim këto vepra vokale për solo ose këngë korale: "Për mëmëdhenë", me poezi të Mihal Gramenos, "O trima luftëtarë", këngë e Tanas Floqit, "Të gjithë ne o djema", me poezi dhe muzikë të Spiridon Ilos, "Vlora, Vlora" e Thoma Nasit, me poezi të Ali Asllanit, "Porsi fleta" e Martin Gjokës, me poezi të At Gjergj Fishtës. Këngë të njohura patriotike janë edhe këto: "Zëri i atdheut", "Një zë popullit", "Sa të rrojë gjithësia", "Mëma jonë Shqipëri".

Mjaft nga këngët e vjetra, janë të njohura e të popullarizuara dhe të ruajtura nga grupet korale dhe të kënduara në kore mikste në qendra kulturore e qytete siç janë Korça, Shkodra, Elbasani, Shkupi, Prizreni, ku ekzistonin ca amatorë të muzikës vokale. Në këtë drejtim një kontribut të mirë ka dhënë Gaqo Avrazi që përmbodhi këngët me titull "Këngë Patriotike", botuar nga Ministria e Kulturës në Tiranë më 1959. Aty gjinden 37 këngë patriotike. Këngë patriotike (34) botoi dhe ASHAK në Prishtinë më 2010 me autor Rauf Dhomin ku janë përfshirë edhe 14 këngë të autorit.

Këngët patriotike në Kosovë këndoheshin gjatë viteve 1941-45. Më vonë ato

nuk këndoheshin publikisht. Në Shqipëri këndoheshin për festën e 28 Nëntorit, ndërsa më rrallë për raste të tjera.

Këngët patriotike, qofshin ato popullore anonime ose të kompozuar me autorë, për solistë ose grupe korale, ishin të kapshme e të lehta për t'u kënduar. Më në fund, këto ishin mundësitë dhe nevojat aktuale të kohës. Melodia e tyre ishte dijatonike, pa kromatikë, kryesisht në tonalitet dur e më rrallë mol dhe pentatonikë. Ritmi ishte me nota të pikëzuara dhe shpesh me karakter marshi. Ato ishin këngë strofike, me refren dhe kishin tingëllim himnik. Harmonia i përgjigjej thjeshtësisë së melodisë, prandaj edhe ajo ishte jopretencioze, modeste, me harmoni kryesisht në gradat kryesore dhe me modulime të pakta. Edhe faktura formale ishte modeste në dy e tre pjesore. Taktet (masat) janë 2/4, 4/4 më rrallë 3/4 e 7/8. Përmbajtja e tyre me motive atdhedashurie, patriotike, me melodi e harmoni jopretencioze, i bëri këto këngë të dashura, shumë të kapshme për shumë amatorë intepretues dhe për popullin në përgjithësi që nga fundi i shekullit XIX e gjatë tërë këtyre 100 vjetëve nga shpallja e pavarësisë së shtetit shqiptar. Shumicën e këtyre këngëve të karakterit patriotik u mblodhën dhe u notuan, u harmonizuan dhe u adaptuan për nevojat e kohës, të përshtatura mundësive relativisht modeste të ansambleve amatore e më vonë edhe atyre profesionale. Për çështjen madhore në fushën e muzikës sonë artistike e patriotike kontribuan: Konstantin Trako, Abdulla Grimci (1913-1994), Koço Uçi, Eftim Dheri. Këngët e kompozuar me autorë me emër ishin të mbështetura në vargjet e poetëve tanë patriotë si Naim Frashëri, Pashko Vasa, Asdreni, Hil Mosi, Mihal Grameno, At Gjergj Fishta dhe të ndonjë tjetër autor i melodisë.

Muzika orkestrale

Muzika orkestrale për arsye të rrethanave jo të favorshme për popullin shqiptar zhvillohet më vonë se ajo vokale. Orkestrat e para u paraqitën në fund të shekullit XIX. Ato ishin orkestra frymore (banda si i quanin në Shqipëri). Orkestra e parë e këtij lloji u formua në Shkodër, më 1978, me dirigjent e kompozitor Palok Kurtin (1960-1920). Ky kompozitor e patriot është autor i marshit “Bashkimi i Shqypnisë” kompozuar në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, në vitin 1881. Kompozitori Martin Gjoka (1890-1940) kompozoi veprën orkestrale me temë patriotike “Dy lule mbi varrin e Skenderbeut”. Në Korçë veprori orkestra frymore “Banda e Lirisë” (1909), në Elbasan orkestra frymore “Afërdita” (1909), në Shkup orkestra frymore “Zani i Maleve” (1912).

Kompozime me tema patriotike për orkestrat simfonike si për shembull për Skënderbeun, janë kompozuar 2 vepra të rëndësishme orkestrale: poema “Skenderbeu” e patriotit me kulturë univerzale dhe muzikore Fan S. Noli (1882-1935) dhe 30 vjet më vonë, këtu në Kosovë kompozitori Fahri Beqiri kompozoi poemën simfonike, “Skenderbeu”.

Këto ishin ato vepra të pakta orkestrale që në përmbajtje kishin tema patriotike nga periudha të ndryshme, që i kushtoheshin heroit tonë kombëtar Skenderbeut.

Temat patriotike në veprat skenike

Motivet e atdheut, temat patriotike të shumë kompozitorëve shqiptarë janë bërë, do të thoshim, *conditio sine qua non*, pra kusht pa të cilin nuk bëhet. Përpos që motivet patriotike i shfrytëzuan shumë këngëtarë e kompozitorë për të kompozuar muzikë vokale, si këngë solo e korale dhe muzikë orkestrale, me këto motive janë kompozuar edhe ca vepra skenike si opera, ku motivi frymëzues është dashuria për popullin dhe luftërat që ai ka bërë gjatë historisë mbi njëqindvjeçare. Kështu, kompozitori korçar Kristo Kono (1907-1991) kompozoi operën “Lulja e Kujtimit” në vitin 1961. Liberto i operës është shkruar sipas romanit të Foçion Postolit. Tema kryesore e muzikës së operës është melodia e këngës “Për mëmëdhenë”. Ky është si lajt motiv i veprës ku flitet për luftën e patriotëve shqiptarë kundër grekofonëve-grekomanëve që vepronin në Toskëri.

Kompozitori kosovar Rauf Dhomi kompozoi operën “Goca e Kaçanikut” sipas novelës të Milto Sotir Gurrës. Në përmbajtjen e kësaj opere janë motivet e luftës së popullit shqiptar për pavarësi dhe të ruajtjes së tërësisë së tokave shqiptare.

Me rastin e kremtimit të 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut janë krijuar tri vepra, opera të rëndësishme skenike. Janë tri opera që u krijuan më 1968 me rastin e pesqindvjetorit të vdekjes së Skënderbeut: kompozitori shkodran Prenk Jakova (1917-1969), kompozoi operën “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”, Abdull Grimci kompozoi operën “Bijtë e Skenderbeut”, ndërsa Nikola Zoraqi (1929-1991) kompozoi operën me titull “Fundi i Golemëve”.

Me rastin e shënimit të pesqindvjetorit të vdekjes së Skenderbeut janë krijuar edhe disa vepra vokalo instrumentale të kompozitorëve këtu në Kosovë. Ato janë: “Skënderbeu ngadhjimentar” e Lorenc Antonit (1909-1991)”, këngë korale *accapella*, Mark Kaçinari (1935-1985) “Bijtë e Shqipës”, kurse Esat Rizvanolli (1936-2006) është autor i kantatës për solist kor dhe orkestër kamertal me titull “Fjala e Skënderbeut”. Zeqirja Ballata kompozoi këngën “Doli Skenderbeu” për kor masiv dhe recitaorë.

Një vepër poashtu e rëndësishme me temë popullore patriotike është poema vokalo instrumentale e kompozitorit Feim Ibrahim (1935-1997) me titull “Tanë Shqipëria asht betue pa gjak malet mos me i lshue”.

Është detyrë dhe obligim madhor në këtë vit jubilar patriotik që veprat e atdhedashurisë të këndohen e të interpretohen në mbarë trevat shqiptare, sidomos nga ansamblet profesioniste, si kori dhe Filarmonia e Kosovës dhe në institucionet arsimore e kulturore siç janë: shkollat, Fakulteti i Arteve (muzikës), shkollat muzikore dhe shoqëritë kulturo artistike. Shtëpitë televizive, në programet e tyre duhet t’u japin më shumë vend këtyre ngjarjeve historike të popullit shqiptar.

KRITIKA, RECENSIONIE

KOLEC TOPALLI: "GRAMATIKË HISTORIKE E GJUHËS SHQIPE", Tiranë, 2011, ff. 1737.

Rexhep ISMAJLI: VEPËR ME VLERË SINTETIZUESE¹

Të nderuar të pranishëm, po për-urojmë sot këtu një vepër të jashtëzakonshme të studimeve historike të gjuhës shqipe të autorit edhe më parë të njohur me ndihmesa të shumta e të çmuara shkencore në këtë fushë dhe jo vetëm, akademik profesor dr. Kolec Topallit. Denduria dhe intensiteti, pesha e ndihmesave me të cilat ai erdhi para opinionit shkencor albanistik brenda dy dekadave, nuk kanë dhënë shumë hapësirë për të sjellë shpjegime para nesh e opinionit për historinë dhe shfaqjen e personalitetit të Kolec Topallit në tërë formatin e tij në gjuhësinë shqiptare.

Akademik profesor dr. Kolec Topalli në studimet albanistike u shfaq për herë të parë më 1973 me një vështrim për çështjet atëherë aktuale të drejtshkrimit, për të vazhduar më ngjeshur në vitet '80 me studime për çështje të ndryshme të gjuhës shqipe, aktuale dhe historike, në revistat shkencore, dhe për t'u bërë dendësisht dhe gati befasishëm i pranishëm në këto studime me monografi për çështje të veçanta pas vitit 1995 dhe me dy vepra sintezë për fonetikën historike dhe për gramatikën historike me vetëm 4 vite ndërmjet – 2007, 2011. Fonetikën historike të shqipes ai e solli pas një dhjetëvjeçari shumë të frytshëm me 8 monografi për çështje të fonetikës historike, ndërsa këtë vepër të

madhe të studimeve të gramatikës historike vetëm 3 vjet më vonë. Edhe pse studimet dhe botimet i kishte nisur në vitet '70, ylli i Kolec Topallit shkëlqeu vetëm në periudhën pas rënies së diktaturës në Shqipëri. Ky fakt dhe elementet plotësuese nuk mjaftojnë për të shpjeguar intensitetin e pranisë së tij në botën albanistike të këtyre dy dekadave të fundit. Vetëm një energji e jashtëzakonshme, një vullnet i pashoq i tij i akumuluar gjatë e me durim, bashkëshoqërues gjatë gjithë jetës, mund ta shpjegojnë dendurinë, gjerësinë dhe cilësinë e kësaj shfaqjeje të vullshme në jetën shkencore shqiptare të këtyre dekadave. Elementet e biografisë së tij e nxjerrin në pah edhe më fuqishëm tërë peshën e kësaj shfaqjeje singulare.

Kolec Topalli ka lindur në qytetin me tradita të shquara kulturore e arsimore të Shkodrës më 1938. Vendosija e sistemit shoqëror komunist e gjeti atë 7 vjeç, në moshën që të fillonte shkollën, pra, t'i shtrohej tërësisht formimit sipas sistemit që synonte njeriun e ri socialist. Fati i tij u vulos nga rrethana të tjera: për shkak të arratisjes së vëllait të tij të madh dhe profesionit prej tregtari të babait ai bashkë me familjen qysh në moshën 10-vjeçare u gjet i internuar në Berat, pastaj në Tepelenë e më tej në Portopalamo dhe damka që iu vu atëherë do ta ndiqte atë deri në rënien e diktaturës. Me ngulmimin e pashoq ai ia doli që në ato rrethana të mbaronte shkollimin e mesëm pedagogjik në Shkodër më 1955 dhe të niste punën si mësues në fshatrat e Kukësit, pastaj të Lezhës. Pa u shkëputur nga puna, mbaroi studimet për gjuhë-histori në Institutin e Lartë pedagogjik të Shkodrës dhe pastaj për gjuhë-letërsi në USHT më 1964. U diplomua, por për arsye biografie në rrethin e Lezhës e pushuan nga puna. Më vonë e emëruan ar-

¹ Fjalët në vijim janë mbajtur me rastin e përrurimit të veprës së akademik Kolec Topallit: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011, në ASHAK, Prishtinë, 07.09. 2012.

simtar në fshatrat e Gramshit, ku qëndroi 7 vjet. Më 1971 e transferuan në fshatin Nikël të rrethit të Krujës, ku punoi deri më 1991. Edhe pse për një kohë nuk e gëzonte as të drejtën e botimit, ai i vijoi studimet me durim duke marrë gradën “kandidat i shkencave” më 1987, ndërsa gradën doktor i shkencave më 1992.

Nga viti 1991 u përfshi në zhbilimet e gjithmbarshme të vendit dhe shumë shpejt u emërua *Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit të Republikës*, ku qëndroi disa vjet. Më 2006 qe emëruar *këshilltar diplomat* në Ambasadën shqiptare në Romë, por në krye të një viti iu kthye sërish punës shkencore. Nga viti 1994 deri më 2009 ka dhënë leksione të fonetikës historike në fabuletin e Filologjisë të UT-së. Nga 1997 filloi punën në Institutin e Gjuhësisë në sektorin e Historisë së gjuhës, ndërsa nga 2008 është koordinator shkencor në QSA. Si studiues K. Topalli ka marrë pjesë aktive me ligjërata, konferenca shkencore e veprimtari të tjera në kongrese e konferenca kombëtare e ndërkombëtare në qendra dhe me raste të ndryshme të Europës, përfshirë dhe veprimtaritë në Prishtinë. Nga viti 2010 është anëtar shumë aktiv i KNGJSH. Për kontributin e tij në fushën e arsimit më 1993 është nderuar me titullin “Mësues i Popullit”, ndërsa për merita në fushën e shkencës më 1994 i është dhënë titulli “Drejtues Kërkimesh”. Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë është zgjedhur në vitin 2008. Është Rektor i Universitetit “Gjon Buzuku” në Shkodër. Për veprën *Fonetika historike e gjuhës shqipe* është nderuar me çmimet “Ekselencia shqiptare 2007” dhe “Çmimi i albanologjisë 2008”, ndërsa për librin që po promovojmë ka qenë fitues i çmimit të *Akademisë KULT 2012*.

Akademik Kolec Topalli deri sot ka botuar 15 vepra studimore-monografike, prej të cilave 10 në fushën e fonetikës historike (një e përkthyer italisht); këtë seri studimesh në fushën e fonetikës historike ai e ka përmbyllur me veprën sintezë *Fonetika historike e gjuhës shqipe* më 2007. Në fushën e gramatikës historike ai ka botuar katër vepra monografike: për përemrat, për nyjat, për sistemin e emrave dhe për sistemin foljor, për ta përmbledhur gjithë këtë punë me veprën sintetizues që kemi përpara – *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. K. Topalli ka botuar dy tekste universitare në fushën e historisë së gjuhës, ndërsa aktualisht po merret me fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe. Dhe të gjitha këto përmbledhen në një periudhë jo më të gjatë se 17 vjet. Energji vërtet e jashtëzakonshme.

Kjo paraqitje e përmbledhur e botimeve të tij e nxjerr para nesh profilin shkencor të akademik Kolec Topallit: duke u marrë gjithë jetën me historinë e gjuhës shqipe ai synon që këtë veprimtari ta përmbyllë me një sintezë të gjerë për historinë tingullore, për historinë gramatikore, tashmë të kryera dhe të botuara, dhe për historinë e leksikut në përfundim e sipër.

Angazhimet në jetën shoqërore K. Topalli i ka orientuar kryesisht në fushën e zbardhjes së fateve të të përndjekurve në botën intelektuale e tjetër shqiptare në periudhën e diktaturës, çka në mënyrë të shtuar flet për një dimension tjetër të fisnikërisë së tij: sensin për drejtësi, të shoqëruar me maturinë, durimin, bashkëndjesinë me vuajtjet e të tjerëve, moralin e lartë dhe qëndrueshmërinë.

Vepra që po përurojmë sot – *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* është monografi shumë e gjerë për gramatikën historike të shqipes me vështrime e shpje-

gime të hollësishme për proceset e përfshira. Në 1737 faqet e librit që kemi përpaparë është përfshirë e tërë materia e gramatikës historike me rreth 60 f. bibliografi, mbi 110 faqe tregues dhe me një Përmbledhje të gjerë në gjuhën angleze prej 344 faqesh, pra një libër i veçantë i hartuar në formë e me stil përmbledhjeje shumë të dobishme.

Historiku i studimeve të gramatikës historike të shqipes është tashmë i gjatë. Në të vërtetë, albanistika si shkencë fillimet e saj teorikisht serioze i ka shënuar në kuadër të studimeve krahasimtare-historike të sh. 19 me F. Boppin, D. Kamardën e të tjerë në vijim. Dokumentimi i vonë i shqipes dhe zhvillimet që e bëjnë atë gjuhë theksimisht inovuese në suaza të gjuhëve IE kanë bërë që depërtimet rindërtuese të jenë më të vështira. Me sintezat e para shkëlqeu G. Meyer në dy dekadat e fundit të sh. 19, ndërsa me hulumtime të thelluara i shpunë më tej ato studime H. Pedersen, N. Jokl, M. La Piana, A. Meillet, P. Skok, H. Bariq, etj. Në gjysmën e dytë të sh. 20 bota shqiptare mori rol të rëndësishëm në studimet albanologjike. Në gjithë gjysmëshekullin kemi zhvillime dinamike në fushat e historisë së gjuhës me një rol të veçantë të autoriteve si E. Çabej e S. Riza qysh në vitet '50. Veprat e para sintezë në këtë fushë nisën me dispensat e K. Cipos më 1948, me *Fillimet e gjuhësisë shqiptare* të S. Rizës në Prishtinë më 1952, *Hymjen në historinë e gjuhës shqipe* të H. Bariqit po aty më 1955, për të arritur te *Hyrja* e famshme në historinë e gjuhës e E. Çabejtë më 1960, por me parahistori nga vitit 1947. Veprat sintezë në fushën e gramatikës historike në vijim vijnë njëra pas tjetrës – monografitë sistematike të Rizës për shumicën e pjesëve të ligjëratës, studimet e Xhuvanit e të Çabejtë për kategori të veçanta, pastaj

sintezat e M. Domit si dispensë më 1962, e I. Ajetit si tekst universitar më 1965, të Sh. Demirajt me disa versione, të Bokshit, të Mann-it, të Orel-it deri te kjo e fundit e K. Topallit. Të gjitha këto vepra mbindërtojnë në traditën e begatshme të studimeve të gramatikës historike në të cilën vend të shquar për ndihmesat e risimet në shpjegime zënë kontributet e një vargu të gjerë studiuesish (Bopp, Camarda, Meyer, Pedersen, Jokl, La Piana, Meillet, Skok, Bariq, Çabej, Riza, Xhuvani, Tagliavini, Mann, Desnickaja, Cimochoowski, Domi, Ajeti, Hamp, Camaj, Gabinski, Bokshi, Fiedler, Ölberg, Demiraj, Klingenschmitt, Mansaku, Likaj, Orel, etj).

Sinteza e studimeve që ka bërë Kolec Topalli në frymë, në gjerësi e në konceptimin e përgjithshëm vjen si e një brezi të tretë tek ne, gjithsesi me vështrim tashmë tradicional të tërë sfondit të studimeve albanistike, pikërisht në frymën dhe modelin e sintezave të mëdha që janë bërë tashmë për gjuhë më të studiuara se jona. Por vepra ka edhe meritën tjetër të madhe që të çon përtej vlerësimeve të kësaj tradite, sjell ide, njohje, interpretime dhe vështrime të reja. Në të i gjejmë në shtrirje të mjaftueshme konceptin e mjeshtrit Topalli, idetë e tij, vështrimet origjinale, tërë përvojën e tij në këto studime.

Vepra përfshin paraqitjet e zgjeruara për të gjitha çështjet e gramatikës historike të shqipes. Metodikisht autori vështrimin e tij e vendos kështu: paraqitje e rezultateve më të rëndësishme në fushën e gramatikës historike nga studiuesit e tjerë bashkë me rezultatet e hulumtimeve të veta, duke u përpjekur të sjellë përfundime që të çojnë më tej. Në çdo rast ai është marrë me faktet, me idetë dhe me diskutimet themelore, duke lënë mënjanë polemikat dhe çështjet e veçanta. Të gjitha këto i ka

shtruar me një gjuhë të qartë jo shumë teknike, por të saktë. Në këtë mënyrë ai na ka dhënë një vepër themelore me vlera të shumanshme për studimet e historisë së gjuhës shqipe, për publikun shkencor shqiptar dhe të huaj, por edhe për një shtresë më të gjerë lexuesish të interesuar. Vepra të këtilla hyjnë në vargun e veprave me rëndësi të dorës së parë të studimeve të gjuhësisë shqiptare.

Akademik Kolec Topallit i shprehim me këtë rast urimet më të përzemërta për sukseset e shënuara deri tash dhe edhe me këtë vepër dhe i urojmë shëndet, durim dhe energji për punë të mëtejme dhe vepra të tjera kështu kuptimplote dhe të rëndësishme për shkencën dhe kulturën tonë. Vitin tjetër e presim prej tij Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe.

Vepra të botuara të Kolec Topallit:

Theksi në gjuhën shqipe, Sh.B. Enciklopedike, Tiranë, 1995, 532 f.

Për historinë e hundorësisë së zanoreve, Sh.B. Enciklopedike, Tiranë, 1996, 196 f.

Zhvillimi historik i diftongjeve në gjuhën shqipe, Toena, Tiranë, 1998, 418 f.

Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe, Toena, Tiranë, 2000, 456 f.

Sonantet e gjuhës shqipe, Mësonjëtorja, Tiranë, 2001, 466 f.

Mbylltoret e gjuhës shqipe, Gjergj Fishta, Tiranë, 2002, 388 f.

Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe, Dita 2000, Tiranë, 2003, 388 f.

Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor, Mësonjëtorja, Tiranë, 2004, 330 f.

Fonetika historike e gjuhës shqipe, Shtëpia Botuese Dituria, 2007, 712 f.

Ricerche sulla storia dell'accento in albanese, Università della Calabria, Rende,

2007, 234 f.

Evolucioni historik i përemrave të shqipes, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës Pjetër Arbënori, Tiranë, 2008, 296 f.

Nyjat e shqipes, Toena, Tiranë, 2009, 380 f.

Sistemi rator i emrave të shqipes, Plejad, Tiranë, 2009, 470 f.

Sistemi foljor i gjuhës shqipe, Plejad, Tiranë, 2010, 667 f.

Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Kristalina, Tiranë, 2011, 1740 f.

Bazat e fonetikës historike të gjuhës shqipe. Libri Universitar. Tiranë, 2005, 174 f.

Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe, Libri Universitar. Tiranë, 2011, 301 f.

Besim BOKSHI: GRAMATIKË
HISTORIKE E GJUHËS SHQIPE E
AKADEMIK TOPALLIT

I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë zoti Gudar Beqiraj, i nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës zoti Hivzi Islami, zonja e zotërinj të nderuar, sot kemi kënaqësi të veçantë që në Akademinë tonë po përurojmë një vepër madhore albanistike, veprën voluminoze *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* të anëtarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të kolegut dhe mikut tonë Kolec Topalli. Në këtë vepër çështjet e zhvillimeve morfosintaksore të shqipes janë trajtuar në një vëllim prej 1400 faqesh, ndjekur nga një prezantim prej 350 faqesh në gjuhën angleze.

Kjo vepër, bashkë me të tjerat para saj, e zbulon autorin si personalitet të fuqishëm që e ngre vullnetin në realizues të arritjeve hulumtuese kulmore, që arrin në mënyrë të pashmangshme të realizojë synimet e tij krijuese. Pengesat e kohës për ta shmangur si gjuhëtar për Kolecin nuk patën efekt demoralizues, sepse ai pati forcën morale, durimin dhe besimin se kualitetet e punës së tij shkencore do të marrin vlerësimin publik të merituar.

Mbasi kishte përfunduar punën e nisur para 30 vjetësh në trajtimin e të gjitha çështjeve të fonetikës historike në tetë vëllime dhe sintezën e këtyre arritjeve në veprën *Fonetika historike e gjuhës shqipe* në 700 faqe, vepër që u nderua me çmime të larta: “Ekselencia Shqiptare 2007” dhe Çmimi i Albanologjisë 2008”, akademik Kolec Topalli filloi punën në trajtimin e çështjeve të gramatikës historike. Edhe këtu ai, para kësaj vepre sintetizuese që po promovojmë, kishte botuar këto monografi: “Evolucioni historik i përemrave të shqi-

pes(2008)”, “Nyjat e shqipes (2009)”, “Sistemi rasor i emrave të shqipes (2009)”, “Sistemi foljor i gjuhës shqipe (2010)”, “Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe (2011)”. Botimi i këtyre veprave një në 2008, dy në 2009, një në 2010 dhe një në 2011 e po në këtë vit edhe libri gati 2000 faqesh që e kemi në shqyrtim, flet për një energji të fuqishme krijuese me një produktivitet të pashoq në studimet albanistike.

Akademik Kolec Topalli në studimet e shqipes ka arritur të jetë i veçantë bashkë me akademik Shaban Demirajn edhe për trajtimin e gjithanshëm të strukturës së shqipes në zhvillim, për begatinë e tematikave studimore të zhvillimit të shqipes në fonetikë, morfologji, sintaksë dhe me arritje në zbulimet e korelacioneve të zhvillimeve e tyre paralele si transformime të strukturës së tërësishme të shqipes përmes një procedimi sintetik që nuk i lë ato, siç thuhet, provnca të pavarura gjuhësore.

Me këtë *Gramatikë historike të shqipes* ashtu si dhe me *Fonetikën historike të shqipes* akademik Kolec Topalli ka aktualizuar rishqyrtimin e të gjitha çështjeve të zhvillimit të gjuhës shqipe deri në thellësitë e saj parahistorike. Këtë aktualizim ai e ka sjellë me tone trajtuese origjinale në çështjet qëndrore të strukturës së gjuhës sonë: në krijimin dhe zhvillimin e nyjës shquese e të përparme, në zhvillimin e sistemit të rasave tek emrat, te mbiemrat e te përemrat, në trajtimin e përemrave pronorë dhe të çështjeve të kohëve, të mënyrave e të diatezës në sistemin foljor.

Kualitetet shkencore të veprës *Gramatikë historike e shqipes* autori i ka arritur me argumentime plotësuese të rezultateve të hulumtimeve nga studiues pararendës dhe me risi të shumta në trajtimin e në rezul-

tate. Kështu, duke problematizuar saktësinë e mjaft rezultateve të gjertanishme albanistike, kjo vepër e objektivizon dhe e nxit nevojën e hulumtimeve të reja të problemeve evolutive të shqipes nga studiues të rinj të sotëm e të ardhshëm. Kjo e bën këtë vepër shumë komunikuese me studiuesin e këtyre çështjeve dhe nxitëse e sugjeruese për hulumtime të reja, nxitëse për zhvillimin e studimeve historike të shqipes.

Akademik Kolec Topalli e ka filluar punën në realizimin e kësaj vepre pasi ka konsultuar me vlerësim kritik tërë literaturën përkatëse, duke e bërë të mbështetur rigorozitetin e trajtimit të shkencore të tij.

Në përrurim të kësaj fjale për këtë vepër, që qëndron krenarisht e veçantë, ne kemi kënaqësi kolegjale që ta përgëzojmë akademik Kolec Topallin që ka arritur me tërësinë e veprave të veta të jetë zotërues kreativ i tërë problematikës së diakronisë së shqipes e ta shohë me mburrje këtë arritje të madhe krijuese.

Dëshiroj që me këtë rast t'i uroj sukses zotit Topalli në punën e nisur për hartimin e fjalorit etimologjik të shqipes, vepër kjo që do ta ngrejë edhe më lart prestigjin e tij si studiues i shqipes.

Seit MANSAKU: GRAMATIKA
HISTORIKE E AKADEMIK KOLEC
TOPALLIT

Thuhet me të drejtë se kur vepra flet vetë s'ka nevojë për shumë fjalë, autori hesht po ashtu edhe të tjerët, por këtu jemi mbledhur jo për të heshtur, por për të folur. Sa herë e bie rasti të flasësh për veprën dhe personalitetin shkencor të akademik Kolec Topallit, ajo që të vjen me një herë në mend dhe të imponohet ta thuash pa ngurrim e me nderim është se kemi të bëjmë me një studiues e punëtor të madh, sistematik e produktiv të shkencës sonë gjuhësore, i pajisur me zell e pasion të jashtëzakonshëm për studimin historik të gjuhës shqipe, me guxim shkencor dhe me aftësi të veçanta për të depërtuar thellë në procesin e gjatë dhe të vështirë të zhvillimeve historike e bashkëkohore të gjuhës shqipe. Me këto cilësi shpjegohen arritjet e tij në fushën arritjet e tij në fushën e gjuhësisë të sintetizuar në disa vepra.

Një shprehje e urtë dhe e njohur latine thotë *Non multa sed multum* që përdoret për ata studiues që kanë arritur tashmë një shkallë të lartë të pjekurisë së tyre shkencore për t'iu kujtuar se është më mirë të thellohesh në një fushë të caktuar, sesa të merresh me shumë fusha. Kjo do t'i shkonte pjekurisë shkencore dhe fazës krijuese të Prof. Kolec Topallit sot. Megjithatë përvoja dhe prodhimtaria shkencore e këtij autori po tregon se mund të jetë po aq e vërtetë edhe shprehja *multa et multum*, se *multa* nuk është e papajtueshme me *multum*. Këtë e dëshmon edhe vepra që kemi sot në tavolinë.

Ajo që dua të vë në dukje është se besoj që nuk ka qenë e lehtë për autorin e kësaj vepre të ndërmerre një sintezë të re në fushën e gramatikës historike pa rrezi-

kuar për të rënë në përsëritje të trajtimeve të njohura kur dihet se kjo fushë studimesh nuk ka qenë djerr. Është një fushë që ka nisur të lëvrohet që në gjysmën e shekullit XIX fill pas themelimit të gjuhësisë krahasuese historike dhe përfshirjes së gjuhës shqipe dhe të vetë shqiptarëve në këtë drejtim studimesh. Arbëreshi i njohur Dhimitër Kamarda nga Hora e arbëreshëve botoi një *Sprovë të gramatikës së krahasuar të gjuhës shqipe* në vitin 1864 në Prato të Italisë dhe dy vjet më vonë më 1866 një *Shtojcë të sprovës së gramatikës së krahasuar të gjuhës shqipe*, pothuajse në të njëjtën kohë kur sapo kishin filluar të botoheshin gramatika të krahasuara për gjuhë e grupe gjuhësh të mëdha, për gjuhët romane, për gjuhët sllave, për gjuhët kelte etj. Më pas gramatika e punime themelore për gramatikën historike të shqipes kanë botuar La Piana, M. Domi, Idriz Ajeti, E. Çabej, S. Riza Shaban Demiraj, Besim Bokshi etj. Madje, që nga viti 1986 ekzistonte një vepër themelore sintetizuese *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, e hartuar nga akademik Shaban Demiraj, një titullar historik i kësaj lënde. Me këtë ndroje e nisa edhe unë leximin e kësaj Gramatike, megjithatë kur e mbaron së lexuari bindesh se ai ka mundur ta kapërcejë këtë vështirësi dhe ia ka arritur të paraqesë një vepër që në tërësinë e saj ka origjinalitetin e vet ndërtime dhe përmbajtjesor dhe sjell përgjithësime e ndihmesa të reja, plotësime e shtjellime çështjes të patrajtuara më parë, vështrime kritike etj.

Dihet se çdo fushë e dijes përparon grumbullimi dhe shfrytëzimi i burimeve e i fakteve të reja të panjohura këtyre fakteve ose përdorimi i metodave të reja të studimit dhe nga shfrytëzimi i burimeve të reja lëndore. Autori i kësaj vepre është përpjekur gjatë punës së tij t'i shfrytëzojë këto

mjete të përparimit shkencor dhe ia ka dalë në krye. Nga pikëpamja e bazës shkencore vepra mbështetet në arritjet më të qëndrueshme të derisotme në fushën e studimit historik të strukturës gramatikore, të shqipes që nga gjysma e dytë e shekullit XIX deri në ditë tona, duke përfshirë sigurisht edhe studimet e tij në këto fusha, duke i shqyrtuar në mënyrë kritike këto arritje.

Nga pikëpamja e fakteve gjuhësore që i nënshtrohen analizës shkencore, vepra mbështetet në një lëndë gjuhësore të gjerë dhe të larmishme me një shtrirje të gjerë në hapësirë dhe në kohë. Janë shfrytëzuar të dhëna të shumta nga të gjitha të folmet e dialektet e shqipes, duke përfshirë edhe ato nga të folmet arbëreshe të Italisë e të Greqisë. Janë shfrytëzuar gjerësisht dhe me njohje të mirë tekstet e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe të shekujve XVI-XVII etj. Të gjitha këto fakte i nënshtrohen një analize të shumanshme dhe të hollësishme për të nxjerrë përfundimet përkatëse rreth çështjeve që studiohen. Lënda e pasur që ka shfrytëzuar dhe analizuar i ka dhënë mundësi autorit të pasurojë argumentimin e mëtejshëm të problemeve të studiuara edhe më pare dhe të përdorë një lëndë të pasur ekzemplifikuese

Vepra shquhet për plotësinë e saj, për gamën e gjerë të problemeve që trajton. Në të janë bërë objekt i një analize të gjerë e të shumanshme pothuajse të gjitha problemet e evolucionit historik të strukturës gramatikore të shqipes, të morfologjisë historike dhe çështje të sintaksës historike të ndërthurura me vështrime të fonetikës e të etimologjisë si për ato që janë zgjidhur ose kanë hyrë në rrugën e zgjidhjes, ashtu edhe ato që nuk kanë gjetur ende zgjidhje përfundimtare.

Kontributet e autorit qëndrojnë në

këto drejtime themelore: Së pari, është shfrytëzuar një lëndë e pasur gjuhësore që vjen nga burime të larmishme: nga vepra letrare autorësh të ndryshëm me gjeografi e tematikë të ndryshme të pashfrytëzuara sa duhet nga studiues të mëparshëm, nga gjuha e sotme e përbashkët, nga dialektet dhe të folmet e shqipes brenda dhe jashtë vendit, nga tekstet e vjetra të shekujve XVI-XVII etj. Kjo e zgjeron dhe e forcon bazën argumentuese, qoftë për ato çështje që janë trajtuar edhe më parë, qoftë për zgjidhjet e reja që propozon autori.

Autori gjatë punimit përballet me të gjitha problemet që shtrohen e dalin gjatë trajtimit të kësaj lënde të vështirë të shqipes, bëhet një inventar pothuajse i plotë i të gjitha trajtave gramatikore që janë përdorur e përdoren në gjuhën shqipe e në të folmet e saj, në gjuhën e shkruar e të folur dhe përpiqet t'u japë shpjegim historik e funksional të gjithë përbërësve të këtyre trajtave, duke përdorur argumente të natyrave të ndryshme dhe në shumicën e rasteve argumentimi është bindës, por edhe kur në ndonjë rast nuk është bindës, është koherent me pikëpamjet e autorit.

Përveç, trajtimit dhe argumentimit më të plotë të problemeve të trajtuara edhe më parë nga studiues të tjerë, autori propozon dhe argumenton edhe zgjidhje të reja për disa çështje që ende nuk kanë gjetur zgjidhje përfundimtare.

Kështu p.sh. një mendim të ndryshëm vetjak paraqet autori për formimin e mënyrës dëshirore, për formimin e së kryerës së thjeshtë të mënyrës dëftore, për formimin e trajtave të pashtjelluara të foljes, për origjinën e disa mbaresave foljore etj.

Me interes është mendimi i autorit për të argumentuar ekzistencën në gjuhën shqipe të një paskajoreje të vjetër e bara-

bartë me trajtën e sotme të pjesores mbi bazën e së cilës janë formuar trajtat e tjera të pashtjelluara, mendim që e pati shprehur më parë edhe prof. Selman Riza. Që në veprën Tri monografia autori në këtë rast e ka mënjanuar termin *pjesore* dhe e ka zëvendësuar me termin *formë e pashtjelluar*. Koncepti që ka autori për formën e pashtjelluar dhe dallimi që bën në mes të saj dhe pjesores duket me interes, por termi nuk më duket i qëlluar, sepse në konceptin “e pashtjelluar” në gramatologjinë shqipe përfshihen të gjitha trajtat që nuk kanë mbareta vetore, paskajorja, përcjellorja dhe pjesorja. Sidoqoftë mendoj se çështja ka nevojë të sqarohet më mirë.

Për problemet e trajtuara edhe më parë nga studiues të tjerë zgjidhjet e të cilave pranohen edhe nga autori, sillen fakte e argumente të reja për t’i mbështetur e plotësuar ato me lëndë të re dhe me shtjellime më të plota e saktësime të mëtejshme, me shqyrtime e analiza të hollësishme.

Nuk ka dyshim se kontributi i autorit nuk qëndron vetëm në trajtimin dhe në argumentimin më të plotë të problemeve të studiuara edhe më parë nga studiues të tjerë, por edhe në hedhjen dhe shtjellimin e tezave e të hipotezave të reja dhe në përpjekjen për t’i argumentuar ato siç janë p.sh. teza për rrugën e formimit të nyjeve shquese, për formimin e trajtës së mënyrës dëshirore, për rrugën e formimit të së kryerës së thjeshtë, për formimin e trajtave të pashtjelluara të foljes etj.

Edhe atëherë kur vështrimet e reja nuk janë krejt bindëse e plotësisht të argumentuara, ato tërheqin vëmendjen e studiueseve dhe i nxisin ata për kërkime të mëtejshme për zgjidhjen e tyre.

Unë p.sh nuk pajtohem me shpje-

gimin e autorit që nyja *i* te sintagma *mishi i dashit* vjen nga një sintagmë e hershme e rindërtuar **i mish i dash*, kur me këtë rrugë nuk shpjegohet nyja *i* te *mishi i lopës* që pritej të vinte nga sintagma e rindërtuar *mish e lopë* dhe do të kishim normalisht *mish e lopës* dhe jo *mish i lopës*. Por dihet se nuk ka ndodhur kështu. Autori e ka ndjerë këtë vështirësi në shpjegim dhe është përpjekur ta shpjegojë me shtrirjen e modelit **i mish i dash* edhe në sintagmat e tjera të tipit *mishi i lopës* apo edhe *lëkura e dashit*. Një shpjegim i tillë është vështirë të jetë bindës. Ai duket si një shpjegim ad hoc për të përligjur hipotezën e autorit. Në një vepër kaq të gjerë ku trajtohen kaq shumë probleme dhe shumë herë të vështira, sidomos në rastin e shqipes periudha e dokumentuar me shkrim e së cilës është shumë e shkurtër për të shpjeguar dukuri të lashta historike e parahistorike, ka vend për mendime e teza që nuk pajtohen me ato të autorit, por kjo i shërben më tej nxitjes së kërkimeve të reja në këto fusha.

Vepra ka edhe mjaft vështrime sintaksore me interes, siç janë kuptimet dhe funksionet e trajtave dhe të togjeve të ndryshme foljore, rrua e formimit të trajtave analitike ose perifrastike, përdorimi i disa lidhëzave me trajta mënyrore e kohore të caktuara etj., përshtatja e kategorive të ndryshme morfologjike të shqipes dhe mjetet e shprehjes së kësaj përshtatjeje, vendi i gjymtyrëve në fjali e frazë etj. Megjithatë problemet e sintaksës historike, ashtu siç ndodh përgjithësisht edhe në gramatike historike të gjuhëve të tjera, nuk janë trajtuar me atë thellësi e kompetence që është trajtuar aspekti morfologjik.; madje ka edhe pohime që duhen rishikuar, sidomos ato që kanë të bëjnë me përdorimin e lidhëzave me këtë ose trajtë foljore, me dallimet midis trajtave analitike e perifrastike dhe

tojeve foljore me funksione të caktuara sintaksore, me një qëndrim më koherent ndaj tyre në konceptim dhe në emërtim. P.sh. distribucioni ose më mirë përndarja e përdorimit të lidhëzave filluese *se* dhe *që*, e para me mënyrën dëftore dhe e dyta me lidhoren dhe me dëftoren. Pohimi se me foljet e mënyrës urdhërore nuk përdoret kryefjala është shumë kategorik. Ka mjaft raste kur urdhri, mënyra urdhërore shoqërohet me kryefjalën përkatëse në pozicion para ose pas kallëzuesit. P.sh. *Ti qendro këtu, unë do të shkoj në Shkodër, Merre ti këtë vendim, jo unë*. Po kështu edhe pohimi se trajtat me paravendosje të trajtave të shkurtra me mënyrën urdhërore nuk janë në natyrën e shqipes, besoj se duhet parë dhe saktësuar, sepse mendoj se në shqip ndërtimet *ma sill* dhe *sillma* janë të dyja të natyrshme dhe normative.

Autori në këtë vepër ka synuar jo vetëm të shpjegojë rrugën e evolucionit historik të trajtave e ndërtimeve të strukturës gramatikore të shqipes, por edhe është përpjekur sistematikisht të përcaktojë burimin dhe kronologjinë absolute dhe relative të këtyre zhvillimeve, duke dalluar dukuritë e trashëguara nga periudha indoevropiane e shqipes, nga zhvillimet e brendshme të saja në periudha më të vona si edhe ato që janë rezultat i proceseve të vetë shqipes nga ato që mund të jenë ndikime nga kontaktet gjuhësore me gjuhë të tjera. Kur ka qenë e mundur, autori është përpjekur t'i shpjegojë zhvillimet e ndryshimet historike në strukturën gramatikore të shqipes si rezultat i proceseve të brendshme të vet shqipes. Krahasimet me të njëjta procese në gjuhë të tjera shërbejnë për të argumentuar në një kontekst më të gjerë zhbillimet në gjuhën shqipe. Kjo sigurisht është një vlerë për gramatikën historike të shqipes.

Kjo vepër ka dalë nga studime mo-

nografike të gjera; pothuajse për të gjithë krerët kryesorë të saj autori ka botuar monografi të veçanta që tashmë janë bërë të njohura dhe janë vlerësuar. Kjo sigurisht është një gjë pozitive, sepse tregon se përfundimet që paraqiten në këtë botim mbështeten në studime të hollësishme e të gjera.

Nga ana tjetër, vështirësia më e madhe e autorit ka qenë besoj realizimi i një sinteze të domosdoshme, për t'i rrudhur e për t'i paraqitur studimet monografike përkatëse në formë krerësh të një vepre përgjithësuese duke mënjanuar hollësitë e tepërta, dukuritë e veçanta me një shtrirje e peshë të kufizuar, faktet et e veçuara dialektore. Kjo nuk ka qenë e lehtë për autorin të cilit sigurisht i vjen keq të heq ose të shkurtojë çdo pjesë studimi të arritur me mund.

Për këtë arsye mendoj se me gjithë përpjekjet që ka bërë autori për të bashkuar a pajtuar kërkesat e një vepre përgjithësuese me gjerësinë e trajtimeve monografike analitike, vepra paraqitet më shumë si një gramatikë thesaurus sesa një gramatikë e mirëfilltë historike. Them një gramatikë thesaurus, sepse në të janë trajtuar jo vetëm tema të mirëfillta të gramatikës historike dhe në rrafshin e mirëfilltë historik, por edhe shumë dukuri e fakte të gramatikës së sotme, të dialektologjisë historike dhe të sotme etj. Kjo veçori nuk ia ul vlerat shkencore të saj. Ajo është pa dyshim një vepër shumë e dobishme për të gjithë studiuesit që merren e do të merren me shpjegimin e evolucionit historik të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe, por edhe për ata që merren me strukturën gramatikore të shqipes së sotme për t'i mbështetur kërkimet e tyre mbi një bazë historike të sigurt, për studentët e fakulteteve filologjike e sidomos për ata që përgatisin mastre dhe doktorata në fushë të gjuhësisë.

Duke përfunduar këto pak fjalë për një vepër të madhe dhe themelore për gramatikën historike të shqipes, e përgëzojmë autorin për këtë arritje të shënuar dhe i urojmë atij shëndet e jetë të gjatë për vepra të tjera në fushën e historisë së gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare.

Imri BADALLAJ: *GRAMATIKË
HISTORIKE E SHQIPES E
AKADEMIK KOLEC TOPALLIT*

Veprat shkencore të akademik Kolec Topallit, të cilat janë publikuar deri më sot mbajnë mbi vete një kontribut tepër të vlefshëm për të gjitha sferat e gjuhësisë, si për fonetikën, për gramatikën, për leksikologjinë, për ballkanistikën dhe në përgjithësi për gjuhësinë shqiptare, që gjithsesi me këtë rast, kur po e bëjmë promovimin e kësaj vepre kaq madhore duhet përmendur edhe disa pararendës të këtyre fushave, që autori ynë u ka hyrë, duke i kapur sa në gjerësi, aq edhe në thellësi.

Me këtë rast na ka shkuar mendja tek Franz Bopp, i cili që nga viti 1854 me veprën *Über das Albanesische in seinen verwandschaftlichen Beziehungen*, hap shtigje të reja për një analizë të kujdesshme me kritere shkencore mbi shqipen, duke i vënë në shqyrtim të gjitha elementet qenësore të sistemit gramatikor për ta përcaktuar karakterin indoeuropian dhe vendin e saj në këtë familje të madhe gjuhësore.

Udhën e hapur nga ky dijetar gjerman e ndoqën edhe shumë gjuhëtarë, të cilët vunë gisht rreth sistemit gramatikor. Ndër ta shquhet edhe italo-abëreshi Dhimiter Kamarda me dy studimet e tij *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese, Livorno, 1864 dhe Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese, Prato, 1866*, ku brenda këtyre dy veprave karakterin indoeuropian të shqipes e pa kryesisht përmes bashkëpërkimeve shqiptare-greke. Këtij tabori i takon edhe një tjetër gjuhëtar i fundit të sh. XIX Franc Miklosich, që analizoi marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera brenda sistemit foljor. Mirëpo, studimi i grama-

tikës historike me gjuhëtarët: Gustav Meyer, Holger Pedersen, Demetrio Camarda, Meyer-Lübke, Norbert Jokl, Marco La Piana, Gjergj Pekmezi, Maximilian Lambert, Carlo Tagliavini, Kristian Sanfeld e të tjerë, krijuan një fazë të re me hulumtimet e tyre mbi gramatikën historike të shqipes.

Krahas këtyre, që u takojnë caqeve të njëjta kohore po përmendim edhe Justin Rrotën me studimin *Analizimi i rasave t' emnit e zhvillimi historik i tymve, Shkodër, 1931*, dhe Ndre Mjedja me studimin *Vrejtje mbi artikuj e premna pronës të gjuhës shqipe, Shkodër, 1934*. Përveç këtyre emrave të ndritur, intensiteti i studimeve rreth shqipes vjen e rritet me studiuesit, si: me Eqrem Çabejn, Selman Rizën, Waclav Cimochofskin, Shaban Denirajn, Idriz Ajetin, e sidomos Besim Bokshin, i cili me monografitë e tij kap, i shqyrton dhe i shpjegon cep më cep të gjitha problemet e zhvillimit historik të shqipes. Pastaj vijnë: Wilfried Fiedler, Rexhep Ismajli, Agnja Desnickaja, Norbert Boretzky, Marcu Gabinski, Vladimir Orel, Erich Hamp, Gerda Uhlisch, Viktor Friedman, Stuart Mann, Ethem Likaj, Seit Mansaku, Bardhyl Demiraj e të tjerë.

Mirëpo, sot e kemi fjalën për këtë vepër të akademik Kolec Topallit, të titulluar *Gramatikë historike e shqipes*.

Autori i kësaj vepre, të cilën e ka shtrirë në 1737 faqe, paraqet gjithë problematikën e gramatikës historike të shqipes.

Kjo vepër shkencore kaq voluminoze erdhi dhe e pa dritën e botimit pasi autori i saj që nga viti 1995 e derti më sot kishte botuar edhe 17 vëllime të tjera të karakterit monografik, si: *Theksi në gjuhën shqipe, Tiranë, 1995, Për historinë e hundorësisë në gjuhën shqipe, Tiranë,*

1996, *Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes*, Tiranë, 2000, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, *Mbylltoret e gjuhës shqipe*, 2002, *Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, *Bazat e fonetikës historike*, Tiranë, 2005, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, *Ricerche sulla storia dell'accento in in albanese*, Cosenza, 2007, *Evolucioni historik i përemrave të shqipes*, Tiranë, 2008, *Nyjat e shqipes*, Tiranë, 2009, *Sistemi rasor i emrave të shqipes*, Tiranë, 2009, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, *Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011 dhe *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 2012, që për këtë të fundit edhe ndodhemi këtu – në ambientet e ASHAK.

Në dallim nga të tjerët, ky vëllim ka për objekt gjithë evolucionin e strukturës gramatikore të shqipes, i cili pa dyshim edhe vetë autorit i duket se ka qenë një proces mjaft i ndërlikuar, nga se lidhet ngushtë edhe me vijimësinë e shoqërisë njerëzore së cilës i shërben si mjet komunikimi në rrjedhën e shumë brezave.

Autorin tonë e intereson thellësisht se kur ka filluar jetën e vet një gjuhë, që do të merret si pikënisje në studimin historik të saj. Gjithsesi, kjo është një çështje sa e vështirë, aq edhe e ndërlikuar, sepse lidhet me dokumentimin dhe me nivelin e njohjes së gjuhës “nënë” siç thotë autori, kur dihet mirëfilli se disa gjuhë janë dokumentuar që herët e disa të tjera më vonë.

Dokumentet e vjetra ndihmojnë në studimin e tyre edhe për caktimin e kronologjisë, çfarë me këtë rast mund të përmendim greqishten, gjuhët romane e disa të tjera, që më lehtë mund të ndiqen udhët, që ato kishin marrë nga lashtësia e deri më sot.

Mirëpo, për fatin e lig, shqipja u dokumentua vonë, prandaj edhe mënyra e studimit të saj kërkon mund e dije të veçanta.

Edhe mbledhja e thesarit leksikor e gramatikor, studimi jo i plotë i dialekteve dhe të folmeve, që së bashku me mungesën e materialeve të gjuhëve, të cilat janë folur në Gadishullin Ballkanik, me të cilat lidhet edhe origjina e shqipes vijnë e shtojnë dukshëm vështirësitë për të ndjekur, jo vetëm vijën e origjinës së shqipes, por edhe mbarë evoluimin e strukturës së saj.

Akademiku ynë në këtë vepër sintetëzë kaq voluminoze ka kapur nga të gjitha anët evolucionin e strukturës gramatikore të gjuhës shqipe, që siç thotë edhe vetë, nuk mund të merret i shkëputur nga studimi i përgjithshëm i historisë së gjuhës, e cila ka për qëllim të sqarojë rrugën që ka ndjekur ajo qysh prej formimit të saj e deri më sot.

Duke bërë kërkime të pandërprera në këtë drejtim, autorit të librit, dukuritë gramatikore, që janë shtruar, përimtuar e shpjeguar, në shqipen i dalin të shfaqura në perioda të ndryshme të zhvillimit të saj, që me mprehtësi i ka ndarë në dy grupe.

Në grupin e parë përfshihen dukuritë e vjetra, si : theksi nistor, metafoia, rënia e mbaresave të vjetra, ngulitja e theksit në një rrokje të caktuar të temës ku nuk ndodhen treguesit gramatikorë, dhe reduktimi i zanoreve të patheksuara, që pa dyshim këto dukuri janë zhvilluar në periudhën e kontakteve të hershme dhe intensive me latinishten. Për të gjitha këto ndryshime dhe evoluime, autori jep edhe shembujt, dhe me të drejtë pohon, se si kategori që janë të trashëguara nga një fazë tepër e hershme dhe nga ndryshimet e mëdha që kanë pësuar gjatë shekujve, ato nuk ndihmojnë për caktimin e gjuhës “nënë” dhe gjuhës “bije”. Mirëpo, autori për të dalë nga

ky shteg i errët, sado pak për t'i përcaktuar dhe shpjeguar caqet e periudhës së lashtë (gjuhës nënë) në shqipen e re (gjuhës bijë) mbështetet në dukuritë, të cilat shumë më vonë zonë vend në gjirin e shqipes dhe që i vendos në grupin e dytë, si: krijimi i kategorisë së shquarsisë me anë të nyjave të prapme, para nyjzëzimi i mbiemrave, formimi i përemrave pronorë të përngjitur, rregullimi mekanik i theksit që krijon fjalë me theks parafundor, zhdukja graduale e snjanësit, hundorësia e zanoreve, rotacizmi e ndonjë dukuri tjetër, që nuk po i përmendim.

Njësitë dhe nënnyjësitë në këtë vëllim janë të shumta, duke filluar nga Evolucionimi i sistemit gramatikor: Sistemi emëror, Sistemi nyjor, sistemi mbiemëror, Sistemi përemëror, sistemi i numërimit, Sistemi foljor, Kategoritë e pa eptueshme, Sistemi i fjalëformimit dhe Sintaksa e fjalisë.

Në këtë vepër akademik Kolec Topalli suksesshëm depërton në çështjet fort problematike të gramatikës historike të shqipes, duke hedhur hapa në ndjekjen konsekuente të teorisë së sistemit, që pa dyshim për të arritur në zgjidhje të drejta është dashur kërkime dhe hulumtime të panderprera në të gjitha sferat e gjuhësisë. Kjo mënyrë e studimit, autorin e ka detyruar, që shumë teza të paqëndrueshme të pararendësve të tij t'i rishikojë dhe t'u jap sqarime e shpjegime të duhura.

Pra, marrë në përgjithësi, sa kemi mundur të hetojmë, kjo vepër është e madhe, e qëndrueshme dhe kryesisht e drejtuar në segmentet më të ndjeshëm të gramatikës historike, fushë kjo, e cila prek pikat qenësore të trungut gjuhësor. Gjithashtu librin e karakterizon gjerësia dhe thellësia e rrokjes së problemeve, fuqia e analizës dhe e sintezës, konkluzionet bindëse dhe zgjidhja e

shumë çështjeve të pazbërthyeshme dhe të pashpjegueshme, që me plot gojën e themi, se rezultatet e arritura hapin udhë të reja për të arritur në përfundime me saktësi shkencore.

E gjithë vepra e akademikut tonë përshkohet edhe nga një frymë e vështrimit kritik, por ky është një gjuhëtar, që nuk e bën kritikën me nënçmim dhe përbuzje, përkundrazi këtë e bën me interpretime e përfundime, që si teza do t'u qëndrojnëpa u luhatur shtrëngatave të moteve.

Në fund të këtyre fjalëve, që për-krah kësaj vepre të madhe, janë fort modeste, e përgëzoj autorin me dëshirën, që mos ta ndalë pendën e tij për të na dhuruar edhe vepra të tjera me këso vlerash të përmasave kaq të mëdha shkencore.

Bardh RUGOVA: KUSH DO TA LEXOJË KËTË LIBËR?

Dje po kaloja para fakultetit me librin që po promovojmë sot, “Gramatika historike e gjuhës shqipe”, gjithë ai vëllim, dhe pata dy-tri komente e pyetje rugës: “Hej, kush do ta lexojë gjithë atë libër?”

U thashë se pyetja që do të duhej ta bënin do të ishte: “Kush e ka shkruar gjithë atë libër?”

Zakonisht projekte të këtilla kapitale realizohen nga një ekip i tërë njerëzish, një institucion i tërë. Mirëpo, ne jemi këtu sot për të promovuar punën sa një institucion, të një njeriu të vetëm, akademik Kolec Topalli.

Zor se ndonjëri nga ata që rrugës ma bënin pyetjen: “Kush do ta lexojë gjithë atë libër?” do të besonte se libri në të vërtetë është i një autori të vetëm, i cili para tij ka edhe shumë vepra të tjera.

Vepra “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” e profesor Kolec Topallit është përmbledhje dhe zgjerim i një pune që pason projektin tjetër të madh të tij “Fonetikën historike të shqipes”, të botuar më 2007.

Gramatika historike e gjuhës shqipe, të cilës i parapriu Bazat e gramatikës historike, botuar vitin e shkuar, përfshin përmbledhje të dhjetë kapitujve: Evolucionin e sistemit gramatikor, Sistemi emëror, Sistemi nyjor, Sistemi mbiemëror, Sistemi përemëror, Sistemi i numërimit, Sistemi foljor, Kategoritë e paëptueshme, Sistemi i fjalëformimit dhe Sintaksa e fjalisë.

Nga këta Evolucionin e perëmrave është botuar si monografi më 2009, kur është botuar edhe sistemi rasor i emrave. Më 2010 qe botuar Sistemi foljor, ndërsa vjet Bazat e gramatikës historike të shqipes.

Me Fonetikën historike dhe tani me

gramatikën historike si dhe me projektin e radhës, fjalorin etimologjik të shqipes, autori përmbledh tërë flurudhën e studimeve historike të gjuhës shqipe.

Në terma të Brian Josephit, gjuhëtarit amerikan, që ka redaktuar projektin e madh amerikan për gjuhësinë historike, të realizuar nga më se dhjetë autorë të ndryshëm, gjuhësia historike trajton kërkimin e mënyrave se si të trajtohen humbëtitat dhe diskontinuitetet që ekzistojnë në njohuritë tona në variantet e testuara të një gjuhe gjatë kohës.

Kryemjeshtri shqiptar i kësaj fushe, profesor Besim Bokshi, në veprën e tij të fundit “Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes” pohon se ky trajtim diskontinuitetesh (Bokshi i quan me të tjera fjalë) dhe mbushjesh të hapësirave “është punë e vështirë në disa elemente dhe punë e pasigurt”.

Roman Jakobsoni e përkufizonte si shfrytëzim të dijes së gjendjes së njohur gjuhësore për të gjetur shtresat e ndryshme sinkronike të së kaluarës.

Gramatika historike e gjuhës shqipe e profesor Kolec Topallit si tërësi është përpjekje për të mbushur këto humbëtitat dhe për t’i zgjidhur diskontinuitetet duke e trajtuar gjuhën si produkt në një sërë zgjidhjesh formulaike, matematike – do ta quaja.

Thënë troç, duke u mbështetur në të dhënat e njohura të dokumentuara gjuhësore të shqipes – dhe profesor Topalli ofron shumë të tilla – synohet të kuptohet e pajohura dhe të nxirret në pah.

Gjuha shqipe është një nga ato gjuhë që ka pësuar ndryshime të thella në sistemin gramatikor, ndonëse jo sa në sistemet e tjera të gjuhës: leksikon, fonetikën, fjalëformimin...

Ai, duke provuar të projektojë rrugën që ka ndjekur struktura gramatikore e shqipes në rrjedhën e saj historike, ofron tezat më të pranueshme dhe disa nga rezultatet më të argumentuara që pajtohen me të dhënat e zhvillimit historik të shqipes. Ai, po ashtu, jep interpretime të reja për dukuri gramatikore dhe mendime që jo doemos përputhen me ato të autorëve të tjerë bashkëkohorë. Mirëpo, me veprën e tij profesor Topalli sjell një përmbledhje më të plotë dhe ekstenzive të gramatikës historike të shqipes, me të cilën bën tutje nga gramatika e profesor Shaban Demirajt.

Libri, si i tillë, është një ndihmesë e madhe për studentët që mësojnë historinë e gjuhës shqipe dhe për specialistët që duan t'u hyjnë studimeve të kësaj fushe.

Për kulturën shqiptare, "Gramatika historike e gjuhës shqipe" e profesor Kolec Topallit është një vijë e re kufiri në shkencën e albanologjisë përgjithësisht.

U mbetet brezave të tërë dhe institucioneve të tëra për ta arritur dhe kaluar.

Ju faleminderit.

RES ALBANICAE. RIVISTA DI ALBANOLOGIA, anno I, n. 1, marzo 2012, pp. 265; anno I, n. 2, settembre 2012, pp. 271.

Studimet shqiptare në botën arbëreshe tashmë kanë një traditë dhe kanë shënuar rezultate me peshë për kulturën dhe shkencën në përgjithësi. Studimet shqiptare në botën arbëreshe nuk mund të veçohen nga studimet e tjera në botën shqiptare, ashtu si dhe nga studimet shqiptare në botën italiane e tjetër. Në shekullin XX dhe sidomos në 3-4 dekadat e fundit këto studime kanë marrë një hov të ri zhvillimi dhe kjo ndërlihet me shkallën e zhvillimeve në studimet albanologjike në përgjithësi, me kontaktet e shtuara brenda botës shqiptare, por edhe me gjendjen brenda vetë komunitetit arbëresh. Për ne shqiptarët këndej Adriatikut, sidomos në dekadat '50-'70 të shekullit të kaluar kishte shumë pak informacione për arbëreshët në kohën tonë. Diçka mësohej për periudha të mëhershme dhe qarkullonin kryesisht veprat letrare të të mëdhenjve si Jeronim De Rada, Zef Serembe, diçka Anton Santori, pjesërisht Zef Skiroi, Binard Bilotta, e ndonjë tjetër dhe kryesisht në versionet e përkthyer dhe të redaktuara. Informacionet që qarkullonin në botimet e diasporës si Shêjzat, këndej nuk depërtonin. Vizita që bëme si studentë më 1970 në Kalabri për brezin tim në Prishtinë që zbuluese: pamë katundet arbëreshe, jetën që zhvillohej atje, botimet, përpjekjet për përdorimin e arbërishtes në radio, njohëm njerëz, vendosëm kontakte. Ato kontakte erdhën duke u rritur dhe në vijim, për kënaqësinë tonë të madhe, zhvillimet morën elan të ri, përshpejtim, qoftë për klimën e ndaj minoriteteve në Itali, qoftë edhe për kontaktet që sa vinte e po rriteshin. Kam pasur mundësinë të ndiqja hap pas hapi

përpjekjet që bënte i ndjeri Papas Francesco Solano (emri letrar Dushko Vetmo) për themelimin e Departamentit të studimeve për gjuhën dhe kulturën shqiptare në Kozencë në vitet '70, e që sot është bërë nga të rëndësishmit në albanologji, ashtu si dhe përpjekjet që bënin të tjerët me revistat, botimet e studimet, si Z. Faraco, bizantinisti G. Skiro i Riu, studiuesi në Romë Papas E. Giordano në Kalabri, apo Antoninno Guzzetta në Sicili, Giuseppe Gradilone në Romë, e shumë të tjerë entuziastë dhe dashamirës të këtyre studimeve gjithandej në botën arbëreshe. Nuk e fsheh dot se në vitet '70 brezin tim e kishte kapluar një entuziazëm për botën arbëreshe dhe për zhvillimet atje. Shumë shpejt patëm mundësinë t'i ftonim në Qendrën, më vonë Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë dhe aty që fare i rregullt profesor Solano me kolegët, bashkëpunëtorët dhe studentët e tij. Në ato kontakte na bënte përshtypje të madhe fakti se atje kishte një kulturë të gjallë tek të rinjtë, kështu i hyra botimit të antologjisë Rrënjë e fortë, që u bë nxitëse për botime në varg pastaj të veprave të autorëve arbëreshë të kohës më shumë në Prishtinë, po edhe në Tiranë. Sot kujtoj me shumë kënaqësi që disa nga studentët e bashkëpunëtorët e rinj që vinin atëherë me profesor Solanon tashmë janë bërë studiues me emër në albanologji, si për shembull Francesco Altimari, Elio Miracco, Italo Fortino, apo në fushat e veprimtarisë kulturore e letrare si Kate Xukaro, Gustin Jordani, Mario Bellizzi, etj. Më vonë patëm mundësinë të merrnim kontakte më të afërta edhe me Palermon, sidomos pas Kongresit të vitit 1988, kur vizitua Horën Arbëreshe të paharrueshme, njohëm nga afër poetin Giuseppe Schiro di Maggio, apo edhe atëherë të riun Matteo Mandalà, sot

një nga studiuesit e shquar të botës shqiptare, pastaj Gianni Belluscio, Vincenzo Belmonte, Monica Genesin, etj. Sot në botën arbëreshe kemi një brez albanistësh me formimthemelor në albanologji.

Rezultat i zhvillimeve të atilla është ngjitja e studimeve shqiptare në botën arbëreshe (me qendrat në Rende-Cosenza, Palermo, Napoli, Roma, Bari, Lecce) në një shkallë të lartë të këtyre studimeve në përgjithësi. Kjo nuk kishte mundur të ndodhte pa traditën e mëparshme të rëndësishme, pa veprimin e qendrave kishtarë, pa ndihmën e studiuesve italianë, etj. Kështu sot në botën arbëreshe kemi realizime krejtësisht të veçanta të botimeve dhe studimeve për traditën arbëreshe, me metoda të përparuar dhe me përkushtim të madh. Kemi po ashtu studime sistematizuese për aspekte të ndryshme të traditës arbëreshe, sidomos për gjuhën, po edhe për aspekte të tjera. Kjo qe shumë e rëndësishme për albanologjinë në vitet '90 të shekullit të kaluar, kur në botën këndej Adriatikut pati ngecje, të mos themi dhe rënie të këtyre studimeve për pasojë të zhvillimeve shoqërore-politike.

Sot janë të shumtë arbëreshët që merren seriozisht dhe japin ndihmesa me vlerë për studimet shqiptare. Këtu do të përmend vetëm ata që lidhen me botimin që kemi përpara, e që prihen nga profesorët Francesco Altimari në Kozencë dhe Matteo Mandalà në Palermo. Me themelimin e Fondacionit Universitar 'Francesco Solano' u krijuan dhe rrethana për botime serioze shkencore në fushën e albanologjisë, siç është revista **Res Albanicae**, që del me bashkimin e forcave të qendrave të ndryshme arbëreshe, por ka integruar dhe energji nga bota tjetër shqiptare. Fondacioni në fjalë tashmë i ka shpallur qëllimet, ku hyjnë

edhe: promovimi i gjuhës dhe i kulturës shqiptare në Itali, zhvillimi i studimeve shqiptare në vend, mbështetja e veprimtarive të bashkëpunimit shkencor me Ballkanin dhe e të gjitha nismave që favorizojnë shkëmbimin kulturor midis komuniteteve shqiptare historike në Itali dhe atyre në Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi e Mal i Zi). Në vitin 2012 nisi botimi i numrit të parë të revistës tashmë të rëndësishme albanologjike, të drejtuar nga Drejtori shkencor Francesco Altimari dhe nga Drejtori përgjegjës Matteo Mandalà, me redaksinë e përbërë nga: Matteo Mandalà, Gëzim Gurga, Fiorella De Rosa, Flora Koleci, Monica Genesin, Giovanna Nanci, Giuseppina Cerniglia. Në komitetin shkencor revista ka afruar: F. Altimarin, A. Aliun, A. Berishën, W. Breu-in, B. Demirajn, R. Ismajlin, T. Johalas-in, M. Mandalanë, A. Omarin, A. Rusakovin, Sh. Rrokajn, L. Savoia-n.

Në numrin e parë janë përfshirë studime gjuhësore, letrare e të tjera.

Francesco Altimari: Mbi huazimet nga italishtja dhe nga dialektet italo-romane në sistemin foljor të arbërishtes së Kalabrisë (ff. 7-22), duke sjellë kështu një studim me vlerë dhe nga aspekti i kontaktit të gjuhëve, sidomos për aspektet e code-mixing.

Rita Manzini e Leonrado Savoia (ff. 23-42), të pranishëm në studimet arbëreshe e shqiptare tashmë një kohë të gjatë, këtë herë sjellin ndihmesën 'Case' categories in the zheg Albanian variete of Shkodër, në të cilën ata zbatojnë metodat e N. Chomskyt të versionit 1995 për trajtimin e lakimeve rasore si zëra të zakonshëm leksikorë, por duke projektuar struktura sintaksore. Modeli i ri sprovohet nga këta autorë edhe

në materiale të latinishtes, po në përgjithësi edhe në materialet nga Shkodra.

Anila Omari shqyrton Sllavizmat në shqipen e autorëve të vjetër të veriut (sh. XV-XVII) në një gjerësi të madhe (43-104), ndërsa Matteo Mandalà boton vështrimin Për botimin e veprës së plotë të Francesco Antonio Santori, me akribinë që e shquan atë (ff. 105-132).

Bardhyl Demiraj boton këtu po ashtu italisht studimin ‘Mallkimi i epirotit (1483)’ (ff. 133-148), ndërsa Salvatore Corso vjen me studimin “Marco La Piana: La famiglia d’origine e la vicenda umana e scientifica” (ff. 149-186), duke sjellë materiale interesante nga jeta dhe veprimtaria shkencore e studiuesit të falshëm arbëresh.

Ali Aliu sjell studimin e gjerë “Proza e Zija Çelës – kapitull majash në letërsinë shqipe” (ff. 187-200), ndërsa Mario G. Giacomarra sjell studimin “La vicenda arbëreshe tra storia e mito” (ff. 201-212).

Francesco Marciandò sjell vështrimin “Coltura e kultura del grano in Spezzano Albanese comunità arbëreshe della Calabria” (ff. 213-230), me ç’rast jepen jo vetëm aspektet e ndryshme të kultivimit të grurit, po edhe leksiku përkatës, ndërsa ANNA Piro-Giuseppe Tagarelli-Antonio Tagarelli shkruajnë për Studimet biodemografike gjenetike për minoritetin gjuhësor historik shqiptar të provincës së Kozencës (ff. 231-267).

Të gjitha studimet e paraqitur a shoqërohen me një përmbledhje italisht ose shqip, varësisht nga gjuha në të cilën është punimi.

Numri i dytë sjell po kështu materiale të bollshme dhe me vlerë studimore.

Në fushën e gjuhësisë Vito Matranga vjen me një studim të gjerë për “Tiparet e leksikut të lojërave tradicionale të fëmijëve ndër arbëreshët e Sicilisë” italisht (ff. 5-24). Studiuesi ka vërejtur se disa terma arbërisht dëshmojnë edhe njëfarë vijimësie gjuhësore me lojërat tipike ballkanike, ndërsa të tjera të huazuara nga kultura siciliane. Gëzim Gurga vjen me studimin për eksperimentimet normëzuese të D. Kamardës (ff. 25-46), ndërsa Donato Martucci sjell të dhëna për sprovën e parë të hartimit të një atlasit gjuhësor shqip (1940-1944) (ff. 47-80).

Matteo Mandalà këtë herë vjen me studimin shqip Aspekte dhe momente të formimit rinor të L. Pirandello-s dhe të Z. Skiroit në bazë të letërkëmbimit të begatshëm (ff. 81-110). Ndërkaq Anton Nikë Berisha vjen me studimin “Ligjërimi poetik si pasuri shpirtërore dhe shqiptim sublim” (ff. 111-126).

Ky numër sjell edhe poezinë e Ali Podrimjes “Te De Rada në maqi” të përkthyer edhe italisht nga Vincenzo Belmonte (ff. 127-128), ndërsa Dhurata Shehri boton kër të herë artikullin “Aspetto dello status odierno della critica letteraria albanese”, ku merret me gjenbdje dhe statusin e kritikës letrare (ff. 129-140). Mark Marku boton artikullin mbi karakterin atipik të katolicizmit shqiptar (ff. 141-152).

Blerina Suta boton një artikull In memoriam për Filippo Bettini (ff. 153-158), ndërsa Agron Tufa shkruan po ashtu për F. Bettinin një përshëndetje shqiptare (ff. 159-164).

Këtë herë revista ka sjellë dhe rubrikën e recensioneve, ku botohen dy vështrime nga Kastriot Marku: për veprën e Shaban Sinanit “Camaj i paskajuar. Rreth

tipologjisë së llojeve në veprën e Camajt”, Tiranë 2011 (ff. 165-167)dhe për librin e Anton Nikë Berishës po për Camajn “Vepra letrare e Martin Camajt, Tiranë, 2010 (ff. 168-171).

Me të gjitha këto materiale Res Albanicae vjen fuqishëm në studimet albanistike. Ajo ka dhe meritën që një pjesë të studimeve e boton italisht, ndërsa një pjesë tjetër shqip. E tillë ajo është më shumë se një dritare. Studimet albanologjike arbëreshe po futen kështu nëpër derë të madhe atje ku janë dhe kanë qenë gjithnjë – në vorbullin e studimeve albanologjike në përgjithësi dhe me një nivel të lartë shkencor e kulturor.

I urojmë jetë të gjatë!

Rexhep ISMAJLI

Robert ELSIE - Bejtullah DESTANI:
THE CHAM ALBANIANS OF
GREECE, Tauris 2013, ff.

Libri "The Cham Albanians of Greece" i realizuar nga Robert Elsie dhe Bejtullah Destani ofron një histori dokumentare të përmbledhur, të rëndësishme për studime të mëtutjeshme që lidhen me çamët dhe me Çamërinë.

Vëllimi paraqet 102 dokumente të mbledhura në arkiva të ndryshme, përfshirë një numër të madh, siç pohojnë autorët brenda vëllimit, të Zyrës së Jashtme të Britanisë. Dokumentacioni ofrohet i klasifikuar në tri periudha: dokumente të kohës së Perandorisë Osmane dhe të viteve të para të pavarësisë së Shqipërisë deri në 1923; dokumente të periudhës pas Traktatit të Lozanës më 1923, në të cilën Turqia përfundimisht hoqi dorë nga territoret e dikurshme të Perandorisë Osmane në Ballkan dhe dokumente pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore. Janë të paraqitura edhe 5 harta dhe 27 fotografi të ndryshme, ndërsa libri ka një hyrje të shkruar nga Robert Elsie. Kjo hyrje ofron gjithë sfondin e çështjes çame, duke i prezentuar setingun dhe historikun e problemit.

"Vëllimi mbledh për herë të parë në gjuhën angleze një numër të madh dokumentesh historike për Çamërinë dhe çamët shqiptarë si pakicë etnike në Greqi për të ofruar njohuri më të mira të historisë së tyre dhe të çështjes çame", shkruan autori Elsie në hyrje. "Ky libër synon të nxjerrë në pah një kaptinë të lënë pas dore të historisë së Ballkanit jugor, sa të dhimbshme për disa lexues, aq edhe irrituese për disa të tjerë. E shkuara nuk mund të ndryshojë, por e ardhmja po".

Në mesin e dokumenteve të ofruara në libër përfshihen edhe përshkrimet e Çamërisë në zërat e Leksikonit të Përgjithshëm të Historisë dhe të Gjeografisë të Sami Frashërit (Kamus al-'alam), letra të ndryshme të përfaqësuesve të Qeverisë së Shqipërisë dhe të punonjësve diplomatikë e humanitarë ndërkombëtarë dërguar sekretarit të Punëve të Jashtme të Britanisë, Sir Edward Gray lidhur me krimet greke mbi çamët. Po ashtu, në dokumentacionin e fazës së parë, ofrohet edhe një memorandum i Mit'hat Frashërit, i cili përshkruan shkatërrimet në pjesës jugore të Shqipërisë nga forcat ushtarake dhe paramilitare greke më 1913, duke ofruar një listë të detajuar me shifra të krimeve për çdo fshat veç e veç si dhe një dokument i datës 1 mars 1919 i Konferencës së Paqes së Parisit, në të cilin trajtohet çështja e kufirit Shqipëri – Greqi.

Autorët kanë paraqitur edhe transkriptin e një komisioni ndërkombëtar të vitit 1919, në të cilin një delegacion treanëtarësh i palës shqiptare dhe një i palës greke mbrojnë qëndrimet e veta lidhur me pretendimet territoriale të Greqisë. Derisa përfaqësuesit e palës shqiptare, Mehmed Konica, Turhan Pasha Përmeti dhe Mihal Turtulli ofrojnë faktet, sipas të cilave në zonën e Çamërisë jetojnë 60.000 banorë nga të cilët 40.000 shqiptarë myslimanë dhe vetëm 6.000 grekë, përfaqësuesi i palës greke, Carapanos pohon se Greqia "është e vetmja që mund ta administrojë si duhet Shqipërinë". Alexandros Carapanos, sipas fjalëve të veta në transkript, është vetë me origjinë shqiptare, por zgjedh identitetin grek, mbështetur në religjion.

Dokumentacioni përfshin edhe ndonjë artikull gazete.

Dokumentacioni i fazës së dytë nis me një letër në “London Times” të Edward Gleichenit dhe të Aubrey Herbertit, të datës 12 janar 1923, në të cilën bëhet apel për ndaljen e dëbimit të shqiptarëve nga Greqia, ndërsa ofrohen edhe shumë artikuj të tjerë gazetash që e denoncojnë dhunën ndaj çamëve nga grekët. Po ashtu, paraqiten edhe një varg dokumentesh që e dokumentojnë dhunën ndaj çamëve myslimanë. Ofrohen dokumente dhe komunikime zyrtare të zyrtarëve qeveritarë të Shqipërisë dhe të Greqisë.

Në mesin e letrave është edhe ajo e kryeministrit të Greqisë, Venizelos, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve. Ai banorët e Çamërisë i klasifikon “subjektë myslimanë të Greqisë që i përkasin racës shqiptare”. Mit’hat Frashëri i delegacioneve të Shqipërisë, ndërkaq, i klasifikon “shqiptarë për nga raca a kombi”.

Një pjesë e rëndësishme e dokumentacionit përfshin memorandumet që tregojnë se si “shqiptarët e Epirit dhe të Maqedonisë u detyruan t’i nënshtroheshin shkëmbimit” që tregojnë “rrethanat nën të cilat shqiptarët e Epirit u detyruan t’i lëshonin vendet e tyre”. Kjo fazë përfshin edhe më së shumti dokumente të paraqitura në libër dhe, së këndejmi, zë pjesën qendrore të tij.

Faza e tretë përfshin 18 dokumente të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore deri më 1947. Dokumenti përmbyllës është një letër që përfshin deklaratat e refugjatëve çamë në Shqipëri, të mbijetuar të masakrave të viteve 1944 dhe 1945 në Filat, Paramithia e vende të tjera.

Çamëria është një territor malor përafësisht sa Kosova për nga territori, por

me denduri shumë më të vogël popullsie (rreth 150.000 banorë, folës të greqishtes) dhe pjesa më e madhe e saj shtrihet në kufijtë politikë të Greqisë. Ndonjë autor e ngatërron nocionin Çamëri me nocionin Epir. Çamëria është pjesë e Epirit, i cili është territor më i gjerë.

Çamët flasin një dialekt të toskërishtes jugore. Ky dialekt është karakteristik, për shkak se në të janë ruajtur grupet e vjetra të bashkëtingëlloreve kl, gl (klumësht, gluhë për qumësh, gjuhë), është ruajtur një ‘l në fjalët, në të cilat në dialektet e tjera të shqipes është shndërruar në j, psh. milë (mijë), val (vaj), ndërsa pësorja e foljeve të tipit është bërë, është larë formohet me pjesëzën përemërore u: u ka bërë, u ka larë.

Çamëria është lënë pjesë e shtetit të Greqisë në vizatimin e kufijve të shteteve të Ballkanit pas Luftës së Parë Ballkanike. Në disa dekadat e ardhshme, një numër i madh i çamëve janë dëbuar

ose kanë ikur në vende të ndryshme – shumica në Shqipëri, ndonëse ka komunitete çame sot edhe në Turqi e Amerikë. Pas Luftës së Dytë Botërore janë persekutuar edhe si bashkëpunëtorë të italianëve e të gjermanëve.

“Me gjithë analizat shtruese të sfondeve historike, politike e juridike të shumë konflikteve në Ballkan vitet e fundit, pak rëndësi i është kushtuar tragjedisë së komunitetit etnik çam”, thuhet në librin e Elsiet e të Destanit.

Në të vërtetë, tema e çamëve është trajtuar në studime e publikime të ndryshme, qoftë si temë kryesore, qoftë si sfond, por ky trajtim përfshin kënde të ndryshme vështrimi dhe rrallë gjithëpërfshirëse.

Derisa autorë si Schmitt (libri “Shqiptarët”, 1912) raportojnë, po e zëmë, për banda greke që shkretinin fshatrat të tëra më 1914 në Jug të Shqipërisë, autorë të tjerë si Charles dhe Barbara Jelavich (libri “Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit (1804 – 1920), viti i botimit 2004”) konsiderojnë se ndarja e kufirit në Konferencën e Ambasadorëve më 1913 në jug të Shqipërisë ka qenë më e arsyeshme se ndarja e kufit në pjesën veriore, në të cilën gjithë Kosova, vise shqiptare të Maqedonisë dhe të Malit të Zi mbetën jashtë kufijve të shtetit atëbotë të sapoformuar shqiptar.

Ndërkohë, vitet e fundit është duke u diskutuar edhe për identitetin e çamëve. Studiuesi i ri rus Matvey Lomonosov në punimin “The Chams? Who are the Chams? (botuar më 2011 në revistën “Porta Balkanica”) thotë se nuk ka shenja të identitetit shqiptar në mesin e folësve të shqipes në këtë territor brenda kufijve të Greqisë, ndërsa këta banorë nuk konsiderohen shqiptarë as nga emigrantët e ardhur nga Shqipëria e që punojnë në këtë rajon. Ky studim ka defekte edhe për përkufizimin e çamëve dhe të Çamërisë, ndërsa në këtë rajon e fut edhe Janinën që është pjesë e Epirit, në të vërtetë, por jo të Çamërisë.

Në të vërtetë, siç pohon Elsie në pjesën hyrëse të librit “The Cham Albanians of Grece”, folësit e shqipes në Greqi klasifikohen në tri grupe. Grupi i parë janë arvanitët, në Atikë, Beoti e Peleponez (More, prej nga edhe e “E bukura More”) dhe në ishujt e Gjirit Saronik. Folësit e arvanitishtes janë në shuarje, ndërsa brezat e rinj nuk e mësojnë më dhe komunikojnë vetëm në greqishten. Në grupin e dytë bëjnë pjesë çamët, ndërsa komuniteti i tretë

dhe i madh sot janë emigrantët e ardhur nga Shqipëria që nga vitet nëntëdhjetë.

Ndër publikime të tjera vlen të përmenden librat e Miranda Vickersit, Emanuele Banfit, Konstantinos Tsitseliisit...


Libri “The Cham Albanians of Greece” i përgatitur nga Elsie dhe Destani ofron, në të vërtetë, përmbledhjen më të mirë të dokumenteve për studimin e çështjes çame deri sot. Si i tillë ai është posaçërisht i rëndësishëm për studiuesit e historisë së Ballkanit, por edhe për politikanët dhe veprimtarët e të drejtave të njeriut.

Historiani Noel Malcolm është cituar në shpinë të librit: “Fati i shqiptarëve çamë, është një ndër sekretet më të errëta të historisë evropiane. Ky koleksion dokumentesh – disa nga të cilat të papublikuara ndonjëherë – ofron pak dritë të nevojshme. Do të jetë me shumë interes jo vetëm për historianët e Greqisë dhe të Ballkanit, por për secilin që dëshiron ta kuptojë gjendjen e sotme të çamëve shqiptarë”.

Robert Elsie është albanolog kanadez, studiues dhe përkthyes. Ka botuar dhjetëra libra që kanë të bëjnë me shqiptarët dhe kulturën e tyre, në mesin e të cilëve edhe një histori të letërsisë shqiptare dhe një leksikon historik të shqiptarëve. Po ashtu, ka botuar material për incizimin më të vjetër në shqipen dhe për fotografitë më të vjetra të shqiptarëve.

Bejtullah Destani është studiues i lindur në Prizren, por që jeton në Britani të Madhe. Ka botuar një numër të madh punimesh.

Bardh RUGOVA



IN MEMORIAM

POETI PODRIMJA

Në letrat shqipe Ali Podrimja erdhi me shkëlqim qysh nga fundi i viteve '50 të sh. 20, me shpërthimin e 17-vjeçarit dhe duke u rritur vijoi të ndriçonte si yll për më shumë se gjysmë shekulli, duke na dhënë kështu njërin nga poetët më të mëdhenj të shqipes, Poetin ylli i të cilit do të na ndrijë përjetësisht. Dhe nuk është e rastit që këto ditë fare spontanisht akademik Ali Podrimja quhet **'korife i poezisë shqipe'**, **'princ i poezisë shqipe'**, ndërsa më herët dhe nga studiues të rendit të parë **'bard i poezisë shqipe'**. Në të vërtetë, me veprën që ka lënë prapa Ai i meriton të gjitha këto epitete bashkë dhe shumë më tepër.

Në letrat europiane na ka rënë të vërejmë se poetët që shkëlqejnë në moshë të hershme disi herët i shterrojnë energjitë. Ne kemi pasur fatin e madh që Ali Podrimja vijoi krijimtarinë e tij poetike të niveleve më të larta që kemi pasur për më shumë se gjysmë shekulli, duke na lënë kështu prapa duzina librash me vargje që presin kohë dhe punë të specialistëve për t'u nxjerrë në dritën e vërtetë.

Ali Podrimja ka lindur në Gjakovë, qytet të cilin ai kaq shumë e donte për gjithë atë begati jetësore e shpirtërore që i kishte dhuruar në fëmijërinë e tij, për mrekullitë që thur jeta atje, por edhe për travajat që ka pësuar në gjithë shekullin e kaluar duke qenë dhe më i prekuri në luftën e fundit. Në atë qytet Ali Podrimja i mori mësimet e para dhe nisi të mesmet, por njëherësh mori shumë më tepër se ç'mund të japë shkolla. Aty ai mori dhe grushtet e parë të jetës, duke mbetur herët pa të dy prindërit. Këto do të jenë momente që nuk mund të mos kishin rolin e tyre në krijimtarinë e tij të bujshme poetike. Pas studimeve për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, një kohë punoi si lektor në Rilindja, ndërsa nga viti 1972 si redaktor te botuesi më i madh shqip në Kosovë – "Rilindja". Përmes botimeve të "Rilindjes" ai ka luajtur një rol me rëndësi kulturore e letrare jo vetëm për shqiptarët e ish-Jugosllavisë, po për kulturën dhe letërsinë shqipe në përgjithësi. Përmes tyre ai ka sjellë në gjuhën shqipe shumë kryevepra të letërsisë moderne të botës, duke luajtur kështu një rol me peshë në emancipimin e përgjithshëm të kulturës sonë letrare të zhytur në tradicionalizëm dhe në shtampa ideologjike që sillte realizmi socialist. Ali Podrimja ka qenë gjatë gjithë jetës së tij thellësisht i impenjuar për zhvillimet e poezisë shqiptare në tërë hapësirën gjuhësore, qoftë përmes serisë së botimeve të autorëve vendës që drejtonte ai, pra redaktimit të drejtpërdrejtë, qoftë përmes shijes që përhapte. Por ndikimin më të rëndësishëm në brezat vijues ai e ka

ushtruar pikërisht si poet me shembullin e tij të drejtpërdrejtë. Përtej të gjitha mureve dhe kufijve që na ndanin ndikimi emancipues dhe çlirues i poezisë së Ali Podrimjes nuk ka mundur të mos ndjehej gjithandej në breza të tërë.

Ali Podrimja është çmuar si njëri ndër poetët më të rëndësishëm shqiptarë të kohës sonë. Në një letërsi shpesh të sunduar nga gjedhet tradicionale të shprehjes, Ali Podrimja ka sjellë elemente të reja dhe këto elemente nuk kanë të bëjnë vetëm me vargun, po me motivet, me zërin identitar, me nyjëtimin e dhimbjes dhe të shpresave, të shpresave të mëdha e të idealeve të lirisë, me shqetësimet e një kohe, me shpirtin e qëndresës dhe të qëndrestarisë, me figuracionin, me reflekset, me shprehjen dhe me gjuhën e autorit. Poezia e Ali Podrimjes solli një zë lartësisht të diferencuar dhe modern në poezinë shqiptare me të gjitha tiparet që e cilësojnë modernitetin europian. Në të njëjtën kohë ajo sublimoi fatin e popullit të vet, duke e mbëltuar në universalen dhe duke i dhënë kështu këtij moderniteti një ngjyrë dhe dinamikë të veçantë. Figuracioni, simboli dhe simbolika, mitet e vendit dhe të popullit të vet, shprehja e ngjeshur, eliptike, me kontrastet e shumta dhe mosngurrimi për të folur drejt dhe prerë në suaza të poetikës së tij ia theksuan tërë dinamikën dhe unikalitetin, freskinë që sillte kjo poezi në suaza të varieteteve të modernitetit europian. Kështu ai arriti aspektin e një elementi dinamik të kulturës moderne europiane.

Tematika e lirikës së tij, qëndrimet, orientimi qysh në fillimet e tyre

janë drejtuar rreptësisht dhe nga gjendja e shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe e shqiptarëve në tërësi.

Ky zë i përhershëm i qëndrestarisë, që herë herë vjen e bëhet i hapur fare, shkrihet natyrshëm në mitologjinë vendëse, të cilën e ka nënshtrat dhe ushqim, në historinë e sublimuar: nivelet dhe domenet që kapi Podrimja në lirikën e tij përmes përgjithësimit të përvojave personale me ato të popullit të tij, sidomos me librin **Lum Lumi**, e më vonë, gjithë duke ruajtur gjuhën e mbështetur në figura, simbole e mite të riinterpretuara tradicionale shqiptare, si: **kullë, gur, mur, urë, rrotë, rrugë, pyll, shi, qiell, tokë, dritë, terr, natë, det, lumë, yll, mace, ujk, dhëlpër, zog, pëllumb, guaskë, gjak, fjalë, heshtje, asht, gjah-tar, litar, njeri, fat, Çabrat, Rozafat, Skënderbe, Vlorë, Tomor, Kal i Trojës**, etj., përmes zbërthimit të shprehjeve të dendësuara e të ngurosurra frazeologjike dhe të fjalëve të urta, etj., qoftë dhe në rrëshqitjet e hapura drejt poezisë ndonjëherë të pastër politike, bëjnë që ajo të shkëlqejë jo vetëm dhe jo në rradhë të parë në zbulimet e shprehjes, në farfuritjen bukurtingëlluese, as në rregullsinë formale të vargut, po të ngulë këmbë në shpërthimet, në peshën e të thënit dhe të mendimit e refleksit, për ta bërë të ngjeshur që të depërtojë tek lexuesi me mesazhet e përdegzësuara. Ai rritej natyrshëm bashkë me qëndrimin reflektues, me gjerësinë e vizionit dhe me ngërthimin e fatit, të ekzistenciales vendore të universallizuar. Kjo qysh në fillimet e kishte çuar tek kërkimi i rrënjëve, tek lidhja me vatrën, tek vetëdija

se “fati im është në duart e mia”, “paçka se mbetesh njëqind herë i mallkuar nën yllin tënd”. Poeti Podrimja ishte dinamik, sensi i tij për kohën e hapësirën i hollë, prandaj në më shumë se 5 dekada të krijimit të tij mund të vërehen faza të ndryshme. Në poezinë e Podrimjes ngjet gjithnjë ashtu që përvoja personale, lokale apo shqiptare të përgjithësohet në mënyrë refleksive dhe kështu poezia të universalizohet. Nuk kanë qenë të kota fjalët e tij: “Shkruhet vetëm një libër. Çdo shkrimtar shkruan librin e tmerrshëm në të cilin e derdh tërë jetën e vet”. E tërë poezia e tij, librat e shumtë me degëzimet e pafund tematike, këtë libër të vetëm të jetës së Ali Podrimjes paraqesin.

Faza e tij e parë e poezisë së revoltës shprehet shpesh përmes fatit të përgjithshëm të njeriut dhe përmes reflektimit për jetën dhe vdekjen, për luftën dhe paqen, për dashurinë. Tematika shoqërore apo edhe vetë tematika e mjedisit po ashtu nuk mungonin.

Më vonë Ali Podrimja arriti nivele dhe domene të reja, sidomos me librin **Lum Lumi**, që çmohet si një nga librat më të arrirë poetikë shqip.

Në vitet ‘90 ai doli dhe me poezi krejt të hapur, pse jo edhe politike.

Përtej ligjëtimeve për fatin e shqiptarëve, mjeshtërisht të kapërthtur me pikënisjen të përvoja personale, vrojtimit të tij të thella, reflektimit dhe nganjëherë madje thjesht poetizimeve të situatave, përtej revoltës dhe protestës kundër fatit njerëzor që merr shkas në përvojën lokale dhe përgjithë-

sohet, në poezinë e Podrimjes vjen e formësohet gjithnjë e më dukshëm dhe në mënyrë gjithnjë e më të pjekur një lloj objektivizimi, një distancim, një qëndrim kritik i shprehur më shpesh përmes ironisë.

Tendencat e përgjithshme të lirisë moderne drejt reduktimit, ndonjëherë madje deri buzë hermetizmit, ashtu si dhe një lloj i figuracionit surrealist ndeshen gjithandej.

Qysh nga **Lum Lumi** e t’hu ai solli në poezinë e tij reflekse ekzistencialiste, dilema për qenien, vrojtimit të vetmisë, përballje me refleksin për frikën, për vdesjen, shtroi dilema për fatin e njeriut dhe të njerëzimit, por edhe përvojën dhe nevojën e marrjes së distancave, të ironisë. Mitologjia e tij ta kujton vargun popullor shqip. Vargu kompakt dhe lakonik e me shprehje të thyer në funksion të reliefizimit të mendimit vijnë si pandane për nevojën për të folur qenësisht për thelbësoren, për të shprehur ankthet, frikët e qenies në ato mëtime të ligjshme të lirisë. Me poezi si “Fajtor është shqiptari” apo “Kush do ta vrasë ujkun”, me ato për Sarajevën e shumë të tjera ai dha shembullin se si shkruhet poezi moderne e qëndrestarisë së reflektuar.

Vargu i tij i viteve të rinisë së hershme “Kosova është gjaku im që nuk falet”, i mbujtur në reflekse të shumanshme mitologjike, historike, kulturore e gjeografike, i mbështetur në një botëkuptim të tërë, jo rastësisht u bë slogani frymëzues për luftëtarët e UÇK-së.

Për poezinë e Ali Podrimjes kanë shkruar shumë kritikë e studiues shqip-

tarë e të huaj. Ajo është përkthyer në gjuhë të ndryshme, mund të jetë, mbase, poeti më i përkthyer shqiptar: janë bërë botime të gjera gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht, turqisht, sllovenisht e serboroatisht, maqedonisht, rumanisht e spanjisht, hungarisht e polonisht dhe në shumë gjuhë të tjera, madje qysh në kohën e ish-Jugosllavisë. Jehona e poezisë së tij dhe angazhimeve të saj në të gjitha periudhat ka qenë e madhe në ish-Jugosllavi para viteve '90. Në vitet ,90 Podrimja ishte shumë i pranishëm në Gjermani e Austri, ku veprat e tij botoheshin me mëtesën eksplicite për të përcuar dhe mesazhin çlirimtar të Kosovës, por edhe për ta treguar letërsinë shqipe dhe në dritë tjetër. Austriakët, me rastin e 50-vjetorit të tij të lindjes madje botuan një vëllim me letër dhe destinacion të veçantë me 25 poezi shqip e gjermanisht në vetëm 50 kopje me titullin "Udhëtimi me uj". Gjeste të tilla simbolike për poetin tonë të madh ne nuk kemi ditur të bënim. Më 1999 në Shtutgart ai mori çmimin e rëndësishëm dhe prestigjioz me emrin e romantikut të shquar gjerman Nikolaus Lenau. Jehona e veprës së madhe poetike të Podrimjes bie në sy edhe sot me rastin e shuarjes së tij në tërë shtypin francez, të ndjeshëm për vlerat kulturore e letrare dhe vlerësues për poetin tonë.

Ali Podrimja në të njëjtën kohë është autor tregimesh dhe prozash të shkurta, kritik dhe eseist me sens. Ai shquhet po ashtu si publicist me refleksitet e tij të përditshme lidhur me jetën shoqërore dhe publike shqiptare vazhdimisht të angazhuara fuqimisht në vijën e

një patriotizmi të dinjitetshëm e të shëndoshë, në vijën e shpërnjohjes së ndarjeve dhe të kufijve që na janë imponuar nga të tjerët.

Vepra të veçanta poetike të akademik Ali Podrimjes kanë shenjuar data në shfaqjen e tyre në letrat shqipe. Do të përmend disa:

Thirrje, 1961.

Dhimbë e bukur, 1967.

Sampo, 1969.

Hija e tokës, 1971.

Torzo, 1971.

Folja, 1973.

Credo, 1976.

Drejtpehimi, 1981.

Lum-lumi, 1982.

Fundi i gëzuar, 1988.

Zari, 1990.

Buzëqeshja në kafaz, 1995.

Ishulli Albania, 1998.

Burgu i hapur, 1998,

Pikë e zezë në blu, 2010. etj.

Do të ishte e padrejtë që me këtë shkëlqim të poetit Podrimja të lëbyrnim reagimet e panumërta të qytetarit dhe intelektualit Podrimja për fatin e popullit të tij, për ngërçet e zierjet midis nesh e me të tjerët, për zhvillimet dinamike në letra dhe në jetën shoqërore, për çka dëshmojnë po ashtu vëllime të shumta. Akademik Ali Podrimja është një figurë komplekse letrare e intelektuale e pranishme në jetën tonë të mbi 5 dekadave të fundit.

Për arritjet e tij në radhë të parë në poezi, por edhe në fushat e tjera të veprimtarisë së tij më 1996 Ali Podrimja u zgjodh anëtar korrespondent i

Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa 4 vjet më vonë anëtar i rregullt.

Akademik Ali Podrimja është nderuar me çmime të ndryshme në Kosovë dhe jashtë saj, ndër të cilët shquhen Çmimet: i Dhjetorit, i Nëntorit (i qytetit të Prishtinës), i Rilindjes, i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i Fjalës, çmimi Pjetër Bogdani, çmimi Azem Shkreli, shumë çmime të tjera në hapësirën shqiptare, në Shqipëri e gjetiu. Ka marrë shumë çmime të rëndësishme në Ballkan e në Evropë, ndër të cilët, pos atij Lenau, do të përmendim edhe çmimin që mori tash vonë në Greqi.

Shuarja e parakohshme e akademik Ali Podrimjes është humbje e pakompensueshme për familjen, për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për Kosovën pavarësinë e së cilës aq shumë e gjakoi dhe e përjetoi, për rrjedhat e rritjes së mëtejme të kësaj pavarësie dhe të këtij shteti, sidomos për letrat dhe botën intelektuale shqiptare, për poezinë shqipe dhe për poezinë moderne europiane.

Qoftë i përjetshëm kujtimi për të dhe veprën e tij!

Rexhep ISMAJLI

KRONIKA 2012**MBLEDHJE KOMEMORATIVE E
ASHAK-UT NË NDERIM TË
ANËTARIT TË SAJ TË JASHTËM
TOMË BERISHA**

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovë organizoi mbledhje komemorative në nderim të anëtarit të saj të jashtëm prof. dr Tomë Berisha, më 02.03.2012, në mjediset e Akademisë. Në mbledhje morën pjesë anëtarë të ASHAK-ut, profesorë të Universitetit të Prishtinës, dashamirë të veprës dhe respektues të personalitetit të tij e përfaqësues të mediave. Akademik Mark Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Anëtar i korrespondent Fejzullah Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës, në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kanë marrë pjesë në varrimin e anëtarit të jashtëm të ASHAK-ut prof. dr. Tomë Berishës. Varrimi i të ndjerit është bërë në Dinoshë -Tuz (Republika e Malit të Zi).

**MBAHEN NË TIRANË MBLEDHJET
E KRYESISË DHE TË KËSHILLIT
NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN
SHQIPE**

Në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 6-8 mars 2012 u mbajtën mbledhjet e Kryesisë dhe të Këshillit Ndërakademik për Gjuhën shqipe. U diskutua, u nxorën përfundime dhe u morën vendime për çështje të leksikut, të terminologjisë dhe të anglicizmave në shqipen e sotme standarde. Raporti nga këto mbledhje, i hartuar për Kryesinë e Akademisë nga akademik Rexhep Ismajli, bashkëkryetar i KGJSH-së pasqyron rrjedhën e

punës së këtyre dy organeve. Diskutimet u zhvilluan për materialet e propozuara: 1. Probleme të leksikut në shqipen standarde; 2. Probleme të terminologjisë shqipe; dhe 3. Problemi i anglicizmave në gjuhën shqipe.

**AKADEMI - KUJTESË HISTORIKE
NË 100-VJETORIN E FEDERATËS
PANSHQIPTARE “VATRA”**

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës bashkë me Institutin e Historisë të Prishtinës organizuan në mjediset e Akademisë më 25 prill 2012 Akademi-kujtesë historike në 100-vjetorin e Federatës Panshqiptare “Vatra”. Morën pjesë anëtarë të Akademisë, pedagogë e punonjës shkencorë, studentë, përfaqësues të mediave dhe të tjerë. Kjo Akademi – kujtesë mbahet në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Akademinë e hapi Kryetari i ASHAK-ut akademik Hivzi Islami.

**AKADEMI – KUJTESË HISTORIKE
NË 100-VJETORIN E KUVENDIT TË
JUNIKUT**

Aktiviteti i radhës i organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti i Historisë i Kosovës dhe nga Komuna e Junikut, në kuadër të veprimtarive kushtuar 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë u mbajt në Junik më 21 maj 2012 me Akademinë- kujtesë historike në 100-vjetorin e Kuvendit të Junikut. Nga ASHAK mori pjesë akademik Pajazit Nushi, Nënkryetar i Akademisë, i cili mbajti një fjalë.

**PËRFAQËSUES TË ASHAK-UT NË
KONFERENCËN SHKENCORE
NDËRKOMBËTARE “HUMANIZMI
DHE BOTA MODERNE”**

Në konferencën shkencore ndërkombëtare “Humanizmi dhe bota moderne”, që u mbajt në Podgoricë më 06-09 qershor 2012, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e përfaqësuan anëtari korrespondent Fejzullah Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe Mr.sc. Ardian Gola, asistent në Fakultetin Filozofik të Univesitetit të Prishtinës. Mr Sc. Gola mbajti kumtesën “Theorizing technology in the post-essentialist era”(Teorizimi i teknologjisë në epokën post-esencialiste).

**NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I
BASHKËPUNIMIT MIDIS ASHAK-
UT DHE AKADEMISË BULLGARE
TË SHKENCAVE**

Më 13 qershor 2012, në mjediset e ASHAK-ut u nënshkrua Memorandumi i bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Bullgarisë për vitet 2012-2015. Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë anëtarë të Akademisë dhe të stafit të saj, përfaqësues të mediave. Mori pjesë edhe Ambasadori i Bullgarisë në Kosovë z. Bobi Bibev.

Për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës Memorandumi u nënshkrua nga akademik Hivzi Islami, Kryetar i Akademisë, ndërsa për Akademinë e Shkencave të Bullgarisë nga anëtari korrespondent Atanas Atanasov, Nënkrjetar i Akademisë Bullgare. Bashkëpunimi para-

shihet të zhvillohet, pa kufizime në fushat si: trashëgimia kulturore dhe historike dhe identiteti kombëtar, njeriu dhe shoqëria, shkencat natyrore, biblioteka dhe shkencat informative, ndërkaq për fushat e tjera të bashkëpunimit dy akademitë mund të diskutojnë veçmas.

Bashkëpunimi në fushat e përmendura mund të përfshijë temat me pajtim të ndërsjellë, si projektet e përbashkëta hulumtuese; seminarët e përbashkëta, simpoziumet, diskutimet e tryezës së rrumbullaktë, takimet, konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet tjera shkencore bilaterale dhe multilaterale të organizuara apo bashkëorganizuara nga akademitë; shkëmbimi i shkencëtarëve të veçantë me qëllim të kryerjes së punës hulumtuese; shkëmbimi i informatave rreth aktivitetëve hulumtuese në vazhdim; miratimi i metodave të reja shkencore; mbajtja e ligjëratave; krijimi i kontakteve të reja shkencore; ndjekja e ngjarjeve shkencore; dhe shkëmbimi i publikimeve dhe informatave shkencore.

**PËRURORHET VEPRA E
AKADEMIK MINIR DUSHIT
“QYMYRI I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS**

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 22 qershor 2012 u përurua vepra e akademik Minir Dushit “Qymyri i Republikës së Kosovës”. Në përurim morën pjesë anëtarë të Akademisë, pedagogë të Univesitetit të Prishtinës, punonjës shkencorë, ekspertë të fushës së xehetarisë e energjetikës, studentë e dashamirë të veprës së akademik Dushit, përfaqësues të mediave e të tjerë. Morën

pjesë edhe z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, z. Arben Gjuka, menaxher i Korporatës Energjetike të Kosovës, Prof. Dr. Arqile Teta, pedagog i Universitetit të Tiranës. Për veprën e akademik Dushit folën anët. Korresp. Fejzullah Krasniqi, akademik Nexhat Daci, Prof. dr. Sotir Guxha dhe Prof. dr. Vahdet Pruthi.

NË TIRANË MBAHET MBLEDHJA E KNGJSH

Më 26-28 qershor 2012 u mbledh në Tiranë Këshilli Ndërademik për Gjuhën Shqipe, organ i themeluar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, me autoritet shkencor për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin, përsosjen e përdorimin e shqipes standarde. Kjo është mbledhja e dytë e Këshillit që mbahet në Tiranë gjatë këtij viti, pas mbledhjes së parë, më 6-8 mars 2012, në të cilën u diskutua, u nxorën përfundime dhe u morën vendime për çështje të leksikut, të terminologjisë dhe të anglicizmave në shqipen e sotme standarde. Mbledhja e tanishme e Këshillit u hap me një minutë heshtje për të nderuar profesor doktor Fadil Rakën, anëtar i Këshillit dhe kryetar i grupit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për drejtshkrimin, i cili u nda nga jeta para pak javësh. Në këtë takim të KNGJSH nga Prishtina morën pjesë: akademik Rexhep Ismajli, bashkëkryetar i Këshillit dhe anëtarët: akademik Besim Bokshi, akademik Mehmet Kraja, prof. dr. Imri Badallaj, prof. dr. Bardh Rugova, dr. Shefkije Islamaj, prof. dr. Abdullah Zymberi, prof. Isa Bajçinca dhe prof. dr. Rrahman Paçarizi. Tema

e diskutimeve në mbledhjen e tanishme të Këshillit ishte: Drejtshkrimi i zanores ë të patheksuar në shqipen standarde.

PËRUROHET NË TIRANË BOTIMI I PËRBASHKËT I DY AKADEMIVE TONA “SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT”

Në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 28 qershor 2012 u përrua botimi i përbashkët i dy Akademive tona Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Në këtë botim janë përfshirë materialet e Konferencës shkencore me të njëjtin titull, mbajtur në Prishtinë më 10-11 nëntor 2011. Përrimin e hapi dhe e drejtoi akademik Emin Riza, përgjegjës për shkencat shoqërore në Akademin e Shkencave të Shqipërisë, ndërsa për botimn folën: akademik Mehmet Kraja, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë të ASHAK-ut, akademik Rexhep Ismajli, akademik Kolec Topalli dhe prof dr. Seit Mansaku.

PËRUROHET NË TIRANË VEPRA E AKADEMIK LATIF SUSURIT DHE Prof. Dr. ARBEN MYRTËS “SË-MUNDJET E PEMËVE FRUTORE TË HARDHISË”

Në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 28 qershor 2012 në praninë e akademikëve, punonjësvë shkencorë dhe ekspertëve të fushës së bujqësisë u përrua botimi i përbashkët i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë të autorëve akademik Latif Susuri dhe Prof. Dr. Arben Myrta me titull: “Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhisë”.

PËRURORHEN 8 BOTIME TË ASHAK-ut

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në praninë e anëtarëve të saj, pedagogëve universitarë dhe përfaqësuesve të mediave organizoi më 29 qershor 2012 përrimin e 8 botimeve të veta. Përrimin e hapi Kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami, ndërsa për botimet folën akademik Pajazit Nushi e akademik Rexhep Ismajli. Nga fjala e hapjes e Kryetarit Islami veçnam:

“Akademia në historikun e saj 37 vjeçar, përkundër rrethanave të rënda në periudha të caktuara sikurse e gjithë Kosova dhe përkrye problemeve të vazhdueshme financiare dhe hapësinore deri vonë – ka arritur të realizojë shumë projekte afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata dhe të botojë vepra nga të gjitha fushat e dijeve. Zatën botimet paraqesin një nga format më të rëndësishme të punës së Akademisë.

Akademia i gëzohet daljes në dritë të librit shkencor, i çfardo fushe të jetë, cila do shtëpie botuese ta nxjerrë, i cilit do autor, vetëm le të jetë shkencor. Zhgënjehet kur dalin botime pa asnjë vlerë shkencore ose me vlera të dyshimëta, me përmbajtje patetike e patriotike, që i sjellin vetëm dëme shkencës si sitem i të njohurit dhe i të vërtetës, dëme shoqërisë dhe kombit, në emër të së cilit edhe bëhen.

Pas rënies së komunizmit, veçanërisht këtë dhjetvjetëshin e fundit, në rrafshin e botimeve, botën shqiptare sikur e kaploi një mani: insistimi që me çdo kusht secili “intelektual” shqiptar të botojë së paku një libër, me kriter e pa kriter, ndërsa ekspansioni i teknologjisë (kompjuterët, shtypshkronjat) e mundëson këtë. Ajo që të bën

ta rrokësh edhe malin është fakti kur një autor përruron brenda një dite 2, 3, 4 libra “shkencorë” me tematikë tepër të koklavitur dhe të gjerë në kohë dhe hapësinë!

Në skenë dalin agresivisht dhunuesit e historisë. Përrurimi i botimeve të tyre, në prani të shumë njerëzve dhe të mediave, me shumë pompozitet, shndërrohet në karnavale. Autorët pa përgatitje bazike profesionale, pa asnjë ditë shkollë profesionale, pa tababan shkencor, por me pretendime të mëdha, bëjnë histori katër mijë vjeçare të kombit tonë, nga parahistoria deri në ditët tona! Autodidaktët tjerë në këtë fushë bëjnë vlerësimin e kësaj historie! “Harrojnë” se nuk mund të shkruhet historia e asnjë populli në Ballkan nga autodidaktët në këtë fushë, pa ditur greqishten e vjetër, latinishten, sllavishten e vjetër, ormanishten etj. dhe pa një ekip të madh studiuesish dhe kohë të gjatë.

Historia jonë, e shkruar në këtë mënyrë, që nuk është mbi nivelin e hartimeve shkollore, si një kompilim i cekët, mjerisht shitet shtrenjtë: gumëllojnë mediat, duartroket opinionin, reklamimi nuk ka të ndalur. Fyhen të tjerët, sidomos Akademia, institutet shkencore. Kritikohet Akademia jonë pse nuk po bën si SANU-ja, e cila hartoi platformën për gjakderdhje masive dhe zhdukje fizike të popujve! Improvizohet historia, sajohen teza, lansohen gënjeshtra. Revidohet historia në favorin tonë për patriotizëm dhe konsum ditor: nuk jemi më ilirë, por pellazgë hyjnorë, me mijëra vjet vetëm ne jemi në këto hapësira e marrëzira të tjera. Lëndohet rëndë e vërteta, dhunohet shkenca, njolla e zezë nuk hiqet lehtë, ndërsa dëmi mbetet i pariparueshëm.

Në Akademinë tonë nuk bëhen kështu librat shkencorë. Punohen gjatë kohë, me përgjegjësi të lartë profesionale dhe shkencore. Nga ideja e autorit e deri te dalja e botimit kalojnë disa vjet. Tryezat shkencore, konferencat, simpoziumet etj. Përgatiten gjatë dhe rezultojnë me botimet shkencore. Sot e kemi rastin që t'i përurojmë 8 botime të tilla. Për të mos e zgjatur, po ua jap fjalën akademikëve Pajazit Nushit dhe Rexhep Ismajli që shkurt t'i prezantojnë botimet, që janë vetëm të dy Seksioneve (Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Seksioni i Shkencave Shoqërore). Për 8 botime i kemi dy referues, jo 8, 16 apo 24! Me fjalë dhe me zhurmë nuk bëhet shkenca; ajo bëhet me rezultate konkrete shkencore”.

Akademikët Nushi dhe Ismajli referuan për botimet në vijim:

1. Shpresë Siqeca, Arkitektura folklorike e rajonit të Prizrenit në shekujt xviii-xix;
2. Hivzi Islami, Aspekti etnik i migrimeve, Shqiptarët në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme;
3. Muhamedin Kullashi, Politika, lufta dhe diplomacia, Anarkia ndërkombëtare dhe e drejta;
4. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit - Albanian and Balkan Languages, Konferencë shkencore;
5. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore, Tryezë shkencore;
6. Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Kosovës, Kolokuium shkencor;
7. Studime 18;
8. Vjetari 2011.

MBLEDHJA PËRKUJTIMORE PËR AKADEMIK ALI PODRIMJEN

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës me rastin e vdekjes së anëtarit të saj të rregullt akademik Ali Podrimjes, në mjediset e Akademisë organizoi më 23 korrik 2012 mbledhje përkujtimore. Në mbledhje morën pjesë anëtarë të Akademisë, shkrimtarë nga Kosova dhe Shqipëria, familjarë të Podrimjes, miq e personalitete të njohura, përfaqësues të mediave. Mbledhjen përkujtimore e hapi akademik Hivzi Islami, Kryetar i Akademisë, ndërsa për jetën dhe veprën e akademik Podrimjes fjalë rasti mbajti akademik Rexhep Ismajli.

Më 26 korrik 2012, në mjediset e Akademisë është ekspozuar trupi i pajetë i Akademikut Podrimja. Në shenjë respekti për poetin e shquar dhe për veprën e tij para arkivolit parakaluan dhe u përkulën me respekt mija qytetarë të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë, Malit të Zi e të Kosovës Lindore. Erdhën për ta nderuar Poetin edhe z. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe qeveritarë të Kosovës, z. Aldo Bumçi, Ministër i Kulturës i Shqipërisë dhe shumë personalitete të njohura nga bota e artit. Pas homazheve në nderim të akademik Podrimjes, para mijëra qytetarëve të tubuar në varrezat e Prishtinës, në emër të Akademisë, i fundit nga Podrimja u nda akademik Ali Aliu. Prof. dr. Basri Qapriqi, Kryetar i Pen Qendrës së Kosovës poashu mbajti fjalë rasti për Poetin Podrimja para pjesëmarrësve në varrim.

SEMINARISTËT VIZITOJNË ASHAK-UN

Pjesëmarrësit e Seminarit Ndërko-mbëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare vizituan më 16 gusht 2012 Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Seminaristët u pritën nga Nën-kryetari i Akademisë akademik Pajazit Nushi, i cili u foli për veprimtarinë e Akademisë, me ç'rast e veçoi veprimtarinë e pasur botuese. Pastaj seminaristët vizituan Bibliotekën e Akademisë. Seminaristëve iu dhuruan disa nga botimet e Akademisë.

NË ASHAK PËRURORHET VEPRA E AKADEMIK KOLEC TOPALLIT “GRAMATIKË HISTORIKE E GJUHËS SHQIPE”

Në kuadër të bashkëpunimit midis dy Akademive tona, Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në mjesdiset e Akademisë sonë më 7 shtator 2012 u përurua vepra e akademik Kolec Topallit “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”.

Në përurim morën pjesë anëtarë të Akademisë, punonjës shkencorë të Fakultetit të Filologjisë të UP-së e të Institutit Albanaologjik të Prishtinës, pedagogë edhe të fakulteteve të tjera të UP-së, përfaqësues të mediave etj.

Përurimin e hapi akademik Hivzi Islami, Kryetar i ASHAK-ut, fjalë përshëndetëse mbajti akademik Gudar Beqiraj, Kryetar i ASHSH-së, ndërsa për veprën folën: akademik Rexhep Ismajli, akademik Besim Bokshi, prof dr. Sei Mansaku, prof dr. Imri Badallaj, prof dr. Bardh Rugova dhe akademik Idriz Ajeti.

KONFERENCË SHKENCORE “PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE KOSOVA 100 VJET PAS”

Në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Instituti i Historisë i Prishtinës, më 13-14 shtator 2012, në mjesdiset e Akademisë organizuan Konferencën shkencore me temë: “Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas”.

Në hapjen e Konferencës morën pjesë akademikë nga Kosova dhe Shqipëria, punonjës shkencorë nga vendi dhe bota e jashtëme, studentë dhe qytetarë si dhe përfaqësues të mediave.

Konferencën e përkatiti Këshilli organizues i përbërë nga: Akademik, Hivzi Islami, kryetar, Prof. dr. Jusuf Bajraktari, anëtar, Akademik Pajazit Nushi, anëtar, Akademik Beqir Meta, anëtar, Prof. Dr. Emine Bakalli, anëtare, Ramë Manaj, anëtar, Mr. Shefqet Zekolli, anëtar, Prof. Dr. Frashër Demaj, sekretar. Konferencën e hapi Akademik Hivzi ISLAMI, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Fjalë përshëndetëse mbajti edhe akademik Gudar Beqiraj, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Brenda dy ditëve u prezantuan 38 kumtesa nga specialistë e studiues të historisë, të shkencave juridike, të ekonomisë, politikologjisë, e të kulturës përgjithësisht. Konferencën e përmbylli prof. Dr. Jusuf Bajraktari. Materialet e Konferencës do të botohen.

KONCERT SOLEMN NË 100-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Seksioni i saj i Arteve, në vazhden e veprimtarive të Akademisë kushtuar 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë (e katërta e radhës), organizuan më 12 tetor 2012, në mjediset e ASHAK-ut koncert solemn, në të cilin morën pjesë akademikë, pedagogë e studentë të artit, personalitete të shquara të muzikës dhe përfaqësues të mediave. Koncertin e shpalli të hapur akademik Engjëll Berisha.

Në vazhdim, në një atmosferë festive, me ambient të dekoruar me lule të freskëta artistët: Shkelzen Veseli, aktor, moderues; Besa Llugiqi, soprano; Luan Durmishi, tenor; Armando Likaj, baritone; Sihana Badivuku-Hoxha, violinë; Lule Ballata, flaut/piccolo; Etrita Ibrahim, piano; Alberta Troni, piano; Zana Basha, piano, me në krye akademik Zeqirja Ballatën, realizuan me shumë sukses programin e paraparë.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI NË AKADEMINË BULLGARE TË SHKENCAVE

Në kuadër të shkëmbimit ndërakademik sipas marrëveshjes së bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Bullgarisë akademik Rexhep Ismajli, Kryetar i Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare ka qëndruar në Sofje nga 14 deri më 21 tetor 2012. Qëndrimi është realizuar sipas programeve të hulumtimit në institutet e Akademisë Bullgare: Instituti i Gjuhës Bullgare, Instituti i Tra-

kologjisë, Instituti i Studimeve Ballkanike, me mikpritjen e Akademisë Bullgare të Shkencave. Nga raporti me shkrim i Akademik Ismajlit për Kryesinë e Akademisë, ndër të tjera rezultojnë se: programi i hulumtimit të tij është përqendruar në pikat: 1. gjuhësi ballkanike, 2. studimet trakologjike, 3. korpusi kombëtar i gjuhës bullgare.

KRYETARI I ASHAK-UT DHE AKADEMIK EQREM BASHA VIZITOJNË AKADEMINË SLOVENE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Në vazhden e vizitave të ndërsjella, të mbështetura në Marrëveshjen për bashkëpunim shkencor dhe artistik midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, nga data 7-10 nëntor në Lubjanë qëndruan Kryetari i ASHAK-ut, akademik Hivzi Islami dhe akademik Eqrem Basha. Vizita u realizua edhe në mbështetje të ftesës së ASSHA për diskutimin e bashkëpunimit të mëtejshëm shkencor dhe artistik në vitin që vjen, si dhe për realizimin e pikave të mbetura nga programi i mëhershëm.

EKSPOZITË ME VEPRA TË ARTEVE PAMORE NË 100 VJETORIN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Seksioni i saj, në vazhden e aktiviteteve për shënimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ka organizuar ekspozitën me vepra të arteve pamore të autorëve shqiptarë. Ekspozita është hapur më 13 nëntor 2012, në mjediset e Akademisë, në të cilën morën pjesë anëtarë të

ASHAK-ut, punonjës e dashamirës të arteve pamore, qytetarë e përfaqësues të mediave.

Ekspozitën e deklaroi të hapur akademik Hivzi Islami, Kryetar i Akademisë, duke theksuar se “Me këtë ekspozitë, Akademia po përmbyllë suksesshëm aktivitetin për nder të njëqind vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, duke iu kundërpërgjigjur kritikeve, të cilat deklarojnë se Akademia nuk po bënë aq sa duhet për shënimin e kësaj date jashtzakonisht të rëndësishme të Kombit tone. Ne nuk po lëvdohemi se, vetëm ne kemi bërë veprimtari, por e theksojmë se Akademia është i vetmi institucion, që me një koncept dhe një program të qartë ka shënuar këtë përvjetor”.

Në kuadër të shënimit të jubileut të madh të mëvetësisë së Shqipërisë, para ekspozitës, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka mbajtur edhe një koncert me muzikë serioze; bashkë me Institutin e Historisë, ASHAK-u ka organizuar një tryezë për shënimin e 100-vjetorit të Shoqatës Panshqiptare “Vatra” të Amerikës, ka shënuar 100–vjetorin e “Kuvendit të Junikut” si dhe ka organizuar konferencën shkencore dyditore me ekspertë të të gjitha trojeve shqiptare dhe më gjerë me temë: “Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas”, ka theksuar ai. Akademik Islami, po ashtu ka bërë të ditur se ka qenë kërkesë e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, që të gjitha këto aktivitete të mbahen nën patronatin e Presidentes Atifete Jahjaga, por, nga kjo e fundit nuk ka pasur gatishmëri për bashkëpunim. “Ne kemi pasur dëshirë që patronazhin t’ia japim Presidentes së Kosovës dhe ia ofruam, por nuk pati gatishmërinë që ta marrë”.

AKADEMIK REXHEP FERRI NDEROHET ME ÇMIMIN “QY- TETAR NDERI I VLORËS”

Akademik Rexhep Ferri, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, është nderuar nga Këshilli i Bashkisë së Vlorës, me propozimin e z. Shpëtim Gjika, Kryetar i Bashkisë, me titullin “Qytetar Nderi i Vlorës”, me motivacionin: “Për kontributin e rëndësishëm si poet, prozator e eseist, por mbi të gjitha si krijues i arteve pamore dhe një ndër personalitetet më të spikatura të brezit të piktorëve modernistë të Kosovës, për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar shqiptar dhe historiesë sonë mbarëshqiptare”. Fletdëshmia i është dorëzuar në një ceremoni rasti dhe pritje madhështore nga Kryetari i Bashkisë së Vlorës zoti Shpëtim Gjika, organizuar në mjediset e Universitetit “Pavarësia” të Vlorës, më 25 nëntor 2012.

PËRFAQËSUES TË ASHAK-ut NË PARIS

Në kuadër të veprimtarive të Komisionit për marrëdhënie ndërkombëtare të ASHAK-ut lidhur me zgjerimin e bashkëpunimit me akademitë evropiane, nga 6-9 dhjetor 2012 delegacioni i përbërë nga Kryetari i ASHAK-ut Akademik Hivzi Islami, kryetari i Komisionit për marrëdhënie ndërkombëtare i ASHAK-ut, akademik Rexhep Ismajli dhe anëtari i këtij komisioni akademik Eqrem Basha, zhvilloi një vizitë në Paris me synimin e vendosjes së bashkëpunimit me Institut de France, të njohur si Akademia Frënge. Ishte parashikuar që ky kontakt të vendosej me dy nga 5 Akademitë e Institut de France, por për shkak të

agjendave të ndryshme të këtyre institucioneve dhe kohës së shkurtë të qëndrimit të delegacionit në Paris, u realizua kontakti konkret zyrtar me njërin prej këtyre akademive: Académie des inscriptions et belles-lettres që bashkon anëtarë të fushave filologjike e linguistike, të kulturave të lashta, të parahistorisë e historisë së hershme, të letërsisë, të mbishkrimeve e shkrimeve të hershme, etj. Mbetet që në të ardhmen të realizohet kontakti zyrtar me Académie des sciences, e cila bashkon anëtarë të fushave të shkencave të natyrës dhe të sakta.

Takimi zyrtar u realizua me 8 dhjetor 2012 në Paris dhe në të merrnin nga pala franceze anëtarë i akademisë Michel Zink, Sekretar perpétuel, dhe Hervé Danesi, Secrétaire general i Académie des inscriptions et belles-lettres. Në takim ishte i pranishëm edhe Ambasadori i Republikës së Kosovës në Paris, Muhamedin Kullashi. Pjesa e parë e bisedës ishte e natyrës njohëse: u paraqit historia, përbërja, funksionet, detyrat, veprimtaria shkencore dhe botimet e ASHAK-ut. Ishte konstatim i përbashkët që ASHAK-u me katër seksionet e tij paraqet ngjashmëri me ndarjet që ka në kuadër të 5 akademive të Institut de France, e cila vepron tashmë 4 shekuj.

U propozua vendosja e një marrëveshjeje bashkëpunimi që do të synonte: shkëmbimin e botimeve; organizimin eventual të veprimtarive të përbashkëta; shkëmbimin e ligjëratave të anëtarëve të dy akademive; pjesëmarrjen në veprimtaritë e secilës prej akademive sipas interesit konkret,

etj. U la e hapur të shihen dhe mundësitë e organizimeve të projekteve të përbashkëta në një kuadër më të gjerë, duke

përfshirë aty dhe institucione të tjera që mund të kenë interes. Anëtarë i Akademisë frënge Michel Zink, pasi shprehu kënaqësinë për këtë kontakt dhe sugjerimet për fushat në të cilat Akademia e tyre mund të kishte më shumë interes për këtë bashkëpunim, duke lënë të kuptoheshin edhe bartësit eventualë nga ana e tyre, sugjeroi mundësinë që në këtë kuadër të përfshiheshin dhe anëtarët e Collège de France dhe të institucioneve të tjera.

Përfundime të përbashkëta:

- ASHAK të dërgojë modelet e marrëveshjes për bashkëpunim, në mënyrë që Akademia frënge të shënojë komentet e saj;
- ndërkohë të nisin bashkëpunimet me ftesa për ligjërata, ndër të cilat e para do të ishte ftesa për Sekretarin perpétuel (Sekretar i përhershëm, funksion me rëndësi thelbësore në këtë Akademi) Michel Zink, specialist i letërsisë dhe filologjisë së vjetër e mesjetare frënge në Prishtinë dhe i një specialisti që do të zgjedhin nga ASHAK ata në Paris, sipas agjendave përkatëse;
- me rastin e vizitës së M. Zink në Prishtinë mund të organizohet edhe ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit, i cili ndërkohë mundet që tashmë të ketë nisur konkretisht;
- u ra dakord që mund të ketë interes të përbashkët në fushat e linguistikës, të studimeve krahasimtare, të kulturave, të mbishkrimeve dhe të historive të vjetra gjuhësore në Ballkan, të arkeologjisë (neolitiku), etj.
- nismat konkrete duhet të fillojnë brenda pjesës së parë të vitit 2013, ndërsa vizita e M. Zink në Prishtinë mund të pritët nga pranvera e këtij viti”.

ISH-KRYEMINISTRI I KOSOVËS HARADINAJ VIZITON AKADEMI- NË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Ish-Kryeministri i Kosovës z. Ramush Haradinaj, njëherësh Kryetar i Aleancës për Ardhmëdinë e Kosovës, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij zotrinjët: Avni Arifi, Burim Ramadani dhe Besnik Tahiri, më 13 dhjetor 2012 ka vizituar Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Vizita është realizuar me kërkesën e z. Haradinaj. Zoti Haradinaj me shoqëruesit e tij u pritën nga Kryesia e Akademisë: akademik Hivzi Islami, Kryetar, akademik Pajazit Nushi, Nënkryetar, akademik Isuf Krasniqi, Sekretar i përgjithshëm, akademik Mehmet Kraja, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, akademik Mark Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Fejzullah Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës, akademik Zeqirja Ballata, Sekretar i Seksionit të Arteve dhe akademik rexhep Ismajlit. Në pritje morën pjesë edhe znj. Lendita Pula, Sekretare e Akademisë e mr. Zija Bylykbashi, Këshilltar i Kryetarit të Akademisë.

Kryetari Islami u uroi mysafirëve mirëseardhje dhe përshëndeti vendimin e Gjykatës së Hagës për shpalljen e z. Haradinaj të pafajshëm për akuzat e pabaza ndaj tij dhe bashkëluftëtarëve të tij. E vlerësoi lart kontributin e që ai dha gjatë luftës dhe punën e suksesshme të Qeverisë së Kosovës në kryesimin e tij. Veçoi angazhimin e tij për menjanimin e pengesave për fillimin e ndërtimit të godinës së re të Akademisë. Në vazhdim foli për arritjet dhe problemet me të cilat është përballur Akademia gjatë

rrugtimit të saj në rrethana shumë të vështira e me shumë sfida, sidomos pas suprimimit me dhunë të institucioneve kosovare nga Serbia. Kryetari e informoi edhe për problemet e pasqirimit me të cilat po vazhdon të ballafaqohet Akademia. Në këtë kontekst, veçoi fushatën e egër të disa qarqeve të caktuara (përfshirë edhe disa deputet të Kuvendit të Kosovës) kundër Akademisë dhe përpjekjet e tyre që perms ndryshimit të Ligjit të Akademisë ta rënojnë autonominë e saj.

Zoti Haradinaj, fillimisht, u falënderua për pritjen që i është rezervuar nga Kryetari Islami dhe Kryesia e Akademisë dhe se, për këtë ndihet i nderuar. Për Akademinë dhe për punën e saj të deritanishme shprehu respektin e tij të vaçantë dhe shtoi se i çmon traditat e mira të saj. Respekt duhet të ketë edhe shoqëria, ndërkaq institucionet përkatëse duhet të ofrojnë kushte më të mira për veprimtarinë e Akademisë. Zoti Haradinaj fushatën e paskrupull të disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës kundër Akademisë e cilësoi të turpshme, ndërkaq ofroi përkrahjen e tij dhe të Partisë që ai e drejton për Akademinë. Ish Kryeministri i Kosovës shpalosi para Kryesisë së Akademisë arsyet e ofertës së tij për t'u inkudruar në bashkëqeverisjen e Kosovës, si: "shkalla e lartë e kontaminimit të shoqërisë"; marrja e përgjegjësive për ta luftuar "kontaminimin"; largimi edhe "substancial i Serbisë nga veriu i Kosovës dhe qasja ndaj sebëve të atjeshëm", etj.

**TRYEZË MUZIKOLOGJIKE ME
TEMË: FAN S. NOLI SI
KOMPOZITOR DHE STUDIUS
MUZIKOR**

Akademia e Shkencave dhe e Ateve e Kosovës, përkatësisht Seksioni i Arteve organizuan Tryezë Muzikologjike me temë: Fan S. Noli si kompozitor dhe studiues muzikor. Tryeza u mbajtë në mjediset e Akademisë më 18 dhjetor 2013, në praninë e anëtarëve të Akademisë, pedagogëve të fushës së artitit të Universitetit të Prishtinës, artistëve të artit muzikor, të dashamirësve të jetës dhe veprës së Nolit dhe përfaqësuesëve të mediave. Tryezën e deklaroi të hapur akademik Zeqirja Ballata, Sekretar i Seksionit të Arteve të ASHAK-ut. U paraqitën dy trajtesa nga akademikët Engjell Berisha dhe Zeqirja Ballata.

**HAPET EKSPozITA PERSONALE E
AKADEMIK REXHP FERRIT**

Ekspozita personale e akademik Rexhep Ferrit, e paraparë të realizohet me programin e punës së Seksionit të Arteve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për këtë vit, u hapë më 20 dhjetor 2012, në mjediset e ASHAK-ut, në praninë e anëtarëve të Akademisë, pedagogëve të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës, artistëve dhe studentëve të arteve pamore, familjarëve të autorit, të mediave dhe të qytetarëve të tjerë të shumtë dashamirës të veprës së Akademik Ferrit.

Ekspozitën e hapi akademik Zeqirja Ballata, Sekretar i Seksionit të Arteve të ASHAK-ut. Ai, me këtë rast u ndal te: “kompozicioni, ngjyrat e përdorura racionale, format komplekse etj. të opusit të gjerë të

piktorit Ferri”. Akademik Eqrem Basha e vlerësoi Ekspozitën, si më poshtë: Ekspozita e Rexhep Ferrit vjen në mbyllje të një viti të përmbushur me aktivitete që shënuan 100 vjetorin e pavarësisë së shtetit shqiptar, por edhe si pjesë e programit të pasur të punës së ASHAK. Kjo ekspozitë, bashkë me atë të para pak kohëve për të shënuar jubileun e madh, inauguron këtë hapësirë edhe si një galeri artistike ku në të ardhmen shpresojmë të kemi mundësinë të ndjekim dhe paraqitje të tjera.

Zija BYLYKBASHI

PËRMBAJTJA

LIGJËRATA, TË ANËTARËVE TË RINJ TË ASHAK-UT.....	5
Akademik Hivzi ISLAMI, FJALA E KRYETARIT TË ASHAK.....	7
Akademik Kolec TOPALLI, FJALA E MBAJTUR NË AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS.....	9
Kolec TOPALLI, DISA REZULTATE NË STUDIMIN E ZHVILLIMIT HISTORIK TË GJUHËS SHQIPE.....	11
STUDIME, ARTIKUJ	23
Besim BOKSHI, RIMARJA E KUNDRINAVE NË GJUHËT BALLKANIKE	25
Rexhep ISMAJLI, GJENEZA E TEKSTIT DHE CAMAJ	33
Kolec TOPALLI, SHITESIMI I HUAZIMEVE NGA GJUHËT BALLKANIKE NË NJË FJALOR ETIMOLOGJIK.....	45
Bardh RUGOVA, GJUHA E KUMTESAVE PËR SHQIPEN STANDARDE.....	53
Lindita TAHIRI, KONSTRUKTIMI I IDENTITETIT TË KOSOVËS NË MEDIAT NDËRKOMBËTARE	61
Shaban SINANI, TEKSTI BIBLIK NË VEPRËN E MIGJENIT	71
Dhurata SHEHRI, KRITIKA LETRARE DHE TERMINOLOGJIA	101
Hivzi ISLAMI, LUFTA KUNDËR FAKTORIT DEMOGRAFIK SHQIPTAR SI STRATEGJI AFATGJATE E POLITIKËS SERBO-JUGOSLLAVE	109
Arsim EJUPI, ZHVILLIMI DEMOGJEOGRAFIK I LUGINËS SË PRESHEVËS – VËSHTRIM RETROSPEKTIV	123
Fehari RAMADANI, QËNDRIMI I AUSTRO-HUNGARISË NDAJ LËVIZJES KULTURORE SHQIPTARE GJATË VITIT 1910	143
Pajazit NUSHI, HASAN TAHSINI DHE PIKËPAMJA E TIJ PËR KAUZALITETIN SHPIRTËROR	165
Albert DOJA, NDERI, BESA DHE BESIMI: QASJE GJUHËSORE ANTROPOLOGJIKE NDAJ VLERAVE MORALE DHE FETARE.....	179
Edi SHUKRIU, ARTI PARAHISTORIK SHKËMBOR I VLASHNJËS - SPIRALET DHE DRERI	203

Exhlale DOBRUNA-SALIHU, SKULPTURA E IMTË E BRONZIT NË PJESËN QENDRORE TË DARDANISË (KOSOVËN E SOTME) GJATË KOHËS ROMAKE	217
Shpresë SIQECA, VESHJET KOMBËTARE TË KOSOVËS NË FUND TË SHEKULLIT XIX DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX	241
Abaz HADO, ARTI PAMOR I RILINDJES KOMBËTARE	257
Ilijana DEMA, PËR NJË QËNDRIM RACIONAL NË INTERPRETIMIN E FIGURAVE RITMIKE TË PARREGULLTA IRRACIONALE	273
PËRVJETORË	283
Hivzi ISLAMI, Kryetar i ASHAK-ut, ME RASTIN E 5-VJETORIT TË PAVARËSISË SË KOSOVËS	285
Akademik Hivzi ISLAMI, KONFERENCA SHKENCORE “PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE KOSOVA 100 VJET PAS”	291
Engjëll BERISHA, NJËQINDVJETORI I SHPALLJËS SË SHQIPËRISË NË ARTIN MUZIKORË.....	297
KRITIKA, RECENSIONE	301
PROMOVIMI I VEPRËS SË AKADEMIK KOLEC TOPALLIT GRAMATIKË HISTORIKE E GJUHËS SHQIPE.....	303
Rexhep ISMAJLI, VEPËR ME VLERË SINTETIZUESE	303
Besim BOKSHI, GRAMATIKË HISTORIKE E GJUHËS SHQIPE E AKADEMIK TOPALLIT	307
Seit MANSAKU, GRAMATIKA HISTORIKE E AKADEMIK KOLEC TOPALLIT.....	309
Imri BADALLAJ, PËRURIMI I LIBRIT GRAMATIKË HISTORIKE E SHQIPES E AUTORIT AKADEMIK KOLEC TOPALLI.	314
Bardh RUGOVA, KUSH DO TA LEXOJË KËTË LIBËR?.....	317
Rexhep Ismajli: RES ALBANICAE. RIVISTA DI ALBANOLOGIA, anno I, n. 1, marzo 2012, pp. 265; anno I, n. 2, settembre 2012, pp. 271.	319
Bardh Rugova: Robert ELSIE - Bejtullah DESTANI: THE CHAM ALBANIANS OF GREECE, Tauris 2013, ff.	323
Rexhep ISMAJLI, POETI PODRIMJA, In Memoriam.....	327
Zija Bylykbashi: KRONIKA/2012	333

STUDIME

19

2012

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Mr. Shefqet Riza

Lektor për anglisht:

Hilmi Zogjani

Rezymetë anglisht i përktheu:

Xhemshit Brajshori

Redaktor teknik:

Taulant Veseli

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 21.68 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

U shtyp në shtypshkronjën:

“Grafobeni“

Prishtinë